



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

**SISTEMI FOLJOR NË PËRMBLEDHJEN
“VISARET E KOMBIT”**

(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)

**Doktorante:
MA. Blerina Kraja**

**Udhëheqës shkencor:
Prof. dr. Mimoza Priku**

Shkodër, 2021



DOKTORATË

Përgatitur nga: Blerina KRAJA

Për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Specialiteti: Gjuhësi

Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”

(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Mimoza Priku

Mbrohet më dt. _____ përpara jurisë të përbërë nga:

1.....kryetar

2.....anëtar (oponent)

3.....anëtar (opponent)

4.....anëtar

5.....anëtar

Shkodër, 2021

Mirënjohje

Janë të shumtë njerëzit dhe institucionet që meritojnë një falënderim të posaçëm në shenjë mirënjohjeje nga ana ime për ndihmën, këshillat, sugjerimet që, me shumë bujari e pa u kursyer, më kanë dhënë në forma të ndryshme.

Dëshiroj të falënderoj përzemërsisht Prof.dr.Mimoza Priku (Teli) për angazhimin që mori përsipër duke më orientuar dhe drejtuar në hapat e mia drejt përgatitjes së këtij punimi. Vërejtjet dhe sugjerimet e saj të vyera kanë luajtur pa diskutim një rol të rëndësishëm gjatë strukturimit, hartimit dhe shkrimit të kësaj teze.

Falënderimet e mia të posaçme, si institucione, u shkojnë Insitutit të Albanologjisë nën drejtimin e Prof.dr.Artan Haxhi, Departamentit të Gjuhësisë të Universitetit të Shkodrës, të drejtuar nga Prof.as.dr. Rrezarta (Hoti) Draçini, për mbështetjen që më kanë dhënë, në miratimin e tezës duke më nxitur drejt realizimit të një projekti konkret.

Me shumë mirënjohje falënderoj punonjëset e Bibliotekës Universitare dhe të Bibliotekës “Marin Barleti” për gatishmërinë me të cilën më kanë ndihmuar duke më vënë në shërbim studimin e literaturës së nevojshme.

I jam mirënjohëse pafund prindërve të mi për mbështetjen psikologjike e shpirtërore që më kanë dhënë.

Në fund, një falënderim të veçantë për familjen time, për bashkëshortin dhe vajzën time pa mbështetjen dhe durimin e vazhdueshëm të së cilës nuk do të kisha qenë në gjendje të finalizoja një sipërmarrje të tillë.

PASQYRA E LËNDËS

Faqja e titullit	I
Mirënjohje.....	II
Përmbajtja e lëndës.....	III
Parathënie.....	V
Objekti dhe qëllimi i studimit	VI
Metodologjia.....	VII

KREU I: TRADITAT GOJORE DHE KËNGËT E KRESHNIKËVE

1.1 Dy fjalë për përmbledhësit e kësaj pasurie.....	11
1.2 Traditat gojore dhe Këngët e Kreshnikëve.....	15
1.3 Epika shqiptare dhe historiku i saj.....	17
1.4 Botime e ribotime. Krahasimi mes botimeve të ndryshme.....	19

KREU II : ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË SISTEMIT FOLJOR NË GJUHËN SHQIPE

2.1 Disa tipare të sistemit foljor.....	21
2.2 Foljet me kuptim të zbehtë leksikor.....	24
2.2.1. Foljet modale.....	24
2.2.3. Foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit	29

KREU III : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS DËFTORE

3.1 Format e kohës së tashme të mënyrës habitore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror	39
3.2 Format e kohës së shkuar të mënyrës habitore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror	62
3.3 Format e kohës së ardhme.x	96
3.4 Kuptimet e këtyre kohëve.....	109

KREU IV : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS HABITORE

4.1 Format e kohës së tashme të mënyrës habitore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror	125
4.2 Format e kohës së shkuar të mënyrës habitore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror	127
4.3 Kuptimet e këtyre kohëve.....	131

KREU V : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS LIDHORE DHE KUSHTORE

5.1	Format e kohës së tashme të mënyrës lidhore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror.....	134
5.2	Format e kohës së shkuar të mënyrës lidhore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror.....	140
5.3	Probleme të mënyrës kushtore.....	141
5.4	Kuptimet e këtyre kohëve.....	142

KREU VI : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS DËSHIRORE DHE URDHËRORE

6.1	Format e kohës së tashme të mënyrës dëshirore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror.....	145
6.2	Format e kohës së shkuar të mënyrës dëshirore. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror.....	150
6.3	Probleme të mënyrës urdhërore.....	151
6.4	Kuptimet e këtyre kohëve.....	155

KREU VII. FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

7.1	Format e pashtjelluara mbi bazën e pjesores.....	163
7.2	Paskajorja me përdorimet e saj.....	167

KREU VIII. FORMIMI I FOLJEVE

8.1	Folje të parme.....	176
8.2	Foljet e prejardhura me parashtesim.....	176
8.3	Foljet e prejardhura me prapashtesim.....	177

KREU IX : PËRFUNDIME

Përfundime	179
Bibliografi	192
Abstrakt	

PARATHËNIE

Tema me titull “Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit” (Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)” është përzgjedhur si një tezë hulumtuese në nivel doktorature me qëllim që të zbulojë prirjet gjuhësore në sistemin foljor në folklor. Studiuuesit kanë vënë re se gjuha e folklorit i përmbahet gjithandej një farë koineje mbidialektore¹, që është fryt, pikërisht i atij procesi të gjatë konverguës.

Meqënëse interesat tona shkencore dhe formimi ynë gjuhësor, përkatësisht njohja e nëndialekteve dhe e të folmeve të Veriut, kryesisht e gegërishtes veriperëndimore, variant i përdorur nga të dy mbledhësit, At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti, na jepte mundësi vëzhgimi në mikrostrukturë, menduam të kufizoheshim në studimin e strukturës foljore të kësaj vepre, duke u fokusuar kryesisht te Kângët e Kreshnikëve.

Për arsytet e përmendura më lart, në realizimin e një përshkrimi dhe të një analize sa më të plotë dhe të qartë të sistemit foljor të përdorur nga dy mbledhësit, At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti, kemi marrë në shqyrtim botimin origjinal të “Visareve të Kombit” Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda, botuar në Tiranë nga Shtypshkronja “Nikaj”, (Botimet e komisionit të krenitivet të 25 -vjetorit të vet – qeverimit 1912 – 1937).

Duke vlerësuar dhe përvetësuar arritjet e studimeve të mëparshme lidhur me gegërishten veriperëndimore, nëpërmjet këtij punimi jemi përpjekur t’i plotësojmë ato, duke studiuar më gjerë sistemin foljor, në kategoritë morfologjike, ku jemi ndeshur me karakteristika specifike apo edhe me raste të izoluar të përdorimeve kohore. Interes për këtë vepër kanë shfaqur gjuhëtarë të ndryshëm, brenda dhe jashtë kufirit me studime, artikuj, trajtime edhe të përziera letrare e gjuhësore, të cilat në tërësinë e tyre na kanë dhënë një pamje të vlerave kombëtare të Këngëve të Kreshnikëve, apo siç është quajtur ndryshe Epos i Kreshnikëve apo Cikël i Kreshnikëve.

Nga shqyrtimet mirëfilli gjuhësore, kemi dalë në përfundimin se janë të pakta trajtimet morfologjike për sistemin foljor të përmbledhjes “Visaret e Kombit II”.

Punimi i Prof. Gjovalin Shkurtaj “Disa dukuri të gjuhës së epikës legjendare”², gjithashtu punimi i Mahir Domit “Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë”³, punimi i Prof. Kolë Ashtës “Elemente të lashta gjuhësore në këngët e kreshnikëve”⁴, artikulli i Bahri Becit “Rreth disa veçorive gjuhësore të këngëve tona epike”⁵, vepra e Prof. Shaban Demiraj “Gramatika historike e gjuhës shqipe”,⁶ “Dialektologjia”⁷ e J.Gjinarit dhe Gj. Shkurtaj, gramatikat normative të sotme dhe ato historike na kanë shërbyer si mbështetje për të zgjeruar trajtimin tonë gjuhësor në lidhje me sistemin foljor të përmbledhjes “Visaret e Kombit” Vëllimi II.

¹J.Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f.73.

² Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Çështje të folklorit shqiptar* 3, Simpoziumi: Epika heroike shqiptare, 20-22 tetor 1983, Tiranë, 1987, f.292-295.

³ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Çështje të folklorit shqiptar* 2, Tiranë, 1986, f.77-103.

⁴ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Çështje të folklorit shqiptar* 3, vep. e cit., f.312 -317.

⁵ B. Beci, *Rreth disa veçorive gjuhësore*, pun. i cit.

⁶ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986; *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

⁷ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep.e cit.

Objekti dhe qëllimi i studimit

Objekti kryesor i këtij punimi është përshkrimi dhe analizimi i sistemit foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit" Vëllimi II, *Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*, (Mbledhë e redaktue nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti), si një prej rrugëve për të hedhur dritë mbi gjendjen dhe zhvillimin e sistemit foljor në të folmet e Mbishkodrës rreth viteve 20-40-të shekullit XX -të. Shtrirja territoriale e këngëve të Ciklit të Kreshnikëve, siç dëshmohet edhe në **Hymje** të "Visaret e Kombit" II i përkasin trojeve të Shqipërisë së Veriut: *"Kângët, qi siellen rreth këtij kreshniku e rreth shokve të tij, nuk këndohen gjithkund; por kemi me i ndie posaçe në Malcí të Madhe, në Dugagjin, në Kosovë, në Pukë, në Dibër, në Ljare e në Shestan"*.⁸

Siç dihet gjuha e folur në viset veriore të Shqipërisë, ruan ende disa tipare të shqipes së autorëve të vjetër të Veriut, që me kalimin e kohës janë zhdukur fare nga të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt, prandaj punimi ka si qëllime kryesore:

1. Njohjen dhe analizimin e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore sipas mënyrave dhe zgjedhimeve, mbaresave përkatëse që dalin sipas kohëve, vetave e numrit, zhvillimeve të tyre të brendshme, sikurse paraqiten në përmbledhjen e studuar.
2. Analizimin e variacioneve të disa formave dhe kuptimeve gramatikore që dalin në këngët e Ciklit të Kreshnikëve.
3. Duke u ndalur në disa raste të veçanta të ndërtimeve morfologjike së bashku me kuptimet gramatikore që ato mbartin, synojmë të paraqesim dhe të analizojmë disa prej zhvillimeve të sistemit foljor të gjuhës shqipe në këtë fazë të ekzistencës së saj, që pasqyrojnë kryesisht karakteristika të gegërishtes veriperëndimore, mjaft të vlefshme për të analizuar aspekte të historisë së shqipes edhe më të vjetër në kohë.
4. Të paraqesim disa prej foljeve e shprehjeve foljore të përdorura në përmbledhje, të cilat dallohen për bukurinë e tyre dhe mund të rigjallërohen, të paktën me funksione dhe stile të veçanta për një pasurim të vërtetë të gjuhës sonë standarde.
5. Të dëshmojmë përpjekjet e mbledhësve të At Bernadin Palajt e të At Donat Kurtit, për ruajtjen dhe mirë përdorimin e gjuhës sonë, duke përzgjedhur motërzimet më të bukura të këngëve të kreshnikëve në viset veriore shqiptare, duke na dhënë kështu një kontribut të paçmuar, edhe si pararendës të shqipes standarde.
6. Njohja konkrete e këtij sistemit foljor, përtej synimeve mirëfilli studimore të gramatikës shqipe, shpresojmë se do të vlejë edhe si ndihmesë për hapësira të reja dhe të vlefshme në analizën e tekstit në shkollat e mesme dhe të larta.

⁸ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit*, Tiranë, 1937, f.IX.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Punimi është hartuar duke u mbështetur në një literaturë të gjerë të studiuesve shqiptarë brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë dhe në koncepte shkencore për dukuri të ndryshme gjuhësore të paraqitura veçanërisht në gramatikat e sotme normative⁹, në gramatikën historike¹⁰ dhe në dialektologji.¹¹

Korpusi i analizuar është nxjerrë nga vjelja terësore për sistemin foljor në punimet në origjinal të:

Botimit të parë, përmbledhjes "**VISARET E KOMBIT**" **VËLLIMI II**, *Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*, (Mbledhë e redaktuëm nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti, Botim i Shtypshkronjës "Nikaj", ISBNIF – 002447, TIRANË, 1937, f. 286).

Botimi i dytë me titull "**EPOSI I KRESHNIKËVE DHE LEGJENDA**" Koleksioni "Visaret e Kombit II", TIRANË, 2005, (Mbledhur dhe redaktuar nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti, Botime "Plejad", f. 345, ISBN 99943-640-9-X).

Botimi i tretë me titull "**VISARET E KOMBIT**": *Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*, (Mbledhë e redaktuëm nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti, Botime Françeskane, Shkodër, 2007, f. 350, ISBN 978-99956-617-3-1).

Vëzhgimet në revistën periodike "HYLLI I DRITËS" që nga botimi i këngës së parë "Gjeto Basho Muji" në Nr.1-2 i vitit 1924, e deri në botimin e plotë të Këngëve Kreshnike në vitin 1929. Të gjitha botimet e Ciklit të Kreshnikëve të cituara pas vitit 1937, i referohen botimit të parë. Ato paraqesin disa ndryshime në interpretime teorike, por gjuhësisht ato nuk kanë ndryshime në sistemin foljor. Për këtë arsye analiza e sistemit foljor dhe shembujt e dhënë janë marrë nga përmbledhja "Visaret e Kombit" II, 1937. Në hyrje të vëllimit gjejmë informacione të përgjithshme të mënyrës në të cilën studimi i folklorit kishte evoluar në botë. Këngët janë paraprirë nga një "Parathënie", në të cilën janë paraqitur aspekte të ndryshme të materialit epik. Ndërsa në vijimësi të "Hýmje" (f. IX-XVI) autorët e kësaj përmbledhjeje trajtojnë çështje të ndryshme që lidhen me rëndësinë historike dhe kulturore të mbledhjes, redaktimit, përpunimit të motërzimeve më të bukura të këtij cikli, siç edhe autorët theksojnë "...i kemi plotësuar këto këngë me shka më të bukur kemi gjetë ndër motërzime me argument të njimishëm, pá pasë nevojë me e bân të rëndë e të mërzitshëm botimin me përsërime".¹²

Cikli i Kreshnikëve përmbledh 34 këngë në 240 faqe të këtij vëllimi, të cilat i kemi bërë objekt studimi në punim, ndërsa vëllimi vazhdon me legjendat e mbledhura në këto troje. "Cikli i Kreshnikëve ruan disa dukuri të vjetra, të rralla e të veçanta të gjuhës sonë"¹³, të cilat u bënë nismë për këtë punim studimor.

Studimi ynë është mbështetur kryesisht në metodën *përshkruese-analizuese*, sipas veçorive të kapitujve, duke pasur si qëllim paraqitjen dhe analizën e një korpusi sa më të gjerë dhe të plotë të formave dhe kuptimeve të foljeve, sipas veçorive gramatikore që dalin në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, *Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda* të At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurtit, një vepër madhore përkrah veprave të tjera që pasqyrojnë zakonet, doket, mbijetesën dhe shpirtin e malësorit në Alpet e Veriut.

⁹ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, Vëllimi I, Morfologjia, Tiranë, 2002.

¹⁰ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986 (ribotim 2002).

¹¹ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.

¹² At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret...*, vep. e cit., f. XII.

¹³ K. Ashta, *Elemente të lashta gjuhësore në këngët e kreshnikëve*, "Çështje të folklorit shqiptar", nr.3, Tiarnë, 1987, f.316.

Një metodë tjetër që kemi përdorur është metoda e *krahasimit*, për të krahasuar veçoritë e sistemit foljor të materialit të vjelë në raport me të folmet e tjera të gegërishtes, e veçanërisht në raport me gjuhën standarde shqipe.

Si burim për metodën *statistikore* kemi përdorur vjeljen manuale të trajtave të përdorura në përmbledhjen e autorëve, për të nxjerrë në dukje disa prej proceseve të formimit të sistemit foljor.

Metodën e *ilustrimit* e kemi trajtuar në dhënien konkrete me shembuj për secilën veçori të sistemit foljor që kemi hasur.

Këta metoda të gërshetuara me njëra-tjetrën, sjellin një tablo më të gjerë të historikut të zhvillimit të të folmeve të zonave të Mbishkodrës në përgjithësi, e të gegërishtes veriperëndimore në veçanti.

Struktura e punimit

Punimi është ndarë në nëntë krerë

Kreu i parë ofron një qasje historike të mbledhjes dhe botimeve të Këngëve të Kreshnikëve. Më tej do të bëhen disa ballafaqime mes botimeve të ndryshme.

Kreu i dytë- Ky kre synon të përcjellë dhe të trajtojë disa çështje të përgjithshme të sistemit foljor siç na vërtetohet në CK, ku do të ndalemi. Do të shqyrtohen disa grupe foljesh me kuptim të zbehtë leksikor.

Kreu i tretë ofron një analizë të ndërtimeve dhe kuptimeve të kohëve të mënyrës dëftore sipas ndarjes: e tashme, e shkuar dhe e ardhme. Do të trajtojmë kohët e saj sipas formës veprare dhe joveprare, duke i klasifikuar foljet sipas zgjedhimeve dhe vetave përkatëse. Ilustrimet me shembuj do të na ndihmojnë për të përcaktuar më saktë përdorimet e formave foljore të kësaj mënyre.

Kreu i katërt do të përmbajë një analizë konkrete të formave dhe kuptimeve të foljeve të mënyrës habitore. Do të ndiqet e njëjta metodologji si tek foljet e mënyrës dëftore.

Në kreun e pestë do të merren në shqyrtim foljet e mënyrës lidhore, sipas ndarjes e tashme- e shkuar. Më vete do të sqarohen disa problematika të mënyrës kushtore.

Kreu i gjashtë merr përsipër analizën e sistemit foljor të foljeve të mënyrës dëshirore dhe urdhërore sipas zgjedhimeve. Do të trajtohen edhe disa kuptime kohore dhe modale të këtyre foljeve.

Kreu i shtatë trajton format e pashtjelluara të foljes në Ciklin e Kreshnikëve, të cilat paraqiten mjaft të pasura. Më vete do të trajtohen probleme të ndërtimit dhe kuptimit të paskajores.

Kreu i tetë trajton disa probleme të formimit të foljeve në Ciklin e Kreshnikëve. Do të trajtohen disa probleme të prejardhjes.

Kreu i nëntë përmban përfundime dhe bibliografinë e shfrytëzuar për realizimin e kësaj teme.

Shkurtesat:

ASHSH = Akademia e Shkencave të Shqipërisë

CK = Cikli i Kreshnikëve

DSH = Dialektologjia shqiptare

FGJSSH = Fjalori i gjuhës së sotme shqipe

SF = Studime filologjike

SSSHS = Seria e Shkencave Shoqërore

VK = Visaret e Kombit

Vep. e cit. = vepër e cituar

Pun. i cit. = punim i cituar

Përshtati = përsht.

* = shembujt nuk po i shënojmë me numër rendor, sepse po lëmë vetëm argumentimet teorike, por do t'i shënojmë vetëm me një *

KREU I: TRADITAT GOJORE DHE KËNGËT E KRESHNIKËVE

1.1 Dy fjalë për përmbledhësit e kësaj pasurie

Provinca Françeskane Shqiptare është një fenomen i rrallë për kulturën shqiptare.¹⁴ Ngjashëm me një zemër përherë në aktivitet, nuk ka reshtur së pompuari oksigjen për venat e kësaj kulture edhe në momentet e asfiksive të mëdha që ka kaluar. Populli i Shkodrës që i njihte fretent ma fort për emen se për punë, pat rasë me e ndie fjalën e Zotit neper gojë të tyne e me e pa zellin e vetmohimin e tyne, shkurt populli i Shkodrës pat rasë me marrë prej tyne mësim e shembull për një jetë ma të lume, ma të gatshme për flije e ma të kulturueme.¹⁵

At Bernadin Palaj, meshtari, etnografi, historiani dhe mbledhësi i Kângëve Kreshnike.

1. Jetëshkrim¹⁶

At Bernadin Palaj ishte i biri i Gjonit dhe Martës (emri i pagëzimit Zef), lindi në fshatin Shllak të Dukagjinit, Shkodër, më 22 tetor 1894, (sipas certifikatës nr.16/70, lëshuar nga gjendja civile e qytetit të Shkodrës, më 2.12.1991) në një familje me tre djem e një vajzë. Bernardini ishte fëmija i parë i familjes.

Mësimet fillore e të mesme i mbaroi në Shkodër pranë Kolegjit Françeskan. U konfirmua më 18 maj 1902 nga Dioqeza e Shkodrës. Pas gjimnazit në Seminarin Françeskan mbaroi edhe studimet e Liceut, në Salzburg, e në Insbruck, përkatësisht në drejtimin filozofi-teologji. Në Insbruck të Austrisë ndoqi edhe kurset universitare të Fakultetit shtetëror të letërsisë. Gjatë studimeve ai tregoi një interes të veçantë për studimet shqiptare, si dhe për autorët e huaj që studiuan zakonet, gjuhën, doket shqiptare.

Më 15 shtator 1911, kur ishte 17 vjeç u bë frat e më 1918 u shugurua si meshtar. Kryesisht e tërhiqnin albanologët gjermanfolës. Për disa vite mësoi shqip e latinisht në Liceun "Illyricum". Shërbeu në famullitë e Toplanës, Palçit, Shalës, Bushkashit dhe të Rubikut. Iu kushtua poezisë, prozës, muzikës, duke punuar për të mirën e atdheut. Krijimtaria e tij është e gjerë d



¹⁴ At V. Prennushi, *Kângë popullore gegënishte* (Parathâne), Botimi II, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f.10.

¹⁵ At Z. Pllumi, *Françeskanët e mëdhaj*, Tiranë, 2001. f.149.

¹⁶ Lidhur me jetën dhe veprimtarinë letrare të B.Palaj i jemi referuar botimit të autorit, A. Çapaliku, *Bernadin Palaj, jeta dhe veprat monografi*, Shkodër, 1999.

he shumë e larmishme. Ajo përfshin shumë aspekte të zhvillimit albanologjik.

Arrestohet në Kuvendin e Rubikut me 22 tetor 1946, ku më pas akuzohet si "agent dhe bashkëpunëtor i fashizmit". Vdiq në burg, para se të "gjykohej" më 2 dhjetor 1946. U varros në oborin e ish-sanatoriumit në Shkodër.¹⁷

2. Veprimtaria letrare

Veprimtaria letrare e autorit ndahet në tre periudha:

Periudhën e parë të veprimtarisë letrare (1919-1934) Palaj ia kushtoi mbledhjes së rapsodive të malësisë. Gjatë këtyre 15 viteve punë të pandërprerë vullnetare, të papërballueshme nga një njeri, pati fatin të kishte një vëlla si veten, At Donat Kurtin (1903-1983), me të cilin e filloi kalvarin në Shkodër, më 1924, me botimin e 5 rapsodive të revista e përmuajshme "HYLLI I DRITËS" dhe e përfundoi në Tiranë më 1937 me botimin e vëllimit të dytë "Visaret e Kombit" - *Kângë kreshnikësh dhe Legjenda*.

Periudhën e dytë të veprimtarisë letrare (1933-1941) Palaj ia kushtoi hartimit të poezive e të poemave me një stil të ri mjaft origjinal, të cilat i botoi pothuajse të gjitha të revista "HYLLI I DRITËS" nën pseudonimin "Kukel Lapaj". Debutoi më 1933 me poemthin "Prej burgut të jetës" për ta vazhduar krijimtarinë poetike deri në vitin 1942, ku botoi poezinë e fundit "E e malësisë, organizimin fisnor, etnografinë, mitologjinë etj. Dielja e Larit n'Aventin" të "Zani i Shna Ndout" nën pseudonimin "Viator".

Periudhën e tretë e të fundit të veprimtarisë letrare (1941-1944), Palaj ua kushtoi studimeve mbi juridiksionin. Më 1942 botoi "Doke e kanu në Dukagjin". Më 1943 botoi fragmentin "Dioçezi i Pultit". Edhe studimi tjetër "Mite, besime e legjenda" (1943) do të kishte ripunime e do të njihte ribotime nga Shkodra, në Tiranë e deri në Romë. Më 1944 boton studimin e fundit "Kanuni i maleve". Më 1940, Palaj mori pjesë në Kongresin e Studimeve Shqiptare, organizuar në Tiranë dhe ishte anëtar i Insitutit të Studimeve Shqiptare, së bashku me Lasgush Poradecin, Aleksandër Xhuvanin, Eqrem Qabej, Kolë Ashtën, Et'hem Haxhiademin, Karl Gurakuqin etj., nën drejtimin e Ernest Koliqit. Mori pjesë në botimin e vëllimeve "Studime dhe tekste", që shpalosën vlerat shkencore të këtij Insituti.¹⁸

3. Vlerësime

Personalitete të njohura shqiptare dhe të huaj kanë dhënë konsiderata të ndryshme lidhur me karakterin e fortë dhe shpirtin artistik të B.Palaj. E.Koliqi e përshkruan kështu B. Palaj: "... djalë malesh, fytyrën e trupin e shpirtin e kishte të mbrûm me tharm ilir. Të gjitha veçorit morale qi e shquejnë Malsorin t'onë si typ njerzuer të veçantë ai i pat trashigim prej prindve fisnikë dhe i çmonte si visar të pashoq. Si individ, mandej, Perëndija e mbushi me të gjitha hiret qi lypë ushtrimi i artit".¹⁹ Për Át Bernardinin shkruan edhe studiuesi prof. dr. Alfred Çapaliku në veprën "Atë Bernardin Palaj - Jeta dhe Vepra", ku thekson: "... ai e heton psikologjinë e shqiptarëve dhe njef thellësisht popullin, gurrën e pashterrur të folklorit nëpërmjet të cilit spikaten aspiratat e kombit në përgjithësi. Kështu që veprat e tij për gjysëm shekulli u heshtën, u injoruan, u përbuzen, u nëpërkëmben, dhe pas atij gjysëm shekulli veprat e Át Bernardin Palaj filluan të shkruhen e të përmenden".²⁰

¹⁷ Po aty, f.6.

¹⁸ Po aty, f.10.

¹⁹ E. Koliqi, *Vepra 5*, Prishtinë, 2003, f.58.

²⁰ A. Çapaliku, *Bernadin Palaj... vep. e cit.*, f.12.

At Zef Pllumi në botimin e tij "Françeskanët e mëdhaj", jep përshtypjen e parë të takimit me At Bernadinin, të cilin "...e kishte takuar në vitin 1932 ose 1933, në një mbramje vllaznore, familjare me françeskanë, që zhvillohet për nder të tij. At Bernardini i binte pianos me një shkathhtësi të çuditshme, ndërsa me zanin e vet prej bilbili të rrallë interpretonte pjesë nga operat klasike..."²¹

Një tjetër vlerësim për Palaj do të vijë nga albanologia ruse Ana Desnickaja, e cila thekson se ai ishte: "Njohësi më i mirë i Maleve shqiptare".²²

Vlerësimi më i rëndësishëm i figurës së At Bernadinit është lumturimi i tij nga Papa Françesku më 5 nëntor të vitit 2016.

At Donat Kurti O.F.M dijetari, meshtari dhe mbledhësi i Eposit të Kreshnikëve.

1. Jetëshkrim²³

At Donat Kurti Lindi në Shkodër më 3 shtator të vitit 1902, në një familje me tradita patriotike dhe intelektuale. Ishte etnolog, folklorist, albanolog, gjuhëtar, poet, piktor e muzikant. Pasi mbaroi shkëlqyeshëm mësimet e para dhe të mesme në qytetin e lindjes, vazhdoi studimet e larta në Romë. Më 1927 u bë prift françeskan dhe po atë vit u kthye në qytetin e tij, ku emërohet profesor në gjimnazin "Illyricum" të fretërve. Lëndët që dha në këtë shkollë ishin: gjuhë shqipe, latinisht dhe histori e natyrës.

Në vitin 1937 nga Universiteti "San'Antonio" i Romës, i jepet titulli "Doktor i Shkencave". Nga 1930-1938 ishte nëndrejtor i shkollës, gjatë kohës kur P. Antoni ishte drejtor. Nga viti 1939 e gjer në mbylljen e saj më 1946 ishte drejtor. Në vitin 1946, At Donat Kurti ishte drejtor i



Gjimnazit të Fretënve "Illyricum" të Shkodrës. Ishte drejtor i atij Gjimnazi, që asht cilësuar vatra prej ku përhapeshin shkëndijat e atij atdhetarizmi dhe të asaj kulture shqiptare, mbi të cilat u ndërtua përjetësisht binomi "Fé e Atdhé". Me datën 12 nëntor është ndër të parët françeskanë që arrestohet me akuzën e formimit të Partisë Demokristiane, të futjes së armëve në Kishë, edukator i rinisë me frymën fashiste, një ndër bashkëpunëtorët e "HYLLIT TË DRITËS", që ka lavdëruar fashizmin etj. U dënua me 25 vite burg, por bëri më shumë se 17 vite.²⁴

At Donat Kurti, një ditë u gjet në një barakë me llamarina pa kurrë mbas shpirtit, vetëm me pak libra, mbasi pjesën ma të madhe i kishte të mëshefun si shumë shokë të tij, me një dyshek për vedi e një për motrën, murgeshën e nderueme të spitalit të Tiranës, e cila nuk e la vetëm

²¹ At Z. Pllumi, *Françeskanët...*, vep. e cit., f.107.

²² A. Çapaliku, *Bernadin Palaj...*, vep. e cit., f.11.

²³ Lidhur me jetën dhe veprimtarinë letrare të D.Kurtit i jemi referuar botimit të autorit, At Z. Pllumi, *Françeskanët...*, vep. e cit.

²⁴ A. Klosi, *Quo vadis, Shqipëri?* (antologji) Tiranë, 1993, f.247.

deri atë ditë, më 10 nandor 1983, që u bashkue me shokët e vet, eshtnat e të cilëve i kishte nën brinjë.²⁵

2. Veprimatria letrare

Në fondin e dorëshkrimeve që ka lënë Atë Donati figurojnë 37 vepra:²⁶ fetare, edukative, letrare, gjuhësore e folklorike, si në vijim:

"*Visaret e Kombit*", XI vëllime, në bashkëpunim me At' Bernardin Palaj; 1937. Ribotime në vitet 2005, 2007.

"*Prralla Kombëtare*", II vëllime, Shkodër 1940 (Ribotim), Botime françeskane, Shkodër, 2005.

"*Lojët Kombëtare*", Botime Françeskane, Shkodër 2007.

Zakone e Doke Shqiptare, Botime françeskane, Shkoder 2010, nën kujdesin e Provincës Françeskane Shqiptare.

3. Vlerësime

At Donat Kurti ka tërhequr vëmendjen me shkrimet e tij edhe të personaliteteve fetare, letrare dhe gjuhësore. Prof. Dr. Norbert Jokli, albanologu i njohur austriak, e cilëson At Donat Kurtin: "Një ndër prozatorët ma të mëdhaj shqiptarë".²⁷

At Z. Pllumi thekson: "At Donat Kurti asht vjollca e letrave shqipe. Ai nuk punoi as për lavdinë e emnit të vet, as për përfitim personal, por vetëm për me qitë në pah ata shka populli ynë kishte të riejtun prej shijes e mendimit të vet estetik, etik e filozofik nëpërmjet kangëve, përrallave e lojnave. Ky ishte qëllimi kryesor i veprës së tij: me punue për popullin."²⁸

At Donat Kurti O.F.M. riejti me dinjitet deri në vdekje të gjitha cilësitë që i përkisnin Urdhnit të tij tue jetue fukara, tue vuajtë me fukara, tue punue me edukue fukaratë dhe tue vdekë si fukara, i nderuem prej fukarave të mbarë Shqipnisë, të cilëve, në këtë jetë të mjerueme, u la trashigim një thesar shumë të çmueshëm nga mendja e Tij e ndritun: "VISARËT E KOMBIT".²⁹

²⁵ At Z. Pllumi, *Françeskanët...*, vep. e cit., f.125.

²⁶ Po aty, f.126.

²⁷ http://www.trepca.net/2005/08/050820_fritz_radovani_at-donat_kurti-perballe_albanalogut_jup_kastrati.htm.

²⁸ At Z. Pllumi, *Françeskanët...*, vep. e cit., f.125.

²⁹ http://www.trepca.net/2005/08/050820_fritz_radovani_at-donat_kurti-perballe_albanalogut_jup_kastrati.htm.

1.2 Traditat gojore dhe Këngët e Kreshnikëve

Traditat gojore dhe shprehjet gojore përfshijnë gjuhën si një mjet të trashëgimisë kulturore jomateriale. Traditat dhe shprehjet gojore të një territori përfshijnë një larmi të madhe formash të folura, duke përfshirë kështu, fjalë të urta, gjëgjëza, tregime, vjersha, legjenda, mite, këngë epike dhe poezi, lutje, himne, këngë, shfaqje dramatike e shumë lloje të tjera. Traditat dhe shprehjet gojore janë përdorur për të kaluar brez pas brezi njohuritë, vlerat kulturore dhe sociale të kujtesës kolektive.³⁰ Ata luajnë një rol të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të kulturës, si një nga elementet kryesore të identitetit të një populli.

Siç dihet, traditat dhe shprehjet gojore duke u transmetuar me anë të fjalës shpesh ndryshojnë nga mënyra e tregimit të tyre. Historitë përfshijnë kombinime të ndryshme nga një zhanër në një tjetër zhanër, nga konteksti në kontekst dhe nga interpretuesi në interpretues duke përfshirë dukuritë e riprodhimit, improvizimit dhe krijimit. Ky kombinim e bën traditën gojore një formë të gjallë të shprehjes, shprehje kjo e brishtë³¹, sepse ekzistenca e kësaj tradite varet nga një lidhje e pandërprerë, e cila përcillet nga një brez i interpretuesve tek brezat e ardhshëm. Këngët Epike kanë si tematikë kryesore luftën e shqiptarëve me fqinjët e tyre sllavë. Këngët dhe tregimet përfshijnë personazhe të tilla siç është Muji, një bari, i cili fiton fuqi të mëdha duke kapur tre dhi me brirë të artë, dhe nga ana tjetër i shkakton humbje sllavëve në betejë. Zana, një qenie mitike që banon pranë lumenjve, e ushqen me gji atë duke i dhënë fuqi të mbinatyrshme. Muji kishte një vëlla, heroin, Halil. Thelbi kryesor i Epikës përfaqëson kultin e fuqisë, siç është Akili në veprat homerike. Halili, na del me imazhin e heroit të qetë, i prirur për kultin e bukurisë. Në ndryshim nga epika helene, ku Odiseu për të mposhtur tundimet e aventurat vendos të ikë larg nga vendi i tij për të sprovuar veten në zgjidhjen e situatave me anë të ditorisë së tij, në Epikën Shqiptare, Halili jeton në vendin e tij të lindjes, lufton duke e mbrojtur atë. Ashtu si në të gjitha epikat, koha shkon sipas një kalendari të ndryshëm nga kalendari njerëzor. Bota e Epikës Shqiptare të kujton "Epin e Gilgameshit", ku një ditë në botën e hyjnive do të thotë mijëra vjet në botën e njerëzve. Heronjtë mitologjike të Epikës Shqiptare mbeten të vdekur për njëqind vjet dhe kur zgjohen ata thonë: "*Unë kam qenë duke marrë një sy gjumë*". A.Çetta do të theksonte lidhur me këtë fenomen: "*Kur Muji mediton ai (Muji) është në gjendje që të vëzhgojë barin që rritet*".³²

E kaluara në Këngët Epike është e largët dhe e papërcaktuar. Heronjtë kryesorë të Epikës Shqiptare janë bijtë e Ajkunës, një karakter i njohur femëror, e cila është e njohur për fuqitë e saj të veçanta. Muji dhe Halili nuk kanë një baba në aspektin formal; ata janë bij të së njëjtës nënë, Ajkunës, një mësuese e shtëpisë. Ata ishin kalorës, të cilët kishin fuqi të mëdha në shumë luftra me armiqtë e tyre fqinje. Ata kishin shumë miq dhe kishin shumë ushtarë në ushtritë e tyre dhe për një kohë të gjatë ata janë konsideruar si pronarët e rajonit të Ballkanit. Pra, Këngët e Kreshnikëve tanë janë një botë e tërë njërezish plot gjallëri e poezi, një botë e tërë ndjenjash të larta, ndodhirash epike, trimërisht vetjake dhe të përbashkëta, një mori e tërë tragjedish të nxjerra nga jeta e popullit tonë.³³ Studiuesit e traditave popullore na mësojnë se, kryesisht në Ballkan, trashëgimia ekspresive i shtrin rranjë të veta në një lloj humusi, pra në një landë të parë t'krijuese prej nocionesh pak a shumë të vagullta mbi fenomenet natyrore, reminishenca

³⁰ J. Vansina, *Oral tradition as history*, London, 1985, p.3-4, (<https://www.questia.com/read/98551048/oral-tradition-as-history>), përsht. B.Kraja.

³¹ Po aty, p.6.

³² A. Çetta, *Këngë kreshnike*, Insituti Albanologjik i Prishtinës, Letërsi popullore, nr.2, Prishtinë, 1974, f.55.

³³ Po aty, f.55.

historike, legjenda, sentence, parime të drejtash zakonore, supersticione, jehona veprash prrallore, atavizma besimesh t' lasha, pasqyrime dokesh e ritesh e veprimesh, pra në një tanësi të vertetë gabimesh, varun pezull mes botës reale dhe asaj fantastike, depozitue në kujtesën kolektive.³⁴ E pikërisht, një ndër këngët më të njohura epike e ruajtur thellë në kujtesën njerëzore është rapsodia kushtuar Gjergj Elez Alisë. Midis 20 Këngëve dhe varianteve të motivit lidhur me Gjergj Elez Alinë³⁵, vendin qendror e zë varianti i këngës që është botuar për herë të parë në revistën "HYLLI I DRITËS" në vitin 1924. Kënga mbahet si varianti më i hershëm, për dy arsye. Së pari ajo është shënuar në Nikaj të Malësisë së Veriut, dhe së dyti është pikërisht kjo zonë që studiuesit e kanë konsideruar si trevë të truallit të krijimit të Këngëve Legjendare. Ajo reflekton funksionimin e shoqërisë matriarkale dhe rolin e karaktereve mitologjike në Epikën Legjendare. Zakonisht për këtë Këngë thuhet, se fuqitë tokësore janë të krahasueshme me fuqitë detare ("*një gjigant i zi ka dalë prej detit*"). Në fakt, burimi kryesor i "Gjergj Elez Alisë" është fundi i epokës së flijimit të njeriut (femrës). Ai rreh në dyluftim bajlozin e zi, i cili kërkon "një dash të pjekun" dhe "një vashë të re"³⁶ për çdo natë. Humbja e bajlozit të zi shënon edhe fundin e sakrificës femërore. Gjergj Elez Alia siguron kështu, një çlirim të përhershëm të sakrificës së grave.

Këngët Shqiptare të Mujit dhe Halilit ecin paralel me versionet boshnjake të Ciklit që këndohen në gjuhën serbokroate, ose më shumë siç edhe dihet, në gjuhën boshnjake, por ndërsa Këngët Epike sllave boshnjake kanë pushuar si një traditë e gjallë, Këngët Epike shqiptare janë ende shumë të gjalla edhe sot e kësaj dite, ku ende mund të gjejmë një numër të mirë lahutarësh në Kosovë, në veçanti në zonat malore të Rugovës, në perëndim të Pejës dhe në veri të Shqipërisë, si dhe disa shpirta të rrallë në Mal të Zi, të cilët janë në gjendje të këndojnë e të recitojnë veprat heroike të Mujit dhe Halilit me tridhjetë agallarët e tyre si pjesë e një tradite të pandërprerë gojore.³⁷

³⁴ E. Koliqi, *Vepra 5*, vep. e cit., f.134.

³⁵ S. Feti, *Aspekte krahasimtare të këngës popullore "Gjergj Elez Ailja"*, Gjurmime albanologjike - Folklor dhe etnologji, Prishtinë, 2012, f.11-14.

³⁶ Z. Neziri, *Këngë të kreshnikëve*, Prishtinë: Libri shkollor, 2001, f.18.

³⁷ Këngë kreshnikësh - *Songs of the frontier warriors*: Albanian epic verse in a bilingual edition/ edit.and transl. R. Elsie; edit. and transl. J. M.Heck, Wauconda, Illinois: Bolchazy – Carducci Publishers, 2004, p.xiv-xv, përsht. nga B.Kraja.

1.3 Epika Shqiptare dhe historiku i saj

Pjesa më e rëndësishme e traditës gojore shqiptare janë Këngët Epike të quajtuara "Cikli i Kreshnikëve", ose "Eposi i Kreshnikëve". Kënga e parë shqiptare epike është regjistruar në vitin 1897 nga etnolinguisti gjerman, Gustav Meyer në Vjenë, i cili botoi fragmentin e Këngës së Ciklit të Mujit e të Halilit "Tha, drit ka dal e dielli nuk ka ra". Ky fragment u botua bashkë me materiale të tjera të letërsisë sonë gojore në veprën e tij "Albanesische Studien", vëllimi VI.³⁸ Ai bëri shumë studime në traditën gojore shqiptare duke sjellë në vëmendjen e dijetarëve "...se të gjitha popullatat e Gadishullit Ballkanik - shqiptarët, sllavët, bullgarët dhe grekët - kanë tradita folklorike të pasura. Edhe pse traditat gojore të këtyre vendeve fqinje ngjajnë me njëra-tjetrën në mënyra të caktuara, ka edhe dallime të shumta ndërmjet kulturave të tyre kombëtare."³⁹

Lidhur me fillimet e krijimtarisë së Epikës Shqiptare disa nga dijetarët vendas ndajnë mendimin se ajo daton në periudhën bizantine. Të dhënat në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm kulturor të shqiptarëve tregojnë se Epika e Veriut është krijuar në një periudhë zhvillimi divergjent. Kjo ishte periudha e ndarjes më të madhe territoriale të etnosit shqiptar (në veri dhe jug), ku në fakt nuk mund të gjendet asnjë gjurmë e Këngëve Epike në jug të lumit Shkumbin, e cila shënon kufirin midis veriut dhe jugut.⁴⁰ Studiuesit theksojnë se Epika Shqiptare është krijuar në mesin e sllavëve që emigruan në këto rajone, për shkak se ajo është e bazuar në luftërat në mes popullit shqiptar dhe sllavëve.⁴¹ Këto rajone i përkisnin Perandorisë Osmane nga viti 1389 (viti i betejës së Kosovës), deri në fund të shekullit të 19-të.

Këngët Epike Shqiptare janë të përqendruara në pjesën veriore të Shqipërisë dhe Kosovës.⁴² "Cikli i Kreshnikëve" ka rreth 500 000 rreshta, secili i përbërë nga dhjetë rrokësha. Për ndjeshmërinë që transmetojnë Këngët Kreshnike ata janë kthyer në një burim krijues për autorët dhe studiuesit e letërsisë shqiptare. Romancieri i njohur shqiptar Ismail Kadare (1936) ka krijuar romane shumë të bukura, të tilla si : "Kush e solli Doruntinën?" (1981), "Ura me tre harqe"(1983) dhe "Dosja H"(1990), të cilat janë të bazuara në traditën gojore shqiptare. Kadare ka dëshmuar se tradita gojore dhe letërsia e shkruar mund të jetojnë së bashku shumë mirë.⁴³ Studiuesi i estetikës dhe artit të letërsisë, Alfred Uçi sugjeron: "...këngët epike duhet të konsiderohen si një zhanër i veçantë popullor, sepse ato posedojnë karakteristika të rëndësishme të tilla si aspektet heroike dhe legjendare, të kombinuara me një metodë të veçantë të shprehjes artistike, gjë që e bën të ndryshme nga format e tjera të poezisë gojore".⁴⁴ Studiuesi i folklorit, Qemal Haxhihasani e përcakton eposin si një "...lidhje e madhe dhe origjinale e epokave të historisë së kombit tonë, ku janë mbledhur në një punë të veçantë në tërësinë e shpirtit të saj, kultura dhe historia".⁴⁵

Problemi i përkufizimit është i lidhur gjithmonë me çështjen e origjinalitetit, origjinës, autorësisë e autoktonisë. Këngët Epike popullore të shqiptarëve janë regjistruar për herë të parë

³⁸ Z. Neziri, *Studime për folklorin I: Eposi i kreshnikëve dhe epika historike, Gustav Majer dhe fillimet e botimit të këngës kreshnike shqiptare*, Insituti Albanologjik i Prishtinës, 2006, f.31.

³⁹ A. Dushi, *The Albanian oral tradition in Kosova*, Prishtinë, 2003, p.4, <https://journal.fi/elore/article/view/78385/39284>, përsht. B.Kraja.

⁴⁰ Sh. Sinani, *Kështjella e virtytit*, Tiranë, 2001, f.81.

⁴¹ A. Dushi, *The Albanian oral*, vep. e cit., 2003, p.6, <https://journal.fi/elore/article/view/78385/39284>, përsht. B.Kraja.

⁴² Po aty, p.5 <https://journal.fi/elore/article/view/78385/39284>.

⁴³ Po aty, p.5-6 <https://journal.fi/elore/article/view/78385/39284>.

⁴⁴ A. Uçi, *Epika heroike dhe roli i saj në folklorin shqiptar*, "Çështje të folklorit shqiptar", nr. 2 Tiranë, 1986, f.3.

⁴⁵ Q. Haxhihasani, *Mendësi zotëruese në Ciklin e Kreshnikëve*, Gjurmime Albanologjike, seria folklor dhe etnologji 21 (Prishtinë, Insituti Albanologjik), 1991, f.33.

nga priftërinjtë françeskanë shqiptarë dhe dijetarët që punonin në veri të Shqipërisë, në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Ata janë materiale të mbledhura në popull nga fshatarët, të cilët kanë jetuar në ato zona të thella dhe malore. Kjo përkoi me një rritje të vetëdijes kombëtare në shumë vende evropiane. Në vitin 1925, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, nisi puna për mbledhjen e Këngëve Kreshnike, ku në vitin 1937, nisi puna e françeskanëve dhe jezuitëve në Shkodër (Shqipëri), ku botuan një përmbledhje librash të quajtur "Visaret e Kombit" (15 vëllime). Në të njëjtën kohë, në vitin 1930, Milman Parry dhe Albert Bates Lord nga Universiteti i Hawardit vizituan vendet e Ballkanit dhe regjistruan vargje të Këngëve Epike. Koleksioni i Millman Perit⁴⁶ nga Ballkani perëndimor (1933-1935), ndër të tjera përfshiu edhe Këngë të Eposit të Kreshnikëve, Këngë epike historike, Këngë lirike, të dhëna biografike për lahutën dhe këngëtarët etj. Në kuadër të Koleksionit të M.Perit është vendosur edhe Koleksioni i Allbert Llordit⁴⁷, që ka kryesisht këngë të kreshnikëve. Në fillim të shekullit XX nga Gikli i Kreshnikëve u publikuan disa këngë epike të plota.⁴⁸ Ata janë mbledhur dhe redaktuar nga autorë të diasporës shqiptare që botuan materialet e tyre në revista dhe gazeta shqiptare të redaktuara jashtë vendit.⁴⁹

Një projekt për të prodhuar një version përfundimtar të Ciklit të Kreshnikëve ka filluar me publikimin e pesëmbëdhjetë vëllimeve të "Visareve të Kombit", një koleksion i folklorit shqiptar, që në vitin 1937. Dy vëllimet e para të këtij koleksioni u janë përkushtuar bëmave të Ciklit të Kreshnikëve.⁵⁰ Pas Luftës së Dytë Botërore, projekti u vazhdua nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, i cili botoi folklorin në një koleksion prej njëzet e pesë vëllimesh. Tre vëllimet e para u redaktuan nën mbikëqyrjen e Anton Çettës, të cilat i janë dedikuar Ciklit të Kreshnikëve. Këngët e këtij Cikli janë redaktuar dhe publikuar, si vepër e folkloristëve individualë, bazuar në regjistrimet dhe punën në terren, siç është projekti, ku përfshin punën e Qemal Haxhihasanit në Institutin e Tiranës si dhe punën e kryer në Prishtinë nën mbikëqyrjen e studiuesit të folklorit, Zymer Nezirit.

Sot ka një numër të konsiderueshëm të materialit të publikuar nga Cikli i Kreshnikëve. Këto publikime, megjithatë, nuk kanë informacion kontekstual. Ato përmbajnë shumë pak informacion në lidhje me krijuesit e Këngëve, rrethanat historike të krijimit të tyre, në lidhje me audiencën apo çdo informacion tjetër që do të hidhte dritë mbi performancën e tyre.⁵¹

Sot ne kemi një koleksion të Anton Çettës (1920-1995), i cili konsiderohet themeluesi i studimeve folklorike shqiptare në Kosovë. Kur Instituti Albanologjik në Prishtinë u rihap në 1967, Çetta ishte drejtuesi i Departamentit të Folklorit, i cili filloi projektin afatgjatë rreth mbledhjes dhe publikimit të folklorit shqiptar. Profesor Çetta ka organizuar në terren ekspedita kërkimore nga të cilat "...kemi trashëguar një material me vlerë të rrallë prej 342 këngë, të mbledhura mes dhimbjeve të mëdha nga françeskanët për rreth dyzet vjet".⁵² Në përmbyllje, "Epika jonë legjendare heroike është ndër gjinitë më të lashta të folklorit tonë e më konservative, sepse gjuha e saj ka ruajtur mjaft arkaizma, leksikore dhe gramatikore, të cilat

⁴⁶ Z. U. Neziri, *Studime për folklorin I...*, vep e cit., f.43.

⁴⁷ Po aty, f. 103-104.

⁴⁸ Z. Sako, *Mbledhës të hershëm të folklorit Shqiptar (1635-1912)*, Instituti i Folklorit, Sektori i Folklorit Letrar, Tiranë, 1962, f.521.

⁴⁹ Po aty, f. 524.

⁵⁰ Gj. Zheji, *Folklori shqiptar*, Tiranë, 1998, f.22.

⁵¹ A. Dushi, *The Albanian oral...*, pun. i cit., p.5 (<https://journal.fi/lore/article/view/78385/39284>).

⁵² At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret...*, vep. e cit., Tiranë, 2005, f. XI.



Sistemi foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit"
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)

ndriçojnë aspekte të ndryshme të periudhave të kaluara të gjuhës shqipe⁵³, duke na dhënë kështu materiale të çmueshme për historinë e saj e të dialektit verior.

1.4 Botime e ribotime. Krahasimi mes botimeve të ndryshme

Përmbledhja "Visaret e Kombit" II deri në ditët e sotme njihet tre botime, përkatësisht:

Botimi i parë me titull "**VISARET E KOMBIT" VËLLIMI II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda**⁵⁴, f. 286 (ISBN IIF – 002447).



Botimi i dytë me titull "**EPOSI I KRESHNIKËVE DHE LEGJENDA**"⁵⁵ Koleksioni "Visaret e Kombit" identike botimit të parë të vitit 1937, ku libri nis me një *Parathënie* nga faqja 5-8 dhe vijon me *Hymjen* nga faqja 9-14. Në vijimësi janë të renditura 34 Këngët e Eposit të Kreshnikëve (f.12-292), ku secila Këngë shoqërohet në fillim me një përmbledhje të shkurtër të tematikës që trajtohet, ndërsa në fund të Këngëve jepen edhe sqarime lidhur me zonën gjeografike nga ku është marrë Kënga dhe shpesh edhe informacione lidhur me identitetin e lahutarit që e ka kënduar atë.

Botimi i tretë me titull "**VISARET E KOMBIT**": *Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*⁵⁶, f.350 (ISBN 978-99956-617-3-1). Siç edhe dëshmohet që nga kopertina, ky botim është frotespici i botimit të parë, që do të thotë se materiali i tematikës është po ai që trajtohet te botimi i parë i "Visareve të Kombit" II. Në faqen e parë dhe të dytë jepet një vlerësim për Provincën Françeskane duke u ndalur në përfaqësuesit konkret që dhanë një ndihmesë të madhe për përparimin e mendimit atdhetar e fetar. Në faqen e tretë jepen disa detaje të përgjithshme të botimit të tretë, gjithashtu jepet edhe një sqarim se ky botim është "paisë me një shtojcë të kangëve të botueme në *Hyllin e dritës* (1938-1944)".⁵⁷ Gjatë shqyrtimit të materialit kemi

⁵³ M. Domi, *Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë*, "Çështje të folklorit shqiptar", nr. 2, Tiranë, 1986, f.80.

⁵⁴ *Visaret e Kombit, Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*, (Mbledhë e redaktueme nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti), Botim i Shtypshkronjës "Nikaj", Tiranë, 1937.

⁵⁵ *Eposi i kreshnikëve dhe legjenda*, Koleksioni *Visaret e Kombit II*, Tiranë, 2005, (Mbledhur dhe redaktuar nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti), Botime "Plejad".

⁵⁶ *Visaret e Kombit: Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda*, (Mbledhë e redaktueme nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti), Botime Françeskane, Shkodër, 2007, f.3.

⁵⁷ Po aty, f.3.

vërejtur se 34 Këngët e Kreshnikëve janë identike me variantin e parë të botuar në vitin 1937. Si në botimin e parë informacioni i përgjithshëm hyrës rreth Këngëve të Kreshnikëve jepet në faqet III-XVI, e më pas nis trajtimi i 34 Këngëve Kreshnike . Duhet theksuar se gjatë botimit mbledhësit kanë zbatuar vendimet e Komisionit Letrarez të Shkodrës për drejtshkrimin.⁵⁸ Me këtë fakt mund të shpjegohet uniteti relativ i Këngëve Kreshnike të botuara në "Visaret e Kombit". Gjithashtu vlejné të përmenden edhe botimet e bëra para viteve 90-të. Në librin "Folklor Shqiptar II"⁵⁹, "Epika Legjendare II", vlen të theksohet se Këngët Epike kanë një shtrirje tematike identike deri te Kënga e 34-t e "Visareve të Kombit" II, pra kemi përshtatjen e materialit të Këngëve të Ciklit të Kreshnikëve, me tituj, tematikë dhe numër korrekt të vargjeve. Nga f.51-271 në botimin nga Insituti i Folklorit kemi vetëm një ndryshim se varianti komik i Këngës "Martesa e Plakut Qefanak", në botimin e 1966 del i shtrirë në dy Këngë. Gjithashtu lidhur me ortografinë vërehet se mungojné theksat hundorë, theksat që ndihmojnë në përcaktimet fonetiko-tingullore të zgjatimit ose të shkurtësisë së tingujve, si një element dallues kryesor i të folmeve gege.

Në Folklorin Shqiptar II, "Epika Legjendare II", jepen disa variante të ndryshme për të njëjtën Këngë që shpesh shoqërohen edhe me një detaj interesant, ku pjesa më e madhe e këtyre varianteve të ndryshme nga Cikli i Kreshnikëve të paraqitur në "Visaret e Kombit" II, i referohen materialeve të botura te revista "HYLLI I DRITËS", (E Përkohshme Kulturale-letrare, botim i Shkollës Katolike Françeskane në "Shtypshkrojen A.Gj.Fishta", Shkodër). Disa nga këto variante janë Këngët që mbajnë tituj të njëjtë si variantet origjinale te Cikli i Kreshnikëve, por trajtimi i tematikës shpeshherë del me ndryshime. Nga këto mund të përmenden Këngët që dalin me më shumë variante, si: "Gjoku i Mujit", "Arnaut Osmani", "Deka e Halilit", "Fuqia e Mujit", "Gjergj Elez Alija", "Martesa e Mujit", "Zuku Bajraktari", të cilat na paraqiten me dy variante, ndërsa me tre variante del përkatësisht Kënga "Deka e Omerit" dhe me katër variante të ndryshme është Kënga "Halili i qet bejleg Mujit".

Në vëllimin e dytë "Epika Legjendare"⁶⁰, vërehet se materialet që i përkasin Ciklit të Kreshnikëve kanë ndryshime të mëdha (si në tematikë, ashtu edhe në emra personazhesh) me Këngët Epike të botuara te "Visaret e Kombit" II nga Bernardin Palaj dhe Donat Kurti. E përbashkëta mes disa Këngëve lidhet me faktin se tematikat janë të afërta dhe shpesh vërehet edhe kombinimi me titujt e Këngëve, si: "Fuqia e Mujit", "Martesa e Halilit", "Martesa e Ali Bajraktarit", "Ali Aga i Ri", "Halili i qet bejleg Mujës", "Martesa e Plakut Qefanak" dhe "Vdekja e Halilit".

⁵⁸ Shih më gjerësisht: "Hylli i Dritës", Kjo bëhet e qartë nga një shënim, ku theksohet se për ndonjë çështje të veçantë botuesit e revistës "Hylli i Dritës", nuk kanë qenë në pajtim me vendimet e Komisionit Letrarez, Shkodër, 1924, f.342.

⁵⁹ Insituti i Folklorit, *Folklor Shqiptar II, Epika Legjendare II*, Tiranë, 1966.

⁶⁰ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Folklor Shqiptar, Epika Legjendare*, seria e dytë, Tiranë, 1983.

KREU II : ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË SISTEMIT FOLJOR NË GJUHËN SHQIPE

2.1 Disa tipare të sistemit foljor

Në Ciklin e Kreshnikëve, sistemi foljor paraqitet me një larmi formash gramatikore, të cilat në pjesën më të madhe të shembujve të vjelë kanë karakteristikat foljore të gegërishtes veriperëndimore⁶¹ dhe më pak të gegërishtes verilindore⁶². Për këtë arsye në të gjitha Këngët e CK është vënë re një gjuhë më e njësuar, "...me më shumë fjalë e struktura të përbashkëta, sesa në gjuhën e folur të trevave përkatëse, ku ato këndohen".⁶³ Kjo veçori lidhet me shtrirjen territoriale të Këngëve Kreshnike, për të cilën u pasqyrua informacion në Kreun I. Këto karakteristika gjuhësore që i takojnë kryesisht gegërishtes veriperëndimore dhe më pak gegërishtes verilindore, i kemi analizuar, jo vetëm në strukturën morfologjike, i cili është edhe qëllimi kryesor i këtij punimi, por në disa raste jemi ndalur edhe në trajtimin e disa dukurive fonetike, ku pjesa më e madhe e të cilave kanë karakter morfonologjik. Veçoritë që i kemi ndeshur, janë kryesisht trajta të mënyrës dëftore, e në raste më të rralla edhe paradigmata kohore të mënyrave të tjera. Të pasura dalin këto kohë edhe me kuptime kohore dhe modale, të cilat do t'i trajtojmë më gjerësisht në sythe të veçanta.

Shkurtimisht po ndalemi në disa tipare me karakter fonetik dhe morfolojik.

Nga dukuritë fonetike veçojmë:

- hundorësia na del në ato folje, ku shqiptimi me timbër hundor i zanores gjendet në pozicion para bashkëtingëlloreve hundore (*m, n, nj*), si: *hîm, shîm, bân, kân* etj., por edhe në pozicione të tjera (ku hyn edhe dukuria e rotacizmit), si: *msÿni, ndêja, ká prû, â frÿ* etj.
- zbërthimi i zanores së theksuar së temës **-o-** në **-ue-** del në foljet e parregullta, tipi: *due*, (vetëm në vetën e parë njëjës), dhe *don, do/don, dona, doni* në vetat e tjera për njëjës dhe shumës;
- dukuria fonetike e aferezës dhe e protezës del në disa folje, të tipit: *ap/apim; nep/nepet* etj.;
- elizioni na ka dalë në pjesëzën që paraprin format e mënyrës lidhore, *t'(t'duroj, të shiloj)*;
- reduktimin e grupit *-fsh* në *-sh* në mënyrën dëshirore të foljet me temë në zanore⁶⁴, si: *hîsha, martosha, deksha, kjosh* etj.

Sistemin foljor, nga mënyra se si ai na paraqitet në materialin e studiuar, do ta vështrojmë duke u ndalur në mënyrat, kohët, zgjedhimet, vetat dhe kuptimet kohore. Sistemi foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, për nga forma është sintetiko-analitik, siç paraqitet edhe në gjuhën standarde, prandaj foljet, përveç formave sintetike të kohës së tashme (*duroj, fshâj*), të së pakryerës (*rrijshin, thojshin*) dhe të kryerës së thjeshtë (*ndriti, vndoi*), dalin edhe me forma analitike të kohës së kryer (*kan sajdisë, janë hallashtisë*), më se të kryer (*kishte rritë, ish' rritë*), të kryerën e tejshkuar (*pate xjerrë, patët dhânë*), kohën e ardhme (*kam + paskajoren gege "me bâ", kam + formë e pashtjelluar "për të bâ", due + paskajore e tipit "me bâ"*).

Një vend të rëndësishëm kanë format foljore të mbipërbëra, si forma karakteristike të gegërishtes, të cilat na dalin të pasura në trajta dhe kuptime. Këto forma na kanë dalë me dy trajta kohore të dëftores: e kryera e dytë (*kam pasë kapë*) dhe më se e kryera e dytë (*kish pa' keshë*) në zgjedhimin vepror dhe jovepror si dhe me trajtën e së kryerës së dytë të habitores (*kênka kênë çue*). Trajtat e mbipërbëra janë të pasqyruara edhe në veprat letrare, sidomos te autorët gegë të periudhës së Rilindjes dhe të kohëve më të reja.⁶⁵ Por, siç dihet, trajtat e

⁶¹J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit.; B.Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995.

⁶²J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit.; B.Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit.; Xh. Gosturani, *Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e gegërishtes verilindore*, SF, Nr. 1-4, 1994.

⁶³Gj. Shkurtaj, *Disa dukuri të gjuhës së epikës legjendare*, "Çështje të folklorit shqiptar" Nr. 3, Tiranë, 1987.

⁶⁴B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit., f.57.

⁶⁵Gj. Shkurtaj, *Dialekti dhe norma në trajtat foljore të mbipërbëra*, "Gjuha Jonë", Nr. 3, Prishtinë, 1984, f.44.

mbipërbëra janë më të vjetra në kohë, sepse ato dëshmojnë që në shkrimet e autorëve të vjetër të Veriut (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani).⁶⁶ Siç do të analizohen gjatë punimit, format kohore të mbipërbëra i japin vargjeve më shumë fuqi shprehëse.

Në materialian e studiuar, një vend të veçantë zënë format e pashtjelluara foljore, të cilat dalin më të pasura në forma dhe kuptime kohore, po t'i krahasojmë me format e standardit. Pjesorja del si formë foljore më vete, duke marrë mbaresa të ndryshme, si: *hatrue, shnjertzue, ngulë, dalë, fjetun, lidhun*, por më shumë ajo gjen përdorim si pjesë përbërëse e trajtave analitike të foljes, si: *ká pasë / ká pasun, kish bâm, patët dhânë, ishin kênë ndry* etj. Paskajorja del me format gramatikore analitike *me bâ* dhe *për me bâ*, por edhe si pjesë përbërëse e së ardhmes analitike, si: *kam me hjekë, due me shetitë* etj. Forma e pashtjelluar e mohores del me trajtat, si: *pá kallxue, për pá pá etj.*, kurse *përcjellorja* vërehet me trajtat, si: *tu' lidhë, tue çetue, tuj ladruetj*.

Nga analiza e vargjeve të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur edhe një llojshmëri të foljeve të quajtuara supletive⁶⁷, që përbëjnë grupin e disa foljeve mjaft të vjetra, të cilat kanë pasur një përdorim mjaft të shpeshtë.⁶⁸ Foljet e ashtuquajtura supletive, të cilat na dalin me tema të ndryshme në kohën e kryer të thjeshtë dhe në pjesore, në krahasim me kohën e tashme, të cilat janë trashëguar nga një fazë e hershme⁶⁹, si: *jam ~ kjeçë ~ kânë; kam ~ pata/paçë; jap ~ dhaçë ~ dhânë; rri ~ ndëja ~ ndëjë; vij ~ erdha ~ ardhë/ardhun* etj. Më gjerësisht Këto forma do t'i trajtojmë në kreun përkatës.

Siç do të shihet edhe nga shembujt që do të jepen në analizë, vihet re se mbledhësit, B.Palaj dhe D.Kurti na ka dhënë variantet më të pasura dhe më të bukura të Këngëve Kreshnike. Sistemi foljor në CK është më i pasur në forma dhe kuptime po ta krahasojmë me format e standardit dhe kjo gjë i jep edhe vlerë studimore Këngëve Kreshnike, sepse pasqyron, jo vetëm vlerat shprehëse të krijimeve popullore, por në një formë edhe gjendjen e sistemit foljor në '30-të shek. XX të dialektit të gegërishtes në përgjithësi, e të gegërishtes veriperëndimore në veçanti dhe më pak të gegërishtes verilindore. Duke u ndalur në disa veçori të sistemi foljor, kemi vënë re ngjashmëritë me të folmet e gegërishtes veriperëndimore në disa drejtime, si:

- disa trajta të zgjedhimit të parë, të dytë dhe ndonjë folje e parregullt dalin me mbaresën -i në vetën e parë njëjës të dëftores, si: *kallxoi, hjeki, mbathi, shprazi, api* etj.;
- disa folje të zgjedhimit të parë në dëftore, dalin me mbaresë zero në vetën e tretë njëjës, si: *fry', grrye, lue, mba, rrë, shtje*, etj.;
- prania e dy trajtave të ndryshme në vetën e parë shumës të dëftores të foljeve ndihmëse⁷⁰ *kam* dhe *jam, kemi, jemi; kena, jena*;
- trajtat e së pakryerës analitike (*kjeçë tuj bâ, kjeçë tu' lidhë*);
- foljet që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në bashkëtingëllore, në vetën e tretë shumës marrin mbaresën -en, karakteristike të gegërishtes veriperëndimore, si: *folen, qiten* etj.;
- foljet që tregojnë lëvizje, gjendje e formojnë të kryerën e dëftores me anë të foljes ndihmëse *jam*⁷¹, si: *jam ardhë, jë dalë, â kênë, âsht râ, janë vojtë* etj.;
- forma analitike gramatikore e paskajores, tipi *për me kundrue*, është karakteristike për gegërishten veriperëndimore.⁷²

⁶⁶ R. Mulaku, *Gjuha e shkrimeve të vjetra shqip (Shek.XV-XVIII)*, Prishtinë, 2012, f.459-461.

⁶⁷ Sipas *Gramatikë e gjuhës shqipe, I...* (vep. e cit). “Foljet supletive janë ato folje të parregullta që dalin me tema të ndryshme nga koha e tashme në kohën e kryer të thjeshtë dhe në pjesore”, f.288.

⁶⁸ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa II)*, Tiranë, 1976, f.14.

⁶⁹ Po aty, f.14.

⁷⁰ B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit., f.50.

⁷¹ J. Gjinari, Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.231.

⁷² B. Beci, E folmja e Shkrelit, DSH, I, Tiranë, 1971, f.301; J. Gjinari, E folmja e Bregut të Bunës, DSH, I, Tiranë, 1971, f.543.

***Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)***

Këto veçori në sitemin foljor të Ciklit të Kreshnikëve do të analizohen në krerët përkatës duke iu bashkëngjitur këtyre edhe karakteristika të tjera dialektore që na kanë dalë nga shembujt e vjelë, si në rastin e formimit të vetës së parë shumës të kohës së tashme të dëftores, e cila del me mbaresat: **-(e)na** dhe **-(h)ena**: *nisena, lahena*, etj., karakteristike për të folmet e gegërishtes verilindore.⁷³

Nga ana tjetër, nga shembujt e vjelë, vërehet se foljet në mënyrën habitore dalin më me pak kohë, në krahasim me kohët normative të gjuhës së sotme shqipe. Një përdorim mjaft të shpeshtë kanë foljet me kuptim të zbehtë leksikor, që ndonëse na dalin kryesisht foljet që shprehin fillimin e veprimit, ato mbartin një ngarkesë kuptimore duke i dhënë intensitet veprimit të foljes. Ato dalin të ndërtuara në konstruktë me folje në mënyra dhe kohë të ndryshme, të tipit, si: marr + folje në dëftore (*kan marrë e jan nisë*), bëj + paskajore (*bân me shkue*), nis + përcjellore (*kan nisë tuj gjamue*) etj.

Trajtat foljore në kategoritë e tyre gramatikore i kemi trajtuar sipas mënyrave foljore. Gjatë shtjellimit të informacionit kemi ilustruar me shembuj të mjaftueshëm për çdo kategori foljore prej vargjeve të Ciklit të Kreshnikëve, ku vlen të theksohet se një vlerë të veçantë kanë edhe kuptimet e pasura kohore.

⁷³ B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit., f.52.

2.2 Foljet me kuptim të zbehtë leksikor

Para se të kalojmë te foljet me kuptim të plotë leksikor, mendojmë se paraqesin interes disa folje me kuptime të zbehta leksikore, të pasura në forma dhe në kuptime, siç janë *foljet modale*, të cilat shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit lidhur me veprimin e emërtuar nga folja ndjekëse.⁷⁴ Siç do të shtjellohet në vijim, foljet modale dalin të pasura në ndërtime foljore duke iu shmangur pothuajse në të gjitha rastet ndërtimeve të standardit të sotëm të shqipes. Në vijim të kreut, do të ndalemi në një analizë të detajuar të foljeve që shprehin mënyrën e veprimit, të cilat, ashtu si foljet modale dalin të pasura në forma dhe në kuptime. Në mënyrë të skematizuar foljet që shprehin mënyrën e veprimit i kemi paraqitur sipas ndërtimeve foljore që dalin në CK, ku, siç vërtetohet edhe nga shembujt e vjelë në CK, ato shoqërohen në ndërtime nga forma të shtjelluara dhe të pashtjelluara. Një vend të veçantë, gjatë analizës, do t'i kushtojmë edhe foljeve që përdoren vetëm në vetën e tretë, si rastet e *foljeve njëvetore*, me kryefjalë të shprehur ose të nënkuptueshme dhe *foljet pavetore*, që nuk i referohen një kryefjale të shprehur dhe as të nënkuptueshme.

2.2.1 Foljet modale

Foljet modale janë një grup foljesh që për nga kuptimi nuk dalin si të mëvetësishme me kuptim të plotë, por këto folje i gjejmë në ndërtime në lidhje me forma të tjera foljore. Në CK këto folje zakonisht dalin të shoqëruara me trajta të dëftores dhe me formën e pashtjelluar të paskajores geqe të tipit "*me marrë*".

Për ilustrim po sjellim më poshtë rastet nga CK:

...“Qi ata qafat kurr s’und i kalojnë! / Ka qitë Jera edhe u ká thânë ... (Kënga 4, f. 25)

...Të dy syt gjaku m’i ká xânë, / Hiç me sy s’mundem me pá... (Kënga 12, f. 104)

Në ndonjë rast më të rrallë foljet modale dalin të shoqëruara edhe me ndërtime të lidhore, të cilat do të trajtohen më gjerësisht gjatë analizës në këtë syth. Në ndërtimet me foljet modale jepet zakonisht modaliteti i detyrimit, domosdoshmërisë, mundësisë a pamundësisë. Modaliteti i pamundësisë shprehet me mohimin e mundësisë, kryesisht me anë të pjesëzës së mohimit s’, *nuk*, siç del edhe nga shembulli i vjelë nga CK:

...Bë mbí Zotin probi i ka bâ:/ Se me ty, Halil, njaty **nuk muj me ardhë**... (Kënga 2, f.15)

Të gjitha këto kuptime, sipas gjuhëtarëve, shprehen kryesisht me folje të veçanta që quhen folje modale.⁷⁵ Në këtë grup hyjnë foljet: *mund*, *duhet* e ndonjëherë *do*, të cilat, janë quajtur folje funksionalisht të pavetëmjaftueshme⁷⁶ ose folje gjysmëndihmëse modale⁷⁷. Selman Riza në studimin monografik "*Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*", bën objekt të veçantë studimi *foljet modale*. Studiuesi këto folje i quan *folje të pavetmjaftueshme marrëdhënore*, pra, pa kuptim të plotë leksikor më vete. Ai në emërtimin e këtyre foljeve dhe mënyrën e trajtimit të tyre nisat nga teoritë e ndryshme evropiane. Kështu ky grup foljesh është quajtur "*folje ndihmëse mënyrore*" (W. Jung); nga rusi A. N. Gvozdev queshin "*folje çfaqëse të mënyrorësisë*", kurse nga francezi A. Dauzat queshin "*ndihmëse sekondare (të rastit)*".⁷⁸ Lidhur me emërtimin dhe trajtimin morfologjik për këtë grup foljesh, ne do t'i referohemi qëndrimin të Akademisë së Shkencave dhënë në "*Gramatikën e gjuhës shqipe*"⁷⁹, duke i klasifikuar si folje me vlerë modale.

⁷⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.261

⁷⁵ S. Mancaku, *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, SF, Nr. 3, 1979, f.135.

⁷⁶ S. Riza, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, 1994, f.89.

⁷⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.261.

⁷⁸ Shiko: S.Riza, *Libri 13- Vepra 2*, Prishtinë, 1997, f.89.

⁷⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.261.

Numri i foljeve modale si dhe kuptimi i tyre nuk është aq i përcaktuar, ai varion dhe ndryshon në gjuhë të ndryshme sipas konceptit të modalitetit dhe sipas veçorive gramatikore dhe leksikore që paraqesin këto folje.⁸⁰ Nga pikëpamja leksikore, folja modale, e cila morfologjikisht nuk mund të quhet e tillë nëse nuk shoqërohet me një folje në lidhore apo në formë të pashtjelluar, në një togfjalësh të tillë, siç e theksuam, nuk mund të ketë kuptim të pavarur leksikor. Sa i përket aspektit morfologjik, foljet modale përdoren kryesisht në kohën e tashme dhe gati gjithmonë në vetën e tretë njëjës⁸¹, por përveç këtij përdorimi, në CK, sipas hulumtimeve tona, foljet modale dalin të pasura edhe me trajta kohore, siç është rasti i foljes modale *mund*, e cila del me trajta të kohëve të thjeshta (e tashme, e pakryer) dhe të kohëve të përbëra analitike të mënyrës dëftore (e kryer, më se e kryer).

Po marrim një rast kur folja është në të *tashmen e dëftores*:

...Kush tu ai s' *mundet me hî*. / Idhním mazi qi ká marrë ... (Kënga 9, f. 76)

Në përmbledhjen e Këngëve Kreshnike "Visaret e Kombit" II vërtetohen forma me vlerë modale në ndërtime foljore me foljet *mund*, *duhet* dhe *do*, por siç del edhe nga materiali i studiuar, përdorim më të shpeshtë kanë ndërtimet me foljen me vlerë modale të mundësisë, zakonisht me foljen *mund*. Me këtë folje do të nisim edhe analizën tonë. Folja modale e mundësisë **mund** del me tre variante: *mund*, *mujsh* dhe *mujt*, të tria forma kohore të mënyrës dëftore.

Ndërtimet me foljen modale *mund* që i gjejmë në CK i kemi klasifikuar në dy grupe, me forma të shtjelluara dhe të pashtjelluara. Kjo folje modale e shoqëruar me ndërtime me forma të shtjelluara në CK mund të dalë si në kohë të ndryshme të dëftores, ashtu edhe të lidhores. Ndërsa, kur ajo shoqërohet me forma të pashtjelluara, kjo formë është paskajore.

Më gjerësisht i kemi klasifikuar sipas skemës në vazhdim:

Folja modale mund në kohën e tashme + folje në dëftore

Këto ndërtime, *folje modale + folje në mënyrën dëftore* në vargjet e Këngëve Kreshnike kanë një përdorim relativisht të kufizuar. Nga shembujt që kemi vjelë vërehet se forma në dëftore del në të *tashmen* kryesisht, por edhe me ndonjë formë të përbërë, në vetën e parë dhe të tretë njëjës dhe shumës, si në shembujt:

...Kurrsi kryet s'po *mund* i a *merr*. / Kaq për seri t'madh qi e kish' pasë ... (Kënga 10, f. 86)

...More i miri i nânës-ooo! / Orët e bjeshkës mâ s'*und* p'e *ndiejnë*... (Kënga 30, f. 226)

...Se kam lânë për vashë, / pse nu' *mund hasa*... (Kënga 2, f. 27)

...Kan marrë rrugën, qi çon bjeshkve të mdhá; / Gjë me sy kurrkund nuk *mund kan pá*... (Kënga 6, f. 51)

Rastet e përdorimit të foljes modale të shoqëruar me një folje në të kryerën e thjeshtë të dëftores apo edhe në kohë të tjera të kësaj mënyre nuk janë karakteristike e standardit të sotëm, prandaj mendojmë se këto raste e gjallërojnë dhe e pasurojnë sistemin foljor të gegërishtes.

Folja modale mund në kohën e tashme + folje në lidhore

Përdorime të tilla janë edhe sot tipike në standardin e shqipes. Me këtë ndërtim kemi vjelë pak forma në *vetën e dytë* dhe *të tretë njëjës* si dhe në *vetën e tretë shumës*, si në rastet:

...Kurrnji ditë djalit s'*mund t*'ia *mbajsh*, / Se njizetekatër vjeç djali ásht... (Kënga 12, f. 98)

⁸⁰ S. Mancaku, *Ndërtimet me foljet modale...*, pun. i cit., f.135.

⁸¹ V. Hamiti, *Selman Riza për modalitetin e foljeve modale*, Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 13-25 gusht 2012, f.650.

...E ká qitë Halili e ká thânë : / Se n’mejdán i dekuni s’mund t’dalë... (Kënga 34, f. 239)
Trajta e shkurtër të dhanores, të vetës së parë dhe të dytë njëjës dhe të vetës së parë shumës, mund të përdoren në gjuhën e folur vetëm për të shprehur qëndrimin emocional të ligjëruesit me funksion të qartë emfatik.⁸² Me këtë përdorim vërtetohen edhe në vargjet e CK:

...Se na nuses po i kallxojmë ! / Po kjo né shka mund t’na bâjnë?... (Kënga 1, f. 7)
Në disa raste folja modale mund të dalë edhe me trajtën e së tashmes së lidhore, në *vetën e dytë njëjës* ose në *vetën e parë shumës*, por rastet janë të pakta, siç e vëtojnë edhe vargjet nga CK:

...Atëherë mbrenda ká me hí, / Sa ku t’mundesh shkjaút me i rá,... (Kënga 2, f. 17)

...Dër të nana ké me rá, / Si t’mundesh n’shpí me hí... (Kënga 11, f. 93)

...Rob të gjallë si t’mujmë me i xânë. / Treqind shkjë rreth gurret janë bashkue. (Kënga 25, f. 202)

Folja modale mund + paskajore e tipit "me punue"

Ashtu si në ndërtimet e formave analitike me folje ndihmëse, edhe në ndërtimet me folje modale, jo të dyja pjesët përbërëse kanë të njëjtin rol gramatikor dhe leksikor. Në ndërtimet me *folje modale + paskajore*, folja *mund* luan rolin kryesor gramatikor, sepse shënon mënyrën, kohën dhe vetën dhe i jep ndërtimit kuptimin modal, ndërsa kuptimin kryesor leksikor e mbart forma e pashtjelluar. Duke pasur funksionet themelore gramatikore të ndërtimit modal, folja modale e ndjekur nga paskajorja, është e detyruar të zgjedhohet në mënyrë, kohë, numër dhe vetë, sepse kjo e fundit është e pazgjedhueshme.⁸³ Trajta e paskajores në këtë ndërtim në CK del vetëm me formën e thjeshtë *me punue*, kurse e ashtuquajtuara paskajore e kryer (*me pasë punue*), e cila del si formë e pashtjelluar më vete, në këtë ndërtim me folje modale nuk na ka dalë në asnjë rast.

Në këtë çështje do t’i referohemi shembujve që i takojnë zgjedhimit vepror dhe jovepror të foljes modale të mundësisë, *mund*, kur shoqërohet nga paskajorja e foljes. Nga rastet që kemi vjelë vërehet se folja modale del zakonisht në formën veprorë me trajtat e përbëra analitike të dëftores.

Folja modale mund në kohën e tashme + paskajore

Në pjesën më të madhe të rasteve, folja *mund* del në *vetën e parë e të tretë njëjës* dhe në *vetën e tretë shumës* të së tashmes së dëftores e ndjekur nga paskajorja e foljes. Zakonisht, folja modale *mund* del me trajta të joveprores.

Nga CK po marrim vargjet:

...A thue mundem ndonji krye me pré,

A thue mundem ndonji çikë me marrë... (Kënga 6, f. 54)

Në këtë ndërtim folja modale në vetën e parë njëjës del edhe me një formë tjetër dialektore, me trajtën *muj*, si në shembujt:

...Se gjâj nuse për gji’ vend! / Por ket gjâ nu’ muj me e lshue... (Kënga 1, f. 9)

...Mundshim Muji plakut m’i përgjegjet: / S’muj Halilin, Dizdar, me t’a dhânë. (Kënga 23, f. 178)

... – Grue për vedi un nuk muj me t’marrë. / Kqyr ça i tha Baloz Sedelija... (Kënga 11, f. 90)

⁸² Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.227.

⁸³ S. Mancaku, Ndërtimet me foljet modale..., pun. i cit., f.138.

... Qí pá e pré kurrnjânin s’muj me e lânë, / E dizginat gjogut i a ká lshue....(Kënga 19, f. 151)
Për *vetën e tretë njëjës* po i referohemi shembujve:

...Madhojnë bashkë ndër Lugje t’verdha, / Askush n’dorë s’mundet me i shti:(Kënga 1, f. 7)

...Tjetër burrë s’mundet me marrë mue. / Gjithkund fjala u hap... (Kënga 24, f. 189)

Veta e parë shumës zakonisht del me mbaresë zero p.sh.:

...Jemi larg s’mund gjâ me pá, / Se nuk janë t’bukrat e dheut... (Kënga 6, f. 62)

Veta e tretë shumës del vetëm me një formë, si në rastin:

...E ndoshta né rob munden me na bâ. / Bét në Zotin Halili i ká bâ.... (Kënga 25, f. 201)

Folja modale në këtë ndërtim del shpesh edhe me pjesëzën e aktualizimit, *po*, e cila në të gjitha rastet del me kuptim mohor, si:

...Me shkue me të, Shkjân fort po e dron, / “N’mejdán ktij s’po mund i dalë..(Kënga 2, f. 16)

...Unë jam plakë edhe jam zgrehë, / Nuk po muj me dalë n’bejleg... (Kënga 10, f. 82)

...Sall një motër, nu’ po muj me lshue, / Varrët e shtatit s’â kush qi m’i lidhë..(Kënga 5, f. 46)

Trajtat e shkurtra gjejnë përdorim të shpeshtë duke ndihmuar edhe në përforsimin kuptimor të këtij ndërtimi modal, si në rastet:

... Njatë s’mundem me t’a çilë, / Se aty âsht Januka e bardhë ... (Kënga 2, f. 17)

...Po as timar gjokun po m’a bân, / Nuk po mundet mazin me e zaptue... (Kënga 9, f. 72)

...Na ato nuk mund i bâjmë, / E na e bjen qirin n’trevezë ... (Kënga 22, f.172)

Ky ndërtim me folje modale shoqërohet shpesh edhe me ndajfolje kohe apo lokucione ndajfoljore, siç na e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë:

...**Kurr mâ** n’tê s’mundem me hype. / Me dorë t’vet Rushja i a ká dhânë (Kënga 17, f. 138)

... **Ká trí dit** nuk muj me folë, / E âma ngjat m’i ká qillue... (Kënga 22, f. 171)

Folja modale në kohën e pakryer + folje në paskajore

Në ndërtimin me foljen me vlerë modale *mund* në kohën e *pakryer* të mënyrës *dëftore* + *paskajore*, folja *mund* del përgjithësisht në vetën dytë njëjës dhe shumës në formën joveprore. Sipas studiuesve ky ndërtim me formën modale *mund* në të pakryerën nuk dëshmohet te autorët e vjetër. Edhe ne mendojmë se ky ndërtim me foljen modale të mundësisë, *mund*, është më i ri në kohë se ndërtimet e argumentuara deri tani, sepse në CK kemi gjetur pak shembuj me këtë ndërtim. Siç vërtetohet edhe nga shembujt e mëposhtëm, megjithëse folja ka ndërtimin e kohëve të mënyrës *dëftore*, kuptimi modal i saj është ai i mënyrës kushtore. Në ndihmë të këtij interpretimi na vinë edhe shoqërimi i këtij ndërtimi foljor me lidhëzat kushtore (*në*), si në vargjet:

...Se për **n’ mujsh** bjeshkët me m’i xjerrë, / Due me t’dhânë shtatqind orum të verdhë... (Kënga 19, f. 148)

...Për **në mujshi** bjeshkët me m’i xjerrë. / Të tânë Agajt kryet e kan ulë ... (Kënga 19, f. 147)

Folja mund në të kryerën e thjeshtë + paskajore.

Në këtë ndërtim veprimi i shprehur nga paskajorja ka qenë e mundur të realizohet në një çast të caktuar të së shkuarës.⁸⁴ Për këtë ndërtim, folja modale, *mund*, del me disa trajta në joveprore, si në pasqyrën e skeduar:

Veta e parë njëjës del me formën, *mujta*, me përdorim të shpeshtë, ku ndërmjet ndërtimit foljor, zakonisht hyjnë gjymtyrët e dyta, si në shembullin e ilustruar:

⁸⁴ Po aty, f.142.

... – Hijeshí Zoti e ki’pa’falë, / E nu’mujta trupin me i a çartë... (Kënga 19, f. 152)
Veta e tretë njëjës dhe shumës del me pak shembuj, ku folja modale në të gjitha rastet del me mbaresë zero, si, p.sh.:

...Jau lypë mrizet zânavet; / Kurkund m’to nu’ mujt m’u ndeshë... (Kënga 1, f. 4)
...Kurrnja shoqin s’mujt me rrxue, / Lavd shoshajt kreshnikët po i hjekin... (Kënga 6, f. 59)
...Sa mirë krajli qi i ká pritë! / Gjithsá muj’n me ngrânë, me pí... (Kënga 1, f. 2)
Në zgjedhimin vepror folja modale *mund* del me trajtat kohore analitike të së kryerës dhe më se të kryerës të dëftores.

Folja modale mund në të kryerën + paskajoren

Në këtë ndërtim trajta *mund* del në *vetën e parë* dhe *të tretë njëjës e shumës*. Ky ndërtim në të gjitha rastet del me kuptim mohor, siç e tregojnë edhe shembujt e ilustruar nga CK:

Numri njëjës:

...Mue rreziku sot ká ardhë me më ndeshë / M’ kan hupë lopët, e askund s’kam mujtë me i gjetë... (Kënga 7, f. 64)

...N’ dorë t’tallallit i kam qitë, / Kurr ‘i grosh s’kam mujtë me i shitë... (Kënga 16, f. 131)

...Buzë nji shkambit m’u ndalë âsht ngushtue; / E tu shpija nu’ ká mujtë me dredhë... (Kënga 7, f. 63)

Numri shumës

...Se fjalë të madhe ké folë, / E në Jutbinë s’kemi mujtë m’u martue. (Kënga 12, f. 98)

...Kurkund gjê me sy s’kan mujtë më pá, / M’çetanik askund s’kan mujtë me ndeshë... (Kënga 7, f. 55)

Ndërtimi me *më se të kryerën + paskajoren* del shumë rrallë, ku folja modale është gjithmonë në *vetën e tretë shumës*, si në rastin:

...Prap në shpellë Shkjët djalit i kin’ hî, / Por në dorë nuk kishin mujtë m’e shtë. (Kënga 23, f. 184)

Në ndërtimin foljor, folje modale *mund + paskajore*, vërehet se ndërmjet formave të ndërtimit modal hyjnë elemente të tjera fjalisë. Këto raste në CK janë të shpeshta dhe zakonisht folja modale del e aktualizuar, si në rastet e ilustruara:

...M’a ké thikën të helmatisun. / N’mujsh ti Banit n’bark me i a ngulë... (Kënga 15, f. 129)

...Tha – nuk po mund Muji me e rrotullue. / Sá burrë i madh qi ki’qillue... (Kënga 31, f. 229)

... – Dhimbhtë e madhe, vllá m’a ká ngjitë, / Nuk po muj n’kâmbë me qindrue... (Kënga 33, f. 234)

Në vijim po shohim ndërtimet e tjera modale, siç na dalin në CK që në krahasim me ndërtimet e trajtuara deri tani janë më rralla.

Folja modale duhet + paskajore

Folja *duhet*, siç dihet është në origjinë forma pësore e foljes kalimtare veprorë *dua*, por duke u larguar kuptimisht prej saj ka marrë kryesisht kuptimin e domosdoshmërisë a të nevojës.⁸⁵ Në shumicën e rasteve, folja *duhet* del me kuptim të plotë leksikor. Si folje me kuptim të zbehtë leksikor, në CK del vetëm një herë me ndërtimin *duhet + paskajore*, ku folja *duhet* është në kohën e tashme dhe del me modalitetin e domosdoshmërisë së kryerjes së veprimit.

Krahaso:

⁸⁵ Po aty, f.148.

- a. ... T'gjitha lavdet Muji po na i merr, / Çeta e plakut tjetër s' t'duhet gjâ!...(Kënga 6, f. 53)
b. ...Prap n'krajli m'duhet me dalë, / Pse besën e zotit krajlit i a kam dhânë (Kënga 13, f. 116)

Folja modale do + folje në të tashmen e dëftores

Gjuhëtari B.Beci i ka trajtuar gjerësisht foljet modale *mund* dhe *duhet*, mirëpo sipas tij folja modale *do* "përdoret në gjuhën e folur dhe tregon detyrim"⁸⁶, kurse për I. Arapi "...folësi me anë të foljes *dua* me vlerë modale shpreh një veprim si të dëshirueshëm, të pëlqyeshëm apo të pranueshëm."⁸⁷ Ndonëse ky ndërtim është trajtuar nga autorë të tjerë, në CK vërtetohet shumë rrallë, ku folja modale del në vetën e tretë njëjës.

Po ilustruam vargjet nga CK:

...Kurrkund gjallë mbí tokë s'do lânë. / Njatëherë Orët po e ndigjojnë... (Kënga 12, f. 92)

2.2.3. Foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit

Në këtë syth do të merremi me foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit dhe me ndërtimet foljore me këto folje, siç edhe na vërtetohen në materialin e vjelë nga CK.

Në planin e shprehjes foljet që mund të përfshihen në një mënyrë veprimi, nuk janë të njëjlojshme. Në mjaft gjuhë ka folje, të cilat kuptimisht hetohet ideja e intensitetit, e përsëritjes së veprimit etj., por nuk kanë ndonjë mjet karakteristik fjalëformues, të specializuar për të shprehur këtë.⁸⁸ Disa folje në togfjalësia të caktuar përdoren për të shprehur fillimin, vazhdimin, rritjen progresive ose mbarimin e veprimit të emërtuar nga fjala ndjekëse, por siç do të dalë edhe nga shembujt që do të jepen për ilustrim nga CK, më të shpeshta dalin rastet me foljet që shënojnë fillimin e veprimit. Në të gjitha rastet e vjela, "...foljet që shprehin mënyrën e shtjellimit të një veprimi, e humbasin mëvetësinë si gjymtyrë fjalie".⁸⁹ Shqipja e sotme, siç dihet, nuk e ka si kategori të veçantë aspektin, por ndërtimet me këtë kuptim janë shfrytëzuar mjaft mirë sidomos në letërsinë artistike,⁹⁰ ku e kemi parë me interes të ndalemë gjerësisht në këto forma.

Në CK ato zënë një vend të rëndësishëm, si për nga vlera e intensitetit që mbartin me trajtat e pasura, ashtu edhe nga denduria e përdorimit. Këto folje me kuptim të zbehtë leksikor do t'i trajtojmë në ndërtime foljore sipas përdorimeve brenda kontekstit.

Lidhur me mënyrat e veprimit foljor gjuhëtarët këto forma i kanë parë në disa pikëvështrime të ndryshme. I pari gjuhëtar që i ka trajtuar këto mënyra veprimi ka qenë K. Cipoja⁹¹, por ai vetëm sa e prek aspektin si dukuri, duke i emërtuar foljet, *bëj*, *rri*, *ul* si *kauzative (shkakësore)*. Në mënyrë të veçantë me trajtimin e mënyrave të veprimit foljor është marrë M.Çeliku⁹² në artikullin "Togje foljore leksikisht të kufizueme në shqipen e sotme", ku jepet në vija të përgjithshme struktura e këtyre ndërtimeve. Ndërsa sipas studiuesit M.Totoni⁹³, "trajtimi i bërë nga Çeliku, bazohet në një material të mbledhur vetëm në disa të folme të Shqipërisë së Mesme

⁸⁶ B. Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Shkodër, 2005, f.161.

⁸⁷ I. Arapi, *Vërejtje mbi mosklasifikimin e foljes "dua" si folje me vlerë modale në gramatikat shqipe*, SF, Nr. 1-2, 2009, f.196.

⁸⁸ A. Dhimo, *Për shqipen dhe shqiptarët I; Çështje të sistemit foljor. Mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*, (f.330-373), Tiranë, 2008, f.332.

⁸⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.264.

⁹⁰ M. Prik, *Reth disa ndërtimeve foljore me vlerë intensive në prozën e Koliqit*, Buletin Shkencor, SSHSH, 2012/62, f.35-40.

⁹¹ K. Cipo, *Gramatikë e gjuhës shqipe*, (ribotim) Tiranë, 2015, f.149-150.

⁹² M. Çeliku, *Togje foljore leksikisht të kufizueme në shqipen e sotme*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 Nëntor 1962), Tiranë, 1965, f.232.

⁹³ M. Totoni, *Kontrakte me foljen aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe*, SF, Nr. 1, 1968, f.85-95.

duke na dhënë një material jo të plotë të këtij trajtimi gjuhësor". Në vazhdim ai thekson: "...shqipes i mungojnë mjetet morfologjike për të shprehur aspektin e fillimit të veprimit, po si shumë gjuhë të tjera indoevropiane, edhe ajo e shpreh këtë kuptim me mjete leksikore, me anë të foljeve aspektive, folje këto me kuptim leksikor të reduktuar, të cilat paraprijnë një folje tjetër që tregon veprim a gjendje".⁹⁴ Duke e parë këtë çështje në plan dialektor, ai përmend për toskërishten përdorimin e foljeve: *zë, bëj e vij*, kurse për gegërishten: *nis, za, marr, vihem, baj, vij, qes, mbes e hyj*, duke theksuar se foljet *qes, mbes e hyj* në gegërishte kanë një përdorim mjaft të kufizuar. Në materialin që kemi analizuar kemi gjetur shembuj të shumtë të përdorimit të këtyre foljeve me këto kuptime leksikore. Për të konkretizuar idenë, po ilustruam shembullin e marrë nga CK:

...–Nuk *kam ardhë* me tÿ *me ndëjë*, / Por çou, djalë, në mejdan me m'dalë...(Kënga, 12, f. 103)

Gjuhëtari K.Topalli në librin "Sistemi foljor i gjuhës shqipe", i trajton mënyrat e veprimit foljor si nuanca aspektore e modale që shprehen me foljet: *baj/bëj, nis, zë, qes, rri, mbet, vihem, shkoj, vij* etj., të cilat si folje aspektore ndiqen nga forma e lidhore a e paskajore (në ligjërime popullore edhe nga përcjellorja), ose nga forma të ndryshme kohore të mënyrës dëftore, duke u lidhur me anë të lidhëzes bashkërenditëse.⁹⁵ Në materialin e studiuar na dalin shpesh këto ndërtime foljore, kryesisht me foljet që shënojnë fillimin e veprimit.

Për ilustrim po i referohemi shembullit nga CK:

...*Kan nisë kângën e po kndojnë,*

Kam marrë vallen e po vallzojnë,

Kan marrë lojën e po lodrojnë...

(Kënga 9, f. 79)

Më gjerësisht këto ndërtime do i shohim gjatë analizës.

Për studiuesin A.Dhrimo, foljet *rreh, rrekem, përpiqem, rropatem, hakatem, bëj, kërkoj, mundohem, tentoj*⁹⁶ që ndiqen zakonisht nga një folje tjetër në mënyrën lidhore, janë foljet që shërbejnë për të shprehur intensitetin e veprimit foljor. Si e tillë nga CK na del vetëm folja *bëj*, e cila ndiqet nga forma e paskajore, si në rastin:

–S'ké bre, Muj, pse m' *bân me plasë*, / Sot dobí vrapi s'po t'bân... (Kënga 21, f. 163)

Në studimin "Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe" të Xh.Alimhillit⁹⁷, është bërë një trajtim i hollësishëm i foljeve sipas mënyrës së veprimit, por duke iu referuar teorisë së aksionsartit. Për foljet *nis, filloj, ndaloj, vazhdoj* etj., autorja thekson: "...ato na bëjnë të mundur, në ndërtimet ku bëjnë pjesë, të dallojmë shtrirjen në kohë të veprimit".

Gjatë trajtimit të ndërtimeve intensive foljore në prozën e Ernest Koliqit, studiuesja M.Priku thekson: "...ata janë ndërtuar kryesisht me foljet: *orvatem, përpiqem, rrekem, bahet* etj., të ndjekura nga një paskajore gege e më pak nga një lidhore".⁹⁸ Edhe në CK, zakonisht foljet me vlerë intensive dalin në ndërtime të ndjekura nga një paskajore gege dhe më rrallë nga një trajtë e lidhore apo e pjesore.

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II kemi hasur kryesisht folje që shënojnë vetëm fillimin e veprimit me kuptim të zbehtë leksikor, si: *bëj, filloj, marr, nis, qes, zë* etj., kurse foljet që shënojnë vazhdimin dhe përfundimin e veprimit na kanë dalë në raste të izoluar. Foljet që

⁹⁴ Po aty, f.85.

⁹⁵ K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f.110.

⁹⁶ A. Dhrimo, *Për shqipen dhe shqiptarët I; Çështje të sistemit foljor...*, vep.e cit., f.366.

⁹⁷ Xh. Alimhilli, *Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimit në gjuhën shqipe*, Cosenza, 2009, f.118.

⁹⁸ M. Priku, *Reth disa ndërtimeve foljore...*, pun. i cit., f.39.

shënojnë fillimin e veprimit dalin në kohë të ndryshme të mënyrës dëftore, kryesisht në të tashmen, në të kryerën dhe më së të kryerën. Në raste më të rralla përdorime të këtyre foljeve vërtetohen edhe për mënyrën habitore. Këto folje zakonisht ndiqen nga një folje në mënyrën dëftore ose nga format e pashtjelluara foljore, paskajore ose përcjellore. Në këtë çështje do të ndalemi në dy drejtime për të analizuar ndërtimet me: **folje që tregon fillimin e veprimit + formë e shtjelluar dhe folje që tregon fillimin e veprimit + formë e pashtjelluar.**

Po i shohim më poshtë.

Ndërtimet me foljet që shënojnë fillimin e veprimit + paskajore dalin me denduri më të madhe përdorimi, në krahasim me ndërtimet me folje + përcjellore, siç do të vërehen në vijimësi gjatë analizës.

Foljet që tregojnë fillimin e veprimit + një folje në dëftore, habitore

Në përmbledhjen "VK" II foljet që tregojnë fillimin e veprimit kanë një përdorim relativisht të shpeshtë. Në këto ndërtime vargjet marrin më shumë aftësi shprehëse dhe gjuhësore. Më të shpeshta në këto përdorime dalin foljet, si: *filloj, hyj, marr, mbet, nis, qes, vij, zë*, të cilat dalin në ndërtime me një trajtë kohore të dëftores dhe më rrallë të habitores. Foljet që shënojnë fillimin e veprimit, si: *mbet, qes, vij, zë*, dalin në kohën e tashme të mënyrës dëftore të shoqëruara nga një folje tjetër po në të tashmen e dëftores. Në disa raste këto forma lidhen me njëra-tjetrën me anë të lidhëzës bashkërenditëse, *e*, si në rastet:

...*Mbet e i foli* krajle kapedani: / A p'e shef, Halil, dekën me sy?... (Kënga 4, f. 39)

...*Qitne e folën* dy kreshnikët e ríj: / A ndigjuet agët e Jutbinës?... (Kënga 6, f. 52)

Këto ndërtime foljore, Sh. Demiraj i klasifikon si togfjalësha të një tipi të lashtë që afrojnë me stilin e P.Budit, ku folja që shënon fillimin e veprimit " ...në shqipen e sotme përdoret rregullisht në mënyrën lidhore",⁹⁹ kurse në CK, siç u trajtua edhe me anë të shembujve, del me trajta kohore të dëftores.

Foljet që shënojnë fillimin e veprimit *filloj, marr, nis, qes, zë*, dalin edhe në kohën e kryer të dëftores të ndjekura nga një formë e së tashmes së dëftores. Këto ndërtime janë të shpeshta në CK, sepse ato shprehin, jo vetëm fillimin e veprimit, por edhe "...dyzimin si një shkallë të ndërmjetme drejt formave më të njësuara, më të përbashkëta e shohim edhe në pranëvënien (në të njëjtin varg) të shprehjeve frazeologjizmave apo lokucioneve dhe fjalëve të barasvlershme me to për nga kuptimi"¹⁰⁰, si në shembujt e dhënë:*

...*Kan nisë* këngën e **p'e këndojnë**, / *Kan nisë* kualt e **po** i lodrojnë... (Kënga 1, f. 2)

...*Kan marrë* llafin e **po llafiten**; *Kan marrë* gazin e **po gazmojnë**;

Kan nisë trimat Mujin **p'e pëvetin**... (Kënga 4, f. 26)

...Me mizdrakë *kan nisë* e **luftojnë**, / E mizdrakët batali i kan bâ... (Kënga 12, f. 103)

...E të dy shpatat i kan xjerrë, / Me shpata *kan nisë* e **po priten**... (Kënga 12, f. 103)

⁹⁹ Sh. Demiraj, *Elemente gjuhësore arkaike në këngët e kreshnikëve*, "Çështje të folklorit shqiptar", nr.2, Tiranë, 1986, f. 86.

¹⁰⁰ Gj. Shkurtaj, *Etnografia e të folurit në eposin e kreshnikëve*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, 39/2009, Prishtinë, f.93.

* *Shembuj të vjelë nga CK: Ká qitë* orët e **po** i pëvetë: / Ç'jeni ju qi ksajt lodroni?..(Kënga 2, f.12); ...*Kan nisë* lodrën e **po lodrojnë**, / *Kan nisë* gurrat e po i turbullojnë... (Kënga 1, f.3); ...*Kan nisë* vajin e **po vajtojnë**, / *Kan nisë* gjâmën e po gjamojnë... (Kënga 1, f.9); ...*Ká fillue* Hallili e e **pvetë**: / – Për kah shkon, ti lyps, a prej kah vjen?..(Kënga 13, f.114); ...*Ká nisë* letrën e **p'e këndon**, / Gjith me lot letrën p'e loton... (Kënga 14, f.120); ...*Kan shtrua* fieri e po rrijnë, / *Kan marrë* pijen e **po pijnë**... (Kënga 22, f.170); ...*Kan shtrua* fieri e po rrijnë, / *Kan marrë* pijen e **po pijnë**... (Kënga 22, f.170); ...*Aty* gjogave Agët u kan zdrypë; / *Kan xânë* vend trimat e **po pushojnë**... (Kënga 23, f.176); ...*Kan nisë* Agët e dert qi po **bajnë**: / Na ká dalë një baloz prej detit... (Kënga 26, f.206); ...*E ká marrë* vajin e **po bërtet**: / Mjeri un, mjeri Sokol-e Halili!..(Kënga 31, f.228)

* *Shembuj të vjelë nga CK:..Atëherë nâna ká nisë* e e **ká pvetë**: / – Për kah shkon, ti lyps, a prej kah vjen?..(Kënga 13, f.115); ...*Ajo* letër në dorë Alís i ká rá, / *Ká fillue* letrën e e **ká kndue**... (Kënga 13, f.113); ...*Të dy* shpatat i kan xjerrë, / E me shpata *kan nisë* e **jan pré**... (Kënga 24, f.193); ...*E kan marrë* rrugën e **jan nisë**, / E m'kan dalë n' Bjeshkën e thatë... (Kënga 25, f.200)

Siç del edhe nga shembujt e dhënë, në këtë ndërtim foljor, si folja që shpreh fillimin e veprimit, ashtu edhe folja e mënyrës dëftore që e shoqëron këtë ndërtim janë në formën veprorë. Trajta e kohës së tashme të dëftores, në shumicën e rasteve, paraprihet nga pjesëza aktualizuese **po**.

Nga materiali i shqyrtuar kemi vënë re përdorimin e foljeve që shënojnë fillimin e veprimit në vetën e tretë njëjës dhe shumës. Në disa ndërtime të tjera foljore, foljet që tregojnë fillimin e veprimit, si: *hyj, filloj, marr, nis, qes*, dalin në të kryerën e dëftores, ashtu si folja tjetër që e shoqëron. Këto ndërtime na paraqiten në material me kuptime intensive të pasura, të cilat dalin si në formën veprorë, ashtu edhe joveprorë. Në pjesën më të madhe të shembujve që kemi vjelë vërtetohet se këto ndërtime foljore lidhen më anë të lidhëzes bashkërenditëse, **e**, si: *kan qitë e kan lodrue, ká nisë e ká pvetë, kan nisë e jan pré* etj., si në shembujt që kemi vjelë nga CK:*

...N'dorë t' Muji letra ká shkue, / *Ká marrë Muji e e ká kndue*... (Kënga 9, f. 77)

...N'podrum gjogun i a ká çue, / *Kan hî n'odë e kan pushue*... (Kënga 10, f. 83)

...Strugën *kan qitë e kan lodrue*, / E mâ mirë me kângë po e ndjekë... (Kënga 10, f. 84)

...E po i shikon fushat rreth e rreth, / E *ká qitë* nânës **e** m'i *ká thânë*... (Kënga 26. f. 204)¹⁰¹

Për sa i takon foljes *vetë*, me kuptimin "*nis*", vërtetohet vetëm me formën e zgjedhimit jovepror të së kryerës dhe më se të kryerës së dëftores në vetën e tretë njëjës dhe shumës, siç e pohojnë edhe shembujt:

...E *janë vojtë* nusen e *e kan marrë*, / E prej shpijet krushqit janë dredhë... (Kënga 20, f. 155)

... *Ish' vojtë* Zuku e nusen e *kish kapë*, / N'vithe t' gjogut nusen e ká qitë... (Kënga 18, f. 145)

Një rast i rrallë është edhe përdorimi i foljes *marr* në të kryerën e dëftores e ndjekur nga folja në kohën e *ardhme*, e cila del me pjesëzën aktualizuese **po**. Në shembullin e dhënë jepet, jo vetëm veprimi i përfunduar, që i ruan lidhjet me çastin e ligjërimit¹⁰², por edhe *veprimi që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit*¹⁰³, si në rastin:

...*Kan marrë ikën e po duen me pshtue*, / Në derë Muji aty po e rue... (Kënga 8, f. 68)

Një ndërtim foljor që përdoret shpesh në CK, është ai i ndërtuar nga trajta kohore e *më se të kryerës* së dëftores e foljes *nis*, e cila shoqërohet me trajta kohore të dëftores, në vetën e tretë njëjës dhe shumës. Në këtë ndërtim foljor, folja që tregon fillimin e veprimit është në formën joveprorë e ndjekur nga një folje në veprorë. Të dyja foljet në këtë ndërtim kanë kuptime të përafërta, siç mund të vërehet edhe nga shembujt e vjelë:

...Në shpinë gjogut i kish'rá, / E *ish'nisë* rrugën e *e kish' marrë*... (Kënga 13, f. 110)

...*Ishte nisë* djali e *kishte shkue*, / Në derë nânës s'Alis i ká trokllue... (Kënga 13, f. 110)

...Trí orë t'bardha midis fushës i ká pá, / Dy *ki'n nisun* lojën *e po luejnë*... (Kënga 2, f. 13)

Në pak raste, koha e kryer e foljes *nis* dhe *qes* ndiqet nga forma veprorë e kohës së kryer të mënyrës habitore, ku ndërmjet ndërtimit foljor, hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë.

Dy shembujt e ilustruar i takojnë së njëjtës këngë dhe faqe të përmbledhjes "VK" II:

...*Ka nisë Muji e paska thânë*: / – T'kishem dijtë si kênka kânë, / Probatin të kishem xânë...

...*Ká qitëm Muji e paska thânë*: / – Zoti t'vraftë Bani Zadrilí... (Kënga 15, f. 129)

Foljet që tregojnë fillimin e veprimit + një formë e pashtjelluar foljore

Në CK ndërtimet me foljen që tregojnë fillimin e veprimit të shoqëruara nga një paskajore janë shumë më të shpeshta, në krahasim me ndërtimet me këto folje me një trajtë të përcjellores.

¹⁰¹ Në ndonjë rast të izoluar ky ndërtim foljor shoqërohet edhe nga ndajfolje kohore, si, p.sh.:...**Atëherë** trimi *ká qitë e i ká thânë*: / Zhurmë n'konak nuk due me m'bá... (Kënga 30, f.224)

¹⁰² Gramatikë e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.312.

¹⁰³ Po aty, f.316.

Këto ndërtime dalin si për kohët e thjeshta, ashtu edhe për kohët e përbëra të mënyrës dëftore. Kemi gjetur shumë raste edhe të ndërtimit të kohës së kryer të mënyrës habitore të foljes *nis* me një paskajore. Këto forma na dalin në të dy trajtat e veprorës dhe joveprorës dhe vërehet një përdorim më i shpeshtë i vetës së tretë njëjës dhe shumë.

Më gjerësisht po i argumentojmë sipas ndërtimeve që dalin në CK.

Në ndërtimet me foljen *bëj* + *paskajore*, folja *bëj* del me dy trajta në kohën e tashme dhe të kryer të dëftores. Zakonisht vërehet përdorimi i vetës së tretë njëjës dhe më rrallë i vetës së parë të numrit njëjës dhe vetës së tretë shumë. Në raste më të izoluara folja *bëj* del në vetën e dytë njëjës të lidhores. Nga shembujt që kemi vjelë, forma veprorë e këtyre trajtave përdoret më shpesh.

Nga CK po ilustruojmë:

... – N’shpí kúr *t’bâj me hî*, / Do t’hjeki binakët me i bré... (Kënga 26, f. 209)

...Qi hiç mbas Mujit mirë nuk *bân me shkue*,/Por në shpinë të gjogut ké me i hypë...(Kënga 2, f. 15)

...Kur *kan bâ me* u *dhânë* uj gjogave,/Kurrnji pikë me rredhë teposhtë s’p’e lânë.(Kënga 6, f. 51)

...N’megje t’ krajlíve kur *t’bâjsh për me dalë*, / Kurrkund kryet gjogut mos me i a ndalë...(Kënga 4, f. 29)

...Në vorr mue si t’më shtísh, / E në shpi kúr *t’bâjsh me kthye*... (Kënga 33, f. 234)

Në raste më të rralla, në këto ndërtime foljore hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë, si në shembujt e ilustruar:

...Si gjâmë deti qi bjen moti i lig, / Si gjâmë qiullet kur *bân rëja me shkrepë*...(Kënga 6, f. 60)

...Kúr *â bâ vakti me rá*, / Keq po i shtrojnë e keq po i mblojnë... (Kënga 11, f. 94)

Në disa raste intensitetin foljor e shoqërojnë edhe disa ndajfolje e lokucione ndajfoljore, të cilat mund të tregojnë vendin e kryerjes së veprimit në një mënyrë pak a shumë të papërcaktuar¹⁰⁴, si: *kurrkund*, *askund*, *gjithkund* etj, si në rastin:

...Çilja derën, n’bafti t’Zotit, / **Kurkund** zêmra s’i *bân me shdrý* derën... (Kënga 4, f. 36)

Një nga përdorimet më të shpeshta në përmbledhjen "VK" II, është ndërtimi me foljen *nis* + *paskajore*, ku forma e shtjelluar foljore, *nis*, del me trajta të kohëve të thjeshta dhe të përbëra të mënyrës dëftore, në formën veprorë dhe joveprorë, zakonisht në vetën e tretë të njëjësit dhe në pak raste edhe në vetën e dytë të njëjësit, siç na vërtetohen edhe në vargjet:*

...*Ká nisë* dita *me dá* terrin, / Nusja *niset me rá* n’krue... (Kënga 1, f. 7)

...*Ká nisë* ashta *me gjimue*, / *Ká nisë* toka *m’u sumurue*... (Kënga 15, f. 12)

...Po *nisë* Rushën *me* e *pëvetë*, / *Ká nisë* Rushës *me* m’i *thânë*... (Kënga 26, f. 208)

...Se m’ká dashtë, e *nisë me vajtue*, / Se m’ká dashtë, e *nisë me mjerue*... (Kënga 29, f. 222)

Siç shihet edhe nga shembujt e dhënë, folja *nis* del në kohën e tashme, të kryerën e thjeshtë dhe në më se të kryerën e dëftores. Kemi vënë re se në zgjedhimin joveprorë, folja *nis*, në pjesën më të madhe të rasteve shoqërohet nga paskajorja gege e foljes *shkoj* (*me shkue*), si në ndërtimet në numrin njëjës, ashtu edhe në numrin shumë, siç e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë nga Këngët Kreshnike:

...Kah *jé nisë*, Mujo, *me shkue*?/ – N’at Jutbinë për n’kjoftë gjikue... (Kënga 6, f. 56)

...Ka marrë rrugën edhe *â nisë me shkue*,/ E m’ká vojtë tu Probja e Januka e bardhë...(Kënga 2, f. 18)

¹⁰⁴ Po aty, f.265.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...I a merr fjalën Dizdar Osman aga: / Tash *ké nisë*, Mujo, *m’u plakë*...(Kënga 6, f.54); ...Sa shpejt plaku kënka çue, / *Ká nisë* odat *me* i a *çilë*... (Kënga 2, f.17); ...Sé kúr *jam nisë* n’mejdán *me t’dalë*, / Asnji rob n’shpí s’kam lânë... (Kënga 12, f.105); ...Dhâmbët për dhâmbë si i ká shtërngue, / Koçekët majesh *kan nisë m’u rrxue*...(Kënga 15, f.127); ...E *ishte nisë* Mujit *me* i *ndihmue*, / E t’tridhetët Krajli i kishte pré... (Kënga 24, f.192)

...Janë çue n'kâmbë, atllarve edhe u kan hypë; / Kan marrë rrugën e janë nisë me shkue...(Kënga 2, f. 16)

Në ndërtimin *nis* + *paskajore*, foljen *nis* e gjejmë zakonisht me trajtën e vetës së tretë shumës të kohës së kryer të dëftores dhe në pak raste vërehet edhe trajta e vetës së dytë shumës e kësaj kohe. Përdorim më të shpeshtë ka forma veprorë, kurse forma e pashtjelluar paskajore del në të dy format, veprorë dhe joveprorë.

Po marrim vargjet nga CK:

...Sot shtatë vjet t'reja u kam mbarue, / Keni nisë shpejt m'u rrênue... (Kënga 14, f. 120)

...Kân nisë vashat me lypë krojet, / Kan gjetë krojet tânë ngrî hej... (Kënga 4, f. 25)

...Kan nisë nakël për m'u bâ, / Kqyre zânat atëherë çka kan thânë... (Kënga 21, f. 167)

...Kûr kâ nisë drita për me dalë, / Kan nisë shkjet m'u avitë... (Kënga 34, f. 240)

...Në shpinë t'gjogut t'Mujit i kan hipë, / E janë nisë të dy me ikë... (Kënga 13, f. 116)

Nga ndërtimet e mësipërme, vërehet edhe përdorimi i pjesës karakteristike **kah** të gegërishtes, e cila rrit intensitetin e veprimit, siç e pohon edhe shembulli i vjelë:

...Mirë se vini, burrat e Jutbinës! / **Kah** po nisna sot për me çetue?... (Kënga 6, f. 51)

Në raste më të rralla, përsëritja e së njëjtës folje, e rrit intensitetin e veprimit foljor brenda vargut, si në shembullin:

... – Nisni pijen, shokë, nisni me kndue, / Probatini tek m'ká ardhë mue... (Kënga 10, f. 88)

Por, jo rrallë, këto ndërtime shoqërohen edhe nga ndajfoljet apo lokucionet ndajfoljore, duke e lënë të papërcaktuar plotësisht mënyrën e kryerjes së veprimit, si në rastet:

...M'a kâ marë gjogun prej frënit, / **Kesh** te gurrat â nisë me i dhânë uj gjogut...(Kënga 23, f. 181)

...**Qat-herë** trimi â nisë me dredhë tu shpija, / Edhe shokët të gjith m'i kâ bashkue...(Kënga 5, f. 47)

Këto ndërtime foljore dalin shpesh me dyzim kuptimor, por për arsye se shpjegimi është dhënë më lart, po japim vetëm një shembull për ilustrim:

...Kâ nisë brimën, atëherë me bërtitë, / Porse djalin nâna s'e kâ zgidhë.. (Kënga 11, f. 91)

Në pak shembuj del edhe ndërtimi, *filloj* + *paskajore*, ku trajta *filloj*, që shënon fillimin e veprimit foljor del në kohën e kryer të dëftores, në veprorë dhe joveprorë, kryesisht në vetën e tretë shumës.

Nga CK po veçojmë vargjet:

...Me gjith nuse janë fillue, / Janë fillue me kthye n'Jutbinë (Kënga 1, f. 2)

...Hiç bré trimat vesht s'kan marrë, / Janë fillue n'bjeshkë për me dalë... (Kënga 15, f. 126)

Më përdorime më të rralla ky ndërtim del në vetën e dytë dhe të tretë njëjës, siç e vërtetojnë edhe shembujt nga CK:

...Kë fillue pak Shkjët me i drashtë! / S'und po pritët njaj Sokol-e Halili... (Kënga 6, f. 54)

...Ishte kthye sarajin e kish' kqyrë, / Kâ fillue sarajin e m'a nême... (Kënga 13, f. 110)

Lidhur me ndërtimin me foljen *marr* të ndjekur nga një lidhore, studiuesi A.Dhrimo shënon: "Krahas mënyrës së fillimit të veprimit, ajo përmban edhe idenë e intensitetit të veprimit, pra shpreh një veprim intensiv të tij".¹⁰⁵ Të njëjtin mendim ndan edhe studiuesja M.Priku, kur gjatë studimit të prozës së Koliqit vëren se kjo folje "...i mbart fare mirë këto vlera".¹⁰⁶ Këto ndërtime nuk na kanë dalë, por në materialin e studiuar në CK kemi vjelë disa shembuj me ndërtimin *marr* + *paskajore*, ku folja *marr* që shpreh fillimin e veprimit na del në kohën e tashme dhe të kryer të dëftores, përkatësisht në vetën e parë dhe të tretë njëjës dhe në vetën e dytë dhe të tretë shumës me të njëjtën vlerë intensitive të argumentuar si më lart nga studiuesit. Trajta e paskajores në këto raste merr funksionet e lidhores.

¹⁰⁵ A. Dhrimo, *Për shqipen dhe shqiptarët I; Çështje të sistemit foljor...*, vep. e cit., f.373.

¹⁰⁶ M. Priku, *Reth disa ndërtimeve foljore...*, pun. i cit., f.38.

Nga CK kemi marrë shembujt për ilustrim:

...Qi kúr kém marrë me kundrue rrugën / S'është pá kali, as s'është pá kalori... (Kënga 23, f. 182)

...Shteku i ballit, si shteku i malit, / Kur merr hâna me pranue... (Kënga 4, f. 27)

...Nji tradhtí e ká mendue, / Merr Omerin kshtu me e msue... (Kënga 26, f. 208)

...Kúr ká marrë m'ta për me sjellë, / Alla n'kâmbë djali është sjellë... (Kënga 26, f. 209)

...Kán marrë lojën me lodrue, / ká nisë drita me ague... (Kënga 10, f. 86)

Gjatë studimit të materialit kemi ndeshur raste më të rralla të ndërtimeve foljore me foljet, si: *di, qes, votë, zë + paskajore*. Foljet me këtë vlerë modale në këto ndërtime dalin me trajta kohore të së tashmes dhe të së shkuarës të mënyrës dëftore. Nga shembujt e vjelë kemi vënë re se në këto ndërtime, veta e tretë njëjës dhe shumës ka përdorim më të shpeshtë.

Po ilustrojmë disa vargje nga CK:

...Gadi shkjaút për n'dijshe me i ndëjë, / Tjetër ftyrën s't'a ká pá... (Kënga 6, f. 61)

...Kúr t'u qesin rruga ksajt me rá, / Mos me britë as dajre mos me bâ... (Kënga 29, f. 222)

...Sá fort hapin ká xânë me e shpejtue! / Sá fort hânën trimat m'a kan true! (Kënga 6, f. 52)

...Ká ndeshë nji mrize, nji krue, / Ká xânë vend Alija me pushue... (Kënga 13, f. 110)

...Qyqe vetëm rrugën ma paska marrë, / Kan xânë vend hyjt vajin për me e ndie... (Kënga 30, f. 225)

...Kúr janë votë me hî në derë, / Dera e mbretit Mujin s'e ká xânë... (Kënga 3, f. 22)

Për sa i takon këtij ndërtimi, në disa raste, trajta fojore që shtjellohet del e shoqëruar edhe nga dy forma të pashtjelluara të njëpasnjëshme, si në rastet:

... – Nuk kam ardhë me ngrânë, me pí, / Nuk kam ardhë me hjekë mërzi... (Kënga 34, f. 237)

...N'mos jé ardhë me ngrânë e me pí, / N'mos jé ardhë sefa për me bâ... (Kënga 14, f. 118)

...Kah tri krena për shoq i kishin marrë, / E ki'n ardhë me i ndihmue me i shpejtue Mujit... (Kënga 24, f. 190)

Siç del edhe nga shembujt e ilustruar më lart, trajta e shtjelluar del në veprorë dhe joveprorë me format kohore të së kryerës dhe më se të kryerës së dëftores.

Në pak raste del edhe ndërtimi me foljen që tregon fillimin e veprimit, *nis në kohën e kryer të habitores + paskajore* e foljes. Në këtë ndërtim foljor, folja që shënon fillimin e veprimit del në formën veprorë dhe joveprorë, në vetën e tretë njëjës dhe shumës, si në vargjet nga CK:

...Nji kah nji krejt punët i a kallxon Mujit, / T'madhe burri paska nisë me qeshë... (Kënga 4, f. 38)

...Kênkan nisë në mâjë t'bjeshkës me dalë, / Njaty vend si paskan xânë... (Kënga 6, f. 56)

...M'a kan ndie, e Zukut i kan dalë para, / Paskan nisë Zukun me m'a pvetë... (Kënga 11, f. 92)

Siç u theksua edhe më sipër, ndërtimet me *folje që tregojnë fillimin e veprimit + përcjellore* kanë një përdorim më të vogël në krahasim me ndërtimet me *folje që tregojnë fillimin e veprimit + paskajore*. Gjatë analizës së përmbledhjes "VK" II, kemi ndeshur disa raste të ndërtimit foljor *nis + përcjellore*, në vetën e dytë dhe të tretë njëjës dhe në vetën e tretë shumës. Në këtë ndërtim, folja *nis* na del në të gjitha rastet në kohën e kryer të dëftores, zakonisht në formën veprorë dhe më rrallë në joveprorë, si në vargjet e dhëna për ilustrim:

...Tha- i a ká nisë Muji tuj punue / Tha- i a ká nisë Muji tuj luftue... (Kënga 7, f. 66)

...Se me ç'giasë qí jam tue pá, / Na ké xânë Bjeshkve tue çetue... (Kënga 23, f. 180)

...Kan nisë gjâmën tuj gjâmue, / M'â nisë nâna, tha, tue lotue... (Kënga 18, f. 142)

...N'mjedis t'fushës kânkân dalë; / E t'm' janë nisun fushës tu' këndue... (Kënga 6, f. 51)

Në raste më të rralla, edhe në këtë ndërtim foljor, ashtu si edhe në disa ndërtime të tjera, kemi vënë re dyzimin kuptimor si një element përforcues në fjali, siç e pohon edhe shembulli nga CK:

...Kan marrë brimë edhe piskamë, / Kan nisë gjâmën tuj gjâmue.... (Kënga 16, f.132)

Por, gjatë analizës së Këngëve Kreshnike dalin edhe disa ndërtime foljore, ku folja që tregon fillimin e veprimit është në mënyrën urdhërore. Ndërtime të tilla janë: *nis + përcjellore* dhe *marr + përcjellore*, ku në të gjithë rastet ndërmjet ndërtimit foljor hyjnë gjymtyrët e dyta:

...Sá t’vijë koha për mjesnatë, / Merrni brimën tuj piskatë... (Kënga 16, f. 131)

...Merrni brimën tue bërtitë. / Nisni brimë e nisni gjâmë... (Kënga 16, f. 132)

Folje që tregon vazhdimin e veprimit + formë e pashtjelluar foljore

Në raste më të rralla, në CK vërtetohen edhe disa ndërtime me foljet që tregojnë vazhdimin e veprimit të ndjekura nga trajta të pashtjelluara foljore, zakonisht me trajta të përcjellorjes dhe më rrallë me trajta të pjesores dhe paskajores. Ndërtimet më të shpeshta janë: *rri + pjesore*, *rri + paskajore*, *rri + përcjellore*, *vij + përcjellore* dhe *shkoj + përcjellore*.

Në ndërtimin me foljen *rri + formë e pashtjelluar foljore*, folja që shënon vazhdimin e veprimit, **rri** del përgjithësisht në tri vetat e njëjësit të së tashmes së dëftores, kurse folja që emërton veprimin e zgjatur është në pjesore, paskajore ose përcjellore sipas rastit:

...Gjokut ashtën i a ká dhânë, / Për buzë kronit po rri pshtetë... (Kënga 1, f. 4)

...Pásh njat degë ku rri pushue, / Falë me shndet Gjeto Basho Mujit!... (Kënga 4, f. 40)

...Por janë çikat e Behurit, / N’ mollë t’shalës s’ Mujit kryet qi po i rri vjerrë... (Kënga 6, f. 62)

...Frigë e madhe plakun m’a ká marrë, / Te kryet trimit ora po i rrin ndêjë (Kënga 23, f. 179)

...Sá t’duesh rri për me hjekë mërzi. / Qyqja Mujit shka i ká thânë... (Kënga 33, f. 238)

...Për trí javë vaden e kam pasë, / Qe trí vjet rri tue pritë (Kënga 14, f. 120)

Ndërtime të tjera foljore janë edhe ato që ndërtohen me anë të foljes *vij + përcjellore* dhe *shkoj + përcjellore*, ku foljet *vij* dhe *shkoj* në të gjitha rastet dalin në kohën e tashme të dëftores në vetën e tretë njëjës.

Nga Këngët Kreshnike po japim shembujt:

...Sá mirë Muja kuvendit po i vjen! / Fort mâ bukur fjalët po vjen tuj tjerrë... (Kënga 6, f. 61)

...Gjoku i Mujës vjen tue tërfrue, / Tym per hundet mjegull tue lshue... (Kënga 15, f. 127)

...Gur e pluhun mazi shkon tuj cue, / Për mjet shehrit po m’i bjen... (Kënga 9, f. 72)

...Vesht ká marrë Sokol-e Halili. / Shkon tuj qeshë Mujit e po i kallxon... (Kënga 24, f. 189)

Në raste më të izoluara del ndërtimi me **vij në të tashmen e dëftores**, e ndjekur nga një formë e së tashmes të lidhore, **t’shkojmë**, e cila shoqërohet nga paskajorja *gege*, *për me shndoshë*, e përsëritur në 5 raste. Folja *vij* në këto ndërtime, përveç kuptimit të plotë të saj, tregon edhe rritjen progresive në të dy veprimet edhe te forma e mënyrës lidhore dhe ngjan se shtrihet edhe te forma e pashtjelluar, si në shembullin:*

...Gjogu mëç, moj shoqe, te i ká dalë, / A po vijni t’shkojmë për me e shndoshë?... (Kënga 32, f. 232)

Në një rast të vetëm na del ndërtimi, *pushoj + përcjellorje*. Trajta *pushoj* del në mënyrën dëftore me kuptim të zbehtë leksikor, e cila jep përfundimin e veprimit të foljes, e ndjekur nga përcjellorja e foljes, si në rastin e vjelë nga CK:

...Gjith rreth kishën shkjet m’a kan rrethue / S’po pushojnë trimat tue luftue... (Kënga 29, f. 220)

Foljet njëvetore

Foljet njëvetore janë ato folje që mund të kenë një kryefjalë të shprehur ose të nënkuptueshme.¹⁰⁷ Si të tilla në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, vërehen disa raste të izoluara:

1. Folje njëvetore që emërton veprime karakteristike për kafshët dhe që, si rrjedhim përdoret vetëm në vetën e tretë¹⁰⁸. Nga materiali në CK na ka dalë vetëm forma, *hingllon*, si në shembujt e dhënë:

...*Hingllloi* gjogu, me këmbë çukurmoi¹⁰⁹ / Rri urtë, gjog, bre”, plaku m’i ká britë... (Kënga 23, f. 177)

...Sá t’madhe gjogu po *hingllon*, / Tâna bjeshkët gjogu po i *shurdhon*... (Kënga 32, f. 232)

2. Folje njëvetore që tregon dukuri atmosferike ose natyrore, kemi marrë formën *ushtojnë*, si në rastin:¹¹⁰

...Ki’n çetinat vetëm kreshtat: / *Ushtojnë* lugjet prej ortiqesh... (Kënga 4, f. 25)

Në këtë Cikël kjo folje lidhet vetëm me një kryefjalë dhe mund ta konsiderojmë si folje njëvetore dhe në asnjë kontekst tjetër kjo folje nuk na del e lidhur me një kryefjalë tjetër.

Foljet pavetore

Folje pavetore klasifikohen ato folje që nuk kanë kryefjale të shprehur, as të nënkuptueshme.¹¹¹ Në CK kemi vjelë pak shembuj me folje pavetore, si:

...- A p’e shef qat lumë te gjân? / Atje i *thonë* “Te-Lumi-i-Tunës... (Kënga 4, f. 31)

...*Thonë* se toka kënká dridhë, / Dushku i maliti i rí ká dalë... (Kënga 17, f. 139)

... Arnauti meshë po çon, / Turqit, tha, uratë po *thonë*... (Kënga 22, f. 173)

...Sá t’madhe Muji áisht hallakatë, / Gjethi i ahit, *thonë* për tokë ká rá... (Kënga 29, f. 221)

Folja këpujore **jam**, kur është pjesë e kallëzuesit emëror përdoret me një kuptim leksikor të zbehur, si në rastet që kemi shkëputur nga CK:

...Kúr të shkojsh n’at katund me rá, / Aty *áisht* sheher i madh... (Kënga 10, f. 83)

...- Po më ndigjoni tridhetë kapedana:/ Tash *á* dimën, prendvera po vjen..(Kënga 12, f. 99)

...E ktu *á* Muja me Halilin, / E ktu *á* Zuku Bajraktár... (Kënga 22, f. 174)

Me vlerën e pavetores, përdoret edhe lokucioni foljor, *bájë dritë* (e barasvlershme me kuptimin *ndriçon*), si në fjalinë:

...Ça ká qitun e ká thânë? / Sa *t’bájë dritë* ká ndoren dielli... (Kënga 4, f. 30)

Nga ndërtimet e skematizuara më sipër, vërehet se *foljet modale* dalin me tre ndërtime, ku përdorim më të shpeshtë kanë ndërtimet foljore me foljen modale *mund*, e cila del me disa ndërtime. Kështu, folja modale, *mund* zakonisht del në kohët e thjeshta dhe të përbëra të mënyrës dëftore, kurse folja shoqëruese del më rrallë në një nga trajtat e mënyrës dëftore (e tashme, e kryer e thjeshtë, e kryer dhe më se e kryer). Në raste të izoluara del edhe ndërtimi *mund + lidhore*. Më të shpeshta dalin ndërtimet me foljen modale *mund* e ndjekur nga trajta e

* *Shembuj të tjerë me foljen vij*:...A po vijni *t’shkojmë për me e shndoshë?* / Atëherë trimat n’këmbë janë çue... (Kënga 12, f.106); ...A po vijni *t’shkojmë për me e shndoshë?* / E me t’shpejtë tu Muja paskan shkue... (Kënga 23, f.177)

¹⁰⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.267.

¹⁰⁸ Po aty, f.268.

¹⁰⁹ FGJSSH, *çukërm/ó-j* - Përplas thundrat në tokë me padurim, i bie tokës me thundër dhe e rrëmon pak, *kali çukërmon* etj., Tiranë, 1980, f.279.

¹¹⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.268.

¹¹¹ Po aty, f.267.

***Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)***

pashtjelluar e paskajores, tipi "*me punue*". Kurse, ndërtimet me foljet modale *duhet* dhe *do* i kemi ndeshur në raste të izoluara.

Siç edhe del nga shembujt e vjelë nga CK, *foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit* dalin të pasura me ndërtime, zakonisht me foljet: *bëj, filloj, marr, nis, qes*, etj., të shoqëruara nga një formë e dëftores, habitores apo nga forma e pashtjelluar e përcjellores. Më të shpeshta dalin ndërtimet me foljet që tregojnë fillimin e veprimit të shoqëruara nga paskajorja geqe "*me bâ*", kurse ndërtimet e tjera me foljet që tregojnë vazhdimin dhe përfundimin e veprimit janë më të rralla.

Foljet njëvetore dhe pavetore nuk janë të shpeshta në CK. Në pak raste disa ndërtime dalin me këto nuanca kuptimore.

KREU III : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS DËFTORE

Ndryshe nga mënyrat e tjera, ku formimet kohore janë të kushtëzuara nga lloji i modalitetit, mënyra dëftore nuk ka ndonjë kushtëzim të tillë. Duke qenë se mënyra dëftore karakterizohet nga kuptimi modal i vërtetësisë, kjo mënyrë në të gjitha gjuhët indoevropiane gjatë zhvillimit të saj historik është pasuruar me forma të ndryshme foljore, nëpërmjet të cilave janë shprehur kundërvënie të larmishme, jo vetëm të karakterit kohor, por edhe të karakterit aspektor e në disa raste edhe kundërvënie, që kanë të bëjnë me mënyrën e veprimit.¹¹²

Një veçori tjetër, që i dallon format kohore të mënyrës dëftore nga ato të mënyrave të tjera, është karakteri i tyre neutral për sa i takon modalitetit, në vështrimin që ato shprehin kuptime kohore të mirëfillta të pampleksura me ndonjë kuptim modal si ato të mënyrave të tjera, nëpërmjet të cilave shprehet vlerësimi plotësues i folësit në formën e një dyshimi, dëshire a emocioni.¹¹³

Për sa i takon krijimit të një sistemi kompleks kundërvëniesh të mënyrës dëftore, kjo është diktuar nga nevoja për të treguar, jo vetëm kohën e kryerjes së një veprimi në raport me çastin e ligjëritimit ose me një çast të caktuar të së shkuarës a të së ardhmes, por edhe mënyrën e paraqitjes së zhvillimit të veprimit si dhe aktualizimin e tij.¹¹⁴

Nga tri kohët themelore të foljes më e pasur në forma kohore, që i kundërvihen njëra-tjetrës, dalin koha e tashme dhe e shkuar. Koha e tashme e dëftores del me një numër të madh formash dhe trajtash, të cilat vërtetohen kryesisht të formuara nga mbaresa dhe variante dialektore (kryesisht i takojnë gegërishtes veriperindimore dhe më pak gegërishtes verilindore) dhe më rrallë sipas normës standarde. Për arsye studimore gjatë trajtimit të kohës së tashme format dytësore i kemi ndarë më vete me qëllimin që të mos na shkëputet vëmendja e studimit nga format parësore të kohëve të thjeshta të ndërtuara me mbaresat së pari dhe së dyti këto forma sekondare janë të shpeshta në material për krahasim formave të tjera të thjeshta.

Në CK, koha e shkuar na vërtetohet me forma kohore të së pakryerës, të kryerës së thjeshtë, të së kryerës, më se të kryerës, të ashtuquajturës e kryer e tejshkuar¹¹⁵ dhe me format e mbipërbëra kohore, karakteristike për gegërishten.

3.1 Format e kohës së tashme. Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror

Kuptimi themelor i kohës së tashme të mënyrës dëftore është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjëritimit.¹¹⁶ Por, siç do të shjtellohet edhe më poshtë, në gjuhën shqipe, ajo përdoret edhe me një kuptim kohor të pacaktuar edhe në disa rrethana edhe me kuptimin e së ardhmes dhe të së shkuarës,¹¹⁷ raste, të cilat do t'i trajtojmë gjatë analizës.

Siç del nga një vështrim i paradigmeve të kohës së tashme në CK, tek temat foljore vërehen edhe disa veçori fonetike, pjesa më e madhe e të cilave me karakter morfonologjik.

- Foljet e parregullta *jam, kam* në të tashmen pësojnë metafoninë **-a:-e-**, në numrin njëjës, kurse ndërrimin **-e:-i-** e pësojnë në vetën e dytë shumës, si: *jam – je – jini, kam – ke – kini*.

Ky është një ndërtim që ka nisur që herët.¹¹⁸ Ndeshet rregullisht te autorët e vjetër veriorë, Buzuku, Budi, po ashtu te Gramatika e Da Lecce-s dhe e De Radës, trajta, të cilat nuk janë

¹¹² Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.711.

¹¹³ Po aty, f.711.

¹¹⁴ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF, Nr.3, 1977, f.117.

¹¹⁵ Po aty, f.118.

¹¹⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.306.

¹¹⁷ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe*, SF, Nr. 4, 1971, f.49.

¹¹⁸ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.745.

përgjithësuar në të gjitha të folmet e shqipes, kurse në shqipen e sotme është normalizuar trajta me **-e**.¹¹⁹

- Në disa folje të zgjedhimit të dytë dhe në ndonjë folje të parregullt ndeshim dukurinë e metafonisë **-a- :-e** ose **-o-** ; **-e-** në vetën e dytë dhe të tretë njëjës, si: *dal~ del, njof~ njef ~ njeh, shof~shef ~sheh* etj.

- Zbërthimi i zanores së theksuar së temës **-o-** në **-ue-** (karakteristike për gegërishten) del e përdorur në foljet e parregullta, tipi, *due*, vetëm në vetën e parë njëjës, ndërsa në vetat e tjera për njëjës dhe shumës dalin format foljore, si: *don, do/don, dona, doni*.

- Disa folje të zgjedhimit të dytë apo disa folje të parregullta që në shqipen standarde dalin me temë në **-h-**, në materialin e studiuar dalin më shpesh me fundoren **-f** (veçori e gegërishtes), si: *njof, shof, njef, shef, shofim, njifni, shofin, njofin* dhe rrallë me formantin tjetër të normës letrare si te foljet: *njeh, sheh, njihni*.

- *Elizioni*. Një rast mjaft interesant i elizionit është shuarja e zanores *o* të pjesëzës *po*, kur pas saj vjen trajta e shkurtër përemërore *e*. Kjo trajtë *p’*e ka marrë kuptimin e pjesëzës *po* dhe përdoret përpara saj në vend të trajtave të tjera të shkurtra.

P.sh : ...Po me e pá a thue e njef ? / Nusen prap **p’**e pvetë.

(Kënga 1, f. 5)

Por, kemi ndeshur edhe raste të përdorimit të pjesëzës pa dukurinë fonetike të elizionit, pra me aktualizim:

...Asnjëherë nuk i ká britë:

Mirë **po** e *din* gjogu se kah me shkue...

(Kënga 6, f.57)

“ Kúr **po** e *ndie* ndejaçek Halili,

Për me t’shejptë Mujin **po** e lshon...

(Kënga 8, f.69)

Lidhur me dukurinë e aktualizimit* jemi ndalur më gjerësisht te kuptimet kohore të foljes në kohën e tashme të mënyrës dëftore.¹²⁰

- Kemi ndeshur dukurinë fonetike të aferezës, ku në rastin e foljes së parregullt *jap*, bie tingulli nistor *-j*: *ap, ep*.

- Si tinguj protetikë kemi ndeshur *n* para *d*-së si në rastin e foljes *ndigjon*:

...Po për n’kjosht ti grue fisit, / Për një fjalë apo m’*ndigjon*?

(Kënga 1, f. 5)

- Togu *kj* nuk palatalizohet në *q*, si te foljet: *kjaj, kján, kjajnë* etj., si në rastin:

...T’madhe çikat qi po *kjajnë*, / Hânën hyjt kan qitë e pvetë...

(Kënga 6, f. 62)

Zevëndësimin e tingujve nistorë si: **z-/s-** me tingullin **l-** te foljet *zbardh/skuq*, përkatësisht me foljet *lbardhë/lkuqë*. Këtë zevëndësim e kemi trajtuar më gjerësisht gjatë trajtimit të materialit me shembuj konkret.¹²¹

...A çue dielli për mbas malit: / Tash **p’**e *lkuqë*¹²² e tash **p’**e *lbardhë*...

(Kënga 6, f.52)

Koha e tashme e mënyrës dëftore në materialin e studiuar na vërtetohet me një larmi trajtash foljore për zgjedhimin vepror dhe jovepror.

Zgjedhimi vepror

Koha e tashme e mënyrës dëftore në CK për zgjedhimin vepror vërtetohet me tri vetat e njëjës dhe të shumës si dhe me zgjedhimet përkatëse, përkatësisht me zgjedhimin e parë, të dytë, të tretë si dhe me foljet e parregullta.

-Format e kohës së tashme dalin me këto mbaresa vetore në zgjedhimin vepror:

¹¹⁹ Po aty, vep. e cit., f.745.

¹²⁰ Më gjerësisht shih: F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988.

¹²¹ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II...*, vep. e cit., Është interesant fakti se për foljen **lbardhë** mbledhësit dhe redaktuesit e përmbledhjes, e japin me kuptimin "zbardhë", kurse për foljen **lkuqë**, nuk jepet asnjë sqarim. Tiranë, 1937, f.11; D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII, Forca dhe madhështia e fjalës te këngët e kreshnikëve*, foljen *lbardhë* e jep të formuar nga *l+bardhë*, kurse foljen *lkuqë* e jep me kuptimin "me kuqë, kuq", formimi nga mbiemri *i kuq* me parasht. *l-*. Shkodër, 2016, f.162-163.

Veta e parë njëjës:	-j/-i/(zero)
Veta e dytë:	-n/-ë/(zero)
Veta e tretë:	-n/-ë/(zero)
Veta e parë shumës:	-(j) m(ë)/-im
Veta e dytë:	- ni
Veta e tretë:	-(j)n(ë)/-in

Veta e parë njëjës e foljeve në këtë kohë del e ndërtuar me mbaresat **-j/ -i / zero**.

1. Me mbaresën **-j** e ndërtojnë kohën e tashme disa folje që dalin me temë në zanore. Të ndërtuara me mbaresën **-j** vërehen foljet e zgjedhimit të parë, të tretë dhe foljet e parregullta. Nga **zgjedhimi i parë** veçojmë foljet, si: *bâj, blëj, çoj, duroj, fshâj*(rënkoj), *gzoj, gjâj/gjëj, kallxoj, kërkuj, kjâj, luej, lshoj, mbaj, ndiej, ndimuj, ndrroj, pritoj, provoj, punoj, qorroj, shikuj, shiluj, shkuj, shkyej, shkurtoj, shtërngoj, rruej, rrxoj, verboj* etj.

Po ilustrujmë me shembuj nga CK:

...As s'jam ngusht për një baxhi, / Se <i>gjâj</i> nuse për gjë vend!...	(Kënga 1, f. 9)
...Të dy syt djalit po i a <i>qorroj</i> , / Të dy syt atit po i a <i>verboj</i> ...	(Kënga 11, f. 90)
...Mos me këne ma i madhi ndër ne / Qato fjalë nuk t'i <i>duroj</i> ...	(Kënga 18, f. 141)
...Po i <i>shikuj</i> fushat anë m'ânë, / I a kâ qitë turbîn e Halilit...	(Kënga 26, f. 204)

Zgjedhimi i tretë del kryesisht me formën: *di/dij*. Gjatë materialit të studiuar në CK na kanë dalë 14 raste të përdorimit të kësaj formë, nga të cilat forma *di* del e përdorur 6 herë, ndërsa forma *dij* 8 herë, pra përdorim më të dendur ka forma dialektore (*dij*).¹²³

Krahaso:

a... – Ti pa hak bjeshkën po e nâmë, T'mira i <i>dij</i> gurrat me uj...	(Kënga 8, f. 67)
b... Pa mba' vesh, or djalë i rí! / P'e <i>di</i> mirë, pse kha jé dalë...	(Kënga 4, f. 30)

Sipas studiuesit R. Mulaku "...kjo mbaresë **-j** te forma *dij*, duhet të ketë shërbyer për të shënuar kuantitetin e vokalit (gjatësinë e zanores)". Sipas I. Ajetit: "...në periudhën e mëvonshme këto folje në dialektin e gegërishtes fillojnë të ndryshojnë dhe të zgjedhohen sipas foljeve të zgjedhimit të parë".¹²⁴ Të njëjtin mendim ndan edhe profesor A.Haxhi ku thekson se "...kjo mbaresë mund të jetë edhe ndikim analogjik i formave foljore të zgjedhimit të parë (*baj, bashkuj, besoj, çoj*)".¹²⁵

2. Me mbaresën **-i**¹²⁶ e vetës së parë.

Në CK mbaresa **-i** që shënon vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores na del shumë rrallë me foljen e zgjedhimit të parë, *kallxoi* dhe me formën e parregullt, *api* (jap), kurse pjesa tjetër e foljeve i takojnë zgjedhimit të dytë, që po e zgjerojmë më poshtë. Pavarësisht se ka një përdorim të izoluar, forma *api/napi* (e përdorur tre herë) janë forma të gjalla të të folurit.

Po japim shembujt:

...Mos më ço n'Janinë t'madhe, / Se kúj Mujo, s'po i <i>kallxoi</i> / Se t' a shkova gurin e peshën...(Kënga 8, f. 68)	
...Due me rá fill n'Jutbinë, / Po ju <i>api</i> besën e Zotit...	(Kënga 12, f. 99)

Sipas të gjitha literaturave të trajtuara, folje të tilla ku **-i** shënon vetën e parë të kohës së tashme të dëftores janë karakteristike për zgjedhimin e dytë. Kjo mbaresë karakteristike për gegërishten¹²⁷, nuk është e re, por është zanorja **-i** mbështetëse e vendosur me kohë ndërmjet

¹²³ I.D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomòs e toskënishtes* (për shkolla të mesme), folja **di** del me këto forma në tri vetat e njëjësit: *dij/ din / din*, Vlorë, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C., 1927, f.116.

¹²⁴ R. Mulaku, *Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë*, Prishtinë, 1987, f.23.

¹²⁵ Cituar sipas: A. Haxhi, *Proza e Fishtës në pamje gjuhësore*, Shkodër, 2003, f.42.

¹²⁶ K. Topalli, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, gjuhëtari jep për vetën e parë, numri njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore mbaresën **-i** (*unë kapi*), Tiranë, 2011, f.784.

¹²⁷ E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, Nr.3, 1964, f.125; B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.294; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, DSH, II, Tiranë, 1974, f.384; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.51.

temës së foljes dhe mbaresës së saj (Buzuku : *nçelinj, nfshehinj*; Bardhi : *zbardhinj*; Bogdani : *puthinj, falinj*; Kazazi : *falinj* etj)¹²⁸, që te CK dëshmohej pa mbaresën **-nj / -j**.

Fadil Sulejmani mendon se kjo **-i** duhet të ketë ardhur "...nën ndikimin analogjik të këtyre foljeve dhe është përhapur përdorimi i kësaj **-i**-je edhe te shumë folje të tjera me temë në bashkëtingëllore, sidomos në të folmet gege veriore".¹²⁹ Profesor A. Haxhi gjatë studimit të prozës së Fishtës thekson përdorimin e kësaj mbarëse te foljet e tipit: *iki, eci*¹³⁰ etj.

I. Ajeti lidhur me këtë dukuri të gegërishtes veriore vinte në dukje që: "...kjo është një dukuri e disa të folmeve gege, kryesisht e Shqipërisë Veriore, ku hyjnë ligjërimet gege veriperëndimore, të folmet e shqiptarëve të Kosovës bashkë me të folmet veriperëndimore".¹³¹ Duke iu referuar edhe botimit të tekstit "Dialektologjia" theksohet se për të folmet e gegërishtes veriore dhe disa të folme të gegërishtes qendrore që janë fqinje me to, foljet me bashkëtingëllore marrin mbaresën **-i** në vetën e parë të numrit njëjës, si: çili "*çel*", *hapi*, "*hap*", *fali* "*fal*", *nisi*, "*nis*", *qenisi* "*qëndis*", *dathi* "*zbath*"¹³² etj.

Mbaresën **-i** në CK e marrin disa folje të **zgjedhimit të dytë**, si: *çarti*, *çili*¹³³, *dridhi*, *hjek*, *hypi/hipi*, *kapi*, *mbathi*, *mbledhi*, *mbylli*, *nxjerri*, *veshi*, *shprazi*, *theri*¹³⁴ etj. Kemi vënë re se pjesa më e madhe e shembujve të vjelë i përkasin trevave kryesisht të gegërishtes veriperëndimore (Malësi e Madhe, Kastrat, Shalë, Theth, Curraj-Epër) gjë që na vërtetojnë edhe shembujt nga CK:*

...Edhe n'rreth Mujin m'a shtjen, / Thotë me dorë un gjallë po e *kapi*... (Kënga 9, f. 73)

...Gjogut t'yt në shpinë po i *hypi*, / Edhe derën, Múj, p'e *çili*... (Kënga 28, f. 235)¹³⁵

Lidhur me mbaresën **-i** të vetës së parë në numrin njëjës për foljet e zgjedhimit të dytë, gjuhëtari K. Topalli jep këtë sqarim: "Kjo mbaresë nuk shfaqet në të gjitha foljet me bashkëtingëllore, por vetëm në ato që dalin me formë të njëjtë në të tria vetat e njëjësit, ku kjo mbaresë bën dallimin e vetës së I nga dy vetat e tjera".¹³⁶ Këtij argumentimi gjuhësor mund t'i shtojmë edhe foljet në CK, kryesisht në vetën e parë dhe të tretë njëjës, si: *çarti / çartë*; *dridhi / dridhë*; *hypi / hypë*; *kapi / kapë*; *mbathi / mbathë*; *veshi / veshë* etj.

3. Me mbaresën zero, njëlloj si në mbarë shqipen, dalin disa forma që u përkasin të gjitha zgjedhimeve si dhe foljet e parregullta:

Zgjedhimi i parë del me pak forma të pazgjeruara, karakteristike e gegërishtes¹³⁷. Ky tipar i gegërishtes na ka dalë edhe në disa raste në CK, si: *drue*, *hî*, *shkrue*, *shî*, si në shembujt:

¹²⁸ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit. f.18.; A. Omari, *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, jepet me mbaresën **-i** folja, *voki*, Tiranë, 2017, f.498.

¹²⁹ F. Sulejmani, *Folja në veprën e Matrëngës*, SF, Nr. 4, 1982, f.75.

¹³⁰ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit. Shembuj: ... e po kapi punën e kryeqitjes... (HD, 1914, fq.326); ... një send të vogël, s'po lypi shumë... (HD, 1924, fq.190), f.43.

¹³¹ I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshëvës e të Bujanovcit*, në "Studime gjuhësore" (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f.74-75.

¹³² J. Gjinarë, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.222.

¹³³ At J. Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botimi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, autori thekson: "*Mendojm se shqipja nuk i ka këto dy verba unë çili e unë dridhi...Këtë trajtë e kanë veshë këta tue i a huajtur temën nga veta e dytë e sh. të prezentit të diftores*", Biblioteka françeskane "At Gjergj Fishta", Kolana e shkrimtarëve françeskane, Botime françeskane, Shkodër, 2006, f.350.

¹³⁴ G. Mikeli, *Gramatika e gjuhës shqype*, gjejmë foljet e zgjedhimit të dytë: *rrahi*, *djegi*, *veshi*, *vjerri*, *falisi*, *helmatisi*, *qenisi*, *qesitisi* etj., që shënojnë vetën e parë të së tashmes të mënyrës dëftores, Shkodër, 1916, f.90-91.

* *Shembuj të tjerë vjelë nga CK*:...Frë as shalë nuk po i a *hjek*, / Der'n e burgut nuk po i a *mbylli*... (Kënga 9, f. 74);...Po dal n'beden t' sarajit, / - Po e *shprazi* pushkën harbetare... (Kënga 13, f. 111);...Ndo po m'çon, Mujo, uj me pí / Ndo po e *theri* gjogun thikë në bri... (Kënga 25, f. 200)¹³⁵

Një dukuri të tillë e ka vënë re edhe B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit. *Kjo dukuri është vërtetuar në të folmet e Shkrelit, Kelmendit, të Hotit, të Kastratit, të Rranzave të Mbishkodrës, të Postribës, të Shkodrës, të Shirokës, të Bregut të Bunës, të Dushmanit, të Zadrimës, të Bregut të Matës, të ishullit të Lezhës e të ishullit të Shëngjinit, të Nikaj-Mërturit, të Pukës, të Krasniqes, Gashit e Bytyçit, të Hasit, të Gjakovës, të Drenicës, të Prekorupës, të Cpojës, të Shalës së Bajgorës, të Kacanikut, të Preshevës e Bujanovcit*, f.50.

¹³⁶ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., f.952.

¹³⁷ Po aty, f.981.

...Mue dy gjûjt te m’i ká kputë, / E po *drue* se m’hanë rrugës bishët e malit.(Kënga 11, f. 94)
...E p’e *shkrue* lokja ‘i letër t’mirë, / E p’e qes katund m’katund... (Kënga 18, f. 142)

Zgjedhimi i dytë paraqitet me foljet, si: *bërtas, çel, dal, flas, giet* (ngjason)¹³⁸, *jes (mbes), marr, mbledh, njoft, pres, pves, qes, thrras* etj. Në këto të folme në përgjithësi si karakteristikë edhe e normës standarde¹³⁹, foljet e këtij zgjedhimi dalin pa mbaresë në tri vetat e para të njëjësit, pavarësisht ndryshimeve fonetike që pësojnë sipas klasave. Disa nga këto folje në të kryerën e thjeshtë e ndërrojnë zanoren e temës në *o*, si në rastin e foljeve: *dal, marr, vjel, pjell, nxjerr, rrjep, vjedh*, karakteristikë edhe e nomës standarde, por tipar që ruhet edhe në CK, të cilin do ta trajtojmë në këtë kapitull në një syth të veçantë.

Nga CK kemi shkëputur vargjet për ilustrim me foljet e zgjedhimit të dytë që shënojnë vetën e parë njëjës të së tashmes:

... – Po ket ftyrë, Zot, ku e kam pá,/ Qi po m’*giet* me t’ Halilit?!... (Kënga 4, f. 32)

...– Amanet, çika, po u *pves*: / Ku e ká kullën, Arnaut Osmani... (Kënga 12, f. 99)

Foljet në **zgjedhimin e tretë** si karakteristikë edhe e normës standarde dalin në tri vetat e para të njëjësit pa mbaresë, pavarësisht ndryshimeve fonetike që pësojnë sipas klasave. Na vërtetohet në pak raste vetëm forma, *zâ*, si p.sh.:

...E lahutës mirë i ká rá, / Probatin - nânë, po e *zâ*... (Kënga 10, f. 84)

Edhe disa **folje të parregullta** e formojnë vetën e parë njëjës me mbaresën *zero*, si: *ap*¹⁴⁰ (formë foljore e dëshmuar edhe te Buzuku)¹⁴¹, *due, há, lâ, nap, rri, shof* etj.¹⁴², të cilat në shumicën e rasteve dalin me aktualizim.

Ilustrojmë me shembuj:

...Sá fort úja m’ká lodhë, / Nuk po *shof* as unë kah po shkoj... (Kënga 11, f. 92)

...Çeta e mirë e e mbarë u daltë, / E me vedi po u *nap* Halil Agën e rí... (Kënga 24, f. 181)

Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur në një rast të vetëm të përdorimit të foljes së parregullt *bie*, e cila në kohën e tashme të dëftores del me mbaresën **-n**, *bjen*:

...Un i vogël atëherë kam dalë, / E kurrjâ ndër mend s’më *bjen*... (Kënga 12, f. 106)

Në vazhdim po paraqesim foljet që dalin me mbaresë në **vetën e dytë njëjës**. Përkatësisht mbaresat janë: **-n**, **-ë** dhe **zero**. Në vazhdim po i marrim me radhë:

1. Me mbaresën **-n** kemi vënë re se dalin disa folje të zgjedhimit të parë dhe të tretë që kanë temë në zanore si dhe foljet e parregullta.

Nga **zgjedhimi i parë** kemi vjelë format, si: *bân, çon, dán, dishron, gjên, kán* (qan), *kërkon, lshon, luen, marron, mendon, mson, ndigjon, rândon, shikon, shkon, pelqen, shtjen, then* etj.

Në pjesën më të madhe të shembujve që kemi vjelë nga materiali i studiuar, kemi vënë re se foljet e këtij zgjedhimi në vetën e dytë të së tashmes dalin zakonisht të aktualizuara, si në rastin e vargjeve të ilustruara:

...Mo, bre, birë – kështu nânës, me i a bâ / Se ti vedin **po** e *marron*... (Kënga 11, f. 95)

...Si ké bâ moj nânë, ti **po** *gjên*, / Ça ké bâ n’mue, due me të bâ... (Kënga 11, f. 95)

...Pse i *rândon* ti Agët me fjalë, / Na trimnít bashkë i kena bâ... (Kënga 25, f. 197)

Për **zgjedhimin e tretë** na ka dalë vetëm folja *di*, e cila e ndërton vetën e dytë njëjës me mbaresën **-n**, e vërtetuar edhe nga shembulli:

¹³⁸ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., për këtë folje japin shpjegimin "po më duket e ngjashme", f.32.

¹³⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, I...*, vep. e cit., f.281.

¹⁴⁰ Formë foljore e dëshmuar edhe te I.D.Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa...*, vep. e cit. Në këtë *Gramatikë*, kjo folje del: *ap, ep, ep, apim, ipni, apin; nap, nep*, f.115.

¹⁴¹ W. Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut*, thekson: "M. Camaj e konsideron si dialektore formën *ap*, ndërsa S. Riza quan dytësore formën *jap* duke dhënë shpjegimin e Pedersenit për bashkëtingëlloren nistore *j-* "si rezultat antihiatizimi brenda një togfjalëshi si "e ap" > e jap". *Gjurmime albanologjike*, Prishtinë, 1977, f.164.

¹⁴² I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa...*, vep. e cit. Këtu dalin edhe format foljore, si: *shof, shef*, përveç formave: *shoh, sheh, sheh, shohim, shihni, shohin*, f.119.

...–A *din*, Mujo, kund ndoi gurrë me uj? / A *din*, Mujo, kund ndoi smet me borë?... (Kënga 25, f. 200)

Foljet e parregullta dalin me foljet, si: *bjen, don, lën, rrin, vjen*. Gjatë studimit të përmbledhjes "Visaret e Kombit" II, këto forma kanë një përdorim relativisht të kufizuar, si në rastet:

...– Kûnë, ç'a ké qi s'po ha buk? / "A mos jé e ligë e s'don"? (Kënga 1, f. 6)

...E kam pushkën habërtare, / Shtrëmbët t'a mbaj, Halil, n'drejtë të *bjen*... (Kënga 31, f. 228)

Me këtë mbaresë, siç edhe është argumentuar në këtë syth, vërtetohen të ndërtuara foljet e parregullta që dalin me temë në zanore. Me sa duket përdorimi i kësaj mbarese në përbërje të këtyre formave është bërë në analogji me foljet e zgjedhimit të parë. Në këtë përdorim e ndeshim edhe në të folme të tjera të gegërishtes veriore.¹⁴³

2. Me mbaresën **-ë**: Sipas studiuesit A. Haxhi: "Kjo **-ë** në këtë rast duhet të ketë shërbyer për të shënuar gjatësinë e zanores së theksuar të temës së foljes".¹⁴⁴ E gjejmë të përdorur vetëm te foljet e **zgjedhimit të dytë**, tipi: *çartë, çilë, falë*¹⁴⁵, *nâmë* (mallkon), *ndjekë, rrokë, shpotitë, zgidhë* etj., Nga shembujt e vjelë kemi vënë re se luhet mes aktualizimit dhe jo aktualizimit, si në vargjet e ilustruara.

Krahaso:

a. ...Ora e malit, Halilit çka i ká thânë:/–Ti pá hak bjeshkën **po** e *nâmë*... (Kënga 25, f. 200)

b. ...Edhe Behuri po shtjen me zgjedhë: /– A po ikë, Mujë, apo *ndjekë*?- ... (Kënga 6, f. 58)

3. Me mbaresë **zero**. Ashtu si në shqipen standarde, me këtë mbaresë formohet veta e dytë njëjës e së tashmes së dëftores për foljet e zgjedhimit të dytë, të tretë e disa folje të parregullta. **Zgjedhimi i dytë** del me disa forma, si: *bërtet, del, fal, kqyr, ik, mbledh, merr, njeh / njeft, ndez, qesh, rreh, rrok, vesh, zgiedh, zgidh* etj., të cilat ndonjëherë dalin të aktualizuara ose jo.

Krahaso:

a. ...Po si s'ia *njeh* – tha – Mujës miqt ku i ké, / Qi probatini i Mujës vetë jam. (Kënga 15, f. 124)

b. ...A po *njeft*, se kush jam vetë ? / Un, po, jam krajil-e kapidani... (Kënga 21, f. 166)

Zgjedhimi i tretë ka një përdorim relativisht të kufizuar. Nga materiali i vjelë ky zgjedhim në vetën e dytë njëjës na del rrallë, vetëm me foljen, *di* si në vargjet e ilustruara:

...A *di* shka, more djali i Mujit! / Udha e mbarë u kjoftë pá mue!... (Kënga 6, f. 54)

Foljet e parregullta dalin me format: *ep*¹⁴⁶, *ha, rri, shef/sheh*, si në shembujt e vjelë nga CK:

...Zana e vogël p'e pëvetë:/ – Kûnë, ç'a ké qi s'po ha buk?... (Kënga 1, f. 6)

Disa nga foljet e parregullta në vetën e dytë e të tretë njëjës, pësojnë ndërrime fonetike, që në të shumtën e rasteve kanë karakter morfonologjik.

Krahaso:

a. ...Ti po *sheh* o gjoe me gjue, / Ti po i *sheh* Shkjét tuj çetue... (Kënga 11, f. 90)

b. ...P'a s'po e *shef*, Halil, se ç'paske bâ? / Se ti gjaksin mue m'a paske vrá.. (Kënga 23, f.185)

Veta e tretë njëjës del e ndërtuar me mbaresë **-n/-ë/zero**.

1. Me mbaresën **-n**. Me këtë mbaresë e formojnë vetën e tretë njëjës shumica e foljeve të **zgjedhimit të parë**, si: *bân, çeton, çon, dâ, diton, dron, duron, fejon, flakron, fluron, fshân, guxon, gjâmon / gjimon, gjên, harron, hijeshon, hîn, kalon, kallxon, kcen, kjân, kndon / këndon, kërkon, këthen / kthen, kundron, lakmon, lán, laton, levdon, limon, liron, lodron, lmon, loton, lshon, luen, lufton, mban, marron, marton, mbaron, mbërthen, mendon, mjeron, mrrîn, mson, msýn, ndalon, ndien, ndigjon, ndimon, ndrýn, pajton, pëlqen, pikon, prîn, prozhmon, qelbson, qillon, qorron, rândon / rendon, ruen, rrxon, sundon, shikjon, shilon, shinon, shgarkon,*

¹⁴³ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.44.

¹⁴⁴ Po aty, f.43.

¹⁴⁵ K.T opalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe, Botimet Albanologjike*, kjo folje del me disa kuptime; në rastin tonë , "dhuroj", Tiranë, 2017, f.464.

¹⁴⁶ G. Mikeli, *Gramatika...*, vep. e cit., f.164.

shkjepon, shkon, shkyen, shilon, shpërthen, shtërngon / shtërnon, shtjen, shtrin, shtyn, shurdhon, rron, rrxon, tepron, ton¹⁴⁷, trupon¹⁴⁸, turbullon, then, thermon, vallon, vendon/vndon, verbon, vîn, vonon etj.

Nga CK po japim shembujt:

...N'petka t'babës trupin i a *hijeshon*, / Armët e brezit i a *rendon*¹⁴⁹ mbi krye...(Kënga 5, f. 43)

...Me ndimë t'Zotit rrugën po e fillojmë! / Po m'u *prîn* Gjeto Basho Muji... (Kënga 24, f. 191)

Po ilustruam me disa shembuj me aktualizim dhe jo me aktualizim.¹⁵⁰

Krahaso:

a. ...Por, po lajnë lesh gurve t'lumit, / Kush **po lán** e kush **po kján** prej dhimet.(Kënga 4, f.34)

...Po i loton pela njanit sy, / Po i *shkjepon*¹⁵¹ pela njânës kâmbë... (Kënga 20, f. 156)

b. ...Halil Agën shka po don me e bâ? / Âsht i zî e për çetë s'vîn¹⁵² gjâ... (Kënga 23, f. 181)

...T'mira i dij ortiqet me borë, / Mirë e dij gjâja ku *diton*¹⁵³... (Kënga 25, f. 200)

Përgjithësisht në të folmet e gegërishtes dhe në të folmet kalimtare, në mënyrë më të theksuar në gegërishten veriperëndimore, zanorja **ë** është zevëndësuar me zanoren **i** në fjalët ku ndodhet pranë një bashkëtingëlloreje qiellzore.¹⁵⁴ Në CK na kanë dalë raste të shpeshta të kësaj dukurie fonetike, si në rastin e foljeve: *gjimon "gjëmon", ndigjon "dëgjoj", qilloy "qëlloj", shinon "shënon"*, etj., gjë, të cilën e vërtetojnë edhe shembujt:

...Po për n'kjosh ti grue fisit, / Për një fjalë apo m'*ndigjon*? (Kënga 1, f. 5)

...Fukarâ ndoshta *qillon*, / Me pare t'mija mirë qi rron... (Kënga 18, f. 137)

Me mbaresën **-n** e formojnë vetën e tretë edhe disa folje të **zgjedhimit të tretë dhe foljet e parregullta**. Këto forma janë karakteristike edhe për disa të folme të gegërishtes veriore dhe në disa të folme të gegërishtes jugore.¹⁵⁵

...Mirë po e *din* gjogu se kah me shkue, / Flakë të verdhë prej gojet qi po qet.(Kënga 6, f. 57)

... – Dekâ *vjen* mbas mikut t'pré, / – Dekâ *vjen* mbas besës s'thyeme... (Kënga 4, f. 38)

Më gjerësisht do t'i trajtojmë më poshtë.

Zgjedhimi i tretë na del me këto folje, si: *din, pin, vên, xên* etj. Në të gjitha rastet zanorja e temës së foljeve është zakonisht e shkurtër. Foljet e zgjedhimit të tretë dalin të aktualizuara dhe jo të aktualizuara.*

Krahaso:

a. ...Ki'n shtrua pijen e **po pín**, / Nusja aspak n'trevesë s'po ulet... (Kënga 1, f. 6)

b. ...E ia *vên* hekurat n'kâmbë, / E m'i a shtjen burgít n'dorë ... (Kënga 10, f. 91)

Foljet e parregullta dalin me këtë pamje, si: *bjen, don, han, lën, vjen, rrin* etj.

...E hysmet nusja u bân, / E për kunat, Hysin po m'a *don*... (Kënga 12, f. 106)

...Gjogu i Mujës, kqyre, çka ká bâ: / Krejt asqerin në dhâmbë po e *han*... (Kënga 21, f. 168)

¹⁴⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*...vep. e cit., forma **tue (me)**, del me kuptimin "më tepër se më fton ka kuptimin më provokon", f.194.

¹⁴⁸ Referuar D. Lukës, vep. e cit. më sipër, "Me interes paraqitet edhe evoluimi i foljes *me trupue*. Te Kreshnikët: "i kaloj me trup; i përshkoj (me trup)" (**Trupon** bjeshkët e mbrapa po i lën). Në këngët e Rugovës: *Ani qat-her' burrat lloçin p'e trupojnë*. Te Kanuni: "i pres një druri degët dhe rrënjët dhe e bëj trup; e cunqoj; e bëj cunq", (më gjenjë tuj trupue arnej të përshkruar), f.193.

¹⁴⁹ "I a vë njëra pas tjetrës, me radhë".

¹⁵⁰ *Shembuj nga CK*:...– Muji mirë po *fshân!* / Ka qitë burri e orvet u ká thânë...(Kënga 2, f.13);...Sa ngusht probi paska rá! / Me shkue me te, Shkjàn, fort po e *dron* ... (Kënga 2, f. 16);...Për rreth dhën n'krajlí mirë po e *vallon*, / Rugat kryq me sy qi po i *kërkon*...(Kënga 6, f. 55);...Tym e mjegull qi m'â bâ, / Shtpat e m'shtpat thue po *fluron*...(Kënga 6, f. 57)...Fort mâ e mirë se vetja qi po i duket, / Copë e grimë aj po m'a *then*...(Kënga 6, f. 57);...Zâna e madhe *kndon* në mal. / Zâna e vogël *kndon* në shkam...(Kënga 1, f. 10);...*Bân* denam e *bân* dyzen, / Darsëm *bân* nândë ditë e net...(Kënga 16, f. 134)

¹⁵¹ K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., folja **shkep** del me kuptimin "çaloj". Fjalë dialektore e gegërishtes, e njëjtë me *shqep*, me të njëjtin kuptim, Tiranë, 2017, f.1393.

¹⁵² B. Palaj, D. Kurti, *Visaret e Kombit II*..., vep. e cit., foljen *vîn*, mbledhësit dhe redaktuesit e përmbledhjes e japin me kuptimin "*vlen*", f.181.

¹⁵³ *Diton*, folje, e cila përmendet në dy këngë. Shih: D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit., "me kalie ditën", f.137.

¹⁵⁴ Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.191.

¹⁵⁵ Po aty, f.224.

Edhe te gramatikat e G.Mikeli dhe I.D.Sheperi (kur i referohen shembujve foljore të gegërishtes) japin si variante për vetën e dytë dhe të tretë njëjës edhe format foljore të parregullta me mbaresën -n, (*don*)¹⁵⁶, të ngjashme me foljet e zgjedhimit të parë.

Ne mendojmë se përdorimi i mbaresës -n me këto folje mund të ketë ardhur për analogji me foljet e zgjedhimit të parë.

2. Me mbaresën -ë¹⁵⁷. Ndeshet e përdorur kryesisht te foljet e zgjedhimit të dytë dhe vetëm në një rast të izoluar na ka dalë përdorimi i foljes së zgjedhimit të parë, vijë:

... – Ça ká qitë krajlí e ká thânë: / Kurgjâ mazi nuk po m’vijë, / Veç pá tê Muja si të rrijë...(Kënga 9, f. 76)

Kjo mbaresë është vështirë të lidhet me ndonjë mbaresë të vjetër vetore (indoevropiane), por mendohet të jetë pasojë e zhvillimit të brendshëm të shqipes. Në origjinë ajo, ndofta, do të jetë një zanore mbështetëse e shtuar midis mbaresës së dikurshme vetore që fillonte me bashkëtingëllore dhe fundores së temës kur kjo dilte me bashkëtingëllore.¹⁵⁸

Zgjedhimi i dytë i vetës së tretë njëjës¹⁵⁹ del me një përdorim të shpeshtë të formave, si: *batisë, dalë, djegë, dredhë, dridhë, falë, folë, gjegjë, gjerbë*¹⁶⁰, *hecë, helmatisë, hikë, hypë, kapë, keshë, kputë, kqyrë, kuvendë, lbardhë, lidhë, lkuqë, lodhë, lypë, mbajë, mathë, mbledhë, mbyllë, mbushë, mrehtë, ndalë, ndeshë, ndritë, ndjekë, ndukë*¹⁶¹, *nëmë, ngrehë, nisë, njehë, pervjellë, përgjegjë, përplasë, pëvetë, presë, puthë, pvetë, qeshë, rrahë, rrasë, rrokë, shetitë, shkundë, shndritë, terë, therë, trokatë, veshë, vrasë, xjerrë* etj.

Nga CK po japim shembujt:*

...I a lân varrat me ato lott e syve;/ I a *terë* gjakun me ato flokët e ballit... (Kënga 5, f. 43)

...Sá e *gjerbë* Muji kafen dalë kadalë, / Sá mirë shkina e ká hetue... (Kënga 9, f. 78)

...M’i ká zgjedhë tridhetë çika t’mira,/ Mirë po i *veshë* e mirë po i *mbathë*...(Kënga 16, f. 133)

...Se gjith dynjêja né na *keshë*, / Se për jashta derës nuk po del... (Kënga 27, f. 216)

Nga format e vjela nga CK, të analizuar deri tani kemi vënë re se në vetën e dytë dhe të tretë njëjës të kohës së tashme të dëftores disa folje të zgjedhimit të dytë pësojnë ndërrimet fonetike, si: -a- : -e- , -o- : -e- dhe -s : -t. Këto ndryshime, ashtu si në shqipen standarde, kanë vlerë morfonologjike, mbasi kemi të bëjmë me optim të brendshëm, si : *flas – flet, marr – merr, njoft – njeft, thrras – thrret* etj.

3. Me mbaresë zero. Më këtë mbaresë, karakteristikë e shqipes standarde, vërtetohet e ndërtuar veta e tretë njëjës e së tashmes së dëftores te foljet e zgjedhimit të dytë dhe për foljet e

¹⁵⁶ G. Mikeli, *Gramatika*..., vep. e cit., për kohën e tashme të mënyrës dëftore, autori paraqet për tri vetat e para të njëjësit foljet e parregullta me këtë pamje: *rrîi, rrîn, rrîn; lãa, lën, lën, due, do, don; vijë, viin, viin*, f.110, 113, 115-116; I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa*..., vep. e cit., *due, don, don*, f.116.

* *Shembuj nga CK*:...Se gjoju i yt kurrjâ nuk *din*, / Sá keq Mujos te i ká ardhë ... (Kënga 32, f. 231); ...Ësht e motra e Ali Bajraktarit, / Mirë po e *din* çika ç’e ká gjetë... (Kënga 14, f. 121); ... Trupon bjeshkët e mbrapa po i *lën*, / E ká dalë në fushë të Jutbinës... (Kënga 12, f. 99); ...M’i *rrin* gadi Bani Zadrili, / N’qafë të dorës çikës i a mbërthei... (Kënga 13, f. 125)

¹⁵⁷ A. Haxhi, *Proza e Fishtës*..., vep. e cit. Këto forma me mbaresën -ë dalin edhe në prozën e Fishtës, si: *behë, çartë, çilë, çpallë*, ku studiuesi A. Haxhi pranon se: "...autori e ka përdorur këtë trajtë të vetës së tretë për të bërë dallimin nga format e vetës së dytë njëjës.", f.221.

¹⁵⁸ Sh. Demiraj, *Gramatikë*..., vep. e cit., f.680.

¹⁵⁹ G. Mikeli, *Gramatika*..., vep. e cit., me këtë mbaresë në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit të dëftores dalin foljet: *avis, avitë, avitë; lus, lutë, lutë; pves, pvetë, pvetë; mys, mytë, mytë*; f.89.

¹⁶⁰ K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., folja *gjerbë* del me kuptimin "pi duke thithur nga pak", f.594.

¹⁶¹ K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., folja *nduk* jepet me kuptimin "kap diçka me gishta dhe e tërheq lehtë, pickoj; zhubros", f.1042.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...“Gjeta gurrat turbullue!” / Nusja zânave po u *përgjegjë*...(Kënga 1, f. 6);...Hajr-e Mujë! Po kshtu kah jé fillue? / E *pëvetë* Sokol Halili...(Kënga 2, f. 14); ...Imshta ishte tânë ahishtë, / Vetë shatorret n’për muzg t’natës po i *lypë*...(Kënga 4, f. 31)...Nj’a ’i copë nuses larg po i rri. / Vetë me vedi djali po *kuvendë*...(Kënga 13, f. 103); ...Si mërzitshëm burrat na ki’n qillue, / As kuvendi kurrkúj nuk po i *hecë*...(Kënga 23, f. 176); ...Edhe gjojun sá mirë i a ká shetitë./ Kqyr Omerin kuvendin si e *nisë*...(Kënga 26, f. 206); ...Të gjith për’ i herë kryet e kan ulë, / Dikush *kqyrë* sumbullat e jelekut...(Kënga 27, f. 212)

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...Shumë ushtrí krajlí qi po ká, / Shum balozat qi po i *mba*...(Kënga 8, f. 68); ...Se na *shtje* meshë për me çue, / E na *shtje* uratë për me thânë...(Kënga 22, f. 172)

parregullta, por edhe te disa folje të zgjedhimit të parë, me të cilat ndeshet e përdorur më shpesh. Mungesa e një mbarese në vetën e tretë njëjës është një dukuri e CK.

Zgjedhimi i parë del me disa forma (shumica e foljeve dalin me togje zanoresh), si: *gatue, gjë, fry’, grrye, gjue, krye, lue, mba, ndie/ndië, rue, rrë, shtje, shti, shtrí* etj.

Po ilustrujmë me vargje:*

...Fill te shpella e paskan çue: / N’kâmë me ndjëjë kurr me pushue, / Po u *gatue* e u merr ujë...(Kënga 1, f.3)

...T’errmën natë, ká ndoren hâna, / Armët e brëzit i a *rue* zâna!... (Kënga 4, f. 30)

...Vetëm Muji, pshtetë, për bré, s’po *lue*¹⁶², / Veç po kqyrë kah gjogat po lodrojnë...(Kënga 6, f. 55)

...Sýt me lot Dizdarit m’i u kan mbushë, / Po e *rrë* mendja Muji s’çohet tjetër...(Kënga 23, f. 178)

Në *Këngën e I-rë* në CK dalin disa forma që nuk përshtaten me asnjë prej këngëve. Në një rast të tillë hyn edhe folja **dëgjoj**, e cila në vetën e tretë njëjës del me dy forma grafike: *ndië/ndie*. Nuk kemi një informacion rreth zonës se ku është mbledhur, prandaj mendojmë se është një modifikim i mbledhësve.

Krahaso:

a. ...Njat-herë *ndië* Gjeto Basho Muji: / Sá keq Mujit i ká rá... (Kënga 1, f. 3)

b. ...Kur po e *ndie* ndejaçek Halili / Për me t’sheptjë Mujin po e lshon... (Kënga 8, f. 69)

Përdorimi i kësaj mbarese me foljet e këtij zgjedhimi është një dukuri e hershme që ndeshet tek autorët e vjetër (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani apo Kazazi), por edhe sot e kësaj dite në disa të folme të gegërishtes veriperëndimore¹⁶³, gjatë procesit të të folurit.

Zgjedhimi i dytë i vetës së tretë njëjës del me disa folje, si: *bërtet, del, dredh, flet, gjegj, hap, kërset, mbledh, mbush, merr, ndjek, njet, ngjall, njesh, njom, ndal, ngul, njef/njeh, pëlset, përket, pisket, pret, qet, rrah/rreh, siëll, shetit, shklet, thrret, vret* etj.

...Nusja aspak n’trevesë s’po ulet, / Po u *siëll* uj e po u then¹⁶⁴ buk... (Kënga 1, f. 6)

...I *thrret* t’madhe i e trokatë një herë / Dikush gjegjë e jashtë ká dalë (Kënga 10, f. 83)

...Sá t’madhe djali po bërtet, / Sá t’madhe gjogu po *pisket*... (Kënga 11, f. 92)

...Dritë ká dalë e dritë-o nuk ká bâ, / Ka rá dielli e me *xé* nuk po *xé*... (Kënga 26, f. 203)

Rasti i foljes të zgjedhimit të dytë **njoh** në tri vetat e njëjësit të dëftores del me këtë pamje, si: veta e parë e njëjësit del me foljen *njof*, veta e dytë dhe e tretë e njëjësit dalin me variantet *njeh* : *njef*. Veta e dytë dhe e tretë e njëjësit të së tashmes në raport me vetën e parë njëjës, formohet me ndryshimin metafonik të tingujve *o* : *e* dhe të tingullit fundor *-h* / *-f*. Me sa duket, mbledhësit dhe redaktuesit e CK paraqesin variacione në shkrimin e kësaj foljeje brenda së njëjtës këngë.

Krahaso:

a. ...Tridhetë krenat rreth e rreth / Mirë po i *njef* janë t’agvet e t’serdarve!...(Kënga 6, f. 57)

b. ...Tridhetë shpata i paska gjetë; / Mirë po i *njeh* se t’agve janë... (Kënga 6, f. 57)

Te trajtat foljore *rrah/rreh* na del dukuria e metafonisë të ndërrimit të tingullit *a:e*.

Krahaso:

a. ...Tuj tërfrue gjogat tue u hjedhë, / Shtatë sahat m’ *rrah* tue u sjellë... (Kënga 15, f. 128)

b. ...Dorën ballit – tha nuk po e hjek, / Veç se gjûnin – tha e *rreh* për tokë.(Kënga 15, f. 125)

Zgjedhimi i tretë në vetën e tretë njëjës del me një përdorim të kufizuar të foljeve. Na dalin vetëm foljet *di* dhe *pi*, si në shembujt përkatës:

...– Zoti t’vraftë, bre krajle kapedani!/- Se Zoti e *di*, për kâ e ké ngulë at’ hû...(Kënga 4, f. 39)

¹⁶² B. Palaj, D. Kurti, *Visaret e Kombit II...*, vep. e cit., folja *lue*, kur jepet sqarimi në fund të faqes, folja del me mbarese -n: "s’po *luen*", f.55.

¹⁶³ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.294; Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.52; Xh. Gosturani, *E folmja e Hasit*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.237.

¹⁶⁴ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., forma *thye (me)* përdoret në Veri me kuptimin "me nda bukën", f.195.

..Kurrnji pikë, Muji, s'po don me pí, / S'po pi vetë as gjogut hiç s'po i nep.. (Kënga 6, f. 57)
Foljet e parregullta paraqiten me disa forma, si: *bjè, ep¹⁶⁵/nep, jet¹⁶⁶, rri, shef/sheh* etj.

Po japim disa shembuj nga CK:

...Tash po merr dielli mbas mājesh, / Tash po *bjè* hāna ndër aha... (Kënga 1, f. 5)

...Se me dalë kush me na i xānë, / Grimë forcejet ne s'na *jet*... (Kënga 1, f. 7)

...M'inadī t'em nuses ngjat i *rri*: / Por kēnka trim e besnik... (Kënga 12, f.103)

...Gjā ma t'mirë s'*shef* njeri nen ket diell! / Vetulla e saj ndrejt si fiskaja... (Kënga 4, f. 27)

...Nën at mājë n'do livadhe, / Mirë po i *sheh* çikat e Behurit... (Kënga 6, f. 55)

Folja **jep** në vetën e tretë të njëjësit del me format dialektore *ep¹⁶⁷ / nep*, ku në rastin e parë kemi zhdukjen e bashkëtingëllores nistore *j-ep*, pra dukurinë fonetike të aferezës, kurse në rastin e dytë kemi shtimin e tingullit protetik **n-**, *ep:n-ep* dhe zevëndësimin e bashkëtingëllores nistore *-j* me *-n*, përkatësisht *jep / nep*.

Krahaso:

a. ...O se ç'po i *ep* edhe Zoti fuqí! / Kēnka bâ si me kânë dragua... (Kënga 7, f. 65)

b. ...I a ká falë njiqind orum të verdhë, / Për shpírt t'Alís po i a *nep*... (Kënga 12, f. 114)

Veta e parë shumës e së tashmes së dëftores del e ndërtuar me forma, të cilat marrin mbaresat: **-(j)më/-im**.

1. Me mbaresën **-(j)më** te CK ndërtohen foljet që dalin me temë në zanore.

a. Me variantin **-m(ë)**, i cili paraqitet me variacione në shkrimin ose jo të zanores **-ë** në pozicion fundor, ndeshen të ndërtuara format foljore, përkatësisht si më poshtë:

Për **zgjedhimin e parë** me këtë mbaresë në vetën e parë shumës dalin pak folje, si: *druë/ druem, hî/ hîm, shî/ shîm*, të cilat edhe në vetën e parë njëjës dalin pa mbaresën **-j**: *druë, hî, shî*. Ky mendojmë të jetë një ndikim i vetës së parë të njëjësit që ka gjetur përdorim edhe në vetën e parë të shumës.

Ilustrojmë me shembuj:

...Kúr t'bājë Zoti me e lirue, / Gjāja e gjallë, *druem*, ká mbarue!... (Kënga 4, f. 25)

...E po *hîm* tokët e po i punojmë. / Atëherë foli Zuko Bajraktari... (Kënga 18, f. 140)

...E po i *shîm* shpatat kryqalisht, / E po i *shîm* shapkat në krye ... (Kënga 22, f. 172)

Me këtë variant (si në shqipen standarde) vërtetohen të ndërtuara edhe disa folje të **zgjedhimit të tretë**, si: *dimë, zâmë/xâmë*, si në shembujt e ilustruar:

...Hajde, nusen po e *xâmë* se e merr, / Kurrnji ditë djalit s'*mund t'ia mbajsh*. (Kënga 13, f. 98)

...Sall prej gjogut me na e zdrypë, / Gjallë me dorë ishalla e *zâmë*... (Kënga 17, f. 137)

b. Me variantin **-jmë**, foljet e vetës së parë shumës na dalin si në shqipen standarde.

Zgjedhimi i parë del me disa forma, si: *bâjmë, blejmë, çetojmë, çojmë, dajmë, fillojmë, gjëjmë, lshojmë, mbajmë, kallxojmë, kthejmë, ndihmojmë, punojmë, sharrojmë, shkojmë* etj.

Nga CK po ilustrojmë disa shembuj:

¹⁶⁵ W. Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor...*, vep. e cit., f.164.

¹⁶⁶ Po aty. Formë foljore e dëshmuar që te Buzuku, me kuptimin leksikor *mbet*.

Formë foljore e dëshmuar edhe te G.Mikeli në "*Gramatika...*" vep. e cit., foljen *me metë*, ai e klasifikon si folje të parregullt me vetat përkatëse të së tashmes së dëftores: *jes, jet, jet, jesim, jetni, jesin*, f.111; K. Topalli në "*Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe*", jep një shpjegim tjetër lidhur me kuptimin e foljes *jes* fol. "mbetem". Fjalë me përhapje të kufizuar në dialektin e Veriut, por dikur e mbarë gjuhës sikur e dëshmojnë të folmet e arbëreshëve të Greqisë dhe të Italisë me formën *vjetem* "mbetem", të formuar nga *vë- + je*. Shfaqet së pari te Buzuku: *pā zhdo të tjerë tek jesënë endë trekt pā punë. Jet* është forma e vetës II shumës të rrënjës i.e. të foljes *es-* "me qenë" në një paradigmë të hershme *jemë ~* jetë ~janë*, ku forma e vetës II shumës është zevëndësuar nga forma më e re *jeni* me mbaresën e foljeve *-njō: jeni si bani / bëni*. Një rrjedhojë e kësaj foljeje është emri *jetë*., f.675. Edhe ne na duket më i drejtë argumentimi që gjuhëtari K. Topalli ka dhënë lidhur me kuptimin e kësaj foljeje, sepse edhe në rastet që kemi ilustruar, folja del me këtë kuptim brenda kontekstit.

¹⁶⁷ S. Riza, *Sistemi foljor i letrarishtes...*, vep. e cit., Lidhur me këtë formë foljore gjuhëtari sqaron: "...në format për të tashmen *j-ja* është sekundare dhe shpjegohet nga Pedersen si rezultat antihitazimi brenda një togfjalëshi si "e ap" > "e jap". a-ja brendatematike e formavet për të dytën dhe të tretën vehtje njëjës metafonizohet si p.sh tek folja **dal-ë**", f.240.

...Lé t'më vrasë Zoti, Gjeto Basho Muji, / Dý çetësh jemi e dyzaz po çetojmë!...(Kënga 6, f. 53)

...Rruga e gjânë mjaft ká qillue; / Se na çetat sot po i *dajmë*... (Kënga 6, f. 54)

...– Fjalë të keqe ndër vedi s'po *bâjmë*, / Na te nusja qi po *shkojmë*... (Kënga 14, f. 120)

...Atëherë foli Hyso Radoica: / – Si t'ia *bâjmë* në Zaharë me rá?!... (Kënga 12, f. 106)

Zgjedhimi i tretë na del shumë rrallë vetëm me përdorimin e trajtës, *dijmë*, si në rastin:

...Nji për nuse qi ké marrë, / E tjetrën pse po e *dijmë* se jé gjallë... (Kënga 13, f. 116)

Foljet e parregullta në vetën e parë shumës dalin vetëm me dy trajta, si: *bijmë, rrijmë*.

Në këto raste, foljet e zgjerojnë temën, nuk dalin vetëm me mbaresën **-më**, si në shembujt e dhënë:

...A po *bijmë* mâ mirë në lumë me u mbytë? / A po hypim n'curr teposhtë me u rrxue?... (Kënga 3, f. 21)

...Se na jém trí dhí prej shkamt, / – Qi *rrijmë* bashkë me zâna... (Kënga 4, f. 30)

2. Në CK ndeshim të përdorur edhe mbaresën **-im**, me të cilën, ashtu si në shqipen standarde, ndërtohen format e së tashmes në vetën e parë shumës që dalin me temë në bashkëtingëllore.

Këtë mbaresë në CK e marrin në vetën e parë shumës foljet e zgjedhimit të dytë si dhe foljet e parregullta.

...– Zot, Halili Mujit shka i ká thânë:/ Na po shkojmë e nânën po e *pvetim*...(Kënga 3, f. 21)

...Kan kujtue se krajli e ká rrethue,/ Porse kullat ngrehun m'i *shofim*... (Kënga 24, f. 189)

Zgjedhimi i dytë del me këto forma, si: *falim, flasim, hjekim, hypim / hipim, korisim, kputim, marrim, mbledhim, presim, pvetim, qesim, shndoshim, veshim, xjerrim* etj. Nga shembujt e vjelë vihet re që luhet mes aktualizimit dhe joaktualizimit.*

Krahaso:

a. ...Edhe nânën na qi **po** e *marrim*, / N'bedën t'kullës nânën na p'e *hipim*.(Kënga 28, f. 216)

b. ...Edhe rëmet t'i blejmë mâ t'mira, / Gjâ e mall me fal na t'*falim*... (Kënga 21, f. 164)

Foljet e parregullta na paraqiten me një përdorim relatisht më të kufizuar, si: *apim, desim, napim, shofim*, të cilat në pjesën më të madhe dalin me aktualizim.

Po marrim vargjet nga CK:

...Po jua *napim* gjogat n'dorë, / Po t'a *bijmë* nusen n'koçi... (Kënga 1, f. 9)

...T'shtýmen nânë na po i a *apim*, / Rrum dý copësh qafën po i a *kputim*... (Kënga 28, f. 216)

...– Grát e fmín, Halili, tâné po i *presim*, / Shehitlí ndër shkjë po *desim*... (Kënga 28, f. 216)

Veta e dytë shumës e së tashmes së dëftores në CK, siç është karakteristike edhe në shqipen standarde, vërtetohet e ndërtohet me mbaresën **-ni**. Është karakteristike që kjo mbaresë është pothuajse unifikuar në këtë vetë në të gjitha zgjedhimet dhe shtrihet edhe te foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë na del me një përdorim të dendur të formave. Disa nga format e vjela janë: *bâni, çoni, hîni, kallxoni, këndoni, lodroni, mrizoni, ndieni, ndimoni, ngâni, shkoni, pushoni, valloni, veroni* etj., siç e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë:

...– Pashi mrizet kû *mrizoni* – / At' forcë ju kah m'a kini... (Kënga 1, f. 5)

...Pashi majet kû *valloni*, / Pashi mrizet kû *pushoni*... (Kënga 1, f. 6)

Zgjedhimi i dytë i vetës së dytë shumës paraqitet me këto trajta, si: *çilni, delni, flladit'i*¹⁶⁸, *hypni, kputni, matni, mbledhni, merrni, ngrehni, nguti, nisni, njihni / njifni, qitni* etj.

Nga CK po japim disa shembuj:

...Pashi gurrat kû *flladit'i* / Me m'kallxue forcën ku e kini?... (Kënga 1, f. 6)

... – Ju për brish fjalët po m'i *xjerni*; / Nuk kam mbetë kërcunë e lânun... (Kënga 22, f. 170)

* *Shembuj të tjerë nga CK*:...E me dhâmbë qi po na han, / Për prezorjet tagjin po ia *qesim*...(Kënga 9, f.76); ...Na ktij djalit uj mos me i dhânë, / Të tâné Jutbinën po e *korisim*... (Kënga 12, f. 100); ...Edhe gruen t'a *marrim* mâ t'mirë, / E sélin t'a gjëjmë mâ t'mirë ... (Kënga 21, f.164)

¹⁶⁸ Në formën, *flladit'i*, përveç argumentimit ritmik të vargut, kjo formë është e gjallë edhe në të folmet e sotme (në disa të folme geqe si: Shosh, Dukagjin etj.)

Veta e dytë e shumësit të foljes *njihni / njifni* del me variacione në CK, por më shumë na ka dalë trajta dialektore, *njifni*, ashtu siç e kemi vënë re edhe në vetat e tjera, si në shembullin: ...Mirë e *njihni*, se â dají trimnísh, / Qi për n' dashtë me m'pru marrën te shpija...(Kënga 4, f. 26)

Zgjedhimi i tretë i vetës së dytë shumë del me një përdorim relativisht të kufizuar me foljet *dijni, pini*, si në vargjet:

...Pashi mrizet kû pushoni, / Pashi gurrat, ku uj *pini*... (Kënga 1, f. 6)

E vetmja folje që duket se na bën përjashtim dhe del me një temë më të zgjeruar është folja *di* e zgjedhimit të tretë, e cila në vetën e tretë shumë nuk del në formën *dini*, por *dijni*, p.sh.:

...A s'po *dijni*, a s'po doni, / Se atje s'janë komitë me shkjë... (Kënga 27, f. 212)

Foljet e parregullta të vetës së dytë shumë në të tashmen dalin me një përdorim më të kufizuar në raport me foljet e zgjedhimeve të tjera, si: *doni, hani, rrini* etj., si p.sh.:

...Me të *hani* krushq e me të *pini*, / Gjû për gjû, krushq me të po *rrini*... (Kënga 9, f. 79)

Veta e tretë shumë e së tashmes së dëftores në CK ndërtohet me dy mbaresa: **-(j)n(ë)** dhe **-in**.
1. Me mbaresën **-(j)n(ë)**, e cila del me disa variante, e ndërtojnë vetën e tretë të kohës së tashme foljet që dalin me temë në zanore sipas ndarjes në vijim.

Me variantin **-jnë**, veta e tretë shumë që ndeshet në shqipen standarde edhe në CK ndeshet me denduri më të madhe përdorimi në krahasim me variantet e tjera të kësaj vete, si, p.sh.:

...E batisë dymnján anë-m'anë, / Atëherë Zânat Mujin po e *zhgjertojnë*¹⁶⁹... (Kënga 6, f. 65)

Me këtë mbaresë vërtetohen të formuara foljet e zgjedhimit të parë, të tretë dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me një numër të madh formash që e ndërtojnë vetën e tretë shumë me mbaresën **-jnë**, si: *bâjnë, bum'rojnë*¹⁷⁰, *çojnë, fillojnë, gazmojnë, gjâmojnë / gjimojnë, gjejnë, kalojnë, kallxojnë, kcejnë, këndojnë / kndojnë, kërkojnë, kjajnë, këthejnë / kthejnë, krijnë, kujtojnë, kundrojnë, kuvendojnë, lajnë, lodrojnë, lshojnë, luejnë, luftojnë, mendojnë, mblojnë, mbulojnë, mjekojnë, mrizojnë, ndajnë, ndiejnë, ndigjojnë, ngarkojnë, ngujojnë, notojnë, prijnë, prozhmojnë, pshtojnë, pushojnë, qillojnë, rândojnë, ruejnë, rrethojnë, rrxojnë, sharrojnë, shijnë, shpengojnë, shtërngojnë, shikjojnë, shkojnë, shkurtojnë, shoshojnë, shtrojnë, shungllojnë, thajnë, thejnë, turbullojnë, vajtojnë, vallzojnë, v'ndojnë, vonojnë, zhgjertojnë* etj. Kemi ndeshur edhe pak folje që dalin me variantin **-jn**, i cili në material ndeshet shumë rrallë, vetëm me trajtën *ndiejn*, dhe me variantet: **-në, -n**, si: *bânë, hînë, ndienë, shtënë* etj.

Nga CK po ilustruam disa vargje, ku luhet mes aktualizimit dhe jo aktualizimit:*

Krahaso:

a. ...Nji lamë t'bukur me sy po *kundrojnë*, / Ah e rrej për anë qi p'e *rrethojnë*...(Kënga 23, f. 176)

b. ...Edhe duert mirë i a *shpengojnë*¹⁷¹, / I a kan dhânë lahutën n'dorë... (Kënga 4, f. 40)
Shembuj me variantet *-jn* dhe *-në* dhe *-n*:

...Fort po u thrasin qetave, / Kurkund zânin s'po jau *ndiejn*... (Kënga 1, f. 8)

...Derdhen trimat n'Jutbinë kan rá, / Kta po i *ndienë* edhe po i shofin... (Kënga 4, f. 48)

¹⁶⁹ Forma *zhgjertojnë* ka kuptimin "po e pyesin imtish" sipas shënimit që jepet te "Visaret e Kombit" II në fundin e faqes me nr.65.

¹⁷⁰ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit., "Me bâ një zhurmë si ushtimë, e cila duket se vjen nga larg e gjithnjë duke u afruar", f.131.

* *Shembuj të tjerë nga CK*:...Në tokë Mujin – tha kâmbët e *lshojnë*, / Asht ulë n'tokë e shum po rrin...(Kënga 15, f.125); ...Kesh se deka mue m'ká ardhë, / Se ishalla n'dhé mue gjallë po m'*shtënë* ... (Kënga 16, f.131); ...E bân Muji një hallakamë të thatë, / T'tâna bjeshkët për 'i herë *shungllojnë*... (Kënga 19, f.150); ...Fjalën n'gojë po i a këthejnë dalë, / Zëmren s'rrahmi i a kan ndalë... (Kënga 30, f.226);...E n'krajlí trimat po m'i *çojnë*, / E n'nândë burgje kthellte po m'i *ngujojnë*...(Kënga 25, f.202);...A thue âst ortek me borë? / A janë dele kah *mrizojnë*?...(Kënga 27, f.212);...Veç se shokët, qi po e *gjâmojnë*. / Edhe ahah, qi e *rrethojnë*. / Mirë bylbylat djalin po e *vajtojnë*... (Kënga 30, f. 224);...Lott ndër sý mirë po i a *krijnë*, / Ftyrën lotsh mirë po i a *shijnë*...(Kënga 30, f.26)

¹⁷¹ Folja *shpengojnë* ka kuptimin "ia lirojnë duart, ia heqin prangat".

...Se me dalë kush qi me i xânë gjallë, / T'tanë forceja u maron!... (Kënga 1, f. 7)
Foljet e **zgjedhimi të tretë** në vetën e tretë shumës të së tashmes dalin me variantet *-jnë*, *-në* dhe *-n* me një përdorim të kufizuar me trajtat: *dijnë*, *pijnë*; *xânë* / *zânë*; *pîn*, *xân* / *xên*, si në rastet:

...E jan ulë n'rudinë e po rrijnë, / E kan ndezë duhan e po *pijnë* ... (Kënga 19, f. 150)

...Kaq trishtimi shkjet m'i ká marrë / As s'po *dijnë* se ç'i ká gjetë... (Kënga 23, f. 182)

...Qyshë m'korite sot me ditë të dekës! / Por po i *zânë* gujat nën shtat... (Kënga 3, f. 21)

...Vetë e dyta gisht për gisht; / Vënd *po xân* te gurt e lumit... (Kënga 4, f. 33)

Foljet e parregullta në këtë vetë marrin kryesisht mbaresën *-jnë*, si: *bijnë* (rashë), *rrijnë*, *vijnë*, dhe në raste më të rralla dalin me variantet: **-jn** (*bijn*, e përdorur në tre raste) dhe **-në/-n**, siç vërtetohet edhe nga format, si: *vinë*, *lânë*, *rrinë*; *bîn*, *hân*, *rrin*.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:*

...Për të gjatë shehrit po i *bijnë* / E kan marrë sokakun e Kishës... (Kënga 12, f. 106)

...Nuk m'a *lânë* me gjâ me kullotë, / As nuk gjegjet travinën me i a lá... (Kënga 19, f. 146)

...I kan brinat prej dukatit, / Ata *rrîn* ndër Lugje t'verdha... (Kënga 1, f. 7)

Foljet e parregullta të vetës së tretë shumës që marrin mbaresën *-n*, në krahasim me foljet që formohen nga mbaresat e tjera dalin kryesisht pa aktualizim, por në pak raste edhe me aktualizim, si në shembujt që po veçojmë nga CK:

Krahaso:

a. ...Ushtojnë lugjet prej ortiqesh, / Prej ortiqesh, kah **po** *bijnë* ndër gropa (Kënga 4, f. 25)

b. ...*Bîn* ortiqet nëpër gropa, / Ushtojnë malet si prej motit... (Kënga 4, f. 28)

2. Me mbaresën **-in** përgjithësisht e formojnë këtë vetë foljet me temë në bashkëtingëllore (zgjedhimi i dytë kryesisht dhe me pak raste edhe foljet e parregullta).

Foljet e **zgjedhimit të dytë** me mbaresën **-in** kanë një përdorim të dendur në CK. Gjatë studimit të materialit na dalin këto trajta, si: *bërtasin*, *çilin*, *dalin*, *dihasin*¹⁷², *dredhin*, *falin*, *fikin*, *flasin*, *hasin*, *hjekin*, *hupin*, *koritin*, *lodhin*, *losin*¹⁷³, *lypin*, *marrin*, *mblehdhin*, *ndalin*, *nderin* (nderojnë), *ndeshin*, *ndiellin*¹⁷⁴, *ngasin*, *ngrehin*, *ngucin*, *njesin*, *njeshin*, *njofin*, *pëvetin* / *pvetin* / *pvesin*, *presin*, *qesin*, *rrekin*, *shetisin*, *shndoshin*, *trândin*, *varin*, *thrrasin* etj., si në rastet:¹⁷⁵

...Fort po i *lypin* lugjeve,

Fort po u *thrrasin* qetave,

Ndiellin dhít e nuk i gjejnë ... (Kënga 1, f. 8)

...N'fushë të mejdanit trimat konkan dalë; / Keq me fjalë shoshojnë po *rrekin*¹⁷⁶... (Kënga 5, f. 46)

* *Shembuj të tjerë të vjelë nga CK*:...Vesht kan marrë Jutbinë e Krahinë / E t'tanë n'shpí Mujit po m'i *vijnë*... (Kënga 34, f.239); ...Fort po i losin gjoget dy djelm t'rij, / Për mbas tyne kah po *vinë*... (Kënga 6, f.51);...Mirë se vjen Raspoka i ká thânë, / Kênkan ulë trimat e po *rrinë*... (Kënga 9, f.75);...Sá mirë agët janë mshehë, / e t'gjith pá zâ po *rrijnë* ... (Kënga 4, f.39)

¹⁷² K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit. foljen **dihás** (*dihát*) del me kuptimin "marr frymë me vështirësi, gulçoj", fjalë e geg. Veriore, huazim nga sll. (skr.) "marr frymë", f.385.

¹⁷³ Po aty, folja **los**, "luaj". Fjalë e dialektit gegë, sinonim i foljes *luej*, së cilës toskërishtja i përgjigjet me *loz* e *luaj*. Formim i brendshëm ku *-s ~ -t* janë prapashtesa foljore, që i janë shtuar rrënjës **lo-* vetëm në kohën e tashme, ashtu si në disa folje të tjera (khs. *vra ~ vras*); madje, edhe këtu jo në të gjitha format vetore, sepse veta II shum. bën *loni*. Kësisoj, kemi një përzjerje të paradigmës me *-n* (*luej ~ luen*) me paradigmën me *-s ~ -t*, f.899.

Duke iu referuar *Fjalorit të Bashkimit, Fjaluer i rii i Shcypës, perbâam prëie Shocniët t' Bashkimit 1908*, kjo folje del me disa trajta: *loxi e lox*, *lot*, *loxa*, *me loxe*, *shif: losi e los.*, (Botim anastatik), 2018, Botimet Fishta, f.287.

¹⁷⁴ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit, folja del me kuptimin "më përftohet një parandjenjë e keqe (nga një shkak i jashtëm apo i brendshëm)", f.171.

¹⁷⁵ *Ilustrime me vargje nga CK*:...Kërkund kângën nuk p'e *ndalin*, / Kërkund vallën nuk p'e ndajnë... (Kënga 1, f. 2); ...Kqyr Muji atëherë ç'ká qitë e ká thânë: / – Shpesh po më *ngucin* çobanija... (Kënga 7, f. 64);

¹⁷⁶ *Shih*:K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., foljen **rrek** e jep me kuptimin "e lodh, e mundoj, e sjell rrotull derisa e mërzis; e mbaj me fjalë";, forma joveprore **rrekem** "përpiqem, mundohem, dobësohem". Fjalë e mbarë gjuhës me shumë kuptime, kryesisht abstrakte. Kuptimi i parë duket se ka qenë "prek, takoj", që del në formën joveprore **rrekem** "përpiqem" (khs. *përpjek* "ndesh, takoj"). A. Xhuvani ka *top* e *rrekë* për një lojë fmijësh; në Shkodër e *rreka* "e munda" përsëri për një

...Thahet geth i ahit, / Kah *dihasin* shoqishoin me marrë... (Kënga 6, f. 60)

...Por janë kullat e Behurit, / *Trândin* tokën kah po bijnë për dhé... (Kënga 6, f. 60)

Si **folje e parregullt** del forma, *shofin*, vetëm në një rast përdorimi, si në vargjet:

...Dredhet djali në Jutbinë po bjen, / Vijnë e e *shofin* shokë, miq e jarana... (Kënga 12, f. 102)

Në CK folja e zgjedhimit të dytë, *pyes* paraqitet me variante fonetike, duke marrë trajta të veçanta foljore për vetën e tretë shumës, si: *pëvetin* / *pvetin* / *pvesin*.

a. Kan nisë trimat Mujin p’e *pëvetin*: / N’ votër t’ ânde kém qillue... (Kënga 4, f. 26)

b. ...Tuba - tuba shoshojnë po *pvesin*: / Ç’kjë kjo gjâmë qi na rá n’krajlí... (Kënga 23, f. 182)

c. ...Kush për Mujin gjâ nuk ká dijtë, / Por Halilin, kur p’e *pvetin*... (Kënga 33, f. 234)

Megjithëse i ndeshim në tre variante këtë folje, në shqipen standarde dalin si dysorë. Diskutimet për këto dysorë vazhdojnë edhe sot. Në lidhje me to, profesor T.Osmani thekson: "Përdorimi i foljeve me -t në dëm të formës me -s fiton përparësi për disa faktorë, sepse ruhet e njëjta temë, pa ndryshime fonetike në të gjitha paradigmat e foljes. Kështu tek foljet e zgjedhimit të dytë, klasa e parë, forma veprorë dhe joveprorë do të kenë të njëjtën temë në të gjitha vetat e kohës së tashme të mënyrës dëftore dhe lidhore, të vetës së dytë njëjës e shumës të urdhërores. E forcon këtë ide edhe përdorimi gjithnjë i këtyre foljeve në formë joveprorë me -t dhe asnjëherë me -s.¹⁷⁷

Foljet e të ashtuquajturit zgjedhim në -mi¹⁷⁸ (*jam, kam dhe thom/thâm*)

Një grup më vete në klasën e foljeve të parregullta përbëjnë edhe foljet e të ashtuquajturit zgjedhim në -mi (*jam, kam dhe tham / thâm*).

Këto folje në CK në kohën e tashme na dalin me këtë pamje:

Veta e parë njëjës	jam	kam	thom/thâm
Veta e dytë “	jé/je	ké	thue
Veta e dytë “	âsht/â	ká	thotë
Veta e parë shumës	jemi/ jém/jena	kemi/kém/kena	—
Veta e dytë “	jeni/jini	keni/kini¹⁷⁹	thoni
Veta e tretë “	janë	kan	thonë

Siç shihet edhe nga pasqyra e mësipërme, veta e parë njëjës e foljeve të zgjedhimit me -mi dalin me mbaresën -m (ashtu si te shkrimtarët e vjetër veriorë), *jam, kam thom/tham*. Paradigma e këtyre tri foljeve paraqet mjaft ngjashmëri (sidomos sa u takon foljeve *kam* e *jam*). Por, krahas ngjashmërive, në temat e këtyre foljeve vihen re edhe dukuri të veçanta. Kështu, këto folje pësojnë ndërrime fonetike, kryesisht metafoninë -a- : -e- në foljet *jam* e *kam* në vetën e dytë njëjës dhe në vetën e parë dhe të dytë shumës (*jam* : *jé* : *jemi* / *jém* / *jena* : *jeni*; *kam* : *ké* : *kemi* / *kém* / *kena* : *keni*). Sipas prof. Sh. Demiraj, ky ndërrim vokalik a:e është një formim analogjik sipas foljes *jam*,¹⁸⁰ si në shembujt:

lojë fëmijësh. Me këtë kuptim *rrek* lidhet përbrenda gjuhës me *prek* "takoj lehtë me dorë a me diçka tjetër" e më tej me *rrok* ~ *rrokem* qe ka pasur si kuptim konkret "kap, takoj", f.1265.

¹⁷⁷ T. Osmani, *Përsosja e standardit gjuhësor në fushën e morfologjisë dhe të drejtshkrimit*, në Konferenca Shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003, f.216.

¹⁷⁸ Për një ndarje të tillë i jemi referuar: Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...* vep. e cit....(1986), f.740; R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f. 9; A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.57; Át J.Rrota, *Gjuha e shkrueme...*, vep. e cit, f.387; B. Demiraj, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Prishtinë, 2006, f.237.

¹⁷⁹ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., ...ndryshe nga folje e zgjedhimit tematik, ku forma e shumësit të mënyrës urdhërore ka kaluar edhe në të tashmen e dëftores (kh. *mbledh* ~ *mblidhni*), te folja *kam* nuk ka ndodhur një zevëndësim i tillë (khs.(*ju keni*). Kjo mund të shpjegohet me faktin se mënyra urdhërore e kësaj foljeje, për vetë kuptimin e saj leksikor përdoret shumë më rrallë se e tashmja dëftore, f.932.

¹⁸⁰ Sh. Demiraj, *Rreth foljevet jam, kam e thom dhe rreth alternimit -e- /-ie- -i- në sistemin foljor të shqipes*, SF, Nr.1, 1972, f.14-15.

... – Hajt, bre babë, hiç me u ngushtue, / Për bajloz sot m’ké djalë mue... (Kënga 10, f. 82)
...E përpara mbretit te i kan rá:/ Qi jé mbret e baba i gith dynjás... (Kënga 3, f. 20)

Bie në sy edhe metafonizimi i mëtejshëm **-e- : -i-** në vetën e dytë shumë (jini e kini). Format e fundit i gjejmë edhe tek autorët e vjetër (jini e kini)¹⁸¹ dhe në të folmet e gegërishtes veriperëndimore,¹⁸² gjë që e vërtetojnë edhe shembujt që kemi marrë nga CK:

...Pashi mrizet, kû mrizoni, / At forcë ju kah m’a kini... (Kënga 1, f. 5)

...Zâna jini e zâna kjoshi! / Besa besë e fjala fjalë... (Kënga 1, f. 9)

Folja *thom* del me trajta të ndryshme: me **-o-**, **-a** *tham/thom* nga të cilat ajo më **-o** është forma e përbashkët dhe më e vjetër e shqipes (*thom*), forma me **-a** është formë e gegërishtes e krijuar nga ndikimi i dy foljeve të tjera të këtij tipi *jam* e *kam*, ndërsa forma e toskërishtes më **-e** është formuar me rrugë prapavajtëse nga forma e shumësit *them*¹⁸³, e cila nuk del në Ciklin e Këngëve Kreshnike.

- Folja *thom*¹⁸⁴ në vetën e parë njëjës del me dy variante, si: *tham* / *thom*.

Krahaso:

a. Trajta me zanoren e temës **-o-** *thom*, e cila ruhet edhe në vetat e tjera (me përjashtim të vetës së dytë njëjës).

... – S kam shka u *thom*, more agët e mij, / Veç m’koriti Sokol-e Halili... (Kënga 4, f. 38)

b. Trajta me zanoren e temës **-â-**, karakteristike për gegërishten veriore (një trajtë e re kjo në krahasim me gjendjen e vjetër), e cila del vetëm në vetën e parë njëjës.¹⁸⁵

...Paska qitë e i paska thânë: / Si *thâm* un, ti ké me bâ... (Kënga 2, f. 16)

- Folja *thom* / *thâm* në vetën e dytë njëjës zanoren e temës **-o/-a-** e zbërthen në togun **-ue-** (*thom/thâm/thue*), i cili në të gjitha rastet te CK na del i plotë dhe nuk monoftongohet, siç ndodh disa herë në gegërishte.¹⁸⁶

...Po me e pá a *thue* e njef, / Nusen prap Muji p’e pvetë... (Kënga 1, f. 5)

Edhe këto forma të foljes *thom* janë rindërtuar nën ndikimin e formave përgjegjëse të foljes ndihmëse *jam* (ka shumë të ngjarë) edhe të formave përgjegjëse analogjike të ndihmëses *kam*.¹⁸⁷

Veta e parë njëjës e foljeve të zgjedhimit në **-mi** del me mbaresën **-m**, që është karakteristike vetëm për këto folje. Këto folje kanë këtë formë edhe sot e kësaj dite si në të folmet e gegërishtes, ashtu edhe në shqipen standarde, si: *jam*, *kam*, *tham* / *thom*. Folja *jam* edhe kur është në rolin e këpujës e merr këtë mbaresë.

Nga CK kemi vjelë vargjet:

...Se nuk *jam* un Raspoja i dhivet, / Por un *jam* Gjeto Basho Muji... (Kënga 9, f. 79)

...Tridhet krena n’saraje i *kam*, / Kputë i kam prej trupit t’agve... (Kënga 6, f. 59)

Veta e dytë njëjës te foljet *jam* e *kam* del me temë në **-e-** dhe me mbaresë *zero*, si: *ké*, *jé* / *je*, si në rastet:

...Ku e *ké* ndoren, mori zânë? / P’a kjo â besa, qi m’patët dhânë... (Kënga 4, f. 40)

...Po ti grue *jé* si t’tâna grât, / Kurrkund puna nuk t’pelqen me fjalë... (Kënga 11, f. 95)

Folja *thom*, që në këtë vetë e ka zbërthyer zanoren e temës **-o-** në diftongun karakteristik për gegërishten **-ue-** (*thue*), gjithashtu del me mbaresë *zero*, si në shembullin e dhënë:

... – A *thue* janë komitë me shkjë, / A *thue* janë rrgalle me gurë... (Kënga 27, f. 211)

Veta e tretë njëjës për foljet *jam* e *thom* ndërtohet me mbaresën **-t(ë)** p.sh.: *â/âsht*, *thotë* dhe pëson supletivizëm folja *jam*. Si në mbarë gegërishten edhe në CK përdoren të dyja trajtat *âsht*

¹⁸¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.745.

¹⁸² Gj. Shkurtaç, *E folnja e Kelmendit*, pun. i cit., f.53.

¹⁸³ Për më shumë shih K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, vep. e cit., f.282.

¹⁸⁴ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa...*, vep. e cit., në vetën e parë njëjës të dëftores del forma, *thom*, f.119.

¹⁸⁵ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.58.

¹⁸⁶ Po aty, f.58.

¹⁸⁷ Sh. Demiraj, *Rreth foljevet jam, kam e thom...*, pun. i cit., f.25.

dhe forma e reduktuar *â*. Nuk mund të caktohet një rregull se kur përdoret njëra dhe kur tjetra.¹⁸⁸

...Po *thotë* Plaku Dizdar Osman aga. / M'a kan marrë fushën përpjetë... (Kënga 6, f. 51)

Siç del nga studimi i materialit të vjelë të Këngëve Kreshnike, veta e tretë njëjës për foljen *jam* del në dy variante:

Krahaso:

a. Me variantin e plotë : **âsht**:

...I pari çete Muji m' *âsht*, / Zânát çetën po m'a ká... (Kënga 20, f. 176)

b. Me variantin e reduktuar **â** (karakteristik për të folmen e Shkodrës):

...Sá t'madhe Halili po i bërtet: / – Ç'â, bre Muj, ti koshën qi po rrahë?... (Kënga 6, f. 56)

Sipas K. Topalli forma *âsht* “... është arritur nga përdorimi i saj si folje ndihmëse në kohën e kryer, duke u shtrirë forma me zanore të shkurtër edhe jashtë këtyre formave”.¹⁸⁹ Ndërkaq, forma vetore e foljes *jam* në këtë vetë pa zanoren *-ë* në pozicion fundor (*âsht*) mund të shpjegohet me tendencën e rënies së saj, kryesisht në pozicione fundore, si një proces fonetik, i cili kishte filluar të vepronte në gegërishte që në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII.¹⁹⁰ Siç e ka vënë re edhe studiuesi A.Haxhi te proza e Fishtës, kjo gjysmëzanore del e paqëndrueshme dhe në vetat e tjera të shumës të këtyre foljeve (*kan për kanë, âsht për âshtë*).¹⁹¹

Foljen *kam* në vetën e tretë njëjës të së tashmes e gjejmë të përdorur në formën *ká* të ndërtuar me mbaresën **zero**, njëlloj si në gjuhën standard, si në shembujt:

...Kur t'vesh tu saraji i shkja, / Nândë bojësh kullat i ká... (Kënga 2, f. 16)

... Aty krajli ushtri po ká, / Njaty njifen trimat kush janë... (Kënga 8, f. 67)

Veta e parë shumës në foljet në shqyrtim del në trajta të ndryshme. Ajo del e ndërtuar:

1. Me mbaresën **-mi**. Kjo është një mbaresë e trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane¹⁹², që përdoret edhe në shqipen standarde. Ndeshim format foljore, si: *jemi, kemi*, si në rastet

...“Ç’jeni ju qi ksajt lodroni? / – *Jemi* vetë t’lumet e Natës!,,... (Kënga 2, f. 12)

...Gjak as fis me shkjé na nuk i *kemi*, / Qi me t’dekun punë ne me na dalë...(Kënga 23, f. 185)

Këtë mbaresë nuk e gjejmë gjithmonë për foljen *them*.

2. Me mbaresën **-na** (karakteristike për gegërishten)¹⁹³. Këto forma në CK janë të rralla. Gjuhëtari K.Topalli thekson: "Dialekti i gegërishtes, sidomos krahu veriperëndimor, e ka zhdukur mbaresën *-mi* të këtij zgjedhimi dhe ka krijuar një mbaresë tjetër për vetën I, numër shumës të këtyre foljeve, mbaresën *-na* (*jena, kena, thona*). Për krijimin e kësaj mbaresë, që ka formë të njëjtë me përemrin vetor të kësaj vete, mund të mendohet një ndikim nga ana e këtij përemri, pa përjashtuar edhe ndikimin e dy formave të tjera që dalin me sonanten *-n* (*jeni, janë*) duke u përgjithësuar kjo bashkëtingëllore në të tria vetat e numrit shumës. Kjo formë e re mund të jetë krijuar edhe për të shmangur njëfarë homonimie me vetën I numër njëjës, që ka mbaresën *-m*".¹⁹⁴

Po ilustrjmë me vargje nga CK:

...Se na n'Jutbinë *kena* pushkë boll! / – Sa për doresh që më kan ardhë... (Kënga 6, f. 56)

...– Djelmt t'ú ná, nânë, *jena* –. / Plakëz mallit atëherë i a çue... (Kënga 12, f. 107)

¹⁸⁸ E. Lafe, *E folmja e Nikaj -Mërturit*, SF, Nr. 3, 1964, f.118.

¹⁸⁹ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., Tiranë, 2011, f.912.

¹⁹⁰ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.12.

¹⁹¹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.59.

¹⁹² Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.671.

¹⁹³ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.295; Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.160; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.51; J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.350.

¹⁹⁴ Më gjerësisht shih: K.Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.289 - 290.

3. Me mbaresën -m. Foljet *jam* dhe *kam* dalin me këtë mbaresë dhe kanë pësuar ndërrimin -a- : -e- (*jém, kém*). Këto forma, që përdoren edhe sot e kësaj dite në disa të folme të gegërishtes, janë shumë të vjetra dhe e ndeshim që tek Kazazi (*jem*).¹⁹⁵

Nga CK kemi vjelë këto shembuj:

...Se na s'*jém* gumanat e zez, / Por na *jém* Agët e Jutbinës... (Kënga 22, f. 174)

...Mirë se n'çetë, mor shokë, na kemi dalë: / At' mâ t'mirin këtu nuk po e *kém*, / Nuk *kém* trimin qi dridhë gúr e dhé...(Kënga 23, f. 176)

Gjatë studimit të materialit të CK kemi gjetur pak raste me foljen *jam, kam*, por nuk kemi ndeshur shembuj me foljen *them*.

Veta e dytë shumës del e ndërtuar me mbaresën -ni (si në shqipen standarde) : *jeni / jini*¹⁹⁶, *keni / kini*¹⁹⁷, *thoni*.

... – Po ku *jeni* ju t'bukrat e malit, / Si nuk ngâni sot për me m'ndihmue?... (Kënga 15, f. 128)

...Zâna *jini* e zâna kjoshti! / Besa besë e fjala fjalë... (Kënga 1, f. 9)

... Pashí malet kú veroni, / Pashí besën qi ju *keni*... (Kënga 2, f. 12)

...– Jú jau xisha llafin, qi po bâni, / – Jú jau xisha forcën, qi ju *kini*... (Kënga 25, f. 197)

...Jau kputë Muji fjalën n'gojë, / P'r ata krushq, qi ju po *thoni*.. (Kënga 1, f. 9)

Sipas Sh. Demiraj “Ndërrimi i -e-/-ie- : -i- në vetën e dytë shumës është vërtetuar në krye të herës tek ato folje, ku -e-/-ie- është ndodhur para dy bashkëtingëlloreve, nga të cilat e dyta ishte -n, si p.sh: *bredhni: bridhni, vret-ni: vritni* etj., kurse forma e vetës së dytë shumës *keni/kini* është formuar analogjikisht sipas *jeni/jini*”.¹⁹⁸

Veta e tretë shumës e këtyre foljeve vërehet e ndërtuar me mbaresën -n(ë), si edhe në shqipen standarde. Përjashtim në këtë vetë bën folja *kam*, e cila në CK del në të gjitha rastet pa zanoren -ë fundore -kan).¹⁹⁹ Nga CK dalin trajtat, si: *janë, kan, thonë*.

Nga CK po marrim vargjet:

a. ...Si kam ndie e si m' kan thânë, / Se kto *janë* prralla prej motit... (Kënga 16, f. 135)

b. ...Të dy lija, loke, t'i ká mbytë, / E në bahçe vorret tek i *kan* ... (Kënga 26, f. 204)

c. Por, shtërngou, baloz, se t'ká ardhë dita! / Se ktu i *thonë* - o Gjergj Elez Alí!(Kënga 5,f.47)

Zgjedhimi jovepror

Siç na vërtetohet gjuha në CK, foljet në kohën e tashme të dëftores në **zgjedhimin jovepror** ndërtohen me anë të mbaresave:

Veta e parë njëjës: -(h)em/-ëm

Veta e dytë - esh

Veta e tretë -(h)et

Veta e parë shumës: -(h)ena/-(h)na

Veta e dytë –

Veta e tretë -(h)en

Këto mbaresat i shtohen një teme foljore që zakonisht përkon me atë të kohës së tashme të dëftores forma veprorë. Kur tema foljore, së cilës i prapangjiten këto mbaresat del me zanore, atëherë para tyre shtohet tingulli kundër hiatit -h-²⁰⁰, si: *bâhem, çohem, shtërngohem* etj. Gjatë studimit të materialit të CK na kanë dalë forma për të gjitha vetat, me përjashtim të vetës së

¹⁹⁵ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.13.

¹⁹⁶ W. Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor...*, pun. i cit., f.160.

¹⁹⁷ Po aty, f.161.

¹⁹⁸ Sh. Demiraj, *Rreth foljevet jam, kam e thom...*, pun. i cit., f.16.

¹⁹⁹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., "...siç duket, duke iu nënshtruar prirjes së përgjithshme të rënies së saj në këto pozicione në gegërishte", f.61.

²⁰⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe, I...*, vep. e cit., ...mbaresat kohore të së tashmes në zgjedhimin jovepror janë: -em/hem, -esh/hesh, -et/-het, -emi/hemi, -eni/-heni, -en/-hen, f. 302.; Sh.Demiraj, *Gramatikë...*, vep. e cit., f.727 - 728.

dytë të shumësit që nuk na ka dalë në asnjë rast. Veta e tretë e numrit njëjës del më shpesh në raport me format e tjera vetore.

Veta e parë njëjës del e ndërtuar me:

1. mbaresën **-(h)em** e ndërtojnë foljet në standard, por që një pjesë e mirë e foljeve na del edhe në këtë mënyrë, siç na rezultojnë edhe nga format e vjela në CK.

Zgjedhimi i parë del me pak folje, si: *çohem, martohem, shtërngohem*, si në rastet:

...Qi, ja *martohem* me gúr e dhé, / Ja e kam marrë Tanushen e krajlit... (Kënga 4, f. 28)

...Po *shtërngohem* e po shkoj vetë, / Nuk báj dâm edhe me mbetë... (Kënga 10, f. 83)

Zgjedhimi i dytë del me këto forma, si: *ndeshem, mundem, pritem, tutem* etj.

...A se *ndeshem* m'trevezë t'tyne, / A se gjumin agët ja xueren... (Kënga 1, f. 4)

... – *Tutem*, djali ká sharrue, / – Po s'erdh Muji për me e pshtue... (Kënga 4, f. 38)

...Kâmbë e dorë lidhë si m'i kan, / Nesër *pritem* n'fushë t'mejdanit... (Kënga 21, f. 167)

Si folje e parregullt del vetëm folja *duhem*, si në rastin:

...Me i a pá njat meremet turki'n, / Për dadë t'ditës kurrjâ nuk i *duhem*... (Kënga 21, f. 160)

2. Në raste të izoluar kemi ndeshur edhe përdorimin e mbaresës **-ëm**, që shënon vetën e parë njëjës të mënyrës dëftore, si në rastin e foljes *dredhëm*:

...Shpejt po *dredhëm*, Mujë, e po t'ndimoj, / Tha Halilit çikën i a ká çue... (Kënga 19, f. 153)

Veta e dytë njëjës del e ndërtuar me mbaresën **-esh**. Këtë mbaresë e marrin foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore:

Zgjedhimi i parë vërtetohet vetëm me dy forma, si: *çohesh* dhe *martohesh*.

...Me u martue Hyso, pse s'*martohesh*! / Se mocët tý të gjith janë martue... (Kënga 12, f. 98)

...– Po a s'e din se kush ká ardhë, / Qi nuk *çohesh* për m'u falë... (Kënga 30, f. 225)

Zgjedhimi i dytë del me disa trajta, si: *gjegjesh, mbathesh, mundesh, tutesh, veshesh* etj.

Po ilustruamë vargjet:

...A po m'*gjegjesh*, more diell? / Pásh njat dritë, qi t'flakron n'báll... (Kënga 4, f. 40)

...Sé tash trí dit ká ndëjë mbi tokë, / A thue t'deknit, krajl, po i tutesh?... (Kënga 16, f. 134)

Folja e parregullt *dua* del në pak raste me formën, *duhesh*, si në rastin:

... Por me e pá ti Gjeto Basho Mujin, / Rrogtár lopësh ti gjâ nuk i *duhesh*... (Kënga 21, f. 160)

Veta e tretë njëjës del me trajta të ndërtuara me mbaresën **-(h)et** për zgjedhimin e parë, të dytë si dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me format, si: *afrohet, bâhet, çohet, dahet, kujtohet, lshohet, merohet, ndihet, njihet, ngushtohet, përmllohet, shtërngohet, rrotullohet, rrxohet, shkurtohet, thahet* etj.

Po ilustruamë me shembuj:*

...Fort ká qeshë ajo ora e malit, / Kërkund djali s'po *kujtohet*... (Kënga 4, f. 30)

...Kurr ksajt, mos me kndue, / Omeri i rí e m'*merohet*²⁰¹... (Kënga 29, f. 222)

Zgjedhimi i dytë na del më i pasur në forma dhe me folje. Disa nga këto folje janë: *derdhet, dredhet, duket, dhimbet, falet, gjegjet, gjindet, gitet, kalbet, kputet, lodhet, lutet, lypet, mërzhitet, mundet, ndeshet, ndezet, ndalet, niset, ngutet, ngjitet/njitet, përgjegjet, pritet, pshtetet, tutet, ulet, xehet* etj.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:²⁰²

...Kúr ká pá shkina Sokol Halilin, / A dredhë mrapsht, si *dredhet* gjarpni.. (Kënga 4, f. 36)

**Shembuj të tjerë vjelë nga CK*: ...Luftë e rrebtë aty qi po *bâhet*, / Me dhâmbë trimat duen shoshojnë me shkye... (Kënga 4, f. 41); ...Me lot faqet trimit m'i u kan mbushë: / Erzi i shpís qysh *lshohet* n'dorë t'balozit?!... (Kënga 5, f. 44); ...Sá Halili po *shtërngohet*, / Edhe gjogun p'e shilon... (Kënga 23, f. 179); ...Pse kam Omerin ktu djalë të rí / M'*përmllohet* e malli e merr për shpí... (Kënga 29, f. 222)

²⁰¹ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit., folja *merohet* ka kuptimin "me u tmerrue, tmerrhem", f. 167.

²⁰² Nga CK kemi marrë edhe vargjet: ...Sa shpejt frima burrave u ká radhë, / Sa shpejt gjaku timave po u *xehet*... (Kënga 4, f. 26); ...Hiç kërkush nuk po i përgjegjë. / Shpejt po i *njitet* nji lugut t'keq... (Kënga 6, f. 58); ...Pásh nji Zot, nânë, qi t'ká dhânë, / Po ç'ka *duket* n'at fush aq bardh?... (Kënga 26, f. 204)

...A të dhimbet paret me i lã? / A të dhimbet darzma m'e bã?... (Kënga 12, f. 98)

.....Mirë po pshtetet për degë t' ahit, / Pikon lodja mbí vorr t' djalit... (Kënga 30, f. 225)

Na dalin vetëm dy **folje të parregullta**: *nepet* dhe *shifet*, si në rastet:

...Ká lshue synin rreth oborrit; / Rob i gjallë asajt nuk *shifet*... (Kënga 4, f. 32)

...E e ka msye kullën e shkamt, / – Hiç s'po i *nepet* djalit me qindrue.... (Kënga 4, f. 37)

Më lart dhamë një panoramë të përgjithshme, ndërsa këtu po i marrim me radhë format sipas vetave në shumës.

Veta e parë shumës del e ndërtuar me mbaresat **-(h)ena** / **-(h)na**. Kemi të bëjmë me të njëjtën mbaresë, por që del e zgjeruar ose jo.

Me mbaresën **-(e)na**, karakteristike për të folmet e gegërishtes verilindore²⁰³, e cila del në dy variante:

a. Me variantin e plotë **-(h)ena**, i cili ndeshet i përdorur tepër rrallë në materialin e studiuar. Kjo dukuri është vërtetuar në të folmen e Shkrelit, Kelmendit, të Hotit, të Kastratit, të Lohes së Sipërme, të Rranzave të Mbishkodrës²⁰⁴, si edhe në të folmet e Dushmanit.²⁰⁵

Ky variant i formimit të vetës së parë të shumësit del në pak raste me format, *çohena*, *lahena* të **zgjedhimit të parë** si dhe me formën foljore, *nisena* të **zgjedhimit të dytë**:

...– Mirë se vini, burrat e Jutbinës! / Kah po *nisena* sot për me çetue?... (Kënga 6, f. 51)

Por kjo folje edhe me mbaresën **-na** si në shembullin:

...Sá mirë krajli ásht pshtjellue; / Tash po *nisna* për Kotorre t'reja... (Kënga 4, f. 34)

Shembuj të tjerë me mbaresën **-(h)ena** na dalin si në shembujt e ilustruar:

...E në mejdan prap po *çohena*, / Shoqishoin atëherë e kan lshue... (Kënga 12, f. 104)

...Nusja uj u ká prû, / E faqesh të dy po *lahena*... (Kënga 12, f. 104)

b. Me formën e rrëgjuar **-(h)na**, edhe kjo karakteristike për të folmet e gegërishtes. Kjo formë që gjallon edhe sot e kësaj dite në të folmet e Grudës, të Hotit, të Trieshtit, të Krajës dhe të Ulqinit,²⁰⁶ nuk është mjaft e vjetër.²⁰⁷ Ndërsa në Shkodër dhe në Shirokë²⁰⁸ është përgjithësuar varianti i shkurtuar **-(h)na** i kësaj mbaresë.²⁰⁹

Kjo mbaresë vërtetohet me pak forma, si: *dahna* (zgjedhimi i parë), *nisna*, *shkepna* (zgjedhimi i dytë) dhe si folje e parregullt del vetëm trajta, *shifna*.

Nga CK po ilustruam shembujt:

...T'gjitha lavdet Muji po na i merr, / Sot po *dahna*, Gjeto Basho Muji!... (Kënga 6, f. 53)

...Nuk po *shkepna* çetë prej çete, / Rândë ká folë ai plaku i thî... (Kënga 6, f. 54)

...Lamtumirë o shokë e kojshî, / Se na s'*shifna* mâ me sy... (Kënga 12, f. 95)

Në **vetën e tretë shumës** foljet në CK formohen kryesisht me mbaresën **-(h)en** dhe më rrallë me mbaresën **-ën**. Nuk na kanë dalë forma në këtë vetë për zgjedhimin e tretë.

1. Mbaresën **-(h)en** e marrin foljet e zgjedhimit të parë, të dytë dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me trajtat, si: *bâhen*, *bashkohen*, *dahen*, *lahen*, *rrënohen*, *rreshtohen*, *shkrumbohen*, *shkrÿrÿhen*, *shpërthyen*, *shtÿÿhen* etj., si në shembujt e ilustruara:*

...As për kulla qi *rrënohen*, / As për t'dekun qi *shkrumbohen*... (Kënga 4, f. 31)

...Por, aty janë agët e Jutbinës, / Për gjith ditë qaty qi m'*bashkohen*... (Kënga 26, f. 205)

²⁰³ R. Mulaku, *Gjuha e shkrimeve të vjetra...*, vep. e cit., f.399-400.

²⁰⁴ B. Beci, *Grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes*, SF, Nr.3, 1970, f.137.

²⁰⁵ B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit., f.52.

²⁰⁶ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.30.

²⁰⁷ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e Pukës*, DSH, II, Tiranë, 1974, f.317.

²⁰⁸ T. Osmani, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor*, 3, "Foljet e të gjitha zgjedhimeve në vetën e parë shumës dalin me mbaresën *-na*: *lahna*, *kthehna*, *nisna*, *çohna*, *merrna*, *lodhna* etj.", Shkodër, 2009, f.292.

²⁰⁹ B. Beci, *Të folmet veriperëndimore...*, vep. e cit., f.52.

* *Shembuj të vjelë nga CK*: ...N'bán t'livadhÿt gjogat qi po u *shkrÿrÿhen*, / Nÿpÿr gurra agët qi po flladiten...(Këng 6, f. 55); ...M'u kan mbledhë shokët përreth tij, / Po *rreshtohen* tânë për 'i rresht...(Kënga 16, f.132)

Si folje të **zgjedhimi të dytë** me këtë mbaresë dalin këto raste: *dërmishen, digjen, duken, dhimben, falen, flladiten, gjinden, kalben, lidhen, llafiten, mblidhen, mbushen, munden, ndeshen, ngrahin, njiqen, përpiqen, plandosen, priten, qeshen, rreshtohen, siellen* etj.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:*

...Maje kualsh me shoqishojn po *falen*²¹⁰, / Kush po falet, kush me gjok lodron...(Kënga 6, f. 51)

...Nëpër gurrat agët qi po *flladiten*, / Vetëm Muji, pshtetë për bré, s’po lue...(Kënga 6, f. 55)

...Ç’po *plandosen* ahave! / Ç’po *dërmishen* krepave!... (Kënga 6, f. 60)

...Qi as s’më *dhimben* paret me i lá, / Por nuk due çfardo nuse me marrë... (Kënga 12, f. 98)

Si **folje të parregullta** në këtë vetë dalin vetëm dy forma, *duhen* dhe *shifen*, në raste mjaft të izoluara, si, p.sh.:

...Trí copë bjeshkë të thata m’i ká lânë, / Qi s’i *duhen* kurrkuj gjâ... (Kënga 19, f. 147)

...Dushku i malit marrë flakë, qi po dredhet, / Kurrku’ bjeshkët, prej timit nuk po *shifen*...(Kënga 3, f. 21)

2. Me mbaresën **-ën**, e formojnë vetën e tretë shumës të së tashmes disa folje të zgjedhimit të dytë dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *çilën, êndën, falën, kalbën, llafitën, mblidhën, shkepën* etj. Duhet theksuar se foljet që e formojnë vetën e tretë shumës me mbaresën **-ën**, pothuajse në të gjitha rastet dalin me aktualizim, gjë që e vërtetojnë edhe shembujt:

...Kah po ndiellin dhit-o çetave, / Kah **po shkepën** m’i lá gurrave... (Kënga 6, f. 52)

...Sa herë burri frymë po ngrahë, / Tâna dyerët me ‘i herë po *çilën*... (Kënga 21, f. 165)

...Veç po i lshojnë gjogat atij ashtit, / Vetë po *mblidhën* tu ajo hija e ahit... (Kënga 23, f. 176)

Vetëm trajta, *shifën* vërtetohet si *folje e parregullt* e përdorur në raste të izoluara, si n, si në rastin:

...Tânë mushknít nepër at varrë po *shifën*, / Edhe zëmra e burrit kah po i rreh.(Kënga 23, f. 179)

Nga materiali i vjelë në CK koha e tashme e mënyrës dëftore na del me këto mbaresa sipas vetave:

Mënyra dëftore			Veprorë			Koha e tashme		
Numri njëjës			Numri shumës					
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III			
-j	-n	-n	-(j)më	-ni	-(j)n(ë)			
-i	-ë	-ë	-im		-in			
zero	zero	zero						

Joveprorë

Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
-(h)em	-esh	-(h)et	-(h)ena	—	-(h)en
-ëm			-(h)na		

²¹⁰D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., forma *me u falë*, ka kuptimin "me u përshëndetë"(në mënyrën e vjetër tradicionale), f.141.

Format dytësore të së tashmes dhe të së pakryerës

E tashmja e dëftores, përveçse një formë sintetike, siç e përmendëm edhe më lart në analizën e trajtuar gjerësisht, del edhe me format dytësore analitike. Në sistemin foljor gramatikalizimi ose morfologjizimi i ndërtimeve si folje ndihmëse, gjysmëndihmëse dhe modale, të cilat shumë herë kanë një kuptim leksikor shumë të përgjithshëm, madje të dobësuar e të rrëgjuar, është shumë më i mundshëm, se sa me folje që kanë një kuptim leksikor të plotë dhe të pavarur.

Edhe në ndërtimet perifrastike të shqipes, me folje ndihmëse *jam + paskajore*, elementi i parë ka kuptimin themelor gramatikor, ndërsa elementi tjetër ka kuptimin themelor leksikor²¹¹, si në rastin:

...Njiky uk i idhtë,qi m'rri te këmbët / Me kalue kërkënd nuk *është tue lânë*. (Kënga 23, f. 180)

Pra, kuptimet kohore dalin nga marrëdhëniet midis të dy elementeve përbërëse të formës perifrastike, kurse për t'u shprehur në formë hipoteze një veprim në zhvillim e sipër (e tashme aktuale) përdoret forma perifrastike *jam + përcjellore*, ku vendin e foljes *jam* e ka zënë forma e së ardhmes.²¹²

Përveç formave të thjeshta (sintetike) e tashmja e dëftores në CK vërtetohet edhe me **forma sekondare (analitike)** të ndërtuara me anë të foljes ndihmëse *jam* në të tashmen e dëftores dhe nga përcjellorja e foljes themelore (ndërtuar me pjesëzat *tu/tue/tuj* dhe *kah/kahë*). Këto trajta jo të thjeshta tregojnë se veprimi vërtet është i zgjatur, por që kufizohet brenda një kohe, pra nuk zgjatet në mënyrë të pacaktuar, p.sh. *jam duke punuar, isha duke punuar* etj.,²¹³ gjë që e vërteton edhe shembulli nga CK:

...Në mejdan, Halil, s'mundem me t'dalë, / Por me tý tek *jam tue ardhë*... (Kënga 1, f. 16)

Sipas gjuhëtarit K. Topalli: "Veprimet në zhvillim e sipër shprehen me anë të foljes *jam* të ndjekur nga përcjellorja e foljes themelore (*jam duke punuar*)".²¹⁴

Në materialin e studiuar këto forma sekondare analitike janë të shpeshta. Këto forma që shërbejnë për të krijuar të tashmen na kanë dalë kryesisht në të tri vetat e njëjësit dhe më me pak forma në numrin shumës, por në këtë syth trajtimin e këtyre formave e kemi marrë jo sipas vetave, por sipas strukturës.

Gjatë studimit të këngëve në CK, këto forma dytësore na kanë dalë me variante, të cilat po i klasifikojmë në dy grupe të mëdha: *jam + përcjellore* duke përfshirë brenda të gjitha variantet me të cilat del kjo folje, kurse në grupin e dytë kemi përfshirë strukturën *jam + kah + folje*.

a. Format sekonadre (analitike) sipas rasteve që vërtetohen në CK ndërtohen me anë të foljes ndihmëse *jam* në të tashmen e dëftores dhe nga përcjellorja e foljes themelore, *jam tue dalë* (=po dal), e cila formohet nga pjesëzat *tu/tue/tuj* me këto variante: *janë + tu' veshë, është tue rá, jam + tuj pritë*.

Disa nga këto forma sekonadre që dalin në CK janë: *jé tu m'giá, janë tu' veshë; jam tue ardhë, jam tue lânë, jam tue lshue, jam tue pá, jé tue kthye, është tue ardhë/â tue ardhë, është tue ecë, është tue lânë, është tue rá, â tue rrehë; jém tuj dhânë, jam tuj pritë, jé tuj bâ, jé tuj pritë, â tuj ardhë, â tuj msue, â tuj pritë, është tuj rá, janë tuj dhânë, janë tuj qeshë* etj.

Këto forma po i ilustruam me vargje nga CK:*

...Kah ditë Raspo zânin t'a kam ndie, / Se edhe n'mue fort *jé tu m'u giá*... (Kënga 9, f. 75)

...– Zoti t'vraftë, si *jé tue kthye*, / Po n'asgjá gjithmonë si *jé tuj m'bâ*... (Kënga 25, f. 198)

...Se përjashta shí nuk *është tuj rá*; / Syt e motrës po t' pikojnë more vllá! (Kënga 5, f. 44)

...T'tânë Jutbina jashtë tek ká dalë, / T'tânë me né *janë tuj qeshë*... (Kënga 13, f. 111)

b. Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike na kanë dalë edhe disa forma sekondare analitike që janë të ndërtuara nga pjesëza karakteristike e gegërishtes *kah/kahë* sipas variantit : *jam+ kah*

²¹¹ S. Mancaku, *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam +paskajore te autorët e vjetër*, SF, Nr. 2, 1980, f.137.

²¹² N. Topalli, *Koha e ardhme e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe*, SF, Nr. 4, 1980, f.129.

²¹³ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.243.

²¹⁴ Më gjerësisht shih, K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., f.749.

kjáj (=po qaj). Ky formim që shërben për të ndërtuar të tashmen është një veçori në të folmet e grupit lindor të nëndialektit verior të gegërishtes dhe sipas J.Gjinari ky formim "...realizohet me anë të foljes *jam*, pjesëzës *ka* dhe të së tashmes së foljes që mban kuptimin kryesor (*jam ka punoj*)".²¹⁵ Dy nga përbërësit e kësaj forme të veçantë janë të shtjellueshëm; folja "jam" shtjellohet nëpër veta dhe kohë, kurse forma e foljes që mbart kuptimin e këtij togu shtjellohet vetëm në vetat dhe qëndron gjithmonë në kohën e tashme.²¹⁶ Lidhur me pjesëzën karakteristike *kah/kahë*, e cila hyn ndërmjet dy foljeve, mendohet të ketë qenë një lidhëz²¹⁷, por duke u përdorur në ndërtime me forma të tilla analitike, ajo e ka humbur funksionin e saj lidhëzor dhe është kthyer në pjesëz.

Disa nga këto forma sekondare analitike janë: *jam kah há*, *jam kah kjáj*, *jé kah folë*, *jé kah thue*, *â kah ndjekë*, *â kah rrin*, *â kah vjen*, *janë kah bâjnë*, *janë kahë vijnë* etj.

Nga CK po marrim vargjet:*

...Se shtatë Omera t'mirë si i pata, / Shtatë Omera *jam kah kjáj* e ngrâta... (Kënga 29, f. 218)

...Është ulë Muja e ká pushue, / Se ai në tokë si *â kah rrin*... (Kënga 15, f. 129)

...Nu' janë jo, kto bumrimë për qiell, / Por *janë kahë vijnë* Muja e Halili!..(Kënga 3, f. 22)

Ky ndërtim bashkëjeton me trajtën aspektive të formuar nga folja *jam* dhe përcjellorja e foljes që është karakteristike për të folmet perëndimore të gegërishtes veriore dhe për të folme të tjera të gegërishtes.²¹⁸

Folja bazë, jo gjithmonë është në veprorë, mund të jetë edhe në **joveprorë**, e cila në këto trajta del e ndërtuar me anë të foljes ndihmëse *jam* në të tashmen e dëftores dhe nga forma joveprorë e përcjellores së foljes themelore. Ka përdorim tepër të kufizuar. Në CK folja ndihmëse *jam*, sipas shembujve të vjelë nga CK, vërtetohet të jetë ose në vetën e tretë njëjës ose në vetën e parë shumës, si, p.sh: *â kah bâhet*, *â t'u m'u kalbë*, *jena tue u çue*:

...Qe nand'vjet, qi trupi *â t'u m'u kalbë*; / Gjergji i yt tjetër pushim nuk ká.(Kënga 5, f. 44)

...Ku jé, Mujo, he ty Zoti t'vraftë! / Qi s'po di kurr gjá se *ç'â kah bâhet*... (Kënga 23, f. 184)

...Atëherë foli Dizdar Osman Aga: / Qetash, Mujo, *jena tue u çue*... (Kënga 23, f. 179)

Në këtë syth po analizojmë edhe disa raste, ku ndërmjet formave sekondare analitike *jam* + *përcjellore* dhe *jam* + *kah kjáj* hyjnë elementë të tjerë, si, trajtat e shkurtra të përemrit vetor apo edhe elemente të tjera të fjalisë, si, p.sh:*

...Por një bé *jam tue jau lshue* / Un robinë, ju zana malit... (Kënga 1, f. 6)

...Se i ká dalë një bajloz prej detit, / Edhe vorrin me hû *â tue i a rrehë*... (Kënga 33, f. 236)

... – Shum e ftohtë bjeshka po m'ásht, / Qetash *âsht gjethi tue rá*... (Kënga 21, f. 16)

...Se kta mue gjâ, nuk *janë kah m'bâjnë*: / Por ndimë t'madhe, besa *janë tuj m'dhânë*...Kënga 23, f. 180)

Përveç formave të zakonshme sintetike të së pakryerës, të cilat do t'i trajtojmë gjatë këtij kapitulli, në CK ndeshim edhe pak forma sekondare analitike, që shërbejnë për të ndërtuar të pakryerën. Këto forma sekondare ndërtohen ose me anë të foljes ndihmëse *isha* në të pakryerën

**Shembuj të tjerë nga CK*:...Prep Muji i ká thânë:/ "Tridhetë dada nusen *janë tu'e veshë*"...(Kënga 13, f.114);...Ven ká xânë dielli e na vên oroe, / Hiç për qiellë nuk *âsht tue ecë*... (Kënga 15, f.129); ...Zâ po ndiej e kend nuk *jam tue pá*, / Un jam msue vetëm n'jeremí...(Kënga 34, f.237); ...Era e keqe ktij *â tuj ardhë*, / Se tash trí dit ká ndëjë mbi tokë...(Kënga 16, f.134); ...Se mue nusen sot m'a ká vjedhë, / E *jam tuj pritë* për n'mejdan në bjeshkë...(Kënga 12, f.101)

* *Shembuj të vjelë nga CK*:... *Jam kah há*, çohem pa ngi, / Tuj pí uj, çohem pá pí...(Kënga 21, f.171); ...Erzin marrë, çikat shnjerrzue! / – Tu thaftë goja! *ç'jé kah thue*?...(Kënga 4, f. 37); ...Jo, more vllá, lum motra! – i ká përgjegjë: / "T'ká lodhë jermi e s'po di ç'jé kah folë!"...(Kënga 5, f.44); ...E shef Behurin se *â kah vjen*, / Fill po msyn der'n e avullis...(Kënga 6, f.58); ...Ai ásht Sokole Halili, / *â kah ndjekë* krajl-e kapidanin...(Kënga 21, f.169)

²¹⁵ J. Gjinari, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, SF, Nr. 4, 1966, f.110.

²¹⁶ J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.244.

²¹⁷ K. Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit, f.848.

²¹⁸ B. Beci, *Të folmet veriperëndimore*..., vep. e cit, f.70.

e dëftores dhe përcjellores së foljes që mbart kuptimin leksikor (*isha + përcjellore*), si, p.sh: *i'n²¹⁹ tuj shkue, kjeçë tuj bâ, kjeçë tu' lidhë, etj.*

Nga CK po ilustruon më vargjet e vjelë:

...E sá shpejt aty te i ká ardhë, / Lott për faqe gjogut *i'n tuj i shkue*... (Kënga 32, f. 232)

...Për me dalun deri n'at krajli, / *Kjeçë tuj e bâ* një heksi t' vogël... (Kënga 4, f. 28)

...Se me kënë, si ç'thue, Llabutani, / *Kjeçë tu' e lidhë* për bishtit të gjogut...(Kënga 23, f. 18)

Të dy ndërtimet analitike *jam + përcjellore* (*jam + tu/tue/tuj shkue*) dhe *jam + kah há*, megjithëse forma dytësore nuk janë fort të rralla në CK, përkundrazi ato përdoren përkrah formave parësore me mbaresa dhe krijojnë kështu larmi në ndërtimet foljore.

3.2 Format e kohës së shkuar Zgjedhimi vepror. Zgjedhimi jovepror.

E pakryera

Folja në kohën e pakryer është e afërt me të tashmen, e cila tregon veprimin gjithashtu në zhvillim e sipër. Nga mënyra se si na dalin format e së pakryerës në CK, ajo vërtetohet me dy forma: me trajtën e thjeshtë (sintetike) të ndërtuar me mbaresat karakteristike për të folmen e gegërishtes: **-te, -(j)shin²²⁰**, si në shembullin e ilustruar:

...N'buzë t'nji kronit, n'dritë të hânës, / N'dritë të hânës kah po *lodroshin*...(Kënga 2, f. 12)

Kurse shembujt me formën sekondare analitike, *isha + përcjellore*, i kemi trajtuar më lart te format dytësore analitike. Koha e pakryer e ndërtuar nga format sintetike del me një numër të vogël foljesh në të dy format (veprore dhe joveprore), por nuk vërtetohet për të gjitha vetat.

Në CK shumica e foljeve në kohën e pakryer kanë një temë të njëjtë me atë të kohës së tashme, kurse disa foljeve që i takojnë zgjedhimit të tretë, mbaresa e vetës së tretë njëjës **-te** e kohës së pakryer i shtohet temës së foljes në kohën e tashme, e cila del me mbaresë zero: *do - dote, rri - rrite*.

Në CK format paraqiten të ndërtuara me mbaresat e kësaj kohe për vetën e parë dhe të tretë njëjës dhe për vetën e dytë dhe të tretë shumës. Këto janë mbaresa vetore të përfutuara nën veprimin analogjik të formave të së pakryerës së foljes *jam e kam* (*ish-a, ish-e, ish-te, ish-im, etj.*) ndarja morfematike në ndërgjegjen gjuhësore popullore është bërë *i-sha, i-she*, duke u interpretuar tingulli fundor i temës **-sh** si pjesë e mbaresës.²²¹ Këto mbaresa vetore analogjike janë përfutuar në një fazë të vonë të zhvillimit të shqipes së shkuar. Gjurmë të këtyre mbaresave i ndeshim që te Kuvendi i Arbërit e më pas në shek. XIX edhe tek autorët e tjerë veriorë.²²² Në CK ato janë mbaresat e vetme me të cilat ndërtohet e pakryera të identifikuar nga materiali i studiuar.

Zgjedhimi vepror

Duke qenë se materiali i vjelë është i paktë dhe nuk na dalin të gjitha zgjedhimet në të gjitha vetat interpretimi i kësaj kohe do të bëhet vetëm sipas vetave dhe formës dhe në ndonjë rast edhe sipas zgjedhimeve.

²¹⁹ Shih më gjerësisht: K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.342.

* *Nga CK po japim shembuj të tjerë*:...Dorën Mujit t'i a ká marrë, / Bes'n e Zotit *jém tuj t'dhânë*... (Kënga 1, f.9): ...Mejdanxhi, Krajli s'ká qillue, / Rishtas mazin Muji *â tuj m'a msue*...(Kënga 9, f.73); ...-Ti qi jé Arnaut Osmani, / *Jé tuj m'pritë* për n'mejdan në bjeshkë...(Kënga 12, f.102) ...Po gjynah tý si *s'âsht tue t'ardhë*, / Për t'dekun njerin me e mundue...(Kënga 16, f.134); ...Mirë se n'çetë, Mujo, tash po dal, / Fort të lig n'të shtrume *jam tue t'lânë* (Kënga 23, f.179)

²²⁰ H. Sulejmani, *Imperfekti në gjuhën shqipe*, Foljet me temë në zanore e kanë ruajtur në të pakryerën tingullin epentetik *-j*, i cili është shndërruar në element përbërës të mbaresës, Tetovë, 1996, f.149.

²²¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.774- 775.

²²² Shih më gjerësisht: R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.44 - 45.

Siç na paraqitet gjuha në CK, në kohën e pakryer të dëftores, format e zgjedhimit **vepror** ndërtohen me anë të këtyre mbaresave:

Veta e parë njëjës:	-sha
Veta e dytë “	- zero
Veta e tretë “	- te
Veta e parë shumës:	-
Veta e dytë “	- shi
Veta e tretë “	-(j)shin

Veta e parë njëjës në CK vërtetohet e ndërtuar me mbaresat **-sha** kryesisht për foljet që dalin me temë në zanore. të zgjedhimit të dytë (*mujsha*). Në vëllimin studimor "Dialektologjia shqiptare IV", theksohet: "Format me mbaresën **-sha** për vetën e parë njëjës, si: *visha, rrisha, shkoshka, blesha, marosha* etj., janë ndeshur në zonën e Rrjodhit (Linaj të Rrjodhit)".²²³ Për sa u takon këtyre formave të së pakryerës që na kanë dalë në CK, na rezultojnë sipas përshkrimeve të dhëna në fund të çdo këngë kreshnike nga mbledhësit B.Palaj dhe D.Kurti, se format e së pakryerës të dëftores janë mbledhur kryesisht në zonat e Kastratit dhe të Malësisë së Madhe – Shalë²²⁴, pra kjo do të jetë arsyeja, sipas nesh, e identifikimit vetëm të kësaj mbarese. Kjo folje në të gjitha rastet na del si folje modale.

...Si në *mujsha* kudo të gjallë me e gjetë, / Me tÿ, nânë, kam me dekë... (Kënga 13, f. 112)

Veta e dytë e kohës së pakryer në materialin e vjelë nga CK nuk ka shumë folje, janë kryesisht folje të zgjedhimit të parë, si: *lájsh, shkojsh* dhe më pak të zgjedhimit të dytë, si: *dalsh, muejsh / mujsh*. Këto folje dalin me fundoren **-sh** dhe më gjerësisht i kemi trajtuar te foljet modale për arsye të ngarkesës kuptimore që mbartin.

Po japim shembujt:

...Por kah 'i natë në muej të vjen, / Për trí dit petkat s' mund i a *lájsh*... (Kënga 20, f. 155)

...–30 qese t'i paça dhânë, / Në *dalsh* Mujit mazin me i a marrë... (Kënga 9, f. 73)

Zgjedhimi i tretë na del vetëm me foljen, *dijsh*, pavarësisht kuptimit të kësaj foljeje si folje modale, si në rastin:

...Kurr pá tÿ bukë s'kan me ngrânë, / Qat-herë n' *dijsh* për me u kuvëndë... (Kënga 1, f. 6)

Veta e tretë njëjës në CK na del e ndërtuar me mbaresën **-te**, si për foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, ashtu edhe për foljet që dalin me temë në zanore, pra, pa **-n**-në (e cila ndeshet e përdorur tek autorët e vjetër: (*deklaronte, dërgonte*) ardhur si efekt i hundorëzimit të zanores së temës.²²⁵ Në këtë rast kemi të bëjmë me një risi të gegërishtes.²²⁶ Këtë gjë e vërteton edhe shembulli i dhënë:

...E tu dera gruan e paskan hasë, / Kah po *kthete* me bullirë prej kronit... (Kënga 4, f. 38)

Kjo është një mbarese relativisht e re dhe duhet të jetë përftuar gjatë evolucionit historik të shqipes dhe është përgjithësuar në gjuhën shqipe sidomos te foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore²²⁷, por që në CK (këtë formë e ndeshim edhe te autorë të tjerë veriorë, kryesisht ata shkodranë, si: Gj.Fishta, F.Shiroka, N. Mjeda, N. Bytyçi, P.Babi, N.Nikaj etj.)²²⁸, e ndeshim të përdorur edhe në folje që dalin me temë në zanore, karakteristikë kjo, edhe e gegërishtes veriore.²²⁹

²²³ Gj. Shkurtaj, *E folmja e Rranzave të Mbishkodrës*, DSH IV, Tiranë, 1982, f.220.

²²⁴ At B. Palaj, At D.Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., f.96, 117.

²²⁵ R. Mulaku, *Vepra 3*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1998, f.91-92.

²²⁶ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...* vep. e cit., f.71.

²²⁷ Sh. Demiraj, *Gramatikë hitorike...*, vep. e cit., f.688.

²²⁸ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.71.

²²⁹ J. Gjinari, Gj.Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.228; I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, "Fundorja **-te** te foljet e **-n** konigacionit, si: *bânte, shkonte, mbaronte, lidhte, shkelte, vriste dinte, rrinte*, nuk mund të jetë e vjetër, pse vokalet fundore të vjetra kanë rënë më kohë, dhe ato që gjenden sot në atë pozicion do të jenë zhvillime të reja. **Te**-ja e përmendur njihet si

Krahaso:

a. ...Se lojë të madhe qi ká marrë, / *Kcete* gardhet dy-tre supe... (Kënga, 9, f. 72)

b. ...Mirë m'a çilte arkën e vet, / Mirë m'i veshte petkat maxharisht... (Kënga 11, f. 94)

Në materialin e studiuar në CK dalin kryesisht forma që nuk paraprihen nga bashkëtingëllorja -n, por edhe këto me përdorime relativisht të kufizuara. Na vërtetohen pak folje. Kështu, zgjedhimi i parë del me dy trajta, *kthete* dhe *kcete*, si në vargjet:

...*Kcete* lumin dy-tri pupa, / Ká marrë vesht Krajlo Kapedani... (Kënga, 9, f. 72)

Zgjedhimi i dytë na ka dalë me pak folje, si: *çilte*, *rrokte*, *veshte*, *zhgulte*, etj. si në shembullin:

...Si nuk jé mâ i fortë se baba, / *Zhgulte* ahát treqind vjeç... (Kënga 11, f. 91)

Foljet e parregullta dalin me foljet, si: *dote*, *hate*, *rrite* etj.

...Po, por nana, s'ish kënë nânë, / Ish' kënë bishë qi *hate* drangujt... (Kënga 4, f. 36)

*Veta e parë shumë*s nuk na ka dalë në materialin e skeduar në CK, kurse *veta e dytë shumë*s del gjithmonë me foljet me vlerë modale si në rastin:

...Për në *mujshi* bjeshkët me m' i xjerrë, / Due me u dhânë shtatqind orum të verdhë...(Kënga 19, f. 147)

Veta e tretë shumës vërtetohet me mbaresat **-(j)shin** dhe **-shin** për foljet me temë në zanore, dhe me mbaresën **-shin** për foljet me temë në bashkëtingëllore. Shembujt janë vjelë për zgjedhimin e parë, të dytë dhe foljet e parregullta, pasi nuk na dalin folje të tjera në këtë vetë.

Zgjedhimi i parë na del rrallë, me pak forma, si: *bâshin*, *çojshin*, *lodroshin*, *shkoshin*, etj.; si në shembullin e vjelë nga CK:

...P'e përcjellë tue këndue, / Fmija *shkoshin* tue vajtue... (Kënga 26, f. 208)

Zgjedhimi i dytë na del vetëm me dy trajta, si: *qitshin* dhe *njeshin*, si në vargjet e shkëputura nga CK:

...Aty gjetkan trí copë makinë, / Qi po *qitshin* ár florî... (Kënga 2, f. 17)

...Mirë po i *njeshin* shpatat e mejdanit, / M'janë shtërngue me shgjeta e me heshta...(Kënga 6, f. 51)

Foljet e parregullta na dalin me pak folje me përdorime relativisht të kufizuara, si: *dojshin*, *rrijshin*, *thojshin*, si në vargjet e ilustruara:

...Edhe mjaft shkjë vrá qi kishin; / Por Omerin *dojshin* për me e rrê... (Kënga 29, f. 220)

Për foljet e parregullta, *rrijshin*, *thojshin* që e formojnë vetën e tretë të shumës me mbaresën *-jshin*, M.Domi ishte i mendimit se: "...trajta e së pakryerës me *-she* a *-jshe* (*lidhshe*, *lajshe*) është një trajtë sekondare e formuar nga pjesorja e shkurtër (në disa raste e reduktuar në temë dhe nga e pakryera e foljes *jam*)".²³⁰

Po japim një shembull me folje të parregullt:

...Ëmën t'bukur nâna i kish'njitë, / Për ëmën i *thojshin* Ali Bajraktari... (Kënga 13, f. 109)

Lidhur me format e së pakryerës të tipit, *punojshe*, S.Riza i sjell si "...të përfutuara në shkodranishte e kosovarishte, pasi tingulli *-nj* tek foljet ishte shndërruar në *-j*".²³¹ Sh. Demiraj duke mbështetur deri diku mendimin e I.Ajetit, lidhur me këto forma të së pakryerës thekson: "...më fort ndikimin analogjik të formavet të së pakryerës së foljes *jam*, natyrisht pa përjashtuar edhe ato të foljes *kam*".²³²

Një grup më vete përbëjnë edhe të ashtuquajtuarat folje të zgjedhimit në **-mi**, siç i kemi klasifikuar edhe në kohën e tashme të dëftores (*jam*, *kam*, *thom/tham*), të cilat na kanë dalë në

rrokje pëshitetëse perftuar për arsye ritmi, e që na del edhe në vetën e parë të prezentit në të folmen e çamërishtes dhe të labërishtes: *kamte*, *vijte* e te Buzuku edhe *vemte* për *vemi* me funksion diferencimi të vetës së tretë singular të imperfektit nga *veta e III* e prezentit: *bân:bën*". Prishtinë, 1969, f.81.

²³⁰Sh. Demiraj, *Rreth foljevet jam, kam e thom...*, pun. i cit., f.28.

²³¹ S. Riza, *Tri monografina albanologjike Abeceja = Drejtëshkrimi = Çështja gjuhësore*, Tiranë, 1944, f.193.

²³² Sh. Demiraj, në artikullin : *Rreth foljevet jam, kam e thom dhe rreth alternimit -e-/-ie- -i- në sistemin foljor të shqipes*, pun. i cit., thekson "...më fort ndikimin analogjik të formavet të së pakryerës së foljes *jam*, natyrisht pa përjashtuar edhe ato të foljes *kam*", f.29.

pak raste në CK. Me disa ndryshime të vogla të karakterit fonetik këto folje ruajnë pamjen sigmatike të së pakryerës edhe sot e kësaj dite në të folmet geqe.²³³

Nga paradigma e zgjedhimit të këtyre foljeve (sidomos e foljeve *jam* e *kam*) vërehet se ka mjaft ngjashmëri. Temat e këtyre foljeve në vetat e vërtetuara të së pakryerës dalin me fundoren **-sh**. Për këto forma në CK na kanë dalë trajta për vetën e parë e të tretë njëjës dhe në vetën e tretë shumës. Për vetën e tretë shumës shtrirja e **-sh**-së është veprim analogjik i formave përgjegjëse të njëjësit (bëhet fjalë për ndikim analogjik të hershëm). Kurse për foljem *kam*, **-sh** është një shtesë analogjike në të gjitha vetat, sipas foljes *jam*. Për foljen *tham*, **-sh**, dikur pjesë e temës (tek autorët e vjetër veriorë dhe në disa të folme të shqipës)²³⁴, shtrirë nën ndikimin analogjik të foljes *jam*, në CK del si element i mbaresës dhe i shtohet një *-j-* antihiat për vetën e tretë të shumësit (e vetmja formë për foljen *them*, e dëshmuar në materialin e studiuar). Me sa duket, këtu kemi të bëjmë me një risi të gegërishtes veriperëndimore.²³⁵

Foljet e këtij zgjedhimi në **vetën e tretë njëjës** në CK dalin rregullisht të ndërtuara me mbaresën **-te**: *ishte*, *kishte*. Gjatë studimit të materialit të CK kemi ndeshur në një përdorim relativisht të kufizuar të foljes **kam** në të pakryerën, sepse kjo folje del më shumë si pjesë përbërëse e kohës së shkuar (koha më se e kryer), se sa si folje më vete.

Nga CK kemi vjelë shembujt:*

...Dymbdhetë ketesh kulla e naltë, / Kërkund shoqen nuk e *kishte*.... (Kënga 4, f. 35)

...Si dý rrfë n'at báll dy sy m'i *kishte*, / Dý herë rresht plaku s' mund e ká kqyrë...(Kënga 23, f. 179)

...*Ishte* frëni telatinit, / *Ishte* shala prej brishimit... (Kënga 9, f. 72)

...*Ishte* varra n'gjoks sá me hî grushti, / Tâne mushknít nëpër atë varrë po shifën...(Kënga 23, f. 179)

Folja **jam** në kohën e pakryer të dëftores, del me dy trajta: *ish'* dhe *ishte*, përkundrejt foljes **kam**, e cila del vetëm me trajtën stadarde të shqipës, *kishte*. Kjo *-sh-* e mbaresave të së pakryerës, që e ka burimin te forma e së pakryerës së foljes *jam* (*isha* etj.), mungon vetëm në vetën e tretë njëjës "për arsye se forma përkatëse e foljes "jam", që bën *ish*, përbëhet vetëm nga një rrokje e theksuar, si rrjedhim këtu nuk *kishte* rrokje të patheksuar që të interpretohej si mbaresë".²³⁶ Lidhur me këto dy trajta të foljes **jam**, ato dalin me variacione edhe nga mbledhësit e Këngëve Kreshnike.

Krahaso:

a. ...Njani *ish* i Dizdar Osman Agës, / Tjetri *ish* i Zukut Bajraktár... (Kënga 6, f. 59)

b. ...Tufa *ishte* treqind delesh, / N'mjedis t' tufës nji uk të zí... (Kënga 4, f. 34)

Veta e tretë shumës për foljet *jam* e *kam* vërtetohet ashtu si në shqipen standarde, e formuar me mbaresën **-in**, kurse për foljen *them* del me mbaresën **-jshin**, kështu, si: *i'n* / *ishin*, *k'in*²³⁷, *thojshin*. Vetëm forma *kishin* nuk del me formën e plotë, por me variantin e shkurtuar, *ki'n*. Kjo shpjegohet edhe me faktin se edhe si folje ndihmëse e kohëve të përbëra të mënyrës dëftore ajo ka një përdorim shumë të madh (*ki'n dalë*, *ki'n ndodhë*, *ki'n pasë*, *ki'n thënë*, *ki'n vajtë* etj.). Kjo formë në CK nuk lokalizohet, sepse këngët janë marrë në zona të ndryshme, dhe pavarësisht kësaj del e vetmja formë. Lidhur me formën e së pakryerës së dëftores të foljes *jam*, ajo në vetën e tretë shumës del me dy trajta, si: *ishin* dhe *i'n*.

Nga CK po ilustruam:

²³³ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.75.

²³⁴ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.746.

²³⁵ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.75.

²³⁶ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.342.

*...Njani *ish'* Smilaliq Alija, / Tjetri *ish'* Baloz Sedelija...(Kënga 11, f.90); ...*Ishte* breu thue njimí vjeç, / *Ishte* hala thue trimí vjeç...(Kënga 23, f.176)

²³⁷ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., ...një formë tjetër *allegro* është krijuar në të pakryerën, ku veta III numër shumës del me një formë të thjeshtuar, meqënëse ka rënë një rrokje në trup të fjalës, *kin* për *kishin*, *in* për *ishin*..., f.912.

- ...Vig m’*a k’in* trimin Osman, / Vig m’*a ki’n* Osman Agën e rí... (Kënga 16, f. 133)
 – *I’n* bucelat plot rakí, / *I’n* fuçijat plot me vënë... (Kënga 4, f. 22)
 ...I a ká qitë syretin n’Halilin, / Shndosh e mirë Muji e Halili *ishin*... (Kënga 29, f. 220)

Zgjedhimi jovepror

Nga materiali i vjelë në CK, **zgjedhimi jovepror** del me pak trajta. Format e së pakryerës në këtë zgjedhim dalin vetëm në vetën e tretë njëjës dhe shumës, të cilat ndërtohen me anën e mbaresave vetore të njëjta si në shqipen standarde: **-(h)ej, -heshin**, historikisht të rindërtuara nën ndikimin analogjik të foljes *jam*²³⁸, shoqëruar (kur folja del me temë në zanore) ose jo (kur folja del me temë në bashkëtingëllore) nga një *-h-* epentetike kundër hiatit. Ashtu si edhe për numrin njëjës trajtat foljore të së pakryerës të dëftores vërehen në vetën e tretë njëjës dhe shumës me një numër të kufizuar foljesh, si në shembujt:

Veta e tretë njëjës del vetëm me dy folje të zgjedhimit të dytë, si: *dredhej* dhe *sillej*, siç vërtetohet edhe në shembullin:

- ...Sá herë *sillej* Muji bilimbash, / Më një gjû Mujin po m’*a qet*... (Kënga 15, f. 128)
 ...Sá herë *dredhej* Bani Zadrlí, / Hiç prej vendit Banin nuk e luen... (Kënga 15, f. 128)

Veta e tretë shumës del e vërtetuar vetëm me foljen e parregullt, *duheshin*, si. p.sh.:

- ...Trí copë bjeshkë t’*thatë* i a ki’ lánë, / Qi s’*po* i *duheshin* kurrkuj gjâ... (Kënga 19, f.146)
 ...– Tý te shpija – tha – ‘i çikë të leftë, / E nândë varrë, nândë pikë t’*u*²³⁹ *çojshin* / Armë e petka tý, Muj, t’*i* gzosha... (Kënga 32, f. 232)

Nga materiali i vjelë po japim tabelën përmbledhëse të mbaresave të kohës së pakryer sipas vetave:

Mënyra dëftore			Veprorë		Koha e pakryer	
Numri njëjës			Numri shumës			
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III	
-sha/-she	zero	-te	–	-shi	-(j)shin	
Joveprorë						
–	–	-ej	–	–	-heshin	

E kryera e thjeshtë

Koha e kryer e thjeshtë është një nga format kohore të së shkuarës "absolute" krahas së pakryerës dhe të kryerës. Karakteristikë kryesore e foljeve në këtë kohë është fakti që ato shprehin veprime të shkurtra, veprime që nuk zgjasin shumë.²⁴⁰

Po ilustrojmë shembullin:

- ...Se t’*a shkova* gurin e peshën, / Se ty rob krajli t’*kâ xânë*... (Kënga 8, f. 68)

Nëse e shohim problemin në pikëpamje historike sipas Sh. Demiraj "...do pasur parasysh se format gramatikore të së kryerës së thjeshtë, në shqipe historikisht janë formime të ndryshme,

²³⁸ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.731.

²³⁹ Ne po e klasifikojm si *joveprorë*, sepse të tillë e ka marrë edhe professor K. Topalli. Shih më gjerësisht: K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit., **u** del si pjesëz përemërore, e cila formon formën joveprorë të së pakryerës së dëftores, f.891.; Xh.Gosturani, *E folmja e Hasit*, Koha e pakryer në këtë të folme formohet duke u paravënë trajtave korresponduese të trajtës veprorë pjesëzën **u**: *u dajshna, u dajshe, u dajke, u dajshim, u dashit, u dajshin* etj.; DSH, III, Tiranë, 1975, f.241.; B. Beci, *E folmja e Mirditës*, për formën joveprorë të së pakryerës dalin format: *u lodhshem, u lodhshe, u lodhte, u lodhshim, u lodhshi, u lodhshin* etj. DSH IV, Tiranë, 1982, f.90.

²⁴⁰ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.49.

që pjesërisht janë vazhdim i së kryerës (perfektit) e pjesërisht rindërtime të reja²⁴¹, gjë, të cilën e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë nga CK.

Krahaso:

a. ...Nuk *pata* paret me i a lá, / Djalin e madh për borxh m'a pat marrë... (Kënga 12, f. 106)

b. ...Hej medet – tha – mori bjeshkë, / Se tetë Omera t'mirë si i paçë... (Kënga 29, f. 222)

Kemi vënë re se format e së kryerës së thjeshtë, që na dalin në CK, për nga tipi i ndërtimit e ruajnë deri në një farë mase kundërvënien e hershme midis aoristit sigmatik dhe atij asigmatik.²⁴² Në CK trajta të aoristit sigmatik²⁴³ kemi gjetur vetëm në vetën e parë njëjës, ashtu si dhe në shqipen standarde të disa foljeve të trashëguara, që përgjithësisht janë të parregullta supletive, si: *dhásh, rash*. Këto folje dalin kryesisht pa **-ë-** fundore, përjashtim bëjnë foljet *jam* dhe *tham*, si në rastin:

–*Thash* shtatë vjet n'njet burg qi jam kânë, / Drit'n e diellit askurr s'e kam pá...(Kënga 18, f. 142)

Aoristi sigmatik, përgjithësisht në materialin e studiuar del me zgjerim teme. Një nga këto forma është edhe ajo që e ka zgjeruar temën me tingullin antihiatizues **-v-**. Këtë aorist e formojnë foljet me temë në zanore (zgjedhimi i parë, klasa e parë). Në gjuhën e përdorur këto forma me **-v-** antihiatizuese dalin vetëm në vetën e parë e të dytë njëjës, si në rastet:

...Nâna e vet ká qitë e i ká thânë: / – Ç'se t'*martova*, bîr të *burgtova*... (Kënga 13, f. 109)

...– Qysh Halilin s'e *martove*? / Janë martue krejt moca e tij... (Kënga 4, f. 26)

Formë tjetër e aoristit sigmatik me zgjerim teme, është fjalëforma e zgjeruar me **-n-**, që tek Cikli i Kreshnikëve, si në të folmet e tjera geqe²⁴⁴, ruhet si e tillë pa u rotacizuar (si në toskërishte), psh: *bâni, hîni, msyni* etj. Kjo temë e zgjeruar del në të gjitha vetat e numrit njëjës.

...Mera i *hîni* Arnaut Osmanit, / Shpejt në ahër Muji ká rá... (Kënga 9, f. 75)

Aoristi tjetër me zgjerim teme është ai **-t/-jt**, të përfutur gjatë evolucionit historik të shqipes²⁴⁵, që tek Cikli i Kreshnikëve e ndeshim kryesisht te folja e tipit: *gjet/gjete*, si, p.sh.:

²⁴¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., f.778.

²⁴² Po aty, "Aoristi sigmatik është mbeturinë e një aoristi të lashtë indoevropian, që e gjejmë edhe në gjuhë të tjera të kësaj familjeje", f.778.

²⁴³ S. Riza, *Sistemi foljor*..., vep. e cit., theksohet se "...qysh prej dëshmimit shkrimor më të hershëm, mbaresa sigmatike çfaqet vetëm në të parën vehtje njëjës të së kryemjes", f.237.

²⁴⁴ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., "...format vetore të numrit njëjës të së kryerës së thjeshtë *ban-a bër-a, hyn-a hyr-a* është në përputhje të plotë me kushtet e shfaqjes së dukurisë së rotacizmit, sepse *-n-*ja këtu është ndodhur midis dy zanoresh". f.791.

²⁴⁵ S. Riza, *Sistemi foljor*..., vep. e cit., f. 185; E. Likaj, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Lidhur me ndryshimet që kanë ndodhur në format foljore të së kryerës së thjeshtë të foljeve të ndryshme, E. Likaj vë në dukje: "Analogjia në tërë sistemin e formave të së kryerës së thjeshtë ka shkakuar ndryshime në dy drejtime themelore: nga një anë e ka diferencuar temën e së kryerës së thjeshtë nga ajo e së tanishmes, nga ana tjetër, temën e vetë kësaj forme e ka bërë më të rregullt", Tiranë, 1997, f.114. *Dallohen edhe disa dukuri të tjera fonetike të së kryerës së thjeshtë, si:*

-Ndërrimi i **-a:-o-** dhe **-ie-/-je:- o** në të gjitha vetat e kësaj kohe në foljet e zgjedhimit të dytë, tipi: *marr: mora, djeg: dogja* etj.

-Qiellzorizimi i **-k:-q-** dhe **-q:-gj-** në të gjitha vetat e kësaj kohe te foljet e zgjedhimit të dytë, tipi: *djeg: dogja*.

-Ndërrimi **-rr:-r-** në të gjitha vetat e kësaj kohe te foljet e zgjedhimit të dytë, tipi: *marr: mora*.

-Ndërrimi **-e:-i-** në të gjitha vetat e kësaj kohe te foljet e zgjedhimit të dytë, tipi: *qes: qita*.

Në foljet e zgjedhimit të tretë gjejmë të përdorur shpesh zanoren *-u-* të theksuar të temës së pazbërthyer në togun zanor *-ue-*, tipi: *xû*.

- Dalin me zanore hundore të gjatë disa folje të zgjedhimit të parë dhe zgjerojnë temën e së kryerës së thjeshtë me *-n* duke marrë mbaresat **-a, -e, -i** (*bâna, bâne, bâni/ hîna, hîni*).

-Zbërthimi i zanoreve të theksuara *-o-* dhe *-e-* përkatësisht në *-ue-* dhe *-ye-* në tri vetat e shumësit për foljet e zgjedhimit të parë, si: *bashkuen, shkruen, shkuen*, etj.

-Zbërthimi i zanores së theksuar *-o-* në *-ue-*, kur gjindet para bashkëtingëlloreve *r, rr, l, ll* në *-ue-* në vetën e tretë njëjës dhe në tri vetat e shumësit te foljet e zgjedhimit të dytë, si: *muer, duel*.

...Treqind krushqt pá nuse janë vojtë. / Kângë e gjeta e kângë e kndova... (Kënga 20, f. 157)
Materialin e skeduar me format e vjela për kohën e kryer të thjeshtë, në ndryshim nga koha e tashme dhe e pakryer e dëftores, e kemi paraqitur sipas zgjedhimeve dhe foljeve të parregullta në vetat e njëjësit dhe shumësit, për arsye se disa veta dalin në raste të izoluara e në ndonjë rast nuk kemi gjetur trajta për ndonjë vetë të caktuar., kurse në një grup më vete kemi marrë foljet e të ashtuquajturit zgjedhim në *-mi*. Më gjerësisht po i trajtojmë me radhë format e së kryerës së thjeshtë.

Zgjedhimi vepror

Foljet e **zgjedhimit të parë** në kohën e kryer të thjeshtë në zgjedhimin vepror dalin me këto mbaresa:

Veta e parë njëjës	-(v)a/(-jt)a
Veta e dytë “	-e
Veta e tretë “	-i/-ni/ -u / zero
Veta e parë shumës	-me
Veta e dytë “	- t
Veta e tretë “	-n

Veta e parë njëjës në foljet e këtij zgjedhimi del e ndërtuar me mbaresën **-a** në foljet, si: *bâna, gjeta, hîna*; del edhe me dy variante të tjera:

a. me **-(v)a**: *burgtova*²⁴⁶, *ljeva, kërkova, kndova, martova, mjerova, ndjeva, punova, pajtova, punova, shkjeva, shkova, shkurtova, verova* etj.

Po e ilustruam me shembuj:

...Edhe un bé u *bâna* tridhetë kapidanave, / E kam ardhë n’mejdán me t’dalë..(Kënga 12, f. 105)

...E borxh krajlit i *hîna*, / Djalín e vogël rob m’a muer... (Kënga 12, f. 106)

...M’u kan dhimtë e jam hudhë me i pajtue, / I *pajtova* e sa grima n’gjumë i kam vdue...(Kënga 7, f. 64)

b. me zgjerim teme me **-(j)ta**: *luejta, mbajta*, si në vargjet:

...Mos me m’ardhë marrja e Jutbinës, / Tybe n’Zotin kâmbën nuk e *luejta*...(Kënga 4, f. 38)

Veta e dytë njëjës del e ndërtuar me mbaresën **-e**: *bâne, çove, harrove, martove, ndjeve / ndigjove, pshtove, shkove, shnjzove, vonove* etj. Siç edhe shihet, nga pasqyra e mësipërme foljet e këtij zgjedhimi, ashtu si në shqipen standarde, në këtë vetë dhe në vetën e dytë njëjës, në pjesën më të madhe të rasteve, e zgjerojnë temën me **-v-** antihiatizuese ose e zgjerojnë temën, siç edhe e theksuam me **-n-**.

Po ilustruam me shembuj:

...Mirë po i flet nâna e motnueme: / – Po ti ç’*bâne*, more bír? ... (Kënga 4, f. 29)

...Si m’*shnjzove* kshtú, Tanushë, mjerë baba! / Qysh me ndëjë me cuba të Jutbinës? ... (Kënga 4, f. 37)

...Sa me t’ambël gjogun po m’a merr: / A nuk *ndjeve*, gjog, shka foli Tali?... (Kënga 23, f. 181)

- Foljet e zgjedhimit të tretë si folje që dalin me temë në zanore, e zgjerojnë temën me fundoren **-n-** ose prapashtesën **-jt-** (si foljet e zgjedhimit të parë, *dijta*).

-Temat e foljeve të parregullta në të kryerën e thjeshtë, në CK paraqiten si supletive dhe josupletive.

²⁴⁶ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., "fus dikë në burg; burgos", f.132.

Veta e tretë njëjës

Kjo vetë është shumë e larmishme me mbaresa. Në këngë të ndryshme na dalin mbaresa jo të njëjta për këtë vetë. Tri janë mbaresat kryesore, të cilat po i shohim më gjerësisht më poshtë. Na del me mbaresat: **-i, -ni, -u, zero**.

1. Formanti **-i**, si: *bumbulloi, çoi, faroi, kaloi, kallxoi, këndoi, kërkoi, kujtoi, mbaroi, mbërthei, mendoi, ndigjoi, ndriti, punoi, pushoi, pshtoi, rrenoi, shkoi, shkurtoi, shiloi, shterngoi, tradhtoi, thermoi, verboi, vndoi, vonoi* etj.

Po marrim disa shembuj konkret nga CK:*

...Sá fort dorën m'a *shtërngoi!* / Copë e grime mue m'a *thermoi*... (Kënga 2, f. 13)

...Nja ka nja ushtrín ai i a *faroi*²⁴⁷, / E n'saraj krajlit i rá... (Kënga 8, f. 68)

...*Hinglloi* gjogu, - bumbulloi tânë logu. / Kaq të bukur Zoti m'a kisht' falë..(Kënga 23, f. 177)

...N'petë t' sylahit e *vndoi* me fjetë. / Qatëherë grueja trí shùjtë i ká gatue... (Kënga 29, f. 219)

2. Formanti **-ni**. Ashtu si në vetën e parë dhe të dytë njëjës të së kryerës së thjeshtë edhe në vetën e tretë tema del e zgjeruar me **-ni**. Me këtë formant dalin foljet, si: *bâni, hîni, mêni, mrrîni, msyni, ndrýni*.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...Si s'i *mêni*²⁴⁸ plaku kurkund fjalët! / N' pope t' kullës Halili te' e ká hype...(Kënga 2, f. 18)

...Kqyr shka *bâni* Gjeto Basho Muji! / T'tânë për darkë Muji i ká ndalë... (Kënga 4, f. 26)

...Për mbas vedit derën e *ndrýni*, / E n'shpinë t'kalit me vrap hypi... (Kënga 9, f. 71)

...I a *mrrîni* Hyso Radoica: / – Mirë se t'gjêj, o Arnaut Osmani! ... (Kënga 12, f. 103)

3. Formantin **-u** ashtu si në shqipen standarde e ndeshim të përdorur vetëm te foljet që dalin me temë në zanoret **-e** ose **-a**, si: *lau, ndjeu, shtjeu, kjau* etj:

...T'madhe qeshi Arnaut Osmani, / Mirë m'a *ndjeu* Krajlo Kapidani / Dorën n' xhep e *shtjeu*...(Kënga 9, f. 75)

...E t' tânë e *lau* dushkun me gjak, / E na muer një dushk të gjânë... (Kënga 12, f. 101)

...Qatëherë çika, tha, meç ká dalë, / *Kjau* e briti ditë e natë... (Kënga 27, f. 214)

4. Me mbaresën **zero**. Këto forma sipas Sh. Demiraj janë "...forma tek të cilat mbaresa **-ë**, përmes kthimit **-i** : **-ë**, ka rënë nën ndikimin e përgjithshëm të gegërishtes në krahasim me format e sotme të shqipes standard që janë arkaike"²⁴⁹ dhe sipas dialektologëve ruhen edhe nga shumica e të folmeve geqe.²⁵⁰ Në studimin e Këngëve Kreshnike më këtë trajtë na ka dalë vetëm folja, *gjet* në një rast të vetëm, si:

...Tridhetë çika tu çezmja na i *gjet*. / – Mirë se u gjêj, mori tridhetë çika!... (Kënga 12, f. 99)²⁵¹

Lidhur me format foljore të zgjedhimit të parë në numrin shumë të kemi ndeshur një përdorim më të kufizuar të foljeve në krahasim me përdorimet foljore të vetës së parë në numrin njëjës.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...Synin krajlit i a *verboi*, / Krahin krajlit i a *shkurtoi*, / Rrash me tokë kullat i a *rrenoi*, / Dymbedhetë Agët trimi i *pshtoi*...(Kënga 16, f.134); ...Shum kan vrá, rob i kan xânë, / Kurrnji mâ n'Kralní nuk *shkoi* gjallë...(Kënga 34, f.240)

²⁴⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit., folja ka kuptimin "me u shue terësisht me kulm e themel; me i u shkimë fara përgjithmonë", f.141.

²⁴⁸ Po aty, folja del me kuptimin "me prâ; me pushue; mos me u dëgjue mâ hurma që vazhdonte deri në atë kohë", f.166.

²⁴⁹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit.,(1986), f.682.

²⁵⁰ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tekste për shkollat e larta, Tiranë, 1975, f. 144; R. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës* DSH VI, Tiranë, 1990, f.224.

²⁵¹ Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., "...disa folje të parregullta , si: zu "zuri", pru "pruri", pat, "pati", vojt "vajti", nejt "ndejt", bashkë me to edhe ndonjë folje tjetër, si *mbet* ose *met* "*mbeti*" *gjet* "*gjeti*", dalin pa mbaresë vetore në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë", f.230.; A. Haxhi, *Proza e Fishtës*..., vep. e cit., këtë folje e jep pa mbaresë, si në shembujt: ...e *gjet* Qeverien e Lezhës...(HD, 1914, f.69); ...*gjet* aq energji...(HD, 1932, f.305), f.88; R. Mulaku, *Sistemi foljor*..., vep. e cit., Bogdani... – mb' udhë gjet disa shërbëtorë (II, 54), f.54.

Numri shumë

Veta e parë shumë del e ndërtuar me mbaresën **-me**. Kjo mbaresë është karakteristike për gegërishten veriperëndimore²⁵² dhe nga materiali i vjelë na ka dalë vetëm folja, *dame*, si në shembullin:

...Zoti t'vraftë, bre Dizdar Osman aga! / Nen ket diell na çetat nuk i *dame!*... (Kënga 6, f. 53)

Në CK **veta e dytë shumë** del në pak raste. Kjo vetë del e ndërtuar për zgjedhimin e parë me mbaresën **-t**, me foljet, si: *bat, msuet, lshuet, ndigjuet/ndigiuet* etj.

Nga CK po marrim vargjet:

...Brevë e gjarpën paçi motër e vllá! / Pikët ndër shtroje kaq shpejt qysh m'i *lshuet!*...(Kënga 4, f. 44)

...A *ndigjuet* agët e Jutbinës? / Bunin, vedit me i a gjetë!... (Kënga 6, f. 52)

...Si s'm'a *msuet* mue një kopilí, / Si të dalim prej ktij burgut të zí... (Kënga 16, f. 131)

Siç edhe vërehet, nga të gjithë shembujt që kemi ilustruar, foljet që dalin me temë **-o-** në vetën e parë dhe të dytë të shumësit e zbërthejnë në **-ue-**²⁵³ duke ruajtur mbaresën **-t**. Në të gjitha rastet te këto trajta me sa duket ka ndikuar prirja e përgjithshme e gegërishtes për mënjanimin e **-ë-** së fundore.

Veta e tretë shumë del e ndërtuar me mbaresën **-n**. Këtë variant e marrin ato folje që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në një zanore të gjatë ose në tog zanor duke diftonguar shpesh zanoren e temës. Në materialin e studiuar në CK dalin pak trajta, si: *bashkuen, kulluen, prozhmuen, shkruen, shkuen* etj.*

...“Prap shumë letra çobajt *shkruen*, / T'tâna Mujit n'dorë i *shkuen*”... (Kënga 9, f. 78)

...E m'*prozhmuen*²⁵⁴ tridhetë kapidana: / Pse rrin, ti Hyso, pá u martue?... (Kënga 12, f. 105)

...Atëherë krajli një letër e *shkruen*, / Fíll n'dorë t'nuses i a ká çue... (Kënga 13, f. 112)

Foljet e **zgjedhimit të dytë** sipas vetave dalin me këto mbaresa:

Veta e parë njëjës	:	-a/zero
Veta e dytë “	:	-e
Veta e tretë “	:	-i/-u/zero/-ë
Veta e parë shumë	:	—
Veta e dytë “	:	-të
Veta e tretë “	:	-ën/-en/-ne

Veta e parë njëjës e kohës së kryer të thjeshtë për zgjedhimin e dytë del e ndërtuar me mbaresën **-a** dhe me mbaresën **zero**:

1. Me mbaresën **-a** na kanë dalë këto folje, si: *dogja, hasa, mbylla, mora, munda, ndesha, plasa, qita, shndosha, vrava, vozita* etj. Kështu i përdorin këto folje në vetën e parë njëjës të aoristit të gjithë shkrimtarët e vjetër të Veriut.²⁵⁵

Po japim shembuj nga CK:

²⁵² B. Beci, *Grupi perëndimor i nëndialektit...*, vep. e cit., f.137; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, DSH II, Tiranë, 1974, f.385; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, Tiranë, 1975, DSH III, f.54.

²⁵³ E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF/3,1964, f.127.

*Në zgjedhimin e parë na del vetëm një folje me formantin **-në**, si në shembullin e marrë nga CK: ...E shumë livadit janë sjellë, / Bytyn lavër livadin e *bânë*...(Kënga 12, f.103)

²⁵⁴ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., folja **prozhmoj** del me kuptimin "flas keq për dikë pas shpine". Fjalë krahinore e gegërishtes me burim të paqartë, f.1193. Me këtë kuptim duket se del edhe në shembullin e cituar.

²⁵⁵ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.54.

...Kah mjerova gjithkund shpi e n'shpi, / Kerkund s'ndesha m'Gjergj Alez Ali!...(Kënga 5, f. 48)

...Mora vesht se nana më ká dekë, / S'ká kush nânën m'a shtje n'dhé... (Kënga 13, f.113)

...Nuri, krajl, un të dy i dogja, / Si zánat qi luftat i ká pasë... (Kënga 16, f.131)

2. Me mbaresë **zero** na ka dalë foljen *duel*, e cila del me togun zanor *-ue*²⁵⁶, shembullin e kemi ilustruar gjatë trajtimit të formave që e formojnë vetën e tretë njëjës me mbaresa të ndryshme. **Veta e dytë njëjës** del e ndërtuar me mbaresën **-e**, si: *dole, dogje, fike, fole, kape, korite, more, ndale, preke, merzite, mushe, preve*.

Po marrim shembujt nga CK:

...Fike vedin – fike mue! / Po, a t'kan plasun syt e ballit?... (Kënga 6, f. 53)

...As te dajat, bír, nuk *dole*, / Miqt e babës ti i harrove... (Kënga 13, f. 109)

...Mirë se kullat ti m'i dogje. / Mirë se mallin ti m'a *more*... (Kënga 16, f. 131)

Veta e tretë njëjës del e ndërtuar me disa mbaresa. Në këngë të ndryshme të CK na dalin mbaresa jo të njëjta për këtë vetë. Tri janë mbaresat kryesore, të cilat po i shohim më gjerësisht më poshtë. Kjo vetë na del me mbaresat: **-i, -u, zero**.

1. Me mbaresën **-i** në CK dalin foljet, si: *briti, çili, çarti, êndi, doli, dridhi, foli, grabiti, hupi, hypi, kapi, koriti, kputi, lidhi, lypi, mbledhi, mbylli, mbyti, mundi, ndali, ndezi, ndodhi, ndriti, qeshi, qiti, paditi, priti, thirri* etj. Këto trajta kanë një përdorim të shpeshtë në materialin e studiuar.

Kemi shkëputur disa vargje nga CK:*

...Shpejt m'a *êndi* 'i pëlhurë t'gjânë e t'gjatë! / E i ka veshun majet rreth e rrotull.(Kënga 4, f. 25)

...Ká rá dielli nëpër maje: / *Hupi* çeta përmbas malit... (Kënga 6, f. 54)

...Po të kujin krye more Llabutan m'ké pré? / Qi né çikën Muji na *grabiti*... (Kënga 23, f.182)

2. Me mbaresën **-u** (të cilën e marrin foljet që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në zanoret **-e** dhe **-a** si në shqipen standarde)²⁵⁷: *preu, vrau*, si në vargjet:

...Qi mue Radi – vllán m'a ká fikun, / E m'a *preu* Gjeto Basho Mujin"... (Kënga 19, f. 151)

...Jabanxhija krajlín na e *preu*, / Pá gjâ n'dorë né po na lën!... (Kënga 24, f. 193)

3. Me mbaresë **zero**. Kjo mbaresë është karakteristike për shumicën e të fomeve të gegërishtes dhe shumë të folme kalimtare.²⁵⁸ Nuk përjashtohet mundësia që këto forma pa mbaresë vetore të jenë mbeturina nga ajo periudhë e zhvillimit të shqipes, kur mbaresa e hershme e vetës së tretë kishte rënë.²⁵⁹ Gjatë materialit të studiuar të CK na kanë dalë pak trajta, ku diftongimi bjerr zanoren, si: *dogj, duel, mbet, muer*²⁶⁰ etj.

Po ilustruam me vargje disa nga këto raste:

...E prej trëmet, gjumi m'*duel*! / Me 'i herë çikat kênkan shkepë... (Kënga 4, f. 32)

...E tu kroni Mujin nesër e gjê! / Nusja *muer* ashtën e fell... (Kënga 1, f. 6)

²⁵⁶ Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., Pothuaj shumica e të folmeve të gegërishtes dhe shumë të folme kalimtare disa kategori foljesh i kanë pa mbaresë vetore në formën e vetës së tretë njëjës. Kategorinë e parë e formojnë ato folje që e bëjnë të kryerën e thjeshtë me apofoni dhe që u mbaron tema me bashkëtingëllore lëngëzore (*dal-dola, marr-mora, mbjell-mbolla*). Folje të këtilla në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë dallohen vetëm prej ndërrimit të zanores e të temës në togzanor *ue* ose në *u* (*ue*): *duel* ose *dul*, “ *doli*”, f.230.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...Krajlí Hyson çoi e e *thirri*, / Edhe t'madhe Hysit i briti...(Kënga 12, f.101); ...Qi:- Kurrkúj derën nuk i a *çili*, / Për pá ardhë Alija êm bír... (Kënga 13, f.109); ...Lik për mjet qirin e kputi, / E kerkund flakën qirit s'ia *dridhi*...(Kënga 22, f.173)

²⁵⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.288.

²⁵⁸ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.230

²⁵⁹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., "Nuk përjashtohet mundësia që këto forma pa mbaresë vetore të jenë mbeturina nga ajo periudhë e zhvillimit të shqipes, kur mbaresa e hershme e vetës së tretë kishte rënë. (1986), f. 93.

²⁶⁰ B. Demiraj, *Gjon P.Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, vep. e cit., folja *muer* del si paradigmë foljore sintetike, Prishtinë, 2006, f.235.

Kështu, siç edhe vërehet nga shembujt e ilustruar, foljet e mësipërme, në ndryshim nga gjuha standarde që vetën e tretë të njëjësit të së kryerës së thjeshtë e formojnë me mbaresën *-i*, në CK këto forma dalin pa mbaresë.

Krahaso:

a... Për mustakut i ká vjerrë n' mollë t'shalës, / Tjetra anë mustakut i *mbet* zharg. (Kënga 6, f. 61)

b... Edhë të tânë shehrin e *dogj*, / Djalin e vogël rob m'a *muer*... (Kënga 12, f. 106)

Siç vërehet edhe nga shembujt e dhënë, në përdorimin e mbaresave dhe trajtave në përgjithësi, gjuha e CK paraqet variacione. Në këtë material e njëjta folje del në të njëjtën vetë në trajta të ndryshme, si: *doli* / *duel* etj.

Po ilustrujmë me shembuj përkatës këto raste.

Krahaso:

... "Marshalla Akuna *foli* / E prej burgut edhe **doli**"... (Kënga 9, f. 71)

... E prej trëmet, gjumi m' **duel!** / Me 'i herë çikat kênkan shkepë... (Kënga 4, f. 32)

4. Me mbaresën **-ë**, e cila ndeshet e përdorur shumë rrallë, vetëm me foljen që del me temë në bashkëtingëllore, *mbetë*. Për studiuesin A. Haxhi te "Proza e Fishtës në pamje gjuhësore", kjo mbaresë mund të jetë një ndikim analogjik nga shumësi i së kryerës së thjeshtë, ku **-ë** historikisht është zanore mbështetëse (*gjet-ë-m ~ gjet-ë-t ~ gjet-ë-n: gjete*),²⁶¹ argumentim që përshatet edhe me shembullin e shkëputur nga CK:

... Ka xjerrë Muji vllán e vet! / Muer Halili i vashë *mbetë* shkret!... (Kënga 4, f. 41)

Numri shumës

Veta e parë shumës në CK nuk del me asnjë shembull.

Veta e dytë shumës ndërtohet me anën e mbaresës **-të**²⁶², të cilën e kemi ndeshur vetëm me trajtën, *mujtë*, si në vargjet:

... "A *mujtë*, burra?, – kan thânë: / "Mjaft kadalë, – burrat i ki'n përgjegjë. (Kënga 23, f. 181)

Veta e tretë shumës del e ndërtuar:

1. Me mbaresën **-ën** (si në shqipen standarde)²⁶³ del e përdorur vetëm në një rast me foljen, *qitën*. Për arsye se gjatë studimit të materialit të CK, kjo folje identifikohet vetëm në një rast, shembullin e kemi ilustruar më poshtë, me qëllimin për të krahasuar trajtat e ndryshme foljore.

a. Me variantin **-en**. Variantet e kësaj mbaresë janë karakteristike për gegërishten veriperëndimore.²⁶⁴ Këtë variant te Këngët Kreshnike e marrin ato folje që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në bashkëtingëllore, si: *folen*, *qiten* etj.

Po ilustrujmë me shembull:

... Atëherë *folen* tridhetë kapidana: / – Ktu â katundi i Ali Bajraktarit... (Kënga 14, f. 122)

b. Me variantin **-ne** (si rast metateze) kemi ndeshur vetëm foljen, *qitne*, në një rast të vetëm, të cilin e kemi dhënë më poshtë për krahasimin e trajtave të vetës së tretë të numrit shumës të së kryerës së thjeshtë.

Nga CK po ilustrujmë disa vargje:

... Jashtë e *qitën*, krajli m'a ká pá, / Por sá kopil krajli ishte kânë... (Kënga 16, f. 133)

²⁶¹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.89.

²⁶² J. Rrota, *Gjuha e shkrueme...*, vep. e cit., Në shumës foljet ruajnë mbaresat e para të së kryerës së thjeshtë, *-më*, *-të*, *-në*. Edhe në rastet kur tema e foljes mbaron më *-t*, në vetën II sh. kësaj i shtohet mbarësia *-të*, duke dhënë këto forma: *mujttë*, *trëttë*, *gjettë*, f.397.

²⁶³ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.289.

²⁶⁴ B. Beci, *Grupi perëndimor...*, pun. i cit., f.137; Gj. Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, DSH II, Tiranë, 1974, f.385; Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, Tiranë, 1975, DSH III, f.54.

...Kúr ia *qiten* syretin e Halilit, / Atëherë drita i u turbullue... (Kënga 29, f. 220)

Me foljet që na kanë dalë në të kryerën e thjeshtë jemi munduar të bëjmë një klasifikim të mbaresave të **zgjedhimit të tretë**:

Veta e parë njëjës	:	-a
Veta e dytë “	:	-e
Veta e tretë “	:	zero

Veta e parë njëjës e zgjedhimit të tretë në CK del e ndërtuar me mbaresën **-a**. Gjatë studimit të materialit kemi gjetur vetëm foljen *dijta*, e cila mendojmë se del me zgjerim teme në analogji me kohën e tashme të dëftores të foljes *dij*. Por, në ndryshim nga veta e parë e kohës së tashme të dëftores, e cila del me dy trajta *di* / *dij*, në vetën e parë të së kryerës së thjeshtë kjo folje del vetëm me trajtën e zgjeruar, *dijta*, si në shembullin e vjelë nga CK:

...Kurr ‘i grosh s’kam mujtë me i shitë; / “Çajren vedit për ta s’*dijta*”... (Kënga 16, f. 131)

Veta e dytë njëjës e foljeve të këtij zgjedhimi na del me një përdorim shumë të kufizuar.

Në materialin e studiuar të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur vetëm një rast, foljen e zgjedhimit të tretë, *xûne*, e cila del me temë të zgjeruar me **-n-**, si në rastin:

...”Pa a ti Mujë, né dhít na i *xûne*?”/ “Po ún vetë dhít jau ko’ *xânë*!”... (Kënga 1, f. 8)

Veta e tretë njëjës e foljeve të zgjedhimit të tretë del e ndërtuar me mbaresën **zero** vetëm me foljen, *xû*, si, p.sh.:

...T’kjosim falë, o i madhi Zot! / Sa shpejt diellin m’a *xû* reja!... (Kënga 4, f. 25)

Veta e tretë njëjës e këtyre foljeve përdoret kështu me mbaresë zero edhe në shumicën e të folmeve të gegërishtes.²⁶⁵

Në CK paradigmën foljore të zgjedhimit të tretë për tri vetat e shumës nuk na dalin asnjëherë.

Foljet e **parregullta** dalin me këto mbaresa:

Veta e parë njëjës	:	-a/-sh²⁶⁶/-ë
Veta e dytë “	:	-e
Veta e tretë “	:	-i/-u/-ë/zero
Veta e parë shumës	:	–
Veta e dytë “	:	-t
Veta e tretë “	:	-në/-ën

Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike dalin disa forma supletive, me një përdorim relativisht të kufizuar, të cilat mendohet se janë të trashëguara nga një fazë e hershme i.e dhe se "...vetë supletivizmi është një dukuri arkaike e trashëguar".²⁶⁷ Nga nëntë folje supletive që janë gjithsej në gjuhën shqipe, ne kemi ndeshur shtatë trajta, të cilat dalin me tema të ndryshme në të tashmen e në të kryerën e thjeshtë, si: *jam* ~ *kjeçë*, *kam* ~ *pata/paçë*, *bie* ~ *rash* (e cila del si folje supletive e trashëguar)²⁶⁸, *jap* ~ *dhaçë*, *rrî* ~ *ndêja*, *vij* ~ *erdha*, *shoh* ~ *pashë* (në CK dalin vetëm format e vetës së dytë dhe të tretë, si: *pave*, *pa*). Nga foljet e parregullta josupletive na kanë dalë tre trajta (nga pesë që janë gjithsej): *them* ~ *thash*, (e cila del si trajtë dialektore, pa -

²⁶⁵ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, vep. e cit., f.144.

²⁶⁶ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep. e cit... Gjatë trajtimit të së kryerës së thjeshtë, gjuhëtari Topalli pohon se: "Prapashtesa **-sh**, me të cilën ndërtohet forma e aoristit sigmatik dhe format e mënyrës dëshirore (khs.*qeshë*, *pashë*; *hapsha*, *qofsha* etj.), është e trashëguar dhe është vijuese e prapashtesës së aoristit dhe e futurit sigmatik", f.717.

²⁶⁷ Shih: Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.781.

²⁶⁸ Po aty, f.781.

ë fundore)) *due ~ desha, lâ ~ laçë* (e cila në të kryerën e ruan të pandryshuar temën e foljes, si në të tashmen).

Veta e parë njëjës e foljeve në shqyrtim na ka dalë e ndërtuar me mbaresat si më poshtë:

1. Me mbaresën **-sh**²⁶⁹ (në zanafillë prapashtesë temëformuese) në CK del e ndërtuar vetëm folja e parregullt, *rash*.²⁷⁰ Me sa duket edhe këtu ka vepruar prirja e përgjithshme e gegërishtes për zhdukjen e **-ë-së** në pozicione fundore, e cila në këtë rast përkon me mbaresën e mirëfilltë të vetës së parë (**-ë** mbaresë arkaike, refleksi i **-a**)²⁷¹:

...Në kuvend me krajla atëherë *râsh*, / E m'prozhmuen tridhetë kapidana... (Kënga 12, f. 105)

2. Me mbaresën **-a** karakteristike për gegërishten veriperëndimore dalin foljet: *deshta*²⁷², *ndêja*, si në rastet:

...*Ndêja* kuk, si natën e vorrit, / E n'krahinë cok s'u martova... (Kënga 4, f. 28)

...Atëherë briti Arnaut Osmani: / – *Deshta* pak me t'lânë me pushue... (Kënga 12, f. 103)

E kryera e thjeshtë të të gjithë autorët veriorë ka bashkëtingëlloren **-sh**, të cilën disa studiues e mendojnë si mbaresë të aoristit sigmatik të shtrirë në të gjitha vetat e kësaj forme kohore, kurse disa të tjerë e marrin si pjesë organike të temës së foljes.²⁷³ Por, ne gjatë studimit të Këngëve Kreshnike këtë mbaresë e kemi ndeshur vetëm në vetën e parë të njëjësit, siç edhe e trajtuam më sipër.

3. Me mbaresën **-ë** kemi ndeshur vetëm foljet: *dhaçë*, *laçë*.

Për ilustrim kemi shkëputur vargjet nga CK:

...Alá shpirti s'm'i ká dalë, / M'lypi uj e nuk i a *dhaçë*... (Kënga 27, f. 212)

...E tetë Omera ndër jú t'dekun i *laçë*, / Dushk as bár, ndër jú, kurr mos daltë... (Kënga 29, f. 222)

Veta e dytë njëjës merr mbaresën **-e**, si: *deshte*, *erdhe*, *lé*²⁷⁴, *pave*, etj. Për foljen *shoh* kemi ndeshur vetëm trajtën *pave*.

Po japim shembujt e vjelë nga CK:

...Aman, Bani, dajën mos me e pré, / Se tjetër dajë kurr mâ nuk m' *lé* ... (Kënga 15, f. 127)

...E te krajli ai vetun qi po shkon, / Mirë se *erdhe*! krajli i paska thânë... (Kënga 19, f. 152)

...– Pash një Zot, harushë, qi t'ká dhânë, / – A m'a *pave* Agën Hasap Agë?... (Kënga 27, f. 214)

...Jam bí krajlit un, po ti çfarë *deshte* ? / – Për një borxh, mori vashë, un ktu kam ardhë!... (Kënga 23, f. 182)

Sipas J. Rrotës: "Ata verba të kësaj kategorie, të cilët kanë në rranjë një a, tue marë në vetën e dytë nj. si dezinencë një -e, përbâjn me të kështu një diftong sekondár: unë dhashë, ti dhae; un pashë, ti pae; unë thashë, ti thae. -Në vetën e tretë nj, dalin e shumta në tingëll të shkurtë e të theksuem. Kështu: ai *dha*, *tha*, *pat*, *qe*, *la*".²⁷⁵ Edhe shembulli i vjelë nga CK e vërteton këtë gjë:

²⁶⁹Po aty, f.786.

²⁷⁰K. Topalli, *Sistemi foljor*..., vep. e cit. ...Në të kryerën e thjeshtë, folja *lë* zgjedhohet sipas paradigmës së foljeve të aoristit sigmatik duke marrë në vetën I mbaresën *-shë* dhe në vetën e dytë mbaresën *-e*, që i ngjitet drejtpërdrejt temës së foljes (*lashë-lae > le*). Kjo paradigëm, ku bëjnë pjesë edhe disa folje të tjera, si: *dhashë ~ dhae*, *pashë ~ pae*, *thashë ~ thae*, është më e vjetër se ajo e foljeve *shkova*, *theve*, *lava* për arsye se ajo është formuar para se të formohej tingulli -v- për të shmangur hiatin, f.418.

²⁷¹A. Haxhi, *Proza e Fishtës*..., vep. e cit., f.85.

²⁷²G. Mikeli, *Gramatika* ..., vep. e cit., Ajo del me format: *deshta*, *deshte*, *desht*, *deshtme*, *deshtë*, *deshtne*, f.115.

²⁷³R. Mulaku, *Sistemi foljor*..., vep. e cit., f.57.

²⁷⁴Po aty. Në të kryerën e thjeshtë kjo folje zgjedhohet sipas foljeve të tipit sigmatik: *lashë*, *lae*, *la*, *lámë*, *lâtë*, *lane*., f.52.

²⁷⁵J. Rrota, *Gjuha e shkrueme*..., vep. e cit., f.388; Te disa folje të parregullta aoristi sigmatik në vetën e dytë njëjës del me trajtat: *dhae*, *lae*. Me *ae* autorët kanë shënuar fonemën /æ/ të gegërishtes veriperëndimore, e cila ka dalë nga kontraksioni i grupit *ae*. (Shih: J.Gjinari, *Dialektet e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1989, f.119).

...Gjokun djalit, që s’i a *dhae*²⁷⁶? Rrezik djali me bâ me e pasë... (Kënga 4, f. 29)
Lidhur më këto forma gjuhëtari B.Bokshi shënon: "Nuk është i qëndrueshëm mendimi se **-ae** ka kaluar në **-e**, ngase është theksuar zanorja **e** e këtij togu zanor, sepse nuk shihet mundësia që kjo zanore të ketë qenë e theksuar, që të kemi jo kontrasion, por rënie të zanores **-a**, pra për shkak të theksimit të **-a-së**, të kishim pasur **-ae > -a** dhe jo siç ndodh **-ae > -ë** [pae >pe, thae > the, rae > re etj.]".²⁷⁷ Këto forma i ndeshim rrallë në material. Na kanë dalë vetëm format: *dhae, lae*.

Për ilustrim po marrim shembullin:

...– Nuk po m’ lën një ah me e pá. / Amanet pse i *lae*²⁷⁸ m’u djerrë?... (Kënga 30, f. 226)

Veta e tretë njëjës na del me një larmi mbaresash. Nga shembujt e vjelë kemi vënë re se në këngë të ndryshme dalin mbaresa të ndryshme në këtë vetë. Katër janë mbaresat kryesore, të cilat po i shohim më gjerësisht më poshtë. Kjo vetë na del me mbaresat: **-i, -u, -ë, zero**.

1. Me formantin **-i**, na vërtetohen pak raste me foljet: *desht-i, ndê-i*, si në shembujt:

..."*Deshti* Zoti, gjogu më ká pshtue, / Dér n’ saraj nuk dij se si m’ká prû..." (Kënga 23, f. 178)

...*Ndêi* trí dit e s’paska ardhë, / *Ndêi* trí net e nuk çoi fjalë... (Kënga 27, f. 211)

2. Me formantin **-u** na del vetëm folja *pau*, si në rastin:

...A s’e *pau* mâ njeri i gjallë, / Kshtu vetë’kan thânë, se atje nuk jam kânë.(Kënga 27, f. 214)

3. Me formantin **-ë** në vetën e tretë njëjës na del vetëm folja, *vojtë*²⁷⁹ (shkoi). Gjatë studimit të gjuhës së Fishtës, A. Haxhi mendon se: "Kjo mbaresë mund të jetë një ndikim i vetës së tretë të numrit shumës të së kryerës së thjeshtë, ku **-ë** historikisht është zanore mbështetëse".²⁸⁰

Po ilustrojmë shembullin e vjelë:

...E për ‘gjatë fushën po e trupon, / E, *vojtë* tu çezmja e Jutbinës... (Kënga 12, f. 99)

4. Me formantin **zero**:²⁸¹ *desht, diq, erdh, la, pá, rá* etj.

Po japim vargjet nga CK:*

...Zâna e madhe sá fort qi po i lutet! / Voësa *rá* – dielli pa lé... (Kënga 6, f. 52)

...N’stom të lugut n’dy gjûjt *rá*, / Sá n’dy gjûjt gjogu ká pushue... (Kënga 10, f. 86)

...E *pá* at’ dushk shkrue me gjak, / E prej serit n’dorë e ká marrë... (Kënga 12, f. 101)

... Kur *erdh* dita e dielle, / Tânë kujdes herët nadje â çue... (Kënga 12, f. 102)

Numri shumës

Veta e parë shumës e këtyre foljeve në materialin e studiuar nuk na del me asnjë shembull.

Veta e dytë shumës del në pak raste. Vërtetohet në këtë vetë *folja e parregullt, lát*, e cila ndërtohet me formantin **-t**, si në vargjet:

...Ku e *lát* ndoren, more diell? / Ku e ké ndoren, mori hânë?... (Kënga 4, f. 40)

Veta e tretë shumës në CK del e ndërtuar:

²⁷⁶ G. Mikeli, *Gramatika ...*, vep. e cit. Në të kryerën e thjeshtë kjo folje ka format *dhaçë, dhae, dha, dhame, dhatë, dhane*, f.110.

²⁷⁷ B. Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010, f.233-234.

²⁷⁸ J. Rrota, *Gjuha e shkrueme...*, vep. e cit., Autori për foljen *lanë* jep këto trajta për aoristin: *lashë, lae, la, lámë, látë, lánë*, f.410.

²⁷⁹ I. D. Sheperi, *Gramatikë dhe sindaksa...*, vep. e cit., për pjesoren e foljes *vete* autori jep këto forma: *vatur, vajtur, (vojtë)*, f.120.

²⁸⁰ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., (*gjet-ë-m ~ gjet-ë-t ~ gjet-ë-n*), f.89.

²⁸¹ G. Mikeli, *Gramatika ...*, vep. e cit., vetën III njëjës të së kryerës së thjeshtë e jep pa mbaresë me foljet: *dinq, erdh, ndêj*, f.107, 110; Më gjerësisht shih: *Gramatikë...*, vep. e cit., K.Topalli, thekson: "...veta III numër njëjës, në një fazë të caktuar të zhvillimit të saj, pas rënies së mbaresave të vjetra, dilte pa mbaresë...", f.991.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...Me i dalë shpirti për gazep, / E m’a *la* dhetë dit e net...(Kënga 11, f.96); ... E gjâ n’dorë në nuk na *la*, / Yrysh bâni i madh e i vogël...(Kënga 24, f.194)

1. Me formantin **-në**, në Këngët Kreshnike na ka dalë vetëm folja e parregullt, *ranë*, si në shembullin e ilustruar:

...– O nuk janë, o krushq darsmorë, / Se ata paresh *ranë* n’lumë... (Kënga 4, f. 25)

2. Me formantin **-ën** del vetëm forma *vojtën*²⁸², si në rastin:

...Turr e vrap rrugën po m’a marrin. / N’derë t’konakut Mujit na i *vojtën*... (Kënga 23, f. 178)

Me shembujt që na kanë dalë për foljet e të ashtuquajturit zgjedhim në **-mi** në të kryerën e thjeshtë jemi munduar të krijojmë një skemë të mbaresave, por jo të gjitha vetat kanë dalë.

Veta e parë njëjës	:	pata/ paçë	kjeçë	thash
Veta e dytë “	:	pate	–	–
Veta e tretë “	:	pat	kje	tha
Veta e parë shumës	:	–	–	–
Veta e dytë “	:	–	–	–
Veta e tretë “	:	–	kênë	thânë

Me disa ndryshime të vogla të karakterit fonetik foljet **jam** e **tham** dalin në pamje sigmatike të së kryerës së thjeshtë të të folmeve geqe dhe të shqipes së sotme standard. Në temat e këtyre foljeve vërehen mjaft ngjashmëri.

Veta e parë njëjës del e ndërtuar:

a. Me formantin **-a** kemi ndeshur vetëm formën, *pata*, si në rastin:

...S’e kam lânë për parë, pse nuk *pata*, / S’e kam lânë për vashë, pse nu’ mund hasa... (Kënga 4, f. 27)

b. Me formantin **-sh/-çë** (**-ë** historikisht është mbaresë vetore, kurse **-sh/-ç-** prapashtesë temëformuese)²⁸³: *paçë*²⁸⁴, *kjeçë*, *thash*. Trajtat, *paçë*, *thash* i kemi ndeshur secilën vetëm në një rast:

...Hej medet – tha – mori bjeshkë, / Se tetë Omera t’mirë si i *paçë*... (Kënga 29, f. 222)

–*Thash* shtatë vjet n’njët burg qi jam kânë, / Drit’n e diellit askurr s’e kam pá. (Kënga 18, f. 142)

Lidhur me trajtën *kjeçë*, ajo na del si formë, por jo më vete. Në të gjitha rastet na del si pjesë përbërëse e së pakryerës analitike (*kjeçë tuj bâ*, *kjeçë tu’ lidhë*), të cilën e kemi trajtuar në kohën e pakryer të mënyrës dëftore.

Veta e dytë njëjës del vetëm me foljen *kam* e ndërtuar me mbaresën **-e**, trajta: *pate*, si në shembullin e dhënë:

...A thue s’*pate* me ngrânë me pí? / A t’lâ keq tý vllau, për veshë e mbathë?... (Kënga 5, f. 45)

Veta e tretë njëjës del me mbaresë **zero** me format: *pat*, *kje*, *tha*.

Po ilustrujmë me shembuj:

... *Tha* – te nâna djali kishte dalë: /- Bét në Zotin- *tha*- mori nânë... (Kënga 10, f. 85)

... Edhe s’*pat* paret me i a dhânë, / Për borxh krajli atëherë më ká marrë... (Kënga 12, f. 105)

...Ç’*kje* kjo gjâmë qi na rá n’ krajlí? / “Thonë se *kje* Halil Aga i rí“... (Kënga 23, f. 182)

Për formën *kjeçë* / *kje*, togu *kj* del që në veprat e Bogdanit. Mbeturina të së cilit ruhen ende sot në Malësi të Madhe dhe në të folmen e Rugovës: *kjeshë*, *kje*, *kje*, *kjemë kjetë*, *kjenë*.²⁸⁵

²⁸² Forma *vojtën* e ka zgjeruar temën në të kryerën e thjeshtë me **-t** dhe ka marrë mbaresën **-ën**.

²⁸³ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., (1986), f.786.

²⁸⁴ K. Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit., ...ndërtimi me mbaresën e aoristit sigmatik duket dytësor përkundrejt së kryerës së thjeshtë me mbaresën **-a**, që e kanë foljet e tjera (khs. *mata*, *gjeta*), dhe mund të jetë krijuar nën ndikimin e dy foljeve të tjera të zgjedhimit atematik që e ndërtojnë këtë formë kohore me mbaresën sigmatike (*qeshë*, *thashë*), f 926.

²⁸⁵ R.Mulaku, *Gjuha e shkrimeve*..., vep. e cit., f.425.

Veta e parë dhe e dytë shumë në këtë grup foljesh nuk na del në asnjë rast.

Veta e tretë shumë vërtetohet me foljet *jam* dhe *them*. Këto folje në këtë vetë marrin mbaresën **-në**. Ato dalin me trajtat: *thânë/than*.

Nga CK po marrim vargjet:

...Gjethi i ahit, *thânë* për tokë ká rá, / Mnera e madhe shkjet i ká marrë... (Kënga 30, f. 221)

...Se nuk ké kurrshka me u bâ! / Se ata m’ *than*: kém trí dhí t’egra... (Kënga 1, f. 7)

Zgjedhimi jovepror

Format gramatikore të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë në zgjedhimin **jovepror** zakonisht në CK ndërtohen mbi bazën e formave të veprorës, duke marrë para pjesëzën përemërore **u**. Ata kanë një përdorim relativisht të kufizuar në material, kështu na vërtetohen forma të tri vetave të njëjësit dhe të vetës së dytë e të tretë shumë.

Veta e parë njëjës në material na del e ndërtuar njëlloj si në shqipen standarde.

Zgjedhimi i parë na ka dalë me format, si: *u martova, u shkjeva, u shurdhova*.

Zgjedhimi i dytë del me foljet, si: *u ndesha, u nisa, u ugja* (u ula) etj.

Po ilustron disa vargje nga CK me disa nga format e mësipërme:

...E n’krahinë cok s’*u martova*, / Por n’qafë m’paçi, mori bjeshkët e nalta...(Kënga 4, f. 28)

...Treqind krushq pá nuse janë vojte, / Vetë *u shkjeva* e jú *u shurdhova*... (Kënga 20, f. 157)

...Ktu m’xû nata e *u ugja* për me fjetë, / S’mbylla sy prej vajit, qi kam ndie...(Kënga 7, f. 64)

Në vetën e **dytë njëjës** vërtetohet vetëm trajta, *u mundove*, si në vargjet:

...Syt e ballit kúj i a ké verbue? / Se ti mjaft *u mundove* me fitue... (Kënga 11, f. 95)

Në **vetën e tretë njëjës** dalin vetëm format e **zgjedhimit të parë**, si: *u turbullue, u majtë, u çue*, si në vargjet:

...Atëherë drita i *u turbullue*, / E kujtoi se â dekë e shkue... (Kënga 29, f. 220)

...Bân denam e bân dyzen, / *U majtë* fjala qi kishin dhânë... (Kënga 16, f.135)

...Dymbëdhetë pash m’ledinë u ngul topuzi; / Dymbëdhetë pash përpjetë, si rê, *u çue* pjuhni...(Kënga 5, f. 47)

Në vetën e parë shumë nuk kemi ndeshur forma të zgjedhimit jovepror në këtë kohë.

Veta e dytë shumë del me dy trajta, *u shburruet* për zgjedhimin *e parë* dhe *u gjetët* për zgjedhimin *e dytë*, si në shembujt e ilustruar:

...Zoti u vrafët, Agët e Jutbinës! / Si *u shburruet* me ditë të sodit! ... (Kënga 6, f. 61)

...Gjoe n’ket bjeshkë kur mos *u gjetët*, / As mos dalët kurr çetë n’ket bjeshkë.(Kënga 11, f. 89)

Veta e tretë shumë në CK na del vetëm me trajtën e **zgjedhimit të parë**, *u bashkuen*, si në rastin:

...T’tânë Jutbinën n’zifafet kan thirrë, / Për shyqyr qi vllaznit *u bashkuen*... (Kënga 12, f. 107)

Në mënyrë të përmbledhur po japim në tabelë të gjitha mbaresat vetore dhe ndërtimet që dalin për të formuar kohën e kryer të thjeshtë në CK:

Koha e kryer e thjeshtë			Veprorë		
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
-na	-e	-i	-me	-(t)ë	-n
-(v)a		-ni			-ën
-(jt)a		-u			-en
-ë		-ë			-ne
-sh		zero			-në
-çë					
zero					

Joveprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
u nisa	u mundove	u çue	—	u gjetët	u bashkuen

E kryera

Në këtë trajtim nuk do të ndalemi në zgjedhime, siç kemi bërë deri tani, sepse kemi vënë re se tipi i zgjedhimit nuk e kushtëzon formën, kurse me pjesoren dhe me ndërtimin e saj sipas mbaresave do të merremi në kapitullin e formave të pashtjelluara.

Zgjedhimi vepror

Format në zgjedhimin vepror në kohën e kryer të mënyrës dëftore në CK na del me të trija vetat e njëjësit dhe shumësit. Në **vetën e parë njëjës** folja ndihmëse *kam*, na ka dalë me tri forma *kam / kém / ko’*. Kështu kalimi nga folja **kam** në formën foljore **kém**, bëhet me anë të ndërrimit apofonik të zanores *a:e* (trajta **kém** na del edhe si vetë e parë e së tashmes së dëftores). Forma e apokopuar **ko’**, realizohet me anë të ndërrimit apofonik të *e:o* dhe me rënien e tingullit fundor *-m*. Përdorim më të madh në CK kanë format e së kryerës që dalin të paraprirë nga folja ndihmëse *kam* dhe nga forma e apokopuar *ko’*, të cilat dalin në të gjitha zgjedhimet si dhe në foljet e parregullta, kurse ndërtimi *kém + pjesore* del vetëm në shembujt e vjelë me foljet e parregullta.

Krahaso:

a....– Vendin t’ëm, Mujo, e *kam çartë*, / E krajlnija mbrendë mâ nuk m’duron...(Kënga 19, f. 153)

b....–Pasha bukën, Mujo, qi *kém ngrânë*, / –Pasha gjît, Mujo, qi t’kam dhânë... (Kënga 25, f. 198)

c....Nam të math për ju, djelm, qi *ko’ ndie*, / M’ká marrë malli qi me ardhë m’u pá... (Kënga 3, f. 22)

Veta e parë njëjës e kohës së kryer të dëftores del me dy ndërtime foljore: me rendin e zakonshëm, *kam + pjesore* dhe me rendin e përmbysur, *pjesore + kam*.

1. Me ndërtimin e parë, *kam + pjesore*, veta e parë del me një përdorim më të shpeshtë. Kemi vënë re se dalin shembuj në të tre zgjedhimet si dhe ndërtimet me foljet e parregullta.

Po ilustrjmë me shembuj nga CK:

...Se pá gjak çikën nuk e lshoj, / Pse kah ditë çikën e *kam zaptue*... (Kënga 24, f. 188)

...Se për qiellë, shká, t’*ko’ lypë*, / N’oborr tëm Zoti, te t’ká qitë... (Kënga 28, f. 216)

...Se ç’ásht varra deri m’sot s’*kam dijtë*, / Por kjo kënka një hall fort i rândë...(Kënga 23, f. 178)

...Qe trí vjet ethet m'kan marrë,/ Qe trí vjet n'gjog nuk kam kânë... (Kënga 17, f. 136)

2. Me ndërtimin e përmbysur, *pjesore + kam*, veta e parë vërtetohet me një përdorim të shpeshtë në të tre zgjedhimet si dhe në ndërtimet me foljet e parregullta. Kemi vënë re se ka një distancë kur rendi është i përmbysur. Ndërmjet ndërtimit hyjnë elemente të tjera, si: pjesëzat e mohimit, trajtat e shkurtra të përemrit vetor etj.

...Lopë e vjedhun *qillue s'kam*, / Se mue m'thonë Gjeto Basho Muja... (Kënga 21, f. 167)

...Tridhetë krena n'saraje i kam; / *Kputë i kam* prej trupit t' agve... (Kënga 7, f. 59)

...Kqyre zânavet, Muja çka i ká thânë: / – Probatesha, zâna, *xânë u kam*.. (Kënga 21, f. 167)

...Se un 'i andërr e kam andrrue: / Andërr *pá kam* hargelen tuj pjellë... (Kënga 9, f. 70)

Veta e dytë njëjës e kohës së kryer të dëftores del me dy ndërtime foljore: me rendin e zakonshëm, *ké + pjesore* dhe me rendin e përmbysur, *pjesore + ké*.

1. Ndërtimi *ké + pjesore* na vërtetohet në të gjitha zgjedhimet, si dhe për foljet e parregullta, siç dalin edhe në shembujt e vjelë nga CK:

...*Ke mbarue*, krajl kapedane, / *Ké fillue* pak Shkjét me i drashtë!... (Kënga 6, f. 54)

...Po t'kujën motër ti *ké grabitë*, / T'kujën derë – tha – ti *ké koritë*... (Kënga 15, f. 126)

...Ti ç'farë ndere, Mujo, po na lypë? / Qi dy djepat na i *ké vû* në gjumë... (Kënga 7, f. 64)

...Ti n'pije, Mujo, *ké kânë*, / Qiti paret, plakut i *ké thânë*... (Kënga 19, f. 149)

2. Ndërtimi, ku pjesorja del para foljes ndihmëse (*pjesore + ké*), në Këngët Kreshnike na del me dy trajta. Në rastet më të shpeshta në këtë ndërtim hyjnë elemente të tjera, si: pjesëzat e mohimit, trajtat e shkurtra të përemrit vetor etj. Në disa raste të tjera pjesorja ndiqet menjëherë nga folja ndihmëse.

Krahaso:

a. ... Se ti gjaksin mue m'a paske vrá: / *Vrá ké* krajlín, *vrá ké* Llabutanin!... (Kënga 23, f. 185)

b. ...Kurr mâ rândë se sot ti *folë nu' m'ké!* / Tjetër babë nuk kam as tjetër nânë... (Kënga 5, f. 45)

Format e **vetës së tretë të njëjës** të së kryerës së dëftores, në krahasim me vetën e parë dhe të dytë të njëjës janë më të shpeshta. Sipas shembujve që kemi vjelë dhe sipas të dhënave që do të jepën në tabelën përfundimtare këto trajta të vetës së tretë njëjës të së kryerës janë format mbizotëruese të sistemit foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II. Ashtu si në dy vetat e para të njëjës edhe veta e tretë del me dy ndërtime foljore: *ká + pjesore* dhe *pjesore + ká*.

1. Ndërtimi *ká + pjesore* del në të gjitha zgjedhimet, si edhe për foljet e parregullta.

Po ilustrujmë me vargje nga CK:

...Të tânë lumën gjaku e *ká tërzue*²⁸⁶, / Për trí vjet krejt vendin e ká qelbun... (Kënga 5, f. 47)

...M'nji prezor si m'paska hypë, / *Ká përbë*²⁸⁷ shtegtarin kah po shkon... (Kënga 5, f. 48)

...E për sy mirë e *ká ujdísë*²⁸⁸, / E m'a kqyrë rrugën e krajlís... (Kënga 12, f. 100)

...Zâna diell e grueja hânë, / Mjerë kush besë grues i *ká xanë!*... (Kënga 1, f. 10)

...Dhimba n'zëmër nuses i *ká vojtë*, / E prej gjogut nusja â rrxue... (Kënga 20, f. 156)

* *Shembuj të vjelë nga CK*: ...Sá mirë Mujit m'i kan rá, / Sá mirë Raspos i *ká përgía*... (Kënga 9, f.76); ...Hallin Agvet mirë jau *ká dertue*: / Mue balozi m'lypë mejdan... (Kënga 9, f.82); ...Ngjat balozit çika ásht shtërngue, / E ká mrrotë e n'shpinë i a *ká vdue*... (Kënga 10, f.86); ...Ora e Zukut ngjat *ká qillue*, / Ajo Zukun mirë *ká prigjue*... (Kënga 11, f.89)

²⁸⁶ Folja merr kuptimin "turbulluar, ndyshuar ngjyrën".

²⁸⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII*..., vep. e cit, folja ka kuptimin "me vû në bé; me u përbetue; me vû në provë; këtu me kuptimin *pyes*, kërkuj të marr vesh diçka që nuk e di", f.175.

²⁸⁸ K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., folja **ujdis** del me kuptimin "ndreq, godis, vë për fije". Fjalë e mbarë gjuhës. Nuk e kanë autorët e vjetër, por dëshmohet në fjalorët e shqipes duke filluar me Kavaliotin, f.1523.

2. Në ndërtimin me rend të përmbysur, *pjesore + ká*, në të gjitha rastet e identifikuar ndërmjet formës analitike të së kryerës së dëftores hyjnë edhe elemente të tjera, si: pjesëzat e mohimit, trajtat e shkurtra të përemrit vetor, por edhe gjymtyrë të fjalisë, si: emra, ndajfolje, etj.

Krahaso:

a. ...Kúr kan dalë në një qafë e ‘i brí, / Hetue i ká Bani Zadrilí... (Kënga 15, f. 126)

b. Vrá më ká njaj Llabutani i krajlit, / N’krye t’krajlís sarajin qi m’a ká... (Kënga 23, f. 179)

c. ...Veshë m’i ká petkat e Raspodimit, / Se edhe Raspon na e ké pré... (Kënga 9, f. 77)

ç. ...Gjumë i rëndë Mujin e ki’marrë, / Edhe thirrë **Mujos fort** i ká... (Kënga 21, f. 165)

d. ...Sá herë në luftë ai që ká rá, / Kurnji rob zânë gjallë s’e ká... (Kënga 11, f. 91)

Një rast për t’u shënuar është edhe përdorimi i pjesores që del me trajta të ndryshme, kryesisht në foljet e zgjedhimit të parë, si: *ká mrrî / ká mrrijtë / ká mrrijtun*, ku pjesorja merr mbaresat: *zero / -të / un/*.

Po ilustrojmë me shembuj të tre rastet e vjelë nga CK:

Krahaso:

a. ...Kúr ka marrë djali m’ gjog me më hypë, / N’vithe t’ gjogut s’ und i ká mrrî..(Kënga 26, f. 205)

b. ...N’ derë të shpellës krajli kúr ká mrrijtë / N’mezdrak t’ madh Halili e ká shinue...(Kënga 23, f. 183)

c. ...Kúr ká mrrijtun Muji për buzë shpelle / Braf! Prej gjogut, burra, tek ká zdrypë...(Kënga 23, f. 183)

Në disa trajta të zgjedhimit të dytë të vetës së tretë njëjës të së kryerës, pjesorja si pjesë përbërëse e kësaj trajte analitike merr mbaresa të ndryshme (kryesisht mbaresat **-ë** dhe **-un**). Forma të tilla dalin shpesh në Këngët Kreshnike dhe për ilustrim po japim disa vargje.

Krahaso:

a. Me idhnim Halili m’ i ká britë Mujit: / Buzën n’ gaz veç Muji m’ a ká bâ..(Kënga 23, f. 184)

b. Â frý vetllash, çartun, sýsh ká britun: / Ti jé shkinë – me turr m’i ká folun.(Kënga 23, f. 182)

c. ...Kúr te shpija Halili ká dalë, / Nâna e vet Halilin e ká rrokë... (Kënga 25, f. 199)

ç. ...Kurrkuj shpirti mâ mirë s’i ká dalun! / Gjâmë të madhe shokët qi m’i kan bâ.(Kënga 5, f. 47)

Numri shumës

Në **vetën e parë shumës** vërtetohen këto forma:

Në **zgjedhimin e parë** folja ndihmëse *kam*, ashtu si edhe në kohën e tashme të mënyrës dëftore del e larmishme me trajta. Nga materiali i vjelë në CK, folja ndihmëse *kam* del me katër trajta, si: *kém/kemi/kena/kimi* e shoqëruar nga pesorja e foljes përkatëse. Te folja ndihmëse *kém*, vërehet re se kemi të bëjmë me ndërtimin apofonik të **-a-** në **-e-**(*kam:kém*). Si folje ndihmëse me trajtat e së kryerës së dëftores, ajo ka një përdorim më të gjerë, sesa si folje më vete e kohës së tashme të mënyrës dëftore. Në rastin kur folja ndihmëse del me formën *kemi*, mbaresa **-mi** në këtë formë është një mbaresë e trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane²⁸⁹, që përdoret edhe në shqipen standarde, të cilën e kemi trajtuar më gjerësisht te koha e tashme e mënyrës dëftore. Mbaresa **-na** te folja ndihmëse *kena* është karakteristike për gegërishten.²⁹⁰ Këtë formë e kemi ndeshur edhe në vetën e parë të shumësit të kohës së tashme, ndonëse format e së kryerës me këtë ndërtim nuk janë të shpeshta. Në një rast të vetëm kemi vjelë formën *kimi*

²⁸⁹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.671.

²⁹⁰ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.295; Sh. Hoxha, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.160; Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, DSH, III, Tiranë, 1975, f.51; J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.350.

ndalë, e cila na del me rend të përmbysur për arsye stilistikore. Secilin nga këto raste po i shohim më konkretisht me shembuj:

Krahaso:

a. ...Na për qiellë Radin e *kém lypë*, / E për tokë Zoti na e *ká* ndeshë... (Kënga 19, f. 151)

b. ...Na për qiellë, Mujo, t'*kemi lypë*, / Shyqyr fjetun për tokë t'*kemi gjetë*... (Kënga 25, f. 201)

c. ...Pse i rëndon ti Agët me fjalë? / Na trimnít bashkë i *kena bâ*... (Kënga 25, f. 197)

ç. ... Edhë diellin, Behur, *ndalë e kimi*, / Sé qysh n'natje s'parit qi jém kapë. (Kënga 6, f. 61)

Veta e parë shumës del me ndërtimin me rendin e zakonshëm, *kena + pjesore* dhe me rendin e përmbysur, *pjesore + këna*. Në shembullin e dytë kemi vënë re se ndërmjet ndërtimit hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë, siç vërtetohet edhe nga shembujt e vjelë në CK:

...Se shkjét djalin t'a kan vrá, / Aty djalin n'dhé t'a *kena shtí*... (Kënga 30, f. 225)

... – Del, Omer, Zoti të vraftë! / Se vrá e *furë*²⁹¹ Halilin të *kena*... (Kënga 29, f. 220)

Veta e dytë shumës në CK del me më pak forma në krahasim me dy vetat e tjera të shumësit. Për vetën e dytë shumës të së kryerës kemi ndeshur rreth 11 forma, ku folja ndihmëse **kam** del me dy trajta: *keni* (6 raste) dhe *kini* (5 raste).

Krahaso:

a. ...Per qat nuse qi m'ké marrë, / P'r'ata krushq që *keni ndalë*... (Kënga 1, f. 8)

b. ...Se kurr pá mue n'çetë s'*kini dalë*, / Se kurr pá mue krena s'*kini marrë*... (Kënga 25, f. 197)

Në një rast të vetëm, pjesorja del para foljes ndihmëse, dhe ndërmjet ndërtimit foljor hyjnë elemente të fjalisë, si në vargjet:

...E rrezikun fort jau *ká* pritë, / Kurr 'i grimë *dijtë nuk i a kini*... (Kënga 26, f. 206)

Veta e tretë shumës e së kryerës del me një larmi formash. Ashtu si edhe në vetat e tjera të së kryerës në veprorë, edhe te kjo vetë folja ndihmëse *kam* del me variacione. Ajo del me tre trajta. Këto trajta janë: *kan*, *kanë* dhe me formën e apokopuar *ko'*, e cila ndiqet nga pjesorja e foljes.

Krahaso:

a. ...Shumë denam atëherë *kan bâ*, / Për shyqyr qi shdosh *kan pshtue*... (Kënga 26, f. 210)

b. ...E kan lypë dymbdhetë agallarë, / E *kanë lypë* dymbdhetë pashallarë... (Kënga 20, f. 154)

c. ...”Po ûn vetë dhít jau *ko' xanë!* / “Mbrenda burgut lidhë jau kam”... (Kënga 1, f. 9)

Kjo vetë del me dy ndërtime foljore, si:

1. Me rendin e zakonshëm, *kan + pjesore*, vërtetohet me shembuj në të gjitha zgjedhimet si dhe për foljet e parregullta.

Po marrim disa vargje nga CK:

...Shndosh e mirë Muji t'ka xjerrë, / Me gjith agë që m'*kan shtangue*²⁹²... (Kënga 1, f. 7)

Shokët përreth pritat kan *xânë*, / I *kan bue* trí dit e net / Derën Mujit ia *kan msy*... (Kënga 1, f. 8)

E ndër darzma gjithkund më *kan thirrë*, / N' krye t'vendit m'*kan sajdisë*²⁹³... (Kënga 12, f. 105)

...–Po thonë se Alín e *kan xânë*, / Edhë n'burg e kan shtí... (Kënga 13, f. 112)

...Të gjith natën per rreth u *kan ndëjë*, / Për rreth bunít Zuku bajraktár... (Kënga 6, f. 52)

2. Me rendin e përmbysur, *pjesore + kan*, ku në të gjitha rastet e vjela në mes të ndërtimit hyjnë edhe elemente të tjera.

²⁹¹ Shih: K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., del forma veprorë, **fur**, "e mbytt dikë duke e shtërnguar në grykë me litar a me duar, e var", f.511.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...Me tre pika djalin m'a *kan ngí*, / E i *ká* falë Zoti kaq fuqí... (Kënga 7, f.64); ...Tridhetë zhgjeta n'shtat m'i *kan vringllue*, / Dhetë në shtat, tjerat në gunë m'janë ngulë... (Kënga 23, f.178)

²⁹²K. Topalli, *Fjalori etimologjik*..., vep. e cit., folja **shtang**, del me kuptimin "ngrij në vend a ngurosem nga habia, nga frika" etj., f.1422.

²⁹³ Po aty, folja **sajdis** merr kuptimin "e nderoj dhe e pres me kujdes". Fjalë e mbarë e gjuhës, në rrugën e zëvendësimit me *nderoj*, f.1294.

Nga CK po ilustruamë me disa vargje:

...Kundra shpijave dalë te m’u kan / Rrash me tokë kullat pá i kan... (Kënga 21, f. 163)

...Edhe thirrë **Halilit i kan**, / E përgjegjë Halili nuk ká... (Kënga 21, f. 167)

...Lypë e kan dymbdhetë vezir agë, / Lypë e kan dymbdhetë pashallarë... (Kënga 24, f. 186)

Siç vërehet edhe nga shembujt e ilustruar, folja ndihmëse *kan* në vetën e tretë shumës të kohës së kryer të mënyrës dëftore del kryesisht pa zanoren fundore **-ë**, (*kan dhân*), karakteristikë për të folmet e gegërishtes. Përjashtim bën një rast i vetëm, ndërtimi *kanë lypë*, të cilin e kemi ilustruar më sipër. Lidhur me këtë variacion të foljes ndihmëse **kan** për vetën e tretë shumës të së kryerës, gjuhëtari K.Topalli thekson: "Duke u përdorur në forma të tjera folja ndihmëse ka dalë në pozicion të patheksuar në fjali, ku ka rënë zanorja fundore dhe për hir të këtij pozicioni zanorja e brendshme del e shkurtër".²⁹⁴

Pjesorja e foljeve për vetën e tretë shumës, ashtu si dhe në vetat e tjera të së kryerës del me dy trajta, si: *kan mrrî* / *kan mrrijtë*, *kan britë* / *kan britun*, *kan ndeshë* / *kan ndeshun kan qitë* / *kan qitun*, etj.

Krahaso:

a. ...N’nji katund, tha, krushqit kúr *kan mrrî*, / Ká qitë Muja e u ká thânë... (Kënga 13, f.121)

b. ...Kur *kan mrrijtë* në fushë t’Jubinës, / Kan nisë vashat kângën-o... (Kënga 1, f. 10)

Folja e parregullt **ha** në vetën e tretë shumës të së kryerës së dëftores na del me dy pjesore: *kan hângër* dhe *kan ngrânë*. Folja ndihmëse *kan* në të dy këto raste del pa mbaresën **-ë**.

Krahaso:

a. ...Mirë *kan hângër* e mirë kan pí, / M’a pvetë djalin prej kah jé... (Kënga 10, f. 84)

b. ...E po i qet vênë e raki, / Mirë *kan ngrânë*, mâ mirë kan pí... (Kënga 11, f. 91)

Këto ishin rastet e kohës së kryer në veprore, tani po merremi me format e joveprores.

Zgjedhimi jovepror

Format analitike të së kryerës, si të gjitha format e tjera analitike, nuk janë të trashëguara nga një fazë e hershme indoevropiane, por janë përfutur në një fazë të dhënë të zhvillimit të shqipes, gjithsesi relativisht të hershme.²⁹⁵

Përveç ndërtimit karakteristik të së kryerës në joveprore janë ndeshur edhe disa ndërtime të tjera që janë karakteristike për gegërishten. Gjatë studimit të sistemit foljor të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur në përdorimin e pjesëzës **u**²⁹⁶, e cila shërben për të formuar zgjedhimin jovepror të kohës së kryer të dëftores si në shembujt e ilustruar:

Qi me i rá mbrapa Halilit sa mâ parë, / Ndryshej djali n’ burgje t’**u ká kalbë!**...(Kënga 4, f. 38)

Folja në joveproren e së kryerës së dëftores ndërtohet nga folja ndihmëse *jam* dhe pjesorja e foljes (*jam* + *pjesore*), si në rastin:

...Për krajli ‘i herë *jam drejtue*, / Der’ tu Vuku i Harambashit... (Kënga 4, f. 30)

Për sa i takon zgjedhimin jovepror të së kryerës *jam* + *pjesore* studiuesit ndajnë mendime të ndryshme lidhur me origjinën e kësaj forme. Akademiku Sh.Demiraj, thekson: "Këtu s’kemi

* *Shembuj të vjelë nga CK* :...Shpejt e shpejt në derë ká dalë, / Xhevapë Halilit zânat te i *kan dhânë*...(Kënga 21, f.168);
...Hajt andej, more budallai marrë, / Të shtatë krajlat sherrin na e *kan pá*...(Kënga 25, f.197)

²⁹⁴ K. Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit., Tiranë, 2011, f.912.

²⁹⁵ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., f.797.

²⁹⁶ K.Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit., lidhur me përdorimin e pjesëzës **u** në përdorimet e zgjedhimin jovepror, gjuhëtari thekson: "Këto forma të zgjedhimin jovepror me pjesëzën **u** dalin vetëm në kohën e kryer (rallëherë në më se të kryerën); si rrjedhim, ata dalin më shtrirje të kufizuar si nga ana gjeografike, ashtu edhe nga ana gramatikore. Për këto arsye edhe koha e krijimit të tyre nuk duhet të jetë e lashtë", f.892.

të bëjmë me ndikim të një gjuhe mbi tjetrën, por me zhvillime brendagjuhësore".²⁹⁷ Këtë mednim ndan edhe I. Ajeti.²⁹⁸ Ndërsa më gjerësiht këto forma analitike i ka studiuar edhe E. Likaj, i cili pranon se: "...ndërtimet analitike me folje jokalmtare janë më të vona dhe janë zhvillime gjedhesh brendagjuhësore, pasi ishte gramatikalizuar ndërtimi *kam* + *pjesore* përk. *jam* + *pjesore*. Ato qysh në fillim kanë përfaqësuar forma thjesht kohore dhe janë ndërtuar terësisht sipas gjedheve ekzistuese të formave analitike të foljeve kalimtare":²⁹⁹ Edhe në CK këto trajta janë të shpeshta, si në shembullin e dhënë:

...As *jam ardhë* me hângër e me pí, / As *jam ardhë* sefâ me bâ... (Kënga 14, f. 118)
Foljet që tregojnë lëvizje e formojnë të kryerën me anë të foljes ndihmëse *jam*, si: *âsht ardh*, *jini ardh*, *jém ardh*, *â dal*, *jém hik*, *jan shkue* etj.³⁰⁰

Nga CK po ilustruamë:

...N' mos *jé ardhë* me ngrânë e me pí, / N' mos *jé ardhë* sefâ për me bâ... (Kënga 14, f. 118)
Si te autorët e vjetër të Veriut edhe te CK, forma joveprore e së kryerës e disa foljeve jokalmtare ndërtohet me foljen ndihmëse *jam*. Kjo formë foljore e kohës së kryer me foljen ndihmëse *jam* përdoret edhe në të folmet e gegërishtes verilindore,³⁰¹ si në shembujt e ilustruar nga CK:

... *A dalë zâni* e paska marrun dhén, / Se 'i baloz i zî *â dalë* prej detit... (Kënga 5, f. 44)
...Tym e mjegull gjogun e ká bâ, / E *â hî* natën n'krajlí... (Kënga 18, f. 143)
...Te Halili atëherë te *janë shkue*, / N' pikë të natës zânat kan trokllue... (Kënga 21, f. 167)

Edhe sipas dialektologëve në të folmet e Shkrelit dhe në atë të Dukagjinit, ndërtime të tilla me foljen ndihmëse "jam" përdoren si variante krahas formave me "kam", kurse në zonat e tjera veriperëndimore, si në Malësinë e Madhe, në Shkodër, në Bregun e Bunës e gjetkë këtë ndërtim e gjejmë vetëm për foljen "jam": "*jam kê: n*", "*kam qenë*", "*â kê:n*" "*ka qenë*" etj.³⁰² Raste të tilla në CK i kemi ndeshur kryesisht në Këngët Kreshnike të mbledhura në zonat e Malësisë së Madhe - Shalë dhe Curraj i Epërm.

Po i ilustruamë me disa vargje:

...Sé s'jam kënë Raspoja i krajlís, / Por *jam kënë* Muji i Jutbinës... (=kam qenë) (Kënga 9, f. 80)
...Shndosh si *â kânë* në gjog po t'a hipi. / I a ká dhânë treqind duket... (=ka qenë) (Kënga 20, f. 157)

Format e joveprores të kohës së kryer të mënyrës dëftore në CK vërehen me një numër më të kufizuar, në krahasim me format e veprores.

Në **vetën e parë njëjës** për pjesoret e foljeve të zgjedhimit të parë dhe të dytë folja ndihmëse *jam* e formës joveprore del me dy forma *jam* dhe *jém* e ndjekur nga pjesorja e foljes, kurse për pjesoret e foljeve të parregullta, përveç dy formave të cituara më sipër del edhe forma e apokopuar: *jo' kânë* / *jo' kënë*, ashtu siç ndodh edhe me foljen ndihmëse *kam* në zgjedhimin vepror.

Krahaso:

- a.** ...*Jam dá* babet, *jam dá* nanet, / *Jam dá* motret, *jam dá* vllaut... (Kënga 1, f. 5)
b. *Jém ngushtue* me t'a shkrepë një fjalë: / – Pse s'po don Bani me u martue? (Kënga 15, f. 123)

²⁹⁷ Sh. Demiraj, *Gramatika historike...*, vep. e cit., f.807.

²⁹⁸ E. Likaj, *Forma analitike e së kryerës në gjuhën shqipe*, "...te ndërtimet me jam (jam ardhunë) i shoh si zhvillime brendagjuhësore", SF, Nr.2, 1989, f.17.

²⁹⁹ Po aty, f.18.

³⁰⁰ E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, Nr.3, 1964, f.127.

³⁰¹ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.71.

³⁰² J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.231.

c. ...Lum e lum për t’Lumin Zot, / – Un n’at çetë, Krajl, vetë s’ jo’ kënë... (Kënga 16, f. 130)
Si folje e mëvetësishme, folja **jam** në vetën e parë të kohës së tashme të mënyrës dëftore në ndryshim me përdorimin e saj si folje ndihmëse e së kryerës del vetëm me trajtën e dhënë më sipër. Për vetën e parë njëjës të kohës së kryer na kanë dalë forma për zgjedhimin e parë, të dytë dhe foljet e parregullta.

Ashtu si ndërtimet e së kryerës në veprorë, edhe në ndërtimet në joveprorë na kanë dalë dy ndërtime foljore në vetën e parë njëjës, me rendin e zakonshëm dhe me rendin e përmbysur.

1. Veta e parë njëjës e së kryerës në joveprorë del zakonisht me ndërtimin: *jam + pjesore*, si në rastet që kemi marrë nga CK:

...Zâ po ndiej e kend nuk jam tue pá, / Un *jam msue* vetëm n’jeremí... (Kënga 34, f. 237)

...– Zoti të vraftë, Baní Zadrilí, / Shtatë sahat qi *jém zatetë!*... (Kënga 15, f. 129)

...Thuej Omerin tu daja e kam çue, / Se *jam dekë* mos me i diftue... (Kënga 29, f. 222)

2. Ndërtimi i përmbysur, *pjesore + jam* na ka dalë në pak raste, por shembujt për arsye të ngarkesës kuptimore që mbartin i kemi trajtuar te kuptimet kohore.

Veta e dytë njëjës në Këngët Kreshnike del me pak forma me ndërtimin foljor: *jé + pjesore*.

Nga CK kemi shkëptur vargjet:

...Çka ká qitë Muji e ká thânë: / Fort asgan, Halil, m’ *jé bâ!*... (Kënga 8, f. 67)

...Fort m’ *jé rritë* shtatit, m’ *jé selitë*³⁰³, / Shtatë krajlít zânin t’a kan ndie... (Kënga 24, f. 187)

...A p’e shef Halil, dekën me sy? / Kurr mâ ngusht, Halil, a thue *jé kânë?*... (Kënga 4, f. 39)

...A *jé kënë* ndo ’i herë zenjine? / Të madhe plaka atëherë ká fshâ... (Kënga 12, f. 106)

Ndërtimin e përmbysur në vetën e dytë njëjës të joveprores nuk e kemi ndeshur.

Ndonjëherë format e së kryerës në joveprorë në vetën e dytë njëjës paraprihen nga pjesëzat karakteristike të gegërishtes *kah / kha*, që japin nuancën e joveprores, zakonisht me folje që tregojnë lëvizje.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...Hajr – e Mujë! Po kshtu **kah** *jé fillue!* / E pëvetë Sokolo Halili... (Kënga 2, f. 13)

...– Mirë se vjen maxharri i rí, / **Kah** *jé kënë*, maxharr, kah po shkon?... (Kënga 24, f. 192)

...P’e dí mirë, pse **kha** *jé dalë* / Se t’kam pá ndër Lugje t’ verdha... (Kënga 4, f. 30)

Në **vetën e tretë njëjës** si në mbarë gegërishten edhe në materialin e vjelë në CK si folje ndihmëse e së kryerës përdoren të dyja format *âsht* dhe *â*. Nuk mund të caktohet një rregull se kur përdoret njëra dhe kur tjetra, sepse ato dalin me variacione.

Krahaso:

a. ...Për shpí t’Mujit plaku *âsht fillue*, / Shpejt n’oborr Mujit m’i ká shkue... (Kënga 19, f. 147)

b. ...E m’ gjog zânat Mujin m’a kan ulë, / E prej shpije Muji *â fillue*... (Kënga 32, f. 232)

Nga studimi i materialit kemi vënë re se veta e tretë njëjës e së kryerës në joveprorë në të gjitha rastet del me rendin e zakonshëm, si: *â bâ / âsht bâ, â mendue, â ndie, âsht ndrrue, â hudhë, â hallashtisë, â kapë, â knâq, â lodhë, âsht mbathë, â vjen, â vojtë*, etj.

Nga Këngët Kreshnike po japim shembujt:*

...Ká hî mbrendë e *âsht ternue*, / E ndër krushq ajo ká dalë... (Kënga 9, f. 78)

...E gjith rreth baçen e ká, / – Kqyr, sa bukur baçja i *â lulue*... (Kënga 12, f. 99)

...Kâ zbardhë dritë e *â errë* natë, / Kurrkund hapin nuk p’e ndalin... (Kënga 2, f. 12)

...Odë për odë kullën e shetitë, / E me kullë mirë *â hallashtisë*... (Kënga 12, f. 102)

³⁰³ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., folja **selís** (selít), del me shumë kuptime e shtrirë kryesisht në dialektin e Jugut, por kryesisht ka kuptimin "mbjell e rris një pemë a një bimë; rris me kujdes; vendos dikë në një vend për të banuar", f.1305. Në shembullin e ilustruar më sipër folja *jé selitë* merr kuptimin "je rritur e zbukuar".

...Atje kjoftë si ç'â *kênë* motit, / Né na ardh të ndima prej Zotit!... (Kënga 12, f. 96)

...Mera e madhe më ká hî, / M'âsht dhânë ika e *kam ikë*... (Kënga 13, f. 112)

Format joveprore të vetës së tretë njëjës nuk dalin asnjëherë me rendin e përmbysur.

Numri shumës

Format joveprore të së kryerës së dëftores në numrin shumës, dalin me më pak shembuj, sesa për numrin njëjës.

Veta e parë shumës

Folja ndihmëse **jam** në vetën e parë shumës të së kryerës në joveprore del me tri trajta, si: *jém* + *pjesore* / *jemi* + *pjesore* (me këto trajta e kemi ndeshur foljen *jam* në vetën e parë shumës të së tashmes së dëftores) dhe trajtën e tretë, *jëmë* + *pjesore*. Në CK trajtat foljore *jemi* + *pjesore* e kemi ndeshur në një rast të vetëm dhe *jëmë* + *pjesore* e kemi ndeshur vetëm në dy raste.

Krahaso:

a....Nën kto hije na kém këndue, / Ndër kto gurra *jém freskue*... (Kënga 1, f. 3)

b....Kurr pá nderë trimat nuk janë dá, / Na atje, bre shokë, s'*jemi kânë*... (Kënga 19, f. 153)

c....Na *jëmë ardhë*³⁰⁴ sherrit me i a mrrî. / Po t'i ap treqind duket... (Kënga 20, f. 157)

Veta e parë shumës del me format e pjesoreve të foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë dhe me foljet e parregullta. Nuk kemi ndeshur raste të përdorimit të vetës së parë shumës të foljeve në joveprore për zgjedhimin e tretë.

Nga CK kemi shkëputur disa vargje:

...Se barrë të madhe vedit i ké vû, / Se para tejet të tânë na *jém mundue*... (Kënga 12, f. 98)

...Se *jém plakë* mendja s'na ká lânë, / Se *jém plakë* mnëra s'na ká hî... (Kënga 16, f. 131)

Forma e parregullt e vetës së parë shumës *jém kânë* shënon fillimin e vargjeve të 15 Këngëve Kreshnike, kurse trajta tjetër *jëmë kânë* del e përdorur në një rast të vetëm po në hyrje të këngës, si në shembujt e vjelë nga CK:

...Të lumët na për t' Lumin Zot, / Qi s'*jém kânë* e Zoti na ká dhânë... (Kënga 2, f. 11)

...Lum e lum për t' lumin Zot / Nu' *jëmë kânë* e Zoti na ká dhânë... (Kënga 10, f. 81)

Në këtë vetë nuk kemi ndeshur asnjë rast ndërtimin me rend të përmbysur.

Veta e dytë shumës e joveprores nuk vërtetohet në material me asnjë shembull.

Në vetën e tretë shumës format e së kryerës në joveprore dalin të ndërtuara nga folja ndihmëse *jam*, e cila në pjesën më të madhe të rasteve del me standardin e shqipes me formën *janë*, të ndjekura nga pjesorja e foljes. Në raste krejt të izoluara dalin edhe format, si: *jan lá*, *jan dalë*, *jan pasë*, ku forma *jan*, si folje e mëvetësishme në kohën e tashme të mënyrës dëftore në vetën e tretë shumës, del gjithmonë me zanoren fundore -ë, kurse si folje ndihmëse e së kryerës, në këtë vetë, del edhe pa këtë zanore.

Krahaso:

a. ...Kúr ká dalë drita, daltë e bardhë, / M' kâmbë *janë çue* trimat e *janë shtërngue*... (Kënga 25, f. 199)

b. ...Po çfarë mikut t'parët m'a *jan pasë*, / Qi ky babën s'dekunit m'a ká shnjërzue... (Kënga 11, f. 95)

Koha e kryer në këtë vetë zakonisht del me rendin e zakonshëm *janë* + *pjesore*, por në pak raste na kanë dalë edhe ndërtimi, ku pjesorja del para foljes ndihmëse, si në shembujt që kemi vjelë nga CK:

³⁰⁴ Në përmbledhjen "Visaret e Kombit", vep. e . cit. Këto trajta dalin te Këngët Kreshnike që janë mbledhur kryesisht në zonën Curraj – Epër.

Krahaso:

1. ...Çikë për ty, bajloz, nu' ká qillue; / Desht e vathit për ty nu' janë *mâjë*³⁰⁵ (Kënga 5, f. 46)
 ...Kurrnji gjurmë përtej s'e bájne, / *Janë shkepë*³⁰⁶ mrizeve edhe pushojnë... (Kënga 1, f. 3)
 ...*Janë xânë* rob dy agët mâ t'mirët, / *Janë xânë* rob Muji me Halilin... (Kënga 26, f. 203)
 ...Kur janë votë në derë kesh-e me hi, / Dera e mbretit Mujin s'e ká xânë... (Kënga 3, f. 22)
2. ... Qe shtatë vjet diellin s'e kan pá, / Qe shtatë vjet *rrue s't'u janë*... (Kënga 26, f. 207)
 Pjesoret e disa foljeve edhe për vetën e tretë shumës dalin me dy trajta, me trajtë të zgjeruar dhe me trajtë të pazgjeruar, si: *jan dalë / janë dalun, janë dobitë / janë dobitun, janë nisë / janë nisun* etj., por me këto forma më gjerësisht do të merremi më gjatë te pjesorja.

Krahaso:

- a. ...Kúr ká dalë drita, dalët e bardhë, / Fyta – fyt me duer *janë dobitë*... (Kënga 25, f. 199)
 b. ...Për nën shpatë Mujit po i kalon, / Fyt- a fyt aty *janë dobitun*³⁰⁷... (Kënga 8, f. 69)
 Siç e përmendëm më lart na ka dalë edhe ndërtimi tjetër i joveprores, i cili ndërtohet me anë të pjesës **u**.

Nga CK kemi marrë vargjet:

- ...At-herë trimi **u ká avitë** bucelat, / At-herë trimi **u ká avitë** fuçijat... (Kënga 4, f. 26)
 ...Qe shtatë vjet *rrue s' t' u janë*, / Sa pak djali paska ndëjë... (Kënga 26, f. 207)
 ...T'tâna sot *mbledhë te na u kan*, / Trimijë shkjë rrethin na e kan qitë... (Kënga 28, f. 215)

Nga të dhënat po rindërtojmë tabelën përmbledhëse për format e kohës së kryer sipas vetave:

Mënyra dëftore			Koha e kryer		
Veprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>kam msue</i>	<i>ké njoftë</i>	<i>ká gostitë</i>	<i>kemi dalë</i>	<i>keni nisë</i>	<i>kanë lypë</i>
<i>kém pasë</i>			<i>kém pushue</i>	<i>kini fitue</i>	<i>kan kujtue</i>
<i>ko' pá</i>			<i>kimi ndalë</i>		<i>ko' xânë</i>
			<i>kena vrá</i>		
Joveprore					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>jam drejtue</i>	<i>jé ardhë</i>	<i>âsht gzue</i>	<i>jemi kânë</i>	–	<i>janë përprjekë</i>
<i>jém zatetë</i>		<i>â kênë</i>	<i>jém mundue</i>		<i>jan pasë</i>
<i>jo' kênë</i>			<i>jemë ardhë</i>		

Më se e kryera

Në këtë trajtim nuk do të ndalemi në zgjedhime, ashtu siç bëjmë edhe për kohën e kryer, sepse kemi vënë re se tipi i zgjedhimit nuk e kushtëzon formën, kurse me pjesoren dhe me ndërtimin e saj sipas mbaresave do të merremi më gjerësisht në kapitullin e formave të pashtjelluara.

Më se e kryera në zgjedhimin vepror ndërtohet me anë të foljes ndihmëse **kam** në kohën e pakryer dhe me pjesoren e foljes që tregon veprimin (**kishte + luejtë**) dhe për zgjedhimin

³⁰⁵ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, Botimet Albanologjike, vep. e cit., kjo folje del me formën foljore **maj / mah**, me kuptimin "ushqej mirë një kafshë, majm". Fjalë e mbarë gjuhës dhe e trashëguar që del me variante dialektore, f.928.

³⁰⁶ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., forma **janë shkepë** është përdorur me një kuptim të figurshëm për një njeri që ndahet nga turma, f.188.

³⁰⁷ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., japin shpjegimin për formën foljore *janë dobitun* = *janë rrokun*, f.69.

jovepror me anë të foljes ndihmëse **jam** në kohën e pakryer dhe me pjesoren e foljes (**ishte + veshë**).

Nga CK po ilustruam me shembuj:

...Por hiç çika s'kishte luejtë. / Kúr ká ague tha drita e bardhë... (Kënga 10, f. 85)

...Ishte veshë Alija, ishte mbathë, / Në shpinë gjogut i kish'rá... (Kënga 13, f. 109)

Gjuha shqipe në një fazë të caktuar të zhvillimit të saj ka ndier nevojën e krijimit të një serie formash analitike për të shprehur kuptimet gramatikore (kohore-aspektore), që nuk duhet të këne qenë të panjohura edhe më parë për strukturën gramatikore të shqipes.³⁰⁸

Koha më se e kryer e mënyrës dëftore sipas materialit të vjelë nga përmbledhja "Visaret e Kombit" II na del me trajta si në veprorë, ashtu edhe në joveprorë, por përdorim më të shpeshtë kanë trajtat në veprorë. Foljet ndihmëse, që shërbejnë për të ndërtuar kohën më se të kryer të dëftores **kisha** dhe **isha**, dalin me më shumë trajta, sesa si folje më vete e së pakryerës së dëftores. Ato dalin të larmishme në forma, të cilat do të analizohen më gjerësisht në këtë syth. Format në zgjedhimin vepror të kohës më se të kryer të mënyrës dëftore në CK dalin në të gjitha vetat në njëjës dhe në shumës, por më të shpeshta janë format e vetës së tretë. Ndryshe nga e kryera që del shpesh edhe me rend të përmbysur, ky ndërtim foljor zakonisht nuk del me këtë rend, por vetëm me rendin e zakonshëm.

Po i shohim me radhë këto forma:

Zgjedhimi vepror

Në **vetën e parë njëjës** folja ndihmëse *kam*, na ka dalë vetëm me formën, *kishem* e shoqëruar nga pjesorja e foljes, si në shembullin e dhënë:

...Rrezikzî *kishem qillue*³⁰⁹, / Ç'se kam lé, mos me u gzue... (Kënga 10, f. 82)

Veta e dytë njëjës del me ndërtimin foljor *kishe + pjesore*, si në rastet që kemi vjelë:

...Ahit t'malit rixhá i *kishe bâ*, / Gurit t'malit rixhá i *kishe bâ*... (Kënga 28, f. 215)

...I nam për tý, krajl, e kam ndie, / Mazin Mujit i a *kishe marrë*... (Kënga 9, f. 76)

...Syt e shkruem si t'út ti i *kishe pá*, / Nuk jam kënë lypc me lypsi... (Kënga 12, f. 94)

Veta e tretë njëjës e kohës më se të kryer, në raport me dy vetat e para të njëjësit, në CK del më shpesh. Në këtë vetë, folja ndihmëse **kam** del e larmishme me trajta. Këto trajta janë: *ki' + pjesore* (a), *kish' + pjesore* (b), *kisht + pjesore* (c) *kishte + pjesore* (ç), *ki'te + pjesore* (d), *kite + pjesore* (e), por përdorim më të shpeshtë ka trajta *kish'*, e cila del pa mbaresën **-te**. Prof. Sh. Demiraj, thekson se kur një formë gramatikore në sistemin foljor ende përdoret me dy variante, këshillon që me e përshtatshme është të ngrihet në normë trajta me mbaresë. Për këtë rast, duhet të përdoret *kishte* dhe jo *kish*:³¹⁰

Krahaso:

a. ...Para Muja na *ki' dalë*, / Krushq e nuse na *ki' ndalë*... (Kënga 22, f. 173)

b. ...Tânë Kotorri tu kisha janë rá, / Ditë e dielle si m'*kish'qillue*... (Kënga 4, f. 39)

c. ...Kaq të bukur Zoti m'a *kisht falë*: / Shtati i tij të tânë roga-roga... (Kënga 23, f. 177)

ç. ...Veshë e mbathë e armët e *kishte njeshë*, / E tu kulla Kurt Agës i ká rá...(Kënga 24, f. 186)

d. ..."Kush jé tí? – i vashë m'*ki'te pvetë*: / "Kush jé tí? – djali m'i ká përgjegjë...(Kënga 23, f. 182)

e. ...Ishte errë ajo nata e bardhë, / Kurrnja krushqsh s'i *kite ardhë*... (Kënga 9, f. 79)

³⁰⁸ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., (1986), f.810; Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore*..., pun. i cit., Natyrisht më parë janë formuar format analitike të së kryerës e më pas ato të më se të kryerës etj., kryesisht për të shprehur veprime të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës, f.58.

³⁰⁹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës*..., vep. e cit., për formën foljore *kishem ra* jep shembullin -...por *kishem ra* në hall...(HD, 1932, fq.91)

³¹⁰ Sh. Demiraj, *Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe*, SF, Nr. 4, 1984, f.75.

Në të gjitha rastet e vjela me forma të vetës së tretë njëjës kemi vënë re se ndërtimi foljor del sipas rendit të zakonshëm (*kish' + pjesore*).

Po ilustrjmë disa vargje nga CK:

...Kúr ish' kënë Ali Aga i rí, / M'a *kish' blé* një gjog veresi... (Kënga 17, f. 136)

...Me gazep nâna e *kishte rritë*: / E *kish' rritë* me lypë të dyrvet... (Kënga 13, f. 109)

...E *ki' vû* nusen n'aktinë, / Gjaku syt të dyve jau *ki' xânë*... (Kënga 12, f. 103)

...Kalon nata e e shtundja m'*ki'ardhë*, / T'tânë agajt n'shpí t'Mujit prap janë bâ bashkë...(Kënga 34, f. 240)

Gjatë studimit të materialit të Këngëve Kreshnike në këtë vetë na kanë dalë edhe disa ndërtime foljore, të cilat dalin me disa trajta, ku nuk ndryshon trajtë vetëm folja ndihmëse **kam**, por edhe pjesorja e foljes, që mbart kuptimin e foljes.

Krahaso:

a. ...Muji 'i anderr e ki' andrue: / *Ki' bâ* mazin bardh si bora... (Kënga 9, f. 70)

b. ...Kah lán tesha aty n'nji bunár; / Krejt me gjak gurrën e *kish bâm*... (Kënga 23, f. 177)

c. ...Ç' *kish' qitë* krajli e kish' thânë: / – Shum hejdi, Agaj, due me u bâ... (Kënga 16, f. 131)

ç. ...I a *ki' qitun* dheut një rreng të rândë: / – Tim për tim kah një dash të pjekun! (Kënga 5, f. 44)

Numri shumës

Format e kohës më së të kryer në numrin shumës dalin me më pak shembuj, sesa për numrin njëjës.

Në **vetën e parë shumës** folja ndihmëse del me dy trajta, si: *kishim* dhe *ki'm*, të cilat ndiqen nga pjesoret e foljeve.

Krahaso:

a. ...Për mik motrën me t'a dhânë, / E shtatë krajlat n'haraç i *kishim mbajtë*...(Kënga 15, f. 129)

b. ...E Halilin tý t'a kiske falë, / *Ki'm sundue*³¹¹ turk edhe kaurr... (Kënga 31, f. 230)

Veta e dytë shumës nuk na ka dalë në asnjë rast, prandaj nuk kemi shembuj për ta ilustruar.

Në **vetën e tretë shumës**, folja ndihmëse **kam** del e larmishme me trajta. Na vërtetohet me disa trajta, si: *ki' + pjesore* (a), *ki'n + pjesore* (b), *k'in + pjesore* (c), *kin + pjesore* (ç), *kishin + pjesore* (d), e shoqëruar nga pjesorja e foljes që mbart kuptimin e foljes, por më shpesh na ka dalë trajta *ki'n*.

Krahaso:

a. ...Tue kundrue aty pak po ndalet, / Gjâmën e luftës ata m'a *ki' ndie*... (Kënga 23, f. 184)

b. ...Përpjetë bjeshkës maxhart kishin dalë, / Kâmbësh e duerësh Alín fjetun e *ki'n lidhë*...(Kënga 13, f. 110)

c. ...I bâjnë krushqit si janë kënë, / Jau kthejnë gjogat si i *k'in pasë*... (Kënga 1, f. 10)

ç. ..."Mirë me log" – Orvet u ká thânë – / – "Mirë se vjen!" Mujit i *kin' përgjegjë*...(Kënga 2, f. 13)

d. ...Përpjetë bjeshkës maxhart *kishin dalë*. / Kâmbësh e duerësh Alín fjetun e *ki'n lidhë*...(Kënga 13, f. 110)

Në këtë vetë më shpesh del ndërtimi me rendin e zakonshëm foljor, por në pak raste vërehet edhe ndërtimi me rendin e përmbysur.

1. Me ndërtimin e parë, *ki'n + pjesore*, kemi vënë re se dalin shembuj në të tre zgjedhimet si dhe ndërtimet me foljet e parregullta.

Po ilustrjmë me shembuj:

...Paj dy djepa aty *ki'n qillue*, / E kan marrë brimën e tuj kajtë... (Kënga 7, f. 63)

...Si t'na thonë nâna po bâjmë! / E janë shkue te nâna edhe e *ki'n pvetë*... (Kënga 2, f. 21)

³¹¹ A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, Trajta *kishim* e vetës së parë shumës përdoret shumë rrallë, zakonisht përdoret trajta e sinkopuar *kim*, SF, Nr. 1, 1968, f.60.

...Flokët e mdhaj shëjin i a *ki'n xânë*, / Përpjetë flokvet u ká dhânë... (Kënga 13, f. 115)

...Ç' ka i *ki'n thânë* Banit Zadrilí: / – Pásh 'i Zot, Bani, qi t'ká falë... (Kënga 13, f.123)

Siç shihet edhe nga shembujt e mësipërm, trajta *kishin* e vetës së tretë shumë përdoret më rrallë, në krahasim me përdorimin e trajtës së sinkopuar *kin*³¹².

2. Në formimin e më së të kryerës, ashtu si edhe te koha e kryer rendi i përbërësve - folje ndihmëse + pjesore – është zakonisht i ngulitur. Në këtë rend fjalësh, midis elementeve përbërëse të më se të kryerës nuk mund të hyjnë elemente të tjera. Por, në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, përveç trajtave vetore të foljeve në kohën më se të kryer të dëftores në të dy format (veprore dhe joveprore), të cilat i ilustruam më sipër me shembuj, na del shumë rrallë edhe ndonjë ndërtim me rend të përmbysur. Këto ndërtime të më se të kryerës së dëftores japin nga ana stilistike gjendjen emocionale të folësit, si në vargjet e ilustruara:

...Edhe mjaft shkjé *vrá qi kishin*; / Por Omerin dojshin për me e rrë... (Kënga 29, f. 220)

Zgjedhimi jovepror

Format e kohës më se të kryer në **joveprore** ndërtohen duke i paraprirë e pakryera e foljes **jam** pjesores së foljes, e cila mbetet e pandryshuar (**isha + pjesore**), si, p.sh.:

...Dymbdhetë vjet endë s'i kish'mbushë, / Fort m'*ish rritë* shtatit e m'*ish selitë*...(Kënga 24, f. 186)

Në materialin e vjelë nga CK, veta parë dhe e dytë njëjës dhe shumë në joveprore nuk na dalin në asnjë rast. Na vërtetohet vetëm veta e tretë njëjës dhe shumë.

Në **vetën e tretë njëjës** të më se të kryerës së dëftores, folja ndihmëse **jam** në joveprore, ashtu si edhe folja ndihmëse *kam* në veprore, del me disa trajta. Trajtat që na dalin janë: *ish' + pjesore* (a.), *i'te + pjesore* (b.), *isht' + pjesore* (c.), *ishte + pjesore* (ç.), pra në pjesën më të madhe të rasteve folja ndihmëse del pa mbaresën **-te** të vetës së tretë të së pakryerës të mënyrës dëftore (me këtë formë foljore del kryesisht edhe në kohën e pakryer të dëftores, të cilën e kemi trajtuar më sipër).

Krahaso:

a. ...N' bé të Zotit si *ish' betue*. / N'konak t'burrit për me i shkue... (Kënga 10, f. 83)

b. ...I *i'te çue* nji gulshim i rândë, / Për gojë gjaku ishte çpí... (Kënga 11, f. 101)

c. ...Në pije Muji si *isht' kânë*: / – Qiti paret – plaku i ká thânë... (Kënga, 19, f. 148)

ç. ...Dymbdhetë vjeç djali *ishte bâ*, / Gjë e máll Zoti i kishte dhânë... (Kënga 13, f. 109)

Në të gjitha rastet kemi ndeshur ndërtimin foljor me rend të zakonshëm, folje ndihmëse + pjesore.

Po japim vargjet nga CK për ilustrim:

...Tha *ishte çue* djali n'sabah, / Po e shilon atin, po e shtërngon... (Kënga 11, f. 89)

...Ç' *ish' kujtue* nji shkinë, e vrafti Zoti! / I a ká shkruë syretin n' Mujin... (Kënga 29, f. 220)

...*Ishte veshë* Plaku edhe *ish mbathë*, / Në shpinë gjogut i kish' hipë... (Kënga 19, f. 146)

...Po, por nâna s'*ish' kênë* nânë: / *Ish' kênë* bishë qi hate drangujt... (Kënga 4, f. 36)

...Kúr po i shkon plakut syni te kâmbët: / Shi ndër kambë m'*ish ndêjë* bisha pshtetë...(Kënga 23, f. 180)

Ka edhe raste kur (si veçori dialektore e gegërishtes veriore) më se e kryera e foljes **jam** (si folje jokalimtare) del e ndërtuar me anë të foljes ndihmëse *jam*³¹³, si: *ish'kânë*, *i'te kênë*, si në rastet:

...Se 'i baloz i zi â dalë prej detit, / Trim i prapët e belagjí qi *ish'kânë*... (Kënga 5, f. 44)

...Zanatlí djali *i'te kênë*, / Me mizdrak Krajlín m'a ká gjue... (Kënga 24, f.193)

³¹² Po aty, f.60.

³¹³ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f. f.113.

Në **vetën e tretë shumës** folja ndihmëse **jam** del me këto forma, si: *ishin* dhe *i'n*.

Krahaso:

a. ...Tridhetë çika bashkë *i'n bashkue*, / Kan lân kullat nânave... (Kënga 22, f. 170)

b. ...Kurrnja gojën çilë nuk e ká, / Kaq nën marre agët *ishin rá*... (Kënga 21, f. 164)

Në këtë vetë, ndërtimi foljor del gjithmonë me rendin e zakonshëm folje ndihmëse + pjesore.

Nga CK kemi marrë për ilustrim vargjet:

...Askurrnjâ shoshonjë trimat s'p'e njoftin, / *I'n ngrí* trimat me sharrue... (Kënga 4, f. 26)

...Kúr *ishin mbushë* plot trí javë, / Ká çue nana krushqit e nusen i a kish'marrë...(Kënga,13, f. 109)

...*I'n mbledhë* treqind Agët e Jutbinës. / Gjumi i rëndë Halilin m'a ká marrë...(Kënga 31, f. 227)

Nga shembujt e vjelë vetëm për vetën e tretë shumës të kohës më se të kryer të dëftores, kemi vënë re se mbledhësit e Këngëve Kreshnike, kanë përdorur më shumë formën që afron me standardin e sotëm, *ishin*, kurse për vetën e tretë të njëjësit përdorin më shpesh trajtat dialektore (*i'te, ish', isht'*), siç edhe i analizuam më sipër.

Nga shembujt e vjelë po japim tabelën përmbledhëse të formave të kohës më se të kryer sipas vetave:

Mënyra dëftore

Koha më se e kryer

Veprorë

Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>kishem qillue</i>	<i>kishe thirrë</i>	<i>ki' andrue</i> <i>kish' kqyrë</i> <i>kisht bâ</i> <i>kishte qitun</i> <i>ki'te pvetë</i> <i>kite ardhë</i>	<i>kishim mbajtë</i> <i>ki'm sundue</i>	–	<i>ki' ndie</i> <i>ki' n rrethue</i> <i>k'in pasë</i> <i>kin çilë</i> <i>kishin ndollë</i>

Joveprorë

Numri njëjës	Numri shumës
Veta III	Veta III
<i>ish mbathë</i> <i>i' te kënë</i> <i>isht' kënë</i> <i>ishte errë</i>	<i>ishin rá</i> <i>i'n mbledhë</i>

E kryera e tejshkuar

Koha e kryer e tejshkuar, si formë analitike, ashtu si edhe e kryera, historikisht është krijim i mëvonshëm në krahasim me format e tjera analitike.³¹⁴ Kjo kohë e dëftores ndërtohet me anë të foljes ndihmëse **kam** (në zgjedhimin vepror) në të kryerën e thjeshtë dhe pjesores së foljes që mbart kuptimin: **pata + pjesore** (*pata lexue, pata dhânë*) etj. Forma të joveprores në këtë kohë nuk na kanë dalë në asnjë rast. Kuptimi themelor i saj është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.³¹⁵

³¹⁴ Sh.Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.810.

³¹⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.315.

E kryera e tejshkuar është përdorur relativisht në shkrimet e autorëve të vjetër veriorë³¹⁶, kurse në Ciklin e Kreshnikëve, ashtu si edhe në shqipen standarde, ajo del më rrallë në krahasim me trajtat e kohëve të tjera të mënyrës dëftore. Në numrin njëjës kjo kohë na vërtetohet me të tri vetat, kurse në numrin shumës nuk del në asnjë rast veta e tretë. Siç do të vërehet edhe nga shembujt e vjelë nga CK, ndërtimet foljore të së kryerës së tejshkuar dalin gjithmonë me rendin e zakonshëm.

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

Veta e parë njëjës del me format e pjesoreve të zgjedhimit të parë, *pata ndie* dhe me foljen e parregullt, *paçë rá* (ashtu si në kohën e kryer të thjeshtë, ku folja ndihmëse **kam** del me dy trajta: *pata* dhe *paçë*), si në rastet:

...Se nám për tý *pate ndie*, / Nám për tý edhe për nusen t'ânde... (Kënga 12, f. 105)

...Jam kënë n'nji bjeshkë të naltë / E *paçë rá* n'nji rrëm të thatë... (Kënga 34, f. 239)

Ndërtimi foljor *paçë rá* ngjan si një formim i dëshirores, sepse folja ndihmëse ka formantin **-çë** të dëshirores, por në këtë rast nuk ka as modalitetin e dëshirores dhe as kuptimin kohor të saj.

Veta e dytë njëjës na ka dalë vetëm me pjesoren e **zgjedhimit të dytë**, *pate xjerrë*, si në shembullin e dhënë:

...Se dy syt mue, nânë, m'i *pate xjerrë*, / E dy syt prap ora m'i ká kthye... (Kënga 11, f. 95)

Veta e tretë njëjës, ashtu si edhe dy vetat e para të njëjësit del me pak raste. Theksojmë se folja ndihmëse **kam** në të kryerën e thjeshtë del në këtë vetë pa mbaresë, po ashtu edhe kur nuk është ndihmëse, duke përjashtuar variacionet. Në këtë vetë na vërtetohen shembuj me ndërtime foljore të *zgjedhimit të parë*, *të dytë* si dhe ndërtimet me foljet e parregullta.

Po marrim vargjet nga CK për ilustrim:

...Luftë të madhe Muj *pat bâ*, / Edhë të tânë shehrin e dogj... (Kënga 12, f. 106)

...Nuk pata pare me i a lá, / Djalin e madh për borxh m'a *pat marrë*... (Kënga 12, f. 106)

...Për pinxhere eshtnit i a kam tretë, / Se *pat nisë* hapsanen me m'a qelbë. (Kënga 13, f. 114)

...Kúr Muji në Zaharë *pat rá*, / Luftë të madhe Muji *pat bâ*... (Kënga 12, f. 106)

...Gjâ e máll Zoti më *pat dhânë*; / Por gjân e mallin Radi m'a ká *marrë*... (Kënga 19, f. 147)

Numri shumës

Në materialin e studiuar në CK **veta e parë shumës** del vetëm në një rast me trajtën, *patëm çue* të *zgjedhimit të parë*, si në shembullin e marrë nga CK:

...Dizdar Agës ká qitë e i ká thânë: / Na për Mujin Dizdar t'*patëm çue*... (Kënga 23, f. 181)

Veta e dytë shumës del vetëm me pjesoren e foljes së parregullt, *patët dhânë*, si, p.sh:

...Ku e ké ndoren, mori zânë? / P'a kjo â besa, qi m'*patët dhânë*... (Kënga 4, f. 40)

Në materialin e vjelë nga "Visaret e Kombit" II, veta e tretë shumës nuk na ka dalë në asnjë rast.

Kohë të mbipërbëra

Për disa të folme të veçanta të shqipes, në disa studime dialektologjike dhe në gramatika të shqipes janë përmendur dhe trajtuar edhe disa trajta të mbipërbëra, të ashtuquajtura "e kryer e dytë" dhe "më se e kryer e dytë". Siç thekshohet edhe në "Gramatikën e gjuhës shqipe": "Në gjuhën e folur, e aty-këtu në gjuhën e shkruar, ndeshen edhe forma të mbipërbëra të së kryerës e të më se të kryerës"³¹⁷, si edhe në vargjet e CK, ashtu si dhe në të folmet e gegërishtes apo edhe te shkrimtarët e tjerë veriorë (si: Gj. Fishta)³¹⁸, kemi ndeshur edhe disa forma të mbipërbëra foljore në të shkruarën, të cilat dalin me një denduri relativisht të vogël në krahasim

³¹⁶ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.75.

³¹⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.289.

³¹⁸ A. Haxhi, *Proza Fishtës...*, vep. e cit., f.118.

me format e tjera foljore të mënyrës dëftore. Në materialin e vjelë nga "Visaret e Kombit" II, nga kohët e mbipërbëra kemi ndeshur dy të tilla, si: **e kryera e dytë**: *kam pasë lânë* dhe **më se e kryera e dytë**: *kish pas marrë*.

Për sa i takon kohës së **kryer të dytë**, kjo ka një kuptim të ngjashëm me atë të së kryerës së dëftores, veçse përdoret zakonisht për veprime që kanë ndodhur në një të shkuar të largët.³¹⁹ Si kohë e mbipërbëre, e kryera e dytë në CK ndërtohet zakonisht nga format vetore të kohës së kryer të foljes ndihmëse *kam* për zgjedhimin vepror (në ndonjë rast të izoluar edhe nga folja ndihmëse *jam* për zgjedhimin jovepror) dhe pjesorja e foljes që bart veprimin, si: **kam pasë + pjesore** dhe **jam kânë + pjesore**.

Po ilustrojmë me shembuj të vjelë nga CK:

...*Kam pasë dalë* n'at bjeshkë-o për me gjue, / Çeta e krajlit tinzë m'ki'rrethue...(Kënga 23, f. 178)

...*Jam kânë nisë* tu dera e probatinit, / Qe nândë vjet qi gjogu ksajt s'â rá... (Kënga 5, f. 46)

Folja në **më se të kryerën e dytë** shpreh një veprim që ka përfunduar shumë kohë para çastit kur jemi duke folur për të.³²⁰ Kjo kohë e mënyrës dëftore ndërtohet me anë të foljes ndihmëse *kam* për zgjedhimin vepror dhe me foljen ndihmëse *jam* për zgjedhimin jovepror në kohën e kryer të tejkshuar dhe nga pjesorja e foljes që bart veprimin, si: **kisha pasë + pjesore** ose **isha kânë + pjesore**.

Nga CK kemi marrë për ilustrim vargjet:

...Vetë me vedi Muji *ki'pa'folë*: / Tybe kjoftë n't'Lumin Zot... (Kënga 19, f. 150)

...Prap në shpellë me gjogun *ishin kênë ndry*. / Të madhe Muji atëherë âsht hallaktë...(Kënga 23, f. 184)

Nëse e shohim problemin në pikëpamje historike, këto trajta janë shumë të vjetra, sepse janë të dokumentuara që në tekstet e para shqipe³²¹, por gjuhëtarët dhe dialektologët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur më këto forma të mbipërbëra³²², si nga terminologjia e përdorur, ashtu edhe nga kuptimi i tyre në fjali. Nëse i referohemi vetëm disa prej gramatikave kemi vënë re se kohët e mbipërbëra dalin me ndërtime të larimishme.³²³

Diskutime ka pasur edhe për sa i takon terminologjisë, kështu I. D. Sheperi i quan "kohë të dypërngjitura", se janë lokusione të bërë me ndihmën e foljes *kam* për vepëroret dhe *jam* për pësoret. Ai i cilëson këto kohë përkatësisht "e tashmja e dypërngjiturë": *kam pasur punuar*, *kam qenë punuar*, e krymja e dypërngjiturë: *pata pasur punuar*, *pata qenë punuar*; e pakrymja e dypërngjiturë: *kisha patur punuar*, *keshë qenë punuar* ".³²⁴

Pra, këto forma dëshmojnë që në fillimin e përshtimit të strukturës gramatikore nga gramatikanë vendës.

³¹⁹ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.58.

³²⁰ R. Mulaku, *Gjuha e shkrimeve...*, vep. e cit., f.460.

³²¹ Po aty, Ilustrime me shembuj: **Buzuku**: Tri herë *jam klenë nvratë* me vargonj n hekuri, një herë *jam klenë nvratë* me gurë; tri herë u *jam klenë nthyem* mbë det (2/ 109); **Bogdani**: ata qi kanë *pasunë hjekunë* keq huunij e hetij (Pj. II, 161) etj., f.459-460.

³²² A. Çerpja, *Formimi i normës së sotme letrare në sistemin foljor të gjuhës shqipe*, Format e mbipërbëra në mënyrën dëftore i gjejmë edhe te K.Kristoforidhi (i cili shënon kohë të mbipërbëra në të gjitha mënyrat duke formuar një nënsistem më vete krahas atij të formave të përbëra), i cili dallon kohën 'e kryer të përparme' (*kam pasë kërkuarë*), të kryer të plotë të përparme (*kishjem pasë kërkuarë*); te S.Frashëri, sipas të cilit prej kohëve të tjera të përbëra ndërtohen format e mbipërbëra që i quan 'të-mëdyshme' dhe që përdoren rrallë, p.sh. 'moti i-parëtanishim i-mëdyshme' (*kam pasurë kërkuarë*); Tiranë, 2012, f.282-283.

³²³ G. Mikeli, *Gramatika e...* vep. e cit., në këtë *Gramatikë*, si kohë të mbipërbëra dalin: 'e atëhershme e kalueme' (*kam pasë shkue*), 'e porsitashme e ptejkalueme' (*kishe pasë shkue*), 'e parshme e ptejkalueme' (*paçë pasë shkue*), 'e atëhershme e ptejkalueme' (*kam pasë pasë shkue*), f.95-97.

³²⁴ O. Myderrizi, *Gramatika e rë e shqipes*: për shkollat e mesme: fonologji e morfologji. Trajtat e mbipërbëra quhen "ma se e kryemja": *kam pasë shkue*, "ma se e kryemja e plotë": *kishte pasë kërkue* dhe "ma se e kryemja e tejkshueme": *paçë qenë largue*. Aty bëhet edhe përcaktimi i kuptimit të tyre, duke theksuar se "...ato dëftojnë një punë a të qenme që është kryer në një kohë të shkuar të largët", Tiranë, 1944, f.123.

³²⁴ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa...*, vep. e cit., f.75.

Lidhur me përhapjen gjeografike të trajtave të mbipërbëra foljore, A. Dodi, vë në dukje se: trajta e mbipërbërë "...përdoret sidomos në gjuhën e folur dhe është karakteristike për gegërishten, kurse në toskërishten ajo haset rrallë".³²⁵ Në tekstin universitar "Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe", Sh. Demiraj, pasi i klasifikon format e së kryerës së dytë, shënon se ato ndeshen "në krijimet popullore, në gjuhën e folur dhe aty-këtu edhe në shqipen e shkruar".³²⁶

Duke qenë se këto forma kanë karakter kryesisht dialektor, po i referohemi dialektologut, J.Gjinari, i cili pohon: "Në qoftë se në gjuhën letrare dhe në toskërishte janë karakteristike vetëm tri forma të përbëra të kohës së shkuar, e kryera (kam punuar), e kryera e plotë (kisha punuar), dhe e kryera e tejshkuar (pata punuar), në të gjitha të folmet e gegërishtes ekzistojnë edhe dy (vende-vende edhe tri), forma të tjera të përbëra: e kryera e dytë, *kam pas punu, ke pas dal*, e kryera e plotë e dytë: *kisha pas punu, kisha pas dal*".³²⁷, pra ai e quan këtë dukuri si një nga dallimet midis gegërishtes, toskërishtes dhe gjuhës letrare. Për shtrirjen e trajtave të mbipërbëra, Gj. Shkurtaj thekson: "...ato ndeshen në të gjitha të folmet e shqipes, që nga bregu i djathtë i Shkumbinit në jug e deri në skajet më veriore e verilindore të trevave shqiptare, në Kosovë, si dhe në trevat me popullsi shqiptare në Maqedoninë Veriperëndimore, në Mal të Zi etj."³²⁸ Siç shihet edhe nga këto të dhëna sa i takon shtrirjes së tyre territoriale janë kryesisht të gegërishtes çka e përlligjin edhe shembujt e gjetur në CK.

Po i shohim më gjerësisht trajtat e së kryerës së dytë dhe më se të kryerës së dytë.

E kryera e dytë

Nga materiali i vjelë në Këngët Kreshnike format e së kryerës së dytë dalin vetëm në numrin njëjës. Folja ndihmëse **kam**, del me dy trajta: *kam* dhe me formën e apokopuar *ko*. Nga këto dy trajta më shpesh në ndërtime del trajta me ndihmësen *kam*. Forma tjetër e apokopuar *ko* del vetëm kur ndiqet nga pjesorja e foljeve të zgjedhimit të tretë.

Krahaso:

a. ...Bé në zotin shkaju i ká bâ, / Qi dorën n'dorë i a *kam pasë kapë*... (Kënga 13, f. 112)

b. ...Ju ku jeni të Lumet e natës, / Qi probatesha juve u *ko'pa'xânë*... (Kënga 31, f. 229)

Veta e parë njëjës e kohës së kryer të dytë del në të gjitha rastet me rendin e zakonshëm (*folje ndihmëse + pjesore*). Kjo vetë vërtetohet në ndërtimet me foljet e zgjedhimit të dytë, të tretë si dhe me foljet e parregullta.

Nga CK po japim vargjet:

...Por *kam pasë lânë* nânën baxhí, / E kam lânë vetun në shpí... (Kënga 12, f. 113)

...– A din, Mujo, se ç'ka t'*kam pasë thanë*? / – Kuj n'mejdan të diellën mos me i dalë?... (Kënga 6, f. 61)

Veta e dytë njëjës del zakonisht në ndërtime me pjesoret e zgjedhimit të dytë. Në pak raste na dalin edhe ndërtimet me pjesoret e foljeve të parregullta. Në të gjitha rastet vërtetohet rendi i zakonshëm. Me përjashtim të një rasti të vetëm që kemi ndeshur, format e tjera të zgjedhimit të dytë shoqërohen gjithmonë nga treguesit kohorë, si: *askurr* dhe *dikúr*, të cilat më gjerësisht i kemi trajtuar te kuptimet kohore.

Po veçojmë vargjet nga CK:

...Edhe mnerën shokvet jau *ké pa'qitë* / Me shtjellma e me topuz vorrin po m'a rreh... (Kënga 34, f. 238)

...Tha – kryet në tokë Muji i a ká qitë: / Fjalët e këqija në ditë t'dekës m'i *ké'pa'thânë*... (Kënga 32, f. 233)

³²⁵ Po aty, f.72.

³²⁶ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, pjesa II, Tiranë, 1963, f.191-192.

³²⁷ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, vep. e cit., f.146 -147.

³²⁸ Gj. Shkurtaj, *Dialekti dhe norma...*, pun. i cit., f.42.

Veta e tretë njëjës vërtetohet me pak raste. Kjo vetë del vetëm me tre raste me rendin e zakonshëm. Folja ndihmëse ndiqet kryesisht nga pjesoret e zgjedhimit të parë, zgjedhimit të dytë dhe foljet e parregullta.

Po ilustruam vargjet e vjelë nga CK:

...Se burrë t'mirë Zoti m'*ká pasë falë*, / T'gjith dylnjëja xânin m'a kan ndie..(Kënga 21, f. 167)

...Gjâ e máll Zoti m'*ká pasë dhânë*, / Gjân e mallin shkjav mue m'a ká marrë...(Kënga 19, f. 148)

Forma të së kryerës së dytë të dëftores për numrin shumë nuk i kemi ndeshur. Nuk është karakteristike rendi i përmbysur në këtë kohë.

Zgjedhimi jovepror i së kryerës së dytë del vetëm në një rast në *vetën e parë të njëjësit* në ndërtimin me foljen e parregullt, *jam kânë nisë*, të cilën e kemi ilustruar më lart.

Lidhur me formën e pjesores *pasë*, kemi vënë re se kur përdoret si folje e theksuar në kohën e kryer me kuptimin leksikor të foljes *kam*, ajo zakonisht e ruan zanoren fundore **-ë** (me përjashtime të vogla kemi ndeshur rënien e saj, (të cilën e kemi trajtuar te koha e kryer e mënyrës dëftore), por në trajtat e mbipërbëra ndodh ndryshe, ajo, jo vetëm e bjerrë zanoren fundore **-ë** në pjesën më të madhe të rasteve, por njëkohësisht kemi ndeshur edhe humbjen e bashkëtingëllores fundore, (*pa'*) si në rastet e ilustruara më poshtë:

Krahaso:

a. ...Se burrë t'mirë Zoti m'*ká pasë falë*, / T'gjith dylnjëja zânin m'a ká ndie.(Kënga 21, f. 167)

b. ...E din Gjogu vetë se ku me t'çue, / Se baba i yt e *ká pa' msue*... (Kënga 2, f. 15)

Duke iu referuar gjuhëtarit K.Topalli: "Kjo *pa*, trajtë e cinguar e pjesores, e përdorur në trajtat e mbipërbëra si folje ndihmëse, nuk përdoret asnjëherë jashtë këtyre trajtave si pjesore e plotë e foljes *kam*, ku do të formonte një homonimi të rrezikshme me pjesoren e foljes *shoh* (pj. *pa*)..."³²⁹. Këtë përdorim, siç e theksuam, e ndeshim edhe në materialin e trajtuar te Cikli i Kreshnikëve, siç e vërteton edhe shembulli:

...Se dikúr rrugën shkjevjet jau *ké pa'ndalë*, / Se dikúr shkjevjet rrugën jau *ké pa'pré*...(Kënga 34, f. 239)

Më se e kryera e dytë

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II me përdorime relativisht të kufizuara, del edhe koha më së e kryer e dytë, e cila na vërtetohet me të dy format në veprorë dhe joveprorë. Në të gjitha rastet që kemi vjelë kemi vënë re se del vetëm veta e tretë njëjës dhe shumë, siç do e trajtojmë më gjerësisht në këtë syth.

Zgjedhimi vepror

Folja ndihmëse **kam** në vetën e tretë njëjës, në ndërtimet e kohës më se të kryer të dytë të dëftores del me dy trajta. Këto trajta janë: *ki'* dhe *kish'*.

Krahaso:

a. ...Mâ përpara rrugën e *ki' pa' xânë*. / – Hej medet Muji po bërtet... (Kënga 24, f. 192)

b. ...Aty Muja s'kish' qillue, / Por te dajat – tha – *kish pasë shkue*... (Kënga 15, f. 124)

Siç e theksuam më lart, në CK forma veprorë e më se të kryerës së dytë na del vetëm në ndërtimet e vetës së tretë njëjës dhe shumë. Raste për vetat e tjera nuk i kemi ndeshur në asnjë rast.

Veta e tretë njëjës del në ndërtime me pjesoret e të tre zgjedhimeve si dhe me foljet e parregullta. Shembujt që kemi marrë nga Këngët Kreshnike, vërtetojnë se më shpesh dalin ndërtimet e më se të kryerës së dytë me pjesoret e zgjedhimit të dytë.

Po ilustruam me disa shembuj:

³²⁹ K. Topalli, *Gramatikë...*, vep., e cit., f.854.

...N'hije t'ahit tu një gurrë, / M'gjûj Halili i *ki' pa' vndue*... (Kënga 6, f. 58)
...Po m'a shef Gjuron Harambash / Pësemijë vetë me vedi i *ki' pa' marrë*...(Kënga 24, f. 192)
...Gjân e mallin Radi i a *kish pa' xânë*. / Nândë copë bjeshkë shkjaui i a kish'marrë...(Kënga 19, f. 146)

...Se dita e ême sot m'*ki' pa' ardhun*, / Sot un votrën Mujit i a kam fikë... (Kënga 19, f. 152)
...Trímijë vetë me vedi i ki'marrë, / Edhe rrugën e *ki' pa' xânë*... (Kënga 24, f. 191)

Veta e tretë shumës del më rrallë se veta e tretë njëjës. E kemi ndeshur në pak ndërtime foljore, si në shembujt që kemi marrë nga CK:

...Kâmbëkryq Mujin m'a ká gjetë, / Mujin zânat e *ki'n pa' çue*... (Kënga 33, f. 236)

...Kûr i'n mbledhë dymbdhetë kapidana, / Llaft të mirë trimat *ki'n pa' marrë*...(Kënga 15, f. 123)

...T'prém m'a gjên dajën e vet, / I *ki'n pa' thânë* Kovaçi i Neramit... (Kënga 24, f. 192)

Edhe pjesorja **pasë** e cila shërben për të ndërtuar kohën më se të kryer të dytë del me dy trajta të ndryshme foljore, si: *pasë / pa'*, por më shpesh ashtu si dhe në kohën e kryer të dytë të dëftores, del pjesorja e bjerrë në trajtën *pa'*.

Krahaso:

a. ...Gjethi i ahit për tokë *kish pasë rá*, / Fort Shkjét friga i *kish pasë marrë*...(Kënga 23, f. 184)

b. ...Shum gjê krajli-tha-e ká xânë. / Sa t'madhe grueja *kish' pa' keshë*... (Kënga 21, f. 165)

Zgjedhimi jovepror i më se të kryerës së dytë ndërtohet nga paravënia pjesores së shkuar të foljes themelore formave vetore të më se të kryerës joveprore të foljes ndihmëse **jam**, (*ishte kênë + pjesore*), që janë karakteristike për gegërishten.

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II format e joveprores në këtë kohë të mënyrës dëftore, ashtu si dhe format e veprores dalin vetëm me trajtat e vetës së tretë njëjës dhe shumës me ndërtime relativisht të kufizuara.

Në **vetën e tretë njëjës** të më se të kryerës së dytë të dëftores, folja ndihmëse **jam** në joveprore, ashtu si edhe folja ndihmëse *kam* në veprore, del me disa trajta, si: *ish' + pjesore* (a), *ite + pjesore* (b), *ishte + pjesore* (c), siç na ka dalë edhe nga shembujt e vjelë.

Krahaso:

a. ...Kênka dalë në bjeshkë t'kralive, / *Ish' kênë ndeshë* n'Krajl-e Kapidanin.(Kënga 21, f. 168)

b. ...Por, Halili aty mâ s'â pá, / Kaq fort djali m' *ite kênë idhnue*... (Kënga 23, f. 181)

c. ...Tjetër Zotit s'i kâmi dashtë, / Jalla ndëjun *ishte kênë çue*... (Kënga 25, f. 202)

Në **vetën e tretë njëjës** në kohën më se të kryer të dytë dalin zakonisht pjesoret e zgjedhimit të parë dhe të dytë.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...Nj'a tre gjarpna i a ká gjetë, / Nja *ish' kânë çuet e dy* i'n kânë fjetë... (Kënga 15, f. 129)

...E për gjurmë Mujin e ká ndjekë, / *Ish' kênë ndeshun* n'at gurrën me uj... (Kënga 19, f. 151)

Në **vetën e tretë shumës**, folja ndihmëse **jam** në joveprore, del me dy trajta, si: *i'n* dhe *ishin*.

Krahaso:

a. ...Se fort nakël *i'n kânë bâ*, / Qysh në vorr kreshniku m'u kalbë... (Kënga 33, f. 236)

b. ...Prap në shpellë me gjogun *ishin kênë ndrý*. / Të madhe Muji atëherë âsht hallaktë...(Kënga 23, f. 184)

Ashtu si në **vetën e tretë njëjës**, edhe në **vetën e tretë shumës** të kohës më se të kryer të dytë na kanë dalë pjesoret e zgjedhimit të parë dhe të dytë, si në rastet që kemi vjelë nga CK:

...Tre gjarpjÿ në bark i a ká gjetë. / Dy *i'n kanë fjetë* e një veç çue... (Kënga 31, f. 230)

Si në numrin njëjës ashtu edhe në numrin shumës, pjesorja e foljes **jam** në më se të kryerën e dytë del me lulatje, si: *kânë / kênë*, duke pësuar ndërrimin metafonik **a : e**.

Krahaso:

a. ...Nja ish' kânë çuet e dy *i'n kânë fjetë*. / Ká nisë Muji atëherë e bërtet...(Kënga 15, f. 129)

b. ...Se me Mujin aty *i'n kênë msue*, / Me i a mujtë Mujit tue ladruë... (Kënga 7, f. 65)

Sipas shembujve na rezulton kjo tabelë përmbledhëse e formave të mbipërbëra të mënyrës dëftore sipas vetave:

Mënyra dëftore	Koha e kryer e dytë	
	Veprorë	Joveprorë
Veta I njëjës	<i>kam pasë thanë</i>	<i>jam kënë nisë</i>
Veta II njëjës	<i>kë pa'qitë</i>	–
Veta III njëjës	<i>ká pasë falë</i>	–

Mënyra dëftore	Koha më se e kryer e dytë	
	Veprorë	Joveprorë
Veta III njëjës	<i>ki' pa' vndue</i> <i>kish pasë shkue</i>	<i>ish' kënë ndeshun</i> <i>ite kënë idhnue</i> <i>ishte kënë çue</i>
Veta III shumës	<i>ki'n pa'marrë</i>	<i>i'n kënë msue</i> <i>ishin kënë ndrý</i>

3.3 Format e kohës së ardhme

Foljet në kohën e ardhme të dëftores *tregojnë një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimin*.³³⁰ Me këtë kuptim përdoret kryesisht e ardhmja e tipit *do të bëj*. Sipas standardit të shqipës, koha e ardhme ka 4 ndarje: *e ardhmja* (e ndërtuar nga dy tipe: *do të bëj*, *kam për të bërë*), *e ardhmja e përparme* (*do të kem bërë*), *e ardhmja e së shkuarës* (*do të bëja*) dhe *e ardhmja e përparme e së shkuarës* (*do të kisha bërë*).

Në CK, siç na vërtetohet edhe nga shembujt që kemi vjelë, koha e ardhme del me 2 ndarje, por që janë të larmishme në ndërtime. Kështu, koha e ardhme del me *të ardhmen* dhe *të ardhmen e së shkuarës*. Për të shprehur kuptimin e *së ardhmes* në CK përdoren disa forma analitike të ndërtuara me anë të pjesëzës **do** (*do të punoj*) dhe të foljes ndihmëse **kam** + paskajoren e foljes (*kam me dftue* dhe *kam për të bâ*). Por në disa raste për të shprehur kuptime të ardhme, ashtu si në të folme të ndryshme të gegërishtes, përdoret edhe konstrukti i ndërtuar me anë të trajtës perifrastike e formuar nga folja **due** + paskajorja e tipit "**me bâ**" dhe nga konstrukti i formuar nga folja **due**+ paskajorja e tipit "**për me bâ**". Të gjitha këto forma i gjejmë në CK, prandaj po marrim edhe shembujt.

Krahaso:

a....Baca Mujit n't'shtrueme do t'i a çoj. / Kúr don trimi kryet me i a shkurtue.(Kënga 23, f. 183)

b. ...Drue sarajin shkjav ká me m'a djegë, / Edhe nusen ká me m'a grabitë...(Kënga 13, f. 109)

c. ...Për një dert qi sot po due me t' kajtë! / Qyshë s' u njom ky shtat qi nand' prendvera...(Kënga 5, f. 45)

ç. ...Por çilm derën e mos m'lën me pritë, / Se ti nânën nânë kë për t'a pasë!"...(Kënga 4, f. 3)

d. ...Sá po don Halili për me e vjerrë, / Tjetra mende Mujit po m'i vjen... (Kënga 25, f. 198)

Koha e *ardhmja e së shkuarës* në CK shprehet me dy ndërtime: **do** + folje në të pakryerën e lidhore dhe **kam** + paskajoren gege, si në vargjet që kemi vjelë nga CK.

Krahaso:

a. Nevojë e madhe ktu, probó, m'ká prú: / Edhë kullat do t'm'kallxojsh ku i ká.(Kënga 2, f. 15)

b. – Jú me sy Bani për me u pá, / T' dyvet t'ligt kishte me u rá... (Kënga 15, f.126)

³³⁰Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.316.

Ka pasur diskutime lidhur me përhapjen dhe shtrirjen gjeografike të së ardhmes. Po i referohemi disa prej këtyre. Lidhur me pohimin e *Cimochowski*³³¹: "... e ardhmja e tipit *do* + *lidhore* është karakteristikë vetëm për toskërishten, ndërsa e ardhmja e tipit *kam* + *paskajore* është vetëm për gegërishten", kurse për studiuesin B. Beci, ky përcaktim nuk është shumë i drejtë, sepse format e së ardhmes të ndërtuara nga folja *kam* dhe paskajorja e tipit me *me* nuk është e përgjithshme për të folmet e gegërishtes.³³² Përdorimi i së ardhmes me pjesëzën "*do*" edhe në gegërishte është vënë në dukje edhe nga disa studiues të tjerë të huaj dhe vendas, si: A. Dozon, M. Domi dhe Sh. Demiraj.³³³ Këtë gjë e vërtetojnë edhe format e së ardhmes, tipi *do të bëj*, që i kemi ndeshur gjatë studimit të materialit të Këngëve të Kreshnikëve, të cilat i kemi skeduar më poshtë gjatë trajtimit të materialit sipas paradigmes së zgjedhimeve.

Koha e ardhme nga materiali i vjelë nga Cikli i Kreshnikëve na paraqitet me një larmi formash si për zgjedhimin vepror, ashtu edhe për zgjedhimin jovepror, por përdorim më të shpeshtë kanë format në veprorë të ndërtuara me anë të foljes ndihmëse *kam* + *paskajoren* e tipit "*me bâ*". Shpesh, foljet *kam* dhe *dua* që janë pjesë përbërëse e formave dhe trajtave perifrastike që shërbejnë për të ndërtuar kohën e ardhme në CK pësojnë ndërrime fonetike, të cilat do t'i analizojmë gjatë trajtimit në material. Edhe për sa u takon kuptimeve kohore, format e së ardhmes në Këngët Kreshnike (*kam me bâ* dhe *due me bâ*) dalin me modalitete të larmishme, të cilat më gjerësisht i kemi trajtuar në një syth të veçantë në këtë analizë.

Po hyjmë në analizën e secilës prej këtyre ndërtimeve të së ardhmes.

Format e kohës së ardhme

Konstrukt i së ardhmes *do* + e tashme e mënyrës lidhore

Ky tipi i së ardhmes është ndërtuar me paravendosjen e pjesëzës me origjinë foljore **do** formave vetore të fojes në kohën e tashme të mënyrës lidhore (**do** + **t' bâj**).

Po ilustruam shembullin:

...Se dhuntin *do t'a ap* vetë, / E nishanat, Rado, *do t'i pres* vetë ... (Kënga 19, f. 153)

Lidhur me historikun e formimit të së ardhmes, që ndërtohet me anë të pjesëzës *do* duke iu bashkangjitur foljes në kohën e tashme të lidhore, studiuesi N. Topalli thekson: "Në një fazë të hershme të shqipes paraletrare, gjë që e dëshmon edhe vepra e Buzukut, veta e tretë ndiqej nga folja në mënyrën lidhore, por më parë situata ishte ndryshe. Po kështu zevëndësimi i lidhore nga paskajorja *me bâ* në togun *duo+lidhore* zuri fill në vetën e tretë, vazhdoi në vetën e dytë dhe përfundoi në vetën e parë, rrugë, të cilën e kishte ndjekur edhe kristalizimi i formës së futurit: nga veta e tretë në vetën e dytë, me të cilën fonetiki ishte e njëjtë dhe së fundi edhe në vetën e parë, për analogji me dy vetat e tjera."³³⁴

Sipas vetave e ardhmja e tipit **do** + **e tashme e mënyrës lidhore** vërehet me forma në vetën e parë dhe të tretë njëjës dhe shumës vetëm në zgjedhimin vepror. Veta e dytë nuk na del në asnjë rast. Në këtë ndërtim foljor format e zgjedhimit jovepror nuk dalin me asnjë shembull.

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

³³¹ A. Cerpja, *Formimi i normës...*, vep. e cit. Studiuesja kur i referohet trajtave të së ardhmes në gegërishte pohon: "...hasen të dyja këto forma të së ardhmes, por konkretisht në të folmen e Shkodrës del vetëm e ardhmja me *kam* + *paskajore* dhe e ardhmja e përparme me *do* + *lidhore*", f.39.

³³² B. Beci, *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre* : autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë historike shqiptare, Tiranë, 2002, f.44.

³³³ A. Dozon, *Manuel de la langue chkipe ou albanaise: grammaire-vocabulaire-chrestomathie*, Paris, 1879, f. 329-333; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe për klasën e VIII*, SHBLSH, Tiranë, 1968, f. 61; Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Prishtinë, 1970, f.69-73.

³³⁴ N. Topalli, *Koha e ardhme e mënyrës dëftore...*, pun. i cit., f.129.

Veta e parë njëjës na vërtetohet me pak forma dhe del në pak raste. Në materialin e studiuar në CK, veta e parë njëjës na ka dalë me forma të zgjedhimit të parë, të dytë dhe me foljet e parregullta. Nuk kemi gjetur forma në këtë vetë për zgjedhimin e tretë.

Trajtat foljore të së tashmes së lidhore që shërbejnë për të ndërtuar këto forma të së ardhmes të dëftores dalin përgjithësisht me të njëjtën formë si në të tashmen e dëftores, por në një rast të vetëm trajta e së tashmes së lidhore për vetën e parë njëjës del me mbaresën **-i** (*do t'hjeki*, folje e *zgjedhimit të dytë*), gjë të cilën e kemi ndeshur edhe gjatë analizës së sistemit foljor të mënyrës lidhore, ku përdoren të dy format foljore (me mbaresë dhe pa mbaresë).

Krahaso:

a. ...Nji rixhá, Mujo, un *do t'a báj*. / A s'na e falë njat Ali Agën e rí?... (Kënga 23, f. 178)

b. ...N'shpí kúr t'báj me hí, / *Do t'hjeki* binakët me i bré... (Kënga 26, f. 209)

Zgjedhimi i parë na del me pak forma, si: *do t'báj*, *do t'çoj*, si në rastin:

...Jo te gjája ti me shkue, / Mirë e din se bín un *do t'martoj*... (Kënga 9, f. 77)

Zgjedhimi i dytë, ashtu si edhe zgjedhimi i parë ka një përdorim relativisht të kufizuar. Ky zgjedhim del me format, si: *do t'dal*, *do t'hjeki*, *do t'kpus*, *do t'pres* etj.

Nga CK kemi vjelë shembullin:

...Shkoni n'shpí e xgidhni nji krajl të rí, / Se njiktí un *do t'* i a *kpus* kryet... (Kënga 23, f. 183)

Foljet e parregullta i kemi ndeshur vetëm me dy trajta, si: *do t'ap* dhe *do t'nap*.

Po ilustrojmë me vargje nga CK:

...Të tâna mrama i' shpí me m'ardhë, / *Do t'u nap* me harë, me pí... (Kënga 1, f. 7)

Veta e dytë njëjës në materialin e studiuar nuk na del në asnjë rast.

Veta e tretë njëjës na del në pak raste, kryesisht në ndërtime me folje të zgjedhimit të parë dhe me foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë na vërtetohet me dy forma, si: *do t'bájë*, *do t'çojë*, si në shembullin:

... E për mejdan Hyson *do t'm'a çojë*, / E çon Zoti nji erë e nji pshtjellsë... (Kënga 12, f. 101)

Foljet e parregullta dalin në pak raste me format, si: *do t'jët* / *do t'jetë*, siç e vërteton edhe shembulli që kemi marrë nga CK:

...Shka i ká thânë baxhija e shkretë: / – N'mos bre fëmën, bír, *do t'jetë*... (Kënga 10, f. 84)

Numri shumës

Format e së ardhmes të këtij ndërtimi në numrin shumës dalin më me pak forma, se për numrin njëjës.

Veta e parë shumës del me këto trajta:

Zgjedhimi i dytë gjatë materialit të studiuar del me dy forma në një rast të vetëm: *do t'jesim*, *do t'marrim*, si në shembullin e vjelë që kemi ilustruar:

...Gjakun Mujit sot na *do t'a marrim*, / “ Ndo të dy na sot p'r'i herë *do t'jesim*... (Kënga 23, f. 181)

Zgjedhimin e tretë dhe foljet e parregullta i kemi ndeshur në një rast të vetëm me format, *do t'i xamë* dhe *do t'bijmë*.

Po ilustrojmë me vargje nga CK:

...Pa ndigioni ju gjahëtarë: / – Gjallë me dorë dhít *do t'i xamë*!... (Kënga 1, f. 8)

...Shtrëngo shtatin se *do t'bijmë* n'Jutbinë, / Për me marrë njatë Gjeto Basho Mujin!... (Kënga 23, f. 177)

Veta e dytë shumës, ashtu edhe si veta e dytë njëjës nuk del asnjëherë në materialin e studiuar në CK.

Veta e tretë shumës na ka dalë vetëm me format e parregullta, si: *do të bijnë*, *do të jén*, ku ndërmjet ndërtimit foljor të së ardhmes hyjnë trajtat e shkurtra të përemrave vetor, si në vargjet: ...Po shoqishoin me kuvend po e lshojmë, / Edhe nusja uj *do të na bijnë*... (Kënga 12, f. 104)

Konstrukt i së ardhmes kam + paskajoren gege “me bâ”

Ky është një konstrukt i së ardhmes³³⁵ që ndërtohet duke i paravendosur paskajores gege të tipit **me bâ** format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse **kam**, si: *kam + me bâ = do të bëj*. Kjo formë gjendet e përdorur dendur edhe sot e kësaj dite në të folme të gegërishtes³³⁶, sidomos, në gegërishten veriore, ku është e gjallë edhe paskajorja e tipit *me punue*.³³⁷ Sot në standard është si një lloj forme dytësore e së ardhmes, por jo me paskajoren gege. Pranohet forma e tipit *kam për të bërë, kisha për të bërë*.³³⁸

Ky ndërtim i së ardhmes ndeshet gjithashtu edhe në veprat e letërsisë së vjetër shqipe "...duke qenë kështu forma mbizotëruese, të cilën e ndeshim të jetë përdorur nga të gjithë shkrimtarët e letërsisë së vjetër shqipe dhe si e tillë ka një përdorim mjaft të shpeshtë (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani).³³⁹ Kjo formë e së ardhmes rron edhe sot në të folmet e gegërishtes, sidomos të asaj verilindore dhe veriperëndimore³⁴⁰, gjë, të cilën e kemi vënë re edhe në gjatë trajtimit të Këngëve Kreshnike.

Po ilustruon shembullin:

...*Kam me dalë* Mujin *kam me* e *ndeshë* / Mirë prej frënit mazin *kam me* e *kapë*... (Kënga 9, f. 74)

Për krijimin e formës perifrastike *kam + paskajoren gege me ba*, gjuhëtarë dhe studiues kanë dhënë mendime të ndryshme. M. Camaj në *Gramatikën* e tij thekson se infinitivi shërben për të ndërtuar dhe kohën e ardhme *kam me sjellë* e të ardhmes të përparme *kam me pasë sjellë*, si dhe kohët e kushtores: *kisha me sjellë, pata me sjellë, kisha me pasë sjellë, pata me pasë sjellë*.³⁴¹

Në materialin e studiuar në CK, format e së ardhmes me ndërtimin **kam + paskajoren gege "me bâ"**, janë mjaft të shpeshta. Këto forma kanë një përdorim më të madh në materialin e studiuar, në krahasim me dy format e tjera të së ardhmes (*do t' báj* dhe *due me bâ*). Format e së ardhmes që ndërtohen me foljen **kam + paskajoren gege “me bâ”** dalin në të gjitha vetat në të dy numrat (njëjës dhe shumës) në zgjedhimin vepror dhe jovepror. Një përdorim më të shpeshtë kanë format e veprorës në numrin njëjës. Kjo kohë me këtë formim në CK del në këto veta:

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

Në *vetën e parë njëjës*, folja **kam** si pjesë përbërëse e ndërtimit të së ardhmes *kam me shkue* del kryesisht me trajtën *kam*, por te foljet e zgjedhimit të dytë dhe te foljet e parregullta ajo del edhe me ndryshimin apofonik **a:e**, *kam : kém*.

Krahaso:

a. ...Ditën e dielle në mejdan *kam me ardhë*, / Me gjithë nuse në bjeshkë *kam me dalë*... (Kënga 12, f. 102)

b. ...– Si në e paçim baftin, qi e kém pasë, / Na n'Jutbinë shndosh – tha, *kém me ardhë*... (Kënga 18, f. 142)

³³⁵ G. Mikeli, *Gramatika...* vep. e cit., Autori jep dy forma për kohën e ardhme: *kam me per t' kënë* dhe *do t'jeem*, të cilën e cilëson si toske. Ndërsa kohën e paraardhshme e ndërton vetëm nga forma toske: *do t' keem kënë*, f.98-99.

N. Ressuli, *Grammatica albanese*. Koha e ardhme del me tri forma: *do + të* tashmen e lidhore, (*do të shkruash*), që është formë më e përhapur në toskërishte, por e padiskutueshme në gjuhën letrare; *kam + paskajoren gege (ke me shkruë)*, që është forma klasike e së ardhmes në gegërishten veriore; *kam + paskajoren e tipit për të punuar (kam për të shkruar)* që është formë më e përhapur në toskërishte, sesa në gegërishte. N. Ressulit thkson se: E ardhmja *kam + paskajoren e tipit për të punuar* në toskërishte mund të shprehë ose domosdoshmëri ose nevojë, kurse në gegërishte është zhdukur (*kam për të shkruar shumë*). E ardhmja toske me *do + lidhore përdoret* dhe në shkodranishte si 'futurum necessitatis' për të treguar nevojën e kryerjes së një veprimi Bolonjë, 1985, f.295, përsht. B.Kraja.

³³⁶ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.103.

³³⁷ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.385.

³³⁸ Po aty, f.290-291.

³³⁹ R. Mulaku, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.79.

³⁴⁰ Po aty, f. 79.

³⁴¹ M. Camaj, *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*. Collaborated on and translated by Leonard Fox. Otto Harrassowitz, Wiesbaden. 1984, f.132, 151-153, 160-161.

Veta e parë njëjës na del e pasur me forma në këtë ndërtim në të gjitha zgjedhimet si dhe me foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me trajtat, si: *kam me bâ, kam me besue, kam me diftue, kam me gri, kam me ndigjue, kam me shkue, kam me shtë* etj.

Po japim shembuj nga CK:

...Paj në kjoftë nafakë për me pshtue, / Ksajt kah shpija *kam me* u *diftue*... (Kënga 10, f. 85)

...Copë me girmë un tÿ *kam me* t' *grî*. – / Tuta nusen pak e kish' marrë... (Kënga 13, f. 111)

Zgjedhimi i dytë na del shumë shpesh me format, si: *kam me çilë, kam me dalë, kam me hjekë, kam me kapë, kam me lypë, kam me marrë / kém me marrë, kam me ndeshë, kam me njoftë, kam me qeshë, kam me qitë, kém me shprazë, kam me xjerrë* etj. Kemi vënë re nga shembujt e vjelë nga CK, se janë të shpeshta edhe rastet, ku ndërmjet ndërtimit të së ardhmes hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë.

Krahaso:

a...T'madhe vetë o *kam me qeshë*, Atëherë krajl ti n'kâmbë m'u çue... (Kënga 9, f. 74)

b...Besën e Zotit Mujit i a kan dhânë, / Qí pá e shprazë ti pushkën, *s'kém me e shprazë*... (Kënga 34, f. 240)

Zgjedhimi i tretë na ka dalë vetëm me një formë, *kam me vû*, si në rastin:

...E ç'ká qitë e ká thânë: / – E n'shpinë t'atit djalin *kam me* e *vû*... (Kënga 11, f. 90)

Foljet e parregullta në këtë ndërtim të së ardhmes janë të shpeshta në Këngët Kreshnike. Kemi ndeshur në disa prej tyre, si: *kam me ardhë / kém me ardhë / kam me ardhun, kam me dhânë, kam me kânë, kam me lânë, kam me ndëjë, kém me thânë, kém me pá, kam me vojtë* etj.

Nga CK po i ilustruam shembujt:

...Kurrkuj gjâ nuk *kém me i thânë!* / Mujin fort e ká ngushtue... (Kënga 1, f. 9)

...Ah! Mbí Zotin Muji bé ká bâ / – Dér tu kullat *kam me* i *vojtë*... (Kënga 6, f. 57)

Veta e dytë njëjës vërtetohet me të gjitha zgjedhimet si dhe me foljet e parregullta. Nga shembujt që kemi vjelë në materialin e këngëve të CK, kemi vënë re se foljet në vetën e dytë njëjës të së ardhmes shprehin kuptimin e urdhrorit të folësit, ku më gjerësisht do e trajtojmë te kuptimet kohore të së ardhmes.

Zgjedhimi i parë del me këto trajta, si: *ké me bâ, ké me dá, ké me hî, ké me kndue, kè me kthye, ké me lshue, ké me mbajtë, ké me ndigjue, ké me ndrý, ké me shkue* etj.

Po japim shembujt:

...Atëherë krajl, ti n'kâmbë m'u çue, / Mbrenda burgut *ké me hî*... (Kënga 9, f. 74)

...–Tÿ t'mëçëm Zotyn t'ká falë, / Qet pleqni *ké me* na e *dá*... (Kënga 18, f. 144)

...*Ké me mbajtë* pishën me dhâmbë, / Edhe dritë *ké me* na *bâ*... (Kënga 21, f. 162)

...Dÿ-trí herë ti aty ké me kndue, / E dikush ndoshta *ká me* t' *ndigjue*... (Kënga 34, f. 238)

Zgjedhimi i dytë del me foljet, si: *ké me çilë, ké me dalë, ké me hjekë, ké me qitë, ké me marrë, ké me pritë, ké me zgjedhë, ké me thirrë* etj.

Po i ilustruam me shembuj:

...Kúr t'shkojsh mbrâma në konak, / *Ké me qitë* e me i pvetë zânat... (Kënga 1, f. 5)

...Njat mâ t'mirën *ké me* e *zgjedhë*, / Tridhetë agë për hajr t'a bâjmë!... (Kënga 2, f. 28)

...Si në bâshin derën mos me çilë, / T'madhe – Mujo – , *ké me thirrë*... (Kënga 13, f. 114)

Zgjedhimi i tretë del në një rast të vetëm me foljen, *ké me dijtë*, si në vargjet:

...Si n'mos mujsha ktu për me kthye, / *Ké me* e *dijtë*, se shkjet m'kan pré... (Kënga 19, f. 150)

Foljet e parregullta na dalin me trajtat, si: *ké me ardhë, ké me ndëjë, ké me dhânë, ké me ngrânë, ké me pá, ké me pasë, ké me rá, ké me thanë* etj.

Nga CK po ilustruam vargjet:

...Pâsh ket buk! – zânave *ké m*'u *thanë* –, / Pashi majet, kû veroni... (Kënga 1, f. 6)

...N'vend elbit grunë *ké me* m'i *dhânë*, / E n'vend t'ujit vënë ké me i qitë... (Kënga 8, f. 71)

...Krejt si lypc, Zuku, ké m'u bâ, / Dér te nâna *ké me rá*... (Kënga 11, f. 93)

...N’vend elbit oriz ti *ké me ngrânë*, / N’vend t’ujit vënë tý kam me t’dhânë..(Kënga 18, f. 142)
...Kqyr Halili atëherë se shka i ká thânë: / – Jam i dekun, me sy s’*ké* si *me* m’ *pá*... (Kënga 34, f. 237)

Veta e tretë njëjës në CK na del me këto forma:

Zgjedhimi i parë del me këto folje, si: *ká me bâ*, *ká me diftue*, *ká me hî*, *ká me kndue*, *ká me lshue*, *ká me ndigjue*, *ká me shikjue*, *ká me shkue* etj.

Po ilustruam me shembuj:

...Me bâ Paji e me m’hetue, / Kurr prej burgut s’*ká me m’lshue*... (Kënga 2, f. 16)

...Ajo furkën *ká me shikjue*. / Sá shpejt djali qi â nisë... (Kënga 10, f. 85)

...Por s’po ká kush nesh bân ndoi kopilí; / Provë të mdhá krajli *ká me bâ*... (Kënga 16, f. 131)

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *ká me çilë*, *ká me dalë*, *ká me djegë*, *ká me dridhë*, *ká me folë*, *ká me grabitë*, *ká me gjegjë*, *ká me hupë*, *ká me marrë*, *ká me qitë*, *ká me thirrë*, *ká me zdashë* etj.

Po japim shembullin nga CK:

...Kush me të nuk *ká me folë*, / Idhnim fort Shkjau *ká me marrë*... (Kënga 2, f. 16)

Foljet e parregullta dalin me trajtat, si: *ká me ardhë*, *ká me dhânë*, *ká me kênë*, *ká me ngrânë*, *ká me pá*, *ká me rá* etj.

Nga CK po ilustruam shembujt:

...E n’maje të bjeshkës djalin *ká me e qitë*, / Harushë e ujk atje po *ka me e ngrânë*... (Kënga 11, f. 90)

...Ai i pari që t’vinë me t’lypë, / Atij baci *ká me t’dhânë*... (Kënga 24, f. 187)

...Shndet m’i ço Halilit t’êm vllá, / Mâ e para e diell qi *ká me ardhë*... (Kënga 34, f. 239)

Numri shumës

Format e së ardhmes në këtë ndërtim në numrin shumës janë më të rralla se format që dalin në numrin njëjës. Këto forma gjatë materialit në CK dalin në të tri vetat e numrit shumës me zgjedhimet përkatëse si dhe me foljet e parregullta.

Veta e parë shumës e së ardhmes del me foljet e zgjedhimit të parë dhe me foljet e parregullta:

Zgjedhimi i parë na ka dalë vetëm në një rast të izoluar me foljen, *kém m’bâ*, si në shembullin e marrë nga CK:

...Të shtatë krajl’et mirë qi *ká me u rá*, / Raja e tyne për jetë na *kém m’u bâ*... (Kënga 25, f. 197)

Foljet e parregullta na vërtetohen më rrallë. Ato dalin vetëm me dy forma, si: *kém me xânë* dhe *kena me ngrânë*, ku folja **kam** për vepron në numrin shumës del me dy trajta: *kém/kena*, siç e kemi thënë edhe në kohën e kryer të dëftores.

Krahaso:

a. ...Kollaj rob na tash *kém me e xânë*, / Ç’mendoi krajli atëherë me bâ... (Kënga 9, f. 73)

b. ...Sá herë darkë t’*kena me ngrânë*, / Ké me mbajtë pishën me dhâmbë... (Kënga 21, f. 162)

Në **vetën e dytë shumës** kemi ndeshur trajtat për zgjedhimin e parë dhe të dytë si dhe foljet e parregullta, të cilat na vërtetohen me pak raste, kurse foljet e zgjedhimit të tretë nuk i kemi ndeshur në asnjë rast.

Gjatë studimit të materialit të CK në vetën e dytë shumës të së ardhmes për foljen *kam*, kemi ndeshur në përdorimin e dy formave **keni / kini**, të cilat i kemi trajtuar më gjerësisht në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

Krahaso:

a. ...Raja e tyne ju *keni m’u bâ*, / Po ndigjoni, Mujo me Halilin... (Kënga 25, f. 199)

b. ...Edhe ndimë *kini me m’dhânë*, / Se Zadrani shpirtin po m’a merr... (Kënga 31, f. 229)

Sipas zgjedhimeve dalin këto forma në vetën e dytë shumës:

Zgjedhimi i parë del me trajtat, si: *keni me bâ*, *keni me kndue* (kjo formë foljore del me rend të përmbysur).

Zgjedhimi i dytë na ka dalë me format, si: *keni me fjetë*, *keni me dalë*.

Foljet e parregullta na dalin vetëm me dy forma, si: *kini me dhânë* dhe *keni me rá*.

Meqënëse në këtë vetë shembujt janë të paktë, po i përmbledhim sipas rasteve:

...Pritni pak, more zo'jt e malit! / Ju *me kndue*, tjetër punë s'*keni*... (Kënga 4, f. 31)

...Aty burrat vend kan xânë: / Pá vesvese *keni me fjetë*... (Kënga 6, f. 52)

...Jau shilon nâna gjogat, jau shtërngon, / E n'shipnë gjogave *keni me* u *rá*... (Kënga 25, f. 199)

Veta e tretë shumës e së ardhmes vërtetohet me forma në të gjitha zgjedhimet si dhe me foljet e parregullta. Format e vetës së tretë shumës në këtë ndërtim të së ardhmes janë më të shpeshta në raport me dy vetat e para të shumësit. Në vetën e tretë shumës, folja *kan* si pjesë përbërëse e trajtës gege të së ardhmes, në CK del në pjesën më të madhe të rasteve pa zanoren fundore -ë (*kan-*), siç duket, duke iu nënshtruar prirjes së përgjithshme të rënies së saj në këto pozicione në gegërishte, por në një rast të vetëm na ka dalë edhe trajta, *kanë*, që e ruan fundoren.

Krahaso:

a. ...Shkjë t'pá farë tu kisha *kan me ardhë*, / Pse ditë e dielle nesër ká qillue. (Kënga 29, f. 219)

b. ...Provë t'mdhá krajli ká me bâ, / N'qafë vedin *kanë me* e *marrë*... (Kënga 16, f. 131)

Folja e parregullt, **ha** në vetën e tretë shumës të së ardhmes na del me dy trajta, si: *kan hângër* dhe *kan ngrânë*. Trajtat e këtyre pjesoreve janë formuar nga dy tema të ndryshme, nga trajta supletive e së tashmes së dëftores, **hâ** (*hângër*), e cila del vetëm për vetën e tretë shumës, dhe nga trajta tjetër *ngrânë*, e cila formohet nga trajta josupletive e pjesores, e cila del në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit dhe në vetën e parë të shumësit të së ardhmes. Folja ndihmëse *kan* në të dy këto raste del pa mbaresën fundore -ë.

Krahaso:

a. ...— A t'kam thânë, Taraku i Kotorrit, / Se Kotorret *kan me* t'a *hângër* kryet! (Kënga 4, f. 38)

b. ...S'ka kush nânën m'a shtje n'dhé, / Zogj e sorra nânën *kan me* m'a *ngrânë*... (Kënga 13, f. 113)

Veta e tretë shumës në **zgjedhimin e parë** del me format, si: *kan me bâ*, *kan me bajtë*, *kan me bashkue*, *kan me rânduë* etj.

Po marrim vargjet nga CK:

...E barrë t'rândë me tý *kan me bâjtë*, / Tâne patkojt, tha, gjog tý kan me t'rá. (Kënga 18, f. 142)

...Jë i rí djalë e po drue, / Se tý agët me fjalë *kan me t'rânduë*... (Kënga 26, f. 205)

Zgjedhimi i dytë na del me pak forma, si: *kan me marrë* / *kanë me marrë*, *kan me pré*, si në shembullin e vjelë:

...Se n'krajli Zuku don me shkue, / Besa shpejt, tha, Zukun *kan me* e *pré*... (Kënga 18, f. 142)

Zgjedhimi i tretë na ka dalë vetëm një herë me formën, *kan me vû*, si në rastin:

...Edhe tý, tha, gjog, kan me t'marrë, / E samarin tý *kan me* t'a *vû*... (Kënga 18, f. 142)

Foljet e parregullta na dalin me format, si: *kan me ardhë*, *kan me hângër* / *kan me ngrânë*, *kan me rá*, *kan me thânë* etj. Në këto trajta ndërmjet ndërtimit të së ardhmes hyjnë edhe elemente të tjera, si: trajtat e shkurtra të përemrit vetor, por edhe gjymtyrë të fjalisë, emra etj.

Nga CK po ilustruon vargjet:

...— Sá herë jashtë un qi kam me dalë, / Nuk *kan vakt agajt ktu me ardhë*... (Kënga 13, f. 111)

...E dikush ndoshta ká me t'ndigjue, / Fjalë të rânda ndoshta *kan me t'thânë*... (Kënga 34, f. 238)

Konstrukt i së ardhmes kam + formë e pashtjelluar "për të bâ"

Tipi i së ardhmes **kam + formë e pashtjelluar "për të bâ"** është ndërtuar duke i paravendosur formës së pashtjelluar **për të bâ** format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse **kam** (*kam + për të bâ = do të bëj*). Në CK ndeshet vetëm një herë në një rast të izoluar forma e parregullt e vetës së dytë njëjës, *ké për t'pasë*, si në shembullin që kemi vjelë nga CK:

...Por çilm derën e mos m'lên me pritë, / Se ti nânën nânë *ké për* t'a *pasë*!... (Kënga 4, f. 3)

Konstrukt i së ardhmes me trajtën perifrastike due + paskajore e tipit "me bâ"

Në CK, ashtu si në përgjithësi të folmet e gegërishtes veriore, për të shprehur kuptimin e së ardhmes përdoret edhe një trajtë perifrastike e formuar nga folja **due** + paskajore e tipit "**me bâ**" (*due me kënë = do të jem, do me dhânë = do të japë*). Kjo formë ka nuancën e një të ardhmeje të vullnetit (futurum voluntatis).³⁴² Në këto raste folja **due**, ndonëse ruan trajtat e saj zgjedhimore, e ka zbehur kuptimin e saj volitiv. Me anë të një togfjalëshi me marrëdhënie kundrinore nuk shprehet dëshira e folësit, por një formë e së ardhmes së thjeshtë.

Po japim shembullin nga CK:

...*Due me dalë* miqt *due me* i *shetitë*. – / Besën e Zotit nâna i a kâ dhânë... (Kënga 13, f. 109)

Ndërtimi i së ardhmes me trajtën perifrastike **due** + paskajore e tipit "**me bâ**" del shpesh në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II. Ky ndërtim për nga denduria e përdorimit radhitet i dyti pas ndërtimit foljor të së ardhmes *kam* + paskajoren e tipit "*me bâ*". Në konstruktin e së ardhmes *due* + paskajore e tipit "*me bâ*", folja **dua** në tri vetat e njëjësit zgjedhohet sipas këtyre formave: *due/don/don*, njëlloj si tri vetat e njëjësit të kohës së tashme të mënyrës dëftore, kurse tri vetat e shumës dalin me format, si: *duem/doni/duen*, ndërkohë që në kohën e tashme të dëftores kemi ndeshur vetëm vetën e dytë shumës, *doni*. Koha e ardhme me këtë ndërtim në zgjedhimin vepror del në të gjitha vetat e njëjësit dhe të shumës, kurse në zgjedhimin jovepror del vetëm me tri vetat e njëjësit.

Në CK vërehen këto forma vetore:

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

Në **vetën e parë njëjës** vërtetohen format e së ardhmes në të gjitha zgjedhimet si dhe ndërtimet me foljet e parregullta. Folja *dua*, si pjesë përbërëse e këtij ndërtimi të së ardhmes del me të njëjtën formë si në kohën e tashme, me formën *due*. Përjashtim bën forma e parregullt, *dua me dhânë*, e cila del me formën e standardit.

Krahaso:

a. ...Shum hejdi, Agaj, *due me u bâ* / Thellë në burg un *due me u shî*... (Kënga 16, f. 131)

b. ...Paska qitë e i paska thânë: / Nj'et bar n'orë *dua me* t'a *dhânë*... (Kënga 2, f. 16)

Zgjedhimi i parë na del me këto forma, si: *due me bâ*, *due me kajtë*, *due me kalue*, *due me ndrrue*, *due me ngî*, *due me shkue*, *due me shî* etj. Nga këto forma të së ardhmes, përdorim më të shpeshtë në CK kanë format, si: *due me bâ* dhe *due me shkue*, ndërsa format e tjera dalin më rrallë.

Po veçojmë disa shembuj nga CK:

...Rrash me tokë *due me i a bâ!* / Bé mbí Zotin krajli i kâ bâ... (Kënga 2, f. 15)

...– Nuk po muj n'kâmbë me qindrue, / Por qe jetë, Halil, *due me ndrrue*... (Kënga 33, f. 234)

...Fort mâ t'madhe Muji i a kâ kthye: / Me mejdan sot po *due me t'ngi*... (Kënga 34, f. 240)

Zgjedhimi i dytë del i pasur në forma dhe në përdorime. Kemi ndeshur këto forma, si: *due me dalë*, *due me falë*, *due me hypë*, *due me lypë*, *due me marrë*, *due me mbetë*, *due me njoftë*, *due me pré*, *due me pritë*, *due me pvetë*, *due me shetitë*, *due me shitë* etj.

Nga CK po ilustruam vargjet:

...– Pâsh një Zot, Arnaut Osmani, / *Due me t'pvetë* e me m'kallxue... (Kënga 12, f. 104)

...Edhe sot Halilin *due me* e *falë* / Kujtoj nâna kopil se e kâ marrë... (Kënga 25, f. 198)

Kemi ndeshur në disa raste ku ndërmjet formës të së ardhmes hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë, si në rastin që kemi marrë nga CK:

...Po nuk *due çfardo nusje me marrë*, / Edhë kndej Jutbinës nuse nuk marr... (Kënga 12, f. 98)

Zgjedhimi i tretë na ka dalë rrallë dhe vetëm me trajtën, *due me xânë*, si në rastin:

...– Se un po *due robín me* e *xânë* / Pak vonojnë, shum s'kan vonue... (Kënga 6, f. 56)

³⁴² B. Beci, *E folmja e Luznisë së Dibrës*, DSH II, Tiranë, 1974, f.250. Gj. Shkurtaj, *E folmja e Hotit*, DSH II, Tiranë, 1974, f.386. Gj. Shkurtaj, *E folmja e Kelmendit*, DSH III, Tiranë, 1975, f.54-55. Xh. Gosturani, *E folmja e Çeremit dhe e Valbonës (rrethi Tropojë)*, DSH IV, Tiranë, 1982, f.310. L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, DSH VI, Tiranë, 1990, f.224.

Foljet e parregullta dalin me format, si: *dua me dhânë, due me kênë, due me lânë, due me pá, due me rá* etj.

Po ilustruam me shembuj:

...Kshtu i përgjegjë Halilit: / N’çetë me veti ty s’po *due me t’lânë*... (Kënga 2, f. 14)
...– E dhe un si baba due m’u bâ, / Edhe mâ trim se baba *due me kênë*... (Kënga 11, f. 91)
...Varrët tua, Mujo, *due me* i *pá!* / Pak jerganin Muji e ká shpërvjelë... (Kënga 23, f. 179)
...Mbas vorrit t’Halilit un *due me rá*, / Mos me fol kush, pushkë kush mos me qitë...(Kënga 34, f. 240)

Në **vetën e dytë njëjës** dalin format e zgjedhimit të parë, të dytë si dhe foljet e parregullta. Format e zgjedhimit të tretë nuk i kemi ndeshur gjatë studimit të materialit në CK.

Për **zgjedhimin e parë** na kanë dalë këto folje, si: *don me bâ, don me gzue, don me mblue, don me ndrrue, don me qindrue, don me shkue* etj.

Po ilustruam shembujt:

...Vaji syt po *don me* t’i *mblue*. / Nuk po i çon njiherë me na shikjue... (Kënga 22, f. 171)
...Halil Agën shka po *don me* e *bâ?* / Æsht i zî e për çetë s’vín gjâ... (Kënga 23, f. 181)
...A po *don* vllazní t’ânde *me shkue?* / Çka i ká thânë djali jabanxhí... (Kënga 24, f. 195)

Zgjedhimi i dytë del me më pak forma, si: *don me dalë, don me qitë, don me koritë*.

Nga CK po ilustruam vargjet:

...Gjogë e shpatë me vedi pse s’ké marrë, / A kshtu burrit n’bejleg ti *don me* i *dalë?*...(Kënga 25, f. 198)

... – Qýsh ti Mujit bejleg po *don me* i *qitë?* / Qýsh konakun, bîr, po *don me* na e *koritë?*...(Kënga 25, f. 199)

Për **zgjedhimin e tretë** kemi ndeshur vetëm formën, *don me xânë*, ku ndërmjet ndërtimit të së ardhmes hyjnë edhe elemente të tjera, si në shembullin e vjelë:

... "A po don krena ma marrë? / "A po *don robín m’e xânë?*... (Kënga 6, f. 56)

Foljet e parregullta na dalin më të rralla, si: *don me ardhë, don me ndëjë, don me pasë, don me rá* etj. Edhe në këto ndërtime hyjnë elemente të tjera të fjalisë.

Po japim vargjet për ilustrim:

... – Mysafir a *don me t’ardhë?* / – Ti hosh gjelden – te i ká thânë... (Kënga 10, f. 83)

...E m’a pvetë djalin jabanxhí: / – A po *don me* mua *me ndëjë*... (Kënga 24, f. 195)

Folja **dua**, si pjesë përbërëse e trajtës perifrastike *due me shkue*, në vetën e tretë njëjës del kryesisht me mbaresën -n (*don*), por në një rast të izoluar e vërtetohet edhe me mbaresën zero, (*do*), ku ndërmjet formës foljore të së ardhmes hyjnë elemente të tjera.

Krahaso:

a. ...Por jam vetë, gjog, tue lotue, / Se n’krajlí Zuku *don me shkue*... (Kënga 18, f. 142)

b. ...Nuk *do nusja uj me i dhânë*. / Tridhetë çikat nuses po i bërtasin.... (Kënga 12, f. 100)

Në **vetën e tretë njëjës** ndeshen këto folje për zgjedhimet përkatëse.

Zgjedhimi i parë del me format, si: *don me bâ, don me çue, don me kallxue, don m’lshue, don me ndimue, don me ndrrue, don me shikjue, don me shtî, don me shkue* etj. Në pjesën më të madhe të shembujve të vjelë në materialin e studiuar, në këto ndërtime të së ardhmes hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë.

Po ilustruam vargjet:

...Tanë copë-copë po *don me e bâ*, / Para çika n’dy gjújt m’i ká rá... (Kënga 15, f. 126)

...Nuk po *don jerganin me e kallxue*. / Mos e ké jerganin ndoi shoq t’ngjatë... (Kënga 22, f. 171)

...Po *don djalin me e shikjue*, / E harron e shtatin e ká lshue... (Kënga 24, f. 194)

...Po *don Zoti vllaz’n’et me u ndimue*, / Po don Zoti e u Æsht dhânë e mbara...(Kënga 29, f. 221)

Zgjedhimi i dytë del vetëm me dy forma, si: *don me dalë, don me pré*, si në shembujt:

...*Don me dalë* në bjeshkë për me gjue, / Sá shum bjeshkën djali e ká shetitë..(Kënga 11, f. 89)

...Kujtoj nâna se kopil e ká marrë, / Qi po *don* vllaut n’mejdán *me* i *dalë*... (Kënga 25, f. 198)

... Po don kryet ai me jau pré. / Pasha ‘i Zot mue qi m’ká dhânë... (Kënga 26, f. 209)
Në materialin e studiuar, **zgjedhimin e tretë** e kemi ndeshur me format, si: *don me pí, don me vû*.

Po japim shembujt:

...Kurrnji pikë, Muji, s’po don me pí / Ah! mbí Zotin Muji bé ká bâ... (Kënga 6, f. 57)

...Larg, o Zot, trimnín me t’a humbë. / Bash në këngë Muja don me t’vû... (Kënga 8, f. 69)

Zgjedhimi i parregullt del me format, si: *don me ardhë, don me lânë, do me dhânë*.

...Me pí zehrin kreshniku ká nisë, / Mârre vedit nuk po don me i lânë... (Kënga 21, f. 164)

Shembujt e tjerë të vjelë janë dhënë gjatë trajtimit për ilustrim.

Numri shumës

Në këtë ndërtim foljor, format e së ardhmes në numrin shumës dalin me më pak forma, se në numrin njëjës. Në raport me dy vetat e tjera të shumës, veta e parë shumës na ka dalë më shpesh, kurse vetat e tjera kanë denduri më të ulët.

Në **vetën e parë shumës** kemi ndeshur forma për të gjitha zgjedhimet si dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me këto forma, si: *duem me bâ, duem me çetue, duem me hî, duem me kjá, duem me shkue* etj.

Po japim disa shembuj:

...Por Mujit hallin duem me i a kjá: / A don, Mujë mbrapa me na rá... (Kënga 2, f. 13)

...Un s’harroj sokakun e Kishës, / Po duem me shkue nânën m’e kërkue... (Kënga 12, f. 106)

...Atëherë Muji prep i ká thânë: / Na dý darsma, Ali, duem me bâ... (Kënga 13, f. 116)

Zgjedhimi i dytë na del me disa forma, si: *duem me dalë, duem me hipë, duem me marrë, duem me pvetë* etj., si në shembujt që kemi shkëputur nga CK:

...Duem me t’pvetë një fjalë me na kallxue: / A jé kênë ndo ‘i herë zenjine?(Kënga 12, f. 106)

...Se duem me u hipë gjogavë n’shpinë, / E duem me dalë n’ato Bjeshkët e thata...(Kënga 19, f. 149)

Zgjedhimi i tretë na del në një rast të vetëm me ndërtimin, *duem me xânë*, si në shembullin e ilustruar:

...Kqyre Zânat, Mujit shka i kan thânë:/– Probatin na, Mujo, duem me të xânë..(Kënga 7, f. 65)

Foljet e parregullta na kanë dalë vetëm në dy raste me formën, *duem me rá*, si, p.sh.:

...Por na mbrapa ty s’po duem me t’rá, / Por Mujit hallin duem me i a kjá... (Kënga 2, f. 13)

...Ká qitë Muji e shokvet u ká thânë: / – Na n’Jutbinë shndosh duem me rá... (Kënga 6, f. 55)

Në CK **veta e dytë shumës** nuk del shpesh. Ajo na vërtetohet me nga një trajtë për secilin nga zgjedhimet. Këto trajta janë: *doni me çetue, doni me marrë, dueni me xânë*. Forma të parregullta në këtë ndërtim të së ardhmes nuk na kanë dalë në asnjë rast. Nga shembujt që kemi vjelë kemi vënë re se në këtë vetë, përveç ndërtimit të zakonshëm të së ardhmes, dalin edhe raste, ku ndërmjet ndërtimit hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë.

Krahaso:

a. ...Ju qi doni me çetue, / Çeta e mirë e e mbarë u daltë... (Kënga 23, f. 181)

b. ...– Ká qillue bjeshka e gjânë, / Gjith ku t’dueni vend me xânë... (Kënga 30, f. 225)

Veta e tretë shumës del me trajta vetëm për zgjedhimin e parë dhe të dytë.

Zgjedhimi i parë na del me pak forma, si: *duen me çetue, duen me pshtue, duen me shkue, duen me shkye* etj.

Po marrim disa shembuj nga CK:

...Përmjet rajes rruga i paska rá: / – Kta gabel ku duen me shkue?... (Kënga 3, f. 21)

...Me dhâmbë trimat duen shoshjnë me shkye, / Notojnë kurmat fëll në dét..(Kënga 4, f. 41)

...– Mos kjáj t’gjallët që në bjeshkë po duen me çetue / Se dekë mâ e âmël, s’âsht se n’luftë m’u pré...(Kënga 29, f. 218)

Zgjedhimi i dytë del me pak forma, si: *duen me dalë, duen me marrë*, si në vargjet:

...Me dhâmbë gjogat *duen* shoshojnë *me marrë*, / Notojnë trupat nëpër gjak... (Kënga 4, f. 41)
...Ku po dalin kta me treqind atllarë? / *Duen me dalë* n'at Kunorën e Bjeshkës... (Kënga 23, f. 176)

Konstrukt i së ardhmes me trajtën perifrastike due + paskajore e tipit "për me bâ"

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, për të shprehur kuptimin e së ardhmes vërtetohet edhe një konstrukt tjetër me trajtën perifrastike të formuar nga folja **due** + paskajore e tipit "**për me bâ**" (*don për me pré = do të presë*). Siç e dimë, në gegërishte, sidomos në gegërishten jugore, ekziston edhe një tip tjetër i paskajores, forma *për me punue*, që ka ardhur nga kontaminimi i paskajores *për të punue* me paskajoren *me punue*.³⁴³ Gjatë analizës të Këngëve Kreshnike na kanë dalë 4 ndërtime të tilla të së ardhmes, që i përkasin zgjedhimit të dytë.

Kështu, *veta e dytë njëjës* del me dy folje: *don për me pré*, *don për me vjerrë* dhe *veta e tretë njëjës* del me dy forma: *don për me pré*, *don për me vjerrë*. Në të gjitha rastet e vjela në mes formës të së ardhmes hyjnë elemente të tjera të fjalisë.

Po ilustruam shembujt përkatës nga CK:

Veta e dytë njëjës:

...A po *don*, bre Mujo, *për me t'pré*, / A po *don*, bre Mujo, *për me t'vjerrë*? (Kënga 21, f. 166)

Veta e tretë njëjës:

...Deri n'gjysë m'a ká xjerrë shpatën, / Sá po *don Halilin për me e pré*... (Kënga 25, f. 198)

Zgjedhimi jovepror

Në CK format e zgjedhimit jovepror të së ardhmes dalin në pak raste. Siç e theksuam më sipër, format e veprorës të së ardhmes dalin me 5 ndërtime, kurse në joveprore na kanë dalë më pak ndërtime foljore. Format e **joveprores** të së ardhmes në CK ndërtohen në të gjitha rastet me anë të pjesëzës **u**. E ndërtojnë formën në joveprore format e së ardhmes me **kam**, konstrukt *kam me la* dhe format e së ardhmes me foljen **dua**, konstrukt *due me shkue*. Format e së ardhmes me **kam** (tipi **kam** + paskajore gege **me la**) dhe me foljen **dua** (tipi, *due me shkue*) në zgjedhimin jovepror ndërtohen me ndihmën e pjesëzës me origjinë përemërore **u** (*kém me u bashkue*, *due me u provue*).

Ndërtimet e së ardhmes në joveprore, siç na vërtetohen në CK janë:

1. Forma joveprore e së ardhmes me kam, tipi kam + paskajore e foljes

Forma joveprore e së ardhmes me **kam**, tipi *kam* + *paskajore e foljes* në CK del rrallë dhe zakonisht me forma të joveprores të së ardhmes, kryesisht në numrin njëjës dhe më rrallë në numrin shumës.

Numri njëjës

Veta e parë njëjës del rrallë. Ajo na ka dalë me forma të **zgjedhimit të parë**, si: *kém me u bashkue*, *kam m'u dá* dhe me formën e **zgjedhimit të dytë**, *kam m'u nisë*.

Nga CK po japim vargjet:

...– Por mbas shëjesh qi gjogu m'ká, / – T'dy çetët shnosh *kém me u bashkue*... (Kënga 6, f. 55)

...Ktij bajlozit do t'i dal n'mejdan, / Zoti e din si *kam m'u dá*... (Kënga 10, f. 85)

...– Pasha 'i Zot mue qi m'ká dhânë, / Prej hapsanej s'*kam m'u nisë*. ... (Kënga 26, f. 209)

Veta e dytë njëjës, ashtu si edhe **veta e parë njëjës**, vërehet me pak forma për dy zgjedhimet e para:

Zgjedhimi i parë del vetëm me foljen *ké m'u bâ*.

Zgjedhimi i dytë del me foljet, si: *ké m'u mbathë*, *ké m'u veshë*.

Për vetën e dytë njëjës po ilustruam shembujt:

...E me marrë një strajcë të shkyeme, / Krejt si lypc, Zuku, *ké m'u bâ*... (Kënga 11, f. 93)

...*Ké m'u veshë*, babë, *ké m'u mbathë*, / Për me rá n'Agaj t'Jutbinës.... (Kënga 10, f. 82)

³⁴³ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.241.

Në **vetën e tretë njëjës** ndeshen format joveprorë të së ardhmes për zgjedhimin e parë, *ka me u bâ* dhe për zgjedhimin e dytë, *ka me u dridhë*, si në shembujt që kemi vjelë nga CK:

...Luftë e madhe *ka me u bâ*, / Notojnë trupat nëpër gjak... (Kënga 2, f. 14)

...N’shtatë furra t’kuquna me m’shtë, / Qërpiku i synit një herë s’*ka me m’u dridhë*... (Kënga 16, f. 131)

Numri shumës

Format e zgjedhimit joveprorë të së ardhmes me tipin *kam + paskajore* e foljes në numrin shumës janë të rralla. Ato vërehen vetëm në *vetën e parë shumës*. Në CK kjo vetë vërtetohet me format e zgjedhimit të parë (*kém m’u bâ*), e zgjedhimit të dytë (*kém me u mbytë*) si dhe me *formën e parregullt* (*kém m’u pá*).

Nga CK kemi veçuar vargjet:

...Probatina atëherë na *kém m’u bâ*. / Njatëherë Alija i ká besue... (Kënga 10, f. 87)

...Do kto gjâ né na i ké lshue, / Se pa to s’*kém ku me u mbytë*... (Kënga 1, f. 9)

...Se sot një javë në darsëm kam me t’ardhë, / Se sot një javë në darsëm *kém m’u pá*... (Kënga 10, f. 87)

Veta e dytë dhe e tretë shumës në zgjedhimin joveprorë nuk del në asnjë rast.

2. Forma joveprorë e së ardhmes me foljen dua, tipi dua + paskajore e foljes

Siç e theksuam edhe më lart, format e së ardhmes me foljen **dua**, tipi *due me shkue*, në zgjedhimin joveprorë ndërtohet me ndihmën e pjesëzës me origjinë përemërore **u** (*due + me u bâ*). Në CK, këto forma në joveproren e së ardhmes na kanë dalë vetëm në numrin njëjës, kurse në numrin shumës nuk na kanë dalë në asnjë rast.

Nga CK po marrim vargjet:

... – E *do me u pré* me Pajin Harambash, / Qi tridhet’ agaj qi i ká marrë... (Kënga 2, f. 14)

...Po m’a xjerrë shtatën e mejdanit, / Me idhnim trimi *don m’u pré*... (Kënga 25, f. 197)

Veta e parë njëjës del me forma të **zgjedhimit të parë**, si: *due m’u çue*, *due me u provue*, *due m’u shtërngue*, kurse **zgjedhimi i dytë** del vetëm me një formë, *due m’u pré*.

Po ilustruam me shembuj:

...Për mejdan mos kjosha mâ! / Qeraxhi sot *due me u bâ*... (Kënga 2, f. 19)

...Se sa pak Muji ká ndëjë, / Izën, mbret, se *due m’u çue*!... (Kënga 3, f. 22)

...N’tri rrugë kryq un *due m’u shtërngue*, / Nuk lâ kënd aspak me kalue... (Kënga 29, f. 219)

...Se mue m’thonë Gjeto Basho Muja, / *Due m’u pré* n’fushë t’mejdanit... (Kënga 21, f. 167)

Veta e dytë njëjës në zgjedhimin joveprorë del vetëm me trajtën e **zgjedhimit të parë**, *don me u martue*, si në rastin që kemi vjelë nga CK:

...Pse s’po *don Bani me u martue*? / Pse s’po don t’gjith neve me na gzue?... (Kënga 15, f. 123)

Veta e tretë njëjës, ashtu si dhe veta e parë njëjës del me trajtat e zgjedhimit të parë dhe të dytë.

Zgjedhimi i parë del me trajtat, si: *don me u çue*, *don m’u lshue*.

Nga CK po marrim shembujt:

...Edhe shtatit kadalë m’i ká dhânë: / Si bân bisha kúr *don me u çue* në kâmbë... (Kënga 23, f. 180)

...Mallim bjeshkën gjith kah p’e kundron, / Porsi shqypja kúr *don m’u lshue* n’gjâ... (Kënga 23, f. 184)

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *do me u pré* / *don m’u pré*, të cilat i ilustruam më lart kur krahasuam format e së ardhmes.

Në vijim po shohim ndërtimet e së ardhmes të së shkuarës, siç na vërtetohen në CK.

E ardhmja e së shkuarës

Kuptimi i themelor i kësaj kohe është të tregojë një veprim, që pritet të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës.³⁴⁴ Për të shprehur kuptimin e së ardhmes të së shkuarës, në CK ndeshim të përdorura dy konstrukte analitike të ndërtuara me anë të pjesëzës **do** dhe të foljes ndihmëse **kam**, me një përdorim të kufizuar.

I. Konstruktin me **do** + folje në të pakryerën e lidhore (*do të kallxojsh*).

II. Konstruktin me **kam** + paskajoren gege (*kish' me rá*).

I. Konstrukti i ndërtuar nga paravendosja e pjesëzës **do** formave vetore të kohës së pakryer të mënyrës lidhore të foljes në formën veprorë ndeshet e përdorur vetëm në një rast në *vetën e dytë të njëjësit* të zgjedhimit të parë, *do t' kallxojsh*, si në vargjet:

...Nevojë e madhe ktu, probu, m'ká prú: / Edhë kullat *do t'm'kallxojsh* ku i ká. (Kënga 2, f. 15)

II. Konstrukti i ndërtuar nga paravendosja e formave vetore të së pakryerës së dëftores së foljes ndihmëse **kam** paskajores gege (të tipit **me bâ**) të foljes që bart veprimin, (*kisha me bâ*). Ajo vërehet vetëm në *vetën e tretë të numrit njëjës* në tre raste me formën, si: *kish' me dalë* e zgjedhimit të dytë dhe me format e parregullta, si: *kishte me rá / kish' me rá*.

Nga CK po ilustruam:

...*Kish'* nevojë drita mos *me dalë*, / *Kish'* nevojë dielli mos *me rá*... (Kënga 26, f. 203)

Në mënyrë të përmbledhur po japim tabelën e të gjitha ndërtimeve të së ardhmes sipas vetave që na rezultojnë në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II:

Koha e ardhme			Veprorë		
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>do t'pres</i> <i>kam me besue</i> <i>due me pvetë</i>	<i>ké me ngrânë</i> <i>don me gzue</i> <i>don për me pré</i>	<i>do t'jetë</i> <i>ká me gjegjë ké</i> <i>don për t'pasë</i> <i>don me ardhë</i> <i>për me vjerrë</i>	<i>do t'marrim</i> <i>kém me xânë</i> <i>duem me çetue</i>	<i>keni me rá</i> <i>doni me marrë</i>	<i>do të bijnë</i> <i>kan me bajtë</i> <i>duen me pshtue</i>
–	<i>do të kallxojsh</i>	<i>kish' me rá</i>	–	–	–

Joveprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>kam m'u dá</i> <i>due me u provue</i>	<i>ké m'u mbathë</i> <i>don me u martue</i>	<i>ka me u bâ</i> <i>don me u çue</i>	<i>kém m'u pá</i>	–	–

3.4 Kuptimet e këtyre kohëve

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, përveç ndërtimeve foljore të mënyrës dëftore që dalin të pasura, paraqesin interes edhe kuptimet kohore të kësaj mënyre. Në këtë syth do të ndalemi në disa prej këtyre kuptimeve.

³⁴⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.317.

Koha e tashme

Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme është të tregojë kryerjen e një veprimi në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjëritimit.³⁴⁵ Format e së tashmes të mënyrës dëftore në CK dalin të pasura në kuptime kohore të ndryshme, ashtu edhe në kuptime modale. Më gjerësisht po i analizojmë secilin nga rastet.

Për sa u takon përdorimeve të kohës së tashme në materialin që kemi studiuar, përveç formës së thjeshtë, ndeshet e përdorur edhe forma e shoqëruar me pjesëzën caktuese *po*. Kur folja shoqërohet me pjesëzën *po*, ajo shpreh një veprim të veçuar me aspekt vazhdimësie,³⁴⁶ të cilin e kemi trajtuar gjatë paradigmës së zgjedhimit foljor të kohës së tashme të mënyrës dëftore.

...Mirë **po** *dí* se á logu i zânave/ E fjalës suej un nuk i *luej*... (Kënga 4, f. 30)

Po me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të kohës së tashme të ndihmëses *jam* dhe përcjellores së foljes themelore³⁴⁷: *ásht tuj msue*, si në rastin:

...Mejdanxhí, krajl, s'ká qillue, / Rishtas mazin Muji *ásht tuj m'a msue*... (Kënga 9, f. 73)

Këto dy forma u japin mundësi foljeve që të tregojnë një veprim të caktuar që vazhdon të zhvillohet në çastin e ligjëritimit.

Disa folje, që emërtojnë veprime, sidomos veprime fizike-fiziologjike, përdoren zakonisht, sidomos në fjalitë pyetëse, me pjesëzën *po*, edhe kur është fjala për veprime të veçuara. Kjo ndodh, për arsye se me anë të fjalive të tilla pyesim zakonisht për veprime të caktuara³⁴⁸, siç na e vërteton edhe shembulli që kemi vjelë nga CK:

...Turr te krajlí nâna paska shkue: /A don çikën, krajl, mâ fort a **po** *don* nderë?... (Kënga 22, f. 171)

Megjithatë, kur duam të përcaktojmë më mirë kuptimin kohor të së tashmes, mund ta përdorim pjesëzën *po* (*hesht, habitesh, dëgjon, qan*).³⁴⁹

...Amanet, mori motër, pse **po** *kán* ?! / Zêmrën dysh, mori motër, pse m'a *dán*?!... (Kënga 5, f. 44)

Në disa ligjëtime veriore, ashtu si edhe në materialin e studiuar në CK, foljet, *jam, kam, di* e ndonjë tjetër e kësaj kategorie përdoren edhe të paraprirra nga pjesëza *po*.³⁵⁰

Po ilustrujmë vargjet nga CK:

...Çka ká qitë Halili e ká thânë: – Shum e ftohtë bjeshka **po** m' *ásht*... (Kënga 21, f. 163)

...Qi s' **po** *kan* kurrkund për mbrapa, / Qi s'po i dhimben turkut as kaurrit... (Kënga 21, f. 161)

... –Mos, bre, Muj, n'Janinë me m'çue, / Jam i rí e luftës nuk **po** i a *dij*... (Kënga 8, f. 67)

Sipas F. Agalliu t pjesëza *po*: "... shërben për ta lokalizuar veprimin që shpreh folja, në momentin e ligjëritimit ose në një moment tjetër para këtij, që përbën sfondin e tregimit ose të përshkrimit".³⁵¹ Me të njëjtën nuancë kuptimore e kemi ndeshur edhe në studimin e Këngëve Kreshnike, si në rastet:

...Ti ç'farë ndere, Mujo, **po** na *lypë*? / A don forcë, Mujo, me qindrue?... (Kënga 7, f. 64)

...Amanet tý **po** t'a *lâ*, / Armë e petka n'shpí me m'i çue... (Kënga 32, f. 232)

Kuptimi i saktë i këtij elementi gjuhësor del në ndërtime, ku heqja ose vendosja e tij nuk e cënon fjalinë si strukturë, por ndryshon ngarkesën e saj kumtuese³⁵², e aktualizon ose jo veprimin, si në rastet e ilustruara nga CK:

Krahaso:

a. ...Lum për tý, o i lumi Zot! / Fort po shndritë njaj diell e pak **po** *xe*'!... (Kënga 4, f. 25)

³⁴⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.306.

³⁴⁶ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.50.

³⁴⁷ Po aty, f.49.

³⁴⁸ Shih: Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.306.

³⁴⁹ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.50.

³⁵⁰ F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë...*, vep. e cit., f.210.

³⁵¹ Po aty, f.209.

³⁵² Po aty, f.217.

...Tridhetë çikat nuses **po** i *bërtasin*: / – Ore nuse, Zoti të vraftë... (Kënga 12, f. 100)

...Se Zadrani shpirtin **po** m'a *merr*, / Tha – i ka britë Zâna prej shkambit... (Kënga 31, f. 229)

b. E çon Zoti një erë e një pshtjellsë,

E çon at dushk përjetë,

E në divanhane krajlit i *bjen*...

(Kënga 12, f. 101)

Kur janë të përdorura pa këtë pjesëz foljet në kohën e tashme dhe të pakryer tregojnë zakonisht veprime që s'kufizohen në kohë, pra zgjaten pa cak, përsëriten herë pas here dhe vazhdojnë s'dihet sa.³⁵³ Kemi gjetur një rast, ku veprimi duket se zgjatet në kohë, si:

...Edhë jashtë me ta ka dalë / – Grueja *kjaj* e plaku *fshâj*- ...

(Kënga 2, f. 18)

Një përdorim relativisht të dendur ka edhe pjesëza karakteristike e gegërishtes **kah**, e cila i paraprin formave të së tashmes. Por, gjatë studimit të materialit kemi ndeshur edhe raste të përdorimit, ku pjesëza karakteristike e gegërishtes **kah** ndiqet nga pjesëza **po**, të cilat paraprijnë formën foljore të së tashmes:

Krahaso:

a. ...– Edhe *tý*, Hyso, po të *pves*: / Fisin t'ând, ti **kah** m'a *ké*?... (Kënga 12, f. 105)

– Për **kah** *shkon*, ti lyps, a prej **kah** *vjen*?– / Fill prej krajlit jam tue ardhë... (Kënga 13, f. 115)

b. ... Dikush *kqyrë* rathët e qestekut, / Dikush *kqyrë* barin **kah po del**... (Kënga 27, f. 212)

Por ndigjoje lokën **kah po** t'*mson*! / Se edhë shpatën të prefët fort t'a ká lânë. (Kënga 2, f. 15)

Ndajfoljet apo lokucionet ndajfoljore në CK shoqërojnë shpesh format e së tashmes dhe mund të tregojnë:

a) kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjërimit. Më këtë kuptim në CK përdoren disa tregues, si: *nesër*, *pasnesër*, *sot një javë*, *sot*, *tash*, *qetash*, *etj.*

Nga CK po ilustruam:*

...**Sot** dobí vrapí s'po t'*bân*, / Se ndër kulla shkjaun na ká rá... (Kënga 21, f. 163)

...Xhevapë Halilit zânat te i kan dhânë: / – **Nesër** *pritet* Gjeto Basho Muja... (Kënga 21, f. 168)

...**Sot një javë** flokët i a *marr* djalit, / Kumár Mujin qi p'e kam... (Kënga 9, f. 73)

...**Qetash** *âsht* gjethi tue rá, / Ndoshta ândrra s'kallxon gjâ... (Kënga 21, f. 163)

b) Në materialin e studiuar kemi ndeshur edhe përdorime të lokucioneve ndajfoljore, që tregojnë kohëzgjatjen e një veprimi a të një gjendjeje, si: *natë e ditë*, *nândë dit e net*, *etj.*

Nga CK po marrim vargjet:

...**Natë e ditë** mu e njëkshtu m'*ruen*, / E ky gjarpën qi m'shetitë ndër varrë... (Kënga 23, f. 180)

c) Në CK disa ndajfolje tregojnë një veprim të çastit, të tilla, si: *fill*, *me 'i herë*, *për 'i herë*, *për një herë*, *etj.*

Po marrim vargjet nga CK:

...As-kërkund vend nuk kan xânë, / Por te miku **fill** po *shkojnë*... (Kënga 1, f. 2)

...N'tânë krajnín u *qit* me '**i herë** kushtrimi, / Gjith rreth kishën shkjet m'a kan rrethue... (Kënga 29, f. 220)

ç) Në CK disa ndajfolje shënojnë një veprim pak më të largët kohor, të tilla, si: *atëherë*, *njatëherë*, *qatëherë*, *etj.*

Njatëherë djalit keq po i *vjen*. / Nuk ká mujtë mâ m'u durue... (Kënga 15, f. 124)

... Bé po i bân n't'Lumin Zot. / **Qatëherë** Muji Halilin m'a *pajton*... (Kënga 8, f. 69)

d) Gjatë studimit të CK na kanë dalë edhe raste të shumta të formave të së tashmes, të cilat shoqërohen edhe me tregues me kuptim mbarëkohor, si: *gjithmonë*, *kurr/kurrë*, siç e vërtetojnë edhe shembujt që kemi vjelë nga CK:

...Máll e gjâ Zoti të ká dhânë, / **Gjithmonë** n'shpí me tý qi *rri*...

(Kënga 19, f. 155)

³⁵³ F. Agalliu, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, SF, Nr. 2, 1968, f.130.

* *Shembuj të tjerë vjelë nga CK: ...Atëherë ç'bân Hyso Radoica? / Në livad vraçin po e lshon... (Kënga 12, f.99); ...U kan rá atllarve n'shpinë, / T'dy për 'i herë n'Janinë po hînë... (Kënga 8, f.68); ...– Se ja *desim* t'dy për një herë, /–Ja kém pshtue t'dy për një herë... (Kënga 4, f.32)*

...Ujt e freskët tek ká qillue, / Si mos **kurrë** fladi po *fry*’... (Kënga 6, f. 52)

e) Nuk janë vetëm ndajfoljet e kohës që shprehin kuptime, por edhe ndajfoljet e mënyrës, por që japin një kuptim të menjëhershëm, si në shembullin:

...**Turr e vrap** rrugën po m’a *marrin*. / N’derë t’konakut Mujit na i vojtën...(Kënga 23, f. 178)

Gjatë studimit të materialit të CK, folja *ndëj* del me mbaresën -j të së tashmes së dëftores, por në shembullin që ilustron ajo ka kuptimin e kohës së kryer të thjeshtë:

... Por këna trim e besnik. / Pak *ndëj*, shum nuk vonoi / I a mrrîni Hyso Radoica...(Kënga 12, f. 103)

Foljet në kohën e tashme të mënyrës dëftore shprehin edhe modalitete të tjera, si modalitetin e dëshirores, ku folja e parregullt e vetës së dytë njëjës dhe shumës *vjen / vîni / vîjni* del vetëm me kuptimin e dëshirores në shprehje të ngulitura dhe shoqërohet me pasthirrma, si në rastet:

... – *Mirë se rrin* Muji i ká thânë, / – *Mirë se vjen* Raspoja i ká thânë... (Kënga 9, f. 75)

... – *Mirë se u gjëj*, mori tridhetë çika! – *Mirë se vjen*, more djalë jabanxhí!...(Kënga 12, f. 99)

... Natja e mirë Muj e Sokol Halili! / – *Mirë se vîni*, burrat e Jutbinës!... (Kënga 5, f. 51)

... – *Mirë se vîjni* – djelmve u ká thânë. / Amanet, o e ngrata plakë... (Kënga 12, f. 106)

Në raste të tjera, format kohore të së tashmes zbërthehen me një formë të dëshirores, por duke e mbajtur gjithmonë kuptimin kushtor, gjë që na vërteton edhe lidhëza kushtore (*në, nëse*), si në shembullin e ilustruar:

Qi tybe n’ Zotin mbrapa **n’i bie**³⁵⁴, / Mos me m’ardhë marrja e Jutbinës!... (Kënga 4, f. 38)

Në pak raste, forma e së tashmes së dëftores merr kuptimin urdhëror që ndiqet nga një formë e pastër e urdhërores, ashtu si në vargjet e ilustruara:

...Nuk ka djalë qi **rrokë** – Zuku i ká thânë, / Por **rrok** burrin qi ké marrë ... (Kënga 12, f. 94)

Koha e shkuar

E pakryera

Kuptimi themelor i kohës së pakryer të dëftores është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës.³⁵⁵ Në lidhje me çastin e ligjërit, veprimi i shprehur nga folja në të pakryerën është përfunduar, por kjo gjë kuptohet vetëm nga konteksti, sepse vetë folja në këtë rast nuk tregon gjë as për mbarimin e as për fillimin e veprimit të emërtuar prej saj.³⁵⁶ Shpesh folja në kohën e pakryer të dëftores në CK shoqërohet edhe me pjesëzën **po** (*po qitshin*), e cila, i jep mundësi foljes që në këtë kohë të tregojë një veprim të caktuar që ishte duke u zhvilluar në një çast të caktuar të së shkuarës, i cili shënohet zakonisht me anë të një treguesi kohor (rrethanor kohe ose fjali e varur kohore).³⁵⁷ Në materialin e studiuar në CK vërtetohen zakonisht shembuj të përdorimit të pjesëzës **po**, e cila shoqëron foljen në të pakryerën, duke e aktualizuar veprimin e foljes, por na kanë dalë edhe raste të përdorimeve kohore të paaktualizuara.

Krahaso:

a. ...Aty gjetkan trí copë makinë, / Qi **po qitshin** ár florî... (Kënga 2, f. 17)

b. ...Me qemerë mbrendë e ká qitë, / Gati **rrite** mbrendë Sokole Halili... (Kënga 2, f. 18)

Si në rastin e kohës së tashme edhe e koha e pakryer mund të dalë e shoqëruar me pjesëzën karakteristike të gegërishtes **kah**, e cila ndiqet nga pjesëza **po**, siç e vërteton edhe shembulli që kemi marrë nga CK:

...N’buzë t’nji kronit, n’dritë të hânës, / N’dritë të hânës **kah po lodroshin**...(Kënga 2, f. 12)

Gjatë studimit të materialit të CK kemi ndeshur edhe raste, kur forma e së pakryerës përdoret për të treguar një veprim, që është përsëritur herë pas here në të shkuarën. Kuptimi i përsëritjes

³⁵⁴ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., japin shpjegimin "Në i rafsha mbrapa", f.38.

J. Rrota, *Gjuha e shkrueme...*, vep. e cit. Forma *bie* del për vetën e parë njëjës njëlloj si në CK.

³⁵⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.308.

³⁵⁶ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit, f.52.

³⁵⁷ Po aty, f.52.

del nga konteksti. Në këto raste folja plotësohet shpesh nga tregues, që e bëjnë të qartë përsëritjen e veprimit, e shoqëruar zakonisht nga një plotës kohe, si: *nji sahat* ose nga një fjali e varur kohore. Në këtë rast folja nuk shoqërohet nga pjesëza *po*³⁵⁸, si në rastin:

...**Nji sahat** pushueshëm trimat s’*rrijshin* / Edhe mjaft shkjë vrá qi kishin... (Kënga 29, f. 220)
Gjatë studimit të këngëve të kreshnikëve kemi vënë re se e pakryera e foljeve *jam* dhe *kam* përdoret jo rrallë edhe me kuptimin e së tashmes.³⁵⁹

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...Përmbi ashtë *ish* (=është) shkam i gjallë, / Për nân-ashta të tânë rrëgallë..(Kënga 1, f. 4)

...Dymbdhetë ketesh kulla e naltë, / Kërkund shoqen nuk e *kishte* (=ka)... (Kënga 4, f. 35)

...Aty m’*ishin* (=janë) sarajet e krajlit, / Kulla parë trí ketsh e Llabutanit... (Kënga 23, f. 181)

Format e së pakryerës na kanë dalë edhe në pak raste, të cilat shprehin një veprim të së shkuarës të palidhur me raporte vartësie me veprime të tjera të së shkuarës, i cili kap një periudhë kohe të pacaktuar duke mos treguar caqet kohore as të fillimit e as të përfundimit të këtij veprimi.³⁶⁰

Me këtë kuptim të pacaktuar në CK na dalin pak raste, si:

...*Rrokte shkâmbin trimij okësh*, / Gjâ pa bâ ai nuk ka lânë... (Kënga 11, f. 91)

Siç e dimë, format foljore të kohës së pakryer nëpër proverba përdoren edhe me vlerën e mënyrës kushtore.³⁶¹ Në CK kemi ndeshur raste të përdorimit të këtyre formave, por që nuk mbartin vlerën kuptimore të proverbit.

Nga CK po marrim vargjet:

...*Se n’ mujsha djalin për me e rrê*, / Kâmbësh e duerësh për me e lidhë... (Kënga 11, f. 90)

...*Si në bâshin derën mos me e çilë*, / T’madhe – Mujo –, ké me thirrë... (Kënga 13, f. 114)

E kryera e thjeshtë

Folja e përdorur në kuptimin themelor të së kryerës së thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës.³⁶² Në këto raste në CK ajo zakonisht shoqërohet me ndajfoljet e kohës, si: *dje*, *vjet*, *atëherë* ose me togfjalëshat me kuptim kohor: *atë ditë*, *atë vit*, *para një jave*, që shënojnë një kohë të caktuar të së shkuarës dhe që përjashtojnë kështu çastin e ligjërimit.³⁶³ Në materialin e studiuar në CK vërehen disa tregues që tregojnë:*

a) kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjërimit. Më këtë kuptim në CK dalin disa ndajfolje, si: *sot*, *tash*, *njetash*, etj., që i paraprijnë foljes në të kryerën e thjeshtë.

Nga CK kemi shkëputur disa vargje për ilustrim:

...Tânë krajlín, me marrë **sot** e *qiti*, / Tânë shkjenín **sot** e *koriti*... (Kënga 23, f. 182)

...E rrash me tokë sarajet **tash** t’i *bâna!* / Vnerin Mujit fort i a paska dyndë.(Kënga 6, f. 60)

b) Në CK disa ndajfolje tregojnë një veprim të çastit, lidhur me çastin e ligjërimit, të tilla si: *me ‘i herë*, etj., si, p.sh.:

...Grue prej fisit qi kish’ kânë. / Sá **me ‘i herë** i a shndosha zêmrën... (Kënga 4, f. 38)

Në pak raste ndajfolja tregon një veprim më të largët në kohë, si në shembullin e dhënë:

...**Qatëherë** *foli* nusja prej oxhakut: / – Pash ‘i Zot, deber e gjibásh... (Kënga 20, f. 155)

ç) Në pak raste foljes në të kryerën e thjeshtë i prin treguesi kohor, **kurr**, për të vënë në dukje se veprimi i përfunduar në të shkuarën ka zgjatur një farë kohe, pra me vlerë mbarëhohore, si në rastin që kemi shkëputur nga CK:

...**Kurr** ndër shokë, ti bîr, nuk *shkove*, / As te dajat, bîr, nuk *dole*... (Kënga 13, f. 109)

Në vend të së kryerës së thjeshtë të foljeve *jam*, *kam*, përdoret aty-këty e pakryera e tyre. Kjo dukuri duhet të shpjegohet më shumë me faktin se këto dy folje tregojnë një gjendje, që e

³⁵⁸ Po aty, f.52.

³⁵⁹ Po aty, f.53.

³⁶⁰ E. Hysa, *Rreth përdorimeve të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF, Nr. 3, 1975, f.103-105.

³⁶¹ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.53.

³⁶² *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.308.

³⁶³ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.54.

karakterizon kryefjalën për një kohë të gjatë. E, me që, e kryera e thjeshtë, zakonisht, vë në dukje vetëm përfundimin e një veprimi a të një gjendjeje, por jo të zgjaturit e tij, ajo ka prirje të zëvendësohet nga e pakryera.³⁶⁴ Me pak raste e kemi ndeshur në material përdorimin e së kryerës së thjeshtë me kuptimin e së pakryerës, siç e vërtetojnë edhe shembujt e ilustruar:

–Ç’kje (=ishte) kjo brimë?’’ – Tanushës po i thonë? (Kënga 4, f. 32)

... – Ky s’kje (=ishte) lypsi fukarâ, / Por këna këne shjaku i biri i shkinës...(Kënga 13, f. 116)

...Se shtatë Omera t’mirë si i pata (=kisha), / Shtatë Omera jam kah kjaç e ngrâta...(Kënga 29, f. 218)

Disa forma të së kryerës së thjeshtë dalin më kuptimin kohor të së kryerës, siç del edhe shembulli në vijim:

...Shpejt e muer (=ka marrë) zogu, shpejt e çoi; / Por mâ shpejt Muja e këndoi(=ka kënduar)...(Kënga 22, f. 172)

Në materialin e studiuar e kryera e thjeshtë përdoret në disa raste në fjali të varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *po*. Në këtë përdorim ajo është sinonime me të tashmen e lidhore.³⁶⁵

Nga CK po japim shembujt:

...– Dheu m’ka mlue e fat s’i qita vedit, / –Po s’e mora (=nuk munda ta marr)Tanushen e krajlit’...(Kënga 4, f. 27)

...–Tutem, djali ká sharrue, / –Po s’erdh (=nuk mundi të vijë) Muji për me e pshtue...(Kënga 4, f. 38)

Në dy shembujt e ilustruar më sipër kushti del i qartë, jo vetëm me ndryshimin e modalitetit të foljes përmes ndryshimit të mënyrës (konkretisht lidhore), por edhe me shoqërimin e saj me një folje modale që duket se e kërkon konteksti.

Lidhur me disa forma, K.Topalli thekson: "...në dialektin e Veriut, ku e ardhmja e tipit *do + lidhore* është e rrallë, përdoren forma të tjera foljore për të shprehur kushtoren e kryer"³⁶⁶, si në rastin e mëposhtëm, ku për të shprehur të kryerën e kushtores përdoret koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore:

...Mos me m’ardhë marrja e Jutbinës, / Tybe n’Zotin kâmbën nuk e luejta... (Kënga 4, f. 38)

E kryera

Kuptimi themelor i kohës së kryer është të tregojë një veprim të përfunduar, që nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërit³⁶⁷. Siç e dimë, pjesorja është bartësja e kuptimit leksikor, por kuptimin kohor e shpreh tërë ndërtimi i kohës së kryer dhe ndonjëherë edhe për të dhënë këtë kuptim ndihmojnë edhe elemente të tjera të gjithë fjalisë, një prej tyre është edhe inversioni apo rendi i përmbytur. Siç e kemi theksuar edhe gjatë analizës së ndërtimit foljor, e kryera e dëftores me rendin e përmbytur është e pasur me shembuj. Në ndërtimet me rend të përmbytur(*pjesore + jam*), forma e së kryerës shpreh gjendjen emocionale të folësit, siç e vërtetojnë edhe vargjet:

...Kqyre zânave Muja çka u ká thânë: /...Kurr mâ ngusht kânë edhe nuk jam.(Kënga 21, f. 167)

Në kuptimin e saj themelor e kryera përdoret kur veprimi i përfunduar lidhet me çastin e ligjërit nëpërmjet pasojave të tij. Në këtë rast ajo mund të shoqërohet ose jo nga ndjafoljet e kohës (*sot, dje, këtë muaj*), që shënojnë një periudhë të caktuar kohe, e cila përfshin edhe çastin e ligjërit, por mund të shoqërohet edhe me tregues me një kuptim mbarëkohor, si: *gjithmonë, kurdoherë, kurrë etj.*^{368*}

³⁶⁴ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore*...pun. i cit., f.54.; *Gramatikë e gjuhës shqipe, I*,..., vep. e cit., f.311-312.

³⁶⁵ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore*..., pun. i cit., f.111.

³⁶⁶ K. Topalli, *Gramatika*..., vep. e cit., f.871.

³⁶⁷ *Gramatikë e gjuhës shqipe, I*,..., vep. e cit., f.312.

³⁶⁸ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore*..., pun. i cit., f.56.

Ky përdorim i foljes i shoqëruar me tregues kohor në të kryerën e dëftores në CK na del shumë i pasur dhe prandaj e kemi klasifikuar si më poshtë:

a) Ndajfoljet që tregojnë kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjëritimit. Më këtë kuptim në CK përdoren disa ndajfolje apo lokucione ndajfoljore, si: *sot, mbrâmë, mjesnatë, natje, nesret, qetash, njetash, tash, vjet, nesret mbrama*, etj. Po ilustruam me disa shembuj nga CK:*

...”Se qysh n’**natje** s’parit qi *jém kapë*, / ”Kurnji gjurmë përtej mâ s’e ká bâ...(Kënga 6, f. 61)

...Fill prej burgut **sot** *kam dalë*, / Po a din gjâ mue me m’kuvendë?... (Kënga 13, f. 113)

...Ja i ká çilë dyert shpejt e shpejt, / Jase drita e syve **qetash** t’u *ká errë!*... (Kënga 2, f. 17)

...Ne e **nesret mbrama** kúr *â errë*, / N’shpinë t’gjogut Zuku paska kcyë.. (Kënga 18, f. 143)

b) Në CK kemi ndeshur edhe përdorime të lokucioneve ndajfoljore, që tregojnë kohëzgjatjen e një veprimi a të një gjendjeje, si: *‘i natë e ‘i ditë, natë e ditë, nândë dit e net, nândë vjet, sot trí dit, trí javë, etj.*

Po ilustruam shembullin:

...Atëherë kafën e ká pí: / **‘i natë e ‘i ditë** aty *ká pushue*... (Kënga 18, f. 143)

c) Kemi ndeshur edhe raste kur ndajfoljet apo lokucionet ndajfoljore tregojnë një veprim të çastit, të tilla si: *brraf, bytym, fill, me ‘i herë, njetëherë, për ‘i herë, vrik; dikúr vonë, kurr mâ, natje heret*, siç e vërtetojnë edhe vargjet e shkëputura nga CK:*

...Kush âsht djalë te aga me shkue? / Të gjithë **për ‘i herë** kryet e *kan ulë*...(Kënga 27, f. 212)

...Ah! bé mb’Zotin paska bâ, / Qi dhimta e shtatit **bytym** tek m’*ká mê*... (Kënga 14, f. 122)

...**Dikúr vonë** Muji *ká thânë*: / Tí, Halil, n’Maje t’rreptë me dalë... (Kënga 29, f. 219)

ç) Në raste të tjera, ndajfoljet tregojnë një veprim të papërcaktuar më saktësi, si: *at-herë, herët, qat-herë (q’atëherë, qatëherë)* ose veprime të çastit, si: *me ‘i herë*.

Po japim vargjet:*

...**At-herë** djali mâ s’*â pritë* pá folë, / Dorën gojës Mujit i a ká vndue... (Kënga 4, f. 27)

...Për Jutbinë **heret** *âsht fillue*, / 30 Agë m’kuvend m’i ká bashkue... (Kënga 10, f. 82)

d) Gjatë studimit të CK na kanë dalë edhe raste të pasura, ku format e kohës së kryer, shoqërohen edhe me tregues me kuptim me vlerë mbarëkohore, si: *gjithmonë, për gjithmonë, kurr, kurr ma, askurr*.

Nga CK po ilustruam me shembuj:*

...**Gjithmonë** krenat m’i *ké prû*,

Gjithmonë dhuntín t’a *kam dhânë*,

Gjithmonë nishanat t’i *kam pré*... (Kënga 19, f. 152)

...**Kurr mâ** thekshim djali s’i *ká folë*: /—Amanet, mori motër, pse po kán?!...(Kënga 5, f. 44)

...Drit’n e diellit askurr s’e kam pá, / **Askurr** burgu mue nuk m’*ká pikue*... (Kënga 18, f. 142)

dh) Por, folja në të kryerën e dëftores del edhe me tregues kohorë që shënojnë veprime periodike, si: *asnji herë, shpeshherë, gjthsa herë, gjithëherë, ka herë*.

Nga CK po japim vargjet:

...Kúr i rí un *kam kânë*, / **Shpesh herë** gjaqet jú Agvet jau *kam marrë*... (Kënga 19, f. 147)

Se **kah herë** Halili në Lugje të Verdha *â rá*, / Në Lugje të Verdha Muji *â rá*...(Kënga 31, f. 228)

* *Shembuj të tjerë vjelë nga CK*:...Çou e shif seri me sy. / **Brraf** në kâmbë Muji *âsht çue*...(Kënga 9, f.71);...**Njetëherë** krajlí i *ká thânë*: / Sá herë turq qi ká pré...(Kënga 19, f.152); ...**Qat-herë** Muji *ká qitë e ká thânë*: / Kush jé ti qi shkon përpjetë?... (Kënga 6, f.58);...— Á trândë fusha kúr *â rrxue* balozi! / **Me ‘i herë** trimi shpatën m’a *ká xjerrun*...(Kënga 5, f.47);...Sá keq Mujos te i ká ardhë, / **Vrik** në shpinë gjogut te i *ká rá*...(Kënga 32, f.231);...N’**natje heret** Muji si m’*â çue*, / Mirë â mbathë, mire â shtëmgue...(Kënga 6, f.50)

Shembuj të tjerë vjelë nga CK:...”Nevojë e madhe ktu, probu, m’ka prû! / Për një msim **sot** t’a *kam msý*...(Kënga 2, f.15);...**Njetash** sýt t’dy i a *kam ngrânë*, / Hiç, por çika vesh s’ká marrë...(Kënga 27, f.214);...Por **mbrâmë** *ká ardhë* Plaku Qefanak, / Dishka tý, Mujo, t’âsht ankue... (Kënga 19, f.148); ...A din, nuse, **vjet**, se çka m’*ké thânë*? / Fjala e ême sá mirë m’ká dalë!.. (Kënga 21, f.162)

* *Shembuj të tjerë vjelë nga CK*: ...Edhë n’burg e kan shtëf, / **Për gjithmonë** burgun i a *kan pré*...(Kënga 13, f.112);...Idhëshëm orët, si gjarpni, shkjaut po i thonë: / **Kurr** kší njeri dér më sot s’*kém pá!*...(Kënga 2, f.12)

...Se **gjithëherë** bashkë *kém luftue*, / E po m'kânde 'i herë me t'ndrrue... (Kënga 24 f. 194)

e) Në raste më të rralla në CK ndajfolja tregon kohën që ka kaluar që nga kryerja e veprimit. Me këtë përdorim del vetëm me treguesin kohor, *motmot*, si në vargjet e vjela nga CK:

...Tjetër djalë n'votër nuk ké, / E qe 'i **motmot** me sy nuk e *ké pá*... (Kënga 4, f. 34)

Koha e kryer, përveç kuptimit të saj themelor del edhe me kuptime të tjera, kështu ajo mund të dalë edhe me kuptimin e kohës së kryerës së thjeshtë. Në këto raste ajo tregon vetëm përfundimin e një veprimi, pa vënë në dukje lidhjen e tij me çastin e ligjërimit. Në këtë përdorim, koha e kryer haset kryesisht në gjuhën e folur,³⁶⁹ pra për t'i bërë më të qarta pasojat e veprimit, se sa lidhjen e tij me çastin e ligjërimit:

Po ilustrojmë disa shembuj nga CK:

...N'treg t'Jutbinës kur *ká rá* (=rá), / I a *ká dhanë* zânin krahinës... (Kënga 1, f. 7)

...Se 'i djalë t'vetëm si *ké pasë*, / T'dy syt djalit për 'i burrë i a *ké verbue* (=verbove)... (Kënga 11, f. 95)

...Po i merr Muji gjaqet e po i tepron. / *Ká prâ* (=pushoi) lufta e n'bjeshkë kan kthye...(Kënga 19, f. 153)

...*Kan lânë* (=lânë) kângën zogjt e malit, / *Kan lânë* (=lânë) kângën me veshtrue...(Kënga 30, f. 225)

Në gegërishten, sidomos në të folmet popullore, të kryerën e mënyrës dëftore e gjejmë edhe si kohë tregimtare, në vend të së kryerës së thjeshtë.³⁷⁰ Edhe në CK vërehen raste të përdorimit të kohës tregimtare, e cila del e përdorur kryesisht në fund të Këngëve Kreshnike, si në rastet:

..."Njashtu thonë se atje kurr s'*jém kânë*;

Njashtu thonë se *ka kânë* motit,

Ndimën paçim na prej Zotit"!...

(Kënga 2, f. 19)

..."Se atje vetë nuk *jam kânë*, / Si kam ndie e si m' *kan thânë*...

(Kënga 16, f.135)

Format e së kryerës që dalin me kuptimin e së ardhmes, ashtu si edhe e kryera e thjeshtë, përdoren atëherë kur folësi e paraqet si një fakt të kryer një veprim, që s'ka nisur ende.³⁷¹ Në këtë kuptim kjo kohë përdoret zakonisht si kohë relative dhe kuptimin e së ardhmes e fiton në kontekst në bashkëvajtje me një folje në të ardhmen ose ndonjë kohë a mënyrë, që në kontekstin e dhënë përdoret në kuptimn e së ardhmes. Foljet që përdoren në këtë kuptim janë kryesisht foljet që tregojnë gjendje dhe jo foljet e lëvizjes,³⁷² siç e vërtetojnë edhe shembujt që kemi vjelë nga CK:

...Qí, ja martohem me gur e dhé, / Ja e *kam marrë* (= **do t'a marr**)Tanushen e Krajlit...(Kënga 4, f. 28)

...Kúr t'bajë Zoti me e lirue, / Gjâja e gjallë, druem, *ká mbarue*!(=**do të mbarojë**)...(Kënga 4, f. 25)

Pak forma të së kryerës të mënyrës dëftore na kanë dalë edhe me modalitetin e kushtores, si në vargjet e shkëputura nga CK:

...M'dhetë konopë atë me e pa' lidhë, / Dhetë konopë i *ká kputë* me 'i hera... (Kënga 11, f. 91)

...Qat- herë n'*dijsh për me u kuvëndë*, / T'*kan kallxue* kû e kan forcën... (Kënga 1, f. 6)

...“Për n'mi falsh, moj vash, dy syt e ballit, / *Ta kam pshtue* vlla Gjergjin prej mejdanit...(Kënga 5, f. 46)

³⁶⁹Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.57.

³⁷⁰Po aty, f.69.

³⁷¹Po aty, f.57.

³⁷²A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës ...*, pun. i cit., f.68.

Gjatë analizës së Këngëve Kreshnike kemi ndeshur edhe në disa ndërtime foljore që sipas studiuesve shënojnë hapin e parë drejt formimit të habitores në gjuhën shqipe.³⁷³ Në këto raste me anë të dy ndërthurjeve kohore jepet kuptimi i kohës së shkuar me të tashmen.

Po japim shembullin:

...*Se edhe un gjogun si e kam pasë e kam,*

Se edhe dy syt si i kam pasë i kam....

(Kënga 12, f. 95)

Në CK kemi ndeshur në disa përdorime të trajtave, ku folja në kohën e kryer ndiqet nga një trajtë e pashtjelluar foljore, konkretisht nga paskajorja e foljes. Në këtë rast kemi të bëjmë me dy veprime që ndjekin njëra-tjetrën, veprimi i parë në të kryerën mundëson edhe realizimin e veprimit tjetër. Këto ndërtime dalin në pak raste, të cilat shoqërohen me ndajfolje kohe ose lokucione ndajfoljore, si në shembujt:

...Por n’Jutbinë **qetash** *kém dá me rá:* / Hallet t’ona Mujit me i a kjá... (Kënga 2, f. 12)

”Qi n’ kjoftë Muji i gjallë e për të gjallë, /”**Sot trí dít t’ka prî me qitë** kunorë.”(Kënga 4, f. 38)

...Gjysën e shkjëve Muji m’i ká dâmtue, / Edhe gjysa *kan kthye me ikë*... (Kënga 28, f. 217)

...Të dy n’odë *kan shkue me rá,* / T’mira teshat m’i kan gjetë... (Kënga 10, f. 84)

Më së e kryera

Kuptimi themelor i kohës më se të kryer është të tregojë një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës³⁷⁴, si në rastin:

...T’a *kish dajtë*, se ksi burri jé, / E Halilin tý t’a kishe falë... (Kënga 31, f. 230)

Ky veprim i përfunduar:

a) mund të lidhet me çastin e caktuar të së shkuarës nëpërmjet pasojave ose duke vazhduar gjer në atë çast, si në rastin:

...Ç’ká qitë letra e *ki’ kallxue,* / –T’falë me shndet ti Krajl e Kapedan... (Kënga 9, f. 80)

b) ose mund të mos ketë lidhje me të³⁷⁵, siç e vërteton edhe shembulli:

...Se e *kish’ zaptue* Burc Eleze Krajli, / E s’jam i zoti n’mejdani me i dalë... (Kënga 24, f. 188)

Si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë, kuptimi i më se të kryerës përcaktohet nga konteksti.³⁷⁶ Në të dyja këto përdorime më se e kryera mund të shoqërohet me tregues kohor të caktuar, që shprehen me anë të plotësi kohe, ose me anë të një fjalie të varur kohore si në rastet në vijim:

a) Në materialin e studiuar vërehen përdorime të kohës më se të kryer e shoqëruar me ndajfoljet që tregojnë një veprim të çastit, si: *fill, me’i herë, m’nji here*, etj.

Nga CK po marrim vargjet:

... Në shpinë gjogut i kish’hipë, / **Fill** te Agajt *ishte nisë*... (Kënga 19, f. 146)

T’mirë selamin Agvet jau ká dhânë, / T’gjith **m’nji herë** *ishin çue* në kambë.(Kënga 19, f. 146)

b) Folja në kohën më se të kryer shoqërohet edhe me ndajfolje që tregojnë një veprim pak më të largët kohor, si: *atëherë, qat-herë*, etj., siç e vërtetojnë edhe shembujt që kemi vjelë nga CK:

...**Atëherë** nusja *ishte tradhtue.* / Ishte ulë derën e e kish’ çilë... (Kënga 13, f. 111)

...**Qatë-herë** djali sa *kish rá* n’breg t’lumit; / Ká lidhë gjogun mbrendë n’nji imshhtë...(Kënga 4, f. 31)

³⁷³F. Altinari, *Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian. Vëzhgime për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes dhe për formimin e habitores të shqipes* (artikull). Studiuesi pranon se "...në përmbysjen e sintagmës (PJESORE + KAM) dhe pastaj në përngjitjen e pjesores së shkurtuar me foljen ndihmëse, në zhdukjen e shkallëshkallshme të vlerës kohore origjinare dhe fitimin e një vlere modale në të cilën e kryera e "supozimit" do të përfaqësonte një pikë nisjeje dhe "habitorja" një pikë mbërritjeje, me një shkallë kuptimesh që shkojnë nga habia e folësit për një veprim të papritur, në mosmiratimin e një veprimi të pambështetur, shfaqur trajtesat e të tjerëve, në ironi dhe në dyshim. Prishtinë, 2014, f.16.

³⁷⁴ *Gramatikë e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.314.*

³⁷⁵ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore...*, pun. i cit., f.58.

³⁷⁶ *Gramatikë e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.314.*

- c) Në disa raste foljet në kohën më se të kryer shoqërohen edhe me një tregues me vlerë mbarëkohore, të tilla, si: *gjithherë, për gjithmonë*, etj., si në vargjet që kemi marrë nga CK:
...M’i çon lopët **gjithherë** ku s’i’n *kânë*, / ‘I natë lopët çobanit i paskan hupë... (Kënga 7, f. 63)
...Thellë në burg Alín e ki’n shtî, / **Për gjithmonë** burgut i a *ki’n pré*... (Kënga 13, f. 110)
Trajtat e kohës më se të kryer të dëftores na dalin edhe me modalitetin e mundësisë që këtë e shpreh zakonisht mënyra kushtore, por meqënëse edhe lidhorja si kushtorja shprehin modalitetin e mundësisë, në këtë rast kushti nuk shprehet nga një lidhëz kushtore, por nëpërmjet formave të kushtores, siç del edhe në shembujt e dhënë:
...Trí vjet ethet t’i *kishin marrë*, / **Për trí vjet nuk t’ kishin lshue**... (Kënga 18, f. 141)
...**Me e pas’pa’ Behurin gjallë**, / Shpirti tutësh u *kishte dalë*... (Kënga 6, f. 62)

Kohët e mbipërbëra

E kryera e mbipërbërë (p.sh: kam pasë larë) e gjuhës shqipe e shënon veprimin foljor si një veprim të përcaktuar kohor që është kryer a ka ndodhur në zgjatjen kohore të kohës së shkuar dhe ka përfunduar a mbaruar si proces.³⁷⁷ Lidhur me trajtat e kohëve të mbipërbëra³⁷⁸, Gj. Shkurtaj thekson: "Duke qenë trajta të gjalla në mbarë dialektin gegë si dhe në ndonjë të folme të Jugut, ato gjejnë përdorim më shumë për aftësitë e mëdha shprehëse e kuptimore".³⁷⁹ Me këtë kuptim na kanë dalë edhe në Këngët Kreshnike, siç edhe e trajtuam më sipër gjatë paradigmave të zgjedhimeve. A.Dodi pohon për formën e së kryerës së dytë: "...ajo përdoret si kohë absolute dhe relative".³⁸⁰

a) Në materialin e studiuar vërtetohen edhe përdorime të formave të mbipërbëra të së kryerës së dytë të shoqëruara me tregues kohor të caktuar, që aktualizon veprimin e foljes, si në rastin e përdorimit të lokucionit ndajfoljor, *turr*, si në rastin:

...Shum marak djali â bâ, / Sá **me turr** bjeshkën qi e *ki’ pa’ marrë*... (Kënga 12, f. 101)

b) Folja në kohën më se të kryer të dytë largohet pak me çastin e ligjërimit, por koha është e përcaktuar dhe del me treguesin kohor, *mbrâmë*, si në vargjet:

– **Mbrâmë** te shpija ti *ké pasë ardhë*, / Pak m’bjen ndër mend se t’kam pá..(Kënga 19, f. 149)

c) Folja në të kryerën e dytë të dëftores shoqërohet edhe me tregues kohorë me vlerë mbarëkohore: *askurr, dikúr*.

Ilustrojmë me shembuj nga CK:

...M’ká kcy e n’at gjog e m’i ká britë: / – Qindro, gjok, se **askurr** s’m’*ké pasë koritë*... (Kënga 15, f. 128)

...Se **dikúr** rrugën shkjevjet jau *ké pa’ ndalë*, / Se **dikúr** shkjevjet rrugën jau *ké pa’ pré*... (Kënga 34, f. 239)

Në një rast, forma e së kryerës së dytë na ka dalë e paraprirë nga pjesëza karakteristike e gegërishtes *kah*, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...Paj në derë – tha – **kah** *ki’ pa’ dalë*, / Shtjelm bre furkës i paska rá... (Kënga 10, f. 85)

³⁷⁷ A. Haxhillazi, *E kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe*, SF, Nr.1-2, 2011, f. 161-163.

³⁷⁸ Gj. Shkurtaj, *Dialekti dhe norma...*, pun. i cit., "...trajtat e mbipërbëra të foljeve nuk janë aspak dysorë të trajtave të përbëra përkatëse, prandaj, ndonëse gurrën e kanë kryesisht nga dialekti, nuk ka pse të mos pranohen në gjuhën letrare. Përdorimi i këtyre trajtave edhe nga shkrimtarë të sotëm jugorë tregon më së miri se ato përbëjnë mjete të nevojshme, te vlefshme sidomos për shprehjen e marrëdhënieve të parakohësisë, për të cilat duhet të tregohet më tepër kujdes si gjatë kodifikimit të normës, ashtu edhe në përgjithësi gjatë studimit të shqipes.", f.46.

³⁷⁹ Po aty, f.44-45.

³⁸⁰ A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës...*, pun. i cit., f.70.

Koha e ardhme

E ardhmja

Kuptimi themelor i së ardhmes është të tregojë një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit³⁸¹, si në shembullin:

...Nji rixhá, Mujo, un *do t'a báj*. / A s'na e falë njat Ali Agën e rí?... (Kënga 23, f. 178)

Koha e ardhme në CK del e pasur, jo vetëm në ndërtime, por edhe në kuptime kohore dhe modale. Më gjerësisht po i trajtojmë kuptimet kohore dhe modale duke dhënë edhe shembujt ilustrues.

Nga materiali i vjelë në CK, e ardhmja vërtetohet në disa raste me pjesëzën aktualizuese **po**, zakonisht në konstruktin me trajtën perifrastike *due + paskajore e tipit "me ba"*, si në rastin:

...Edhë rrugë **po duem me marrë**, / Nuk po shkepna çetë prej çete... (Kënga 6, f. 54)

Togu i formuar nga folja *dua + paskajore* gege shënon një veprim që mund të ndodhë së shpejti, sepse ka një kuptim të përafërt me shprehjet: "është duke...; është gati për të...; dhe përdoret si sinonim për formimet analitike të tipit, *jam/isha duke larë* ose *po+kohë e tashme /e pakryer e mënyrës dëftore*".³⁸²

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...Natë e ditë n'burg tue m'i lânë, / **Po don** kryet ai *me* jau *pré*... (Kënga 26, f. 209)

Në ndonjë rast format e së ardhmes paraprihen edhe nga pjesëza karakteristike e gegërishtes **kah**, si, p.sh:

...Hajt, bre bacë – Dizdari m'i ká britë, / **Kah don** frênin *me* i a *shtí* në gojë..(Kënga 23, f. 177)

...Kúr ká nisë drita për me dalë, / Ká pá popin n'kishë **kah don me ardhë**... (Kënga 29, f. 220)

Në materialin e studiuar, ashtu si në kohët e tjera të dëftores, edhe koha e ardhme shoqërohet me ndajfolje apo lokucione ndajfoljore, të cilat mund të tregojnë:

a) kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjërimit. Më këtë kuptim përdoren në CK disa ndajfolje, si: *sot, neser, tash, qetash*, etj. Këto ndajfolje dalin vetëm me ndërtimin foljor, *due me shkue*.

Po ilustruam vargjet:

...Lshojau zânin tridhetë agve t'vînë, / Se na **sot duem me çetue**!... (Kënga 6, f. 50)

...Për gjahë **neser duem me hî** ! / Shpejt janë mbledhë treqin gjah'tarë... (Kënga 1, f. 7)

...Ká qitë çikës e i paska thânë: / –Kush po **don tash me** na *ardhë*?... (Kënga 16, f. 126)

...**Qetash due** me *tý me u provue*, / **Qetash due** me *tý n'mejdan m'u pré*... (Kënga 25, f. 197)

b) Nga materiali i vjelë në Këngët Kreshnike, na kanë dalë edhe disa përdorime të lokucioneve ndajfoljore, që largohen pak nga çasti i ligjërimit, si: *sot nji javë, sot dy javë, sot gjashtë ditë, trí vjet*, etj. Këto lokucione ndajfoljore na kanë dalë në të dy ndërtimet e së ardhmes, si: *kam me bâ, due me bâ*.

Nga CK po japim shembujt:

...Se **sot nji javë** në darsëm *kam me t'ardhë*, / Se **sot nji javë** në darsëm *kém m'u pá* (Kënga 10, f. 87)

...Don me m'dhânë ndër gumana t' zez, / E **sot dy javë** nuse *kam me shkue*..(Kënga 22, f. 172)

Qi **sot gjashtë ditë** ktu prep *kam me kânë*, / Aspak krajli besë nuk i ká xânë..(Kënga 13, f. 113)

Për **trí vjet**, nânë, un *due me e pritë*, / **Trí vjet**, nânë, me letra *due me e lypë*..(Kënga 13, f. 112)

c) Por, në pak raste format e së ardhmes me ndërtimim, *kam me bâ* dalin të shoqëruara edhe me tregues me kuptim kohor të pacaktuar, si: *kurr, kurr mâ*, etj., si në rastet:

...Pse tânë Jutbina mbrapa me t'u vû, / **Kurr ç'me t'bâ s'po kan**... (Kënga 9, f. 74)

...Por me ty tek jam tue ardhë, / Drit'n e diellit **kurr mâ s'kém me e pá**... (Kënga 2, f. 16)

³⁸¹ Gramatikë e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.316.

³⁸² I. Arapi, Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore të paskajores e lidhores gege në veprën "Epika legjendare e Rugovës", në Eposi i kreshnikëve: Momument i trashëgimisë kulturore shqiptare vëllimi II. (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare. Prishtinë, 28-30 gusht 2010). Insituti Albanologjik – Prishtinë, 2016. f.575.

ç) Kemi ndeshur gjatë studimit të CK edhe raste të përdorimeve të kohës së ardhme, e cila shoqërohet edhe me tregues me vlerë mbarëkohore, si: *për gjithmonë, gjithmonë, për shumë vjet, etj.* Këto raste na dalin vetëm për konstruktin e së ardhmes *kam me bâ*.

Nga CK po japim shembujt përkatës:

– Se në mujsh nusen me i a marrë, / **Për gjithmonë** zenjin *kam me t'bâ...* (Kënga 13, f. 110)

...Sá mâ parë xhevap mue me m'dhânë, / Se **gjithmonë** me nânën *kam me t'ndêjë...*(Kënga 13, f. 112)

Nga studimi i materialit të Këngëve Kreshnike del edhe një rast, ku forma e së ardhmes paraprihet nga dy tregues kohor që kanë vlerë të caktuar dhe që vijnë njëri pas tjetrit. Shembullin e kemi ilustruar edhe më lart, por për arsye të këtij përdorimi po e rimarrim edhe një herë, sepse forma e së ardhmes paraprihet nga treguesit kohorë, *sot dhe p'r'itherë*:

...Gjakun Mujit *sot na do t'a marrim,*

“ Ndo të dy na **sot p'r'i herë** *do t'jesim...* (Kënga 23, f. 181)

Si në toskërishte, konstrukti *kam për të shkuar*, ashtu edhe në gegërishte konstrukti *kam me shkue* shprehin jo kohën e ardhshme, por detyrimin e ardhshëm, me këtë dallim që në gegërishten e folur përdoret për kohën e ardhshme³⁸³, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...Me ‘i shtjelm derës *ká me i rá,* / Copash derën *ká me e bâ...* (Kënga 2, f. 16)

Kjo dukuri është e përgjithshme, pra vërtetohet në të gjitha të folmet e gegërishtes pa përjashtim dhe në funksione sintaksore që janë karakteristike për paskajoret sintetike të gjuhëve të tjera indoevropiane, si latinishtja (*laudáre, crédere* etj.) gjermanishtja (*laben, glauben* etj.) etj.³⁸⁴

S. Mancaku për formën perifrastike *kam + paskajoren* gege *me ba*, thekson: “...është në pajtim të plotë me natyrën semantike të paplotë të foljes *kam*, me përdorimin e saj me një kuptim të papërfunduar, e cila për pasojë ka nevojë të plotësohet nga një fjalë tjetër, dhe me natyrën leksiko-gramatikore të paskajores, si një formë emërore e foljes që emërton një veprim të zhveshur në përgjithësi nga kuptimet gramatikore dhe e përshtatshme për të plotësuar një folje tjetër me karakteristika gramatikore të përcaktuara”.³⁸⁵ Edhe në CK, e ardhmja e ndërtuar nga *kam + paskajoren* gege “*me shkue*” ka të njëjtin kuptim, si në shembullin e ilustruar:

...– Gjë kjo ândërr mos me kallxue, / Kurr mâ ândrr’et s’*kam me u besue...* (Kënga 21, f. 163)

Sipas N.Topallit “...në formimin e trajtës *kam me bâ* mund të ketë ndikuar edhe forma *do të ketë bâ* që me këtë kuptim modal përdoret edhe në disa të folme, pra në këto përdorime, elementi i parë formues, koha e ardhme, *do të ketë*, mund të jetë zevëndësuar nga e ardhmja e tipit *ka me pasë* si forma kryesore e së ardhmes në përdorim”. Edhe në ndërtimet analitike e perifrastike të shqipes, me folje ndihmëse + paskajore, elementi i parë ka kuptimin themelor gramatikor, ndërsa elementi tjetër ka kuptimin themelor leksikor.³⁸⁶ Pra, kuptimet kohore dalin nga marrëdhëniet midis të dy elementeve përbërëse të formës analitike ose perifrastike. Kështu në ndërtimin *kam + paskajore*, ndërtimi ruan atë kuptim që ka folja *kam*.

Po ilustrojmë shembullin nga CK:

...Kqyr Halili shka i *ká thânë:* / Copë e grimë *cok kam me t'bâ...* (Kënga 2, f. 18)

Përsa i përket vjetërsisë së kësaj formë perifrastike *kam + paskajore me me* ajo është relativisht e hershme, përderisa ka një përdorim më të dendur në krahasim me përdorimin e së ardhmes me pjesëzën *do+ lidhore*. Por, nga pikëpamja kuptimore, e ardhmja *kam + paskajore* e ruan në një farë mase kuptimin e domosdoshmërisë që ka edhe ndërtimi i lirë, prandaj me të drejtë është quajtur *futurum necessitates*.³⁸⁷ Studiuesi K.Topalli e veçon këtë si dukuri karakteristike të

³⁸³ S. Riza, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.124.

³⁸⁴ B. Beci, *Dialektet e shqipes...*, vep. e cit, f.29.

³⁸⁵ S. Mancaku, *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam...*, pun. i cit., f.139.

³⁸⁶ Po aty, f.137.

³⁸⁷ Po aty, f.140.

gegërishtes veriperëndimore, në të cilën e ardhmja e mirëfilltë ndërtohet me *kam* + paskajore, kurse e ardhmja e tipit *do* + lidhore përdoret si një 'futurum necessitatis'.³⁸⁸

Krahaso:

a. Me m'ia shtë thumbat prej çelikut, / Se *do t'dal* m'u pré me bajloz t'detit!(Kënga 5, f. 46)

b. ...Mâ e para e diell qi ká me ardhë / At havale vetë *kam me t'a hjekë*... (Kënga 34, f. 239)

Me modalitetin e detyrimit na ka dalë edhe ndërtimi i së ardhmes, tipit, *dote me bâ*, siç e vërteton edhe shembulli i marrë nga CK:

...Djalë të mirë Zoti e ki' falë, / Edhe si babën *dote me e bâ*... (Kënga 11, f. 89)

Në materialin e studiuar na kanë dalë edhe disa raste, ku e ardhmja shpreh kuptimin e saj të zakonshëm, pa ndonjë nuancë domosdoshmërie.

Po japim shembujt:

...Tridhet agë *kan me u bashkue*, / Tridhet vasha t'i kan prû... (Kënga 4, f. 27)

...Mirë për nuse dert s'po kam, / Gjogun t'ând kû *kém me e marrë*? ... (Kënga 13, f. 116)

Me nuancën e domosdoshmërisë kemi ndeshur përdorime të shumta, zakonisht të ndërtuara nga forma perifrastike *kam* + *paskajore*, siç e theksuam edhe më sipër, por në CK me këtë modalitet na del shpesh edhe trajta perifrastike *due* + paskajore e tipit "*me ba*".

Po japim shembujt nga CK.

Krahaso:

a. Kthellë në burg vetë mazin *kam me e shtë*, / Frë as shalë nuk po i a hjekë... (Kënga 9, f. 74)

b. *Duem me shkue* n'Janinë të vogël, / Aty krajli ushtri po ká... (Kënga 8, f. 67)

Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike na kanë dalë edhe disa trajta të së ardhmes që ndiqen nga dy paskajore njëra pas tjetrës, duke e përforcuar edhe më shumë domosdoshmërinë e kryerjes së veprimit, si në rastet:

...N'maje t'majes *ké me shkue me rá*, / E të tâna gjak kê me bâ... (Kënga 33, f. 236)

...Nji mand t'thatë, qyqe, n'oborr e kém, / N'maje t'majes *ké me shkue me rá*... (Kënga 34, f. 23)

Përveç kuptimit të domosdoshmërisë, në disa raste në CK, e ardhmja e tipit *kam* + *paskajore* merr edhe kuptimin modal të mundësisë.

Për ilustrim po marrim vargjet nga CK:

...Drue sarajin shkja *ká me m'a djegë*, / Edhe nusen *ká me m'a grabitë*... (Kënga 13, f. 109)

...– Aspak marak, djalë mos u bân: / Dalë - kadalë e jona *ká me kënë*... (Kënga 13, f. 112)

...E dikush ndoshta *ká me t'ndigjue*, / Por vesh kûj, qyqe mos i vên... (Kënga 34, f. 238)

Në pak raste në CK format e së ardhmes shprehin kuptimin e kohës së tashme me vlerën modale të mundësisë.³⁸⁹ Gjatë analizës së sistemit foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, me modalitetin e mundësisë del vetëm folja, *do t'jet*, e vetës së tretë të njëjësit, si në rastin:

...Ká qitë Muji e ká thânë: / – Logu i zânave ktû *do t'jët*!... (Kënga 1, f. 4)

E ardhmja nuk shprehet me format e veta, por edhe me format e tjera, siç na vërtetohet edhe në këto vargje me format e së tashmes:

...Si n'mos mujsha me e gjetë për tri vjet, / Atëherë nji burrë **tash e zgiedh**... (Kënga 13, f. 112)

Koha e ardhme nuk del e pasur, vetëm me nuanca kuptimore, por edhe me nuanca modale. Kjo kohë shpesh del me modalitetin e urdhërores dhe të kushtores. E ardhmja në vetën e dytë dhe të tretë në numrin njëjës, dhe në vetën e dytë shumës "...përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin e urdhërores, për të dhënë urdhra nganjëherë më kategorikë se vetë mënyra urdhërore"³⁹⁰, siç edhe vërehen disa raste në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II.

Veta e dytë njëjës:

...E prep zâpt ti **ké me i bâ (=bëji)**, / Jose kryet atje un kam me e lânë... (Kënga 19, f. 149)

...Sá mirë Muja po i përgjegjë: / **Ké me bâ (=bën)** ti si t'soj vetë... (Kënga 1, f. 5)

³⁸⁸ K. Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit., f.874.

³⁸⁹ Sh. Demiraj, *Kuptimet kryesore*..., pun. i cit., f.61.

³⁹⁰ Po aty, f.61.

...Der'n përbrenda **ké me e ndrý**(=**mbylle**), / Vetë mbas deret **ké me ndêjë** (=rri)!(Kënga 2, f. 16)

Veta e tretë njëjës:

...Ká me qitë babës, **ká me i thirrë** (=thirr): / – M' u çue derën me m'a çilë...(Kënga 2, f. 16)

Veta e dytë shumës:

...Jau shilon nâna gjogat, jau shtërngon, / E n' Bjeshkë t' thata **keni me dalë** (=dilni)...(Kënga 25, f. 199)

Sipas studiuesit N.Veselaj, e ardhmja e ndërtuar sipas formës *ké për t' pasë* shpreh sigurinë e folësit për kryerjen e veprimit dhe prandaj ai e quan “*e ardhme e sigurisë*”.³⁹¹ Me këtë kuptim na ka dalë vetëm një rast, të cilin e kemi dhënë te ndërtimet e së ardhmes, por po e rimarrim këtu për të dhënë nuancën kuptimore:

...Por çilm derën e mos m'lên me pritë, / Se ti nânën nânë **ké për t'a pasë** !”(Kënga 4, f. 3)

Në CK e ardhmja që karakterizohet nga ndërtimi perifrastik *kam + paskajoren* e tipit “*me bâ*” dhe trajta perifrastike *due + paskajoren* e tipit “*me bâ*”, dalin edhe me vlerën e mënyrës kushtore.

Nga CK po iustrojmë vargjet:

...Sé n'm'a dhaç n'dhé me e mblue, / Si t'më thuejsh *kam me t' ndigjue*... (Kënga 16, f. 133)

...E n'kjosha i gjallë e për të gjallë, / Shpejt njiktu *kam me t' ardhun*... (Kënga 19, f. 151)

...Se për n'don ti ndër me pasë, / Shpejt, tha, çikën, n'konop me e vjerrë... (Kënga 22, f. 171)

Përsa i përket formës, konstrukti perifrastik *kam + paskajore* e tipit “*me bâ*” dhe konstrukti me trajtën perifrastike *due + paskajore e tipit “me ba”* në Këngët Kreshnike nuk paraqesin gjithmonë një strukturë shumë të ngurosur, ato shpesh dalin si togje të lira, ndryshe nga e ardhmja e tipit *do të punoj*, e cila del me një strukturë shumë të ngurosur. Kalimi i së ardhmes nga një tog i lirë në një formë perifrastike apo trajtë perifrastike nuk ka pësuar ndryshime të strukturës formale: elementi i parë që është i zgjedhueshëm si tog i lirë, mbetet i tillë edhe në përbërjen e formës perifrastike, ndërsa elementi i dytë është i pandryshueshëm në të gjitha rastet.³⁹² Rendi i përmbysyr i formave të së ardhmes kanë një përdorim të gjerë në CK. Arsyeja e këtij përdorimi lidhet me arsye të veçanta stilistike, ku folja ndihmëse *kam* dhe folja *dua* mund të ndërrojnë vend me paskajoren. Në këto shembuj kemi vënë re se ndërmjet formave të së ardhmes hyjnë elemente të tjera të fjalisë, si, përemrat vetorë, etj. Në raste më të rralla, ndërmjet formës të së ardhmes së përmbysyr nuk hyjnë elementë të tjerë, siç e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë nga CK:

Krahaso:

a. ...Sá m'ulë mazin me e pá, / Hânë e hýll me pá si i ká... (Kënga 9, f. 76)

...Shum inád çobajt si më kan, / Paj me forcë me jau kalue un due... (Kënga 7, f. 64)

...A don forcë, Mujo, me qindrue? / A don luftë, Mujo, me luftue? ... (Kënga 7, f. 64)

...Mazin Mujit i a kishte marrë, / Kam ardhë mazin për hajr me t'bâ... (Kënga 9, f. 76)

b. ...Kërkund vetëm mos me m'lânë, / Se un me pré due Pajin Harambash!.. (Kënga 2, f. 15)

...Se un me rá due n' Kotorre t'reja, / A thue *mundem* ndonji plaçkë *me bâ*... (Kënga 6, f. 54)

Siç u trajtua, mënyra dëftore del e pasur me ndërtime dhe me kuptime kohore. Kështu, koha *e tashme* e mënyrës dëftore del shumë e pasur në mbaresa vetore në zgjedhimin vepror dhe jovepror. Ajo na vërtetohet në të gjitha vetat në numrin njëjës dhe shumës. Koha e tashme e dëftores në vargjet e CK ndërtohet me mënyra të ndryshme, si: me forma gramatikore të mbarë shqipes, me veçori dialektore (kryesisht të gegërishtes veriperëndimore) dhe me veçori

³⁹¹ N. Veselaj, *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2006, f.113.

³⁹² S. Mancaku, *Ndërtimet me foljen...*, pun. i cit., f.141.

individuale të mbledhësve (siç ishte rasti i mbaresës -ë në vetën e dytë dhe të tretë të njëjësit). Shpesh struktura morfologjike e sistemit foljor karakterizohet edhe nga dukuri fonetike.

Ndërtimet analitike *jam + përcjellore, jam + kah há, isha + përcjellore*, megjithëse forma dytësore në CK, dalin shpesh edhe përkrah formave parësore me mbaresa të së tashmes dhe të pakryerës së mënyrës dëftore. Këto ndërtime të fundit duke qenë se edhe mbartin vlera apektore aktualizojnë edhe më mirë veprimin e shprehur nga folja bazë.

Siç vërtetohet edhe nga materiali i vjelë, format e së pakryerës së dëftores janë të pakta në numër. Në zgjedhimin vepror dalin forma në vetat e njëjësit dhe të shumës, me përjashtim të vetës së parë shumës që nuk del në asnjë rast. Trajta të së pakryerës në joveprorë na kanë dalë vetëm në vetën e tretë njëjës dhe shumës.

Koha e kryer e thjeshtë del e pasur në forma. Në CK format e së kryerës së thjeshtë ndërtohen ose sipas standardit të shqipes ose me veçori dialektore. Në disa raste kemi ndeshur edhe aoristin sigmatik. Kjo kohë na del me forma në veprorë dhe joveprorë në të gjitha zgjedhimet, si dhe me foljet e parregullta. Më i pasur në forma dhe në mbaresa vetore del zgjedhimi i parë i foljeve. Nga materiali i vjelë për format e së kryerës thjeshtë, na rezulton se, në përdorimin e mbaresave dhe formave në përgjithësi, gjuha e përdorur në CK paraqet variacione, nuk ndiqet një kriter fonetik gjatë paradigmave të zgjedhimit.

Format e së kryerës në zgjedhimin jovepror dalin me një numër më të vogël në krahasim me format në zgjedhimin vepror. Si në zgjedhimin vepror, ashtu edhe në atë jovepror, veta e tretë njëjës dhe shumës del më e pasur me forma. Me më pak raste me ndërtime në zgjedhimin vepror na ka dalë veta e dytë shumës, kurse në zgjedhimin jovepror kjo vetë në numrin shumës nuk del në asnjë rast. Ndërtimet foljore në veprorë me rend të përmbysur, ku më shumë e ku më pak, dalin në të gjitha vetat, por më të shpeshta këto ndërtime vërehen në vetën e parë dhe të tretë shumës. Format e vjela në joveprorë të së kryerës zakonisht dalin me rendin e zakonshëm. Por, kemi ndeshur edhe në pak raste, kur disa forma të vetës së parë njëjës dhe të tretë shumës dalin me rend të përmbysur.

Format e zgjedhimit vepror të kohës *më se të kryer* dalin në një numër më të madh në krahasim me format e zgjedhimit jovepror. Në zgjedhimin vepror nuk e kemi ndeshur në asnjë rast vetën e dytë shumës, kurse në zgjedhimin jovepror na del vetëm veta e tretë me forma në numrin njëjës dhe shumës, dy vetat e para nuk na vërtetohen me asnjë rast. Në veprorë veta e tretë del më e pasur me forma. Foljet ndihmëse si në veprorë ashtu edhe në joveprorë dalin të larmishme me trajta. Ndërtimet foljore të më se të kryerës dalin në pjesën më të madhe të rasteve me rendin e zakonshëm (folje ndihmëse + pjesore), përjashim këtu bën veta e tretë shumës në veprorë, e cila në pak raste del me rendin e përmbysur (pjesore + folje ndihmëse).

Koha e kryer e tejkshkuar në CK del në pak raste dhe vetëm me ndërtime foljore në zgjedhimin vepror. Ajo vërtetohet me trajta në numrin njëjës dhe shumës. Në numrin njëjës kjo kohë del me të tri vetat, kurse në numrin shumës del vetëm me forma për vetën e parë dhe të dytë. Në asnjë rast nuk na ka dalë veta e tretë shumës. Të gjitha ndërtimet foljore të së kryerës së tejkshkuar dalin me rendin e zakonshëm.

Kohët e mbipërbëra në CK vërehen me dy kohë: koha e kryer e dytë dhe më se e kryera e dytë. Koha e kryer e dytë e dëftores del me ndërtime vetëm në tri vetat e njëjësit në zgjedhimin vepror, kurse në zgjedhimin jovepror na ka dalë vetëm me një ndërtim foljor në vetën e parë njëjës. Koha *më se e kryer e dytë* e dëftores na ka dalë me ndërtime vetëm në vetën e tretë njëjës dhe shumës për të dy zgjedhimet. Koha e kryer e dytë del më shpesh në vargjet e CK, sesa koha më se e kryer e dytë.

Koha e ardhme në CK, ndërtohet nga e ardhmja dhe e ardhmja e së shkuarës. E ardhmja në zgjedhimin vepror ndërtohet nga format: *do + e tashme e mënyrës lidhore, kam + paskajoren gege "me bâ", kam + formë e pashtjelluar "për të bâ", due + paskajore e tipit "me bâ", due + paskajore e tipit "për me bâ"*, kurse format në zgjedhimin jovepror në të gjitha rastet ndërtohen

***Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)***

me anë të pjesëzës **u**, në trajtat, si: *kam + paskajore e foljes, dua + paskajore e foljes*. E ardhmja e së shkuarës na del me ndërtimet: **do** + *folje në të pakryerën e lidhore* dhe *kam në të pakryerën + paskajoren geqe*. Forma mbizotëruese e së ardhmes në CK vërtetohet me ndërtimin *kam + paskajoren geqe (kam me shkue)*.

Mënyra dëftore del e pasur edhe me kuptime. Nga shembujt e vjelë kemi vënë re se format e së tashmes dhe më rrallë të së pakryerës dalin edhe të aktualizuara (*po njef, po ishte*). Format kohore të së tashmes, kryerës së thjeshtë, kryerës dhe të ardhmes shoqërohen shpesh edhe nga tregues kohor (ndajfolje kohe apo lokucione ndajfoljore). Këto tregues kohor dalin më rrallë te ndërtimet foljore të kohës së pakryer dhe te kohët e tjera analitike. Shpesh, format e së tashmes dalin edhe me modalitete të mënyrave të tjera. Të pasura me kuptime kohore dhe modale dalin edhe format e së kryerës së thjeshtë, të kryerës dhe të ardhmes.

KREU IV : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS HABITORE

Me anë të mënyrës habitore shprehet në përgjithësi modaliteti i vërtetësisë, shoqëruar edhe me ndjenjën e habitës së folësit për një veprim të habitur, që është kryer në të shkuarën ose që kryhet në momentin e ligjëritimit.³⁹³ Të shprehurit e habitës, pra, është kushti kryesor i trajtave foljore të mënyrës habitore, dhe kjo gjë i bën të dallohen këto kuptimisht nga format foljore të dëftores. Nga ana tjetër, format foljore të habitores kanë një strukturë të anasjelltë dhe të ndryshme në krahasim me ato të dëftores: derisa format foljore të dëftores në kohën e kryer formohen me foljen ndihmëse përpara pjesores së plotë të foljes që bart veprimin, si, p.sh: *kam lidhë, kam thënë, kam dhënë* etj., format foljore të habitores ndërtohen, duke ia pasvënë pjesores së shkurtuar të foljes që tregon veprimin foljen ndihmëse, si: *marrkam, thankam, lidhkam* etj.³⁹⁴ Besim Bokshi, ka një tezë tjetër për krijimin e formave të habitores. Sipas tij baza për krijimin e formës së parë të habitores duhet të ketë qenë më se e kryera e dëftores e jo e kryera. Ai trajtën e shkurtër të pjesores brenda formave të habitores e sheh si shumë të rëndësishme për përcaktimin e kohës së krijimit të saj. Trajta e shkurtër e pjesores brenda habitores haset në tërë shqipen, prandaj edhe dëshmon lashtësinë e saj parashkimore.³⁹⁵

Sa i takon mënyrës së formimit të trajtave kohore të habitores, që për nga tipi i ndërtimit nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane³⁹⁶, është pranuar se zanafilla e kësaj mënyre lidhet me përngjitjen në formë të anasjelltë të së kryerës së përmbysur.³⁹⁷

Gjuhëtari Selman Riza pranon dy forma për habitoren: një habitore që shpreh habi, çudi dhe një tjetër me kuptim referativ, me anë të të cilit "ndodhja e fenomenit - origjinarisht është kumtuar nga një tjetër folës, të cilit prandaj edhe i lihet përgjegjësia e këtij kumtimi".³⁹⁸ Ethem Likaj i ndan format e habitores në dy grupe për nga mënyra e përfutimit: në forma të lindura sintaksërisht dhe forma të përfutura nëpërmjet analogjisë.³⁹⁹

Sh. Demiraj, duke iu sjellë argumentit lidhur me moshën e habitores thekson, ndër të tjera, se "ajo e ka zanafillën para fillimit të shkrimeve të para shqipe, sepse të shkrimtarët e vjetër e gjejmë të dokumentuar mirë".⁴⁰⁰ Ndër shkrimtarët e vjetër shqiptar të dialektit gegë, mënyrën habitore e ka përdorur më së shpeshti, P. Bogdani, kurse shkrimtarët e tjerë shumë më rrallë, gjë që mund të supozohet se djepi i formimit të kësaj mënyre ka qenë gegërishtja verilindore dhe se zanafillën e saj e ka para shekullit XVI.⁴⁰¹ Haborja është parë herë si formim i brendshëm i shqipes e herë si ndikim nga gjuhët e tjera.⁴⁰² Studiuesi Kolec Topalli e sheh mënyrën habitore si një krijim të brendshëm të shqipes, si "...një dukuri me karakter stilistik ka çuar në krijimin e një forme të re gramatikore, e cila pas formimit të saj ka pësuar një zhvendosje të dyfishtë: modale e kohore".⁴⁰³

³⁹³ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.308.

³⁹⁴ Sh. Demiraj, *Haborja dhe mosha e saj*, SF, Nr. 3, 1971, f.33, A. Dozoni, *Manuel de la langue chkiqe ou albanaise* (1878), f.226 (cit. sipas studimit të Sh. Demirajt, *Haborja dhe mosha e saj*..., f.33); E. Qabej, *Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes*, VI, sofia, 1968 (cit. sipas të njëjtit studim të Demirajt).

³⁹⁵ B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes* (vështrim diakronik). Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Prishtinë, 1998, f.106 -108.

³⁹⁶ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., (1986), f.906.

³⁹⁷ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike*..., vep. e cit., f.147- 150.

³⁹⁸ S. Riza, *Sistemi foljor*..., vep. e cit., f.133.

³⁹⁹ E. Likaj, *Format analitike*..., vep. e cit., f.110.

⁴⁰⁰ Sh. Demiraj, *Haborja dhe mosha e saj*, vep. e cit., f.47.

⁴⁰¹ R. Mulaku, *Sistemi foljor*..., vep. e cit. Në këtë studim mbi gjuhën e shkrimtarëve të vjetër të Veriut, autori sqaron se haborja gjendet më shumë me përdorimet në kohën e pakryer, f.117.

⁴⁰² V. Friedman: *The age of Albanian Admirative: A problem in Historical Semantics*, "...in Albanian, therefore, is a combination of language-internal and contact-induced change", in *Ex Anatolia Lux. Anatolian and Indo-European studies* (in honor of H. Craig Melchert). Ann Arbor. Beech Stave Press, 2010, f.38; shih edhe F. Altimari, *Vëzhgime për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes dhe për formimin e habitores së shqipes*, në "Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe", Prishtinë, 2002.

⁴⁰³ K. Topalli, *Gramatikë*..., vep. e cit., f.833.

Lidhur me numrin e mënyrave në gjuhën shqipe ka pasur qendrim të ndryshme.⁴⁰⁴ Walter Breu, në shkrimin "*Mood in Albanian*", pranon 10 mënyra, për gjuhën shqipe, ku e pranon habitoren si mënyrë, por shikon vështirësi në planin teorik.⁴⁰⁵

Mënyrën habitore e ka trajtuar edhe studiuesja Bleritë Ismajli, e cila shkruan: "Komentativiteti është vetëm njëri nga funksionet e habitores, ndërsa funksioni tjetër – shprehja e emocionalitetit vazhdon të jetë funksion i fuqishëm i habitores. Sidoqoftë, si në ras-tin e emocionalitetit, ashtu edhe në rastin e komentativitetit shprehet qëndrimi i folësit që është tipik për mënyrat. Pra, nuk mund të mohohet fakti se habitoret janë mënyrë".⁴⁰⁶ Për modalitetin përgjithësisht është pranuar se, "format kohore të dëftores për nga modaliteti karakterizohen negativisht, kurse format kohore të habitores për nga modaliteti karakterizohen pozitivisht".⁴⁰⁷

Ndërtimet e habitores në Epikën legjendare i ka trajtuar edhe studiuesja Mimoza Priku, e cila merr në shqyrtim kohët foljore dhe strukturat me të cilat paraqiten ato.⁴⁰⁸

Është provuar se përdorim më të dendur kanë gjetur ato forma kohore të habitores, nëpërmjet të cilave shprehen më natyrshëm kuptimet modale karakteristike të kësaj mënyre. Kështu, duke qenë se habia, ironia apo mosmiratimi i folësit shprehen në çastin e ligjërimit, përdorim më të dendur kanë pasur e kanë pikërisht ato forma kohore, që lidhen me këtë çast, domethënë e tashmja dhe e kryera.⁴⁰⁹ Një gjë e tillë vërehet edhe në CK, ku kemi vjelë vetëm forma në këto dy kohë, ndërsa forma e tyre paraqitet shpesh e thjeshtuar në standard.⁴¹⁰ Kohën e pakryer dhe më se të kryer nuk vërtetohen me asnjë rast. Në raste të veçanta përdorimi kemi ndeshur edhe kohën e mbipërbërë.

1. Kohën e tashme:	lânka
2. Koha e shkuar	
a. Kohën e pakryer:	–
b. Kohën e kryer:	paska mrrîjë
c. Kohën më se të kryer:	–
ç. E kryera e dytë	kênka kênë çue

4.1 Format e kohës së tashme

Zgjedhimi vepror

Kuptimi themelor i foljes në kohën e tashme të mënyrës habitore është *të shprehë habi për një veprim të caktuar që vazhdon të kryhet në çastin e ligjërimit*.⁴¹¹ Kjo kohë e habitores ndërtohet duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes format vetore të kohës së tashme të ndihmës **kam** (*ndeshkam*). Ndryshe, e tashmja e habitores është një formë sintetike e përfutur nga përngjitja e elementeve të kohës së kryer më rend të përmbysur.

⁴⁰⁴ Në *Gramatikën e gjuhës shqipe, I*, pranohen gjashtë mënyra (dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore); F. Agalliu diskuton për pesë mënyra, duke përfshirë kushtoren (*Mënyra lidhore në gjuhën shqipe*, në "Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1988).

⁴⁰⁵ W. Breu, *The classification of the admirative as a mood raises serious questions from a theoretical point of view, as it can combine with other moods (Mood in Albanian, "Mood in the Languages of Europe"*, John Benjamins Publishing Company, 2010, pg.457).

⁴⁰⁶ B. Ismajli, *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe ha-bitorja*, në "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit" (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë), Prishtinë, 2012, f.477.

⁴⁰⁷ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore...*, vep. e cit., f.104.

⁴⁰⁸ M. Priku, *Mbi disa ndërtime të habitores në Epikën legjendare*, në "Gjurmime Albanologjike" -Seria e shkencave filologjike, Nr. 43, 2013, f.91-100.

⁴⁰⁹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.171.

⁴¹⁰ E. Lafë, *Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional*, në përmbledhjen "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", "Norma e sotme e habitores kënduaka, shkuaqa, vrapuaka etj. po lëkundet mjaft nga format këndoka, shkoka, vrapoka (të ndërtuara nga tema e së tashmes)", Tiranë, 2003, f.15; Shih edhe Xh. Ylli, *Çështje të normës në trajtat e habitores*, në rev. "Gjuha jonë", Tiranë, 1987, Nr 4.

⁴¹¹ *Fonetika e Gramatika...*, vep. e cit., f.274.

Në materialin në shqyrtim në CK kemi vjelë forma vetëm për tri vetat e njëjësit, ndërsa në numrin shumë të kemi ndeshur vetëm shembuj të vetës së tretë. Veta e tretë njëjës dhe shumë ka një përdorim më të madh të formave në krahasim me vetat e tjera.

Numri njëjës na paraqitet sipas skemës:

Veta e parë njëjës del vetëm me një formë të zgjedhimit të dytë, si, *ndeshkam*, siç vërtetohet edhe nga shembulli:

...Qe nândë vjet, qi gjogu ksajt s’â rá, / M’fal se *ndeshkam* n’derën e magjupit!. (Kënga 5, f. 46)

Veta e dytë njëjës del me një përdorim relativisht të kufizuar me format, si: *folke*, *deshtka*, *kênke*. Secilin nga këto raste po e ilustruam me shembull nga CK:

...– Pash një Zot, korb, qi t’ká dhânë, / Se gjith sendi m’at vakt po *folke*... (Kënga 27, f. 214)

Ktheu një-herë e t’hîm brenda në shpî! / Ty dishká po *deshtka* sot me t’gjetë! (Kënga 4, f. 37)

...– Zoti të vraftë, Omer, i paska thânë, / *Kênke* i rí un sot me t’çartë... (Kënga 10, f. 86)

Për **vetën e tretë njëjës** kemi vjelë format:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *harrueke*, *gjetka* / *gjêka*, *këcyeka*, *kthyeke*, *lëshueke*, *rrethueke*, *shêmka*, *tërnueke*, etj.

Po japim disa shembuj nga CK:

...Aty *gjetka* plakun nandëqindvjeç. / – Mirë se t’gjetëm! – plakut i ká thânë.. (Kënga 2, f. 17)

...Për me shkue te kulla e bukur; / Aty m’ *gjêka* kullën xânë... (Kënga 4, f. 36)

...Sa herë trupin motra p’e *tërnueke*⁴¹², / Dhimb’ n e varrëve vllau krejt e *harrueke*, / Dhimba e motrës dekun n’tokë e *lëshueke*... (Kënga 5, f. 43)

...Qysh s’u *shêmka* kulla me na xânë! / Qysh s’u *kthyeke* shpija n’nji muranë. (Kënga 5, f. 43)

Për zgjedhimin e dytë kemi vjelë këto forma, si: *britka*, *marrka* / *mërrka*, *niska*, *qitka*, *përcjellka*, *pritka*, *shêmka*, *vrâka* etj.

Nga shembujt e vjelë nga CK kemi veçuar:

...Sa për gaz fjalën i a *mërrka*, / I a merr fjalën Dizdar Osman aga... (Kënga 5, f. 54)

...Kâmba – dorës âsht avitë, / Edhë e *pritka* një copë shatorrr... (Kënga 4, f. 32)

...Se ‘i tërmale qi *qitka* te kjo kullë, / Mue dy gjûjt tek m’i ká kputë... (Kënga 11, f. 93)

Foljet e parregullta dalin me pak forma, si: *dashka*, *lânka*, *kênka*, *pâka*, *paska*, si në rastet:

...M’a kan ngjitë “taraku i Kotorrit”, / E frima e gjallë s’u *lânka* peng për log! (Kënga 4, f. 28)

...‘I ândërr t’vshtír e paska pá: / *Pâka* n’ândërr një tufë berresh... (Kënga 4, f. 34)

...Por kjo *kênka* një hall fort i rândë, / Pse i varruemi *kênka* vorr për shpí... (Kënga 23, f.178)

Numri shumë

Veta e parë shumë nuk na ka dalë në asnjë rast.

Veta e dytë shumë na vërtetohet vetëm me formën, *dik’i* (ditkeni)⁴¹³, si në rastin:

...Faqebardhë, more shokë, ju kjoshi! / Se mirë hallin po ma *dik’i*, burra!... (Kënga 4, f. 26)

Veta e tretë shumë del me përdorim shumë të kufizuar vetëm me trajtën, *gjetkan*, siç e tregon edhe shembulli i vjelë nga CK:

...N’ maje t’ Bjeshkës kúr na kan dalë, / Aty *gjetkan* treqinq agallarë... (Kënga 23, f. 180)

Nuk kemi gjetur anjë rast të përdorimit të kohës së pakryer.

⁴¹² ndërroj

⁴¹³At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., japin shpjegimin "ditkeni", f.26.

Zgjedhimi jovepror

Format në *zgjedhimin jovepror* në të tashmen e habitores në CK (si në shqipen standarde) formohen nga paravënia e pjesëzës me origjinë përemërore **u** formave vetore të së tashmes së habitores në formën vepror: *u vrâka*. Në materialin e vjelë nga Këngët Kreshnike kemi ndeshur në pak raste forma të *vetës së tretë njëjës*, si: *u gjetka, u vrâka*, si në vargjet nga CK: ...Se ç’*u vrâka* Gjeto Basho Muji! / ...Zoti t’vraftë, bre Dizdar Osman aga!... (Kënga 6, f. 53) ...Si s’po *u gjetka* uj o kund me pí, / Si s’po *u gjetka* bor-o për me ngrânë... (Kënga 25, f. 200)

4.2 Format e kohës së shkuar

E kryera

Kuptimi themelor i kohës së kryer të habitores është *të shprehë habinë, dyshimin, mospajtimin etj., të folësit për një veprim të përfunduar, që nuk i ka këputur lidhjet më çastin e ligjërmit*.⁴¹⁴

Kjo kohë në formën veprorë ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes themelore të formave vetore të kohës së tashme habitore të ndihmëses **kam**, si: *paska bâ*, si në vargjet:

...’I gaz t’*madh* Shkjau *paska bâ*: / – Mujin me bâ vetë qi me e xânë... (Kënga 2, f. 12)

Nga materiali i vjelë kemi gjetur përdorime të formave habitore të *vetës së dytë dhe të tretë njëjës dhe shumës*. Në asnjë rast nuk na ka dalë në përdorim veta e parë e këtyre formave. Si për njëjës, ashtu edhe për shumës përdorim më të dendur kanë format foljore të *vetës së tretë*.

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

Veta e parë njëjës nuk vërtetohet në asnjë rast.

Veta e dytë njëjës del me një përdorim relativisht të kufizuar me format, si: *paske bâ, paske mbetë, paske vrâ, si*, p.sh:

...Buzën n’ gaz veç Muji m’a ká bâ: / – P’a s’po shef, Halil, se ç’*paske bâ*?. (Kënga 23, f. 185)

...– Ti qi jé mâ e mira e gjithëve, / *Paske mbetë* sot kërcunë e lânun... (Kënga 22, f. 171)

Në materialin e shqyrtuar **veta e tretë njëjës** del me një përdorim të dendur të formave. Sipas formave të vjela nga CK kemi këtë skemë:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *paska bâ, paska çue, paska gjue, paska hî, paska kcyë, paska kthye, paska lá, paska luejtë, paska lshue, paska mbërthye, paska mrrîjë, paska msue, paska ndie, paska ndrrue, paska prî, paska shkue, paska shfî, paska shtrue, paska vndue* etj.

Me disa nga këto forma po ilustruam shembujt që kemi marrë nga CK:

...Mue e vedit faqen me i a zbardhë, / Sá shpejt gjogu Shkján e *paska mrrîjë*..(Kënga 6, f. 59)

...*Paska ndie* Gjeto Basho Muja,

Paska ndie Zuku Bajraktari,

Paska ndie Plaku Qefanak...

(Kënga 14, f. 120)

...Djali popin n’ pushkë e *paska gjue*, / Dekun n’ tokë, popin e *paska lshue*..(Kënga 29, f. 220)

Zgjedhimi i dytë na ka dalë me trajtat, si: *paska çilë / paska çilun, paska dalë, paska dredhë, paska dyndë, paska folë, paska hasë, paska hipë / paska hypë, paska hupë, paska lidhë, paska marrë / paska marrun, paska ndalë, paska ndjekë, paska njeshë, paska pré, paska pvetë, paska qeshë, paska qitë, paska vra, paska ulë* etj.

Nga shembujt e vjelë kemi veçuar:

...Zot! A flet dhija në mal? / *Paska folë* dhija në mal!...

(Kënga 4, f. 29)

⁴¹⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.274.

...Ká britë t’madhe Shkjau i Kotorrit: / Edhë ftyra zjarm i *paska marrun*... (Kënga 4, f. 37)
...Huj mbë shokë, tha, Muja *paska marrë*. / E mirë nuses po i kallxon ... (Kënga 14, f. 121)
...Ai në bjeshkë si *paska hipë*, / Çka ká bâ Gjeto Basho Muji... (Kënga 27, f. 211)

Për **zgjedhimin e tretë** kemi gjetur vetëm dy forma, si: *paska zânë* / *paska xânë*, siç e kemi ilustruar edhe me vargjet:

...Se n’ krajli Muji *paska dalë*, / Edhe ‘i nuse e *paska zânë*... (Kënga 1, f. 1)
...Shpejt, tha, çikën n’ konop me e vjerrë, / Pse dashtni në turk çika *paska xânë*...(Kënga 22, f. 171)

Foljet e parregullta na kanë dalë me disa forma, si: *paska ardhë* / *paska ardhun*, *paska dekë*, *paska dhânun*, *paska ndêjë*, *paska pá*, *paska rá* / *paska rámun*, *paska thânë* etj, siç e tregojnë edhe shembujt:

...“Amanet, motra e Gjergje Eles Alisë”! / Edhë shtatit trimi i *paska dhâmun*.(Kënga 5, f. 47)
...– Ndalnje kângën – tha dajre mos me bâ, / Se ‘i probatin – tha – mue *paska dekë*...(Kënga 10, f. 87)

... I u ká lutë të lumit Zot: / – ‘I zog prej malit *paska ardhë*... (Kënga 14, f. 119)
Krejt p’e kndon kângën n’gjuhë t’parve; / E kshtu drita e mbrame m’*paska ardhun-ó!*...(Kënga 4, f. 40)

Numri shumës

Veta e parë shumës nuk del në asnjë rast.

Nga format e vjela në Këngët Kreshnike kemi ndeshur vetëm një rast të përdorimit të **vetës së dytë shumës** me formën e parregullt, *paski pasë*, siç e tregon edhe shembulli:

...Inat t’madh Mujit i *paski pasë*, / T’tâna luftat Muji si u ká bâ... (Kënga 26, f. 206)

Veta e tretë shumës:

Zgjedhimi i parë del me disa trajta, si: *paskan bâ*, *paskan çue*, *paskan gjetë*, *paskan hî*, *paskan mê* (*paskan pushue*), *paskan ndie*, *paskan pshtue*, *paskan rrue*, *paskan shkue* etj.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...E përpara Mujit i ká prî, / E n’krajli t’dy *paskan hî*... (Kënga 19, f. 152)
...Shpejt e shpejt berberët i ká prû, / E aq mâ shpejt e *paskan rrue*... (Kënga 26, f. 209)
...Hjeke të madhe *paskan bâ*, / Shndosh e mirë aty janë dá... (Kënga 26, f. 210)

Për **zgjedhimin e dytë** kemi vjelë këto forma, si: *paskan dalë*, *paskan dredhë*, *paskan dyndë*, *paskan fjetë*, *paskan ndeshë*, *paskan vrâ* etj.

Nga këto formime kemi veçuar vargjet:

...Mirë selamin jau kan bâ, / Fort mâ mirë agajt i a *paskan dredhë*... (Kënga 6, f. 51)
...Të dy shpatat lik i *paskan ndeshë*, / Katër copash po m’i thejnë... (Kënga 15, f. 128)
...N’ Lugje t’Verdha kúr ká dalë, / Djalín Shkjét i a *paskan vrâ*... (Kënga 30, f. 224)

Format foljore të **zgjedhimit të tretë** dalin me një përdorim relativisht të rrallë. Kemi ndeshur format, si: *paskan zanë*, *paskan pí*, si në shembujt e ilustruar:

...Gjallë me dorë i *paskan zanë*, / E n’ Jutbinë me to ká rá... (Kënga 1, f. 8)
...Qatëherë shkina fjalën e ká lânë. / Paskan hângër e *paskan pí*... (Kënga 9, f. 79)

Foljet e parregullta dalin me format, si: *paskan hângër*, *paskan lânë*, *paskan rá* / *paskan ramun*, *paskan pá*, *paskan thânë* etj, si në shembujt:

...Vllá e motër dekun *paskan ramun!* / Kurrkuj shpirti mâ mirë s’i ká dalun!...(Kënga 5, f. 47)
...Mirë kan ngrânë atëherë e mirë kan pì, / *Paskan rá* trimat e *paskan fjetë*...(Kënga 25, f. 199)

Zgjedhimi jovepror

Format e *zgjedhimit jovepror* të kohës së kryer të habitores në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II vërtetohen në disa raste dhe formohen nga paravënia pjesore së foljes themelore të formave vetore të foljes **jam** në të tashmen e habitores, si: *kênka fillue, kênka tutë* etj., siç e pohon edhe shembulli:

...Edhe mbreti fort na *kênka tutë*: / Mos o Zot! – tha Muja e Halili... (Kënga 3, f. 22)

Nga materiali i vjelë nga Këngët Kreshnike kemi vënë re se forma joveprorë del me forma të vetës së dytë njëjës dhe vetës së tretë njëjës dhe shumë, por më e pasur nga këto përdorime është veta e tretë njëjës. Në asnjë rast nuk vërtetohen forma të *zgjedhimit* të tretë.

Numri njëjës del me forma të vetës së dytë dhe të tretë.

Veta e dytë njëjës del vetëm një herë në CK me formën, *konke çue* dhe në raste të rralla me formën e parregullt, *kênke kânë*, siç e tregojnë edhe shembujt e ilustruar nga CK:

...P'a prej vorrit, Gjergj, ti *konke çue*? / Pse me m'qitë, bre burrë, n'ket fushë t'mejdanit!?... (Kënga 5, f. 46)

... – Hajt, Alí, t'kjoftë rruga e mbarë! / Se besnik ti *kênke kânë* ... (Kënga 13, f. 117)

Veta e tretë njëjës:

Zgjedhimi i parë del me disa forma, si: *kênka bâ, kênka çue / konka çue / kânka çue, kênka fillue, kênka hî, kênka idhnue, kênka ngushtue, kênka shkue / konka shkue, kênka shtërngue* etj. Folja ndihmëse *jam* në kohën e kryer të habitores del me disa trajta gramatikore, si: *kênka çue / konka çue / kânka çue*, si në shembujt e vjelë nga CK:

Krahaso:

a. ...Trêmshen grûeja *konka çue*! / Fill tu krajli *konka shkue*... (Kënga 4, f. 34)

b. ...Halla n'kâmbë Alija *kênka çue*, / Ah! bé mb' Zotin paska bâ... (Kënga 14, f. 122)

c. ...Jalla n' kâmbë Halili *kânka çue*, / Sá shpejt gjogat i ká shtërngue... (Kënga 19, f. 150)

Shembuj të tjerë të vjelë nga Këngët Kreshnike:

...Fort Halili *kênka idhnue*, / Me duer n'í shkallve po u ngjitet... (Kënga 2, f. 14)

...Alla n'kâmbë djal ásht çue, / Për bejleg *kênka shtërngue*... (Kënga 26, f. 209)

Zgjedhimi i dytë del i pasur me forma, si: *kênka armatisë, kênka çilë, kênka dalë, kênka dredhë, kênka dridhë, kânka hipë / kênka hipë, kênka hupë, kênka ikë, kênka lodhë, kênka mbathë, kânka mbetë / kênka mbetë, kênka mbushë, kênka mshehë, kênka ndalë, kênka ndeshë, kênka ndezë, kênka ngrehë, kênka prishë, kênka rritë, kênka sjellë, kênka trembë, kênka tutë, kênka veshë* etj.

Nga CK po ilustrojmë me shembuj:

...N'tri orë t'bardha *kênka ndeshë*, / N'buzë t'nji kronit n'dritë t'hânës... (Kënga 2, f. 12)

N'odë të Mujit trimi *kânka hipë*; / Mirë m'janë veshun trimat e m'janë mbathë. (Kënga 6, f. 50)

...M'i ká kcyë, tha mazit n' shpinë, / Tu arnauti, tha, *kênka mshehë*... (Kënga 9, f. 74)

...*Kênka veshë* Plaku e *kênka mbathë*. / M' ká veshë gozhup e zhelana... (Kënga 20, f. 158)

...E sa mirë *kênka armatisë*, / E ká marrë shpatën e mejdanit... (Kënga 21, f. 164)

Foljet e parregullta në vetën e tretë të njëjësit dalin me këto forma, si: *kênka kânë / kênka kênë, kânka rá / kênka rá / konka rá, kênka vajtë* etj, siç e tregojnë edhe shembujt:

E n'derë të mbretit Muja *kânka rá*. / Kúr â kapë për shkallë përpjetë me hipë. (Kënga 3, f. 22)

... – Ky s'kje lypsi fukará, / Por *kênka kênë* shjaku i biri i shkinës... (Kënga 13, f. 116)

... – Sá kopil Muji *kênka kânë*, / Qi n' bjeshkë t' nalta qi ká dekë... (Kënga 33, f. 235)

Veta e tretë shumës del e pasur me forma.

Zgjedhimi i parë del me disa forma, si: *kâncan çue / kênkan çue, kênkan gjue, kênkan punue, kênkan shkue* etj.

Nga CK po i referohemi shembujve:

...Kulla rishto shum *kênkan punue*, / Probatinit kullën i a kam harrue!... (Kënga 12, f. 99)

...Krah për krah me t’bín e krajlit, / Fill te miku *kênkan shkue*... (Kënga 9, f. 78)

...Halla n’kâmbë trimat *kâncan çue*, / Në shpinë gjogavet u kan hipë ... (Kënga 29, f. 221)

Për **zgjedhimin e dytë** na kanë dalë format, si: *kênkan dalë / konkan dalë, kênkan dredhë, kênkan kallë, kênkan kapë, kênkan marrë, kênkan mbathë, kênkan mbetë, kênkan mbledhë, kênkan ndeshë, kênkan sjellun, kênkan shkepë, kênkan veshë* etj.

Nga këto formime kemi veçuar:

...Kushtrim, djalë, për me çetue! / Me ‘i herë trimat *kênkan mbledhë*... (Kënga 4, f. 38)

...Shndosh e mirë aty janë dá, / Ngryka – ngryka *kênkan marrë*... (Kënga 26, f. 210)

...Nândë pushkë të flakës – tha – *kênkan kallë*, / Nândë – tha – n’shtat tek e kan marrë... (Kënga 32, f. 231)

Foljet e parregullta na dalin me përdorime më të pakta në krahasim me format e tjera, si: *ko’ncan kânë, kênkan rá, kênkan vojtë* etj.

Nga Këngët Kreshnike po japim vargjet:

...T’gjith ngrî n’ari si *ko’ncan kânë*, / E Halilit para i a ká shtrue... (Kënga 4, f. 33)

...Të tre te nusja *kênkan vojtë*. / Nusja muer Plakun Qefanak... (Kënga 14, f. 120)

...Kúr ish kânë Muji me Halilin, / Me fjetë trimat *kênkan rá*... (Kënga 28, f. 215)

Kohë të mbipërbëra

E kryera e dytë

Kjo kohë e habitores, karakteristike për gegërishten⁴¹⁵, ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes që bart veprimin e formave vetore të së kryerës habitore të ndihmëses **kam** për formën veprorë dhe **jam** për formën joveprorë. Gjatë analizës së Këngëve Kreshnike forma të habitores në kohën e kryer të dytë për zgjedhimin vepror⁴¹⁶ nuk na dalin në asnjë rast, kurse për zgjedhimin jovepror na del vetëm një rast me formën, *kênka kênë çue*, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...Zuku n’kâmbë *kênka kênë çue*, / Në shpinë gjogut m’i ká kcyë... (Kënga 27, f. 212)

4.3 Kuptimet e këtyre kohëve

Siç u theksua edhe gjatë trajtimit, mënyra habitore përdoret zakonisht për të shprehur habinë, dyshimin, mospajtimin etj. të folësit për një veprim të caktuar. Por veprimi që ngjall habinë, dyshimin etj. të folësit mund të jetë edhe i tillë që përsëritet herë pas here, ose që mund të ketë vlerë mbarëkohore⁴¹⁷, sipas shembujve të ilustruar:

...Edhë hâna *paska hupë* mbas çetash; / Edhë kângën *paskan më* bylbylat... (Kënga 6, f. 53)

...Dy topuzat – tha – *kênkan ndeshë*, / Shpatë për shpatë – tha – *kênkan dredhë* (Kënga 15, f. 128)

...Sá shpejt lufta aty *kênka ngrehë!* / Shumë potera aty *kênka bâ!*... (Kënga 21, f. 168)

⁴¹⁵ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.176.

⁴¹⁶ Át Donat Kurti, *Gramatika shqipe*, ... forma veprorë e kohës së kryer të dytë e habitores del me formën: *un paskam pasë lá*, vep. e cit., f.107.

⁴¹⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.319.

Me anë të kësaj mënyre mund të shprehet edhe dyshim ose mospajtim e ndonjëherë ironi, lidhur me një thënie a pohim të një tjetri, siç e kemi ilustruar me format kohore të mënyrës habitore, por nuancat kuptimore të habitës e të ironisë shprehen dhe me ndërtimet në fjali pyetëse, si në shembujt:

...Po kjo vashë ndorë qysh t’ka rá, / Qi né pahin krejt na *paska marrë?!...* (Kënga 4, f. 33)

...”Po kjo çikë n’dorë kah t’ká rá, / Qi n’dynjë, shoqen s’e *paska!?”...* (Kënga 4, f. 34)

...Çfarë idhnimit, djalë, sot t’*paska rá?* / Nânës s’vet Zuku i ká thânë... (Kënga 18, f. 141)

Në kuptimin themelor e tashmja e habitores shoqërohet shpesh me pjesëzën **po**, që jep nuanca aktualizimi, si, p.sh.:

...Sá shpejt mazi na áshtr rritë, / Fort **po niska** m’u mërzitë... (Kënga 9, f. 71)

...Si s’**po** u *gjetka* gjâ-o kund m’u gjue, / Si s’**po** u *paka* çetë-o me luftue!... (Kënga 25, f. 200)

Për kohën e kryer të habitores nuk kemi gjetur asnjë përdorim të pjesëzës **po**.

Ndërtimi *kah + folje në të tashmen e habitores* është më i rrallë:

...Mirë po e ndritë rrugën e shpatit, / **Kah përcjellka** do dasmorë... (Kënga 6, f. 62)

Kjo formë foljore shoqërohet shpesh me ndajfolje kohe duke përforcuar kuptimin e saj kohor dhe mund të tregojnë:

a) kohën e saktë të kryerjes së një veprimi lidhur me çastin e ligjërit. Më këtë kuptim në CK përdoren disa tregues, si: *qetash, sabah, sot, nadje heret*, etj.

Në këto përdorime kemi ndeshur kryesisht format kohore të së kryerës dhe më rrallë përdorimet e së tashmes.

Po veçojmë disa shembuj nga CK:

...Me t’peshueme plaku ‘i fjalë ká folun: / **Qetash dashka** Zoti me na fikun⁴¹⁸... (Kënga 23, f. 178)

...Dritë ká dalë, dielli s’ká rá, / **N’sabah** Muji kênka çue... (Kënga 9, f. 74)

...**Nadje heret** trimat *kênkan çue*, / M’a kan ndezë zjarmin n’oxhak... (Kënga 25, f. 196)

b) Në CK disa ndajfolje shpesh tregojnë një veprim të çastit, të tilla, si: *braf, fill, me ‘i herë, vrrik* etj.

Po marrim vargjet nga CK:

...Po un balozit qysh i shkoj tu dera! / **Braf** në kâmbë por djali *konka çue*... (Kënga 5, f. 45)

...Në shpinë gjogut m’i ká kcyë, / **Fíll** te kulla *paska rá*... (Kënga 27, f. 212)

...**Me ‘i herë** çikat *kênkan shkepë*, / Me ‘i herë vasha â ulë me rá... (Kënga 4, f. 32)

c) Format e së kryerës së habitores shpesh shoqërohen edhe me ndajfolje që shënojnë një veprim pak më të largët kohor, të tilla, si: *atëherë, njatëherë, qatëherë*, etj.

...**Njatëherë** Muja *kênka ngushtue*, / Shpejt ai zânavet po m’u thrret... (Kënga 15, f. 128)

...**Qat-herë** drita m’ *konka errë*. / Lum për ty, o i lumi Zot!... (Kënga 4, f. 31)

ç) Në pak raste format e së kryerës së habitores dalin edhe me ndajfolje që shënojnë një veprim të papërcaktuar kohor, siç na e vërtetojnë edhe shembujt e vjelë nga CK:

...Ká nisë dita me ague, / Muji **heret kênka çue**... (Kënga 18, f. 141)

...Qatje **vonë** kuvendin *paska xânë*: / Pa ndigioni, more shokë kreshnikë... (Kënga 6, f. 53)

d) Më rrallë kemi gjetur përdorimin e lokucioneve ndajfoljore, që tregojnë kohëzgjatjen e një veprimi a të një gjendjeje, si: *nândë vjet, tre sahat, trí vjet* etj., si në rastet:

...**Tre sahat** tha *kênkan* sjellun / Sall nën vedi Halili e ká qitun... (Kënga 9, f. 69)

...Jau u kan shtí burgagijt n’ kâmbë, / N’burg **nândë vjet** i *paskan lânë*... (Kënga 16, f. 130)

...Për gjith ditë mâ keq *kênka vojtë*, **E trí vjet** mb’t’shtrve *kênka mbetë*... (Kënga 14, f. 119)

Nuk janë vetëm ndajfoljet e kohës që shprehin kuptime, por edhe ndajfoljet e mënyrës, por që japin një kuptim të menjëhershëm, si në shembullin:

⁴¹⁸ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., del me kuptimin "me qitë fare, me shkatërrue e zhdukë", f.142.

...**Turr** te krajl i nâna *paska shkue*: / A don erz me pasë, a mârren n’derë?... (Kënga 22, f. 171)
Trajatat e shkurtra i bashkëshoqërojnë trajtat kohore të mënyrës habitore duke ndihmuar edhe në përforcimin kuptimor të kësaj kohe⁴¹⁹, si, në rastet:

...Aty plaku **u paska folë**: / “Po ndigjoni, o krushq darsmorë!”... (Kënga 1, f. 2)

...Shpejt ndërmjet **u paska hî**: /—Zoti të vrafët, moj zâna e madhe!... (Kënga 1, f. 6)

...Kur po hîn Halili mbrendë, / Aty **e marrka** Jankën e bardhë... (Kënga 2, f. 17)

...Sa mirë nâna bjeshkët **m’i paska gjue**! / Sa shpejt deti djalin ká ndigjue.. (Kënga 4, f. 29)

...Se ’i andër t’vshtirë sonte kam pá. / Hajre i kjoftë! – **i britka** krajl... (Kënga 4, f. 34)

...T’dyve lott **u paskan pshtue**, / Shoqishojë ngrykë e kan marrë... (Kënga 12, f. 105)

...Se ti gjaksin mue **m’a paske vrá**. / Vrá ké krajlín, vrá ké Llabutanín!... (Kënga 23, f. 185)

Për efekte stilistikore është përdorur edhe rendi i përmbytur i formave kohore të së kryerës:

...Edhe ’i nuse e *paska zânë*, / **Zânë e paska** t’bín e krajlit... (Kënga 1. f. 1)

Nuk janë të rralla ndërkëmbimet mes foljeve ndihmëse në ndërtimin e kohës së kryer habitore, sidomos ndihmësja *jam* në vend të foljes *kam*; p.sh.

...E mb’t’shtrúe *kênka rá*. / Hiç mâ mirë Alija nuk po bân... (Kënga 14, f. 119)

...E n’ shpinë t’gjogavet u kan rá, / *Kênkan dalë* n’at fushë t’mejdanit... (Kënga 18, f. 145)

...Të nândta n’zëmër m a kan prekë, / Sall pak gjallë – tha – Muji *kânka mbetë*..(Kënga 32, f. 231)

Në vargjet e Këngëve Kreshnike bie në sy vendosja mjaft e shpeshtë e njëra pas tjetrës e ndërtimeve habitore, të cilat japin kuptime më intensive, si: “konka çue, konka shkue”(f. 34), “paskan hângër e paskan pí”(f. 79), “kênka vojtë, kênka mbetë” (f. 119), “kênka veshë, kênka mbathë” (f. 158), “paskan rá, paskan fjetë” (f. 199), “kênkan veshë, kênkan mbathë” (f. 215), “paska gjue, paska lshue” (f. 220) etj.

Duke iu referuar vjeljeve të bëra në CK na rezulton se format kohore të mënyrës habitore në CK janë të larmishme. Vërtetohen zakonisht koha e tashme dhe e kryer. Këto kohë dalin me forma të zgjedhimit vepror dhe jovepror. Koha e tashme del e pasur me forma, me përjashtim të vetës së parë shumë që nuk del në asnjë rast. Format e së kryerës në zgjedhimin vepror vërtetohen me vetën e parë dhe të dytë në njëjës dhe shumë, kurse format e vetës së parë nuk na dalin në asnjë rast. Në zgjedhimin jovepror, koha e kryer del me pak forma. Në asnjë rast nuk dalin forma të së pakryerës dhe më se të kryerës. Trajatat e habitores shpesh shoqërohen me elemente, si: pjesëza, ndajflope, të cilat ndihmojnë për krijimin e nuancave të reja kuptimore. Duke iu referuar shembujve kemi rindërtuar këtë skemë për mënyrën habitore.

⁴¹⁹ M. Prik, *Mbi disa ndërtime të habitores...*, pun. i cit., f.96.

Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)

Mënyra habitore			Koha e tashme		
Veprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
ndeshkam	folke deshtka	harrueke shêmka	–	dik’i	gjetkan
		<i>joveprorë</i> u vrâka			

Koha e kryer			Veprorë		
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
–	paske bâ	paska dhânun	–	paski pasë	paskan dalë

Joveprorë

Numri njëjës		Numri shumës
Veta II	Veta III	Veta III
konke çue	kênka tutë	kenkan kallë

KREU V : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS LIDHORE DHE KUSHTORE

Mënyra lidhore është një nga mënyrat e trashëguara të gjuhës shqipe. Por gjatë zhvillimit historik ajo ka pësuar ndryshime largvajtëse, si nga ana kuptimore-funksionale, ashtu edhe nga ajo formale.⁴²⁰ Sa i takon anës formale (ndërtimit të kësaj mënyre), ashti siç vërtetohet edhe në CK, në krahasim me format e tjera është pajisja e saj (si dhe në shqipen standarde) me pjesëzën **të**, që në zanafillë është një lidhëz nënrenditëse⁴²¹, si në rastin:

...Se *t'çoj* me dhí, e po m'i lën n'mal, / Se *t'çoj* në çetë me dalë... (Kënga 2, f. 14)

Nga pikëpamja formale lidhëzja prej dëftores, dallohet kryesisht prej një elementi gjuhësor të paravendosur **të**, i cili nga Sh. Demiraj "është quajtur formant i paravendosur dhe i është njohur funksioni i dallimit të mënyrës"⁴²².

Nga materiali i vjelë nga Këngët Kreshnike, mënyra lidhore del e pasur në ndërtime foljore. Duke iu referuar shembujve që kemi vjelë, mënyra lidhore na vërtetohet me kohën e tashme dhe të shkuarën:

- | | |
|---------------------------------|---------------------|
| 1. Kohën e tashme: | t'báj |
| 2. Koha e shkuar | |
| a. Kohën e pakryer: | t'kiske |
| b. Kohën e kryer: | t'kém ardhë |
| c. Kohën më se të kryer: | t'kish dijtë |

5.1 Format e kohës së tashme të mënyrës lidhore

Kjo kohë ndërtohet nga paravendosja e pjesëzës **të** formave vetore të së tashmes së dëftores (**t'báj**). Në pikëpamje sinkronike më i saktë do të ishte pohimi se e tashmja e lidhore formohet mbi bazën e temës së kohës së tashme të dëftores.⁴²³

Foljet e përdorura në këtë kohë në CK, me përjashtim të foljeve *jam* e *kam* (që në të tashmen e lidhore dalin me temë në -e), dalin me tema të njëjta me atë të kohës së tashme të mënyrës dëftore (por të prira nga pjesëza **të**).

Krahaso:

a. ...I a ká dhânë zânin krahinës: / Kushdo *t'jësh* gjah'tar në treg... (Kënga 1, f. 7)

b. ...Gjith – ku *t'kësh* nuse me marrë, / Gjith – ku *t'kësh* baloz me pré... (Kënga 1, f. 9)

Mbaresat vetore për të tashmen e lidhore, përveç vetës së dytë e të tretë njëjës, siç do të analizohet në vazhdim, nuk ndryshojnë nga ato të së tashmes së dëftores. Për të gjitha foljet, duke përfshirë edhe foljet *jam* e *kam*, mbaresa vetore e vetës së dytë është **-sh** (refleks i mbaresës së hershme indoevropiane **-si**⁴²⁴), kurse ajo e vetës së tretë është **-ë**.

Në CK dalin të tri vetat e njëjësit e të shumësit, por më i pasur me forma vërtetohet numri njëjës.

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës na vërtetohet me këto mbaresa vetore:

Veta e parë: -j / zero / -i

Veta e dytë: -jsh / -(i)sh

⁴²⁰ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.865.

⁴²¹ Po aty, f.876.

⁴²² Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, pun. i cit., f.103.

⁴²³ F. Agalliu, *Mënyra lidhore në gjuhën shqipe. Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, vep. e cit., f.15.

⁴²⁴ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.684.

Veta e tretë: -(j)ë

Veta e parë njëjës e së tashmes së lidhore del e pasur, jo vetëm me forma për të gjitha zgjedhimet si dhe me foljet e parregullta, por e pasur edhe në paradigmen e zgjedhimit, duke marrë kështu më shumë mbaresa se shqipja standarde. Këto forma dallohen në vetën e parë njëjës të së tashmes, edhe nga pjesëza **të**, që merr para ky ndërtim foljor, e cila në materialin e vjelë nga përmbledhja "Visaret e Kombit" II, zakonisht karakterizohet nga dukuria e elizionit ku -ë-ja fundore bie (*t'*).

Krahaso:

a. ...Ku *t'* jët puna për mejdan, / Mejdanxhí vetë **të dal**... (Kënga 24, f. 190)

b. ...Paska qitë e i paska thânë! / Si **t'tham** un ti ké me bâ!... (Kënga 2, f. 16)

Veta e parë njëjës e së tashmes së lidhore vërtetohet e ndërtuar me tre formante. Ato janë:

1. Me formantin -j dalin vetëm forma të zgjedhimit të parë, si: *t'bâj, t'blëj, t'çoj, t'duroj, t'gjëj, t'hîj, t'kallxoj, t'lshoj, të/t'ndrroj, t'punoj, t'soj, të shiloj, t'shkurtoj, të shtërngoj, t'rruiej, t'rrxoj* etj.

Nga shembuj e vjelë nga CK kemi veçuar shembujt:

...Frê e shalë ti me m'i dhânë, / Terbjët gjogun si *t'a bâj*... (Kënga 9, f. 76)

...E në livad vrâçin *t'a lshoj*, / E *t'a shiloj* vrâçin e *t'a shtërngoj*... (Kënga 12, f. 99)

...Edhe kryet ktu *t'a shkurtoj*, / Se fort mundim na kè dhânë sot... (Kënga 22, f. 174)

...*T'i blëj* vetë arë e livade, / Edhe kullën vetë **t'a punoj**... (Kënga 24, f. 191)

2. Krahas mbaresës vetore -j, zgjedhimi i parë në CK në vetën e parë njëjës na ka dalë në pak raste edhe me forma të së tashmes që dalin me mbaresën zero. Me formantin zero na dalin pak forma të **zgjedhimit të parë**, si: *t'hî, t'shtî* etj., siç na e vërtetojnë edhe shembujt që kemi vjelë nga CK:

– Çilma derën, Rushe, mbrendë *t'hî*. / – Nuk muj derën, thotë, me *t'a çilë*... (Kënga 18, f. 143)

...Vig ma ki'n Osman agën e rí, / A m'a fal qi n'dhë *t'a shtî*... (Kënga 16, f. 133)

Me formantin zero ashtu si në shipen standarde e kemi ndeshur me format e **zgjedhimit të dytë**, si: *të dal / t'dal, t'marr*, etj., siç e tregojnë edhe shembujt nga CK:

...*T'i a marr* motrën e të bín,

T'i a marr shpatën e mejdanit,

T'i a marr selín prej dukatit,

T'i a marr rêmet kah *t'i kén*... (Kënga 21, f. 161)

...Ku *t'a marr* 'i krah dushk me ngrânë, / Sá fort ûja m'ká lodhë... (Kënga 11, f. 92)

Për **zgjedhimin e tretë** me formantin zero kemi vjelë format, si: *t'pí, t'zâ / t'xê*.

Nga CK po ilustruonim:

...Disa dít në livad due m'e lânë, / Ditë prej ditve të çohem e *t'a xâ*... (Kënga 12, f. 99)

...E *t'a xê* n'nji oxhak të mirë, / E *t'a lá* me pare t'hallallit... (Kënga 18, f. 142)

...Nji tas uj m'a bjen *t'a pí*, / Se buza gjak prej ethesh m'u ká plasë... (Kënga 16, f. 137)

Foljet e parregullta me formantin zero dalin zakonisht me trajtat, si: *t'due*⁴²⁵, *t'lâ, t'shof, t'tham*, si në rastin e shembujve që kemi shkëputur nga CK:

...Bét në Zotin Omeri i ká bâ: / – Sot n'marak tý nuk po *t'lâ*... (Kënga 10, f. 85)

...Besën e Zotit në letër po i a çon. / Qi n'vënd *t'* motërs nusen *t'a due*... (Kënga 12, f. 102)

...Del kundruell, ti Ali Bajraktari, / Del e *t'shof*, ti Sokol-e Halili... (Kënga 24, f. 193)

⁴²⁵ G. Mikeli, *Gramatika...*, vep. e cit., për kohën e tashme të mënyrës lidhore del folja *t'due*, f.115.

3. Me formantin **-i**,⁴²⁶ këto trajta të lidhore janë më të rralla, në krahasim me format e lidhore që e formojnë këtë vetë me mbaresën zero. Këto forma siç na vërtetohen në CK na kanë dalë edhe në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores. Ato janë: *t'çarti*, *t'mbathi*, *t'nxjerri*, *t'veshi*, etj.

Po marrim vargjet për ilustrim nga CK:

...E *t'i veshi* të tânë e *t'i mbathi*, / E *t'i rruej* të tânë e *t'i ndrojt*... (Kënga 21, f. 161)

...Ndo *t'a çarti* fën e Muhametit, / Ndo *t'i nxjerri* eshtnat prej vorrit!... (Kënga 33, f.216)

Në **vetën e dytë njëjës** vërehen trajta në të gjitha zgjedhimet si dhe foljet e parregullta. Foljet e vjela nga CK në zgjedhimin e parë në këtë vetë ndërtohen me mbaresën **-jsh / -sh**. Disa folje të zgjedhimit të parë dhe foljet e tjera me temë vokalike midis temës dhe mbaresës **-sh** marrin bashkëtingëlloren **-j**, kurse disa folje të tjera, ashtu si në vetën e parë njëjës, dalin në temë me mbaresën zero.

Krahaso:

a. ...Kúr *t'lësh* bjeshkën edhe ***t'hësh*** n'kralji, / Gjogu kryet ké me i a lshue... (Kënga 2, f. 15)

b. Por qe jetë, Halil, due me ndrrue; / E ***t'm'a mbarojsh*** nji vorr të gjânë... (Kënga 33, f. 234)

Në disa folje të zgjedhimit të dytë, si: *marr*, *dal*, dalin me variacione, sepse kemi vënë re se në disa raste kemi ndërrimin metafonik **a:e** (*t'delsh*) e në disa raste të tjera nuk e ndeshim këtë ndërrim (*t'marrsh*) në ndryshim nga koha e tashme e dëftores që e pësojnë gjithmonë metafoninë.

Krahaso:

a. ...Gjith-sá herë *t'delsh* me çetue, / Gjith-sá *t'doni* n'at log me lodrue... (Kënga 1, f. 9)

b. Po un balozit, qysh i shkoj tu dera! / *T'e marrsh* gjogun, motër, të mejdanit. (Kënga 5, f. 45)

Në një rast të izoluar forma e vetës së parë të së tashmes së lidhore na ka dalë me mbaresën

-u (*t'djegu*)⁴²⁷, si në shembullin:

...E *t'i a djegu* kullat e sarajet, / Rrash me tokë kullat qi *t'i a baj*... (Kënga 15, f. 124)

Veta e dytë njëjës e lidhore del e pasur në formante.

Foljet e **zgjedhimit të parë** dalin të ndërtuara me mbaresën **-jsh/-sh**, pa **-ë** fundore, si: *të hësh*, *të bájsh / t'bájsh*, *të mbajsh*, *t'mbarojsh*, *t'shkojsh*, *t'shtish*, *të ruejsh* etj.

Nga këto forma të lidhore kemi veçuar shembullin:

...Qýsh *t'a ruejsh* at Gjeto Basho Mujin, / Se tevdil Muji ásht veshë... (Kënga 9, f. 77)

Foljet e **zgjedhimit të dytë** që dalin me bashkëtingëllore marrin mbaresat **-esh/-ish** (kjo formë ekziston si variant në të folmet e gegërishtes jugore dhe në të folmet kalimtare)⁴²⁸/**-sh**,⁴²⁹ ku **-i-** ja në ndonjë rast luan rolin e zanores mbështetëse (në shqipen e sotme i përgjigjet një **-ë**)⁴³⁰, si: *të delsh*, *t'kallxojsh*, *t'marrsh*, *të mundesh*, *të njifsh / t'njifsh / t' njofish / të njofish*, etj.

Nga Këngët Kreshnike po japim vargjet:

...A thue ndjeve, more gjogu i êm i mirë, / Hyp ku *t'mundesh*, more gjogu i êm i bardhë... (Kënga 11, f. 93)

...Por çou, djalë, n'mejdan me m'dalë, / Sot *t'a njofish* Hyso Radoicën!... (Kënga 12, f.103)

...Shtërngou n'armë, bacë, sá mâ mirë *të mundesh*, / As për mue mos kij hiç mërzi... (Kënga 23, f. 179)

...Mejdanxhi vetë un jam, / Sot *të njifsh* Siran Ali Agën... (Kënga 24, f. 193)

Në CK në raste të izoluar vërehen foljet e **zgjedhimit të tretë**, si: *t'dijsh*, *t'vejsh*, që dalin me mbaresën **-jsh**, njëlloj si foljet e zgjedhimit të parë.

⁴²⁶ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit. *Kjo formë del në vetën e tretë njëjës, kryesisht në gegërishten jugore dhe në të folmet kalimtare*, f.233.

⁴²⁷ Kjo formë është e regjistruar në zonën e Shoshit si rast i izoluar.

⁴²⁸ J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia*, vep. e cit., f.233.

⁴²⁹ Po aty, ...*kjo formë del në të gjithë dialektin verior dhe është varianti kryesor fonetik për të folmet e gegërishtes jugore dhe në të folmet kalimtare*, f.233.

⁴³⁰ A. Haxhi, *Rreth së tashmes së lidhore në prozën e Fishtës*, Buletin Shkencor, Nr. 50, Shkodër, 1999, f.10.

Nga CK po japim shembujt:

...Por me tý tek jam tue ardhë, / Veç *t’a dijsh*, se rob Shkjau na ká xânë... (Kënga 2, f. 16)

...N’fushë t’mejdanit për me rá, / Aty *t’vejsh* djalin me e rrë... (Kënga 16, f. 137)

Foljet e parregullta vërtetohen me mbaresën **-(i)sh**, si: *të apish, t’bijsh, t’duesh / të duesh, t’jësh, t’kësh, t’lësh, t’thuejsh / t’thuesh etj.* Zevëndësimi i mbaresës **-ë** me **-i** shkon krahas me zëvendësimin e zanores dikur mbështetëse **-ë** për vetën e dytë po me **-i**: *të hapish, të lidhish*, në vend të *të hapësh, të lidhësh*.⁴³¹ Disa folje të parregullta dalin me variacione, si në shembujt:

Krahaso:

a....Gjith si t’m’thuejsh, Mujë, t’kam ndigjue, / Bash me e dijt se kryet m’ shkurtohet!...(Kënga1, f. 5)

b. ...Qi *t’ m’ i thuesh* Sokol-e Halilit, / Llaf për tý ndër shoqe kam bâ... (Kënga 22, f. 172)

Shembuj të tjerë të vjelë nga CK:

...Gjith-ku *t’kësh* nuse me marrë, / Gjith-ku t’kësh baloz me pré... (Kënga 1, f. 9)

...Lyp shka *t’duesh* Mujos te i kan thanë. / Kqyr Muji atëherë ç’ká qitë e ká thânë...(Kënga 7, f. 64)

...Merre ‘i burrë ku *të duesh* vetë, / Se Alín në burg e ké... (Kënga 13, f. 112)

...Kâmbë e duerësh Mujin t’a kam lidhë, / Si *të duesh* me të për me bâ... (Kënga 21, f. 166)

Veta e tretë njëjës e kohës së tashme të lidhores në CK në të gjitha zgjedhimet si dhe për foljet e parregullta, zakonisht del me mbaresën **-(j)ë**, e cila është përfutur gjatë zhvillimit historik të shqipës, prandaj ajo nuk mund të jetë shumë e vjetër⁴³² e, me sa duket, në krye të herës do të ketë qenë një zanore mbështetëse, e cila me kalimin e kohës ka marrë vlerën e një mbaresë vetore,⁴³³ siç e vërtetojnë edhe vargjet nga CK:

...Sa *t’bâjë* dritë ká ndoren dielli, / T’ermën natë, ká ndoren hâna... (Kënga 4, f. 30)

Të gjitha foljet që dalin me temë në zanore ndërmjet temës dhe mbaresës marrin një **-j-** bukuringëlluese për të zhdukur hiatin.⁴³⁴ Në materialin e shqyrtuar në Këngët Kreshnike kemi ndeshur edhe në pak raste të përdorimit të formave pa këtë mbaresë (*t’ hjek, t’ jet*). Mungesa e të pasqyruarit grafik të kësaj mbarese, mund të shpjegohet me mungesën e të shqiptuarit të zanores ë në të folmet gege në përgjithësi, sidomos në pozicion fundor, si në rastet e ilustruara nga CK:

Krahaso:

a. ...Ç’ká qitë letra e ká thânë: / *T’falë* me shndet krajl e kapidan... (Kënga 9, f. 77)

b. ...Se ku *t’jët* puna për mejdan, / Mejdanxhi del Gjeto Basho Muji... (Kënga 24, f. 190)

Zgjedhimi i parë del me pak folje, si: *t’bâjë, t’çojë, t’gjëjë, t’hijë, t’këndojë, t’mbajë, t’prijë, të shkojë etj.*

Nga CK po ilustruamë vargjet:

...E t’a marrë krajli e *t’a këndojë*, / E për mejdan Hyson do t’m’a çojë... (Kënga 12, f. 101)

...– Kúr *të shkojë* sahati n’ gjashtë, / Ktu, lum baca, ké me m’pritë!... (Kënga 19, f. 150)

...Çoje, Zot, nji erë e nji pshtjellsë / E *t’a çojë* ket dushk përpjetë... (Kënga 12, f. 101)

Zgjedhimi i dytë del me këto forma, si: *t’dalë / të dalë, t’falë, t’kapë, t’marrë, t’mbushë, t’ndeshë, t’vrasë, t’zdeshtë etj.*

Po marrim vargjet nga CK:

⁴³¹ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.345-346.

⁴³² Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.881.

⁴³³ Po ai, po aty, f.881.

⁴³⁴ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.391.

...Prap mâ idhshëm plaku i a dredh fjalën: / – Le t'm' vrasë Zoti, Gjeto Basho Muji!...(Kënga 6, f. 53)

...Kúr të dalë ky n'at vetull Bjeshke, / Tridhetë agët porsí shtjerrat po i gjë..(Kënga 6, f. 58)

...Kush *dalsh*⁴³⁵ t'ligt nusen me m'i a hjekë / Po i ap treqind duket... (Kënga 20, f. 156)

– Kush *dalsh* nusen Zukut me m'i a xjerrë, / Po i ap treqind duket të verdhë...(Kënga 20, f. 157)

...Po për tokë Muja me të ndeshë, / Armët e teshat t'y zdashë... (Kënga 15, f. 124)

Foljet e parregullta dalin me disa trajta, si: *të bijë / t'bijë, t'duejë, t'jet, të rrijë, të shofë, t'vijë / të vijë etj.*

Nga materiali i vjelë po ilustruam vargjet:

...Kúr të vijë Pahi Harambash, / – M'u çue derën, me m'a çilë... (Kënga 2, f. 16)

...Veç pá të Muja si të rrijë, / Qysh at ditë-o qi e kam marrë... (Kënga 9, f. 76)

...Kúr t'i bijë huj djalit gjí me pí, / Kúr t'i bijë huj djalit për me fjetë... (Kënga 24, f. 194)

...E pá zanát Omeri po m'jet, / Lâng sheqerit i ap sá t'duejë m'u ngí... (Kënga 29, f. 219)

Numri shumës

Format e së tashmes së lidhore në numrin shumës dalin me më pak forma në krahasim me trajtat e njëjësit. Foljet në kohën e tashme të mënyrës lidhore në numrin shumës dalin me tema dhe me mbaresa të njëjta me ato të së tashmes së dëftores.

Numri shumës na vërtetohet me këto mbaresa vetore:

Veta e parë: -(j)më / zero / -im

Veta e dytë: -ni

Veta e tretë: -(j)në / -in

Në **vetën e parë shumës** dalin foljet:

Foljet e **zgjedhimit të parë** në vetën e parë shumës të së tashmes së lidhore dalin me formante të ndryshme, si:

1. Me formantin **-(j)m(ë)** dalin zakonisht pjesa më e madhe e foljeve të zgjedhimit të parë, si: *të bájme, t'blejmë, t'bájme, t'çojmë, t'gjëjmë, t'shkojmë* etj. si dhe forma e parregullt: *t'bijmë*.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...E m'u lodhë, Muj, mos u lodh, / Se edhe kullat t'i bájme mâ t'mira... (Kënga 21, f. 163)

...Cilin t'çojmë prá Mujin për m'e marrë? / Po çojmë plakun Dizdar Osman Agën...(Kënga 23, f. 176)

2. Me formantin **zero** vërtetohet rrallë dhe del vetëm forma e lidhore, *t'hím*, si në rastin:

Se kso britmet kurr nuk kemi ndí! / Ktheu nji-herë e t'hím mbrenda në shpí!(Kënga 4, f. 37)

3. Format e lidhore që i takojnë **zgjedhimit të dytë** e formojnë vetën e parë shumës me mbaresën **-im**, si: *të dalim, t'hjekim, t'kputim, t'mujmë*⁴³⁶, *të nisna*⁴³⁷, *t'i xjerrim*, etj.

Po veçojmë disa vargje nga CK:

...Njikta gjak syve t'a hjekim. / Gjakun syve e kan hjekë... (Kënga 12, f. 104)

...Ndo dý copësh qafën t'a kputim, / Të dy në shpí trimat kan shkue... (Kënga 18, f. 144)

Yrysh gog, t'i xjerrim shkjet përjashta! / Krahu për krahu me mue ti me luftue.(Kënga 23, f. 184)

... – Ndalniu 'i herë, ju Agajt e Jutbinës / Sot t'a njiñni Sminaliq-e Savin... (Kënga 24, f. 193)

Rob të gjallë si t'mujmë me i xânë,/ Treqind shkjet rreth gurret janë bashkue.(Kënga 25, f.202)

⁴³⁵ At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., japin shpjegimin "të dalë", f.156. (forma *dalsh* = të dalë, përsëritet me të njëjtin kuptim edhe në faqen 157).

⁴³⁶ G. Mikeli, *Gramatika...*, vep. e cit., për kohën e tashme të mënyrës lidhore, del folja *t'mujmë*, f.112.

Në CK kjo formë zakonisht del si folje modale.

⁴³⁷ Në një rast të izoluar na ka dalë edhe forma , *të nisna*, të cilën më gjerësisht do e trajtojmë te kuptimet e lidhore.

Trajta të lidhores në vetën e parë shumë të kohës së tashme për zgjedhimin e tretë nuk dalin në asnjë rast.

Në pak raste vërtetohet edhe forma e parregullt, *t'shofim*, si në rastin:

...Se bash Zoti edhe e ká vrá, / E t'bijmë n'ahër nânë e t'a shofim... (Kënga 26, f. 204)

Në **vetën e dytë shumë** dalin pak forma.

Zgjedhimi i parë del vetëm me formën, *t'lshoni*, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...E me vedi Rushën t' a merrni, / T'dy për 'i herë gjogat t'i lshoni... (Kënga 18, f. 144)

Zgjedhimi i dytë del me foljet, si: *të delni*, *t'mundi*, *t'merrni*, *t'njifni*, *t'qitni*, *t'matni*, etj.

Me disa nga këto forma po japim vargjet nga CK:

...Kúr *të delni* n'maje t'bjeshkës, / Aty janë tri mrize t'mdhá!... (Kënga 1, f. 2)

...Me u shtërngue burra si *t'mundi*, / Se dita e dekës má e vshtirë ndryshej nuk vjen!...(Kënga 4, f. 39)

... – Me vedi Rushën t'a merrni,

E t'a *qitni* n'krye t'fushës s'mejdanit

E t'i *matni* gjogat barabar....

(Kënga 18, f. 144)

Foljet e parregullta në CK në vetën e dytë shumë të së tashmes së lidhores dalin me format, me variacion dialektor, si: *t'dueni*, *t'doni*, si, p.sh:

...Un robinë, ju zana malit, / Sá herë t'*dueni* guër me m'bâ... (Kënga 1, f. 6)

...Gjith – sa t'*doni* n'at log me lodrue,

Gjith – sa t'*doni* n'at log me këndue,

Gjith – sa t'*doni* n'at log shëjin me e gjue...

(Kënga 1, f. 9)

Trajta të lidhores në këtë vetë për zgjedhimin e tretë nuk na kanë dalë në asnjë rast.

Në **vetën e tretë shumë** foljet e **zgjedhimit të parë** që dalin janë: *t'shkojnë*, *t'rrëjnë*, si në shembujt:

...Se kúr t'*shkojnë* katërmijë krushq, / As hiç nusja s'â m'u kjá... (Kënga 24, f. 192)

...Ruej se t'*rrëjnë* shkjet për me dale, / Ruej se t'*rrëjnë* shkjet për me t'grí..(Kënga 29, f. 219)

Për **zgjedhimin e dytë** kemi gjetur këto forma të lidhores, si: *t'dhimbën*, *të marrin*, *t'perpiqen*, *të presin*, *t'qesin*, etj.

...Njëni shoin qi *të presin*, / Ai tjetri nusen ká me e marrë... (Kënga 12, f. 102)

...*Të marrin* vesht Jutbinë e krahinë. / Ata ktu kan me ardhë... (Kënga 13, f. 111)

...A thue t'*dhimbën* paret për me i dhânë? / A thue t'*dhimbën* darsmat për me i bâ?... (Kënga 13, f. 123)

Tu t'*perpiqen* shtatë krajlnit e mbreti, / Se burrë t'mirë Zoti m'ká pasë falë... (Kënga 21, f. 167)

...Amanet, mor llavë, jau paça lânë: / Kúr t'u *qesin* rruga ksajt me rá... (Kënga 29, f. 222)

Edhe në vetën e tretë shumë, ashtu si në dy vetat e para të shumës nuk vërtetohen forma të zgjedhimit të tretë.

Foljet e parregullta dalin me format: *të hanë*, *t'kan* / *të kan* / *të kén* / *t'kena*, *t'lânë*, *t'rrin* / *t'rrinë*, *t'shofin*, *t'vînë*.

Po japim disa vargje nga CK:

...Për buzë kronit po rri pshtetë: / Zânat pret kúr t'*vîn* për uj... (Kënga 1, f. 4)

...Lshojau zânin tridhetë agve t'*vînë*! / Se na sot duem me çetue... (Kënga 6, f. 50)

...Për me rá n' Agaj t' Jutbinës, / Agajt s't'*lânë* jo me u koritë... (Kënga 9, f. 82)

...Shpejt po i mbledhi shokët e mij, / T' *shofin* shkjet, se kush *jém* na... (Kënga 28, f. 216)

Zgjedhimi jovepror

Foljet e të gjitha zgjedhimeve si dhe foljet e parregullta në zgjedhimin **jovepror** të kohës së tashme të mënyrës lidhore dalin me të njëjtën formë të së tashmes së dëftores, duke marrë para pjesëzën karakteristike të lidhores **të / t’**. Nga materiali i studiuar për të tashmen e lidhores kemi vjelë forma në vetën e parë dhe të tretë njëjës dhe në vetën e tretë shumës. Për shkak se nuk kemi shumë forma, do marrim vetëm disa forma të joveprores sipas mbaresave që na kanë dalë.

Veta e parë njëjës del me dy forma, si: *të çohem, t’kapem*, si në rastet:

...Ditë prej ditve *të çohem* e t’a xâ, / Se due me rá fill n’Jutbinë... (Kënga 12, f. 99)

...Deri *t’kapem* natën te qaj katundi i largtë. / Ç’ká qitë balozi e i ká thânë.. (Kënga 11, f. 94)

Në **vetën e tretë njëjës** vërtetohen këto folje, si: *t’dahet, t’gjindet, të kthehet, të mbushet*.

Nga CK po marrim vargjet:

...Kúr *të kthehet* diellin për me e kqyrë, / Dorën shtjere në xhep të shmâjët...(Kënga 6, f. 61)

...E *të mbushet* mali me gjeth / E *të mbushet* fusha me bár e lule... (Kënga 12, f. 99)

Veta e tretë shumës del vetëm me foljet, si: *t’aviten, t’bâhen*, si në shembujt e ilustruar:

...Kúr *t’aviten* zânat n’tryezë, / Ti n’at bukë mos me u avitë... (Kënga 1, f. 5)

...E plot gjak petkat *t’i bâhen*, / E për ditë petkat me i a lá... (Kënga 24, f. 187)

5.2 Format e kohës së shkuar të mënyrës lidhore

E pakryera

Kuptimi themelor i kohës së pakryer të lidhores është *të tregojë një veprim të mundshëm të së shkuarës*.⁴³⁸ Kjo është më fort një e tashme e lidhores në të shkuarën dhe përdorimi i saj në fjalitë e varura është i kushtëzuar vetëm nga koha e foljes drejtuese⁴³⁹. Në krahasim me kohën e tashme, e pakryera e lidhores ka një përdorim të rrallë. Në CK del vetëm **veta e dytë njëjës** me pak forma, si: *t’mujshe, t’kiske* etj.

Po ilustrojmë me vargje nga CK:

...Për me dalun deri n’ krajlí, / *T’mujshe* detit, me i prí der’ ndër qafa... (Kënga 4, f. 28)

E kryera

Kuptimi themelor i së kryerës së lidhores është *të tregojë një veprim që mund të jetë kryer para çastit të ligjërit, me të cilin nuk i ka të këputura lidhjet*.⁴⁴⁰

Kjo kohë ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të kohës së tashme lidhore të ndihmëses **kam** (*t’kém ardhë*), e cila na del vetëm në një rast, si në vargjet:

...Mirë i a priti Gjeto Basho Muja: / – Para orokut, tha, krajl, *t’kém ardhë*...(Kënga 22, f. 173)

Forma e së kryerës së lidhores në **zgjedhimin jovepror** në CK (si në shqipen standarde) ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes që bart veprimin e formave vetore të së tashmes së lidhores të foljes ndihmëse **jam**, formë, të cilën e kemi ndeshur vetëm në një rast në CK, si: *t’jém ngusht*:

...– Fol, ti Mujo, tash qysh po thue! – Tu *t’jém ngusht*, Zâna me m’ndimue!...(Kënga 8, f. 65)

Më se e kryera

Kuptimi themelor i kohës më se të kryer të lidhores është *të tregojë një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës*.⁴⁴¹ Kjo formë ndërtohet nga paravendosja pjesores së foljes themelore e formave vetore të kohës së pakryer të lidhores të foljes ndihmëse **kam**: (*t’ki’n pasë*), si në shembullin:

...Kaq nën marre agët ishin rá, / Si luftue agët mos *t’ki’n pasë*... (Kënga 21, f. 164)

⁴³⁸ Gramatika e gjuhës shqipe I, vep. cit., f.323.

⁴³⁹ Po aty, f.324.

⁴⁴⁰ Po aty, f.325.

⁴⁴¹ Po aty, f.314.

Në CK në këtë kohë vërtetohen këto forma vetore vetëm për zgjedhimin vepror:

Në **vetën e parë njëjës** del vetëm forma, *t'kish dijtë*, si në rastin:

...*T'a kish dijtë*, se ksi burri jé, / E Halilin tý t'a kish falë... (Kënga 31, f. 230)

Veta e parë shumës del vetëm me formën, *të kishem dijtë*.

Nga CK po ilustruamë:

...*Ká nisë Muji e paska thânë: / – T'kishem dijtë* si këna këne... (Kënga 15, f. 129)

Veta e tretë shumës del me trajtat, si: *t'kishin lshue*, *t'kishin marrë*, *t'ki'n pasë*, etj., si në shembujt e dhënë nga CK:

... – Pasha ‘i Zot Zuku qi m’ *ká dhânë*, / Për tri vjet nuk *t'kishin lshue*... (Kënga 18, f. 141)

...*Sall me kullat me i a pá*, / Tri vjet ethet *t’i kishin marrë*.... (Kënga 18, f. 141)

Forma të zgjedhimit jovepror për kohën më së të kryer nuk kemi gjetur.

5.3 Probleme të mënyrës kushtore

Kuptimi i foljes në mënyrën kushtore *është të tregojë një veprim që mund të kryhej, po të vërtetohej një kusht i caktuar*. Ai mund të jetë i mundshëm në të ardhmen ose i perealizueshëm, sepse nuk është realizuar ose është i perealizueshëm kushti.⁴⁴² Mënyra kushtore ndërtohet sipas standardit të shqipes me dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. Format gramatikore të kohës së tashme të mënyrës kushtore janë homonime me ato të së ardhmes të së shkuarës të mënyrës dëftore (*do të laja*). Format gramatikore të së kryerës së mënyrës kushtore janë homonime me ato të së ardhmes së përparme të së shkuarës të mënyrës dëftore (*do të kem larë*).

Në CK në anjë rast nuk na vërtetohet asnjë ndërtim i kushtores, por siç dihet me anë të mënyrës kushtore shprehet modaliteti i mundësisë, të cilin e kemi ndeshur në disa ndërtime foljore me forma të shtjelluara dhe të pashtjelluara foljore. Siç e kemi trajtuar edhe te kuptimet kohore disa ndërtime të mënyrës dëftore dalin me modalitetin e mundësisë, të tilla, si: disa folje në kohën e tashme, të pakryer, në të kryerën e thjeshtë, në të kryerën dhe më se të kryerën. Edhe format e së ardhmes dalin shpesh me kuptimin e kushtores. Në pjesën më të madhe të shembujve që kemi vjelë vërehet se ndërtimet kohore të mënyrës dëftore dalin me modalitetin e kohës së tashme të kushtores. Në raste më të rralla disa ndërtime të së kryerës së thjeshtë dalin edhe me kuptimin kohor të së kryerës së kushtores.

Me kuptimin modal të kushtores vërtetohen edhe forma të mënyrave të tjera, si: format e lidhore apo të dëshirores. Në disa raste, foljet modale dhe format e pashtjelluara foljore, si ato të paskajores dalin me modalitetin e mënyrës kushtore. Format e paskajores që tregojnë modalitetin e kushtores më gjerësisht do i trajtojmë në kreun përkatës.

Në të gjitha rastet kur format dalin me kuptimin e mënyrës kushtore, për të përforcuar kushtin shoqërohen edhe nga lidhëzat nënrenditëse kushtore, si: *në*, *n’*, *po*.

5.4 Kuptimet e këtyre kohëve

Mënyra lidhore del e pasur, jo vetëm në ndërtime, por edhe në kuptime. Kuptimi themelor i kohës së tashme të lidhore është *të tregojë një veprim, kryerjen e të cilit folësi e paraqet si të mundshme a të dëshirueshme*.⁴⁴³ Kjo mënyrë përdoret me kuptim volutiv ose voluntativ, pra, me kuptimin modal të dëshirueshmërisë. Gjatë analizës së materialit kemi vënë re se zakonisht format e kohës së tashme dalin të pasura me kuptime kohore dhe modale. Trajatat e kohëve të tjera të mënyrës lidhore dalin më rrallë. Në fjalitë e varura e tashmja e lidhore mund të përdoret

⁴⁴² Po aty, f.327.

⁴⁴³ Po aty, f.321.

pa ndonjë lidhëz nënrenditëse, ose mund të prihet nga lidhëzat nënrenditëse kohore: *si, kur, sa*; vendore: *ku*; *si* dhe nga përemrat lidhorë: *i cili, kush, cili, sa*⁴⁴⁴.

Disa nga këto përdorime po ilustruam me vargje:*

...N’ megje t’ krajlive **kur** t’bajsh për me dalë, / Kurrkund kryet gjogut mos me i a ndalë...(Kënga 4, f. 29)

...Njiqind dit të treqindt **si** t’i mbajë, / Mish tarokut të tânë të hanë... (Kënga 21, f. 161)

...Merre ‘i burrë **ku** të duesh vetë, / Se Alín në burg e ké... (Kënga 13, f. 112)

...**Cili** t’a kapë nusen mâ pare, / Qatij nusja i kjoftë për hajr!... (Kënga 18, f. 144)

... – **Kush** t’jët djalë me mue me ardhë, / Prej urdís t’dahet n’njënen anë!. (Kënga 24, f. 191)

Në pak raste forma forma e pashtjelluar në përcjellore paraprihet nga forma *jam* në të tashmen e lidhore (t’jët) dhe komplet ndërtimi (t’jët + tue luftue) ka vlerën e kohës së tashme të mënyrës dëftore, siç vërtetohet edhe nga shembulli i vjelë nga CK:

...Se un nji burrë fort trim e due, / Qí për ditë me shkjë t’jët tue luftue (=po lufton)...(Kënga 24, f. 187)

E tashmja e lidhore përdoret me kuptimin e së ardhmes,⁴⁴⁵ si në rastin:

...E t’i a djegu kullat e sarajet, / Rrash me tokë kullat qi t’i a baj... (Kënga 15, f. 124)

...Se kúr t’dalë nesër drita, daltë e bardhë, / Shkjë të pá farë tu kisha kan me ardhë...(Kënga 29, f. 219)

Modalitetin e mundësisë ose të detyrimit në CK, mënyra lidhore e shpreh kur përdoret në fjali pyetëse të drejta që nisin me një fjalë pyetëse (përemër pyetës, ndajfolje pyetëse ose pjesëz pyetëse), ose pa ndonjë fjalë të tillë, siç dalin edhe në vargjet nga CK:

...– **Ku** t’bajmë mriz, o e bukra e dheut? / N’at ledinë nën hije t’rrapit... (Kënga 22, f. 170)

... – Ndalniu ‘i herë, ju Agajt e Jutbinës / Sot t’a njiñni Sminaliq-e Savin...(Kënga 24, f. 193)

Format e së tashmes së lidhore dalin shpesh në CK me modalitet dëshiror.

Po ilustruam vargje nga CK:

...“Mirë se t’gjëjë!” Mujit i thotë, / “Mirë se vjen” – Muji i përgjegjë... (Kënga 1, f. 4)

...– Kah t’na prjje e djathta e Zotit! / N’mjedis fushës këkan dalë... (Kënga 6, f. 51)

E tashmja e lidhore modalitetin e dëshirës e shpreh edhe atëherë kur përdoret me vlerën e mënyrës urdhërore (për urdhra, nxitje, këshilla, propozime etj.) Ajo përdoret kështu, jo vetëm në vetën e parë shumës, por edhe në vetën e tretë (njëjës e shumës), për të cilat urdhërorja nuk ka forma gramatikore të posaçme, por edhe në vetën e dytë⁴⁴⁶, por në CK na del me këtë kuptim vetëm vetë e parë shumës, siç vërtetohet edhe nga shembujt e vjelë:

... E selín t’a gjejmë mâ t’mirë, / Edhe rëmet t’i blejmë mâ t’mira... (Kënga 21, f. 164)

...Sá me shpejt ai gjogun m’a ká thirrë: / “Hajde, gjog, të nisna për Jutbinë!” (Kënga 23, f. 177)

Trajta e së pakryerës së lidhore del në të gjitha rastet me modalitetin e kushtores, si vargjet që kemi marrë nga CK:

...Për me dalun deri n’ krajlí, / T’mujshe detit, me i prí der’ ndër qafa... (Kënga 4, f. 28)

...Si t’i kishë un syt si i kam pasë, / Shum trimnít me tý i kishë bâ... (Kënga 11, f. 92)

Lidhur me pjesëzat e mohimit, tërë format e foljes shqipe, të shtjelluara dhe të pashtjelluara, ndahen në dy grupe: pjesëzat *nuk* dhe *s’* shkojnë me dëftoren dhe habitoren, ndërsa pjesëza

⁴⁴⁴Po aty, f.321.

* ...I cili t’rrin mâ shumë uj pá pí / I cili t’rrinë mâ shumë bukë pá ngrânë, / I cili t’rrinë mâ shumë pá fjetë...(Kënga 25, f.199)

⁴⁴⁵ I. Arapi, *Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore..* vep. e cit.. "Ky përdorim është krejt i papritur dhe duhet parë me kujdes, sepse lidhoren me kuptimin e së ardhmes e gjejmë vetëm te Buzuku dhe te asnjë autor tjetër pas tij", f.584.

⁴⁴⁶ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore...*, pun. i cit., f.127.

mos me gjithë format e tjera, përfshirë edhe lidhoren. Në ligjërimet dialektore ose në ligjërimin e shkujdesur pjesëza e mohimit **mos** mund të qëndrojë edhe para pjesëzës të⁴⁴⁷. Kjo dukuri, e pasqyruar edhe në ndonjë gramatikë të kohës⁴⁴⁸ na shfaqet gjerësisht në CK:

... – A'i kue bukë **mos t'kësh** për mik, / – Sá mâ ngusht, krajli, qi ka kânë..(Kënga 4, f. 39)

...Mos t'u dhimben turkut as kaurrit, / **Mos të kën** kurrkend shokësh mbrapa.(Kënga 21, f. 161)

Në CK kemi ndeshur rrallë edhe raste të përdorimit të lidhëzës këpujore **as**, që kërkon ndërtim mohor, por që në shembullin që kemi vjelë lidhorja në mohore del edhe me pjesëzën e mohimit *mos*:

...Thellë në burg unë due me u shtî, / **Dritë as diell mos t'shofë me sy**... (Kënga 1, f. 31)

Kemi vënë re gjatë studimit të materialit në CK se janë të shpeshta rastet, kur koha e tashme e lidhores shoqërohet edhe me ndajfolje me kuptime kohore të caktuara, si: *sot, nesër*, apo nga ndajfoljet e kohës që mund të tregojnë një veprim që ndodh aty për aty, si: *fill, tash, kesh, për'i herë etj.*

Po marrim shembujt nga CK:

...Djalë me sy sot ti ké me pá, / **Sot t'a njoftsh** Arnaut Osmanin... (Kënga 12, f. 103)

...Braf në kâmbë por djali konka çue / **Fill**, n'gjytet me të, motër të m'bijsh...(Kënga 5, f. 45)

...Kâmbë e duerësh ç'djalë ti ké lidhë? / **Tash t'a njoftsh** Zukun bajraktár. (Kënga 11, f. 95)

...**Kesh t'i hÿjë** n'trup pak kyvet, / Ká nisë mikut e po m'i thotë:... (Kënga 11, f. 93)

...E me vedi Rushën t'a merrni, / T'dy **për 'i herë** gjogat t'i lshoni... (Kënga 18, f. 144)

Siç na rezulton edhe nga vjeljet që kemi bërë, *mënyra lidhore* në CK nuk është shumë e pasur në forma. Nga materiali i vjelë vërtetohen forma në kohën e tashme dhe në kohën e shkuar. Më e pasur në forma del koha e tashme, e cila vërtetohet në të gjitha vetat në njëjës dhe shumës në zgjedhimin vepror dhe jovepror. Mbaresat vetore të kohës së tashme janë më të pasura në krahasim me standardin e shqipes. Koha e shkuar e mënyrës lidhore del me pak forma për kohën e pakryer, të kryer dhe më se të kryer.

Për sa i takon kuptimit, koha e tashme e lidhores del e pasur edhe me kuptime e modalitete, si: me kuptimin e së tashmes së dëftores, me modalitetin e dëshirores, urëdhërores etj. Format e së pakryerës së lidhores dalin gjithmonë me modalitetin e kushtores.

Mënyra kushtore në CK nuk del me asnjërin prej ndërtimeve foljore, të saj, por disa ndërtime të mënyrave të tjera si dhe ndonjë formë e pashtjelluar foljore dalin me këtë modalitet. Më të shpeshta janë disa ndërtime kohore të mënyrës dëftore dhe lidhore.

Format më të përdorura të mënyrës lidhore sipas kohëve dhe mbaresave vetore përmbledhtas janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

⁴⁴⁷ Po aty, f.13.

⁴⁴⁸ I. D. Sheperi, *Gramatika e sindaka...*, vep. e cit., f.178.

**Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)**

Mënyra lidhore			Koha e tashme		
Veprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>t'kallxoj</i>	<i>t'shkojsh</i>	<i>t'prijë të dalë t'duejë</i>	<i>t'shkojmë</i>	<i>t'njifni t'doni</i>	<i>t'rrëjnë</i>
<i>t'hî, t'marr</i>	<i>të apish</i>		<i>t'hîm</i>		<i>t'qesin</i>
<i>t'veshi t'djegu</i>			<i>t'kputim të nisna</i>		<i>të hanë t'kena</i>

Joveprorë

Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
<i>t'kapem</i>	–	<i>t'gjindet</i>	–	–	<i>t'bâhen</i>

Koha e shkuar e lidhores del me këto forma foljore:

	Veta I nj.	Veta II nj.	Veta I sh.	Veta III sh.
Koha e pakryer	–	<i>t'mujshë</i>	–	–
Koha e kryer	<i>t'kém ardhë</i>	–		–
Koha më se e kryer	<i>t'kish dijtë</i>	–	<i>t'kishem dijtë</i>	<i>t'kishin marrë</i>

KREU VI : NDËRTIMI DHE KUPTIMET GRAMATIKORE TË MËNYRËS DËSHIRORE DHE URDHËRORE

6.1 Format e kohës së tashme të mënyrës dëshirore

Dëshirorja është një nga mënyrat e krijuara qysh në faza të hershme të indoevropianishtes dhe duhet të ketë një moshë relativisht të vjetër edhe në gjuhën shqipe.⁴⁴⁹ Çështja e formimit të mënyrës dëshirore dhe e burimit të saj në gjuhën shqipe është bërë objekt studimi i albanologëve të njohur, si: G.Meyeri, i cili mënyrën dëshirore të shqipes e sjell të ardhur nga më se e kryera e lidhore latine e tipit *cantavisse*. Këtë shpjegim e kanë kundërshtuar me një varg argumentesh gjuhëtarët, si: H.Pedersen, M.Domi, I.Ajeti, Sh.Demiraj etj., duke parë në trajtat e dëshirores një formim të brendshëm të shqipes, që nuk i ngjason asnjërës nga gjuhët e tjera indoevropiane.⁴⁵⁰ Sh. Demiraj, jep mendimin se "...dëshirorja është ndërtuar mbi bazën e së kryerës së thjeshtë të dëftores, e cila është një kohë e trashëguar dhe këtë gjë e dëshmon prania *-f-* së të dëshirorja e foljeve me temë në zanore, si p.sh: *kë ndo-f-sha < kë rko-vsh-a*, që është një shurdhim i *-v-*së së aoristit të dëftores.⁴⁵¹

Sistemi foljor i shqipes, ashtu siç na vërtetohet edhe në CK, përfshin edhe format e dëshirores, përmes të cilave shprehet modaliteti i dëshirës në formë urimi ose mallkimi.⁴⁵²

Në CK vërtetohen të dy kohët e dëshirores.

1. Koha e tashme	bâsha
2. Koha e shkuar	
Koha e kryer	paça dhânë

6.1 Format e kohës së tashme të mënyrës dëshirore

Zgjedhimi vepror

Format e kësaj kohe ndërtohen duke i shtuar temës së posaçme të dëshirores mbaresat vetore përkatëse. Tema e posaçme e dëshirores, ashtu si në shqipen standarde, edhe në CK ndërtohet me anë të prapashtesës trajtëformuese **-(f)sh**, që, në shumicën e rasteve, i ngjitet temës të së kryerës së thjeshtë. Formanti **-f** (i cili, sipas Sh. Demiraj, lidhet historikisht me tingullin antihiatizues **-v-**, të së kryerës së thjeshtë të tipit *këndo-v-a*),⁴⁵³ si rregull, duhet të shfaqet te foljet me temë në zanore (*thafshin*), por në CK edhe në këto folje nuk e gjejmë të përdorur (*shndoshin*, *thashin* etj.).

Për ilustrim po i referohemi shembullit:

...Armë e petka tý, Muj, t'i gzosha,

Gjogun t'ând, Muj, t'a shilosha,

Dhe nusen t'a martosha!...

(Kënga 31, f. 232)

Reduktimi në *sh* i grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* me mënyrën dëshirore të foljeve me temë në zanore; (ti) *gzosh*, *rrnosh* është një dukuri e dëshmuar në mbarë të folmet perëndimore të gegërishtes veriore.⁴⁵⁴ Kjo është veçori e të folmes së Shkodrës "me gropën e saj", ku grupi i bashkëtingëlloreve **-fsh** në çdo rast del i thjeshtuar në **-sh**.⁴⁵⁵ Përrjashtim në CK bën vetëm veta

⁴⁴⁹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.887.

⁴⁵⁰ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.136-138.

⁴⁵¹ Po aty, f.139

⁴⁵² *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.329.

⁴⁵³ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.139.

⁴⁵⁴ B. Beci, *Gegërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, SF, Nr.3, 1987, f.73.

⁴⁵⁵ J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, DSH, I, Tiranë, 1971, f.117.

e dytë njëjës e formës të parregullt, *kofsh*, të cilën e kemi ndeshur në këtë përdorim vetëm në një rast, si në vargjet:

Amanet, more shtegtari i malit: / N’*kofsh* tuj kndue ksajt, kajkën me e pushue... (Kënga 5, f. 4)
Kurse formanti **-sh**, i cili del në të gjitha vetat (me përjashtim të vetës së tretë njëjës), në CK ka raste që del në formën **-ç** (për vetën e dytë dhe të tretë njëjës dhe shumës), si në rastin:

...T’madhe trimi por m’i ká bëritë: / Mos, Dizdar, bre, t’*plaçin* të dy syt!.. (Kënga 23, f. 180)
Sipas argumentimit të studiuesit K.Topalli: "Në format e tjera vetore, ku krahas mbaresave për rdoret edhe prapashtesa *-sh* (khs. *hap-sh-a*, *hap-sh* etj.), fërkimorja *-s* e temës *pas(ë)*, duke u shkrirë me prapashtesën *-sh*, ka dhënë afrikaten *-ç*; p.sh: te Buzuku, Kazazi. Duke u interpretuar si mbaresë, bashkëtingëllorja *-ç* është shtrirë edhe në ndonjë folje tjetër me rrugë analogike duke zevëndësuar prapashtesën *-sh*; si te Fishta".⁴⁵⁶ Studiuesi, A.Haxhi mendon se kjo dukuri ndodh "...nga takimi i fundores së temës **-t-** me formantin **-sh-** të dëshirores, duke na dhënë **-ç-** (*paç*, *paçin*) ose kur këtij formanti i prin një **-sh-** tjetër (*daç*, *daçim*, *daçin*)".⁴⁵⁷

Nga materiali i vjelë nga Këngët Kreshnike vërtetohen forma në të gjitha vetat në nunrin njëjës dhe shumës zakonisht në zgjedhimin vepror. Format e së tashmes së dëshirores në veprorë dalin me këto mbaresa vetore:

Veta e parë njëjës	:	-sha / -ça
Veta e dytë	“ :	zero
Veta e tretë	“ :	-të / -ët
Veta e parë shumës	:	-im
Veta e dytë	“ :	-i
Veta e tretë	“ :	-in

Në raste të izoluara na del edhe një formë e së tashmes së dëshirores në jovepore.

Numri njëjës

Veta e tretë njëjës del më e pasur në forma në krahasim me dy vetat e para. Në të dy vetat e para të njëjësit nuk na vërtetohen forma të dëshirores për zgjedhimin e tretë.

Veta e parë njëjës e mënyrës dëshirore del me një përdorim relativisht të kufizuar me forma të zgjedhimit të parë, të dytë dhe me foljet e parregullta. Këto forma dalin me reduktim në *sh* të grupit të bashkëtingëlloreve *fsh* te foljet me temë në zanore; (ti) *gzosh*, *çosh*. Kjo dukuri është dëshmuar në mbarë të folmet perëndimore të gegërishtes veriore. Përhapja e këtij tipari është dominues për të folmet perëndimore të gegërishtes veriore, por ka shtrirje edhe në të folmet lindore të gegërishtes veriore⁴⁵⁸, gjë të cilën e kemi vënë re edhe gjatë trajtimit të materialit të Këngëve Kreshnike.

Zgjedhimi i parë del me format⁴⁵⁹, si: *bâsha*, *gzosha*, *hîsha*, *martosha*, *nxisha*, *shilosha*, *xîsha* etj.

Po ilustruam me shembuj nga CK:

⁴⁵⁶ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., për këto përdorime të formave jepen shembujt: Buzuku: *Përse nukë çuditem se në paça fëjyem (LXXX/2 = CX/2, pasthënia; Kazazi: ndë paç ndonji kryq ndo figurë (DK 24); Fishta: Eh ju dhaa ujët e detit (LM 25), f.319.*

⁴⁵⁷ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., jepen shembujt: *...për në daçin me ju bëjtë ndonji e pa pritme... (HD, 1923, fq. 502); ...n’i paçin, të na i qesin në shesh... (HD, 1923, fq. 195), f.186.*

⁴⁵⁸ B. Beci, *Gegërishtja veriore...*, pun. i cit., f.73.

⁴⁵⁹ O. Myderrizi, *Gramatika e rë e shqipës...*, vep. e cit., Kjo mënyrë në kohë të lashta duket se dftong nuk merrte. Edhe tashti në ca krahuina, foljet që mbarojnë me zânore a dftong, **f-** ën eufonike për vetën I e të dytë nuk e marrin: *bâsha (bâfsha)*, *bâsh (bâfsh)*", f. 126; Shih më gjerësisht: K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.199.

– Po a kaq fort, thue, jermi t’ká ngushtue? / *Hîsha* gjallë në dhé n’tu martue motra!...(Kënga 5, f. 45)

...Se në *bâsha* un mbrendë me hî, / Copë me grimë un tý kam me t’ grî... (Kënga 13, f. 111)

... – Jú jau *xîsha* llafin qi po bâni, / Nâna djalë n’ Jutbinë s’ká bâ... (Kënga 18, f. 140)

Zgjedhimi i dytë del me pak forma, si: *presha, pritsha, shndosha*, etj., si në rastet:

...Ah mos *pritsha*, Jovan, me kânë! / Nâna qi m’paditi... (Kënga 4, f. 37)

...Gjithmonë nishanat t’i kam pré, / Tybe kjoftë nishanat në t’i *presha!*... (Kënga 19, f. 152)

Foljet e parregullta na kanë dalë me këto trajta, si: *deksha, dhaça, kjosha, pasha* (formë foljore e dëshmuar edhe te Buzuku)⁴⁶⁰, *paça* etj.

Nga CK po marrim shembujt:

...Bé mbí Zotin Halili ká bâ: / Për mejdan mos *kjosha* mâ!... (Kënga 2, f. 18)

...Githmonë dhuntín t’a kam dhânë, / Tybe kjoftë dhuntín sot në t’a *dhaça!*...(Kënga 19, f. 152)

Forma **kam** në mënyrën dëshirore në vetën e parë njëjës të së tashmes del me dy trajta: *pasha* / *paça*, si në rastet:

Krahaso:

a. ... – *Pasha* Zotin, Mujo qi m’ká dhânë, / Gjân t’ême un kam marrë... (Kënga 13, f. 116)

b. ...Me pshtue, nafakë n’e *paça*, / Shpejt po i mbledhi shokët e mij... (Kënga 28, f. 216)

Veta e dytë njëjës e kohës së dëshirores del me mbaresë **zero** me forma të zgjedhimit të parë, të dytë si dhe me foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë vërtetohet me këto forma, si: *çosh, gzosh, nxâsh, çosh, shtîsh* etj.

Nga CK kemi shkëputur disa vargje për ilustrim:

...T’madhe Halili aj po m’i thret: / Çou Halil! Kryet mos e *çosh!*... (Kënga 6, f. 50)

...Ma t’mirë mazin s’ké pse e lypë, / Për hajr t’kjoftë e mirë e *gzosh!*... (Kënga 9, f. 77)

... – *Pâsh* një Zot, nânë, qi t’ká falë, / E *pâsh* bukën, qi kém ngrânë... (Kënga 25, f. 198)

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *mbetsh, shndosh*, etj. ., si në vargjet:

... – Mori çikë, tha ti *shndosh* vetë, / Sé edhe Agën shkjét t’a kan vrá... (Kënga 27, f. 213)

...T’madhin vrap mazit me i a dhânë, / – Tu mirë *mbetsh*, Krajl-o Kapidani!...(Kënga 9, f. 74)

Foljet e parregullta dalin të pasura me forma, si: *duesh*, (disa folje të këtij zgjedhimi e ndërtojnë mënyrën dëshirore nga tema e diftonguar e pjesores, si në rastin e foljes *dua*), *daç, dhaç, kjosh / kofsh, paç, pát, pâsh, vosh*.⁴⁶¹ Folja *dua*, ashtu siç ndodh përgjithësisht me foljet e tjera, e formon nga tema e pjesores *dash*(-ur); ku ndeshja e fërkimores *-sh* të temës me të njëjtën bashkëtingëllore të prapashtesës së dëshirores ka përfutur afrikaten *-ç* : *dash* + *-sh* > *daç*.⁴⁶²

Po ilustrojmë me vargje nga CK:*

–Hajt sa t’ *duesh*, për n’*daç* me e pá! / – Se mue ngaëja kurrkund sot s’m’a qet! (Kënga 4, f. 36)

...Fjal’n e mbrame, n’e *paç* për me folë, / Se tý jeta njat hû t’u ká sosë!... (Kënga 4, f. 39)

...Ti, n’m’*dhaç*, Múj, Besën e Zotit, / Sé përjashta derës nuk po del... (Kënga 28, f. 216)

...Shkon n’krajlní, ti ké me kthye, / Tu mirë *vosh* Arnaut Osmani!... (Kënga 9, f. 74)

...Ká fillue sarajin e m’a nêinë: / Tý saraj – thotë – hajri mos t’u *pát!*... (Kënga 13, f. 110)

⁴⁶⁰ W. Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor*..., vep. e cit., f.165.

⁴⁶¹ G. Mikeli, *Gramatika*..., vep. e cit., për kohën e tashme të mënyrës dëshirore del: *vosha, vosh, vofitë*, f.108.

⁴⁶² K. Topalli, *Sistemi foljor*..., vep. cit., f.429.

* *Shembuj të tjerë nga CK*: ...Si në *daç* ti paret me m’dhânë, / T’kam msue mazin si me e marrë...(Kënga 9, f.73);...Besën e Zotit në *daç* me m’a dhânë, / Qi kurrkúj derën nuk i a çilë...(Kënga 12, f.109);...Se shkjét djalin t’a kan vrá. / N’Lugje t’Verdha n’*daç* me e pá...(Kënga 30, f.225)

Gjatë shqyrtimit të materialit të Këngëve Kreshnike kemi vënë re përdorimin e foljeve ndihmëse **kam** dhe **jam**, të cilat e ndërtojnë mënyrën dëshirore me dy forma: *kofsh / kjosh* dhe *pásh/paç*.

Krahaso:

a. ... Amanet more shtegtari i malit! / N' *kofsh* tu'kajtë ksajt, gjâmën për me e xânë!... (Kënga 5, f. 48)

b. ... Si në *kjosh*, Ali, kund gjallë, / Sá mâ parë xhevap mue me m' dhânë... (Kënga 13, f. 112)

c. ... *Pásh*, gjit, bír, qi t'kam dhânë, / E *pásh* majën qi t'kam bâ... (Kënga 18, f. 141)

ç. ... – Hajr *paç*, Zuku Bajraktár! / Gjà e mall Zoti më pat dhânë... (Kënga 19, f. 147)

Veta e tretë njëjës e mënyrës dëshirore vërtetohet me mbaresën **-të**. Kjo vetë del më e pasur në forma në krahasim me dy vetat e para të njëjësit. Kemi ndeshur këto forma:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *bâftë, çoftë, daftë, kndoftë, ndigjoftë, ndimoftë, preftë, rroftë, ruejtë, rrenoftë, shkimtë*⁴⁶³, *thaftë* etj:

Nga CK po veçojmë vargjet:

Ç'jé kah thue, bre burrë, goja t'u *thaftë*! / Qe nândë vjet, qi gjogu ksajt s'â rá. (Kënga 5, f. 46)

Kshtu m'kan thânë, se atje nu' jam kânë, / Por kush *ndigjoftë*, zêmra i *knoftë*! (Kënga 8, f. 69)

... E me lot, fort po e loton, / – Lê, mori çikë, tý Zoti t' *ruejtë*!... (Kënga 10, f. 82)

I madhi Zot, Plak, thotë, hajr e *bâftë*! / – Ç'farë nevojat tý njiktu t'ká prû... (Kënga 19, f. 147)

... Mbarë Jutbina për ta denam ká bâ. / Kush *ndigjoftë*, Zoti e *ndimoftë*!... (Kënga 21, f. 169)

... – T'u *shkimtë* drita tý, o mori hânë – é, / Qi s'ma çove at natë një fjalë... (Kënga 30, f. 225)

Zgjedhimi i dytë i vetës së tretë njëjës zakonisht del me mbaresën **-të** dhe vërehen format, si: *daltë, leftë, preftë, vraftë*, etj. Këto forma janë të shpeshta në vargjet e CK.

Po ilustruam me disa shembuj:

... Zoti t' *vraftë*! - Tanushës po i thotë: / – Po a jé nieri qi ké besë?... (Kënga 4, f. 32)

... Duro, gjog, bisha të *preftë*, / N'kike, t'mazit po i a njet... (Kënga 9, f. 76)

... Ká qitë bjeshkën e po e nëmë: / Çoban gjâjet n'jú kurr mos *daltë*!... (Kënga 25, f. 200)

Kemi vënë re gjatë shqyrtimit të Këngëve Kreshnike se disa folje të zgjedhimit të dytë dalin edhe me variacione dialektore, si: *dalët, vrafët*, etj.

Po marrim vargjet nga CK:

... Zoti të *vrafët*, moj zâna e madhe! / Sé na nuses po i kallxojmë... (Kënga 1, f. 6)

... As mos *dalët* kurr çetë n' ket bjeshkë! / Ora e Zukut ngjat ká qillue... (Kënga 11, f. 89)

Zgjedhimi i tretë del vetëm në një rast të izoluar me formën, *piftë*, si në shembullin e vjelë nga CK:

... Dushk as bár ndër jú kurr mos *daltë*! / As uj ndër jú kurr mos u *piftë*!... (Kënga 29, f. 222)

Foljet e parregullta në CK kanë një përdorim të dendur dhe na vërtetohen këto forma, si: *ardhtë, dhashtë, kjoftë, lashtë, pasët / pastë, pát, shofë, vofhtë* etj.

Nga Këngët Kreshnike po marrim shembujt:*

... Hiç idhnim, t' *pasët* lokja, mos me marrë! / Pse tý baba gjogun t'a ká lânë... (Kënga 2, f. 14)

... Për n' *kjoftë* bjeshkve kah çeton, / Kurr te shpija shndosh mos *vofhtë*!... (Kënga 4, f. 40)

⁴⁶³ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., folja ka kuptimin "me fikë zjarrin; me shue (zjarrin a një objekt tjetër çfarëdo); me marrë jetën e një njeriu; me e zhdrukë nga faqja e dheut", f. 188.

**Shembuj të vjelë nga CK*: ... Atje *kjoftë* si ç'a kënë motit, / Né na *ardhtë* ndima prej Zotit!... (Kënga 11, f. 96); ... Por kush iu çoftë shoqit për t' lig, / Kurr Zotyn mbarë mos i a *dhashtë*... (Kënga 18, f. 145); ... T' *kjoftë* haram mâja qi t' kam bâ, / T' *kjoftë* haram tagjija qi t' kam dhânë... (Kënga 21, f. 164)

...Edhe krushqevet u ká thënë: / Pa u vrá Zoti burra mos u *lashtë!*... (Kënga 9, f. 78)
...E m'a la dhetë dit e net: / Nânë si këtë, Zoti kuj mos i a *dhashtë*... (Kënga 11, f. 96)
Lidhur me format foljore të dëshirores *dhashtë*, *lashtë*, të cilat dalin me prapashtesën *-sh* në vetën e tretë, dëshmojnë se kjo prapashtesë ka qenë e pranishme në tërë paradigmen, por ka rënë në vetën e tretë numri njëjës, ku formohej një grup prej tri bashkëtingëlloresh (*haptë* nga **hapshtë*, *shkoftë* nga **shkofshhtë*). Tek foljet e mësipërme është ruajtur kjo prapashtesë, meqënëse ato nuk kanë pësuar ndikimin e foljeve të zgjedhimit me zanoren *-o*, nga diftongimi i së cilës është formuar prapashtesa *-f* e kësaj forme modale.⁴⁶⁴

Numri shumës

Format foljore të numrit shumës të së tashmes së dëshirores dalin me më pak forma se numri njëjës. Këto forma na dalin në të tri vetat sipas skemës:

Veta e parë shumës del me mbaresën **-im** vetëm me format e parregullta, si: *kjoshim*, *paçim*, *pashim*.

Po ilustruam me shembuj këto forma:

...Kah kndojnë zânat shkam e m'shkam, / Zâna jena e zâna *kjoshim!*... (Kënga 1, f. 10)
...Se kto janë pralla prej motit, / Ndimën *paçim* na prej Zotit"!... (Kënga 16, f. 135)
...Atje kjoftë si ç'a kanë motit, / Né k'a *paçim* ndimën e Zotit"!... (Kënga 19, f. 153)

Në **vetën e dytë shumës** dalin forma të zgjedhimit të parë dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë del me trajtat, si: *baroshi*, *gzoshi*, *mbloshi*, *ndigjoshi* etj.

Nga CK kemi shkëputur vargjet për ilustrim:

...Me lymashk u *mbloshi* n'fund e n'krye! / Brevë e gjarpën paçi motër e vllá!(Kënga 5, f. 44)
...Në m'*ndigjoshi*, more shokët e mij, / Po e punojmë një pallë e një parmendë...(Kënga 18, f. 140)

Gjatë trajtimit të materialit të përmbledhjes "Visaret e Kombit" II vërtetohet vetëm përdorimi i tre formave të parregullta, si: *kjoshi*, *pashi* (formë foljore e dëshmuar edhe te Buzuku)⁴⁶⁵, *paçi*.

Po ilustruam me shembuj nga CK:

...Por, n'mos *kjoshi* Muji e Halili, / Gjallë s'u lâ derën për me e çilë!... (Kënga 29, f. 221)
...As bé m' Zotin trimi nuk ká bâ: / – Faqe-bardhë, more shokë, ju *kjoshi*... (Kënga 4, f. 26)
...*Pashi* majet, kû veroni, / *Pashi* mrizet, ku pushoni... (Kënga 1, f. 6)
...Por n'qafë m'*paçi*, mori bjeshkët e nalta! / Kurrkû 'i shtek qi nuk m'a lát...(Kënga 4, f. 28)

Veta e tretë shumës në CK del me mbaresën **-in** me pak forma. Forma në këtë vetë për zgjedhimin e tretë nuk na kanë dalë në asnjë rast.

Zgjedhimi i parë del me format, si: *thashin* / *thaçin*. Për **zgjedhimin e dytë** kemi ndeshur dy forma, si: *shndoshin*, *plaçin*.

Po ilustruam me vargje nga CK:

...Prap mâ idhshëm plaku i a dredh fjalën: / "T'*thashin* krahët, more plaku i thî!"...(Kënga 6, f. 53)
...Jú u *thaçin* Bjeshkët e thata! / Ortek borete ksajt mos me rrxue... (Kënga 29, f. 222)
...E për nuse kryet i a *shndoshin*, / E ket punë kurrkúj s'i a kallxon... (Kënga 12, f. 102)

⁴⁶⁴ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit..., f.320.

⁴⁶⁵ W. Fiedler, *Supletivizmi në sistemin foljor...*, vep. e cit., f.165.

Foljen e parregullt *thaçin*⁴⁶⁶ e kemi ndeshur në një rast përdorimi:

...Në të *thaçin* gjog, si t’kanë thanë, / N’dy gjûj ti për me rá... (Kënga 26, f. 205)

Zgjedhimi jovepror

Forma e mënyrës dëshirore në zgjedhimin jovepror ndërtohet duke i paravënë pjesëzën me origjinë përemërore **u** trajtave vetore të formës veprare të foljeve në të tashmen e dëshirores. Në CK kemi ndeshur pak raste, si: *u martosha*, *u nxâsh u pashim*, etj., siç del edhe nga shembujt që kemi veçuar nga CK:

...Kah kam vllá e kah kam motër, / – Deksha para, n’*u martosha*... (Kënga 4, f. 27)

...E t’mirë *u pashim* – burrave u ká thanë, / Edhe gjogut plaku n’shpinë i këcyeka... (Kënga 6, f. 54)

...– Thuej mori bí, *u nxâsh* robí, / Qe ‘izet vjet turku aty s’ká dalë... (Kënga 17, f. 136)

6.2 Format e kohës së shkuar të mënyrës dëshirore

Mënyra dëshirore në CK del edhe me forma të kohës së kryer. Kuptimi themelor i së kryerës së dëshirores është *të shprehë dëshirën e folësit, në formë urimi ose mallkimi, për veprime të së shkuarës*.⁴⁶⁷ Format e zgjedhimit vepror të kësaj kohe ndërtohen duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së tashmes së dëshirores së foljes ndihmëse **kam**: *paça dhânë*, si në shembullin e vjelë nga CK:

...Gumanave t’zez fjalë u ká çue: / – Tha çikën t’ême jú jau *paça dhânë*... (Kënga 22, f. 171)

Mënyra dëshirore ka në përdorim kryesisht një formim kohor, atë të kohës së tashme, por që kuptimisht i referohet më shumë së ardhmes, sepse modaliteti i dëshirueshmërisë, i shpehur në formë urimi apo mallkimi, lidhet rregullisht me veprime që pritet të kryhet pas çastit të ligjërit.⁴⁶⁸ Për këtë arsye forma e kohës së kryer të mënyrës dëshirore në CK, ka një përdorim të kufizuar.

Gjatë analizës së materialit të Këngëve Kreshnike kemi vjelë forma të vetës së parë dhe të tretë njëjës dhe forma për vetën e tretë shumës.

Zgjedhimi vepror

Numri njëjës

Veta e parë njëjës del vetëm me një formë të **zgjedhimit të tretë**, *paça xânë* dhe me pak forma të parregullta, si: *paça dhânë*, *paça lânë*, *paçë rá* etj.

Po marrim disa shembuj nga CK:

... – Udha e mbarë krajli u ká thânë, / Miq për zëmër jú sot u *paça xânë*... (Kënga 22, f. 174)

...Por amanet, Jovan, t’a *paça lanë*: / Nji fjalë Mujit tu dera me i a çue... (Kënga 4, f. 37)

...Çka qitë krajli e ká thânë: / – 300 qese t’i *paça dhânë*... (Kënga 9, f. 73)

Veta e tretë njëjës del me format e parregullta, si: *pastë ardhë*, *pastë lânë*, *pastë rá* / *paçë rá*, si në shembujt e vjelë:

...Dita e kobit tý n’t’ *pastë ardhë*, / Robinë turku tý me t’marrë... (Kënga 17, f. 137)

Në rastin e formës të së kryerës së dëshirores, kemi ndeshur edhe raste kur folja ndihmëse **kam** del me dy forma:

Krahaso:

a. ...Se n’t’*pastë rá* qefi i mejdanit, / Çoi fjalë bylykbash-e Mujit... (Kënga 33, f. 236)

b. ...E *paçë rá* n’nji rrëm të thatë, / Dý- tri herë aty kam hukatë... (Kënga 34, f. 239)

⁴⁶⁶ G. Mikeli, *Gramatika*..., vep. e cit., si forma të së tashmes të dëshirores dalin: *thaça*, *thaç*, *thashtë*, *thaçim*, *thaçi*, *thaçin*, f.114.

⁴⁶⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*..., vep. e cit..., f.330.

⁴⁶⁸ Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore*..., pun. i cit., f.114

Numri shumë

Veta e tretë shumë vërtetohet vetëm me një formë që i takon **zgjedhimit të dytë**, paçin mbetë, si në vargjet:

Tânë trimnít njatij i paçin mbetë! / Sá mirë nânën djelmt m'a kan ndigjue...(Kënga 25, f. 199)

Zgjedhimi jovepror

Në zgjedhimin jovepror forma e së kryerës së dëshirores ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së tashmes së dëshirores së foljes ndihmëse **jam: kjoshim falë**, si në rastin:

...T'lumit Zot, baca, i *kjoshim falë!* / Dritë ká dalë e dritë - o nuk ká bâ... (Kënga 26, f. 203)

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, për zgjedhimin jovepror të kohës së kryer, vërehen forma për vetën e tretë njëjës dhe për vetën e parë dhe të tretë shumë.

Veta e tretë njëjës vërtetohet me forma të **zgjedhimit të parë**, si: *kjoftë gjikue, kjoftë qillue* etj., dhe të **zgjedhimit të dytë**, si: *koftë falë, kjoftë fjetun*, etj.

Po ilustruam me shembuj:

...Kah jé nisë, Mujo me shkue? / – N'at Jutbinë për n'kjoftë gjikue⁴⁶⁹!... (Kënga 6, f. 56)

...N'kjoftë qillue Halili tue vjedhë, / Zoti t'mbarën kurr mos i a dhashtë!... (Kënga 21, f. 168)

...E u *koftë falë* krejt malli e gjâja e shpís! / Amanet motra Gjergj Elez Alís!...(Kënga 5, f. 47)

...Tybe *kjoftë fjetun* për me e pré, / Marre, Mujë, burra m'u pré n'gjumë... (Kënga 19, f. 150)

Veta e parë shumë del vetëm me formën, *kjoshim falë*, të zgjedhimit të dytë, siç vërtetohet edhe në vargjet nga CK:

...T'lumit Zot more i *kjoshim falë*, / Se s'jêm kânë e jetën na e ká dhânë!...(Kënga 21, f. 159)

Veta e tretë shumë del në pak raste vetëm me dy forma, si: *kjoshin falë, kjoshin dhânë*, si në vargjet:

...Besa besë e fjala fjalë, / Dhít e egra u *kjoshin falë!*... (Kënga 1, f. 9)

...– A del djalë kush maz'n me i a marrë, / 3oo qese për maz i *kjoshin dhânë*...(Kënga 9, f. 73)

6.3 Probleme të mënyrës urdhërore

Mënyra urdhërore është një nga mënyrat e trashëguara të gjuhës shqipe. Kjo mënyrë ka dy forma gramatikore për vetën e dytë njëjës dhe shumë, si: *ruej - rueni*. Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II format e vetës së dytë njëjës të urdhërores, përgjithësisht dallohen nga format përgjegjëse të kësaj vete në të tashmen e dëftores, por ka edhe raste që dalin me të njëjtën formë gramatikore (*del, merr, qesh, vesh*, etj.). Këto forma homonimike dallohen në fjali vetëm nga intonacioni përkatës, si në rastet:

Krahaso:

a. ...Para *del* djali jabanxhí, / Don n'mejdan Gjuros me i dalë...(e **tashme**) (Kënga 24, f. 194)

b. ...**Del**, bre Muj, Zoti të vraftë! / Se dy binakët djali m'i ká xânë... (**urdhërore**) (Kënga 26, f. 209)

Për format foljore të vetës së dytë shumë të urdhërores ndodhin po ato ndryshime fonetike që kanë pësuar format gjegjëse të vetës së dytë shumë urdhërore (që formalisht janë të njëjta me ato të vetës së dytë shumë të së tashmes së dëftores). Tema e vetës së dytë njëjës e urdhërores, nën veprimin rrafshues të analogjisë, është ndërtuar në bazë të vetës së dytë shumë të urdhërores.⁴⁷⁰ Megjithatë, dallimi i kësaj mënyre nga e tashmja e dëftores bëhet edhe me mjete

⁴⁶⁹ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., kjo formë foljore ka kuptimin "diçka që do të ndodhë, sepse kështu e ka prerë fati i njeriut; veprimi që do të ndodhë jashtë ndërgjegjes sonë e që nuk do të mundemi t'i bëjmë ballë", f. 147.

⁴⁷⁰ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.853.

të tjera gjuhësore, si intonacioni e pjesëza e mohimit (pjesëza s’ zakonisht përdoret për dëftoren dhe **mos** për urdhëroren).

Krahaso:

a. ...A s’po *dijni*, a s’po doni, / Se atje s’janë komitë me shkjë... (Kënga 27, f. 212)

b. ...Hiç për hajr, nusen **mos** m’a *bâni*, / Se e ká zaptue Burc Eleze Krajli... (Kënga 24, f. 188)

Në CK vërtetohet si veta e dytë njëjës, ashtu edhe veta e dytë shumës e urdhërores. Nga format e vjela na rezulton se format e urdhërores për vetën e dytë njëjës janë më të pasura në mbaresat vetore, se format e vetës së dytë shumës.

Zgjedhimi vepror

Veta e dytë njëjës vërtetohet e ndërtuar me këto mbaresa:

a. Me mbaresë **zero** si në shqipen e sotme⁴⁷¹ dalin forma të urdhërores për të gjitha zgjedhimet si dhe foljet e parregullta.

Zgjedhimi i parë. Foljet e këtij zgjedhimi që dalin me zanore të thjeshtë në të tashmen e dëftores, mënyrën urdhërore e formojnë pa ndonjë mbaresë, vetëm me temën e foljes, si: *beko, ço, difto, drejto, gabo, guxo, kallxo, lufto, lsho, msy, mba, ndigio / ndigjo / nigjo, ndimo, qindro, sundo, shpejto, shpërthe, shko, shtërngo* etj.

Nga CK po marrim shembujt:

... – Pa *nigjo*, more krajlje kapidane! / S’â ngusht njeri deri n’ditë të dekës... (Kënga 4, f. 39)

Ká zgjidhë gjogun e ká shilue, / *Ndimo* ora e bjeshkve!” – e n’shpinë i ká kcye.(Kënga 2, f. 13)

...E ruej se e *msy* tjetër derën e shpís, / Se babës e vedit i a ká mbyllë me ferrë..(Kënga 4, f. 37)

Zgjedhimi i dytë del me disa forma duke e ruajtur temën e foljes njëlloj si në të tashmen e dëftores, si: *brít, del, dredh / dredho, fol, hup, ik, kqyr, lyp, merr, ndal, ndez, prit, qesh, qit, shetit, vesh, vozit* etj.

Po ilustruam me vargje ng CK:

...*Dredho*, gjog, se sot t’ká ardhun dita! / Gjokut Muji i ká bërtitë... (Kënga 6, f. 59)

...*Kqyr* ç’ká bân nâna, kjoftë e zezë, / Për dollapit balozin m’a shikjon... (Kënga 11, f. 90)

...Ti *vozt*, un drejto velat! / Na çon Zoti ‘i freski t’hollë... (Kënga 4, f. 35)

Zgjedhimin e tretë e kemi ndeshur vetëm me formën, *pi*:

...Tjetër fjalë Muja s’ká qitë. / ”*Pi* uj, Mujë!” – Ora te i ká britë... (Kënga 6, f. 57)

Foljet e parregullta dalin me pak forma, si: *ep, kí, rri, shif*, si në rastet:

...N’votër tânde kém qillue, / Mos na *ki* rândë për një fjalë!... (Kënga 4, f. 26)

...– Ne kujtojsh sevapin e Zotit, / Me dorë t’ânde m’*ep* t’a pí... (Kënga 17, f. 137)

...Mos *rri* shum për me i kërkue / N’burg Omeri t’i ká ngujue... (Kënga 26, f. 208)

b. Me mbaresën **-j**, e cila në zanafillë është tingull antihiatizues, por që në rrjedhë të kohës është shndërruar në mbaresë karakteristike të kësaj mënyre për vetën e dytë njëjës⁴⁷², pra, kemi të bëjmë me një mbaresë **sui generis**.⁴⁷³ Foljet që kanë gjatësi të ndryshme zanoresh, dallohen edhe për formantin që marrin në këtë formë modale: ato me zanore të gjata marrin mbaresën **-j**, kurse ato me zanore të shkurtra nuk marrin mbaresë⁴⁷⁴, gjë, e cila vërehet edhe në materialin e shqyrtuar të këngëve kreshnike me forma zakonisht të zgjedhimit të parë dhe me foljet e parregullta.

⁴⁷¹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.297.

⁴⁷² Sh. Demiraj, Gramatikë historike..., vep. e cit., (1986), f.859.

⁴⁷³ A. Haxhi, Proza e Fishtës..., vep. e cit., jepen shembujt: ...-*mshâj*ë asaj karrige perfundi... (HD, 1934, fq.457);...-ktu *rrêj*ë, atje *gênj*e... (HD, 1924, fq.196);, f.190.

⁴⁷⁴ K. Topalli, Sistemi foljor..., vep. e cit., f.392.

Zgjedhimi i parë del me pak forma, si: *gjûj, kjáj, msýj, práj, ruej, shuej* etj.

Nga CK po veçojmë shembujt:

... – *Shuej*⁴⁷⁵, mori Rushe, Zoti t'vraftë! / Qe trí vjet ethet m'kan marrë... (Kënga 17, f. 137)

... – *Práj* mos qesh, budalla i marrë, / Skáj m'skáj turku ásht marrue... (Kënga 24, f. 189)

...Muji grues çka qitë e i ká thânë: / – Mos *kjaj* djelmt qi n'luftë kan dekë..(Kënga 29, f. 218)

Foljet e parregullta dalin vetëm me foljet, si: *kij, thuej*:

... "Mos *kij* gajle!" – Halili i ká thânë: / Janë çue n'kâmbë, atllarve edhe u kan hypë...(Kënga 2, f. 16)

c. Me mbaresën **-ë**, që mendohet të ketë ardhur nga pjesorja e foljes⁴⁷⁶, që është e njëjtë me mbaresën e vetës III numër njëjës të mënyrës lidhore.⁴⁷⁷ Vërtetohen të jenë përdorur me këtë mbaresë vetëm foljet e **zgjedhimit të dytë**, që dalin me temë në bashkëtingëllore, si: *çilë, falë, kqyrë, zgidhë* etj.

Nga Këngët Kreshnike po marrim vargjet:

...– *Kqyrë*, Muje, kúr daltë drita, dalët e bardhë, / Shpejt derën ké me çilë... (Kënga 11, f. 89)

...Shpejt derën ti m'a *çilë*, / Mâ shpejt hekurat ti m'i *zgidhë* ... (Kënga 11, f. 90)

d. Me mbaresën **-n**. Këtë mbaresë e marrin foljet që dalin me temë në zanore dhe që e zgjerojnë temën me **-n**. Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II ndeshen të përdorura vetëm tri forma, si: folja e zgjedhimit të parë, *hîn*, zgjedhimit të tretë, *vên* dhe folja e parregullt, *lên*. Format e urdhërores *vên* dhe *lên* dalin gjithmonë të shoqëruara me pjesëzën e mohimit *mos*.

Po ilustruam me disa shembuj:

...Hajt e *hîn*, nânë, n'at burgun e terrtë, / E ma zgidh, tha, një gjog pa qéf... (Kënga 18, f. 142)

...Se tý dergjen nâna t'a ká shdnoshë, / – Por çilm derën e **mos** m'*lên* me pritë..(Kënga 4, f. 36)

... Por vesh kúj, qyqe, *mos* i *vên*, / Qyqja e kuqe për hava ká përkatë... (Kënga 34, f. 238)

Veta e dytë shumës e urdhërores del njësoj si format gjegjëse të së tashmes së dëftores, e cila del e ndërtuar me mbaresën vetore **-ni** (*rueni*), si në vargjet:

...Njaty *rueni* se *lodroni*! / Njaty kângën mos e *knodni*!.. (Kënga 1, f. 2)

...– *Hajtni* n'odë të dy për me shtrudhë, / Po n'kjoftë fëmën ká m'u diftue... (Kënga 10, f. 84)

...E *hajdi*⁴⁷⁸ tash e çeta e mbarë u kjoftë! / Atëherë foli Dizdar Osman Aga...(Kënga 23, f. 179)

Në CK na kanë dalë këto forma:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *diftoni, gjëni, hîni, kallxoni, këndoni / kndoni, lani, lodroni, lshoni, mbani, ndigjoni / ndigjioni, pushoni, rueni, shkoni, tallni, xjerni, zgidhni* etj.

Po ilustruam me vargje:

... – Por ju *lani*, u pastë Tanusha! / – *Lani* lesh e mos u tallni!... (Kënga 4, f. 33)

...Po ju vendin pse s'ma *lshoni*? / Po mue gjogun pse s'ma *mbani*?... (Kënga 26, f. 206)

Zgjedhimi i dytë del me disa forma të urdhërores, si: *hypni, merrni, ngrehni, nisni, pritni, qitni, tallni, zgidhni* etj.

Me disa nga këto forma po japim shembujt e vjelë nga CK:

...*Pritni* pak, more zo'jt e malit! / Ká përgjegjë dhija në shkam... (Kënga 4, f. 31)

...*Qitni* strugën e unâza lodroni! Mirë kan hângër e mirë kan pí... (Kënga 10, f. 84)

⁴⁷⁵ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., folja **shúaj / shúej** ka kuptimin "fik zjarrin a dritën", Fjalë e mbarë gjuhës, me burim onomatopeik, imitim i zhurmës që bëjmë kur duam të fikim një zjarr. Në anë të Mirditës përdoret me kuptimin "hesht, pusho", f.1433. Edhe në shembullin që kemi ilustruar më lart del me të njëjtin kuptim "pusho, mbylle gojën".

⁴⁷⁶ M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Prishtinë, 1959, f.56-57.

⁴⁷⁷ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., këto forma janë të dëshmuara edhe në veprën e Buzukut: *Ecë me Tenëzonë* (XXV/2b), f.347.

⁴⁷⁸ Trajta *hajdi*, nuk del me trajtën e shkurtër, sepse duke qenë rrëfimi në varg nuk rëndohet edhe me trajtën e shkurtër.

Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit. Në gjuhën popullore përdoret dendur si urdhërores e kësaj foljeje huazimi turk, *hajde*, që për vetën e dytë shumës merr dhe mbaresën vetore **-ni**, f.859.

...E selín ma gjëni mâ t'mirë, / Po m'i ngrehni kullat e sarajet... (Kënga 21, f. 164)

Forma të urdhërores në vetën e dytë shumë për zgjedhimin e tretë nuk vërtetohen në asnjë rast.

Foljet e parregullta kanë një përdorim më të kufizuar në raport me format e tjera foljore të urdhërores. Format që dalin më shpesh janë: *bini / bijni, disni, hani, hajtni / hajdi, lêni, kini* etj. Nga CK po marrim vargjet:

...*Kini* mêt e mos pushoni! / Se aty janë trí zâna t' idhta... (Kënga 1, f. 2)

...Nâna djelmve mirë u ká përgjegjë: / "As mos *bijni* n'uj, o djelm, me u mbytë"... (Kënga 3, f. 21)

...Se mik shpijet t'parët t'a kan pasë, / *Lêni* fjalët, moj nânë, e nânë mos t'paça... (Kënga 11, f. 95)

Zgjedhimi jovepror

Forma në **joveprore** e mënyrës urdhërore në CK, del e ndërtuar nga prapavënia formës së urdhërores veprorë të pjesëzës me origjinë përemërore **u**. Në materialin e studiuar, në vetën e dytë shumë, në dallim nga shqipja standarde, kjo pjesëz vjen pas mbaresës **-ni**, kurse **-i-ja** e mbaresës, si dhe në rastin e trajtave të shkurtra konsonantizohet në **-j** duke formuar me pjesëzën diftongun sekondar **-ju**,⁴⁷⁹ siç vërtetohet edhe nga shembulli që kemi marrë nga CK:

...*Ndalnju* gurrave me u freskue, / *Ndalnju* mrizve me pushue... (Kënga 1, f. 9)

Në **vetën e dytë njëjës** dalin këto forma për zgjedhimin e parë dhe të dytë:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *çou, ktheu, largou, lshojau, martou / martohu, ngujoju, prapou*⁴⁸⁰, *prapu, shtërngou / shtërngou, rueju* etj.

Po ilustrojmë disa shembuj nga CK:

...Aq mâ tepër djali â pezmatue: / *Prapou*, Mujë se m'ká ardhë dita e dekës!... (Kënga 4, f. 27)

...*Shtërngou*, Mujë, qetash po t'rrxoj! / Mirë janë lidhë me llâna t'krahve... (Kënga 6, f. 60)

...*Çou* moj, Rushe, ndera e shpís, / *Çou*, m'i vesh petkat e nusís... (Kënga 9, f. 78)

...*Prapu* Halili, mâ kndej mos hajde, / E kam pushkën habërtare... (Kënga 31, f. 228)

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *avitu, hiq-u, mos u lodh, ndalu, ngrehu, mos u ngut, ulu, xirjau* etj.

Nga CK kemi shkëputur vargjet për ilustrim:

...Por *avitu* 'i herë prej mejet! / A p'e shef qat lum të gjânë?... (Kënga 4, f. 31)

...Ndezi ashtat anë e m'anë! / *Zirjau* gjumin orve n'mal... (Kënga 4, f. 40)

...“A po don krena me marrë? / – *Hiq-u* krenash, dreqi i rroftë!... (Kënga 6, f. 56)

Veta e dytë shumë del me trajtat, si: *shtërngohi*⁴⁸¹, *ndalniu / ndalnju*⁴⁸², *qeshiu*, si në rastet:

...As mos hîni n'kullë për me u ngujue, / Mirë *shtërngohi* e gjogat mirë me i sh'lue... (Kënga 3, f. 21)

...Tjetra mende Mujit po m'i vjen. / *Qeshiu* – thotë – trima agallarë... (Kënga 25, f.198)

⁴⁷⁹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.196.; Ne këtu presim një tingull antihiatizues, por na del një diftong sekondar (**çoju** në vend të *çou*, **martoju** në vend të *martou* etj.)

⁴⁸⁰ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, folja ka kuptimin "prapësohu; mos ndërhyj; mos vazhdo, por sillu mbrapsht", f.177.

⁴⁸¹ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit. "Për trajtat e tipit *dah, mbah, çudit*, është shprehur mendimi se janë përfutur nëpërmjet sinkopimit të formave të plota, për t'u dalluar kështu nga format gjegjëse e së tashmes së dëftores", f.862.

At Donat Kurti, *Gramatika shqype*, "Vetëm për shumë përdoret ndoiherë edhe trajta e shkurtueme e vehtjes II, të kohës së tashme të m. dëftore, b. fj.; *çohi!* (prej *çoheni*), *dahi!* (prej *daheni*)", Botime Françeskane, Shkodër, 2020, f.104.

⁴⁸² J.Rrota, *Gjuha e shkrueme...* vep. e cit., Foljet e mënyrës urdhërore në vetën e II-të njëjës dhe shumë dalin: *lidhu- lidhnju, zbutu-zbutnju, banu-banju, venu-venju*, f.383.

6.4 Kuptimet e këtyre kohëve

Mënyra dëshirore

Kuptimi themelor i kohës së tashme të dëshirores është të shprehë dëshirën e folësit, në formë urimi ose mallkimi, për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjëritimit ose pas tij.⁴⁸³ Koha e tashme e dëshirores *përdoret edhe për të shprehur veprime të mundshme të së ardhmes, pa shprehur dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi*. Kjo ndodh kur ajo përdoret në fjali të varuara kushtore dhe lejore, të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *në*, siç vërtetohet edhe në vargjet nga CK.⁴⁸⁴

...Se n' bafhtë dita e ême për me ardhë, / Derë n' derë un t' y prap kam me t' lypë. (Kënga 11, f. 93)

...E ç' ká qitë nâna e i ká thânë: / – Për ne e paçi bafthin për me pshtue... (Kënga 18, f. 142)

...Se në kjoftë Halili kopil, / Burrë me sy nesër ká me pá... (Kënga 25, f. 198)

Në Këngët Kreshnike koha e **kryer** e dëshirores ndeshet shumë rrallë edhe në fjalitë e varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *në*, si në vargjet:⁴⁸⁵

...N' kjoftë qillue Halili tue shburrue, / Zoti t' mbarën kurr mos i a dhashtë!... (Kënga 21, f. 168)

Në raste të izoluara forma e së tashmes së dëftores del me kuptimin e dëshirores, si në vargjet e dhëna:

...Qi tybe n' Zotin mbrapa n' i *bie*⁴⁸⁶ / Mos me m' ardhë marrja e Jutbinës... (Kënga 4, f. 38)

Gjatë shqyrtimit të CK, kemi vënë re se disa forma dalin me kuptimin e dëshirores, por nuk kanë formantin e dëshirores.

Nga CK kemi shkëputur vargjet:

...T' u *ngjatët* jeta, tha, kralj-e kapedani, / Por një idizá mue qi m' ká rá... (Kënga 14, f. 118)

...Kqyr çka foli Gjeto Basho Muja: / – U *rritët* ndera – agve u ka thânë... (Kënga 21, f. 164)

Disa forma të së tashmes së dëshirores kur shoqërohen me trajta të shkurtra të përemrit vetor pjesëza i prapangjitet foljes, ndërsa mbaresa *-ë* ka pësuar një krasis, e cila në këtë rast përkon edhe si mbaresë e vetës së tretë të numrit njëjës, si: *shtoftu, thafta, vrafti*.

Po ilustruam me shembujt e vjelë nga CK:

...Hé ju Zoti *shtoftu* vargun! / “Kuj, ju orën-o, po i ndimoni?... (Kënga 2, f. 12)

...Si s' u thá kjo motër, *thafta* – e vera! / Po un balozit qysh i shkoj tu dera!... (Kënga 5, f. 45)

...Ç' ish kujtue një shkinë, e *vrafti* Zoti! / I a ká shkruet syretin n' Mujin... (Kënga 29, f. 220)

Format e së tashmes dhe të së kryerës së dëshirores në pak raste shoqërohen edhe me tregues kohor që tregojnë ose kohën e caktuar të veprimit ose dalin me vlerë mbarëkohore, si: *sot, kurr* etj.

Nga CK po marrim shembujt:

...E ate gjumi n' e pastë xânë, / **Kurr** kryet *shndosh*-o mos e *çoftë*!... (Kënga 4, f. 40)

... – **Kurr**, o bjeshkë, ju mos u *gzoshi* / Me bár t' njomë **kurr** *baroshi*!... (Kënga 25, f. 200)

... – Udha e mbarë krajli u ká thânë, / Miq për zëmër jú **sot** u *paça xânë*... (Kënga 22, f. 174)

Gjatë analizës së Këngëve Kreshnike vërtetohet edhe rendi i përmbysur i formave të së kryerës së dëshirores, ku pjesorja del para foljes ndihmëse edhe për arsye stilistikore.

Nga CK po veçojmë vargjet:

...*Falë* u *kofshin* sarajet e mija! / *Falë* u *kofshin* tânë paret e mija!... (Kënga 5, f. 47)

...*Mallkue* *kjosh*, o mori hânë / Qysh me e lânë nânën pá t' djalë!... (Kënga 30, f. 225)

⁴⁸³ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.283.

⁴⁸⁴ Po aty, f.329.

⁴⁸⁵ Po aty, f.330.

⁴⁸⁶ Sqarohet edhe në fund të faqes së *Visareve të Kombit II*, kuptimi me vlerë dëshirore: *Në i rafsha mbrapa*, f.38.

Mënyra urdhërore

Kuptimi kryesor i urdhërores është të shprehë dëshirën e folësit në formë: urdhri, nxitje, grishje, këshillë, porosi, lutje, pranim, lejim, për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjërimit ose pas tij.⁴⁸⁷ Në përputhje me kuptimin modal karakteristik, format gramatikore të kësaj mënyre shprehin zakonisht kuptimin e kohës së ardhme⁴⁸⁸, pra të një veprimi që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit. Format e urdhërores në CK na dalin të pasura me përdorime, si, p.sh.:

a. urdhërorja që shpreh urdhër, si në vargjet:

...*Ruej*, bré Mujë, se krajlin po m’a çartë! / *Zgidhmi* kush prângat prej dore!...(Kënga 4, f. 41)

b. urdhërorja që shpreh nxitje, grishje, si në rastin:

...Por *hajde*, djalë, hajrin tý t’a pasha, / Se për trimní Zoti tek t’ká falë... (Kënga 26, f. 204)

c. urdhërorja që shpreh këshillë, porosi, si në shembullin e ilustruar nga CK:

...Sa mirë ora e paska msue! / Po *mba* vesh, or djalë i rí!... (Kënga 4, f. 30)

ç. urdhërorja që shpreh lutje, kërkesë:

...Aman, Muj, Halili i kish thânë: / Mos më *ço*, n’Janinë të madhe!... (Kënga 8, f. 68)

...Qi:– Kurrkúj derën nuk i a *çilë*, / Për pá ardhë, Alija, yt bír... (Kënga 13, f. 109)

... –A *din* gjâ mue me m’kuvendë, / Për Ali Bajraktarin, djalin t’ëm... (Kënga 13, f. 115)

Lokucioni foljor, *falë me shndet*, i përdorur në disa raste, del me modalitetin e urdhërores, por me kuptimin e lutjes, si në shembullin që po veçojmë nga CK:

... "Zânës s’madhe *falë* me shndet! / Thuej Halili qetash mbet!"... (Kënga 4, f. 40)

d. urdhërorja që shpreh pranim, lejim, si, p.sh:

– *Largou*, more budalla i marrë, / Se i zoti gjân e vet m’duket se ká marrë...(Kënga 13, f. 116)

Në vargjet e CK vërehet edhe përdorimi i urdhërores tregimtare, e cila e jep veprimin më shprehës emocionalisht dhe me nuanca të veçanta gramatikore, zgjatje apo përsëritje të tij, siç vërtetohet edhe nga shembujt e vjelë në CK:

...*Vasha kjáj*, Halili *brít*: / "Kshtu merr gjakun Halil Aga i rí!"... (Kënga 23, f. 182)

...Ata *msÿj* yrysh si bisha e malit / Ai *qindro* n’at shpellë si drang luânit... (Kënga 23, f. 183)

Veta e dytë njëjës e urdhërores mund të përdoret për të tri vetat (e njëjësit dhe të shumësit), për të paraqitur me një fuqi shprehëse të veçantë një a më shumë veprime të përsëritur në të shkuarën. Kjo ndodh atëherë kur përsëritet urdhërorja e së njëjtës folje, ose kur përdoren format e urdhërores të dy a më shumë foljeve të ndryshme, të shoqëruara secila me kryefjalën përkatëse (e cila mund edhe të nënkuptohet) dhe të lidhura midis tyre me anë të lidhëzës bashkërenditëse *e*, ose asidentisht,⁴⁸⁹ siç e tregojnë edhe shembujt:

...**Cou e shif** seri me sy. / Brraf në kâmbë Muji âsht çue... (Kënga 9, f. 71)

– Ti nândë odat ké me i çilë, / Njat mâ t’fundshëm **ruej se e çilë**... (Kënga 12, f. 90)

...E bija e krajlit fjalë paska çue: / – **Hajt e thuej** Begzades s’bardhë... (Kënga 14, f. 120)

Format e mënyrës urdhërore dalin shpesh të shoqëruara me trajtat e shkurtra duke ndihmuar edhe në përforcimin kuptimor të kësaj mënyre duke iu ngjitur enklitikisht si formave të njëjësit ashtu edhe të shumësit, si në rastet: *bjeri, bjere, bjerma, çilja, çilm, çilma, çoja, çoje, epja, fike, gjujma, hajde, hiqja, hypi, kape, kërkoë kqyre, kqyrnie, merre, ndale, ndalnje, ndigioma, ndigjoje, prite, prîna, priti, qiti, qitma, qitmi, shpërthe, shtjere, vrae, xêne, zgidhmi, zirna* etj. Nga shembujt e vjelë në CK kemi veçuar:*

⁴⁸⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.330.

⁴⁸⁸ Sh. Demiraj, Gramatikë historike..., vep. e cit., f.852.

⁴⁸⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, ..., vep. e cit., f.331.

**Shembuj të vjelë nga CK: ...“Prîna*, Mujë, se na ká xânë mjesdita!” / Kush â’ rá n’lumë gjogut uj’ me i dhânë...(Kënga 6, f. 51);...Amanet për t’mbramën herë! / *Kërkoë* bjeshkën krep e m’ krep! ... (Kënga 4, f. 40); ...*Epja* fyellin a thue po i bjen, / *Epja* ‘i herë lahutën n’dorë...(Kënga 10, f. 84);...Atëherë Muji djalit i ká thânë: / – *Xêne* çikën, djali jabanxhí...(Kënga 24, f. 191)

...”Çilma derën, bre Trashi i Marjanit!”... / As kërkush s’i ká përgjegjë: / (Kënga 2, f. 18)
...Gjurma rê, qetash me kokërr rfeje! / Zirma n’tokë përjashta natë t’ vorrit!..(Kënga 4, f. 27)
...Lsho-na dritën n’pr’ ato biga, / Lsho-na synin n’pr’ ato çeta... (Kënga 6, f. 52)
...Veç Halili paska folë: / “Baca Mujë, po ndigioma ‘i fjalë “!... (Kënga 6, f. 55)
...Vrae Zot at Arnaut Osmanin! / Njato fjalë tha trimi kúr m’i ndie... (Kënga, 9, f. 73)

Në mënyrën urdhërore është ruajtur lëngëzorja **-r** e temës, te foljet *bjere*, *shtjere* meqënëse nuk ka qenë në pozicion fundor falë mbaresës vetore **-ë**, që e ka ndaluar evolucionin e zanores **-e** në shkallën e diftongut **/je/** duke mos lejuar shndërrimin e tij të mëtejshëm në tog zanor⁴⁹⁰, siç e vërteton edhe shembulli që po ilustron nga CK:

...Dorën *shtjere* në xhep të shmâjët, / Aty gjë një thikë të helmatisne... (Kënga 6, f. 61)
Ndërsa, kur folja në mënyrën urdhërore përdoret në formë mohore, me pjesëzën **mos**, ose e shoqëruar me trajtë të shkurtër, pjesëza me origjinë përemërore **u** gjendet e vendosur ndërmjet pjesëzës mohuese **mos** ose trajtës së shkurtër dhe trupit të foljes, si: *mos u ban*, *mos m’u hiq*, *mos u mërzit*, *mos u ngut*, *mos u lodh*, *mos u tallni* etj., siç e tregojnë edhe shembujt e marrë nga CK:

... **Mos u ngut**, ti mori hânë! Ujt e freskët tek ká qillue... (Kënga 6, f. 52)
...Ai tjetri nusen ká me e marrë, / E për nuse marak **mos u bân!**... (Kënga 12, f. 102)
...Edhe Mujit dorën po m’i a merr:–**Mos u mërzit**, bre Gjeto Basho Muji! (Kënga 23, f. 180)
...Kurrkush vendin **mos i a lsho**,
Kush selamin **mos i a dredh**,
Askush kalin **mos i a shetit!** ...(Kënga 26, f. 205)

Siç u trajtua edhe me sipër, mënyra dëshirore del me dy kohë, të tashmen dhe të kryerën. Format e së tashmes më së shumti ruajnë mbaresat vetore të standardit të shqipes. Në disa raste format e së tashmes dalin edhe me variacione dialektore. Forma e joveprores del shumë rrallë. Format e së kryerës vërtetohen me një numër relativisht të vogël në zgjedhimin vepror dhe jovepror. Këto forma nuk dalin në të gjitha vetat. Shpesh format e së tashmes dhe më pak të së kryerës dalin me modalitetin e kushtores.

Siç na vërtetohet edhe nga shembujt e vjelë, mënyra urdhërore në CK, si në shqipen standarde del me të dy format e saj, vetën e dytë njëjës dhe shumës. Më e pasur në mbaresa vetore është veta e dytë njëjës. Format e urdhërores shpesh shoqërohen edhe me pjesëza duke na dhënë edhe nuanca të reja kuptimore. Format më të shpeshta në materialin e shqyrtuar janë ato të vetës së dytë njëjës. Format e urdhërores dalin të pasura edhe me përdorime të ndryshme në fjali.

Disa nga format e dëshirores dhe të urdhërores po i japim përmbledhtas në tabelat:

⁴⁹⁰ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., f.858.

Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kresbnikësh dhe Legjenda)

Mënyra dëshirore			Koha e tashme		
Veprorë					
Numri njëjës			Numri shumës		
Veta I	Veta II	Veta III	Veta I	Veta II	Veta III
bâsha shndosha pasha/paça	gzosh dalsh kjosh/kofsh pát/paç	bâftë shkimtë/shkimët daltë/dalët pastë/pasët	shnoshim kjoshim paçim	gzoshi kjoshi paçi	shnoshin thashin/thaçin thaçin

Joveprorë
Veta I njëjës: u martosha

Mënyra dëshirore			Koha e kryer		
Veprorë			Joveprorë		
Numri njëjës		Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës	
Veta I	Veta III	Veta III	Veta III	Veta I	Veta III
paça xânë paça dhânë paçë rá	pastë rá/paçë rá	paçin mbetë	kjoftë gjikue kjoftë falë	kjoshim falë	kjoshin falë

Mënyra urdhërore			
Veprorë		Joveprorë	
Veta II njëjës	Veta II shumës	Veta II njëjës	Veta II shumës
lufto, brit, pi, kí prâj, kij, kqyrë lên hajt e thuej mos u bân mos i a lsho	kallxoni, merrni, kini	martou/martohu xirjau mos u lodh	shtërngohi ndalniu / ndalnju mos u tallni

KREU VII. FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

Foljet në gjuhën shqipe përdoren edhe në disa forma të ngurosura, që nuk ndryshojnë sipas vetës dhe numrit, por përdoren me të njëjtën formë, pavarësisht nga numri dhe veta e kryefjalës, së cilës i referohen. Këtyre formave, që në gramatikat tona quhen forma të pashtjelluara foljore, u mungon karakteri modal, sepse nëpërmjet tyre nuk shprehet qëndrimi i folësit lidhur me veprimin e gjendjen e treguar nga folja.⁴⁹¹ Nisur nga aspekti sintaksor, Bucholz e Fiedler thonë se privativi formon një njësi me konstruktet duke / me + pjesore. Sipas tyre, gjerundi (siç e quajnë ata përcjelloren) paraqet të kundërtën e privativit se edhe infinitivi gegë (me punue) për nga struktura dhe kategoritë është shumë i ngjashëm me privativin dhe gjerundin, por ndryshe nga këto dy trajta, infinitivi mund të përfaqësojë edhe lloje të fjalive kryesore.⁴⁹²

Gjuhëtari S. Riza thekson se "...pasi që infinitivi i lashtë erdhi duke kryer edhe funksionin e participit, atëherë për t'u dalluar infinitivi nga participi formalisht, të parit iu shtua edhe parafjala *me*, në analogji me përdorimin e infinitivit me parafjalën *pa*".⁴⁹³ Lidhjen ndërmjet dy trajtave *pa punue* e *me punue* B. Bokshi e argumenton duke u bazuar në antoniminë ndërmjet parafjalëve *pa* dhe *me* dhe elementin e njëjtë që i prapavendoset këtyre parafjalëve.⁴⁹⁴

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II, vërtetohen të gjitha format e pashtjelluara foljore: pjesorja, format e pashtjelluara mbi bazën e pjesores (përcjellorja dhe mohorja), paskajorja (e tashme dhe e kryer). Format e pashtjelluara dalin në të dy trajtat në veprë dhe joveprë. Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike vërehet se forma e paskajores paraqitet me një denduri me të madhe të përdorimit, në krahasim me format e tjera të pashtjelluara foljore.

Pjesorja

Pjesorja e shqipes është një formë foljore e ngurour pa kategori gramatikore. Ajo nuk ka as mënyrë, as kohë, as diatezë. Madje, ajo nuk ka as formë mohore, meqënëse funksionin e një formë të tillë e kryen forma e tipit *pa punuar*.⁴⁹⁵ Folja në formën gramatikore të pjesores shërben për të shprehur një veprim, duke e paraqitur atë jo si gjendje, por si tipar⁴⁹⁶. Këto tipare i ruan edhe në gegërisht, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...N' Lugje t' Verdha kúr ká shkue, / M'a ká pá vllán *shtrî* për dhé... (Kënga 27, f. 213)

Këto forma për nga kuptimi, nga funksionet dhe për nga tipi i ndërtimit i përgjigjen së ashtuquajturës pjesore të perfektit pësor të gjuhëve indoevropiane.⁴⁹⁷

Përgjithësisht pjesorja ka kuptimin e kohës së shkuar e atë të diatezës pësore kur vjen prej një foljeje kalimtare.⁴⁹⁸ Pjesorja ka tiparet e foljes dhe të mbiemrit. Më shpesh ajo përdoret për formimin e kohëve të përbëra të foljeve (*kam punuar, kisha punuar*) dhe të formave të tjera të pashtjelluara (*pa punuar, duke punuar, për të punuar*), si dhe pas foljeve modale: *duhet, do*.⁴⁹⁹ Duke iu referuar B. Bokshit theksohet se "... pjesorja e mbarë shqipes ka qenë e shkurtër fillimisht, mirëpo me krijimin e mbiemrave prejpjesorë toskërishtja e ka barazuar temën e

⁴⁹¹ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.193.

⁴⁹² K. Binaj, *Trajta e pashtjelluara mohore dhe përdorimi i saj në veprën e Martin Camajt*, SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, Prishtinë, 19-30.08.2013, f.286.

⁴⁹³ S. Riza, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.125.

⁴⁹⁴ B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, vep. e cit., f.138.

⁴⁹⁵ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.448-449.

⁴⁹⁶ F. Agalliu, *Pjesorja në gjuhën shqipe*. "Çështje të morfologjisë...", vep. e cit., f.174.

⁴⁹⁷ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.177.

⁴⁹⁸ Po aty, f.17.

⁴⁹⁹ B. Beci, *Gramatika e gjuhës shqipe...*, vep. e cit., f.134.

mbiemrit me atë të pjesores, duke e zgjeruar kështu temën e pjesores me prapashtesat mbiemërore. Në këtë mënyrë, *pa punuar* del edhe me pjesoren e zgjeruar edhe me pjesoren e shkurtër në sferën dialektore, kurse forma e pashtjelluar e tipit *me punu(e)*, pasi që mbeti jashtë shqipes standarde, e ruajti pjesoren e shkurtër në përbërjen e saj".⁵⁰⁰

Pjesorja në CK del e përdorur kryesisht si pjesë përbërëse e trajtave analitike, por ajo del edhe si formë më vete. Trajtat e pjesores që dalin në CK janë ndërtuar me anë formantesh që i shtohen një teme foljore që në përgjithësi përkon me atë të së kryerës së thjeshtë. Në mbështetje të shembujve të vjelë nga CK vërehet se format e pjesores janë përgjithësisht prapashtesore ose të zgjeruara, siç janë edhe sot në gjuhën shqipe. Siç vërtetohet edhe nga materiali i vjelë, pjesorja si folje më vete vërtetohet e ndërtuar me këto prapashtesa trajtëformuese:

1. Me formant zero. Ky formant karakteristik për gegërishten verëhet tepër i përdorur në CK. Formantin *zero* e marrin foljet që dalin me temë në zanore e, që në pjesën më të madhe e zbërthejnë atë në tog zanor **-ue-**, **-ye-**, ose foljet (kryesisht njërrrokëshe) që dalin me temë në zanore të theksuar, siç dalin edhe në shembujt e ilustruar:

...Të tanë ballët guri s'*lmue*/

Anash krejt guri s'*latue*.

Latue shkambi prej mermerit...

(Kënga 4, f. 35)

...Atëherë drita i u *turbullue*, / E kujtoi se â deké e shkue...

(Kënga 29, f. 220)

Këto forma pa mbaresë nuk mund të kenë qenë që në krye të herës forma pjesorësh. Meqënëse pjesorja e shqipes ka kuptim kohor të së shkuarës, është e pamundur që këtë kuptim ta ketë pasur forma themelore e foljes, prej së cilës janë ndërtuar format e tjera modale e kohore, prandaj format e pashtjelluara pa mbaresa mund të kenë shërbyer si paskajore dhe më vonë do të jenë interpretuar si forma pjesorësh, meqënëse dalin me një morfemë të vetme, ashtu si pjesoret e tjera, të cilat, edhe pse marrin prapashtesa të veçanta me rrugë aglutinative, mbesin forma sintetike. Në dialektin e Jugut nuk ekzistojnë më këto forma të paskajores sintetike.⁵⁰¹

Format foljore të pashtjelluara të pjesores me formantin *zero* i kemi ndeshur vetëm për **zgjedhimin e parë** me disa trajta, si: *bashkue*, *çue*, *hatrue*⁵⁰², *kthye*, *lá*, *latue*, *lmue*, *mallkue*, *martue*, *mbërthye*, *ngarkue*, *ngrî*, *peshue*, *prarue*, *punue*, *pushue*, *rândue*, *rrue*, *shkrue*, *shkue*, *shkurtue*, *shnjertzue*, *shpërdá*, *shtërngue*, *shtí*, *shtrí*, *shue*, *turbullue*, *vorruue* etj.

Po ilustrujmë disa vargje nga CK:

...Kanë gjetë lumën tånë *ngrî* akull; / Kanë gjetë krojet tånë *ngrî* hej... (Kënga 4, f. 25)

...Erzi i armve ndorja e zånës, / Dekë e ême me orë *çue*... (Kënga 4, f. 30)

...E tý kullat t'í kan zaptue, / Erzín marrë, çikat *shnjertzue*... (Kënga 4, f. 37)

2. Me formantin -ë (prapashtesë) dalin zakonisht disa trajta të zgjedhimit të dytë* që dalin me temë në bashkëtingëllore, si: *çilë*, *dalë*, *derdhë*, *dredhë*, *hupë*, *lidhë*, *marrë*, *mbathë*, *mbetë*, *mbështjellë*, *përdredhë*, *pkjë*, *pshtetë*, *pshtjellë*, *puthë*, *sjellë*, *shkepë*, *shkundë*, *veshë*, *vjerrë*, *vrasë*, *vrânë*, *zdeshtë*, *zgjedhë*, *zgidhë*, *zdrypë* etj. Këtë formant fillimisht e kanë marrë pjesoret e foljeve me temë në *-r*, *-l*, *-ll*, që pësojnë apofoni në të kryerën e thjeshtë e më pas për analogji duhet të jetë shtrirë edhe te foljet e tjera që dalin me temë në bashkëtingëllore.⁵⁰³

⁵⁰⁰ B. Bokshi, *Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe*, në botimin e autorit "Varia", AKADEMIA SHKENCAVE DHE ARTEVE KOSOVËS E EE ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS BOTIME TË VEÇANTA CXXXXV SEKSIONI GJUHËSISË DHE I LETËRSISË LIBRI 50, Prishtinë, 2014, f.55-57.

⁵⁰¹ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.470 - 471.

⁵⁰² D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., "më ka mbajtur hatrin; më ka përkrahë në veprimet e mia", f.150.

* *Shembuj të tjerë nga CK*: ...Pësmbdhetë *shkepë* n'anë për mbi rrugë; / Pësmbdhetë *derdhë* n'anë për nën rrugë...(Kënga 6, f.56);...Aj tu kullat shpejt po i shkon, / Der'n e avullis *çilë* po m'a gjë...(Kënga 6, f. 57)

Për ilustrim po i referohemi vargjeve nga CK:*

...Fort janë dredhë edhe *përdredhë*, / Kurrnja shoqin s’mujt me rrxue... (Kënga 7, f. 59)

...Lum për tý, o i madhi Zot! / Drita *dalë*, hâna prarue... (Kënga 22, f. 170)

Aty shef at gjarpnin *pshtjellë* kulaç: / Kishte shpinën të tânë shkrola - shkrola.(Kënga 23, f. 179)

Në pak raste në CK vërtetohen edhe pjesoret e *foljeve të parregullta*, si: *dekë*, *ndëjë*, të cilat e formojnë pjesoren me formantin **-ë**, si në rastet që kemi marrë nga CK:

...At-herë djelmt janë dyndë e rá te buni! / *Dekë* për gjumë, i kan gjetë burrat fjetun...(Kënga 6, f. 53)

Pjesorja e foljes së parregullt, *ndëjë*, del në të gjitha rastet si pjesë përbërëse e kohëve të përbëra, por këtu po e marrim si pjesore më vete, si në rastin:

...E në divanhane krajlit i bjen. / *Ndëjë* në karrige djali ishte kënë... (Kënga 12, f. 101)

3. Me formantin **-në**: Në një rast të vetëm kemi ndeshur trajtën e pjesores, *xânë* të *zgjedhimit të tretë*, siç vërehet edhe në vargjet e ilustruara:

...E kshtu drita e mbrame paska ardhun-ó! / Dielli *xânë* e majet *xânë* !... (Kënga 4, f. 40)

4. Pjesorja me formantin **-un** e foljeve me temë në bashkëtingëllore (*lidhun*) lidhet me të njëjtën pjesore indoevropiane me *no*, ndonëse Jokli e lidh me format në origjinë të rasës kallëzore të pjesores indoevropiane në *ono*.⁵⁰⁴ Me formantin **-un**, i cili është karakteristik për gegërishten, shërben për të formuar pjesoren e foljeve që dalin me temë në bashkëtingëllore, ku *u* historikisht mendohet të jetë një zanore mbështetëse.⁵⁰⁵ Në Këngët Kreshnike ky formant ndeshet i përdorur zakonisht me disa trajta të *zgjedhimit të dytë*, si: *çilun*⁵⁰⁶, *fjetun*, *gjegjun*, *lidhun*, *mbledhun*, *mbyllun*, *ngrehun* etj., dhe me format e parregullta të pjesoreve, si: *dekun*, *ndëjun*.

Nga CK po ilustruam vargjet:

...*Lidhun* Mujën e ka gjetë, / Sá shpejt Mujën e ká zgidhë... (Kënga 21, f. 169)

...N’ kjoftë se dera *çilun* ka qillue, / Mos guxo kishës me i u afrue... (Kënga 29, f. 219)

...Pushkës zjarm Muji i ká dhânë, / *Dekun* n’tokë Kreshton e ká lânë... (Kënga 34, f. 240)

Nga materiali i studiuar kemi vënë re se formanti **-mun**⁵⁰⁷ del shumë rrallë, vetëm me një rast të izoluar të trajtës së *zgjedhimit të parë*, *lâmun*, siç e vërteton edhe shembulli i vjelë nga CK:

...Për kah ‘i natë në muej të vjen, / Edhe at natë *lâmun* me gjak... (Kënga 20, f. 154)

5. Me formantin **-m**. Ky formant është karakteristik për gegërishten dhe zakonisht e marrin foljet që në të kryerën e thjeshtë dalin me temë në zanore. Në CK ky formant na del rrallë dhe vetëm me formën, *pritëm*, si në vargjet:

...Për pá shkue tu gurra nuk mund *pritëm* / Mâ mirë shkjet, Mujo, rob me m’ xânë, / Se prej edjet shpirti sot me m’ dalë... (Kënga 25, f. 201)

Folja e parregullt **ha** në vetën e tretë shumë të së kryerës së dëftores na del me dy pjesore: *kan hângër*, *kan ngrânë*. Dy trajtat e pjesoreve janë formuar nga dy tema të ndryshme, njëra bazohet në temën e së tashmes dhe tema tjetër bazohet në temën e së kryerës së thjeshtë. Nga trajta supletive e së tashmes së dëftores, **hâ** (*hângër*), e cila del vetëm për vetën e tretë njëjës dhe shumë, dhe nga trajta tjetër *ngrânë*, e cila formohet nga trajta josupletive e pjesores, e cila del në dy vetat e tjera të njëjësit dhe shumësit të së kryerës.

⁵⁰³ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.185.

⁵⁰⁴ Xh. Gosturani, *Format e pashtjelluara të foljes...*, pun. i cit., f.132.

⁵⁰⁵ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.184.

⁵⁰⁶ Disa forma dalin të përafërta me standardin dhe disa të tjera sipas zonave të gegërishtes, si: *çilë/çilun*, *lidhë/lidhun*, *dekë/dekun* etj.

⁵⁰⁷ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, me prapashtesën **-mun** dalin pjesoret: *lamun*, *lyemun*, vep. e cit., f.451.

Krahaso:

- a. ...Mirë kan *hângër* e mirë kan pí, / M’a pvetë djalin prej kah jé... (Kënga 10, f. 84)
b. ...E po i qet vënë e raki, / Mirë kan *ngrânë*, mâ mirë kan pí... (Kënga 11, f. 91)

Kuptimet dhe përdorimet e pjesores

Shkurtimisht në këtë pikë po ndalemi në disa prej funksioneve të pjesores, pavarësisht se nuk është qëllimi ynë studimor. Në shumicën e përdorimeve të saj me vlerën e një gjymtyre të fjalisë pjesorja e gjuhës shqipe tregon rezultatin e një veprimi të shkuar në një çast të caktuar të së tashmes, së shkuarës ose së ardhmes:⁵⁰⁸

Krahaso:

...Trupi i vllaut *vorruë* qe⁵⁰⁹ nând’ vjet në shpí! / Trupi i motrës n’dorë t’ balozit t’ zí...(=e tashme) (Kënga 5, f. 44)

...Ka pá muret *lá* me gjak, / Tridhetë krenat rreth e rreth...(=e shkuar) (Kënga 6, f. 57)

...N’ kjoftë se dera *mbyllun* kâ me kênë, / Shpërthe derën e mbrendë ngujoju...(=e ardhme)(Kënga 29, f. 219)

Pjesorja, si folje më vete mund të shërbejë edhe si pjesë e kallëzuesit emëror, siç del edhe në vargjet e shkëputura nga CK:

...Aj m’âsht Zuku bajraktár, / *Mbërthye vetllat* m’at shtek ballit... (Kënga 6, f. 54)

Pjesorja, si gjymtyrë më vete mund të shërbejë edhe si përcaktor i veçuar, siç vërtetohet edhe nga shembulli i vjelë nga CK:

...Deri n’gjysë shpatat i shkurtojnë. / *Zdrypë prej gjokash*, n’tokë kan rá... (Kënga 6, f. 59)

Pjesorja e foljeve kalimtare mund të përdoret edhe si pjesë e kallëzuesit emëror. Në këtë rast ajo tregon një gjendje të kryefjalës dhe mund të zevëndësohet nga mbiemri prejpjesor i nyjësuar, si në rastin:

...Tjetër Zotit s’i kéri dashtë, / Jalla *ndéjun* (=i **ulur**) ishte kênë çue, Zór ndër krahë trimi paska marrë...(Kënga 25, f. 202)

Gjatë studimit të materialit të Këngëve Kreshnike kemi vënë re se pjesorja del vetëm edhe në ato raste kur duhej të ishte pjesë përbërëse e formave analitike, por meqënëse rrëfimi është në varg dhe për të shmangur monotoninë gjatë ligjëritimit, pjesorja del vetëm duke eliminuar kështu përsëritjen e foljes ndihmëse *kam*, si në shembullin e ilustruar nga CK:

...Edhe ngrykë paj gruen i a ká marrë, / Të dy syt, tha, krajli i a *puthë*⁵¹⁰ / I a ká nisë lodërs e po luen...(Kënga 21, f. 166)

7.1 Format e pashtjelluara mbi bazën e pjesores

Mohorja

Forma e pashtjelluar foljore e tipit *pa + pjesore*, konvencionalisht quhet *mohore*.⁵¹¹ Kjo është një formë foljore që nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane, si për nga tipi i ndërtimit, ashtu edhe për nga krijimi.⁵¹²

Po ilustrojmë shembullin nga CK:

...Jam kah há, çohem *pá ngî*, / Me kênë n’gjumë çohem *pá fjetë*... (Kënga 22, f. 171)

Të dy pjesët përbërëse të kësaj forme të pashtjelluar analitike janë të lidhura aq ngushtë sa që nuk mund të veçohen si dy fjalë më vete, pra pjesëza *pa* e ruan edhe këtu kuptimin mohor.⁵¹³

⁵⁰⁸ F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë...*, vep. e cit., f.177-178.

⁵⁰⁹ *qe* - përdoret në të gjitha rastet si pjesëz.

⁵¹⁰ *puthë* = *ka puthë*

⁵¹¹ F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë...*, vep. e cit., f.194.

⁵¹² Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.967.

⁵¹³ F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë...*, vep. e cit., f.194.

Sipas M.Çelikut togu *pa ardhur* është një trajtë e veçantë e shprehjes së përcjellores së shqipes dhe në këtë mënyrë *duke ardhur* dhe *pa ardhur* janë dy trajta të shprehjes së një forme të vetme të pashtjelluar të foljes.⁵¹⁴ Ai e mbështet këtë tezë, sepse të dy këto forma të pashtjelluara shprehin veprime të pakryera ose veprime që zakonisht nuk kanë filluar fare të kryhen ose më rrallë kanë filluar të kryhen, por janë ndërprerë nuk kanë përfunduar dhe veprimi i foljes drejtuese kryhet para tyre (këtë kuptim ka shpesh trajta *pa ardhur*).⁵¹⁵ Forma e pashtjelluar mohore (në kohën e tashme), është një formë analitike që ndërtohet duke i paravënë pjesores së foljes themelore pjesëzën **pa**, tipi: *pa bâ*. Por, në materialin në shqyrtim, përveç kësaj forme, si formë karakteristike për gegërishten veriperëndimore, ndeshet edhe një formë tjetër e prirë nga pjesëza me origjinë parafjalore **për**, e cila del si për zgjedhimin vepror: *për pá dá, për pá ndie, për pá thye, për pá dale, për pá marrë, për pá mujtë, për pá pré, për pá rrue, për pá shprazë, për pá ardhë, për pá pá, për pá ndëjë*, ashtu edhe për zgjedhimin jovepror, si: *për pá u pré, për pá u ndrrue, për pá u rrue*, por me një përdorim më të rrallë. Nga Këngët Kreshnike po japim disa shembuj me këto trajta të mohores:

Zgjedhimi vepror:

- ...As s’kan lânë drum *për pá thye*, / As s’kan lânë baloz n’mejdan ... (Kënga 3, f. 20)
- ...Paj me e lânë pleqnín *për pá e dá*. / Të dy bashkë kadin po e presin... (Kënga 18, f. 144)
- ...*Për pá mujtë* ti për me e rrë, / S’mundesh Mujin për me e lidhë... (Kënga 21, f. 166)
- ...Adet krajli, qi e ki’ pasë, / *Për pá ndëjë* trí dit e net... (Kënga 14, f. 118)
- ...Qýsh m’u pré kurrkush *për pá m’pá?! / Ká nisë* krajli me turfillue... (Kënga 21, f. 167)
- ... *Për pá t’ndie* Muji, êm vllá, / Qyqja e kuqe për hava ká përkatë... (Kënga 34, f. 238)

Zgjedhimi jovepror:

- Kurr balozit motrën mos m’i a dhânë, / *Për pa u pré* n’at fushën e mejdanit!...(Kënga 5, f. 47)
- ...A jau ká mërztitë mjekra *për pá u rrue*, / A jau kán mërztitë kmishat *për pá u ndrrue*... (Kënga 16, f. 132)

Në CK me trajtën *pá ardhë*, kemi ndeshur këto forma sipas zgjedhimeve:

Zgjedhimi vepror:

Zgjedhimi i parë del me format e mohores, si: *pá dá, pá gzue, pá fejuem, pá kallxue, pá lame, pá martuem, pá mrrijtë, pá ndrrue, pá ndie, pá rrue, pá shkue, pá thye* etj.

Nga CK kemi marrë vargjet:

- ...A kmishat *pá i ndrrue?* / Ç’ká qitë Aija e ká thânë... (Kënga 13, f. 113)
- Të *pá fejuem* të tânë, të *pá martuem*, / Mos t’u dhimben as turkut, as kaurrit..(Kënga 21, f. 161)
- ... – Ik mori shkinë, shkina e *pá lame*, / Se un për Mujin nuk kam dert... (Kënga 29, f. 220)

Zgjedhimi i dytë del me këto forma mohore, si: *pá çartë, pá dalë, pá falë, pá fjetë, pá grabitë, pá lé, pá marrë, pá mujtë, pá ngafisë* (me shtangue), *pá ngí, pá njuhë, pá njoftë, pá pré, pá pshtjellë, pá shmângë, pá shprazë* etj.

Po japim disa shembuj nga CK:

- ...Për gjith ditë ndër mriza tuj pushue, / Rrugë as shtek *pá njoftë* nuk ká lânë... (Kënga 7, f. 63)
- ...Shoqishojt na n’mejdan me i dalë, / Njëni shoqin çajre s’ ásh *pá e çartë* (Kënga 25, f. 197)
- Në këto ndërtime të mohores, verëhet se ndërmjet formës së mohores hyjnë shpesh edhe trajtat e shkurtra të përemrit, si në rastet që kemi veçuar nga CK:
- ...N’muejsh me pshtue *pá t’ngafisë* zânat, / Kurrkahë béve s’kan si u pshtojnë...(Kënga 1, f. 6)

⁵¹⁴ M. Çeliku, *Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1997, f.119.

⁵¹⁵ Po aty, f.119.

... – Pasha ‘i Zot mue qi m’ká dhânë, / Marrja e hallkut po m’lên pá t’pré. (Kënga 21, f. 160)
...Shoqishojt na n’mejdán me i dalë, / Njâni shoqin çajre s’âsht pá e çartë... (Kënga 25, f. 197)
...Për t’gjallë s’dal, mbret, i ká thânë. / – Pá m’a falë sofrën prej dukatit... (Kënga 26, f. 209)

Zgjedhimi i tretë del më rrallë me trajtat, si: pá pí, pá xânë, si në rastin:

...As kan pá çetë me luftue, / Bukë pá ngrânë trimat uj pá pí... (Kënga 25, f. 200)

Zgjedhimi i parregullt del me format, si: pá ardhë, pá dhânë, pá lânë, pá ngrânë, pá pá, pá pasë, pá rá, si në shembujt:

...Ket hall Mujit me i kjá, / Zór se e lën Muji mbrapa pá t’ rá... (Kënga 19, f. 147)

...Prej hapsanje kurr s’ kam dalë, / – Pá m’ i dhânë tri mushka me pare... (Kënga 26, f. 209)

...E i kan mbushë dhetë dit e net, / E pá pasë kurnjâni gjumë në sy... (Kënga 25, f. 200)

Zgjedhimi jovepror te format e mohores ndërtohet duke ndërkalur pjesëzën **u** ndërmjet pjesëzës **pa** dhe pjesores së foljes. Ndeshen këto forma të **zgjedhimit të parë**, si: pá u martue, pá u ndrrue, pá u vonue dhe të **zgjedhimit të dytë**, si: pá u pré, pá u vrá. Forma të tjera nuk na vërtetohen.

Nga CK po veçojmë vargjet:

...S’m’a ká mërzitë veshá pá u ndrrue, / Por kam pasë lânë nânën baxhí... (Kënga 13, f. 113)

... – Pse rrin, ti Hyso, pá u martue, / Edhe un bé u bâna tridhetë kapidanave... (Kënga 12, f. 105)

...‘I pikël gjak për me i a lshue, / Dekun n’tokë bjen pá u vonue... (Kënga 15, f. 129)

...Edhe krushqvet u ká thânë: / Pá u vrá Zoti burra mos u lashtë!... (Kënga 9, f. 78)

Format e mbipërbëra, tipi, pa pasë larë, nuk vërtetohen në asnjë rast në CK

Kuptimet dhe përdorimet e mohores

Forma e pashtjelluar mohore përdoret për të shprehur një veprim ose gjendje, që është kryer në të shkuarën, ose që pritet të kryhet në të ardhmen, para ose pas veprimit të shprehur nga folja e fjalisë, prej së cilës ajo varet.⁵¹⁶ Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike vërehet se format e pashtjelluara mohore dalin me funksione të ndryshme në fjali, përkatësisht:

- me funksionin e rrethanorit të *kohës*:

Djalë dhjetë vjeç m’u rritë s’ká lânë, / Çikë shtatë vjeç pá grabitë s’ka lânë... (Kënga 11, f. 91)

- me funksionin e rrethanorit të *mënyrës*:

...Se dekë mâ e âmël, s’âsht se n’luftë m’u pré. / N’luftë me u pré pá i lânë marre vedit... (Kënga 29, f. 218)

- me funksionin e rrethanorit të *kushtit*:

...Besën e Zotit ai mue m’a ká dhânë, / N’kjosha gjallë pa t’gzue s’due me t’ lânë... (Kënga 10, f. 87)

...Se me kënë puna për mejdan, / Nuk e lâ Çikën pá e xânë... (Kënga 24, f. 191)

...Për pá ardhë Muja bilimbash, / Kurrkúj derën nuk i a çili... (Kënga 15, f. 124)

Kjo formë e pashtjelluar përdoret edhe për të shprehur mungesën e një veprimi dytësor, i cili kuptimisht paraqitet i bashkërenditur me atë të foljes drejtuese⁵¹⁷, si në rastin:

...I a ka falë paret pá njuhë (=por nuk i njehi), / Për shpirt t’birit po i a nep... (Kënga 13, f. 115)

⁵¹⁶ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*..., vep. e cit., (1986), f.967.

⁵¹⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Jepet shembulli: *Nxënësi e zgjidhi problemin pa arsyetuar* (=por nuk e arsyetoi) vep. e cit., f.336.

Përcjellorja

Formimi i kësaj mënyre foljore, historikisht lidhet me faktin se pjesa e dytë e saj ka qenë "...një emër prepjesor i paparanyjzuar, kurse elementi i parë *tue / duke* në zanafillë ka qenë një parafjalë".⁵¹⁸

Përcjellorja në CK, ashtu si në shqipen standarde, del me një formë gramatikore analitike, që ndërtohet duke pararendosur pjesores së foljes pjesëzën **tue/tuj/tu** (*tue dhânë*). Për dialektin e Veriut, duke u mbështetur në përhapjen e këtyre formave, si edhe në ligjet e zhvillimit fonetik të shqipes, forma më e hershme prej së cilës mund të shpjegohen format e tjera, është *tue*.⁵¹⁹ Kjo është forma e vetme me të cilën e kemi ndeshur trajtën e pashtjelluar të përcjellores dhe këtë formë konvencionalisht do ta quajmë e tashme e përcjellores (megjithëse kuptimi i saj kohor është i kushtëzuar).⁵²⁰ Në CK, nuk kemi ndeshur forma të mbipërbëra të përcjellores (koha e kryer e përcjellores)., Pjesëza *tue* e formës analitike të përcjellores shërben si shenjë markuese, në një kohë që forma mund të marrë formante të ndryshme⁵²¹, si në rastet:

...Ká gjetë gjogun *tu'lotue / Me kâmbë t'para tu' çukurmue...* (Kënga 6, f. 53)

...Tuj tërfrue gjogat *tue u hjedhë, / Shtatë sahat m' rrah tue u sjellë...* (Kënga 15, f. 128)

...–Kurrnja nesh veç mos me dekë në t'shtrueme / – Por me shpata *tuj pré* me këndue...(Kënga 4, f. 40)

Nga materiali i vjelë vërtetohen këto forma foljore të së tashmes së përcjellores në veprorë dhe joveprorë:

Zgjedhimi vepror:

Zgjedhimi i parë del me një denduri përdorimi me format foljore, si: *tue/tuj bá, tue/tuj çetue, tue/tuj çue, tu' çukurmue*⁵²², *tue fluturue, tu' freskue, tuj gjâmue, tuj gjue, tue hî, tuj hingllue, tue/tuj kajtë, tue/tuj këndue, tue kërkue, tue kthye, tue kundrue, tuj kuvendue, tue lá, tuj ladrue, tue lotue, tue/tuj luftue, tue/tuj lshue, tu' mbajtë, tuj msue, tue mrizue, tuj ndî, tue prarue, tuj punue, tu' pushue, tue/tuj ruejtë, tue/tuj rmue, tue shburruue, tuj shî, tuj shikjue, tuj shkruue, tue/tuj shkue, tue shtegtue, tue tërflue, tue tërfrue, tue vajtue, tuj varrue, tuj zgjatue* etj.

Po ilustruam disa vargje të shkëputura nga CK:

...Bytyn lavër livadin e bânë, / Me çizme trimat *tuj rmue...* (Kënga 12, f. 103)

...Por gjithë moti malit i shkon, / Po i shkon moti malit *tue luftue...* (Kënga 20, f. 154)

...Jam i largtë e *tue shtegtue*, / Babë e migjë për me kërkue... (Kënga 26, f. 207)

Zgjedhimi i dytë vërtetohet me disa forma, si: *tue bërtitë, tue dalë, tuj errë, tue hjedhë, tuj hukatë, tuj kuvendë, tu'/tue lidhë, tuj lypë, tuj marrë, tue ndritë, tuj përkundë, tuj piskatë, tue pjekë, tuj pjellë, tuj plakë, tuj pré, tue/tuj pritë, tue qeshë, tue sjellë, tuj shetitë, tue/tuj rrehë, tuj tjerrë, tu' veshë, tue vjedhë, tuj xjerrun* etj.

Nga CK po japim vargjet:

...Po zo'! shka jeni me gjithë ketë dritë? / – Zâna jemi, Mujo, *tuj shetitë* ... (Kënga 7, f. 64)

...Kângatarët s'po pushojnë një herë, / Pushkë *tuj qitë*, dajre tuj bâ... (Kënga 10, f. 87)

...Briti vasha mbrenda prej trishtimit, / Kâmbën n' bark e shpatën *tuj e xjerrun*.(Kënga 23, f. 183)

⁵¹⁸ Sh. Demiraj, *Morfologjia historike...*, vep. e cit., f.196.

⁵¹⁹ Më gjerësisht shih: K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.490 - 491.

⁵²⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, vep. e cit., f.337.

⁵²¹ K.Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.483.

⁵²² At B. Palaj, At D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, japin shpjegimin, "me gërrye me kâmbë", vep. e cit., f.53; K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, foljen *çukurmoj*, e jep me kuptimin "i bie tokës me thundër, godas tokën", vep. e cit., f.349.

Për **zgjedhimin e tretë** kemi ndeshur vetëm trajtën, *tuj pi*, si në rastin:

...*Tuj pi* uj, çohem pá pí, / Me kênë n’gjumë, çohem pá fjetë... (Kënga 22, f. 171)

Zgjedhimi i parregullt na del me trajtat, si: *tue/tuj ardhë, tuj dhânë, tue lânë, tue ngrânë, tue pá, tue rá/tuj rá* etj., si në rastet:

...*Â turpnue* çika e nuk po flet. / Po m’a shofin një djalë *tue ardhë*... (Kënga 24, f. 187)

...*Bukë tue ngrânë* motrën e ká gjetë, / Nuk po i ep bukë me ngrânë... (Kënga 27, f. 212)

Në **zgjedhimin jovepror** përcjellorja merr pjesëzën me origjinë përemërore **u**, e cila vihet ndërmjet pjesëzës parafjalore *tu’ / tue / tuj* dhe pjesores së foljes që tregon veprimin.

Sipas vjeleve të materialit na dalin këto forma për **zgjedhimin e parë**, si: *tu’ u varrue, tu’ u zgjatue, tue u lshue, tue u hî* dhe për **zgjedhimin e dytë**, trajtat, si: *tuj u lutë, tuj u plakë, tuj u sjellë, tuj u u tutë*.

Nga CK po ilustruam me vargje:

...Përbí krye hâna tuj i shikjue, / Për mbas shkamit hija *tu’ u zgjatue*... (Kënga 7, f. 65)

... – *Tuj u sjellë* na njerzvet me u ndihmue, / Ti ç’farë ndere, Mujo, po na lypë. (Kënga 7, f. 64)

Kuptimet dhe përdorimet e përcjellores

Folja në këtë formë të pashtjelluar foljore *shpreh një veprim, që shoqëron veprimin e foljes drejtuese, me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë*.⁵²³ Pra, kuptimi i saj kohor është i kushtëzuar nga kuptimi kohor i foljes drejtuese. Zanafilla e kësaj foljeje humbet në thellësi të shekujve.⁵²⁴ Përcjellorja shpreh një veprim që shoqëron veprimin e foljes kryesore, veprimet zakonisht kryhen njëkohësisht. Sipas kohës në të cilën është folja kryesore, përcjellorja në CK në disa raste ka kuptimin e së tashmes ose të së shkuarës.⁵²⁵

Nga CK po marrim vargjet:

...Krahit t’vet thikë m’i ká rá, / Shkon gjithë rrugën n’gjak *tue e lá*... (=e tashme)(Kënga 27, f. 213)

...N’mjedis t’fushës kâkan dalë; / E t’m’ janë nisun fushës *tu’ këndue*. (=shkuar) (Kënga 6, f. 51)

Gjatë studimit të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur trajta të përcjellorjes që përdoren në ndërtime me funksione të ndryshme në fjali:

- me funksion mënyror:

...Tuj të bâ datat hysmet, / *Tue t’i pjekë kafet me sheqer*... (Kënga 20, f. 154)

- me funksion shkakor:

...*A jë mërzitë hysmet tue m’bâ?* / A jë mërzitë për burrin me e marrë... (Kënga 14, f. 120)

- me kushtëzim kohor

...*Natë tuj errë, dielli tuj rá*, / Bët në Zotin çika qi ká bâ... (Kënga 10, f. 83)

...*Se shkoi nata çika kishte fjetë*, / Edhe djali *tuj* na e ruejtë... (Kënga 10, f. 85)

- me funksion kushtor

...*E për n’kjoftë kund ksajt tuj ndi*, / Kurr mâ ngusht vedin s’e dí!... (Kënga 4, f. 40)

...*Për në kjoftë Zotit tuj u lutë*, / Zoti t’mbarën Halilit i a dhashtë!... (Kënga 21, f. 168)

Gjatë studimit të materialit kemi vjelë edhe disa përdorime të formave të përcjellores që paraprihen nga një ndajfolje kohe ose lokucion ndajfoljor.

Për ilustrim po japim shembujt nga CK:

...**Për gjith ditë** bjeshkët Muja *tu’ i kërkue*; / **Për gjith ditë** ndër gurra *tu’ u freskue*, / **Për gjith ditë** ndër mriza *tuj pushue*... (Kënga 7, f. 63)

⁵²³ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.336.

⁵²⁴ A. Haxhi, Proza e Fishtës..., vep. e cit., f.212.

⁵²⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f.337.

...M'duket vehtja **ka'i herë tue çetue**, / M'duket vehtja **ka'i herë tue mrizue**...(Kënga 23, f. 180)

...Se dy binakët djali m'i ká xânë, / **Natë e ditë** n'burg tue m'i lânë... (Kënga 26, f. 209)

Një vend të veçantë zë përdorimi i trajtave të përcjellores në vend të një trajte foljore të dëftores, ku veprimi shprehet në mënyrë më të spikatur dhe më shprehës. "Disa prej këtyre përdorimeve mund të shpjegohen edhe si të prejardhura prej trajtave analitike *jam + përcjellore* me elipsë të foljes *jam*"⁵²⁶, si, p.sh.:

...Gjithë me rend varrët tue i a lidhë, / Gjithë me rend me gojë tuj hukatë... (Kënga 32, f. 232)

...Gjith sá mundet nusja tuj shkue, / Gjith sá mundet letra tuj shkruie (Kënga 14, f.121)

...Muji vorrin tue e rrmue, / Veç se zanat tue lotue... (Kënga 30, f. 224)

Përcjellorja në CK na del edhe me një trajtë të veçantë, *ka rrqet*, e cila ka funksion të njëjtë në fjali si dhe trajtat e tjera që kemi trajtuar në këtë çështje. Shembulli i vjelë e vërteton këtë gjë:

...Në fyt kafen i a shef *ka i rrqet (tu rrqet)*. / Sá fort djali si ásht ngushtue... (Kënga 10, f. 84)

Në raste të izoluara vërehet përdorimi i ndërtimeve përcjellore të bashkërenditura, që tregojnë veprime apo gjendje të lidhura nga koha apo mënyra, procese që zhvillohen me të njëjtin ritëm⁵²⁷, si në rastin e vjelë nga Këngët Kreshnike:

... – *Tuj u plakë* – tha – Mujo, e *tuj u tutë* – / Se gjogy i yt kurrjâ nuk din... (Kënga 33, f. 231)

7.2 Paskajorja me përdorimet e saj

Folja në formën gramatikore të paskajores shërben për të emërtuar një veprim ose gjendje si proces, por pa iu referuar një kryefjale të caktuar.⁵²⁸ Studiuesi N.Veselaj i ka kushtuar një trajtim të veçantë paskajores dhe veçorive specifike të saj, ku gjatë trajtimit thekson: "Paskajoren *me + pjesore* e ndeshim domosdo si trajtë përfaqësuese, sepse me anë të saj formohen mënyra dhe kohë të tjera të foljeve".⁵²⁹ Format e pashtjelluara të tipit *me ba* dhe *për të bërë* janë parë si sinonime me mënyrën lidhore, të shoqëruara ose jo me lidhëza nënrenditëse, në shumicën e funksioneve të saj⁵³⁰, siç e vërteton edhe rasti që kemi veçuar nga CK:

...Bash me e dijt se kryet m'shkurtohet! / At-herë Muji e paska msue...(=**të di**) (Kënga 1, f. 5)

M.Camaj në *Gramatikën* e tij kur përshkruan variantet e paskajores, ai rendit trajtat, si: privativin - e ashtuquajtura mohore (*pa sjellë*), formën *me të* ose *me një të* + pjesore (*me të sjellë*), formën *për të* + pjesore (*për të sjellë*). Ai gjithashtu jep edhe infinitivin gegë *me + pjesore* në të tashmen (*me sjellë*) si dhe *me + pjesoren* e foljes ndihmëse *pasë* në të kryerën (*me pasë sjellë*).⁵³¹

Në materialin që kemi vjelë nga përmbledhja "Visaret e Kombit" II, ashtu si edhe në të folme të gegërishtes, përveç formave të zakonshme me vlerë paskajoreje (*me ndie*), vërtetohen edhe koha e përbërë e saj, që, në krahasim me formën përfaqësuese, kovencionalisht e quajmë **kohë e kryer** (*me pasë ndie*).⁵³²

Nga CK po veçojmë shembujt:

...Ti *me kânë* e mirë qýsh thonë, / Mirë m'veshesh e mirë m'mbathesh... (Kënga 17, f.136)

...*Me e pas pá* Behurin gjallë, / Shpirti tutësh u kishtë dalë... (Kënga 6, f. 62)

⁵²⁶ M. Domi, *Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë*, pun. i cit., f. 94.

⁵²⁷ Po aty, f. 95.

⁵²⁸ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1971, f.220.

⁵²⁹ N. Veselaj, *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, vep. e cit., f.105-106.

⁵³⁰ Sh. Demiraj, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*, SF Nr. 1, 1969, f.89-90; *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe*, SF Nr. 1, 1971, f.73.

⁵³¹ M. Camaj, *Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries*, vep. e cit., f. 227-228.

⁵³² A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit., f.197.

Në CK kemi ndeshur forma për të ashtuquajturën kohë e tashme me vlerë paskajoreje sipas materialit të skeduar më poshtë:

Zgjedhmi vepror:

1. Forma gramatikore analitike **me bâ**, që interpretohet si e përbërë nga pjesëza formant **me**, i cili në zanafillë duhet të ketë qenë parafjalë, por prej kohësh është shndërruar në formant me vlerë thjesht gramatikore⁵³³, dhe nga pjesorja e foljes (një interpretim të tillë bëjnë të gjitha gramatikat përshkruese të gjuhës shqipe)⁵³⁴.

Po ilustrojmë shembullin nga CK:

...Maná darsmat s'm'u kan dhimët *me* i *bâmun!* / Jú t'pá- vllazën, shokë, s'kini qillue... (Kënga 4, f.26)

2. Forma analitike gramatikore **për me bâ**, e ndërtuar nga paravendosja e parafjalës **për** formës së paskajores gege të tipit **me bâ**. Togu *për me ardhë*, që takohet në gegërishte, nuk duhet parë as si formë, as si trajtë tjetër e paskajores, përfutur me kontaminimin nga forma *me ardhë* e togut *për të ardhë*, por si paskajore e paraprirë nga pjesëza *për* që fillimisht është përdorur si parafjalë e paskajores.⁵³⁵ Kjo formë është karakteristike për gegërishten veriperëndimore.⁵³⁶

Për konkretizim po ilustrojmë shembullin:

...A çue n'kâmbë *për me kundrue*, / Tym e mjegull veç ká pá... (Kënga 26, f. 205)

Po i shohim me radhë format e paskajores.

1.

Formën gramatikore analitike e tipit **me bâ** paraqitet si formë e ngulitur mirë në gegërishte me të gjitha tiparet morfologjike e, në pjesën më të madhe të rasteve, edhe me funksionet sintaksore karakteristike të paskajores, që ndeshen edhe në paskajoret e gjuhëve të tjera indoevropiane.⁵³⁷

Për të folmet e gegërishtes është tipike paskajorja e formuar me pjesëzën përemërore **me** dhe nga pjesorja e foljes **punue**. Në gegërishten veriore dhe në shumë të folme të gegërishtes qendrore, kjo paskajore është forma dominuese, ajo ka një përdorim të madh edhe në të folmet e Shqipërisë së Mesme, kurse në anët e Elbasanit dhe në të folmet kalimtare është pak e përdorshme.⁵³⁸

Nga materiali në studim forma gramatikore **me bâ** ka një denduri të madhe përdorimi. Ky ndërtim është forma dominuese e paskajores në CK. Siç e kemi trajtuar edhe gjatë analizës, forma *me bâ*, përveç përdorimit të saj si paskajore e mirëfilltë, na del shpesh edhe si pjesë përbërëse e formave analitike të së ardhmes dhe të së ardhmes të së shkuarës.

Në Këngët Kreshnike vertetohen këto forma:

Zgjedhimi i parë del me një përdorim të dendur me forma, si: *me afrue, me ague, me bâ, me bajtë, me bashkue, me besue, me bré, me bûjtë*⁵³⁹, *me çetue, me çue, me dá, me diftue, me drashtë, me fillue, me flurue, me fitue, me gatue, me gzue, me gjátue, me gjetë, m' gjê, me gjimue, me gjue, me gjuejtë, me harrue, me hetue, me hî, me kalue, me kallxue, me kërkue, me kjà, me kndue, me kujtue, me kundrue, me kthye, me lá, me lakmue, me ladrue / me lodrue, me lirue, me lshue, me lye, me luejtë, me luftue, me mashtrue, me mbajtë, me mblue, me mendue, me mjerue, me mrî / me mrrî, me msue, me msye, me mundue, me ndie / me ndigjue, me ndimue,*

⁵³³ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f. 963.

⁵³⁴ A. Haxhi, *Proza e Fishtës...*, vep. e cit..., f.197.

⁵³⁵ M. Çeliku, *Problemi i paskajores në shqipen standarde*, "Çështje të shqipes standarde", Tiranë, 2009, f.111.

⁵³⁶ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, DSH, I, Tiranë, 1971, f. 301; J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, , DSH, I, Tiranë, 1971, f.543.

⁵³⁷ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike...*, vep. e cit., (1986), f.959.

⁵³⁸ E. Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, Nr.3, 1964, f.240.

⁵³⁹ Shih: K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., foljen **buj / bûj**, e jep me kuptimin "kaloj natën"; fjalë e mbarë gjuhës që e kanë edhe arbëreshët e Italisë e Greqisë, f.262.

me ndrrue, me ndry, me pajtue, me peshue, me pikue, me pranue⁵⁴⁰, me prarue⁵⁴¹, me prí, me pritue, me provue, me pshtue, me pûnue, me pushue, me qeftue (kënaqem), me qindrue, me rrê, me rrotullue, me rrxue, me sue, me sharrue, me shdry, me shikjue, me shilue / me sh'lue, me shkarkue, me shkue, me shkurtue, me shkye, me shpejtue, me shpengue, me shtî, me shtue, me tërnue, me teprue, me turflue, me ushtue, me vajtue, me velzue, me vndue, me veshtrue, me zaptue etj.

Po ilustrujmë me vargje disa nga këto forma:*

...Hallet tona Mujit *me* i a *kjá*: /"A don gjakun, Mujë, né me na e marrë?"..(Kënga 2, f. 12)

...Tu mos t'gjindet gjâ *me gjatue*, / Tu mos t'gjindet çetë *me çetue*... (Kënga 25, f. 199)

...N' Lugje t' Verdha nuk t'ká mbetë, / Por ká shkue *me bújtë* tu dajat ... (Kënga 29, f. 224)

Zgjedhimi i dytë, ashtu si zgjedhimi i parë del me denduri formash të paskajores, si: *me avitë, me bëritë, me britë, me çartë, me çilë, me dalë / me dalun, me dejë, me dredhë, me djegë / me djegun, me djergun, me djerrë, me dridhë, me falë, me fikun, me fjetë, me folë, me gjegjë, me gjesdenisë, me grabitë, me hjedhë, me hjekë, me hipë / me hypë, me hike / me ikë, me humbë, me kapë, me kashagitë, me koritë, me kputë, me kqyrë / me kqyrun, me kullotë, me kthye, me kuvendë, me lbardhë, me lypë, me marrë / me marrun, me mate, me mbathë / me mbathun, me mbetë, me mbledhë, me mbytë, me ndalë, me ndeshë, me ngiatë, me ngrafisun⁵⁴², me ngrehë, me mujtë, m' nême⁵⁴³, me ngî, me njitë / me ngjitë, me ngrehë, me njoftë, me pré, me përcjellë, me pëvetë / me pvetë, me plasë / me plasun, me pré / me premun, me prekë, me pritë, me pshtue, me puthë, me qelbë, me qeshë, me qitë, me rredhë, me rritë, me rrokë, me rrshitë, me shetitë, me shitë, me shkepë, me shkrepë, me shprazë, me tretë, me thirrë, me ulë, me veshë, me vrá, me xé, me xjerrë, me zbardhë, me zdashë, me zgjedhë, me zgidhë, me zdrypë etj.*

Nga CK po japim shembujt:*

...Bjeshkve Mujin kund *me* e *ndeshë*, / N'mejdan t'natës kryet *me* i a *pré* ... (Kënga 2, f. 11)

...Falë me shndet ty Gjergji të ká çue: / *Me* m'a *mbathun* gjogun mirë e mirë!..(Kënga 5, f. 45)

...Se sall prej gjogut 'i herë *me zdrypë*, / Kurr mâ n'tê s'mundem me hypë... (Kënga 17, f. 137)

...Për pá m'rrue, *me* m' *gjesdenisë*⁵⁴⁴, / Shpejt e shpejt berberët i ká prû... (Kënga 26, f. 209)

Zgjedhimi i tretë del me paskajoret, si: *me dijt / me dijtë, me pí, me vû, me xânë / me zânë* etj.

Po ilustrujmë disa shembuj:

...E bija e krajlit qefil m'âsht bâ, / *Me* e *dijtë* se mâ n'Jtubinë kam me ardhë..(Kënga 13, f. 116)

...Mujin me bâ vetë qi *me* e *xânë*, / Kurrkund kutrudhë, nuk mundet Muji me m'dalë!...(Kënga 2, f.12)

...N'do po m'çon, Mujo, uj *me pí*, / N'do po e theri gjogun thikë në brî... (Kënga 25, f. 200)

Foljet e parregulltavërehen me këto paksajore, si: *me ardhë / me ardhun, me dashtë, me deké / me vdekë, me dhânë, me hângër / me harë (me hangër) / me ngrânë, me lânë, me ndêjë, me kânë / me kênë, me rá, me pá, me pasë, me prû, me thânë / me thue, me vojtë* etj.

Nga CK po marrim disa vargje për ilustrim:*

...Kém qitë shkjaout edhe i kém thânë: / "Gúr të gjallë na ktu *me dashtë* po t' bájme... (Kënga 2, f. 13)

⁵⁴⁰At B.Palaj, At D.Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., mbledhësit e CK japin shpjegimin "me prendue", f.27.

⁵⁴¹Po aty, *me prarue* për – **prendue**; Dugagjin, Shalë, Shosh, Nikaj, Mertúr, f.59.

* *Shembuj të vjelë nga CK*:...N'maje të bjeshkës kënka dalë, / Tridhetë agët aty m' i *gjë* / Me Halilin çikat e Behurit... (Kënga 6, f.61); ...Ato petka *me* i *ternue*, / Gjogun t'Mujit *me* e *shilue*... (Kënga 9, f.78)

⁵⁴²B. Palaj, D. Kurti, *Visaret e Kombit II*, vep. e cit., "me shtangue ndokend, tuj e hukatë : me ngrî", f.6.

⁵⁴³Po ata, po aty, "nâm, i dëshiroj tjetrit një të keqe duke e shprehur me zë të lartë e me zemërim; e mallkoj", f.171.

**Shembuj të vjelë nga CK*:...Kurrnji pikë *me rredhë* teposhtë s'p'e lânë, / Kan marrë rrugën, qi çon bjeshkve të mdhá... (Kënga 6, f.51);...Me dhetë konopë, nânë, *me* m'*lidhë* / Dhetë konopë si baba i kputi... (Kënga 11, f.91)

⁵⁴⁴me stolisë, me ndreqë, sqarim i dhënë në përmbledhjen "*Visaret e Kombit II*", vep. e cit..., f.109.

...Se me thue kúr po i bjen, / Dekun n'tokë gjinden po i qet... (Kënga 7, f. 6)
...Ti me kânë e mirë qýsh thonë, / Mirë m'veshesh e mirë m'mbathesh... (Kënga 17, f. 136)
...Ndoshta e kam exhelin me dekë, / E pá zanát Omeri po m'jet... (Kënga 29, f. 219)
...Do t'u nap me harë, me pi / "Për gjahë neser duem me hí... (Kënga 1, f. 7)

2.

Forma me vlerë paskajoreje e tipit **për me shkue**, karakteristike për gegërishten⁵⁴⁵ përdoret kryesisht për të dalluar më mirë ndonjë funksion sintaksor të paskajores.⁵⁴⁶ Kjo formë foljore ka ardhur nga kontaminimi i paskajores *për të punue* me paskajoren *me punue*.⁵⁴⁷

Ilustrojmë shembullin nga CK:

...Jam dá motret, jam dá vllaut, / *Për me marrë* një burrë kreshnik... (Kënga 1, f. 5)

Kjo formë, që nuk takohet në letërsinë e vjetër shqipe⁵⁴⁸, është krijim i mëvonshëm e përdoret kryesisht me funksion qëllimor. Në CK, në krahasim me formën e paskajores **me bâ**, e cila del shumë shpesh, forma **për me shkue** del më rrallë.

Kemi ndeshur forma për të gjitha zgjedhimet si dhe format e parregullta.

Këto forma i kemi skeduar si në vijim:

Zgjedhimi parë del me disa forma, si: *për me bâ*, *për me çetue*, *për me çue*, *për me dá*, *për me grî*, *për me gjetë*, *për me gjue*, *për me hî*, *për me kallxue*, *për me kërkue*, *për me kthye*, *për me kundrue*, *për me largue*, *për me lodrue*, *për me mblue*, *për me ndalue*, *për me ndie*, *për me ndimue*, *për me pranue*, *për me rrê*, *për me pshtue*, *për me pushue*, *për me shkruue*, *për me shkue*, *për me shtërgue*, *për me shtrue* etj.

Po ilustrojmë me vargje:

..."A t'u dhimben darsmat *për me i bâ?*" / Tut'na djalin dikush po na rrê... (Kënga 4, f. 26)

M'ké lypë beret para se çobanin; / E jam dredhë n'ket log *për me t'kallxue*... (Kënga 5, f. 46)

...Del ndo'i herë *për me lodrue*, / Bjen ndër gurra për me u freskue... (Kënga 30, f. 226)

Zgjedhimi i dytë del me format, si: *për me çilë*, *për me dalë* / *për me dalun*, *për me fjetë*, *për me folë*, *për me hipë* / *për me hypë*, *për me hjekë*, *për me hikun*, , *për me kapë*, *për me kputë*, *për me kqyrë*, *për me lidhë*, *për me marrë*, *për me mbledhë*, *për me mbytë*, *për me nâmë*, *për me shndoshë*, *për me pré*, *për me pritë*, *për me rrokë*, *për me sjellë*, *për me shetitë*, *për me tjerrë*, *për me tretë*, *për me vjerrë*, *për me vrá* etj.

Nga CK po veçojmë shembujt:

...Me dhetë konopë nâna e ki' lidhë, / Nuk ká mujtë Zuku *për me i kputë*... (Kënga 11, f. 91)

...Por Omerin dojshin për me e rrê, / As jashtë t'dale *për me e vrá*... (Kënga 29, f. 220)

...Mirë ushtria qi po i rue. / Kërkund giasë s'po i shofin *për me hikun*... (Kënga 4, f. 35)

Zgjedhimi i tretë del me përdorime të kufizuara vetëm me dy forma paskajoresh, si: *për me pí*, *për me xânë*. Nga shembujt e vjelë me këto forma, zakonisht trajtat e shkurtra të përemrit vector hyjnë në mes trajtës foljore të paskajores.

Po ilustrojmë shembujt:

...Edhe kâmbët shpejt me m'i lá, / Ujët e kambve *për me e pí*... (Kënga 21, f. 162)

...T'tre janë kthye çikën *për me e xânë*, / Të tre n'udhë janë përpjekë... (Kënga 14, f. 120)

Zgjedhimi i parregullt del me këto trajta, si: *për me ardhë*, *për me dhânë*, *për me lânë*, *për me ndêjë*, *për me ngrânë*, *për me pá*, *për me rá* / *për me râm*, *për me thânë* etj.

Prej zotnís burri kur ásht dá, / Ká dredhë n'shpi – tha – nânën *për me e pá*... (Kënga 7, f. 66)

...Njatje vetun djalin e ká lânë / Harushë e ujk t'shkretin *për me e ngrânë*... (Kënga 11, f. 92)

⁵⁴⁵ S.Mancaku, *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*, SF, Nr. 1, 1982, f.140.

⁵⁴⁶ A.Haxhi, *Proza e Fishtës*..., vep. e cit., f.200.

⁵⁴⁷ E.Lafe, *E folmja e Nikaj-Mërturit*, SF, Nr.3, 1964, f.242.

⁵⁴⁸ S.Mancaku, *Paskajorja e shqipes*..., pun. i cit., f.140.

...Mish tarokut të tânë të hanë, / E tu kullat Mujos për me râm... (Kënga 21, f. 161)

Zgjedhimi jovepror

Forma e paskajores në zgjedhimin jovepror ndërtohet me ndihmën e pjesëzës me origjinë përemërore **u**, që vihet ndërmjt pjesëzës së paskajores dhe pjesores së foljes. Në CK forma në joveprore vërtetohen për të dy ndërtimet: *me u bâ* dhe *për m'u bâ*. Më dendur përdoret forma joveprore e ndërtimit *me u bâ*.

1.

Në CK nga forma e tipit **me bâ** dalin:

Zgjedhimin e parë e ndeshim me format e paskajoreve, si: *me u afrue, me u bâ, me u bashkue, me u çue, me u dá, m'u diftue, me durue, me u dushkue*⁵⁴⁹, *me u fejue, me u fillue, me u freskue, me u gëzue, me u gjue, me u harrue, me u kallxue, me u kujtue, m'u la, me u lakmue, me u lshue, me u martue, m'u mërzitë, m'u miqasue, m'u ndie, me u ndihmue, m'u ngí, me u ngushtue, me u provue, m'u rrênue, me u rrxue, me u sumurue, me u shnjertzue, me u shtërngue, me u shtue, me u varrue, me u vonue, m'u zymtue* etj.

Disa nga këta forma po i shohim me shembuj:

...As s'kan lânë çikë *me u martue*, / As s'kan lânë baloz n'mejdan... (Kënga 3, f. 20)

...Shkoni e bini, mori shoqe, / Si lugat dishka, *m'u shtí*... (Kënga 4, f. 32)

...Rrezikí kishem qillue, / Ç'se kam lé mos *me u gëzue*... (Kënga 10, f. 82)

...Natë as ditë derën s'm'a lshojnë, / As me gjumë s'po m'lânë *m'u ngí*... (Kënga 24, f. 187)

...Ç'ká qitë krajli e ká folë: / Të dy sot m'u *miqasue*... (Kënga 26, f. 209)

Zgjedhimi i dytë del me tajtat, si: *me u avitë, me u dukë, m'u dredhë, me u flladitë, me u mahnitë, me u mbledhë, me u mûshë, me u mbytë, me u ndalë, me u nisë, m'u pré, me u varrue*, etj.

Po ilustrujmë nga CK:

...Mirë po i sheh çikat e Behurit: / *Me u flladitë* n'ata ujt e bjeshkës... (Kënga 6, f. 55)

...Mue balozi m'lypë n'mejdan, / M'lypë bejleg me të *me u pré*... (Kënga 10, f. 82)

Në disa raste bie zanorja e pjesëzës parafjalore edhe kur ndodhet formanti *u* i formës joveprore,⁵⁵⁰ si në format: *m'u avitë, m'u djerrë*⁵⁵¹, *m'u kalbë, m'u mbathë, m'u pré, m'u qeftue, m'u rritë, m'u shtirë, m'ulë, m'u veshë, m'u xé* etj. Këto raste janë të shpeshta në përmbledhjen e "Visareve të Kombit", II si në vargjet e shkëputura nga CK:

...As s'kan lânë djalë t'ri *m'u rritë*, / Davë kan bâ Raja e Stambolli ... (Kënga 3, f. 20)

...Kur ká bâ Muji m'u *dredhë*, / Mirë po i flet nâna e motnueme... (Kënga 4, f. 29)

...Por, a di shka, more shokët e mij, / Po provoj sonte *m'u shtirë* ... (Kënga 16, f. 131)

Forma e joveprores për zgjedhimin e tretë nuk na kanë dalë në asnjë rast.

Foljet e parregullta të paskajoreve dalin me përdorime të kufizuara, si: *me u dhânë, me u pá*, si në rastet që kemi vjelë nga CK:

...Kúr ká hî féll n'ashtë të bjeshkës, / Kurrkû drita mos *me u pá*... (Kënga 1, f. 4)

...Kur kan bâ uj gjogave *me u dhânë*, / Kan rá në lumë! ... (Kënga 6, f. 51)

2.

Në CK nga ndërtimi i tipit **për me bâ** në joveprore dalin:

Zgjedhimi i parë del me format, si: *për m'u bâ, për m'u çue, për me u ngujuje, për m'u shtërgue, për me u thye*, si në rastet:

⁵⁴⁹ Shih: K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., kjo folje del me formën foljore dushkon me kuptimin "lëshon gjethet, vishet me fletë", f.421.

⁵⁵⁰ Shih: T. Osmani, "Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor", 3, vep. e cit., f.291.

⁵⁵¹ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit., foljen *djerr*, gjuhëtari e jep të dëshmuar që te Bardhi si folje me kuptimin "humb", f.395.

...As mos hîni n’kullë për me u ngujue, / Hajtni, loke, tu mbreti tu presin!... (Kënga 3, f. 21)
...Aspak nânën Omeri s’e ká ndigjue, / Ká lypë armët për m’u shtërgue... (Kënga 26, f. 205)
Forma e joveprores për zgjedhimin e tretë nuk na kanë dalë në asnjë rast.

Zgjedhimi i dytë vërtetohet me këto forma, si: *për me u falë, për me u kuvëndë, për m’u pre*, si në vargjet:

...Ká ardhë dita për m’u pre, / Ja n’mejdán njitash me m’dalë... (Kënga 9, f. 79)

...Qi nuk çohesh për me u falë, / More i miri i nânës-ooo!... (Kënga 30, f. 225)

Foljet e parregullta dalin vetëm me formën, *për me u pá*, siç vërehet edhe nga shembulli i dhënë:

...Bét në zotin trimi u ká bâ: / – Ju me sý Bani për me u pá... (Kënga 15, f. 125)

Koha e kryer e paskajores në CK vërtetohet vetëm për zgjedhimin vepror dhe ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes themelore e formës së paskajores të foljes ndihmëse *kam*. Ndeshet në pak raste me një përdorim shumë të kufizuar me forma të zgjedhimit të parë, *me pasë ndie*, të zgjedhimit të dytë, *me pa’ lidhë* dhe për format e parregullta, *me pa’ dashtë, me pas’ pá*.

Nga CK po marrim vargjet:

...Pse *me pasë ndie* agët e Jutbinës / Se sá kohë orokun e ké dá... (Kënga 22, f. 173)

...M’ dhetë konopë atë *me e pa’ lidhë*, / Dhetë konopë i ká kputë me ‘i hera. (Kënga 11, f. 91)

Shembujt e tjerë që i takojnë foljeve të parregullta i kemi trajtuar te kuptimet dhe përdorimet e paskajores.

Kuptimet dhe përdorimet e paskajores

Paskajorja është forma që ka vlerë gramatikore shumë abstrakte; ajo shënon veprimin në mënyrë shumë të përgjithshme e të paaktualizuar me tregues gramatikorë, që janë karakteristike për foljen.⁵⁵² Paskajorja e tashme ose paskajorja e thjeshtë shënon një veprim të pacaktuar në kohë. Koha e saj aktualizohet nga konteksti ku bën pjesë: së pari nga koha e foljes prej së cilës varet, së dyti nga ndajfolje të kohës, nga fjalë të ndryshme treguese: përemra vetorë, dëftorë etj., dhe në një farë mase nga intonacioni.⁵⁵³

Kemi ndeshur gjatë studimit të materialit në CK në disa raste të përdorimeve të formave të paskajores, e cila shoqërohet edhe me tregues me kuptim kohor të caktuar (*sande*) ose të papërcaktuar (*at-herë*), siç vërtetohet edhe nga vargjet:

Aman **sande** mbrendë për me m’lânë: / Se ‘i tërmale qi qitka te kjo kullë... (Kënga 11, f. 93)

Kurrnji gjurmë përtej mâ s’e ká bâ! / **At-herë** shkjaú â sjellë *me kqyrun* diellin. (Kënga 6, f. 61)

Shpesh forma e paskajores shoqërohet edhe nga ndajfoljet e kohës që mund të tregojnë një veprim që ndodh aty për aty, si: *fill, tash, njitash, kesh, për’i herë* etj.:

...Motër-zezë n grykas **kesh me e marrun**, / Të dý zëmrat p’r ‘i herë janë ndalun... (Kënga 5, f. 47)

...Shpejto n’kâmbë **tash fill me u çue**, / Kurr mâ ngusht Halili s’ká qillue!... (Kënga 23, f. 184)

Më të pakta janë rastet kur ndajfoljet tregojnë vlerë mbarëkohore, siç e vërteton edhe shembulli nga CK:

...E ‘i murânë të bukur e kan mbarue, / Vllá e motër **kurr** mos *me u harrue*... (Kënga 5, f. 47)

Në raste të tjera paskajorja shoqërohet edhe me lokucione ndajfoljore, si: *trí herë, trí vjet, sot dý javë*, si në shembujt:

...**Trí herë** në ditë *me m’a kashagitë*⁵⁵⁴, / Për **trí vjet** jashtë mos me e qitë.. (Kënga 9, f. 71)

...N’nji odë çikën e ká ngujue, / **Sot dý javë** vadën me jau lânë... (Kënga 22, f. 171)

⁵⁵² S. Mancaku, *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*, pun. i cit., f.144.

⁵⁵³ Po aty, f.157.

⁵⁵⁴ K. Topalli, *Fjalori etimologjik...*, vep. e cit.,...kjo folje del me kuptimin "kreh, pastroj qimet e kalit, të lopës etj.", f.731.

Disa forma të paskajores dalin të pasura edhe me modalitete dhe kuptime kohore. Lidhur me këto përdorime të formave të paskajores në Këngët Kreshnike na vërtetohen shembuj të përdorimit të saj me vlerën e mënyrës dëftore, si në rastin:

...Kur po hyn njeriu n'at kullë, / *Me kujtue* (= **kujtoi**) se ka ndrrue jetë... (Kënga 12, f. 97)

Ashtu si forma e pashtjelluar e tipit *me ba* edhe forma e pashtjelluar e tipit *për të bërë* është sinonime me mënyrën lidhore në disa prej funksioneve të kësaj të fundit.⁵⁵⁵ Me të njëjtat tipare format e paskajores na vërtetohen edhe në CK, si në rastet:

...A s'na e falë njat Ali Agën e rí? / Bashkë me çetë *me dalun* (= **të dalim**) ndër krajli... (Kënga 23, f.178)

...Është ulë djali aty *për me fjetë* (= **të flejë**), / Paj dy djepa aty *ki'n qillue*... (Kënga 7, f. 63)

Në protasat e periudhave hipotetike *koha e kryer* e paskajores ka marrë kuptimin modal të irrealitetit dhe vlerën kohore të më se të kryerës së lidhore për të shprehur veprime të përcaktuara në të shkuarën⁵⁵⁶, si në shembujt e ilustruar:

...*Me e pas'pá* (= **të kisha pasur**) Behurin gjallë, / Shpirti tutësh u kishte dalë! (Kënga 6, f. 62)

...Por rrok burrin qi ké marrë, / *Se me pa'dashtë* (= **të kisha dashur**) djalin me rrokë... (Kënga 11, f. 94)

Me modalitetin e kushtores, format e paskajores janë të shpeshta. Ky kuptim përfordhet edhe nga foljet modale: *mujsha*, *mujsh*, siç vërtetohen edhe nga shembujt në CK:

...*Si në mujsha kudo të gjallë me e gjetë*, / Me tý, nânë kám me dekë;... (Kënga 13, f. 112)

...*Se në mujsh nusen me i a marrë*, / Përgjithmonë zenjin kam me t'ba... (Kënga 13, f. 110)

Në raste të izoluar forma e paskajores del edhe me kuptimin e mënyrës urdhërore, e cila del e vetme, e palidhur me ndonjë folje tjetër:

...? *Me hecë para!* – u ka thënë, / Edhë jashtë me ta ka dalë... (Kënga 2, f. 17)

...T'madhe britka qaj Sokol Halili: / – *Me u çue burra!*... (Kënga 6, f. 53)

...A ndiguiet, agëve po u thotë, / çetë prej çete mos *me u dá*... (Kënga 6, f. 53)

Nuk është qëllimi ynë studimor që të japim funksionet, por për ta bërë më të larmishme trajtimin, po japim disa prej funksioneve të paskajores. Trajtat e paskajores në CK zakonisht përdoren me funksion qëllimor, por në disa raste ato përdoren edhe me funksion shkakor. Me këto përdorime dalin të dyja ndërtimet e paskajores (*me bâ* dhe *për me bâ*).

Po marrim disa vargje nga CK:

- **me funksion qëllimor:**

...N'qerraxhi po due me t'shitë, / *E qymyr me bajtë me ty*... (Kënga 10, f. 83)

...*Për me hi natën n'krajli*, / Tu kulla Rushës me m'i vajtë... (Kënga 18, f. 140)

- **me funksion shkakor:**

...Jam dá motret, jam dá vllaut, / *Për me marrë një burrë kreshnik*... (Kënga 1, f. 5)

Format e paskajores gege përdoren edhe me formën e tyre mohuese, që realizohet me pjesëzën *mos*⁵⁵⁷ (*mos me punue*). Përdorimi i kësaj pjesëze mohore (përkundrajt pjesëzës *nuk* që përdoret me mënyrën dëftore) i afron këto forma me ato që shprehin modalitetin e mundësisë, të supozimit a të irrealitetit, siç është mënyra lidhore, urdhërorja a dëshirorja.⁵⁵⁸

⁵⁵⁵ Gj. Shkurtaj, "E folmja e Rranzave të Mbishkodrës", në DSH IV, Tiranë, 1982, f.73

⁵⁵⁶ K. Topalli, *Sistemi foljor...*, vep. e cit., f.475.

⁵⁵⁷ K. Topalli në librin e tij "*Sistemi foljor i gjuhës shqipe*", sjell disa argumente që vërtetojnë se forma më e hershme ka qenë ajo te autorët e vjetër të Veriut. Në rrethana të tilla, duke mundur se fjala mohuese ka qëndruar para pjesëzës **me**, ndërrimi i pozicionit të saj mund të ketë ndodhur nën ndikimin e formave të shtjelluara që fjalën mohuese e vënë në fillim, siç është mënyra urdhërore e dëshirorja (khs. shkoni ~ me shkue, mos shkoni ~ mos me shkue). Është për t'u shënuar së në dialektin gegë, që ka një paskajore të tillë, një ndërrim i pozicionit të pjesëzave duke nxjerrë fjalën mohuese në fillim vërehet edhe në mënyrën lidhore (khs. mos të vijë turp, mos t'i thuesh kujt), f.476-478.

⁵⁵⁸ Po ai, po aty, f.475.

Nga CK po ilustruamë vargjet:

...– Pásh ‘i Zot, Bani, qi të ká dhânë, / **Mos m’a çart** ket vllán tim sot!... (Kënga 15, f. 126)

...N’kjosht azgan sikur ké thânë, / Hiç prej vendit **mos me luejtë**... (Kënga 15, f. 126)

...**Mos me britë**, as dajre **mos me bâ**, / Pse kam Omerin ktu djalë të rí... (Kënga 29, f. 222)

...**Mos me folë** kush, pushkë kush **mos me qitë**, / Për pá e shprazë un pushkën, pikë e parë...(Kënga 32, f. 240)

Nga shembujt e vjelë, është vënë re se trajtat e shkurtra të përemrit vetor hyjnë ndërmjet trajtës foljore të paskajores, si në rastet e shumta që na vërtetohen:

...Fluturim janë çue në kâmë / Nuse zezën **me e ngrafisun**... (Kënga 1, f. 6)

...Djelt e tyne n’lojë t’ tânë janë dalë, / "A t’u dhimtën paret **për me i dhânë**"...(Kënga 4, f. 26)

...Pá nevojë pse **me na bashkue**. / Muji Halilit atëherë i ká britë... (Kënga 24, f. 189)

...Fluturim si zâna jashtë ká dalë: / – Edhe n’daç ti mbrendë **për me na ardhë**.(Kënga 34, f. 238)

Në raste më të rralla format e paskajores ndjekin njëra-tjetrën në fjali, si në rastin:

...Me gajret ata **me bâ me ardhë**, / "Qi prej lavdit kurkund vend s’na lânë"!...(Kënga 6, f. 55)

Pjesëza *kah* në pak raste i paraprin formës së paskajores, siç e vërteton edhe shembulli nga CK:

...Por tash nâna syt m’i ká verbue, / Nuk po dij i shkreti **kah me t’çue**... (Kënga 11, f. 92)

Si përfundim, na rezulton se format e pashtjelluara foljore në CK janë të pasura me ndërtime dhe me kuptime. Këto forma vërtetohen me trajtat e *pjesores*, format e pashtjelluara mbi bazën e pjesores (*mohorja* dhe *përcjellorja*) dhe *paskajorja*.

Forma e pashtjelluar foljore e *pjesores* del me formante si në shqipen standarde, ashtu edhe me formante tipike për gegërishten. Pjesorja zakonisht del si pjesë e ndërtimeve foljore analitike, por në rastet kur del si gjymtyrë më vete merr edhe disa funksione në fjali.

Mohorja del me dy forma dhe vetëm për të ashtuquajturën kohë e tashme. Këto forma dalin në të dy zgjedhimet. Në disa raste, format e mohores marrin edhe funksione të ndryshme sintaksore.

Trajtat e *përcjellores* vërtetohen vetëm për të ashtuquajturën kohë e tashme. Këto trajta dalin me forma në veprorë dhe joveprorë. Të shpeshta janë rastet, kur këto forma shoqërohen edhe nga ndajfoljet e kohës.

Paskajorja del me dy të ashtuquajtura kohë: të tashmen dhe të kryerën. Format e paskajores për nga denduria janë më të shpeshta në krahasim me format e tjera foljore të pashtjelluara. Këto forma vërehen për zgjedhimin vepror dhe jovepror. Trajtat e paskajores nuk dalin të pasura vetëm me ndërtime, por në vargje ata marrin edhe kuptime modale apo funksione të tjera.

Në mënyrë të përmbledhur po japim tabelën me format e pashtjelluara foljore:

Pjesorja	<i>shnjertzue, mbathë, xânë, fjetun, pritëm</i>
Mohorja	<i>pá gzue, për pá ardhë</i>
Përcjellorja	<i>tuj gjâmue, tue kundrue, tu’ çukurmue</i>
Paskajorja	<i>me bâ, për me bâ, me pas’ pá</i>

KREU VIII. FORMIMI I FOLJEVE

Qëllimi ynë në këtë trajtim nuk ka qenë fjalëformimi, prandaj po e cekim shkurtazi, pa qenë fare shtrues.

Fjalëformimi në gjuhën shqipe paraqitet i gjerë dhe në mjaft raste me modele prodhimtare. Ky sistem përfshin tipet e fjalëformimit sipas prejardhjes (këtu përfshihet parashtesimi, prapashtesimi parashteso-prapashtesimi dhe fjalëformimi pa ndajshtesë, përngjitje, kompozim, konversion dhe tipat e përzierë).⁵⁵⁹ Nga analiza e bërë në studimin e foljeve të vjelura në "Visaret e Kombit" II shohim të përdorura disa prej këtyre modeleve, ku tërheq vëmendje formimi i fjalëve mbi bazën e disa parashtesave dhe prapashtesave prodhimtare në gjuhën shqipe. Nuk presim që t'i kemi të gjitha modelet e fjalëformimit, sepse nuk është një gjuhë e ndërlikuar.

8.1 Folje të parme

Nga analiza e bërë kemi arritur në përfundimin se një pjesë e konsiderueshme e foljeve të përdorura në përmbledhjen janë të **parme**, si: *ap, bāj, brit, çart, çili, çoj, dal, dán, dredh, , dridhi, drue/dron, fal, flet, fry', giet, grrye, gjāj/gjëj/gjë, gjue, ha, hap, hypi/hipi, hjekin, ikë, kapi, kânde, kcen, kërset, kjaj, kthen, lodh, marr, mbaj, mbledh, mbush, muj, ndal, ndie/ndiej, ndrroj, njeh/njef/njof, nis, njet, njom, nxjerr, pëlqen, pëlset, pres/pret, prîn, pves/pëvetin/pvesin, qes, qesh, qit, qorroj, rrah, rrasë, rrê, rri, rrok, rrqet, rue, rruej, rrxoj, shef, shetit, shiloj, shklet, shkoj, shkruet, shkundë, shprazi, shfû/shtjen, shtrin, shtýn, ulet (ul), vesh, vozit, terë, trokatë, then, ther, thrret, vret, zgidhë, xe, etj.*

8.2 Foljet e prejardhura me parashtesim

Foljet e prejardhura formohen me anë të parashtesave dhe prapashtesave, kurse formimet e tjera nuk i kemi ndeshur në materialin e studiuar.

Parashtesa foljore për-

Përsa i përket prejardhjes së parashtesës, për H.Pedersenin e N. Jokli⁵⁶⁰, mendojnë se ajo është autoktone në gjuhën shqipe. Disa dijetarë të tjerë mendojnë se kjo parashtesë parafjalore *për-* vjen prej latinishtes, gjegjësisht prej fjalës së kësaj gjuhe *per*.⁵⁶¹ Kjo parashtesë në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II mund t'u paravijet foljeve të çdo tipi zgjedhimi.

Me të janë formuar:

a) folje nga temat e parme foljore: *përket, përvejellë, përgjegjë, përplasë* etj.

Foljet e prejardhura nga temat emërore janë formuar:

a) *Parashtesa për + tema fjalëformuese (emër) + prapashtesa zero*:⁵⁶² *përdore*.

b) *Parashtesa për + tema fjalëformuese + mbaresa e foljes joveprorë* që kryen në këto raste edhe funksionin e prapashtesës, si: *përgjegjet, përpiqen* etj.

Parashtesa *për-* u jep foljeve shpesh edhe një kuptim intensiv, si: *përpjekë*.

Parashtesa sh-⁵⁶³(ç-).

Parashtesa **sh-** në CK shërben për të ndërtuar folje me kuptim të kundërt me atë të temës fjalëformuese: (*me*) *shdukë (dukë), shpengojnë (pengojnë)*. Por, gjatë studimit të Këngëve Kreshnike kemi ndeshur edhe përdorimim e dy parashtesave të përngjitura që i japin kuptim intensiv foljes, si në rastin, *shndritë: sh + n + dritë*.

⁵⁵⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, I, vep. e cit., f. 342 - 343.

⁵⁶⁰ E. Qabej, A. Xhuvani, *Studime Gjuhësore III*, "Parashtesat - Prapashtesat", Prishtinë, 1976, f. 173.

⁵⁶¹ R. Mulaku, *Parashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrimet e vjetra (shek. XV-XVIII)*, Insituti Albanologjik i Prishtinës, 1998, f. 61.

⁵⁶² E. Hysa, *Formimet me parashtesën për- në gjuhën shqipe*, "Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II", Tiranë, 1975, f. 94.

⁵⁶³ R. Mulaku, *Parashtesat e prapashtesat ...*, vep. e cit., f. 45.

Parashtesa **ç-**. *çpí (me)*, një formim nga parashtesa **ç-** dhe folja *pí*, e cila del me kuptim të kundërt ose antonimik.

Parashtesa z-

Parashtesa **z-** përdoret para bashkëtingëlloreve të zënshe. Në CK trajta **z-** shërben për të krijuar folje me kuptime antonimie, si: *zgidh* (lidh), *zdeshtë* (vesh); folje me kuptim intensiv, si: (me) *zbardhtë* nga mbiemri *i bardhtë*, (me) *zblue* nga folja *bluaj* etj.

Parashtesa zh-⁵⁶⁴. Me këtë parashtesë në material janë të formuara pak folje me kuptim antonimie: (me) *zhdry* (*dry-ni, ndryj*), (me) *zhdukë* (*dukë*).

8.3 Foljet e prejardhura me prapashtesim

Prapashtesat me të cilat janë formuar foljet e prejardhuara në CK, janë:

Prapashtesat: -o-, -(ro), -(so)-, -(zo)-. Katër prapashtesat e fundit janë zgjerime të prapashtesës **-o-**, por në gjendjen e sotme nuk paraqiten si prapashtesa sinonime.⁵⁶⁵ Këto janë njëkohësisht edhe paraprashtesa të foljeve të zgjedhimit të parë.

Prapashtesa -o-⁵⁶⁶ është më prodhimtare në sistemin foljor të shqipës, po ashtu edhe në CK. Me këtë prapashtesë janë formuar një numër i madh foljesh nga:

-tema emërore, si: *duron, diton* (ditë), *çeton/çetojmë* (çetë), *fejon* (fejesë), *fillojmë* (fillim), *flurue (me)* (flutur), *gurrue (me)* (gurrë), *gjamue (me) guxon, gjâmon* (gjëmë-a), *gjâtue (me)*,⁵⁶⁷ *harron, hijeshon* (hijeshi), *hingllon, kalon, kallxon, kndon / këndon, kujtojnë, kulluen* (kulloj), *laton* (latë), *lakmon* (lakmi), *levdon* (lavd), *lmon, loton* (lot), *marton* (martesë), *mbaron, ngarkojnë, notojnë* (not), *ngujojnë* (ngujim), *pajton, pikon* (pikë), *pshtojnë* (shpëtim), *punojmë* (punë), *qillon, (qëllim) qorron, rreshtohen* (rresht) *rrethojnë* (rreth), *rrotullohet* (rrotë), *rrxon/rrxojnë, sundon* (sundim), *sharrojnë* (sharrë), *shgarkon, shikjoj/shikjon* (shikim), *shinon* (shënim), *shkrumbohen* (shkrumb), *shtërngon /shtërnon / shtërngojnë* (shtrëngim), *shurdhon* (shurdh), *tradhtoi* (tradhti), *trupon* (trup), *turbullojnë* (turbull) etj.

-tema mbiemërore, si: *marron* (i marrë), *mjeron* (i mjerë), *shkurtoj* (i shkurtër), *turbullon, verboj* (i verbër) etj.

-tema ndajfoljore, si: *afrohet* (afër), *bashkohen* (bashkë), *tepron* (tepër), *vonon* (vonë).

-tema foljore, si: *ndalon* (ndal), *rrnon* (jeton), *rrënoi* (shkatërroj), *shilon* (folje njëvetore), *thermon* (thërrmoj) etj

Prapashtesa -ro-. Me këtë prapashtesë në CK formohen një numër relativisht i kufizuar foljesh, kryesisht nga tema emërore, si: *flakroj* (flakë), *bum' rojnë*⁵⁶⁸, *kundron / kundrojnë* etj.

Prapashtesa -so-, është shumë e rrallë dhe me të del e formuar vetëm folja *qelbson* nga mbiemri, *i qelbur*.

Parashtesa **-zo-**, është përdorur vetëm në formimin e foljes *vallon/vallzojnë* nga emri, *valle*.

Prapashtesat: -s/- is, -atis me të cilat janë formuar pak folje të zgjedhimit të dytë, dalin me këtë pamje:

Parashtesa **-s/- is**, del me dy alomorfe. Alomorfi **-s** u shtohet temave emërore, që mbarojnë

⁵⁶⁴ A. Xhuvani, E. Qabej, *Parashtesat e prapashtesat ...*, vep. e cit., f. 53.

⁵⁶⁵ Po aty, f. 344.

⁵⁶⁶ Meqënëse disa folje nuk i kemi ndeshur në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores, po i japim në vetat e tjera ose edhe në mënyrat e tjera, ashtu siç i kemi ndeshur shembujt që kanë prapashtesën *-o*.

⁵⁶⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., kjo formë foljore del si prejmemëror nga *gjâ-ja* me prap. foljore *-o/j*. Me këtë kuptim "baj gjâ; bëhem i pasur". Nuk ndeshet në asnjë fjalor të gjuhës shqipe, f. 106.

⁵⁶⁸ Po aty, kjo formë foljore interpretohet si një formim nga onomatopeja *bum*, me prapashtesën e aglutinuar *-ro/j*, f. 103.

**Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)**

me **-i** të theksuar, kurse me alomorfin **-is** janë formuar një numër i kufizuar foljesh prej emrash që nuk dalin me **-i** të theksuar⁵⁶⁹, si në rastet: *batisë*⁵⁷⁰, *korisim*, nga emrat: *batisje*, *helm*, *korí*. Prapashtesa **-atis** është një zgjerim i prapashtesës **-at**, me të cilën kemi ndeshur vetëm foljen *helmatisë*, i formuar nga emri, *helm*.

Tipet e tjera të fjalëformimit nuk na vërtetohen me asnjë rast.

Në këtë syth u ndalëm shkurt në tipet e fjalëformimit të formave foljore. Zakonisht foljet janë ose të parme ose të prejardhura. Te foljet e prejardhura vërehet formimi parashtesor dhe prapashtesor.

⁵⁶⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, I ..., vep. e cit., f. 347-348.

⁵⁷⁰ D. Luka, *Studime gjuhësore XVIII...*, vep. e cit., forma **batisë(me)**, / batis "Dëmtoj rëndë, prish..." (Fjalor, 1980, f.117). Ndër kuptimet që jep **Fjalori** i 1980-ës, veçojmë "E rrëzoj përtokë, e përmbys; e pllakos sipër, e vë poshtë" etj. Folja *batis* nuk është huazim nga turq. *batmak*, perfekti *batti*, por formim përbrenda shqipes, një zgjerim i rrënjës *bat* me prap. *-is*.

KREU IX : PËRFUNDIME

Foljet me kuptim të zbehtë leksikor dalin të pasura në forma dhe kuptime. Si folje të tilla në CK vërehen: *foljet modale*, foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit, *foljet njëvetore* dhe *foljet pavetore*.

Foljet modale dalin me disa ndërtime, si:

1. Folja modale **mund**, e cila del me forma kohore të kohëve të thjeshta dhe të përbëra të mënyrës dëftore e shoqëruar në ndërtime foljore me forma të mënyrës dëftore, lidhore apo edhe me paskajoren gege "me bâ" (*mund+merr, mund + t'dalë, mujsh + me xjerrë, mujt + m'u ndeshë, kém mujtë me gjetë, kishim mujtë m'e shtë* etj.).

Folja modale *mund* del në të dy format, por përdorim më të shpeshtë ka forma veprare. Nga shembujt e vjelë kemi konstatuar përdorim më të shpejtë të numrit njëjës. Në disa raste foljet modale shqërohen me ndajfolje apo lokucione ndajfoljore.

Në raste shumë të rralla vërtetohen edhe dy ndërtime të tjera:

2. Folja modale *duhet +paskajore* (*duhet me dalë*)

3. Ndërtimin me foljen modale *do + lânë*

Foljet që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit në CK dalin zakonisht me ndërtime foljore që tregojnë fillimin e veprimit dhe më rrallë me ndërtime foljore që tregojnë vazhdimin dhe përfundimin e veprimit.

Në pjesën më të madhe të rasteve foljet që tregojnë fillimin e veprimit shoqërohen nga foljet e kohëve të thjeshta apo të përbëra të mënyrës dëftore si dhe nga përdorimet me paskajoren "gege" (*mbet e foli, kan marrë e po llafiten, ka nisë e paska thënë, kan bâ me dhënë, t'bajsh me kthye, kan nisë tuj gjâmue, rri tue pritë, pushojnë tue luftue* etj.).

Folja *nis* e shoqëruar me një folje tjetër të dëftores apo e ndjekur nga paskajorja gege "*me shkue*" del më shpesh në krahasim me ndërtimet e tjera që tregojnë mënyrën e zhvillimit të veprimit. Rendi i foljeve me kuptim të zbehtë leksikor, del i lirë brenda fjalisë, herë në fillim e herë në fund të saj. Nga shembujt e vjelë na rezulton se janë të shpeshta rastet, kur ndërmjet ndërtimit hyjnë elementë të tjerë të fjalisë.

Në ndryshim nga shqipja standarde nuk na ka dalë asnjë ndërtim foljor në përbërje të të cilit folja që rrit intensitetin e veprimit në fjali të ndiqet nga një folje e mënyrës lidhore.

Mënyra dëftore

Koha e tashme

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II foljet e të gjitha zgjedhimeve si dhe foljet e parregullta në kohën e tashme të mënyrës dëftore dalin me këto forma:

1. Me forma gramatikore të shqipes standarde dalin foljet e të gjitha zgjedhimeve si dhe foljet e parregullta në të gjitha vetat, të ndërtuara përkatësisht me mbaresat: Veta e parë njëjës: **-j/(zero)**; Veta e dytë njëjës: **-n/(zero)**; Veta e tretë njëjës: **-n/(zero)**; Veta e parë shumës: **-(j)m(ë)/-im**; Veta e dytë shumës: **-ni**; Veta e tretë shumës: **-(j)n(ë)/-in**.

Këto forma në CK janë me denduri më të madhe përdorimi se format e tjera foljore.

2. Me veçori dialektore në vargjet e CK dalin:

a. Si veçori e gegërishtes veriperëndimore disa folje të zgjedhimit të parë në vetën e parë njëjës dalin me mbaresë **zero**, sipas modeleve të foljeve të zgjedhimit të tretë.

b. Disa folje të zgjedhimit të dytë në vetën e parë njëjës dalin me mbaresë **-i** (*kapi, mbathi, mbledhi*). Në raste të izoluara kemi ndeshur folje të zgjedhimit të parë dhe të tretë që dalin me këtë mbaresë.

c. Folja e zgjedhimit të tretë, *di*, në pak raste, në vetën e parë njëjës del me mbaresën **-j**, Kjo dukuri mund të interpretohet si ndikim analogjik i foljeve të zgjedhimit të parë.

ç. Disa folje të zgjedhimit të tretë dhe foljet e parregullta: *din, pin, vên, xên, bjen, don, han, lën, vjen, rrin* (që dalin me temë në zanore) në vetën e dytë njëjës marrin mbaresën **-n** si foljet e zgjedhimit të parë.

d. Në vetën e tretë njëjës disa folje të zgjedhimit të parë dalin me mbaresën **zero**: *gatue, gjê, fry’, grrye, gjue*, veçori e gegërishtes veriore.

dh. Veta e tretë njëjës për foljen *jam* del në dy variante:

-me variantin e plotë: **âsht**

-me variantin e reduktuar **â** (karakteristik për të folmen e Shkodrës).

e. Disa folje të **zgjedhimit të parë**: *druë/druem, hî/hîm, shtî/shtîm* dalin në vetën e parë shumës pa zanoren ë fundore. Kjo është një veçori e mbarë të folmeve të gegërishtes. Pa zanoren ë fundore del edhe veta e tretë shumës e foljes ndihmëse *kam*.

ë. Foljet ndihmëse **kam** dhe **jam** në vetën e parë shumës dalin me mbaresën **-na** (karakteristikë e gegërishtes veriperëndimore).

f. Foljet *jam* dhe *kam* në vetën e parë shumës dalin me mbaresën **-m** (*jém, kém*). Këto forma, përdoren edhe sot e kësaj dite në disa të folme të gegërishtes. Folja *jam* ka një përdorim tepër të kufizuar si folje më vete, kurse si folje ndihmëse në këtë formë ajo ka një përdorim të gjerë.

3. Si veçori individuale e mbledhësve mund të veçojmë disa folje të zgjedhimit të dytë në vetën e tretë njëjës ndërtohen me mbaresën **-ë**, si: *mbledhë, mbushë, ndjekë, rrëshë, shetitë* etj.

Megjithatë, mbledhësit e CK nuk janë treguar konsekuentë, sepse gjatë trajtimit kemi ndeshur edhe format pa zanoren fundore, si: *mbledh, mbush, ndjek, rrah/rreh, shetit* etj.

-Zgjedhimi jovepror i foljeve për të gjitha zgjedhimet si dhe për foljet e parregullta del me trajta të njëjta, si ato të shqipes standarde: Veta e parë njëjës: **-(h)em**; Veta e dytë njëjës: **-esh**; Veta e tretë njëjës: **-(h)et**; Veta e tretë shumës: **-(h)en**.

-Vetën e dytë shumës të zgjedhimit jovepror nuk e kemi ndeshur në CK.

-Veta e parë shumës ndërtohet me mbaresat **-(h)ena / -(h)na**. Me mbaresën **-(e)na**, karakteristike për të folmet e gegërishtes, e cila del në dy variante:

a. Me variantin e plotë **-(h)ena**, i cili ndeshet i përdorur tepër rrallë në materialin e studiuar. Me këtë variant dalin foljet e zgjedhimit të parë dhe të dytë, si: *çohena, lahena, nisena*.

b. Me formën e rrëgjuar **-(h)na**, dalin foljet e zgjedhimit të parë, të dytë si dhe në raste të izoluar foljet e parregullta, si: *dahna, nisna, shkepna, shifna*.

Kjo dukuri është karakteristike për të folmet e gegërishtes.

-Format analitike që kemi ndeshur në CK ndërtohen nga paravënia formës së pashtjelluar përcjellore të foljes themelore e formave vetore të foljes ndihmëse *jam* në kohën e tashme, si: *jam tue ardhë, âsht tuj rá* (veprore); *â kah bâhet, jena tue u çue* (joveprore).

Koha e shkuar

Koha e pakryer e foljeve vërtetohet me tre vetat e njëjësit dhe me vetën e parë të shumësit, përkatësisht me mbaresat vetore: **-sha, -(j)sh, -te, (j)shin**. Veta e parë shumës nuk del të jetë përdorur në asnjë rast.

-Si veçori e gegërishtes veriperëndimore, veta e tretë njëjës del e ndërtuar me mbaresën **-te**, pa **-n**- karakteristike të shqipes së sotme (*çilte, rrokte, veshite, hate*).

-Zgjedhimi jovepror i foljeve në të pakryerën ka një përdorim realitivist të kufizuar dhe zakonisht del me foljet e vetës së tretë njëjës dhe shumës, si: *dredhej, sillej, duheshin* etj. Këto trajta të zgjedhimit jovepror janë në përputhje me shqipen e standarde.

-Përveç formave të zakonshme sintetike të së pakryerës, kemi gjetur edhe forma analitike të ndërtuara me:

a. anë të foljes ndihmëse *jam* në të pakryerën e dëftores dhe përcjellores së foljes themelore (*i’n tuj i shkue*). Kjo formë e mbarë shqipes ka një përdorim relativisht të kufizuar.

b. anë të foljes ndihmëse *jam* në të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe formës së pashtjelluar përcjellore të foljes themelore (*kjeçë tu’ lidhë*). Kjo formë, karakteristike për gegërishten veriperëndimore del vetëm në dy raste.

Koha e kryer e thjeshtë

-Format foljore, që përfshihen në të kryerën e thjeshtë në CK e kanë ruajtur deri në një farë mase kundërvënien e hershme midis aoristit sigmatik- aorist asigmatik. Këto forma dalin në vetën e parë njëjës me foljet e parregullta supletive, si: *dhásh, rash*.

-Format e tjera foljore e ndërtojnë të kryerën e thjeshtë (asigmatike) me zgjerim teme: me **-v-** në vetën e parë dhe të dytë njëjës: (*martova, pajtova; shkove, shnjerezove* etj.); me **-n-** në të tria vetat e njëjësit: (*bâna, bane, msyni* etj.); me **-jt-** në vetën e parë dhe të dytë njëjës: (*luejta*).

1. Me forma gramatikore si të shqipes standarde dalin foljet e të gjitha zgjedhimeve si dhe foljet e parregullta në të gjitha vetat, të ndërtuara përkatësisht me mbaresat: Veta e parë njëjës: **-a**; Veta e dytë njëjës: **-e**; Veta e tretë njëjës: **-i/-u /zero**; Veta e dytë shumës: **-(ë)t**; Veta e tretë shumës: **-në/-ën**.

2. Me veçori dialektore në vargjet e CK dalin:

a. Veta e parë njëjës e disa foljeve të parregullta e ndërtojnë të kryerën e thjeshtë me mbaresën **-sh** dhe pa znoren **ë**-në fundore, si: *dhásh, rash*.

b. Vetën e tretë njëjës të disa foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë dhe foljet e parregullta, e kemi ndeshur të ndërtuar me mbaresën **zero**, si: *gjet, duel, muer, xû, diq, erdh, pat, kje* etj. Kjo është formë arkaike e të folmeve të gegërishtes dhe si e tillë ka përdorim të rrallë.

c. Veta e tretë njëjës të disa foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë dhe vetëm me një folje të parregullt, del e ndërtuar me mbaresën **-u**, si: *ndjeu, kjau, preu, vrau, pau*.

-Ndërtimet foljore në numrin shumës kanë një përdorim më të kufizuar në raport me format e numrit njëjës. Sipas tingujve fundorë të temës kohore, veta e parë dhe e tretë shumës e foljeve, del me mbaresat **-m(e)**: *dame* (vetëm për zgjedhimin e parë e kemi gjetur) dhe **-(e)n**: *prozhmuen, shkruen, folen, dhimben* (dalin pak folje të zgjedhimit të parë dhe të dytë).

-Në disa raste, foljet e zgjedhimit të parë e ndërtojnë vetën e dytë shumës me mbaresën **-t**: *msuet, lshuet, ndigiuët* etj. Në të gjitha rastet këto forma dalin pa znoren fundore **-ë**.

-Format gramatikore të foljeve në kohën e kryer të thjeshtë në **zgjedhimin jovepror** kanë një përdorim relativisht të kufizuar. Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II këto forma ndërtohen mbi bazën e formave të zgjedhimit vepror, duke marrë para pjesëzën përemërore **u**: *u shurdhova, u turbullue, u shburrnuët* etj.

-**Kohët e përbëra** kanë përdorim të dendur në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II. Këto trajta na vërtetohen me këtë pamje:

1. Me forma analitike si të shqipes standarde dalin trajtat e përbëra: **e kryera, më se e kryera** dhe **e kryera e tejshkuar** që formohen nga paravënia pjesores së shkuar të foljes, e cila bart veprimin e formave vetore të kohës së tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë të foljes ndihmëse **kam** (forma e zgjedhimit vepror) dhe **jam** (forma e zgjedhimit jovepror): *kam guxue, jam zhgrehë; kishte pasë, ishte errë; pate xjerrë, patët dhânë* etj.

2. Me trajta gramatikore me karakter dialektor vërehen:

a. *E kryera* dhe *më se e kryera* e disa foljeve jokalmittare që formohen me foljen ndihmëse **jam**, si: *jam ardhë, â vjen; ish vojtë, ishin kânë* etj.

b. Si në shumë të folme të gegërishtes, edhe në vargjet e CK, kemi gjetur disa forma të mbipërbëra foljore në të shkuarën, të cilat e pasurojnë rrëfimin e ngjarjeve. Nga materiali i vjelë na kanë dalë dy kohë të mbipërbëra në zgjedhimin vepror dhe jovepror: **e kryera e dytë** (*ka pasë dhânë; jam kânë nisë*) dhe **më se e kryera e dytë** (*ki'n pa' marrë; ishin kênë ndrý*) etj. Folja në kohën e kryer del me rendin e zakonshëm, *kam + pjesore* dhe me rendin e përmbytur, *pjesore + kam*.

Koha e ardhme

Në CK dalin disa ndërtime të së ardhmes.

1. Ndërtimet e së ardhmes të njëjta me standardin e shqipes:

a. E ardhmja e ndërtuar nga paravendosja e pjesëzës **do** formave vetore të fojes në kohën e tashme të lidhore, si: *do t'bâj, do t'kpus, do t'nap* etj.

b. E ardhmja e ndërtuar me paravendosjen e formave vetore të së të tashmes së dëftores të foljes ndihmëse **kam** formës së pashtjelluar të tipit "*për të bâ*", si: *kë për t'a pasë*.

2. Ndërtimet e së ardhmes karakteristike për gegërishten:

a. E ardhmja e ndërtuar nga paravendosja e formave vetore të së të tashmes së foljes ndihmëse **kam** paskajores gege të tipit "*me bâ*", si: *kam me bâ*.

b. Për të shprehur kuptime të ardhme në CK, ashtu si në përgjithësi të të folmet e gegërishtes veriore, përdoret edhe një trajtë perifrastike e formuar nga folja **due** + paskajore e tipit "**me bâ**" (*due me kajtë, don me koritë* etj.) dhe nga folja **due** + paskajore e tipit "**për me bâ**" (*don për me pré*).

-Zgjedhimi jovepror i formave të së ardhmes del i ndërtuar me trajta të njëjta si të gegërishtes:

a. E ardhmja me **kam** + formën në joveprore të paskajores gege të foljes themelore, si: *ka me u dridhë*.

b. Trajtat e së ardhmes me foljen **dua**, tipi *due me shkue*, e ndërtojnë formën në zgjedhimin jovepror me ndihmën e pjesëzës me origjinë përemërore **u** (*due me u provue*).

-E ardhmja e së shkuarës del me raste të izoluara. E kemi gjetur të përdorur me trajta të njëjta si të shqipes e ndërtuar nga paravendosja e pjesëzës *do* formave vetore të së pakryerës të mënyrës lidhore (**do të kallxojsh**) dhe me trajta karakteristike të gegërishtes, ku e e ardhmja e së shkuarës del e ndërtuar nga paravendosja e formave vetore të së pakryerës së dëftores së foljes ndihmëse *kam* paskajores gege të foljes që bart veprimin (**kishte me rá**).


Kuptimet kohore të mënyrës dëftore

- Mënyra dëftore në CK del e pasur, jo vetëm me ndërtime, por edhe me kuptime kohore dhe modale, si për kohët e thjeshta ashtu edhe për kohët e përbëra. Kështu, koha e **tashme**, zakonisht del e aktualizuar me anë të pjesëzës **po** (*po luen*) dhe në disa raste *po* me këtë kuptim mund të përdoret edhe forma perifrastike e ndërtuar me anë të kohës së tashme të ndihmëses *jam* dhe përcjellores së foljes themelore (*âsht tuj m'a msue*).
- Në disa forma të së tashmes, foljes i paraprin pjesëza karakteristike e gegërishtes **kah** (*kah vjen*).
- Të pasura në përdorime na kanë dalë në këtë kohë edhe ndajfoljet e kohës dhe lokucionet ndajfoljore. Duke iu referuar çastit të ligjërimin, ata mund të tregojnë: kohën e saktë të kryerjes së një veprimi, si: *nesër, pasnesër, sot një javë*, etj.; kohëzgjatjen e një veprimi a të një gjendjeje, si: *natë e ditë, nândë dit e net*, etj.; një veprim të çastit, si: *fill, me'i herë, për një herë*, etj.; një veprim pak më të largët kohor, si: *atëherë, njetëherë, qatëherë* etj.; me kuptime mbarëkohore, si: *gjithmonë, kurr/kurrë* etj.
- Foljet në kohën e tashme të mënyrës dëftore dalin edhe modalitete të tjera, si me modalitetin e *dëshirores, kushtores* dhe të *urdhërores*.
- Format e së pakryerës dalin zakonisht të paaktualizuara, por në pak raste na kanë dalë edhe të aktualizuara me pjesëzën **po** (*po qitshin*).
- Koha e pakryer del vetëm me modalitetin e kushtores.
- Format e së kryerës së thjeshtë dalin ta pasura në kuptime kohore dhe zakonisht ato shoqërohen nga ndajfoljet e kohës dhe lokucionet ndajfoljore, të cilat mund të tregojnë: kohën e saktë të kryerjes së një veprimi, si: *sot, tash, njetash*, etj.; veprime të çastit, si: *me'i herë*; veprime më të largëta në kohë, si: *qatëherë*; veprime me kuptime mbarëkohore, si: *kurr*.


- Disa forma të së kryerës dalin me kuptime të ndryshme kohore, si: me kuptimin e së pakryerës apo të kryerës.
- E kryera e thjeshtë del edhe me modalitete të tjera, siç del në disa raste me modalitetin e kushtores në fjali të varura kushtore të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *po* apo me modalitetin e së kryerës së lidhores.
- Koha e kryer në CK del e pasur me tregues kohorë dhe duke iu referuar çastit të ligjërimin, ata mund të tregojnë: kohën e saktë të kryerjes së një veprimi, si: *sot, mbrâmë, mjesnatë*, etj.; kohëzgjatjen e një veprimi a të një gjendjeje, si: *'i natë e 'i ditë, natë e ditë*, etj.; një veprim të çastit, si: *brraf, bytym, fill*, etj.; një veprim të papërcaktuar më saktësi, si: *at-herë, qat-herë*, etj.; me një kuptim me vlerë mbarëkohore, si: *gjithmonë, kurr, kurr ma*, etj.; veprime periodike, si: *asnji herë, shpeshherë, gjthsa herë*, etj.
- Format e së kryerës dalin të pasura në kuptime kohore. Kështu, ata dalin në CK me kuptimin e së kryerës së thjeshtë duke dhënë vetëm përfundimin e një veprimi, pa theksuar lidhjen e tij me çastin e ligjërimin. Koha e kryer si *kohë tregimtare*, zakonisht del në përfundim të këngëve të Ciklit. Me kuptimin e së ardhmes del zakonisht me folje që tregojnë gjendje. Në pak raste format e së kryerës dalin edhe me modalitetin e kushtores.
- Format e më se të kryerës shpesh shoqërohen edhe nga ndajfoljet e kohës që mund të tregojnë: një veprim të çastit, si: *fill, me 'i herë*, etj.; një veprim pak më të largët kohor, si: *atëherë, qat-herë*, etj.
- Përveç kuptimeve kohore, format e më se të kryerës dalin edhe me modalitete të tjera, siç është modaliteti i mundësisë (kushtore).
- Trajtat e kohëve të mbipërbëra ashtu si edhe kohët e tjera analitike dalin edhe me tregues kohër të caktuar, që aktualizon veprimin e foljes, si: *mbrâmë, turr*, por edhe me tregues me vlerë mbarëkohore, si: *askurr, dikúr*.
- Trajtat e së ardhmes shpesh dalin të aktualizuara me anë të pjesëzës **po**, zakonisht në ndërtimin me trajtën perifrastike (**po duem me marrë**) dhe shënojnë një veprim që mund të ndodhë së shpejti. Në raste më të rralla, së ardhmes i paraprin pjesëza karakteristike e gegërishtes **kah** (**kah don me ardhë**).
- Koha e ardhme shoqërohet shpesh edhe nga ndajfoljet e kohës apo lokucione ndajfoljore të cilat tregojnë: kohën e saktë të kryerjes së një veprimi, si: *sot, neser*, etj.; me kuptim kohor të caktuar, si: *sot nji javë, sot dy javë*, etj.; me kuptime kohore të pacaktuara, si: *kurr, kurr mâ* etj.; me kuptime me vlerë mbarëkohore, si: *për gjithmonë, gjithmonë*, etj.
- Nga ana kuptimore, e ardhmja në ndërtimin, *kam + paskajore* e ruan në një farë mase kuptimin e domosdoshmërisë, ashtu si edhe ndërtimi, *do + lidhore*, kurse ndërtimi me trajtën perifrastike *due + paskajore e tipit "me ba"* del zakonisht me kuptimin e mundësisë.
- Në pak raste e kjo kohë shpreh edhe kuptime të tjera kohore, si të *tashmen e dëftores*.
- E ardhmja, shpesh del me modalitetin e *urdhërores* dhe të *kushtores*.
- Përveç rendit të zakonshëm, format e së ardhmes dalin edhe me rend të përmbysur (ndërtimet: *kam + paskajoren gege "me bâ"* dhe *due + paskajoren gege "me ba"*), ku ndërmjet ndërtimit foljor hyjnë edhe elemente të tjera të fjalisë.

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II denduri më të madhe të formave foljore ka mënyra dëftore me kohët e saj. Për të parë intensitetin e tyre na rezultoi kjo statistikë në përdorimin e tyre (nuk përjashtojmë ndonjë gabim, pasi numërimi është bërë në mënyrë mekanike).

*Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit”
(Vëllimi II, Kângë Kresbnikësh dhe Legjenda)*



Totali: 1149 folje



Totali: 949 folje

Mënyra habitore

-Kjo mënyrë del me këto kohë: e tashmja: *ndeshkam*; e kryera: *paska prî*; e kryera e dytë: *kênka kênë çue*.

-Nuk kemi ndeshur në asnjë rast forma për kohën e pakryer dhe më se të kryer. Me sa duket këto kohë nuk i japin shumë mundësi shprehëse narracionit.

Koha e tashme e habitores ndërtohet duke i prapangjitur pjesores së shkurtër të foljes format vetore të kohës së tashme të ndihmëses **kam**. Nuk kemi gjetur forma për vetën e parë shumës. Për vetat e tjera të njëjësit dhe të shumësit dalin foljet, si: *ndeshkam, kênke, këcyecka, shêmka, tërnueke, britka, shêmka, dik'i, gjetkan* etj.

-**Zgjedhimi jovepror** i së tashmes del i ndërtuar nga paravënia e pjesëzës me origjinë përemërore **u** formave vetore të së tashmes së habitores në formën veprorë: *u vrâka*. Përdoret rrallë dhe vetëm për vetën e tretë njëjës.

Koha e kryer ndërtohet nga prapavendosja pjesores së foljes që bart veprimin e formave vetore të së tashmes së habitores të ndihmëses **kam** (për zgjedhimin vepror) dhe **jam** (për zgjedhimin jovepror), si: *paske mbetë, paska gjue, paska vndue, paskan dyndë; kênke kânë, konka çue, kênka armatisë* etj.

Kohën e kryer në zgjedhimin vepror dhe jovepror e kemi ndeshur në vetën e dytë njëjës dhe në vetën e tretë njëjës dhe shumës.


-Në një rast të izoluar kemi gjetur një ndërtim të kohës së **kryer të dytë** të habitores, *kênka kênë çue*, e cila formohet nga prapavendosja pjesores së foljes që bart veprimin e formave vetore të së kryerës të ndihmëses **jam** (për joveproren).

-E tashmja në kuptimin e saj themelor shoqërohet shpesh me pjesëzën aktualizuese, **po**, por në disa raste ndeshet edhe me ndërtimin **kah + folje në të tashmen e habitores** (*kah përcjellka*).

-Format në të tashmen dhe të kryerën e habitores shpesh shoqërohen me ndajfoljet e kohës, si: *atëherë, braf, fill, heret, me'itherë* etj.

-Trajtat e shkurtra i shoqërojnë format e habitores. Ata kanë një përdorim të dendur dhe luajnë rol në përforcimin kuptimor të foljes.

- Në disa raste kemi ndeshur edhe forma të së kryerës së përmbysur me efekte stilistikore. Dendurinë e formave të habitores po e paraqesim me anë të grafikut:



Totali: 176 folje

Mënyra lidhore

Kjo mënyrë del me këto kohë: e tashmja: *t'kallxoj*; e pakryera: *t'mujshë*; e kryera: *t'këm ardhë*; më se e kryera: *t'kishin lshue*.

Koha e tashme e lidhores ndërtohet mbi bazën e së tashmes së dëftores. Format kohore të së tashmes së lidhores ashtu si në shqipen standarde (me përjashtim të foljeve *kam* dhe *jam*) dalin me të njëjta tema si në të tashmen e dëftores, por të prira nga pjesëza **të/t'**. Mbaresat vetore të numrit shumës nuk ndryshojnë nga ato të së tashmes së dëftores.

Me veçori dialektore vërehen:

-Në vetën e parë njëjës formantin **zero** e marrin edhe pak folje të zgjedhimit të parë, si: *t'hî*, *t'shtî*, kurse disa folje të zgjedhimit të dytë dalin me mbaresën **-i**, si: *t'çarti*, *t'mbathi*, *t'nxjerri*, *t'veshi* (këto forma me këtë mbaresë na kanë dalë edhe në të tashmen e dëftores).

-Te foljet me temë në bashkëtingëllore, veta e dytë njëjës, në disa raste del me mbaresën **-ish**, ku **-i** duhet të jetë zanore mbështetëse.

-Veta e tretë njëjës e foljeve të zgjedhimit të dytë dhe foljeve të parregullta, në pak raste, vërtetohet pa **-ë**-në fundore, si: *t'hjek*, *t'jet* (veçori e të folmeve geqe, ku **-ë**, sidomos në pozicionin fundor nuk shqiptohet).

-Format në **zgjedhimin jovepror** të së tashmes së lidhores dalin në pak raste dhe me të njëjtat forma të së tashmes së dëftores, por të prira nga pjesëza **të/t'**, si: *t'dahet*, *t'gjindet*. Ky zgjedhim vërtetohet me forma të vetës së parë e të tretë njëjës dhe shumës.

Koha e pakryer e lidhores del në një rast të izoluar me formën, *t'mujshë* me modalitet kushtor.

Koha e kryer ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes themelore format vetore të kohës së tashme lidhore të ndihmësës **kam** (për zgjedhimin vepror) ose **jam** (për zgjedhimin jovepror), si: *t'këm ardhë*, *t'jém ngusht*. Këto forma vërtetohen rrallë dhe vetëm në vetën e parë njëjës.

Koha më se e kryer vërtetohet vetëm me forma për zgjedhimin vepror dhe del e ndërtuar me paravendosjen e pjesores së foljes themelore e formave vetore të së pakryerës të lidhores të foljes ndihmëse **kam**: (*t'ki'n pasë*). Ka përdorim të rrallë.

E tashmja e lidhores përdoret shpesh me *kuptimin e së ardhmes*.


-Trajtat e së tashmes së lidhores dalin shpesh me *modalitet dëshiror*, të cilat e shprehin edhe atëherë kur përdoren me vlerën e mënyrës urdhërore (për urdhra, nxitje, këshilla, propozime etj.). Me këtë kuptim lidhëria del vetëm në vetën e parë shumës.

-Si veçori e gegërishtes në material dalin edhe rastet e shpeshta të përdorimit të pjesëzës së mohimit (**mos**) para formantit **të/t'** të lidhores (**mos t'gjindet**).

-Trajtat e së tashmes shoqërohen edhe me tregues me kuptim kohor të caktuar, si: *sot*, *nesër*, apo që tregojnë një veprim që ndodh aty për aty, si: *fill*, *tash*, *kesh*, *për'i herë* etj.

Mënyra kushtore me ndërtimet e saj foljore nuk vërehet në asnjë rast, por me modalitetin e kushtores dalin disa ndërtime kohore të mënyrës dëftore (e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e ardhmja etj.). Me kuptimin e mënyrës kushtore vërtetohen edhe disa shembuj të ndërtimeve të mënyrës lidhore, dëshirore dhe të paskajores. Janë të shpeshta edhe rastet ku foljet modale dalin me modalitetin e kushtores. Në të gjitha rastet kushtin e përforcojnë edhe lidhëzat nënrenditëse, si: *n'në*, *po*.

Sipas të dhënave statistikore format e lidhores dalin me këtë pamje:



Totali: 132 folje

Mënyra dëshirore

-Kjo mënyrë del me dy kohë si në standardin e shqipes: **koha e tashme** (*gzosha*) dhe **koha e kryer** (*paça dhânë*).

-Foljet në kohën e tashme ndërtohen duke i shtuar temës së posaçme të dëshirores mbaresat vetore të mënyrës dëshirore, ku ashtu si në shqipen standarde dalin me anë të prapashtesës trajtëformuese **-f(sh)** që i prapangjitet (në pjesën më të madhe të rasteve) temës të së kryerës së thjeshtë.

1. Me forma gramatikore si ato të shqipes standarde, **koha e tashme del e ndërtuar me mbaresat: Veta e parë njëjës: **-sha**; Veta e dytë njëjës: **zero**; Veta e tretë njëjës: **-të**; Veta e parë shumës: **-im**; Veta e dytë shumës: **-i**; Veta e tretë shumës: **-in**.**

-Në pak forma vetore, krahas mbaresave përdoret edhe prapashtesa **-sh**, ku ndeshja e fërkimores **-sh** të temës me të njëjtën bashkëtingëllore të prapashtesës së dëshirores ka përfutur afrikaten **-ç**, si në rastet: *dhaça, daç, paç, thaçin* etj.).

2. Me trajta dialektore:

-Në CK, te foljet e zgjedhimit të parë që dalin me temë në zanore, si rregull duhej të dilnin me formantin **-f**, por që në pjesën më të madhe të rasteve vërehen pa këtë formant (*gzosha, martosha, kjosha, pasha, kjoshim* etj.).

-**Forma e joveprores** e së tashmes ndërtohet duke i paravënë pjesëzën **u** foljes në formë veprorë (*u martosha, u pashim* etj.).


-Foljet në **kohën e kryer** ndërtohen duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të së tashmes së dëshirores së foljes ndihmëse **kam** (forma e zgjedhimit vepror) dhe **jam** (për zgjedhimin jovepror): *paça lânë, kjoshin falë*. Me përdorime të rralla kjo kohë në zgjedhimin vepror del me forma të vetës së parë dhe të tretë njëjës dhe shumës, kurse në zgjedhimin jovepror del me forma të vetës së tretë njëjës dhe të vetës së parë dhe të tretë shumës.

-**Koha e tashme** përdoret në pak raste në fjali për të shprehur veprime të mundshme të së *ardhmes*. Në këto përdorime ajo del edhe në fjali të varuara kushtore, të ndërtuara me lidhëzën nënrenditëse *në*. Në raste më të kufizuara edhe koha e kryer del me *modalitetin e kushtores*.

-Në raste të izoluara, e kryera e dëshirores del me rend të përmbysur, ku pjesorja del para formës së dëshirores për të theksuar më shumë veprimin e foljes.

Nga vjeljet mënyra dëshirore na rezulton me këtë denduri sipas skemës:

Mënyra dëshirore



Totali: 92 folje

Mënyra urdhërore

1. Foljet në mënyrën urdhërore janë të njëjta me ato të shqipes standarde.

Format e *vetës së dytë njëjës*, përgjithësisht dallohen nga format përgjegjëse të kësaj vete në të tashmen e dëftores, por ka edhe raste që dalin me të njëjtën formë gramatikore (*del, merr, qesh*), kurse te format e *vetës së dytë shumës* ndodhin po ato ndryshime fonetike që kanë pësuar format gjegjëse të vetës së dytë shumës urdhërore (që formalisht janë të njëjta me ato të vetës së dytë shumës të së tashmes së dëftores).

a. Veta e dytë njëjës në pjesën më të madhe formohet me: mbaresë **zero** (*kallxo, kqyr, pi, ki* etj.); me mbaresën **-j** për foljet e zgjedhimit të parë dhe foljet e parregullta (*prâj, kij* etj.)

b. Foljet në vetën e dytë shumës dalin njësoj si format gjegjëse të së tashmes së dëftores, të ndërtuara me mbaresën **-ni**, si: *diftoni, lodroni, hajtni, pritni, qitni, disni, kini* etj.)

2. Me forma karakteristike për gegërishten dalin format e urdhërores që ndërtohen me zgjerim teme me anë të formantit **-n**: *hîn, vên* etj.

3. Në pak folje të zgjedhimit të dytë, veta e dytë njëjës merr mbaresën **-ë**, si: *falë, kqyrë* etj. Me sa duket, kjo është një veçori individuale e mbledhësve të CK për të ruajtur theksin ritmik të vargut.

1. Si në standardin e shqipes, **forma e zgjedhimit jovepror** të urdhërores, del e ndërtuar nga prapavënia formës së urdhërores veprorë të pjesëzës **u**, si: *martohu, ngujoju, avitu, qeshiu*, etj.

Ndërsa, kur folja në urdhërore përdoret në mohore pjesëza **u** gjendet e vendosur ndërmjet pjesëzës mohuese **mos** apo trajtës së shkurtër dhe trupit të foljes, si: *mos u ban, mos m'u hiq, mos u tallni* etj.

2. Si veçori dialektore (e gegërishtes veriperëndimore) vërtetohet në raste të izoluara vendosja e pjesëzës **u** në pozicionin fundor të fjalës (*ndalnju*).

-Në një rast të vetëm na ka dalë veta e dytë shumë e ndërtuar me mbaresën **-(h)i**: *shtërngohi*. Kjo veçori është tipike e gegërishtes veriore.

-Format gramatikore të kësaj mënyre shprehin zakonisht dëshirën e folësit në formë: urdhri, nxitjeje, këshillë, lutje etj.

-Trajtat e urdhërores vërehen shpesh të shoqëruara me trajtat e shkurtra duke iu ngjitur enklitikisht si formave të njëjësit ashtu edhe të shumës (*bjeri, bjere, bjerma*). Në këto raste trajtat e shkurtra ndihmojnë edhe në përforcimin kuptimor të mënyrës urdhërore.

Nga numërimi manual format e urdhërores për nga denduria dalin sipas skemës:

Mënyra urdhërore

Nga 117 folje të mënyrës urdhërore gjendja paraqitet e tillë:

1. Vetën e dytë njëjës e ndeshim në 79 folje (59 veprorë dhe 20 joveprorë);

2. Vetën e dytë shumë e ndeshim në 38 folje (34 veprorë dhe 4 joveprorë).

Totali: 117 folje

Në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II kemi gjetur këto forma të pashtjelluara foljore:

Pjesorja

Kjo formë e pashtjelluar foljore përdoret më shumë si pjesë përbërëse e trajtave analitike, por edhe si gjymtyrë më vete. Ajo del e ndërtuar me këto formante:

1. Formante karakteristike si të shqipes standarde:

a. Fomanti **-ë**: dalin disa trajta që dalin me temë në bashkëtingëllore, kryesisht foljet me temë në **-r, -rr, -l, -ll** (*dalë, marrë*, etj.)

b. Fomanti **-në**, del vetëm me foljen e zgjedhimit të tretë (*xânë*)

2. Formante të veçanta dialektore (të gegërishtes):

a. Formantin **zero**, e marrin foljet që dalin me temë në zanore e që e zbërthejnë atë në tog zanor **-ue-**, **-ye-**, ose foljet (kryesisht njërrrokëshe) që dalin me temë në zanore të theksuar, si: *çue, martue, mbërthye, prarue, shnjertzue* etj.

b. Fomanti **-ë**, në të folme të gegërishtes, ka ardhur duke u përdorur në analogji me foljet që dalin me temë në **-r, -rr, -l, -ll**, të cilat pësojnë apofoni në të kryerën e thjeshtë, del e përdorur edhe me folje të tjera që dalin me temë në bashkëtingëllore, kryesisht te foljet e zgjedhimit të dytë, si: *hupë, lidhë, marrë, mbathë, mbetë* etj. Këtë formant e kemi ndeshur në raste të izoluara edhe në pak folje të parregullta (*dekë, ndëjë*).

c. Fomanti **-un**, tipik për gegërishten, e formon pjesoren e foljeve (të zgjedhimit të parë, të dytë dhe foljet e parregullta) që dalin me temë në bashkëtingëllore, si: *lâmun, fjetun, lidhun, ndëjun* etj.

ç. Fomanti **-m**, karakteristik për gegërishten del shumë rrallë me formën, *pritëm*.

Pjesorja si gjymtyrë më vete del edhe si pjesë e kallëzuesit emëror apo si përcaktor i veçuar.

Format e pashtjelluara mbi bazën e pjesores

Mohorja

Kjo formë e pashtjelluar në CK del vetëm me të ashtuquajturën **kohë e tashme** me dy forma: *pá mujtë* dhe *për pá mujtë*.

1. Forma analitike, e njëjtë si me shqipen standarde, në veprorë ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes themelore e pjesëzës **pa**, si: *pá gzue, pá njuhë, pá ngrânë*, etj.

2. Në CK paraqitet edhe forma analitike e mohores, e cila formohet nga pjesëza me origjinë parafjalore **për**, si: *për pá ndie, për pá thye, për pá dale, për pá marrë* etj.

-Format në **joveprore** të mohores ndërtohen nga vendosja e pjesëzës **u** ndërmjet pjesëzës **pa** dhe pjesores së foljes, si: *pá u vonue, pá u pré* etj.

-Trajtat e mohores dalin me funksione të ndryshme në fjali, si: me funksionin e rrethororit të *kohës, mënyrës* dhe *kushtit*.

Përcjellorja

-Forma e pashtjelluar foljore, përcjellorja në CK vërtetohet e përdorur vetëm në të ashtuquajturën **kohë e tashme**: *tue kërkue*. Forma e pashtjelluar e paskajores në veprorë ndeshet e ndërtuar nga paravënia e varianteve të pjesëzës **tue/tuj/tu** pjesores së foljes, si: *tue fluturue, tuj nxjerrun, tu' lotue* etj.

-Forma e përcjellores në **joveprore** ndërtohet nga vendosja e pjesëzës **u** ndërmjet pjesëzës së përcjellores dhe pjesores së foljes themelore, si: *tue u lshue, tuj u tutë* etj.

-Trajtat foljore të përcjellores dalin me funksione të ndryshme në fjali, si: me funksion *mënyror, shkakor, kohor* dhe *kushtor*.

Paskajorja

Në CK, paskajorja vërehet e përdorur në dy të ashtuquajtura kohë:

E tashme: *me bâ, për me bâ*

E kryer: *me pasë ndie*

Në CK dalin këto forma për paskajoren karakteristike për gegërishten:

a. Forma e paskajores gege, **me bâ**, e cila ndërtohet nga paravendosja e pjesëzës formant **me** pjesores së foljes. Kjo formë ka përdorim më të dendur në përmbledhjen "Visaret e Kombit" II.

b. Forma e paskajores **për me bâ**, del e ndërtuar nga paravendosja e parafjalës **për** formës së paskajores gege të tipit "*me bâ*", p.sh.: *për me çetue, për me tjerrë, për me xânë, për me lânë* etj. Kjo formë karakteristike për gegërishten veriperëndimore është forma mbizotëruese e formës së pashtjelluar paskajore.

-Format e paskajores në **joveprore** ndërtohen me ndihmën e pjesëzës **u**, që vihet ndërmjet pjesëzës formant të paskajores dhe pjesores së foljes themelore: *me u provue, me u flladitë, m' u mbathë, me u dhânë* etj.


-E ashtuquajtuara **koha e kryer** e paskajores në CK del vetëm me format në veprorë dhe ndërtohet nga paravënia pjesores së foljes themelore e formës së paskajores të foljes ndihmëse *kam* (*me pa' lidhë, me pa' dashtë* etj.)

-Format e paskajores marrin në fjali edhe kuptime të tjera kur shqoqërohen me tregues me kuptim kohor të caktuar (*nji deqik, sande, kesh*) apo të pacaktuar (*kurr*). Më rrallë këto forma shoqërohen edhe me lokucione ndajfoljore (*trí vjet, sot dý javë*).

-Trajtat e paskajores i kemi ndeshur edhe me modalitete të tjera, si: me modalitetin e mënyrës *dëftore, lidhore, kushtore* apo *urdhërore*.

-Paskajorja e përdorur në formën mohuese (*mos me punue*) në fjali shpreh modalitetin e mundësisë, të supozimit a të irrealitetit, të përafërt me mënyrën lidhore, urdhërore apo dëshirore.

Format e pashtjelluara foljore dalin me një përdorim të dendur. Nga të gjitha format, trajta e paskajores *me bâ* ka numrin më të madh të formave. Për të parë intensitetin e tyre na rezulton kjo statistikë në përdorimin e tyre (të dhënat janë me përafërsi, sepse numërimi është bërë në mënyrë mekanike).



Totali: 546

Sipas materialit të vjelë formimi i foljeve del sipas këtyre tipeve:

- 1. Folje të parme**, të cilat dalin në një numër të konsiderueshëm, si: *bâj, brit, kja, terë* etj.
- 2. Foljet e prejardhura me parashtesim** nuk janë të shpeshta. Formimi parashtesor del zakonisht me parashtesat:
për-: (*përvjellë, përplasë, përgjegjet, përpiqen, përprjekë*);
sh-: (*me shdukë (dukë), shpengojnë (pengojnë)*) etj.;
z- dhe **zh-**: *zgidh (lidh), zdeshë (vesh)*; (*me zhdukë (dukë)*) etj.
- 3. Foljet e prejardhura me prapashtesim**, ashtu si në shqipen standarde, edhe në CK ky formim është tipi më prodhimtar në grupin e foljeve të prejardhuara. Prapashtesat me të cilat janë formuar foljet e prejardhuara në CK, janë:
 - a.** Prapashtesat **-o-**, **-(ro)**, **-(so)-**, **-(zo)-**, p.sh.: *shkurtoj, tepron, qelbson; vallon*; etj. Foljet e formuara nga këto prapashtesa vijnë nga tema emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore. Formimi i foljeve me prapashtesën **-o-** ka numrin më të madh të foljeve.
 - b.** Prapashtesat **-s/- is**, **-atis** shërbejnë për të formuar pak folje të zgjedhimit të dytë, si: *batisë, helmatisë, korisim*, të cilat formohen nga tema emërore.

BIBLIOGRAFI

Akademia e Shkencave të Shqipërisë:

- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë, 1976.
- Gramatika e gjuhës shqipe, I, Tiranë, 2002.

AGALLIU, Fatmir:

- Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore, "Studime filologjike", 1968, nr.2.
- Mënyra lidhore në gjuhën shqipe, në botimin e autorit "Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1988.
- Pjesorja në gjuhën shqipe, në botimin e autorit "Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1988.

AJETI, Idriz:

- Historia e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1969.
- Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshëvës e të Bujanovcit, në "Studime gjuhësore" (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

ALIMHILLI, Xhilda:

- Klasifikimi foljor sipas mënyrave të veprimtimit në gjuhën shqipe, Cosenza, 2009.

ALTIMARI, Francesco:

- Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian. Vëzhgime për të kryerën e "supozimit" të arbërishtes dhe për formimin e habitores së shqipes, (f.11-40), Prishtinë, 2014.

ARAPI, Ina:

- Vërejtje mbi mosklasifikimin e foljes "dua" si folje me vlerë modale në gramatikat shqipe, "Studime filologjike", 2009, nr.1-2.
- Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore të paskajores e lidhores geqe në veprën "Epika legjendare e Rugovës", në Eposi i kreshnikëve: Momument i trashëgimisë kulturore shqiptare vëllimi II. (Konferencë Shkencore Ndërkombëtare. Prishtinë, 28-30 gusht 2010). Insituti Albanologjik – Prishtinë, 2016.

ASHTA, Kolë:

- Elemente të lashta gjuhësore në këngët e kreshnikëve në botimin "Çështje të folklorit shqiptar", 1987, nr.3.

BECI, Bahri:

- Grupi perëndimor i nëndialektit verior të gegërishtes, "Studime filologjike", 1970, nr. 3.
- E folmja e Shkrelit, në "Dialektologjia shqiptare I", Tiranë, 1971.
- E folmja e Luznisë së Dibrës, në "Dialektologjia shqiptare II", Tiranë, 1974.
- E folmja e Mirditës, në "Dialektologjia shqiptare IV", Tiranë, 1982.
- Rreth disa veçorive gjuhësore të këngëve tona epike, "Studime filologjike", 1986, nr.4.
- Gegërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj, "Studime filologjike", 1987, nr.3.
- Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i të folmes së Shkodrës, Tiranë, 1995.
- Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Tiranë, 2002.
- Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër, 2005.

BINAJ, Kadire:

- Trajta e pashtjelluara mohore dhe përdorimi i saj në veprën e Martin Camajt, SEMINARI XXXII NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE, Prishtinë, 19-30.08.2013.

BOKSHI, Besim:

- Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik), Prishtinë, 1998.

Sistemi foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit"
(Vëllimi II, Këngë Kreshnikësh dhe Legjenda)

- Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Prishtinë, 2010.
- Rreth problemit të paskajores në gjuhën shqipe, në botimin e autorit "Varia", Prishtinë, 2014.

BREU, Walter:

- The classification of the admirative as a mood raises serious questions from a theoretical point of view, as it can combine with other moods (Mood in Albanian, "Mood in the Languages of Europe"), John Benjamins Publishing Company, 2010.

CAMAJ, Martin:

- Albanian Grammar with Exercises, Chrestomathy and Glossaries, Wiesbaden. 1984.

CIPO, Kostaq:

- Gramatikë e gjuhës shqipe, Tiranë, 2015 (ribotim).

ÇAPALIKU, Alfred:

- Bernadin Palaj, jeta dhe veprat monografi, Shkodër, 1999.

ÇELIKU, Mehmet:

- Togje foljore leksikisht të kufizueme në shqipen e sotme, në "Konferenca e parë e studimeve albanologjike" (15-21 Nëntor 1962), Tiranë, 1965.
- Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1997.
- Problemi i paskajores në shqipen standarde, në botimin e autorit "Çështje të shqipes standarde", Tiranë, 2009.

ÇERPJA, Adelina:

- Formimi i normës së sotme letrare në sistemin foljor të gjuhës shqipe, Tiranë, 2012.

ÇETTA, Anton:

- Këngë kreshnike, Insituti Albanologjik i Prishtinës, 1974.

DEMIRAJ, Shaban:

- Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, pjesa II, Tiranë, 1963.
- Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1969, nr.1.
- Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Prishtinë, 1970.
- Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Prishtinë, 1971.
- Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1971, nr. 1.
- Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1971, nr. 3.
- Haborja dhe mosha e saj, "Studime filologjike", 1971, nr. 4.
- Rreth foljevet jam, kam e thom dhe rreth alternimit -e- /-ie- -i- në sistemin foljor të shqipes, "Studime filologjike", 1972, nr.1.
- Morfologjia historike e gjuhës shqipe (pjesa II), Tiranë, 1976.
- Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1977, nr.3.
- Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe, "Studime filologjike", 1984, nr.4.
- Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 1986 (ribotim 2002).
- Elemente gjuhësore arkaike në këngët e kreshnikëve në botimin "Çështje të folklorit shqiptar", 1986, nr.2.

DEMIRAJ, Bardhyl:

- Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij, Prishtinë, 2006.

DODI, Anastas:

- Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1968, nr.1.

DOMI, Mahir:

- Morfologjia historike e shqipes, Prishtinë, 1959.
- Gramatika e gjuhës shqipe për klasën e VIII, Tiranë, 1968.
- Çështje të gjuhës së epikës legjendare heroike sidomos në sintaksë në botimin "Çështje të folklorit shqiptar", Tiranë, 1986, nr.2.

DOZON, Auguste:

- Manuel de la langue shqipe ou albanaise: grammaire-vocabulaire-chrestomathie, Paris, 1879.

DUSHI, Arbnora:

- The Albanian oral tradition in Kosova, Prishtinë, 2003, <https://journal.fi/elope/article/view/78385/39284>.

DHRIMO, ALI:

- Për shqipen dhe shqiptarët 1, Çështje të sistemit foljor. Mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe, (f.330-373), Tiranë, 2008.

ELSIE, Robert – HECK, Janise Mathie

- Këngë kreshnikësh - Songs of the frontier warriors: Albanian epic verse in a bilingual edition, Wauconda, Illinois, 2004.

FETIU, Sadri:

- Aspekte krahasimtare të këngës popullore "Gjergj Elez Ailja", në "Gjurmime albanologjike–Folklor dhe etnologji", Prishtinë, 2012.

FIEDLER, Wilfried:

- Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut, në "Gjurmime albanologjike", Prishtinë, 1977.

FRIEDMAN, Victor:

- The age of Albanian Admirative: A problem in Historical Semantics, in Ex Anatolia Lux. Anatolian and Indo-European studies (in honor of H. Craig Melchert). Ann Arbor. Beech Stave Press, 2010.

FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE, Tiranë, 1980

FJALORI I "BASHKIMIT": botim anastatik i Fjaluer i rii i Shcypés, perbâam préie Shocniét t’ Bashkimit 1908, (2018)

GOSTURANI, Xheladin:

- E folmja e Hasit, në "Dialektologjia shqiptare III", Tiranë, 1975.
- E folmja e Çeremit dhe e Valbonës (rrethi Tropojë), në "Dialektologjia shqiptare IV", Tiranë, 1982.
- Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e gegërishtes verilindore, "Studime filologjike", 1994, nr. 1-4.

GJINARI, Jorgji – SHKURTAJ, Gjovalin:

- Dialektologjia, Tiranë, 1997.

GJINARI, Jorgji:

- Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe, "Studime filologjike", 1966, nr.4.
- Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës, në "Dialektologjia shqiptare I", Tiranë, 1971.
- Dialektologjia shqiptare, Tekste për shkollat e larta, Tiranë, 1975.

HAMITI, Vjosa:

- Selman Riza për modalitetin e foljeve modale, Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2012.

HAXHI, Artan:

- Rreth së tashmes së lidhore në prozën e Fishtës, Buletin Shkencor, Shkodër, 1999, nr. 50.
- Proza e Fishtës në pamje gjuhësore, Shkodër, 2003.

HAXHIHASANI, Qemal:

- Mendësi zotëruese në Ciklin e Kreshnikëve në "Gjurmime Albanologjike", seria folklor dhe etnologji 21, Prishtinë, 1991.

Haxhillazi, Adrian:

- E kryera e mbipërbërë e gjuhës shqipe, "Studime filologjike", 2011, nr.1-2.

HOXHA, Shefqet:

- Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës, në "Dialektologjia shqiptare III", Tiranë, 1975.

HYSA, Enver:

- Rreth përdorimeve të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1975, nr.3.
- Formimet me parashtesën për- në gjuhën shqipe, në botimin "Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II", Tiranë, 1975.

ISMAJLI, Blertë:

- Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe ha-bitorja, në "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit" (Konferencë shkencore e mbajtur më 10-11 nëntor 2011 në Prishtinë), Prishtinë, 2012.

KLOSI, Ardian:

- Quo vadis, Shqipëri? (antologji) Tiranë, 1993.

KOLIQI, Ernest:

- Vepra 5, Prishtinë, 2003.

KURTI, Donat:

- Gramatika shqype, Botime Françeskane, Shkodër, 2020.

LAFE, Emil:

- E folmja e Nikaj - Mërturit, "Studime filologjike", 1964, nr.3.
- Shqipja standarde në vështrim strukturor dhe funksional, në përmbledhjen "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003.

LIKAJ, Ethem:

- Forma analitike e së kryerës në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1989, nr.2.
- Format analitike në gjuhën shqipe, Tiranë, 1997.

LUKA, David:

- Studime gjuhësore XVIII, Forca dhe madhështia e fjalës te këngët e kreshnikëve, Shkodër, 2016.

MANCAKU, Seit:

- Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku, "Studime filologjike", 1979, nr.3.
- Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskajore te autorët e vjetër, "Studime filologjike", 1980, nr.2.

*Sistemi foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit"
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)*

- Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj, "Studime filologjike", 1982, nr.1.

MIKELI, Gaspër:

- Gramatika e gjuhës shqype, Shkodër, 1916.

MULAKU, Latif:

- E folmja e Shalës së Bajgorës, në "Dialektologjia shqiptare VI", Tiranë, 1990.

MULAKU, Ragip:

- Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë, Prishtinë, 1987.
- Vepra 3, Prishtinë, 1998.
- Parashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrimet e vjetra (shek. XV-XVIII), Prishtinë, 1998.
- Gjuha e shkrimeve të vjetra shqip (Shek.XV-XVIII), Prishtinë, 2012.

MYDERRIZI, Osman:

- Gramatika e rë e shqipes: për shkollat e mesme: fonologji e morfologji, Tiranë, 1944.

NEZIRI, Zymer:

- Epika legjendare e Rugovës, vol. 5, Prishtinë, 1997.
- Këngë të kreshnikëve. Prishtinë: Libri shkollor, 2001.
- Studime për folklorin 1: Eposi i kreshnikëve dhe epika historike, Gustav Majer dhe fillet e botimit të këngës kreshnike shqiptare, Prishtinë, 2006.

OMARI, Anila:

- Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit, Tiranë, 2017.

OSMANI, Tomorr:

- Përsosja e standardit gjuhësor në fushën e morfologjisë dhe të drejtshkrimit, në Konferenca Shkencore "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Tiranë, 2003.
- Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor, 3, Shkodër, 2009.

PLLUMI, Zef:

- Françeskanët e mëdhaj, Tiranë, 2001.

PRENNUSHI, Vinçenc:

- Kângë popullore gegenishte (Parathâne), Botimi II, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.

PRIKU, Mimoza:

- Reth disa ndërtimeve fojore me vlerë intensive në prozën e Koliqit, Buletin Shkencor, SSHSH, 2012, nr. 62.
- Mbi disa ndërtime të habitores në Epikën legjendare, në "Gjurmime Albanologjike", 2013, nr. 43.

QABEJ, Eqrem – XHUVANI, Aleksandër:

- Studime Gjuhësore III, "Parashtesat - Prapashtesat" Prishtinë, 1976.

RADOVANI, Fritz:

- http://www.trepca.net/2005/08/050820_fritz_radovani_at-donat_kurti-perballe_albanalogut_jup_kastrati.htm

RESSULI, Namik:

- Grammatica Albanese, Bolonjë, 1985.

RIZA, Selman:

- Tri monografina albanologjike Abeceja = Drejtëshkrimi = Çështja gjuhësore, Tiranë, 1944.

- Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, Tiranë, 1994.

RROTA, Justin:

- Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Botimi I, Shkodër, 2006.

SAKO, Zihni:

- Mbledhës të hershëm të folklorit Shqiptar (1635-1912), Sektori i Folklorit Letrar, Tiranë, 1962.

SINANI, Shaban:

- Kështjella e virtytit, Tiranë, 2001.

SULEJMANI, Fadil:

- Folja në veprën e Matrëngës, "Studime filologjike", 1982, nr.4.

SULEJMANI, Haxhere:

- Imperfekti në gjuhën shqipe, Tetovë, 1996.

SHEPERI, Ilija D.:

- Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe, sidomòs e toskënishtes (për shkolla të mesme), Vlorë, Shtypshkronja "Vlora" G. Direttore & C., 1927.

SHKURTAJ, Gjovalin:

- E folmja e Hotit, në "Dialektologjia shqiptare II", Tiranë, 1974.

- E folmja e Kelmendit, në "Dialektologjia shqiptare III", Tiranë, 1975.

- E folmja e Rranzave të Mbishkodrës, në "Dialektologjia shqiptare IV", Tiranë, 1982.

- Dialekti dhe norma në trajtat foljore të mbipërbëra, "Gjuha Jonë", 1984, nr.3.

- Disa dukuri të gjuhës së epikës legjendare, në "Çështje të folklorit shqiptar" (Simpoziumi: Epika heroike shqiptare, 20-22 tetor 1983), Tiranë, 1987, nr. 3.

- Etnografia e të folurit në eposin e kreshnikëve, në "Gjurmime albanologjike", Seria e shkencave filologjike, Prishtinë, 2009, nr.39.

TOPALLI, Kolec:

- Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2010.

- Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Tiranë, 2011.

- Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2013.

TOPALLI, Xhabir:

- Disa vërejtje për të folmen e Pukës, në "Dialektologjia shqiptare II", Tiranë, 1974.

TOPALLI, Nikollë:

- Koha e ardhme e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1980, nr.4.

TOTONI, Minella:

- Kontrukte me foljen aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe, "Studime filologjike", 1986, nr.1.

UÇI, Alfred:

- Epika heroike dhe roli i saj në folklorin shqiptar, në botimin "Çështje të folklorit shqiptar", 1986, nr.2.

VANSINA, Jan:

- Oral tradition as history, London, 1985, <https://www.questia.com/read/98551048/oral-tradition-as-history>.

VESELAJ, Nuhi:

- Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006.

ZHEJI, Gjergj:

- Folklori shqiptar, Tiranë, 1998.

Sistemi foljor në përmbledhjen "Visaret e Kombit"
(Vëllimi II, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda)

Letërsi e vjelë:

Akademia e Shkencave të Shqipërisë:

- Folklor Shqiptar II, Epika Legjendare II, Tiranë, 1966.
- Folklor Shqiptar, Epika Legjendare, seria e dytë, Tiranë, 1983.

PALAJ, Bernard – KURTI, Donat:

- Visaret e Kombit, Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda, Tiranë, 1937.
- Eposi i kreshnikëve dhe legjenda, Koleksioni "Visaret e Kombit" II, Botimi i dytë, Tiranë, 2005.
- Visaret e Kombit: Kângë Kreshnikësh dhe Legjenda (mbledhë), Botime Françeskane, Shkodër, 2007.

Abstrakt

Studimi i gjuhës së folklorit është pjesë e pandarë dhe e pazëvendësueshme e studimeve gjuhësore në përgjithësi, si në planin diakronik e sinkronik, ashtu edhe në planin gjeografik e shoqëror.

Në këtë aspekt njohja e thelluar e gjuhës së krijimeve popullore lidhet ngushtë edhe me njohjen e procesit të formimit të gjuhës letrare, para së gjithash të gjuhës në letërsinë artistike, sepse, siç dihet, te folklori gjejmë fillimet dhe burimet e artit të fjalës.

Me anë të këtij punimi synohet që të hidhet dritë rreth formave foljore të "Visaret e Kombit", vëllimi II, Kângë Kreshnikësh, Mbledhë dhe redaktue nga At Bernadin Palaj dhe At Donat Kurti.

Ndër synimet kryesore të punimit është vjelja dhe interpretimi i përdorimeve të foljeve me karakteristikat e veçanta morfologjike që shprehin ato.

Njohjen dhe analizimin e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore, sipas mënyrave, mbaresave të tyre që dalin sipas kohëve, vetave e numrit, zhvillimet e tyre të brendshme, sikurse paraqiten në përmbledhjen e autorëve.

Duke u ndalur në disa raste të veçanta të ndërtimeve morfologjike së bashku me kuptimet gramatikore që ato mbartin, hidhet dritë dhe analizohen edhe më tej disa prej zhvillimeve të sistemit foljor të gegërishtes veriperëndimore.

Jemi ndalur edhe në disa kuptime kohore të mënyrave dhe të formave të pashtjelluara foljore, të cilat dalin mjaft të pasura.

Me metodat kërkimore të ndjekura kemi krahasuar sistemin foljor të gjuhës së përmbledhjes nga autorët Bernadin Palaj dhe Donat Kurti me shqipen standarde, me të folmet e gegërishtes e në ndonjë rast të izoluar edhe me autorët e vjetër Veriorë.

Fjalë kyçe: gegërishte, forma foljore, standard, paradigëm, kuptime kohore.

Abstract

The study of folklore language is an integral and indispensable part of linguistic studies in general, in the synchronic and diachronic plan, as well as the geographic and social levels.

In this regard the depth of knowledge in the popular creations is closely linked with the recognition process of the formation of the literary language, first of all the language in fiction, because, as known, we find the beginnings of folklore and resources of the word art.

Through this paper, we aim to clarify on the verbal forms of "Visaret e Kombit" (National Treasure), Volume II, Kreshnik Songs, Collect and edit the Father and Bernardin Palaj and Father Donat Kurti.

Among the main goals of this paper is the collection and interpretation of verbs use with specific morphologic features express them.

Recognition and analysis of the diversity of forms and grammatical meanings, according to the methods, their endings changing under different times, persons number, their internal developments, as showed in the summary of the authors.

Focusing on a few special occasions of the morphological constructions with their grammatical meanings they carry, they light and analyze further developments in some of the verbal system of north Western Gheg.

We have also dwelled on some tense meanings of stative verbs in other manners and forms which turned out to be quite rich.

With the research methods followed we have compared the verbal system of the language of the summary Bernardin Palaj authors and Donat Kurti Albanian standards, with the Gheg dialects in any case be isolated with the Northern older authors.

Keywords: Gheg, verb forms, standard, paradigm, tense meanings.